

Prof. Dr.
Mehmet
MAKSUDOĞLU

HISTORIA OSMANE DHE INSTITUCIONET



**Bu kitap (Yurtdışı Türkler ve Akraba Topluluklar Başkanlığı)
desteğiyle Arnavutçaya kazandırılmıştır.**

**Ky libër është botuar në gjuhën shqipe
falë mbështetjes së YTB**

**(Kryesia për turqit që jetojnë jashtë atdheut dhe marrdhënieve
me komunitetet mike)**



ANKARA 2019

Titulli origjinal:
Osmanlı History and Institutions

Titulli:
Historia osmane dhe institucionet

Autori:
Prof. Dr. Mehmet Maksudoğlu

Ribotimi i 3-të i rishikuar 2019

Shqipëroi nga anglishtja:
Enilda Meidani

Redaktoi:
Petrit Bezhani

Faqosja dhe kopertina:
Halil Berisha

BORDI BOTUES – ALSAR
Mehdi Gurra – Kryetar Bordi
Saimir Rusheku- Teolog
Prof.Dr. Zyhdi Dervishi – Sociolog
Prof.Dr. Luan Malltezi – Historian
Dr. Abaz Hado – Mjeshtër i Madh
Shaban Murati – Mjeshtër i Madh
Sherif Delvina - Historian

ISBN



Adresa: Rruga e Bogdaneve Pallati Eurocol Kati 1
Tiranë-Albania
Tel&Fax: 00355 4 2241852
e-mail: alsar2006al@yahoo.com
Website: www.alsar-al.com



HISTORIA OSMANE dhe INSTITUCIONET

Prof. Dr. Mehmet Maksudođlu

ANKARA 2019

PËRMBAJTJA

FJALORTH	XI
SHKURTIME	XIX
SHËNIME SQARUESE MBI SHQIPTIMIN E TINGUJVE NË	
HYRJE	XXIII
Paraqitja e librit:.....	XLIII

PJESA E PARË**THEMELIMI I DEVLETIT OSMAN**

1289 – 1453

KAPITULLI 1

ISLAMI NË ANADOLL	3
1.1 Islami dhe turqit:	7
1.2 “Hapja” e Anadollit ndaj Islamit.....	11
1.3 Pushtimi mongol i Anadollit.....	18

KAPITULLI 2

THEMELIMI I DEVLETIT OSMAN	21
2.1 Ertuğrul Gaziu	21
2.2 Osman Gaziu 1289-1324	22
2.3 Orhan Beu 1324-1360.....	40
2.4 Hilafeti: Qëllimi dhe ideali i osmanëve	45
2.5 Gazi Sulltan Muradi 1360-1389.....	54
Rikthimi për të hapur territore të reja në Evropë.....	68
Lufta e parë e Kosovës 791/1389.....	77
Struktura administrative osmane.....	81
2.6 Sulltan Jëlldërëm Bajezid Hani 1389-1402.....	83
Beteja e Nigbollut (Niğbolu) (Nikopolit) 798/1396.....	89
Emir Timuri dhe Jëlldërëm Bajezidi	97
Vlerësimi.....	103
Periudha e trazirave 1402 – 1413	105

KAPITULLI 3

RIVENDOSJA	107
3.1 Çelebi Mehemmedi 1413-1421	107
3.2 Sulltan Muradi II 1421-1451	116
3.3 Abdikimi i Sulltan Muradit.....	132

KAPITULLI 4**KTHIMI NË NJË SUPERFUQI 145**

4.1 Fatih Sulltan Mehemed Hani 1451-1481	145
Hapja e Kostandinopojës ndaj Islamit 857/ 29.05.1453	150
Xhihadi kundër Serbisë	167
Fitorja në Berat të Shqipërisë	168
Rrethimi i Beogradit.....	169
Hapja e Serbisë ndaj Islamit në 863/1459.....	170
Hapja e Pontusit ndaj Islamit në 865/1461.....	171
Hapja e territoreve të reja ndaj Islamit në Shqipëri.....	175
Princi Vlad i Vllahisë, Gjakatari	178
Hapja e Bosnjës ndaj Islamit	179
Republika e Raguzës.....	180
Hapja e Moresë (Peloponezit) ndaj Islamit	181
Aneksimi i Bejlikut të Karamanit	182
Beteja e Otlukbelit 878/1473	183
Hapja e qyteteve Kefe dhe Azak ndaj Islamit 880/1475.....	185
Hapja e rajoneve të reja evropiane ndaj Islamit	187
Vdekja e Sulltanit Fatih.....	189

PJESA E DYTË**EKSPANSIONI**

1481-1699

KAPITULLI 5

5.1 SULLTANI BAJEZID VELI 1481-1512	201
Ekspedita drejt Bogdanit	207
Ndihma ndaj muslimanëve të Andaluzisë.....	209
Xhihadi drejt Lehistanit	210
Marrëdhëniet osmane-memluke	211
Përfundimi i hapjes së Moresë ndaj Islamit	212
Përhapja e Shiizmit në Anadoll	213

KAPITULLI 6**LUFTA PËR UNITETIN ISLAM 217**

6.1 Javuz Sulltan Selim Hani 1512-1520.....	217
Beteja midis Javuzit dhe Ismailit	221
Fushata kundër memlukëve	228
Hilafeti Osman.....	237
Çështjet detare	242
Aneksimi i Krimesë.....	243
Kalorësit e Shën Xhonit (Kalorësit ndihmëtarë).....	244
Vdekja e Sulltan Selimit.....	246

KAPITULLI 7	
SUPERFUQJA BOTËRORE.....	249
7.1 Kanuni Sulltan Sylejmani (i Madhërishëm) 1520-1566.....	249
Hapja e Beogradit ndaj Islamit	250
Hapja e Rodosit ndaj Islamit 928/1522.....	251
Beteja e Mohaçit në vitin 932/1526	254
Rrethimi i parë i Vjenës 935/1529	257
Fushata e tretë në Hungari 938/1532.....	258
Fushata e katërt në Hungari 948/1541	260
Fushata e pestë në Hungari 950/1543.....	261
FUSHATA NË EL-IRAKEJN DHE PUSHTIMI I BAGDADIT	263
Fushata në Iran	265
Veprimtaritë e flotës detare.....	267
Veprimtaria osmane në Oqeanin Indian	278
KAPITULLI 8	
FILLIMI I DOBËSIMIT	287
8.1 Selimi II 1566-1574.....	287
Përpyekja për ndërtimin e Kanalit të Vollgës 1569	288
Hapja e Qipros ndaj Islamit	289
Disfata e osmanëve në Inebahtë 979/1571	290
Përpyekja tek Kanali i Suvejsshit 980/1572	292
8.2 Sulltan Muradi III 1574-1595.....	294
8.3 Sulltan Mehmede III 1595-1603.....	299
8.4 Sulltan Ahmedi I 1603-1617	305
KAPITULLI 9	
SULLTANI OSMAN BIE NË NJË NIVEL	
ME PERANDORIN.....	307
9.1 Traktati i Zitvatorokut 1606	307
9.2 Sulltan Osmani II 1618-1622.....	308
Mbretvrasja e Genç Osmanit 1622.....	310
KAPITULLI 10	
RIGJALLËRIMI.....	313
10.1 Sulltani Murad IV 1623-1640.....	313
Marrja e Bagdadit nga Shahu i Iranit.....	313
Ekspedita e Sulltan Muradit në Revan	314
KAPITULLI 11	
RËNIA DHE RINGRITJA.....	317
11.1 Sulltan Ibrahim i 1640-1648	317
11.2 Sulltan Mehmede IV 1648-1687	318
11.3 Sulltan Sylejmani II 1687-1691	331
11.4 Sulltan Ahmedi II 1691-1695	332
11.5 Sulltan Mustafai II 1695-1703.....	333

PJESA E TRETË

RËNIA

1699-1922

KAPITULLI 12	339
12.1 RIFILLIMI I RËNIES	339
12.2 Sulltan Ahmedi III 1703-1730.....	341
Beteja e Prutit 1711	341
Lufta me Austrinë	344
Lufta me Persinë.....	346
KAPTULLI 13	
PËRPFJEKJA PËR RINGRITJE	347
13.1 Sulltan Mahmudi 1730-1754.....	347
Lufta me Rusinë.....	347
Lufta me Austrinë	349
Lufta me Persinë.....	351
KAPITULLI 14	
KRIZË DHE PËRPFJEKJE	353
14.1 Sulltan Mustafai III 1757-1774.....	353
Lufta me Rusinë.....	353
Asgjësimi i flotës osmane	356
Sulmi rus kundër Krimesë	357
KAPITULLI 15	
PËRPFJEKJA PËR RINGRITJE	359
15.1 Sulltan Abdulhamidi I 1774-1789	359
Kërëmi (Krimea).....	362
Lufta me Austrinë dhe Rusinë 1201/1787.....	363
15.2 Sulltan Selimi III 1789-1807.....	365
15.3 Sulltan Mustafai IV 1807-1808	376
15.4 Sulltan Mahmudi II 1808-1839.....	377
Nacionalizmi dhe ndikimi mbi Devletin Osman	378
15.5 Sulltan Abdylmexhidi 1839-1861.....	391
Lufta e Krimesë 1853-1856.....	400
Fermani i Islahatit 1272/1856.....	403
Situata financiare.....	405
15.6 Sulltan Abdylazizi 1861-1876.....	409
15.7 Sulltan Muradi V 1876	424
KAPITULLI 16	
RUAJTJA DHE PËRTËRITJA	427
16.1 Sulltan Abdylhamidi II 1876-1909.....	427
Shpallja e Kushtetutës (Meshrutijet).....	427
Parlamenti Osman (Mexhlis-i Meb’usan).....	431

Pushtimi francez i Tunizisë.....	438
Dyjun-ë Umumijje (Huat Publike)	440
Pushtimi britanik i Egjiptit 1882.....	441
Bullgaria	444
Lufta osmano-greke	445
Marrëdhëniet osmano-gjermane	446
KAPITULLI 17	
SHOQËRIA ITTIHAD ve TERAKKI	
(BASHKIM DHE PËRARIM).....	449
17.1 Shfronësimi i sulltanit	455
17.2 Sulltan Mehmed V Reshad 1909-1918.....	457
Lufta e Tripolit 1911	458
Luftat Ballkanike 1912-1913	460
Lufta e Parë Botërore 1914-1918	462
17.1 Mehmedi VI Vahideddini.....	467
PËRFUNDIMI	468
SULLTANËT OSMANË	478
SHTOJCË	481
1 - ENTITETI SOCIO-POLITIK OSMAN: PERANDORI	
apo DEVLET?.....	481
2 - NDJESË NË EMËR TË KRYQTARËVE	498
Ndjesë pas 9 shekujsh	498
3 - 20 USHTARAKË OSMANË ISHIN TË BARABARTË ME	
NJË USHTRI	499
INSTITUCIONET OSMANE.....	501
HYRJE.....	503
I – ORGANIZIMI ADMINISTRATIV	507
1. Hilafeti	507
2. Vizareti.....	515
3. Divani.....	518
3.1 Divan-ë Hymajun	519
3.2 Divani i Vezir-i A' zamit.....	521
4. Kalemijje	521
5. Komunikimi	522
II – INSTITUCIONET EKONOMIKE.....	525
6. Administrimi i Tokës	525
7. Tregtia.....	526
7.1 Ahijje-Fitjan	527
8. Financa.....	528
8.1 Bejtu'l Mal.....	528
8.2 Zekati	528

8.3 Oshr	530
8.4. Xhizja.....	530
8.5 Taksa Haraxh	532
8.6 Gana'im, Fej.....	533
III – SISTEMI LIGJOR.....	535
9. Kada (Drejtesia)	537
Nekibu'l Eshraf	539
9.1 Shejhulislami	540
9.2 Kadiaskeri (Kazaskeri).....	543
9.3 Ihtisab Agasë (Ağası)	545
IV – ORGANIZIMI USHTARAK	549
10. Ushtria	549
10.1 Ushtria qendrore.....	550
10.2 Ejalet Askerleri (Ushtria provinciale)	555
11. Flota detare.....	560
11.1 Flota qendrore.....	560
11.2 Muxhahidinët vullnetarë.....	562
V – INSTITUCIONET SOCIALE	567
12. Vakëfi	567
13. Zavije-Tarikatet.....	570
14. Imaret	573
15. Kervansaraj.....	574
16. Hamami	576
17. Spitali	578
18. Arsimimi.....	582
18.1 Xhamia	582
18.2 Sibjan mektebi.....	583
18.3 Medreseja.....	584
18.4 Enderun	588
PËRFUNDIMI.....	591
BIBLIOGRAFIA	593
TREGUESI.....	603

FJALORTH

ahi: Ahijje-Fitjan ishte një forcë vullnetare policore religioze-ushtarake në Anadoll, në shekullin e 13-të dhe të 14-të, që ishte e përbërë nga tregtarë dhe artizanë. Ata nuk paguheshin nga Devleti Osman dhe ishin të përjashtuar nga taksat.

akënxhë (akinxhi): Ishin forca vullnetare kufitare nën komandën e Akënxhë Begi (Beği/Beu). Këto komando sulmuese ishin *muxhahidinë* të fuqishëm, të stërvitur mirë, jashtëzakonisht të guximshëm. Ata përdorshin për të demoralizuar armikun.

alp, alperen: Një luftëtar *muxhahid* i përgatitur shpirtërisht dhe fizikisht.

beğlerbeği (Bejlerbej): Bej i Bejlerëve. Devleti Osman kishte kryesisht dy bejlerbejë, gjatë periudhës klasike: njërin për Rumelinë (në Evropën Osmane), dhe tjetrin për Anadollin. Secili prej tyre qëndronte në krahun e djathtë të ushtrisë, kur xhihadi zhvillohej në rajonin që ai mbulonte.

bejtulmal (beytülmal) (në arab.: bejtu'l mal): Thesari Publik i Devletit Musliman.

berat: Dekreti i autorizimit.

bork, boryk (bërk, börüük): Kapelja e turqëve. Forma e saj ndryshonte sipas klimës dhe kohës. Gokturqit (Göktürk) mbanin *börk* (ose *böryk*) të punuar nga lëkura dhe leshi i qengjit me lesh mbi të. Ndërsa, turqit që jetonin në pjesën veriore të Kaspikut dhe Detit të Zi, mbanin kapelen *börk* të punuar nga lëkura e qepur e qengjit, që quhej edhe *kalpak*. Turqit e Anadollit mbanin kapele (*börk*) prej shajaku.

Trupat jeniçere, që u krijuan nga Orhan Gaziu, mbanin kapelen *börk* me ngjyrë të bardhë.

dervish (në pers.: darvish): Ndjekës i një urdhri sufrit.

devshirme: Fëmijë jomuslimanë që konvertoheshin në fenë islame, dhe më pas rekrutoheshin në shërbimin ushtarak që njihej me emrin *jeniçeri* (jeniçer). Ata, që ishin shkolluar në *Enderun* (Shkollën e Pallatit) bëheshin *pashallarë*, *vezirë* dhe *sadrizamë*.

dizdar: Komandanti i një kështjelle.

zimmi/dhimmi (në arab.: dhimmi): Jomusliman, që jetonte në mbrojtjen e Devletit Musliman.

enderun (në pers.: anderun): Shkollë e Pallatit.

eren: Një njeri i devotshëm që arrin një nivel të lartë shpirtëror dhe shikohej si *veli* (shenjtor musliman).

ezan (në arab.: adhan): Mënyra islame e thirrjes për namaz.

ferman: Dekreti i Sulltanit.

feta (në arab.: fata): I ri, i fuqishëm, i aftë dhe i virtytshëm.

fetva (në arab.: fatua): Mendim ligjor që jepej nga Shejhulislami, ose nga Muftiu.

gaza (në arab. ghaza): Sipas përdorimit osman, ka kuptimin e xhihadit. *Xhihad* dhe *muxhahede* janë mënyra paskajore e foljes *xhahade*, në gjuhën arabe, që do të thotë të luftosh. *Xhihad* do të thotë të luftosh kundër jobesimtarëve dhe *muxhahede* do të thotë të luftosh me vetveten për të arritur nivele më të larta.

gazi (në arab.: ghazi): *Muxhahid*, luftëtar për çështjen e Islamit.

gusl (në arab.: ghusl): Abdesi i madh (larja e tërë trupit).

haxhet namaz: Dy rekate të namazit, për t'iu lutur Krijuesit për ndonjë nevojë (*salat el-haxheh*).

hafëz (në arab.: hafiz): (shumësi: Huffaz) Një person që e di përmendësh gjithë Kur'anin Fisnik.

hamam (në arab.: hammam): Banjë publike.

hamamxhë esnafë: Njerëzit, që siguronin ujë të ngrohtë dhe vende të përshtatshme për ushtrinë osmane, për të bërë banjë gjatë xhihadit.

haraç (në arab.: haraxh): Taksë për tokën, që paguhej nga jomuslimanët, që jetonin në territorin e Devletit Osman.

haxh: Peligrinazhi në Ka'be, në Meke el-Mukerreme.

ixhazet (në arab.: ixhazeh): Leje për të kryer një veprim.

ikta (në arab.: ikta’): Ndarja e një pjese toke për t’ua dhënë individëve. Kjo praktikë u fillua nga Pejgamberi i Fundit, dhe më pas u pranua nga osmanët nën emërtimin *tëmar* (*timar*). Tëmaret pak më të mëdha quheshin *ze’amet* dhe ato që ishin më të mëdhatë quheshin *hass*.

imaret (në arab.: ‘imareh): Një ndërtesë që shërbente për të ushqyer njerëzit e varfër; ajo ndonjëherë shërbente edhe si strehë. Të ardhurat e saj vinin nga *vakëfi*, që ishte caktuar për mirëmbajtjen e saj. Tradita e *imaretit* vazhdoi në Turqi edhe pas rrënimit apo rënies së Devletit Osman. Pothuajse në çdo fshat gjendej një dhomë e veçantë e quajtur *köy odasë* (*köy odası*) për vizitorët që mund të qëndronin atje për tre netë dhe mund të ushqeheshin falas. Kjo periudhë (3 ditore) është e përcaktuar në mënyrë të veçantë në një nga *hadithet sherif* (thëniet e Pejgamebrit të Fundit).

jeniçeri: Ushtar i ri. Devleti Osman stërviste robërit e tij të konvertuar për t’i përgatitur ata si luftëtarë. Ata u quajtën *jeniçeri*, një term ky që më pas nga gjuha angleze u kthye në “*janissaries*”.

kadë (në arab.: kadi): Gjykatës musliman që duhej të jepte vendime në përputhje me Sheriatin (Ligjin e Shenjtë të Islamit).

kazasker (në arab.: kadi asker): Gjykatës ushtarak. Devleti Osman, duke qenë se e kishte bazuar themelin e tij në idealin e xhihadit, e krijoi në një kohë mjaft të hershme postin e kazaskerit (gjykatësit ushtarak). Me kalimin e

kohës, ky post u nda në dy poste kryesore: Kazaskeri i Rumelisë dhe Kazaskeri i Anadollit.

kaptan-ë derja: Kryekomandanti i forcave detare osmane.

mehter: Banda ushtarake osmane, që ka qënë një traditë selçuke, nga ku dhe u mor, dhe që luante zakonisht muzikë çdo pasdite. Kjo bandë përdorej në mënyrë të dobishme gjatë xhihadit. Ajo u kthye në një model të bandave të ardhshme evropiane.

menhur (në arab. manshur): Dekret i lëshuar nga sulltani, me të cilin u jepet rangu vezirit, bejlerbeut, etj., ose për emërimin e dikujt për kryekomandant të ushtrisë. Është sinonim i fermanit.

muxhahid/myxhahid (në arab.: muxhahid): Luftëtar në xhihad.

muderris/myderris (në arab.: mudarris): Një profesor apo mësues i medresesë.

mukashefe/mykashefe (në arab.: mukashafeh): Përqasja shpirtërore e një *veliu* për të arritur njohurinë për të panjohurën.

muselem/mysel-lem (në arab.: musel-lem): Një ushtar, që përjashtohet nga taksat. Fillimisht, pjesëtar i trupës së këmbësorisë së krijuar nga Orhan Gaziu.

muteveli/mytevel-li (në arab.: mutevel-li): Administratori i një vakëfi.

nedim (në arab.: nadim): Një njeri dijetar dhe i këndshëm me të cilin sulltanët kishin kënaqësi të bashkëbisedonin.

oshyr/oshr (öşür) (në arab.: ushr): E dhjeta (1/10). Një musliman paguan *oshyr* për grurin e prodhuar që mund të ulet në të njëzetën, nëse përfshihen shpenzimet njerëzore dhe të tjera.

raijjet (në arab.: ra'ijeh) (shumësi: ra'aja): Ata për të cilët Devleti Osman kujdesej. Popullsia e qeverisur në administratën islame nuk janë **subjekte**, por ishin dhe u

quajtën **ra'aja**. Kjo fjalë nënkupton përgjegjësinë e Devletit ndaj popullsisë së qeverisur.

sadrizam (në arab.: sadr a'zam): Kryeveziri.

salat (në pers.: namaz): Mënyra muslimane e adhurimit pesë herë në ditë. Pejgamberi i Fundit u mësua se si të falej nga Xhibrili (Gabriel).

sipahi (spahi): Kalorës. Njësitë *sipahi* u krijuan gjatë viteve të sundimit të Sulltan Muradit (1362-1389). Përveç njërive *sipahi* në kryeqytet, ekzistonin edhe njësi të tjera kalorësiake të provincave, që po ashtu quheshin *sipahi*.

sufi: Njeri i devotshëm dhe besimtar: që i përket njërit prej urdhrave shpirtërore të quajtura *tarikat*.

syrrë (mahmal) (në arab.: surreh): Dhurata dhe para që u dërgoheshin njerëzve të dy Qyteteve të Shenjta të Islamit, Mekës dhe Medinës. Sulltani i parë osman që dërgoi **syrrë**, ishte Çelebi Mehemmedi (1413-1421). Që nga viti 1517 dhe deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore, osmanët rregullisht dërgonin **syrrë** vjetore në Hixhaz. Dhe **Syrrë Emini** (Kreu i grupit të **syrrës**) kryente **haxhin në emër të sulltanit**.

sunnet/synnet (në arab.: sunnat): Tradita e Pejgamberit të Fundit.

shehzade (në pers.: shahzadeh): Djali i sulltanit.

shejh/sheh (në arab.: shejkh): Mjeshtër shpirtëror i urdhrit të sufive. Pjesa më e madhe e sulltanëve dhe e vezirëve osmanë kishin një respekt të konsiderueshëm ndaj *shejhëve*.

shejhulislam/shejhyislam (në arab.: shejhu'l Islam): Autoriteti më i lartë gjyqësor dhe arsimor i Devletit Osman. Ai ishte në një nivel të barabartë në hierarki me Sadrazamin dhe Devleti Osman duhej të merrte miratimin e tij për çështje të rëndësishme.

tablhane (në pers.: tablkhaneh): (shiko **mehter**) Banda ushtarake muslimane.

tarik (në arab.: **tarik**): Një urdhër sufit.

tekke/teqe: Shtëpia e një *shejhu* dhe vendi ku mblidheshin anëtarët e urdhrut sufi, ku praktikohet trajnimi shpirtëror dhe u jepet ihtarëve.

tekmur: Guvernatori romak i një qyteti apo një qyteze.

tëmar/timar: Sistemi Osman i *iktasë*.

tug (tuğ): Maja e shtizës së flamurit me tre bishta kali që shënonte pozitën e lartë të pronarit të saj.

ulufe (në arab.: 'ulufeh): Paga që u jepej jeniçerëve çdo tre muaj.

vakëf (në arab.: uakf): Ndihma që ndanin të pasurit për qëllime fetare dhe shoqërore.

veli shum.: **evlija (në arab.: uali, shum.: eulija')**: Një njeri shumë i dashur, i devotshëm, i pastër dhe i dliur, që arrin në një niv` shumë të lartë shpirtëror.

vezir (në arab.: uazir): Sipas konceptit islam, një person i cili merr përsipër përgjegjësinë dhe **përgjegjshmërinë** për çështjet e Devletit, duke pasur më shumë fuqi dhe autoritet se një ministër i kabinetit qeveritar, në ditët e sotme.

xhihad: Lufta e shenjtë e Islamit.

xhizje (në arab.: xhizjeh): Rrënja e kësaj fjale vjen nga arabishtja *xheza*, që do të thotë të kompensosh. Pra, *xhizje* ishte një taksë lokale që paguhej nga jomuslimanët, që jetonin në mbrojtjen e Devletit Musliman. Kjo taksë ndryshonte për nga sasia, dhe: të varfërit, gratë, fëmijët, skllëvërit, murgjit dhe eremitët ishin të përjashtuar nga kjo taksë. Kjo ishte një urdhëresë e Krijuesit në Kur'anin Kerim [Sure *et-Teve*, 29] dhe u zbatua fillimisht nga Pejgamberi i Fundit, kur ai u nis për në xhihadin në Tebuk, në vitin 9/630; Peshkopi i Akabes (Ajles), Juhanna, shkoi tek ai me një kryq floriri, që varej në kraharorin e tij dhe pagoi taksën *xhizje*. Për pasojë, ai përfitoi mbrojtjen e Devletit Musliman.

zekat (në arab.: zakah): E dhënë fetare, që duhej të paguhej nga muslimanët e pasur. Zekati është urdhëresë e dhënë nga Krijuesi, në vende të ndryshme në Kur'anin Fisnik. Kur një musliman paguan zekatin e tij, prona e tij pastrohet dhe rritet.

SHKURTIME

Aşıkpaşaoğlu Tarihi: Aşık Paşa-zade, *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, (*Tevarih-i Al-i Osman*), bot. nga Nihal Atsız, Ankara 1985.

AÜİF Dergisi: *Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*. (Revista periodike e Fakultetit Teologjik, Universiteti i Ankarasë).

BOA: Başbakanlık Osmanlı Arşivi (Arkiva e Kryeministrisë, Stamboll).

Feridun Beğ, Münsheat: Feridun Ahmed Beğ, *Mexhmu'a-i Mysnsheat-i Selatin*, Stamboll, 1274 H. I-II.

Karal, OT: Enver Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi*, Ankara: Türk Tarih Kurumu (Instituti i Historisë Osmane), vëll. V-VIII.

Lewis, Emergence: Bernard Lewis, *The Emergence of Modern Turkey* (Krijimi i Turqisë Moderne), botimi i dytë, Londër: Oxford University Press, 1968.

Na'ima: Mustafa Na'ima, *Rawdatu'l Husejn fi Hulasati Ahbari'l Hafikejn* (*Tarih-i Na'ima*) bot. i dytë , 6 vëll. Stamboll, 1280 H.

Neşri: Mehmed Neşri, *Kitab-ı Cihan-numa*, red. nga F.R. Unat dhe M.A. Köymen, Ankara: Türk Tarih Kurumu (Instituti i Historisë Osmane), 1949.

Netajixh: Mustafa Nuri Pasha, *Netajixhul Vukuat*, Stamboll, 1327 H, I-IV.

Shaw: Stenford Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey* (Historia e Perandorisë Otomane dhe Turqia Moderne), vëllimi I, Cambridge, 1988.

Uzunçarşılı, OT: İsmail Hakkı Uzunçarşılı, *Osmanlı Tarihi* (Historia Osmane), Ankara: Türk Tarih Kurumu (Instituti i Historisë Osmane), 1947-.

Uzunçarşılı: İsmail Hakkı **Uzunçarşılı**, *Osmanlı Devleti Teşkilatından Kapıkulu Ocakları*, Ankara: Türk Tarih Kurumu (Instituti i Historisë Osmane), 1984.

s.a.v.s.: sal-la Allahu alejhi ve sel-lem.

s.v.t.: subhanahu ve te'ala.

p.b.w.h.: Paqja qoftë me të (p.q.m.t.).

r.a.: radiallahu 'anhu (Allahu qoftë i kënaqur me të).

SHËNIME SQARUESE MBI SHQIPTIMIN E TINGUJVE NË GJUHËN TURKE

ğ është një tingull që nuk shqiptohet, por që shërben për të zgatur shqiptimin e një tingulli që është para tij. Sipas shqiptimit të fjalës në tekst diku është zëvendësuar me “g”, diku me “j” ose nuk është shqiptuar fare.

ı shqiptimi ë

ö si shqiptimi i grupit dyzanorësh *eu* në frëngjisht ose *ö* në gjermanisht. Ky tingull haset edhe në të folurit e disa zonave veriore të trojeve shqiptare.

ü shqiptimi y

Shkronjat e tjera dhe tingujt e tyre shqiptohen në mënyrë të ngjashme me shkronjat dhe tingujt e gjuhës shqipe.

HYRJE

Mbi historinë osmane¹ janë shkruar shumë libra në gjuhë perëndimore, por pjesa më e madhe e tyre bazohen vetëm në burime dytësore. Megjithatë, unë nuk kam për qëllim që nëpërmjet këtij libri, i cili bazohet në burimet osmane, të bëj një kritikë të literaturës ekzistuese mbi historinë osmane, edhe pse mund të jetë e nevojshme që të diskutojmë mbi problemet e saj metodologjike dhe të konceptimit, si dhe të shpjegojmë metodologjinë time dhe objektivat dhe përfundimet e mia në këtë hyrje.

Gjithashtu, këtu do të jepet edhe një përmbledhje e këtij libri. Duhet të ishte e pritshme që të gjithë autorët e historisë osmane, të ishin bazuar kryesisht në burimet osmane të historisë, por, për një kohë të gjatë, ky fakt është anashkaluar dhe shpërfillur plotësisht, ashtu siç përmendet në mënyrë të qartë edhe në librin e Stenford Sho (Stanford Shaw) *Historia e Perandorisë Osmane dhe Turqia Moderne*: “Sigurisht, historia osmane është diskutuar shumë kohë më parë dhe në detaje, por gjithmonë nga këndvështrimi evropian, në dritën e para-

1 Emrat e përveçëm dhe emërtimet nuk duhet të ndryshojnë; sepse çdo ndryshim përbën shtrembërim. **Për këtë arsye nuk ka asnjë shkak ta shtrembërojmë “Osman” në “Otoman”.** Megjithatë, në disa raste, edhe në Perëndim është përdorur emri i duhur “Osman”. Shiko, për shembull: Z. Duckett Ferriman, *Turkey and the Turks* (Londër: Mills and Boon Limited; 1911) fq. 50-51; H. A. Gibbons, *The Foundation of the Ottoman Empire: A History of the Ottoman Empire up to the death of Bayezid I, 1300-1403*, (Frank Cass & Co. 1968) fq. 158-159, 163, 173-179, 183 dhe 184.

gjykimeve evropiane dhe kryesisht mbi bazën e burimeve evropiane.”² Sho dhe bashkëshortja e tij Ezel Kural Sho e kanë pranuar këtë fakt me guxim në librin e tyre *Historia e Perandorisë Osmane dhe Turqia Moderne*, duke u shprehur: “ ... ne nuk kërkojmë ndjesë për faktin që kemi përdorur burime otomane për një histori të Perandorisë Otomane. **Për një kohë shumë të gjatë historia e otomanëve është studiuar pa marrë nën shqyrtim asnjë nga burimet e tyre, gjë që ka sjellë shtrembërime dhe gabime të rënda. Historia e Francës nuk do të konsiderohej e saktë dhe e balancuar nga pikëpamja metodologjike, nëse do të shkruhej mbi bazën e vëzhgimeve angleze apo italiane.** Megjithatë, në të njëjtën kohë, ne kemi përdorur një pjesë të madhe materialesh të rëndësishme jo-osmane, ashtu siç vihet re dhe në Bibliografinë e këtij libri.”³

Duke qenë se shkencëtarët perëndimorë vijnë nga një sfond krejtësisht i ndryshëm, ata kanë disa “prirje” të caktuara. Këta shkencëtarë e nënvlerësojnë madje dhe e injorojnë faktin që **“vendet dhe popujt janë të veçantë dhe nuk mund të ndërhyjnë kaq lehtë në identitetin e njëri-tjetrit, me përjashtim të disa rasteve të kufizuara dhe specifike”**.⁴ Pra, në këtë rast është e nevojshme të kuptojmë dhe të përcaktojmë shumë terma në lidhje me osmanët dhe historinë e tyre. Si fillim, duhet të sqarojmë emërtimin e saktë të kësaj strukture socio-politike. Pothuajse në të gjitha studimet akademike angleze, ndeshemi me përdorimin e termit “Perandori Osmane.” Por, nëse hedhim një shikim në dokumentet osmane, korrespondencën zyrtare, traktatet dhe librat e shkruara gjatë asaj periudhe dhe nga historianët e tyre zyrtarë, vihet re se nuk është përdorur asnjëherë nga ata titulli “Imperatorije-i Osmanije”. Osmanët e

2 Stanford J. Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey* (Cambridge University Press, 1991) vëll. I, fq. vii.

3 Stanford J. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey* (Cambridge University Press, 1997) vëll. II, fq. X. Theksimi është shtuar.

4 Rupert Emerson, *From Empire to Nation* (Cambridge, Massachusetts: Harvard University Press, 1967), fq. vii. Theksimi është shtuar.

emërtuan strukturën e tyre socio-politike “Devlet-i Alijje-i Osmanijje” dhe disa herë edhe “Devlet-i Senijje” (Devleti Sublim Osman dhe Devleti i Mrekullueshëm, përkatësisht). Faktikisht, termi *Devolet* është përdorur nga vetë osmanët për shekuj me radhë. **Largimi nga ky emërtim i përveçëm** gjithsesi do të nënkuptonte një vlerësim *subjektiv* dhe më e pakta shfaqjen e një qëndrimi *jomiqësor*. Gjithashtu, është një rregull i përgjithshëm dhe universal që emrat e përveçëm duhet të lihen si të tillë dhe nuk duhet të përkthehen asnjëherë. Veçanërisht termi **perandori nuk i përshtatet fare** strukturës socio-politike osmane. Për këtë është e mjaftueshme të rikujtojmë se pjesa më e madhe e *sadrazamëve* (vezirëve të mëdhenj) dhe *vizirëve* osmanë nuk ishin me origjinë turke, ndërkohë që *jeniçerët* mbajtën pozitën e tyre të lartë deri në fund të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Pra, si racizmi, ashtu dhe nacionalizmi, ishin të panjohur për strukturën osmane. Ata nuk e imponuan asnjëherë gjuhën e tyre ndaj komuniteteve të tjera. Përkundrazi, ata përdorën gjuhën arabe si një mjet shkollimi në institucionet e tyre të arsimit. Për më tepër, ata përdorën alfabetin arab të Kur’anit për gjuhën e tyre – turke osmane. Nga perspektiva ekonomike, pretendimi se shtrirja osmane drejt territoreve të tjera, për të përfituar lëndën e parë për industrinë e tyre, është i gabuar dhe çorientues. Për shembull, vajtja e tyre në Jemen, nuk ishte për shkak të naftës, por për t’i parandaluar fuqitë evropiane që t’i afroreshin rajonit të Detit të Kuq, dhe dy qyteteve më të shenjta të fesë Islame, Mekës dhe el-Medinës. Me pak fjalë, Devleti Osman nuk kishte për qëllim shfrytëzimin e popullsisë së territoreve të aneksuara prej tij. Në fakt, tregtia dhe industria ishin në duart e popujve jomuslimanë, ashtu siç është pranuar dhe nga vetë Bernard Luis (Bernard Lewis): “Industria dhe tregtia iu lanë subjekteve të pushtuara jomuslimane, që vazhduan të praktikonin trashëgiminë e tyre artizanale.”⁵

5 Bernard Lewis, *The Emergence of Modern Turkey*, Botimi i Dytë (London: Oxford University Press, 1968), fq. 2.

Pasi bëmë një përcaktim të çështjes së emërimit të Devletit Osman⁶, duhet të shpjegojmë kuptimin dhe nënkuptimin e *divanit* ose qeverisë osmane. Termi *Divan* në origjinën e tij ka kuptimin e regjistrave për çështjet administrative, ushtarake dhe fiskale; dhe vendi ku mbaheshin këto regjistra dhe blloqe llogarish, u quajt në mënyrë metaforike *divan*, dhe në të njëjtën kohë ka kuptimin e regjistrit ose bllokut të llogarive. Në një *hadith sherif* (thënie e Pejgamberit (s.a.v.s) që u transmetua nga Ummul Mu'minin (Nëna e besimtarëve) Aisheja (r.a) thuhet: "Janë tre *divane* në prezencën e Allahut".⁷ Nga ana tjetër, Pejgamberi (s.a.v.s) përdori shkruer për shkrimin e *vahjit* (shpalljes). Mund të argumentohet se këta shkruer e përpiluan *divanin* e parë të fesë Islame.⁸

Gjithashtu, lista e shokëve të Pejgamberit të Fundit Muhammed (s.a.v.s.) në el-Medinë, afro 1500,⁹ mund të merret si një lloj *divani*, pasi ai iu dha atyre '*ata* (*ma'ash*) (taksa 1/5) në të njëjtën ditë që mori *fejin* (sasinë e përfutur nga jobesimtarët si dëmshpërblim pa përfshirë luftën). Në përputhje me këtë *divan* (regjistër): dy pjesë iu takojnë të martuarve dhe një pjesë i takon të pamartuarve.¹⁰ Kur u shpërndante '*atijeh* (*ma'ash*) (taksa 1/5) për muslimanët, Halifi i parë Ebu Bekri (r.a.) e pyeste personin: "A ke pronë që të paguash *zekatin*?". Nëse personi përgjigjej "po", Halifi merrte *zekatin* nga '*ata* (*ma'ashi*) i tij.¹¹

Halifi i dytë Omer b. el-Hattabi, ishte i pari në histori që krijoi *divanin* në kuptimin administrativ.¹² Ky institucion

6 As fjala "shtet" nuk i korrespondon fjalës "Devlet". Koncepti i fjalës "shtet" mori në botën perëndimore përmasa të tjera si dhe një jurisdikcion më të gjerë, që pas Traktatit të Vestfalias (Westphalia) nënshkruar në vitin 1648. Autoritetet e "shtetit" mund të ligjëronin në mënyrë absolute, por në konceptin dhe praktikën islame *devleti* është vetëm një mjet për zbatimin e Sheriatit, që ishte paracaktuar nga Krijuesi tashmë.

7 Ahmed Ibn Hanbel, *el-Musned*, VI, fq. 240.

8 Hassan Ali Hallak, *Tarihun Nukud ve'd Dawawin* (Bejrut: 1986) fq. 86.

9 Buhari, *es-Sahih, Kitabul Xhihad ve's Sijer*, 181.

10 Ebu Davud, *es-Sunen, Imareh*, 14.

11 Malik b.Enes, *el Muvatta'*; *Zekat*, 4

12 el Maverdi, *el Ehkamu's Sultanijeh* (Kajro: 1983), fq. 172

vazhdoi të ekzistonte përgjatë gjithë administrimit musliman: të emevitëve (661-750); të abasidëve (750-1258); të selçukëve të mëdhenj (1075-1157); dhe selçukëve të Anadollit (1079-1308). Kur dinastia osmane e mori territorin e dinastisë së selçukëve të Anadollit, ajo vazhdoi të mbante të njëjtën strukturë dhe institucione islame, përfshirë edhe *divanin*.

Duke qenë se osmanët e mendonin veten si ata që mbanin mbi supe përgjegjësinë e përfaqësimit dhe zbatimit të mesazhit hyjnor apo qiellor të Islamit, osmanët e quajtën *divanin* e tyre, Divan-ë Hymajun (*Divan-ı Hümayun*). *Hymajun* vjen nga fjala perse Hyma (*Hüma*), një shpend i mitologjisë (feniksi) për të cilin thuhet se ai jeton disa qindra vjet dhe pasi e djeg vetveten, më pas rilind nga hiri i trupit të tij. Përderisa ai jetonte gjithmonë në qiell, *Hymajun* do të thotë “qiellor”, ose “që i përket qiellit”. Osmanët e shikonin veten si përcjellës të Mesazhit të Fundit Qiellor – Islamit, dhe, për këtë arsye, e lidhnin çdo ngjarje të rëndësishme me fjalën *Hymajun*.¹³ Për këtë arsye u përdor dhe Ordu-ju Hymajun (*Ordu-yu Hümayun*) ose Ushtria Qiellore, dhe Hatt-ë Hymajun (*Hatt-ı Hümayun*) ose Dekreti Qiellor i Halifit – Sulltanit. Porta e parë e rezidencës së Halifit, Pallati Topkapë, u quajt Bab-ë Hymajun (*Bab-ı Hümayun*): Porta Qiellore. Për këtë arsye edhe termi *Divan-ë Hymajun* do të thotë **Divani Qiellor**. Është e gabuar që ky term të përkthehet si “Këshilli Perandorak”, siç e përkthen Stenford Sho¹⁴ pasi nuk pasqyron kuptimin e duhur. Për më tepër, **emërtimet nuk duhet të përkthehen në asnjë rast.**

Divani ishte i përbërë nga vezirët. Fjalën vezir mund ta ndeshim në disa raste në Kur'an me kuptimin “ndihmës”,

13 Në përkthimin e tij të veprës së shtjelluar të Sarë Mehmed Pashait, *Nesai-hul Vyzera ve'l Umera*, nën titullin “Ottoman Statecraft, The Book of Counsel for Vezirs and Governors of Sarı Mehmed Pasha, *The Defterdar*” (Princeton: Princeton University Press, 1935) Walter Livingston Wright Jr. përkthen gabimisht “Rikab-ı Hümayun”-in si “Porta Perandorake” (fq. 71, shënimi në fund të faqes me nr. 48), dhe e percepton Divan-ı Hümayun si “Divani Perandorak”, fq. 17.

14 S. Shaw, *The History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, (C.U.P. 1976), fq. 25, 26, 101, 102, 108, 115, 117...

“asistent”, “mbështetës”, kur Pejgamberi Musa (Paqja qoftë me të) i kërkoi Allahut të Plotfuqishëm: “Dhe cakto një *vezir* për mua nga familja ime, vëllanë tim, Harunin.”¹⁵ Fjala *vezir* përmendet edhe në thëniet e Pejgamberit të Fundit Muhammed (s.a.v.s.): “Nëse Allahu dëshiron një *emir* (administrator) të mirë, i jep atij një *vezir* të drejtë dhe të besueshëm. Kur ai harron, ai i kujton atij, kur atij i kujtohet, ai e ndihmon atë.”¹⁶; “Secili prej jush ka një detyrë dhe nëse Allahu ia do të mirën, i jep atij një *vezir* të mirë. Nëse ai harron, veziri e kujton atë, kur atij i kujtohet, ai e ndihmon atë.”¹⁷ Fjala *vezir* e ka prejardhjen nga rrënja arabe *vzr* që do të thotë përgjegjësi. *Vezir* ka kuptimin e një personi që mban mbi supe përgjegjësi dhe merr mbi vete *barrën* e popullit. Siç thuhet edhe në Kur’an, “*La teziru vaziretun vizra uhra*”¹⁸: “Asnjë shpirt nuk mban barrën e tjetrit.”

Divani në administratën osmane, u themelua fillimisht nga Orhan Gaziu (1324-1362), në ndjekje të praktikës së dinastisë së selçukëve të Anadollit, dhe numri i vezirëve u rrit me kalimin e kohës. Gjatë sundimit të Mehemmed Çelebiut (1413-1421) dhe djalit të tij Muradit II (1421-1451), një nga vezirët u quajt “*ullu vezir*” (veziri i madh), dhe më pas *vezir-i a’zam*. Emërtimi i fundit vazhdoi të përdorej deri në kohën e Sylejmanit të Madhërishtëm (1520-1566), i cili e ndryshoi këtë titull me përcaktorin *sadr-i a’zam* (*sadrizam*). *Sadrizam* osman ishte një vezir i *tefovizit* (*vezir* i autorizuar), të cilit i jepej autoritet i plotë, dhe vepronte në emër të Sulltanit pasi mbante edhe *myhr-i hymajun* (mühr-i hümayun – vulën e Sulltanit). Megjithatë, në rast se ai do të kryente mëkat të madh, ai do të mbante përgjegjësinë dhe mund të humbiste dhe jetën. Por do të ishte e pasaktë t’i referoheshim *sadrizamit* si “nëpunësi i parë ekzekutiv i shtetit duke filluar nga viti 1360”,¹⁹ siç bën Sho, pasi veziri kishte një

15 *Kur’ani Fisnik, Ta Ha*: 29, 30.

16 Ebu Davud, *es-Sunen, el-Imareh*, 14.

17 Nesai, *es-Sunen, el-Bey-eh*, 33.

18 *Kur’ani Fisnik, el-Enam*: 164.

19 S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 25.

kompetencë ekzekutive (*vezir* i tenfidhit) vetëm në fillimet e tij. Por, kur numri i vezirëve u shtua me kalimin e kohës, njëri prej tyre përzgjidhej si *sadrazam* dhe njihej si *vezir* i *tefvizit* (vezir i autorizuar). Për më tepër, në administratën osmane, *vezir* nuk duhet përkthyer si ministër.

Një koncept tjetër për të cilin është e nevojshme të bëhen sqarime më të detajuara, është edhe termi *fet'h*. Shumë studiues e përkthojnë atë si pushtim, dhe kështu *el-Fatih* bëhet “pushuesi”. Por, pushtimi nuk është, si të thuash, i njëjtë me *fet'hin*. Ndërkohë që pushtim nënkupton nënshtrim me dhunë, *fet'hi* i një vendi do të thotë fjalë për fjalë hapja e tij ndaj Islamit, jurisprudencës së tij (shariatit) dhe vlerave, por pa i detyruar njerëzit në asnjë mënyrë të pranojnë Islamin. Islami përkrah tolerancën fetare dhe të gjithë jomuslimanët kanë të drejtën e lirisë së plotë të besimit të tyre. Midis tyre, meshkujve që i përkasin moshës madhore u kërkohet të paguajnë taksën *khizje* në këmbim të mbrojtjes së jetës dhe pronës së tyre, si dhe *haraxh* (haraç) për tokën që kanë në pronësi. Në këtë aspekt, si dhe në aspekte të tjera, ata trajtohen në baza të njëjta me muslimanët, të cilëve iu kërkohet të paguajnë *zekat* për pronën dhe *'ushr* për të korrat e tyre.

Zekati është i institucionalizuar në Kur'anin Fisnik dhe përmendet shpesh në të së bashku me fjalën *salat* (namaz).²⁰ *Zekat* në gjuhën arabe nënkupton “pastërti” dhe muslimanët janë të detyruar ta paguajnë këtë taksë për pronat dhe atë që kanë në zotërim, në mënyrë që t'i “pastrojnë” ato nga të drejtat e të tjerëve. Kur një musliman paguan *zekat*, pasuria e tij do të rritet, ashtu sikurse rritet edhe një pemë pasi degët e saj krasiten. Krijuesi e paracaktoi këtë detyrim; dhe në Kur'an janë përcaktuar qartazi sferat e shpenzimit të tij.²¹ Pra, motivimi i

20 *Kur'ani Fisnik, el-Bekare*, 43, 110, 177; *en-Nisa*, 162; *el-Maide*: 55. *Ushr* do të thotë një e dhjeta. Megjithatë, fermerët mund të paguanin të njëzetën nëse ata pësonin dëmtime dhe bënin shpenzime të tepërta për tokat e tyre.

21 *Kur'ani Fisnik, et-Teubeh*: 60.

pagesës së *zekatit* duhet të jetë një karakteristikë e rëndësishme e sistemit fiskal për çdo Devlet musliman. Osmanët, që ishin të përkushtuar për zbatimin e Islamit në të gjitha aspektet e jetës, e ruajtën këtë institucion në Devletin e tyre ndër shekuj.²² Duhet të rikujtojmë se shumë studiues të përgatitur mirë në fushën e jurisprudencës Islame (Fikh) në vazhdimësi kanë rrjedhur në territorin osman ndërsa të tjerë diplomoheshin në medresetë e tij. Puna e rëndësishme për referencë *esh-Sheka'iku'n Nu'manijjeh fi Ulema'id Devleti'l Uthmanijjeh e Tashkopryzades* (Taşköprüzade)²³ na jep një listë të gjatë të atyre që jetuan në periudhën e sundimit të Osman Gaziut. Devleti Osman i respektonte parimet islame të drejtësisë, në një masë të tillë, sa që zakonisht nuk kishte asnjë musliman nevojtar për të marrë *zekat* gjatë periudhës së sundimit të Orhan Gaziut (1324-1362).²⁴ Në të vërtetë, në aspektin e organizimit shoqëror dhe të bamirësisë, ishte një sistem më i përparuar se ai i Perandorisë Romake. Për këtë arsye, vlerësimi i Sho se osmanët e mbajtën me pak ndryshime “strukturën e taksave” dhe “praktikat feudale” të Perandorisë Bizantine²⁵, është i pasaktë.

Gjithashtu, ne jemi kundër përdorimit të termit “praktikë feudale”, pasi sistemi *tëmar* (timar) osman nuk kishte të bënte aspak me feudalizmin.²⁶ Në fakt, ai ishte një vazhdimësi e konceptit të *iktasë*, që ishte filluar nga Pejgamberi i Fundit (s.a.v.s.),

22 Ata, gjithashtu, e mbajtën edhe *khizjen* që përmendet në *Kur'anin Fisnik, et-Teubeh*, ajeti 29. Atë e mori Profeti nga populli i Akabes (Ejle) gjatë ekspeditës së tij në Tebuk në 9/630.

23 Tashköprüzade Ahmed 'Isameddin, *esh-Sheka'iku'n Nu'manijjeh fi 'Ulema'id Devleti 'Uthmanijjah*. Rastësisht emri i tij nuk është Husameddin siç e lexon Shaw: vepra e cituar, fq. 145.

24 Neşri (Mehmed), *Kitab-ı Cihan-Nüma* (botim i F.R. Unat dhe M.A. Köymen) Ankara, Türk Tarih Kurumu, 1949, I, fq. 26.

25 S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 26.

26 Zakonisht në shkrimet e tyre, studiuesit perëndimorë e barazojnë sistemin *timar* me feudalizmin dhe *timarlı sipahi* (kalorësia provinciale) kthehet automatikisht në “Ushtri feudale”. Shiko për shembull: Walter Livingstone Wight, *Sarı Mehmed Pasha, the Defterdar, Ottoman Statecraft, Turkish Text with Introduction, Translation, and Notes* (Princeton: Princeton University Press: 1935), fq. 43.

dhe që u përvetësua nga Hulefai Rashidunët, në Devletin e parë musliman në histori. Nën sistemin *timar*, në shenjë vlerësimi të trimërisë së tyre, dhe me kusht që ata të pajisnin Devletin me një numër të caktuar ushtarësh të stërvitur dhe të armatosur mirë, *sipahive* (spahinjve), u jepej e drejta për të administruar (jo për të pasur në pronësi) dhe e drejta për të mbledhur të ardhurat e disa pjesëve të tokës. Njerëzit, që jetonin në këto toka, njiheshin si *ra'ijjet* (rajë) (ata të cilët ishin nën përkujdesje), por ata nuk konsideroheshin kurrësi si skllëvër, siç konsiderohejshin në periudhën feudale. Ndërkohë që gjatë feudalizmit, ata mund të shiteshin së bashku me kafshët e fermave, dhe bashkëshorteve të tyre të sapomartuara u kërkohej ta kalonin natën e tyre të parë të martesës me pronarin feudal të tokës (kjo praktikë në latinisht quhet: **jus primae noctis**). Për këto praktika çnjerëzore në sistemin *timar* nuk kishte vend. Përkundrazi, *sipahiu* (spahiu) kishte përgjegjësinë të mbronte *nderin*, jetën dhe pronën e popullsisë *ra'ijjet*.

Literatura në këtë libër, është marrë kryesisht nga burime bashkëkohore osmane. Duke treguar ngjarje të ndryshme kam bërë një gjykim nëpërmjet sfondit të tyre, dhe në disa raste kam paraqitur krahasimin me situatën në vende të tjera në të njëjtën kohë. Një krahasim i tillë, mund të jetë mënyra më e mirë për të kuptuar dhe vlerësuar faktet dhe ngjarjet. Jam përpjekur, gjithashtu, ta shikoj entitetin socio-politik osman, ashtu si ata e perceptonin atë, duke i mbështetur faktet sipas rrethanave dhe kushteve të tyre. **Kjo do të jetë me shumë mundësi një përjasje shumë e ndryshme nga përjasjet e tjera, që janë shfaqur në historiografinë ekzistuese osmane, pasaktësive të të cilave iu jam referuar në disa raste në këtë vepër.**

Burimet

Burimet të cilave iu jam referuar për këtë libër janë si më poshtë vijon:

Për gjenealogjinë osmane, burimi kryesor është dorëshkrimi i Jazëxhëzade (Yazıcızade), me titullin *Selçukname*, që ruhet në Muzeun *Topkapë Sarajë* në Stamboll (TSMK, Revan 1391).

Për sa i përket themelimit të Devletit Osman është përdorur gjerësisht vepra e mirënjohur e **Feridun Beut**, *Munsheat-i Selatin*. Feridun Beu ishte shkruesi i *Sadrazamit* osman **Sokollu Mehmed Pasha** (1505-1579) që i shërbeu **Sylejmanit të Madhë-rishëm** (1520-1566), të birit të tij **Selimit II** (1566-1574) dhe **Muradit III** (1574-1595). Në veprën e tij me dy vëllime, Feridun Beu, mblodhi dhe përpiloi korrespondencën e sundimtarëve osmanë. Edhe pse mund të jetë e hapur ndaj kritikës në lidhje me korrespondencat e Osman Gaziut dhe të Orhan Gaziut, kjo veper përbën një burim të rëndësishëm pasi jep informacione të bollshme. *Kjo veper të paktën pasqyron konceptin osman për qëndrimin ndaj ngjarjeve dhe mënyrës së të menduarit rreth tyre*. Ajo tregon në veçanti se Devleti Osman – ndryshe nga shumë emirate të tjera – nuk u themelua nga rrënim i Devletit të Selçukëve të Anadollit. Përkundrazi, Sulltani selçuk caktoi Osman Gaziun si drejtues të qytezës Sogyt (Söğüt) dhe e shikonte atë si pasardhësin e tij të mundshëm, sikurse paraqitet qartazi edhe në veprën e **Neshriut**, *Xhihan nyma (Cihan-numa)*.

Për këtë periudhë, jam bazuar edhe në veprën me dy vëllime të **Neshriut**, *Xhihan-nyma*, që u botua nga Shoqata e Historisë Turke në Ankara, në vitin 1949. **Neshriu** jetoi gjatë epokës së **Fatihut** (1451-1481) dhe birit të tij, **Bajezidit II** (1481-1512). Vepra e tij është një nga burimet e para të historisë osmane, që u përdor – në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe indirekte – në periudhat që pasuan, nga historianë osmanë të tillë si: Sa’deddin, Solakzade dhe Mynexhxhimbashë (Münejjimbashu). Janë marrë gjithashtu referenca edhe nga vepra e **Ibn Battutës**

(703-770/1307-1369), që ka vizituar Anadollin gjatë kohës së Orhan Gaziut (1326-1362). Edhe pse ai nuk ishte një historian i mirëfilltë, vepra e Ibn Battutës, *Tuhfetu'n Nuzzar*, është mjaft e rëndësishme pasi bën një "përshkrim të admirueshëm dhe të pavarur të Azisë së Vogël"²⁷ të asaj kohe.

Për periudhën e hershme të historisë osmane, burimi të cilit i jam referuar, është vepra e **Ashëkpashazades** (803/1400-?), *Tevarih-i Al-i Osman* (Histori të Familjes së Osmanit), publikuar me titullin *Aşıkpaşaoğlu Tarihi* dhe redaktuar nga Atsëz (Atsız). Ashëkpashazade, mori të dhënat e tija nga **Jahshë Fakih**, imami i xhamisë së Orhanit në Bursa. Për këtë periudhë kam konsultuar edhe veprën e **Oruç Beut**, si dhe *Düsturname* e **Enveriut**.

Për sa i përket periudhës së **Fatihut** (1451-1481), burimet e mia janë kryesisht: *Tarih-i Ebu'l Fet'h* e **Tursun Beut** (Tursun Beğ) dhe *Xhihan-nyma* e Neshriut. Tursun Beu jetoi në shekullin e 15-të dhe e shkroi këtë vepër midis viteve 903-905/1497-1500, e cila pasqyron ngjarjet historike të periudhës 848-893/1444-1488.

Për **Bajezidin II** (1481-1512) jam mbështetur kryesisht mbi *Xhihan-nyma* të **Neshriut**.

Për periudhën e Selimit I (1512-1520) referencat e mia kryesore janë bazuar në **Xhelalzade Koxha Nishanxhë Mustafa** (v.975/1567), *Kitab-i Measir-i Selim Hani*, që gjendet në TSMK, h.1415, dhe në veprën e **Ibn Ijasit** – *Bedai'uz Zuhur*, që mbulon periudhën deri në vitin 928/1521. Jam konsultuar gjithashtu edhe me veprat e Kemal Pashazades (Ibn Kemalit), në mënyrë të veçantë me defterin e tij të 7-të (vëllimin 7). Kjo vepër të cilës i jam referuar, është e përbërë nga 10 deftere (vëllime) që mbulojnë historinë osmane nga fillimet deri në vitin 1527. **Ibn Kemal Shemu'd Din Ahmed** lindi në vitin 873/1468-69 në Edrene (Edirne) dhe i përkiste një familjeje të shquar. Gjyshi i tij Kemal Pasha, nofken e të cilit më pas e mori ai, ishte një komandant gjatë periudhës së **Fatih Mehemed** (1451-1481), ndërsa

27 D.E. Pitcher, *An Historical Geography of the Ottoman Empire*, (Leiden: E.J. Brill, 1972), fq. 5.

babai i tij, Sylejmani, ishte komandant gjatë periudhës së **Bajezidit II** (1481-1512). Ibn Kemali mori postin e Kadiaskerit (gjykatësit ushtarak) të Anadollit në vitin 922/1516, mori pjesë në fushatën kundër memlukëve, dhe u emërua për Shejhulislam në vitin 932/1526. Ai ndërroi jetë në vitin 940/1534.²⁸

Hoxha Sa'deddin (1536-1599), djali i **Hasan Xhanit**, një *nedim* i **Selimit I** (1512-1520), ushtronte profesionin e *muderrisit* (profesorit) gjatë periudhës së sundimit të **Sylejmanit të Madhërishëm** (1520-1566). Vepra e tij *Taxhu't Tevarih* (Kurora e historive) jep një informacion me shumë vlerë mbi historinë osmane deri pas vdekjes së Selimit I. **Hoxha Sa'deddin** personalisht luajti një rol kyç në ndryshimin e disfatës së ushtrisë osmane në fitore, në Betejën e Haçovës të vitit 1596.

Për sa i përket periudhës së **Sylejmanit të Madhërishëm** (1520-1566), burimet mbi të cilat jam bazuar janë veprat e: **Selanikiut** (v.1600); **Solakzades** (v.1657); **Na'imas** (1665-1716), kronistit të parë të oborrit osman **Piri Reisit** (v.1553), dhe një kohë sadrazamit **Lytfi Pasha** (1539-1541). Gjithashtu, iu jam referuar dhe jam konsultuar me veprat e: **Katib Çelebiut** (1609-1657); **Peçuji Ibrahimit** (1574-1649); dhe të **Silahdar Fëndëkllellë Mehmed Agait**. Kam përdorur edhe vepra të tjera të kronistëve osmanë të tilla si: veprat e **Na'imas** (1665-1716), pasardhësve të tij: **Mehmed Rashidit** (v.1735), **Ahmed Vasëfit** (1739-1807), **Ahmed Asimit** (1755-1819) dhe **Shanizade Mehmed Ataullahut** (v. 1827).

Vepra e **Mustafa Nuri Pashait** (v.1307/1889), *Netajixhul Vuku'at* (*Netayijul Vuku'at*), (4 vëllime në 1), Stamboll 1327, dhe vepra e **I. H. Uzunçarshëllë** (İ.H. Uzunçarşılı), *Osmanlı Tarihi*, (I-IV) janë marrë gjithashtu si referencë në këtë libër. I pari shërbeu në postin e *Defter-i Hakani Nazërë* (zyrtarit më të lartë përgjegjës për Çështjet Financiare Osmane) për 5 vjet (1293-1298/1876-1881), dhe si i tillë, vepra e tij ka shumë vlerë për sa i

28 Şerafettin Turan, Ibn Kemal, *Tevarih-i Al-i Osman VII. Defter*, Atatürk Kültür, Dil ve Tarih Yüksek Kurumu, Ankara, 1991, IX-XXII.

përket dhënies së një informacioni të detajuar, dhe përvojës personale të një zyrtari të brendshëm. Ndërsa i fundit ishte një historian mjaft prodhimtar, që i përket periudhës midis dekadave të fundit të Devletit Osman dhe një periudhe mbi gjysëm shekulllore të Turqisë republikane. Vepra e tij *Osmanlı Tarihi* I-IV, që bazohet në burime dhe të dhëna nga arkiva osmane, është një punim me vlerë mbi politikën osmane. Vepra e I.H. Uzunçarshëllë, u vazhdua nga **Enver Zija Karal** (Enver Ziya Karal), i cili shkroi edhe 4 vëllime të tjera në gjuhën turke (V-VIII), që bënin fjalë kryesisht për ngjarje të shekullit të 19-të.

Përveç burimeve të lartpërmendura, jam konsultuar me materiale të tjera në lidhje me këtë temë, ku përfshihen edhe të dhëna të arkivuara.

Vrojtime të rëndësishme

Ndërsa studion burimet osmane, mund të ndodhë që të ndeshesh me informacione interesante, dhe ndoshta edhe me informacione të reja. Këto burime, për shembull, faktojnë se **Devleti Osman është themeluar në vitin 1289 dhe jo në vitin 1299**, siç është pretenduar përgjithësisht. Duke qenë se nuk kishte asnjë pasardhës, në vitin 688/1289, sovrani Selçuk i dërgoi Osman Gaziut, të cilin e shikonte si djalin e tij, një daulle të madhe dhe një flamur të bardhë.²⁹ Ky i fundit, kishte planifikuar në fakt të shkonte në Konja, në kryeqytetin Selçuk, me dhurata të çmuara me shpresën se do të bëhej *veliahd* i Sulltanit selçuk, por ai nuk arriti, pasi sulltani vdiq. Edhe pse vazhdoi të mbante Hutben e së Xhumasë dhe *sikkenë* (monedhën në qarku-

29 Neşri, *Kitab-i Cihan-Nüma*, (Ankara Türk Tarih Kurumu, 1949) I, fq. 109; Feridun Beğ, *Munshat-i Selatin* (Stamboll: 1274) I, fq. 56. Në të dyja këto vepra, Sulltani, i cili i dërgoi flamurin dhe daullen Osman Gaziut, është Alaeddin b. Feramurz. Sulltani e shikonte Osman Gaziun si djalin e tij dhe kjo është përmendur në *Cihannüma* (I, fq. 109), ndërsa flamuri (AK Sanxhak) përmendet në *Munshat* (I, fq. 56). Por mund të ketë një gabim në lidhje me emrin e vërtetë të sulltanit. Një fakt i sigurtë është se sulltani i asaj kohe, në vitin 1289, i dërgoi me të vërtetë Osman Gaziut një daulle të madhe dhe një flamur të bardhë.

llim) në emër të sulltanit nga respekti ndaj tij, faktikisht Osman Gaziu kishte arritur në atë kohë në një nivel më të lartë të pavarësisë.³⁰ **Në të vërtetë, ai u bë i pavarur në vitin 688/1289, sepse në atë vit ai mori *menshuranë*, daullen, shpatën dhe flaurin nga sovrani Selçuk.** Megjithatë, Osman Gaziu dhe pasardhësit e tij, në shenjë respekti ndaj selçukëve e vazhduan praktikën e tyre të dëgjimit në këmbë të *mehterit*, që luante muzikë gjatë pasditeve. Kjo praktikë, megjithatë, u ndërpre në kohën e Mehmed Fatihut (855-886/1451-1481), i cili pasi hapi Kostandinopojën për Islamin, në vitin 857/1453, e dëgjoi *mehterin* duke qëndruar i ulur.

Sipas një mendimi të përgjithshëm, Hilafeti i erdhi fundi pas rënies së Abasidëve në vitin 656/1258. Por, burimet osmane tregojnë se ky mendim apo pretendim nuk është i vërtetë, pasi Hilafeti Abasid në Bagdad, u transferua dhe vazhdoi me selçukët e Anadollit (1075-1308). Duke i dhënë Osman Gaziut, Sogytin, një qytet i vogël, që shtrihej në Anadollin veri-perëndimor në kufi me Perandorinë Romake, Sulltani selçuk i Anadollit, e quajti veten në *menshurasë* që daton nga Ramazani 683/Nëntor 1284 si: “*ve mansëb-i ma be-derehe-i nisbet-i zil-lullah fi'l Arz*” (Qëndrimi, pozita jonë është në rangun e **hijes së Allahut** në botë).³¹ Duke qenë se zil-lullah (Hija e Allahut) njihet si titull i Halifit, kjo do të thotë se Sulltani selçuk e mendonte veten si Halif. Për pasojë, ky institucion qëndror, mbijetoi në sajë të selçukëve të Anadollit (1075-1308) edhe pas nënshtrimit mongol të Abasidëve (1258).

Marrja e Hilafetit duket se ishte kthyer në një qëllim të osmanëve, që në vitin 1332, kur **Orhan Gaziu** i kishte shkruar hapur dhe qartë në *beratin* e tij (dekretin), djalit të tij më të madh, **Sylejman Pashait**, se ai e emëronte atë anëtar të divanit: “sepse është e detyrueshme që ne të rigjallërojmë funksionet e fesë dhe të modelojmë Devletin sipas praktikës së sulltanëve të

30 Neşri, *vepër e cituar*, fq. 108, rreshti 13.

31 *Munsheat*, I, fq. 48.

mëdhenj, që kishin funksionin e Halifit.”³² Djali i tij, **Muradi I** (1362-1389), e shikonte veten si Halif.³³ Në vitin 1391, edhe djali i **Muradit, Bajezidi** (1389-1402), u adresua nga sovrani i Egjiptit, **Haxh b. Sha’ban**, me titullin “Zil-lullah fil Hafikejn” dhe “Sulltan i muslimanëve”.³⁴ Djali i **Bajezidit, Çelebi Mehamedi** (1412-1421) dërgoi *surre* (dhurata) në Ka’be dhe para për popullsinë e Mekës dhe Medinës, ndërkohë që titulli i **Fatih Mehamedit** (1451-1481) ishte “Sulltani i dy kontinenteve, *Hakan* i dy deteve (Detit Mesdhe dhe Detit të Zi), **Emirul Mu’minin** (Princi i besimtarëve).”³⁵ Siç dihet, titulli *Emirul Mu’minin* është një titull tjetër që i referohet Halifit dhe që është përdorur fillimisht nga **Omer b. el-Hattab** (r.a.). Djali i **Fatihut, Bajezidi II** (1481-1512) u adresua nga **Husejin Bajkara** (795-819/1392-1416), **Padishahu i Horasanit**, si “Halifetullah fil enam” (**Halifi** (mëkëmbësi) i Allahut ndër Krijesat e Tij).³⁶ Sovrani i Indisë, **Ja’kub Shah** dhe djali i tij **Bajsungur Mirza** iu adresuan Bajezidit II si Halif, gjithashtu.³⁷ Ndërkohë që, djali i tij, **Javuz Selimi** (1512-1520), ishte i ndërgjegjshëm për pozicionin e tij si Halif, **Ubejd Hani** i Samarkandës e njohu atë si të tillë në vitin 920/1514, përpara se ai të merrte Egjiptin në vitin 923/1517.³⁸ Pra, në këtë mënyrë sulltanët osmanë vazhduan të mbanin titullin dhe pushtetin e Hilafetit, deri në fundin e Devletit të tyre. Ajo që **Abdylhamidi II** (1876-1909) bëri, ishte thjesht theksi që ai vendosi mbi nevojën e Unitetit Islamik, por

32 Po aty, I, fq. 69.

33 Po aty, I, fq. 87. në *beratin* (dekretin) e tij për Evrenos Beun, Muradi I, përmend faktin se tokat në Rumeli (pjesa evropiane e Devletit Osman), të aneksuara nga Evrenos Beu, i përkisnin Allahut, pastaj Pejgamberit të Tij (s.a.v.s) dhe më pas Halifit të Pejgamberit të Tij (që do të thotë vetë Muradit I), reshti 9.

34 Po aty, I, fq. 116.

35 Tursun Beg, *Tarih-i Ebul Fet’h* (Stamboll: Istanbul Fetih Cemiyeti, 1977), fq. 33.

36 *Munsheat*, I, fq. 306; Hysejin Bajkara vazhdon: “i caktuar për Sulltanatin dhe Hilafetin ... Mjeshtëri i xihadit (Ebu’l Megazi), Sulltan Bajezidi.”

37 Po aty, I, fq. 307, 326.

38 Po aty, I, fq. 375-377.

ai nuk e “shpiku” nocionin e Hilafetit, në kundërshtim të pretendimeve të disa studiuesve perëndimorë.

Burimet osmane tregojnë gjithashtu se **Javuz Selimi** ishte i vendosur të çrrënjoste shiizmin në Iran dhe ndërkohë kishte planifikuar që në vitin 1516 të marshonte kundër **Ismail Safeviut**. Por, avancimi i Sulltanit memluk **Kansu Gavri** (1440-1516), drejt Anadollit në po të njëjtin vit, e detyroi atë të ndalonte këtë aventurë. Nëse nuk do të kishte ndodhur kjo, **Javuz Selimi** do të kishte mundur t’ia dilte mbanë që të shfaroste shiizmin në Iran dhe të bashkonte territorin musliman sunnit të perëndimit me Turkestanin.

Historia sociale e Anadollit në dekadën e fundit të shekullit të 13-të dhe në dekadën e parë të shekullit të 14-të, mund të studiohet në një mënyrë të përshtatshme në librin e famshëm të **Ibn Batuttës**. Pas pushtimit mongol, pa dyshim që Anadulli vuajti shumë, edhe pse përshkrimi i kësaj situate nuk ishte edhe kaq i errët nga ç’pretendohet. Shoqëria ishte e mirorganizuar dhe *ahinjte* vepronin si forca vullnetare të sigurimit dhe mbanin – sipas trajnimit shpirtëror të sufive – një standard mjaft të lartë profesional dhe moral, të cilin ne nuk mund ta gjejmë në ditët e sotme, në forcat policore të shumë vendeve të ashtuquajtura vende të zhvilluara. Pra, është e arsyeshme të themi se: popullsia e Anadollit – pa dallim race apo besimi fetar – gëzonte gjatë erës osmane një siguri më të lartë, në krahasim me shumë popuj që në ditët e sotme jetojnë në disa qytete të Gjermanisë, Rusisë dhe SH.B.A-ve, për të mos përmendur në këtë rast edhe evropianët e shekullit të 14-të.

Burimet osmane tregojnë se Devleti Osman ishte në fakt një vazhdimësi e Devletit Musliman të **Katër Halifëve të drejtë**; dinastisë së **Emevitëve** (661-750) dhe të **Abasidëve** (750-1258); **Selçukëve** (1038-1157) dhe **Selçukëve të Anadollit** (1075-1308). Pjesa më e madhe e dokumenteve osmane e nxjerrin këtë fakt në pah, dhe unë do të citoj në këtë rast vetëm disa shembuj. **Sulltan Muradi I** (1362-1389), iu drejtua **Evrenos Beut** me titu-

llin “Emirul Mu’minin”, kur e emëroi atë komandant suprem të luftëtarëve *gazij* në Evropën osmane.³⁹ Ka mundësi që ai ta ketë bërë këtë si një veprim paralel me veprimin e Pejgamberit të Fundit Muhammed (s.a.v.s), i cili ia dha këtë titull për herë të parë ‘**Abdullah b. Xhehshit**, që udhëhoqi një grup të vogël të *muhaxhirinëve* për të kontrolluar veprimtaritë e Kurejshëve në vitin 2/624. Për më tepër, harkëtarët osmanë, në betejën e parë të Kosovës (791/1389), u krahasuan me harkëtarin e famshëm musliman, **Sa’d b. Ebi Vekkasin**, që hodhi 1.000 shigjeta gjatë betejës së Uhudit (3/625).⁴⁰

Katib Çelebiu, studiuesi dhe historiani i madh osman, thotë, “Duka i Venedikut ishte i barasvlershëm me rangun e **Bejlerbeut** në administratën **muslimane**.”⁴¹ Duke përdorur fjalën në gjuhën turke *bejlerbej*, në këtë kontekst musliman, autori tregon se turqit osmanë e kishin identifikuar plotësisht veten e tyre me Islamin. Një tregues tjetër i këtij fakti, mund të vihet re edhe në informacionin e dhënë nga **Neshriu**, në librin e tij me dy vëllime, për krijimin e trupës së famshme të ushtarëve jeniçerë. Osmanët e pranuan me vendosmëri dhe rreptësi ligjin e Krijuesit në Kur’an, duke marrë 1/5 e *ganimetit*⁴² (plaçkës së luftës) për Devletin.⁴³ Për më tepër, fëmijët që më parë kishin qenë të krishterë, por që ishin marrë si pjesë e *ganimetit* (plaçkës së luftës), trajtoheshin mirë. Dhe pasi ata pranonin Islamin, nuk diskriminoheshin për të marrë postet publike, dhe shumë prej tyre shërbyen në poste të ndryshme të tilla si: pashallarë, vezirë dhe vezirë të mëdhenj.

Ndoshta aspekti më domethënës i vazhdimësisë shfaqet në qëndrimin osman ndaj *Sahabit* të Madh (shokut të Pejgamberit të Fundit s.a.v.s) **Ebu Ejjub Halid b. Zejd el-Ensari**. Turqit e quajnë atë **Ejup Sulltan**. Edhe në ditët e sotme, pas një peri-

39 *Munsheat*, I, fq. 87.

40 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 294.

41 Katib Çelebi, *Tuhfetu'l Kibar fi Esfari'l Bihar*, (Stamboll, 1329), fq. 37.

42 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 96.

43 *Kur’ani Fisnik, el-Enfal*, ajeti 41.

udhe prej më shumë se 9 dekadash, pas shkatërrimit të Devletit Osman, tyrbja e Sulltan Ejupit, vizitohet nga çiftet e reja të saponmartuar dhe nga djemtë e bërë synet. Ceremonia e rrethprerjes në mënyrë domethënëse është quajtur në gjuhën turke “sünnet düğünü” (festa e synetit), në ndjekje të praktikës së Muhammedit (s.a.v.s.). Fakti që këtij Sahabi të Madh i është dhënë titulli “Sulltan”, është një shenjë e respektit më të lartë dhe më të thellë që i është bërë atij nga muslimanët osmanë.

Një fakt tjetër interesant që tregojnë burimet osmane, është se osmanët, ia dedikuan tokat që ndodheshin në zemër të Evropës, në Kanixhe (që në ditët e sotme i përket Hungarisë) qytetit të shenjtë të el-Medinës. Kur **Tirjaki Hasan Pasha**, u rrethua në kështjellën Kanixhe, në vitin 1601, nga **Arkiduka Ferdinand** i Austrisë, dhe nga një ushtri e madhe hungareze, komandanti i rrethuar musliman i nxiti moralisht ushtarët e tij duke iu thënë: “Kanixha dhe territori rrethues i saj janë kthyer në *vakëf* për qytetin e shenjtë të el-Medine el-Munevveres”, që do të thotë se të ardhurat e përfituara nga ky vend, do të shkonin për qytetin e Pejgamberit të Fundit (s.a.v.s.), dhe se Krijuesi nuk do të lejonte që kjo pjesë toke të binte në duart e jobesimtarëve.⁴⁴ Osmanët kishin caktuar edhe fshatra të tjera në Bursa (në Anadoll) dhe në Egjipt si *vakëfe* për *el-Haramejn esh-Sherifejn*. Të gjitha këto tregojnë “kujdesin” dhe dedikimin që Osmanët iu kushtonin vendeve të shenjta të Islamit.

Në burimet osmane edhe ndihma e tyre ndaj muslimanëve të Andaluzisë, është shprehur qartë; **Hëzër Hajreddin Reisi** (që më pas mori titullin Pasha: 1466-1546) shpëtoi 70.000 muslimanë nga Inkuizionin në Spanjë dhe i transportoi ata në Afrikën muslimane të Veriut.⁴⁵ **Kemal Reisi** (?-1511), i cili u emërua nga **Bajezidi II** si *Kaptan-ë Derja* (Kryekomandanti i Flo-tës Detare Osmane), arriti t’i ndihmonte me sukses muslimanët

44 Na’ima, *Ravzatul Husejn fi Hulasati Ahbaril Hafikejn*, (Stamboll: 1280), I, fq. 257.

45 Katib Çelebi, *Tuhfetul Kibar fi Esfaril Bihar*, (Stamboll: 1329), fq. 40.

e Andaluzisë në vitin 829/1487.⁴⁶ Prezenca osmane në Afrikën e Veriut, kishte shpëtuar vendin nga kthimi i tij në një Andaluzi të dytë, ose në një “Afrikë latine”. Nëse osmanët nuk do të kishin shkuar në këtë vend, popullsia e Libisë, Tunizisë dhe Algjerisë, do të ishte kthyer me shumë mundësi në një popull “katolik, spanjishtfolës”, dhe ajo e Marokut në popull “katolik, portugalishtfolës”. Është me shumë interes të përmendim në këtë rast faktin se Oruç Reisi, (?-1518), vëllai i madh i Hajreddin Pashait, shkoi nga Tunizia në Algjeri me kërkesë të fisnikëve dinjitarë të Algjerisë⁴⁷ për mbrojtjen e qytetit dhe vendit të tyre nga invadimi spanjoll.

Kur lexojmë një përshkrim të **Sulltanit osman Sylejmanit të Madhërishëm** (1520-1566) dhe një poezi të një komandanti *akinxhi*,⁴⁸ një dimension krejtësisht i ri hapet para syve tanë në lidhje me motivacionin e përparimit osman drejt Evropës. Pas fitores në betejën e Mohaç (932/1526), Sylejmani i Madhërishëm i tha ambasadorit hungarez që e vizitoi atë në Stamboll: “bota e krishterë grumbullonte re kërcënuese mbi paraardhësit e mi, por këto re nuk shpërthyen në shi. Nëse ata (bota e krishterë) nuk do t’i kishin shkaktuar këto beteja, nuk do të kishte qenë e nevojshme ajo gjakderdhje.”⁴⁹ Në poezinë e lartpërmendur komandanti *akënxhë Mihalogllu Ali Bej* (Mihaloğlu Ali Beğ) thotë si më poshtë vijon:

46 Mustafa Xhenabi, *Tarih*, Ragib Pasha Ktb. Nr. 986, 339b, cituar nga İsmet Parmaksızoğlu, “Kemal Reis” IA, fq. 566-569.

Piri Reis, *Kitab-ı Bahriye* (Stamboll: 1935), fq. 17; D.E. Pitcher është gjithashtu i ndërgjegjshëm për këtë fakt; Shiko: *An Historical Geography of the Ottoman Empire*, (Leiden: 1972), fq. 98.

47 Përkthimi i ftesës origjinale: TSMK E 6456.

48 *Akinxhi* ishte një forcë vullnetare osmane, që luftonte përkrah ushtrive qendrore dhe provinciale. Shpesh kjo forcë përdorej për të sulmuar paraprakisht armiqtë.

49 Cituar në veprën e Osman Turan, *Türk Cihan Hakimiyeti Mefkuresi Tarihi*, (Stamboll: Shtëpia Botuese Nakışlar, 1979), II, fq. 422.

*Eğer def elmaz ise bu beliyye
Ne İznik kala ne Konstantiniyye*⁵⁰

Nëse kjo sfidë nuk do të zmbrapset

As Nikea, as Kostandinopoja (Stambolli) nuk do të jenë në zotërimin tonë.

Kjo tregon se evropianët ishin të vendosur t'i zmbropsnin ata nga Evropa, në kohën kur osmanët kaluan Detin Marmara. Pra, osmanët duhet të luftonin për vendosjen dhe konsolidimin e autoritetit të tyre në këtë kontinent.

Kur lexojmë librin *Tarih* (Histori) të **Solakzades** (1000?-1068/1590?-1657), ne marrim njohuri të detajuara mbi aneksimin osman të Krimesë. Ashtu sikurse është përmendur edhe diku tjetër në këtë libër, **Fatih**u mori brigjet e Azakut nga gjenovezët, ndërkohë që pjesa e mbetur e Krimesë u aneksua në saj të diplomacisë së nipit të tij, **Javuz Selimit** (1512-1520).⁵¹

Gjithashtu, burimet osmane faktojnë edhe motivin kryesor të pranisë osmane në Jemen, që ishte mbrojtja e dy qyteteve të shenjta të Islamit, ndaj sulmit portugez të shekullit të 16-të, dhe armiqësive që do të vijonin nga fuqitë e tjera evropiane. Si mbrojtës të Qyteteve të Shenjta, osmanët ishin të detyruar të siguronin rrugën e *haxhit* (pelegrinazhit) nga India nënkonti-

50 Agah Sirri Levend, *Gazavatnameler ve Mihaloğlu Ali Beyin Gazavatnamesi*, (Stamboll: 1956), fq. 246, 254 dhe 295, cituar po aty, fq. 244.

51 Në librat e shkruara në gjuhët evropiane, aneksimi i Krimesë është pranuar përgjithësisht si një arritje e Fatihut; shiko për shembull hartën që tregon "The Rise of the Ottoman Empire: 1280-1683" në librin e S. Shaw *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey* (C.U.P.): 1976), I, XIV-XV. Disa deklarojnë se nuk është kaq e sigurtë nëse Fatihu përvetësoi të gjithë Krimenë apo vetëm brigjet e saj, **për shkak të mos përdorimit të burimeve osmane**. Por nuk përmendet Javuz Selimi, i cili ishte ai që arriti të përmbushte këtë detyrë të rëndësishme në një mënyrë tejet diplomatike.

mentale dhe Java, kundër epërsisë së flotës detare portugeze në Oqeanin Indian.

Duhet të theksojmë në këtë rast se studimi i atyre burimeve osmane kërkon një njohuri të mirë të gjuhës osmane dhe njohuri të mjaftueshme të gjuhës arabe dhe perse. Përveç kësaj, një person duhet të ketë dije të fesë islame, kulturës dhe historisë islame, në mënyrë që të arrijë të kuptojë dhe të vlerësojë historinë osmane. Edhe baza psikologjike e zakonshme mund të jetë një ndihmë e madhe në këtë kontekst. Pra, edhe një musliman turk, jopraktikues, është i destinuar të ndjejë disa boshllëqe dhe mangësi, edhe për sa i përket kuptimit të historisë osmane.

Paraqitja e librit:

Në ndryshim nga librat e tjerë të fushës, në këtë libër, Historia Osmane ndahet në tri pjesë kryesore:

Pjesa e parë (1289-1453), pasqyron periudhën që nga **Themelimi i Devletit Osman**, që fillon me vitin 1289 (dhe jo në vitin e shumë përmendur 1299) dhe vazhdon deri në hapjen e Kostandinopojës (Stambollit) ndaj Islamit (857/1453). Në fakt, Devleti Osman u kthye në një *bejlik* (emirat) të rëndësishëm gjatë sundimit të **Orhan Gaziut**, dhe në një superfuqi gjatë viteve të drejtimit të **Sulltan Muradit I**, i cili u shkaktoi disfatë ushtrive të bashkuara evropiane, dhe e reduktoi Perandorinë Romake në një vend vasal që iu paguante haraç osmanëve. Megjithatë, Devleti Osman mbeti i pasigurt derisa ai i dha fund Perandorisë Romake në vitin 1453.

Pjesa e dytë (1453-1699), ka të bëjë me **Shtirirjen e Devletit Osman**. Shtirirja e këtij Devleti pretendohet se ka vazhduar deri në vitin 1579, që përkon me vitin e vdekjes së vezirit të famshëm Sokollu Mehmed Pashait. Por, ne jemi tashmë në dijeni të faktit që kjo shtirirje vazhdoi edhe pas kësaj date. Egri (Eğri) u hap ndaj Islamit në vitin 1596, Kanixha në vitin 1600 dhe Estergoni në vitin 1605. Deri në vitin 1606, vit në të cilin u nënshkrua Traktati i famshëm i Zitvatorokut, statusi i gjithë

mbretërve të Evropës ishte i barabartë me atë të *Sadrzamid* osman, ndërsa Sulltani osman mbeti suprem ndaj të gjithë atyre. Sidoqoftë, me këtë Traktat, osmanët e njohën Mbretin e Austrisë me titullin Cezar, duke bërë që ai të vinte në një nivel të barabartë me atë të Sulltanit të tyre. Pra, ky traktat shënoi një pikë kthimi në historinë osmane.

Edhe pse Devleti Osman aneksoi Kretën dhe rrethoi Vjenën, kryeqytetin e Austrisë (1683), dukej se në dekadat e fundit të shekullit të 17-të, Devleti e kishte humbur forcën, dinamikën dhe zellin; dhe sipas Traktatit të Karlofças (1699) ata humbën territorin e tyre të parë.

Pjesa e tretë (1699-1922), është një studim i rënies graduale të Devletit Osman. Është e vërtetë se osmanët e mposhtën Carin rus, Petër, në Prut, në vitin 1711 dhe se pati përpjekje për modernizim dhe rigjallërim, por tipari i përgjithshëm i Devletit në atë kohë ishte shkatërrimi dhe rënia. Sulltani i aftë **Abdylhamid II** (1876-1909) u përpoq të bënte maksimumin për të rigjallëruar Devletin Osman. Përkundër intrigave të superfuqive të kohës, ky gjeni i politikës, arriti të mbante të bashkuar popuj të racave dhe kulturave të ndryshme, brenda një strukture të vetme socio-politike që vazhdoi të qëndronte për 30 vjet. Kjo arritje e besueshme, u realizua pa shkaktuar asnjë ngarkesë ekonomike të padrejtë mbi popullsinë. Përveç kësaj, Abdylhamidi ndërtoi dhe themeloi shumë institucione arsimit në të cilat u diplomuan shumë intelektualë të niveleve të larta. Gjithashtu, ai ishte një kampion i madh i Bashkimit Islamik, që ishte në linjë me traditën dhe parimet themelore të Devletit Osman.

Por me rrëzimin e tij nga fronti në vitin 1909, Devleti Osman, mori rrugën drejt shpërbërjes në duart e prijësve të Partisë Ittihad ve Terakki (Bashkim dhe Përparim), derisa u shkatërrua përfundimisht gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918) dhe pushoi zyrtarisht së ekzistuari më 4 nëntor 1922.

PJESA E PARË

THEMELIMI
I DEVLETIT OSMAN

1289 – 1453

KAPITULLI 1

ISLAMI NË ANADOLL

Vula e pejgamberëve, Muhammedi (s.a.v.s) pranoi shpalljen e parë në vitin 610 e.s. Menjëherë pas **hixhretit** (emigrimit) historik për në qytetin e Medinës, ai themeloi në vitin 622 Devletin e Parë Musliman në histori. Ky devlet i ri dhe mjaft dinamik, u përhap me shpejtësi në të gjitha drejtimet dhe i përcolli mbarë njerëzimit mesazhin e lavdishëm dhe revolucionar të Islamit, dhe brenda një kohe shumë të shkurtër sfidoi edhe vetë autoritetin dhe ekzistencën e dy superfuqive botërore, asokohe, në rënie: Perandorisë Romake dhe Persisë Sasanide.

Megjithatë, muslimanët kishin kaluar si fillim në rajonin e Anadollit gjatë Hilafetit Emevit (41-132 p.h. ☐ 661-750 e.s.), kur ushtria e tij marshoi drejt këtij vendi, deri sa mbërriti në Skutari, përballë kryeqytetit të Kostandinopojës, në pjesën evropiane të Bosforit. Për pasojë, një forcë tjetër e komanduar nga **Sufjan b. Avf** sulmoi Kostandinopojën. Ndërkohë flota muslimane lundroi në Detin Mesdhe dhe Detin Egje, derisa u vendos në Istmin e Kapëdagë (Kapıdağı), në bregdetin jugor të Detit Marmara. Nga kjo bazë detare strategjike, flota muslimane u hodh në sulm kundër flotës romake dhe më pas ndihmoi ushtrinë muslimane, gjatë rrethimit të Kostandinopojës.

Duhet të theksojmë këtu se midis luftëtarëve të ushtrisë muslimane, ishte sahabi i njohur (shok i Pejgamberit), **Ebu Ejjub Halid b. Zejd El-Ensari**, i cili strehoi Pejgamberin (s.a.v.s) gjatë emigrimit të tij në Medinë. **Ebu Ejjubi** vdiq atje në 49/669


dhe u varros jashtë mureve të qytetit të Kostandinopojës, në një vend që mbeti i papërcaktuar për 8 shekujt që do të pasonin. Njoftohet se kur Kostandinopoja “u hap”¹ ndaj Islamit në vitin 857/1453, Sulltani osman Mehemmedi i Dytë (el-Fatih) i bëri apel shejhut (prijësit sufi), Sufi Akshemseddin, që ta gjente vendndodhjen e varrit të tij, gjë që ai e bëri. Më pas, një monument guri u vendos mbi varrin e Ebu Ejjubit dhe pranë këtij vendi u ndërtua një xhami për nder të kujtimit të tij. Turqit i dhanë këtij sahabi të madh titullin sovran *Sulltan* dhe ai, rrjedhimisht, njihet mes tyre si “Sulltan Ejupi”. Sulltanët osmanë e inauguruan këtë vend gjatë një ceremonie të quajtur “Këllëç Allajë” (Parada e shpatës); dhe ata së bashku me komandantët e tyre ushtarakë e vizitonin tyrben e Ensarit për të marrë bekimin e tij, sa herë që duhet të niseshin në fushatat e tyre të Xhihadit kundër evropianëve jobesimtarë.

1 Termi “hapje”, përdoret në këtë libër me pak maturi, për të shmangur përdorimin e pakënaqshëm të termit “pushtim” apo “zaptim”.



Oborri i brendshëm i Xhamisë Ejup Sulltan.

Një ushtri tjetër muslimane e rrethoi Kostandinopojën në vitin 99/717-718, por nuk arriti ta hapte atë ndaj Islamit. Edhe pse komandanti me famë **Meslemeh b. Abd il-Melik** (v.120/738), kishte arritur të depërtonte në Anadoll, dhe e kishte pushtuar qytetin Kajseri në vitin 108/726, ku **Sejjid Battal Gaziu**, miku i tij i famshëm dhe trim, e shok shumë i ngushtë me të, ra martir i Islamit në pjesën perëndimore të Anadollit në vitin 122/740, prapë Kostandinopoja nuk u hap.



Sejitgazi

Dyert e minareve kudo që ndodhen qëndrojnë të hapura në drejtimin e Kibles. Por këtu janë të hapura në drejtimin e tyrbesë së muxhahidit të madh në xhami; dhe teksa myezini thërret ezanin duke i rënë përreth minares, nuk ia kthen asnjëherë shpinën tyrbes në shenjë respekti ndaj Battal Gaziut.

Kur kjo zonë u aneksua nga turqit selçukë, mbi varrin e tij u ndërtua një tyrbe dhe një xhami. Për një kohë shumë të shkurtër, vendi u bë shumë i famshëm dhe qyteti pranë këtij vendi mori emrin e tij: **Sejitgazi**.

Abasidët ndërmorën sulme të reja në rajonin e Anadollit. **Halifi Harun er-Rashid** (170-193/786-809), mundi **Perandorin romak Nikiforin**, gjatë një beteje pranë **Ereglit** (Ereğli), në Konja, në 190/806, dhe e detyroi atë të paguante taksën *xhizje* (taksë për frymë). Një Halif tjetër i Abasidëve, **El-Me'mun** (198-218/813-833), arriti të shkatërronte ushtrinë romake pas një beteje të ashpër që zgjati tre vjet (215-218/830-833), por ai vdiq në vitin 218/833 dhe u varros në qytetin e vogël historik të Tarsusit. Tyrbja e tij, sot, gjendet pranë xhamisë së madhe të këtij qyteti.

*Xhamia e Madhe**Sarkofagu i El-Me'munit*

Pasardhësi i tij, **El-Mu'tesim** (218-227/833/842), i shkaktoi më 220/837, një humbje tjetër të turpshme **Perandorit** romak **Theofilos**, duke shkatërruar dhe qendrën e rëndësishme të vendlindjes së perandorit, qytetin Amorium.

Gjithashtu, el-Mu'tesim arriti të zotëronte dhe zonën "Avasim", që shtrihej nga Malatja (Malatya) deri në Tarsus. Por të gjitha këto fitore ishin të përkohshme edhe pse Islami kishte fituar kontroll të fuqishëm të Anadollit, gjatë periudhës së turqve selçukë, të cilët zotëruan dhe vendosën pushtetin e tyre në pjesën më të madhe të këtij territori.

1.1 Islami dhe turqit:

Turqit e lashtë ishin vendosur përreth zonës së maleve Alltaj, në jug të lumit Jenisej. Ata ishin pasardhës të Ja'fethit, i biri i **Profetit Nuh** (a.s.). Personaliteti i tyre më i shquar është **Oguz (Oğuz) Han**, bashkëkohës i Profetit Ibrahim (a.s.), i cili e pranoi me dëshirën e tij Islamit. Turqit e quajnë atë **Zulka-rnejn. Oguz Han** kishte 6 djem: Gyn, Aj, Jëlldëz, Gok (Gök), Dag (Dağ) dhe Deniz. Prej tyre u formuan 6 fise si më poshtë:

Gyn Han – Kajë, Bajat, Alkaevli, Karaevli

Aj Han – Jazër, Doger (Döger), Dodurga, Jabërlle

Jëlldëz Han – Avshar, Karëk, Big-dili, Karkën

Këto fise u vendosën në anën e djathtë të territorit dhe për pasojë u quajtën fiset e Oguzit të krahut të djathtë.

Gök Han – Bajëndër, Peçenek, Çavundur, Çebni

Dağ Han – Salur, Ejmyr, Alajundlu, Yregir (Üreğir)

Deniz Han – Ęgdër, Bykdyz, Jëva, Kënëk.

Këto fise njiheshin si fiset e krahut të majtë.²

Saluri, stërgjyshi themelues i fisit Salur, jetoi gjatë kohës së Pejgamberit Muhammed (s.a.v.s), dhe pasardhësi i tij, **Çanak Han**, e pranoi Islamin. Fiset dhe familjet e tjera turke u konvertuan në Islam, dhe për këtë arsye u quajtën **Tyrk-i Iman** (turq besimtarë, që do thotë turq muslimanë). Më pas, kjo fjalë u lexua Tyrkiman (Tyrkoman) dhe në ditët e sotme **Tyrkmen**.

Në Turkestan, Islami u përhap nëpërmjet tregtarëve. Edhe pse **Kutejbeh b. Muslim** e hapi qytetin Buhara ndaj Islamit, dhe ndërtoi atje xhaminë e parë në vitin 94/713, ky veprim nuk e përshpejtoi procesin e përqaimit të Islamit nga turqit. Por duke u familjarizuar me Islamin, nëpërmjet tregtarëve muslimanë dhe duke ndjerë se Islami ishte në harmoni të plotë me pikëpamjet, dhe mënyrën e tyre të jetesës, turqit e përqaftuan Islamin me dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë. **Duhet theksuar se momenti kur turqit hynë në Islam, njihet si një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë botërore.**

Megjithatë, duket se Islami u përhap mjaft herët midis turqve të veriut. Të parët i shikojmë **bullgarët** (nga burimet arabe: Sakalibeh), që dalin në shesh si Devleti i Parë Musliman Turk në histori. “Emri ‘bullgar’ duket se shfaqet për herë të parë në vitin 482 (e.s.). Pas vdekjes së Mbretit të Hunëve, **Atilla**, në vitin 453 (e.s.), bashkësia e **Hunëve** u shkatërrua dhe bullgarët turq vendosën sovranitetin e tyre nga Kaukazi në Danub.”³ Disa nga bullgarët turq u vendosën në rajonin e

2 Yazijzade, *Selchuqname*, TSMK, Revan 1391, 3a

3 Nuri Yüce, “Bulgar (Një nga fiset turke brenda Devletit Perëndimor të Hunëve)” T.D.V. (Türkiye Diyanet Vakfı) *Islam Ansiklopedisi*, Stamboll 1992, vëll. VI, fq. 390.

Dobrukhës, nën drejtimin e **Esperihut**, djalit të **Kuvrat Hanit**, për shkak të presionit të ushtruar nga Hazarët. Kjo degë e bullgarëve ose e bullgarëve të Danubit, jetoi në periudhën më të shkëlqyeshme nën drejtimin e **Kurum Hanit** (803-814), dhe **Omurtag Hanit** (814-831). **Pars Hani** (859-890), u konvertua në fenë e krishterë në vitin 864 dhe u quajt **Boris Han**, dhe për pasojë edhe bullgarët e Danubit u konvertuan në të krishterë, dhe me kalimin e kohës, duke u përzier me sllavët u kthyen në popuj sllavë. Disa fjalë turke që kanë mbetur në gjuhën bullgare nga periudha paraislamike janë shembuj që tregojnë këtë lidhje.

Dega tjetër e bullgarëve u vendos në rajonin e Itilit të mesëm (Vollgës), në gjysmën e dytë të shekullit të 17-të. Qytetet më të rëndësishme të tyre ishin: **Bullgar**, **Biler**, **Suvar**, **Oshal** dhe **Tetish**. Islami u përhap shpejt nëpërmjet tregtarëve, që vinin nga vendet muslimane. Bullgari **Han Allmësh**, i biri i **Jaltavarit**,⁴ e përqafoi Islamin dhe në vitin 920 dërgoi lajmëtarin e tij te Halifi i Abasidëve në Bagdad, duke i kërkuar atij të dërgonte *ulema* për t'i mësuar popullit bullgar Islamin, dhe arkitektë për të ndërtuar xhami dhe kështjella. **Halifi el-Muktedir Bil-lah Xha'fer** dërgoi një komision ambasadorësh në vitin 310/922.⁵ Bullgarët e Vollgës e përqaftuan Islamin në vitin **922**, duke formuar kështu **Devletin e Parë Musliman Turk**.

Bullgarët e Idilit (Vollgës), jetuan të qetë deri në gjysmën e dytë të shekullit të 13-të; por sulmi i tyre ndaj mongolëve, që po ktheheshin drejt zonës së Araleve, pas një beteje kundër Kumanëve në rajonin Don në vitin 1223, dhe mposhtja e tyre shënoi rrugën e rrënimit të vetë bullgarëve. Kështu, nën urdhrat e **Batu Hanit**, mongolët i sulmuan bullgarët, pas një parapërgatitje të gjatë dhe në vitin 1236 i shkatërruan të gjithë qytetet e tyre duke i varur njerëzit.

4 Emri i tij musliman është **Xha'fer b'Abdullah**: Akdes Nimet Kurat, "Bulgar", M.E.B (Ministria e Arsimit Turke) *Islam Ansiklopedisi*, Stamboll 1979, vëll. II, fq. 791.

5 Në vendin e cituar.

Gjatë Epokës së **Hordhisë së Artë** (1282-1452), bullgarët u rimëkëmbën deri në një farë mase dhe vazhduan të jetonin me vështirësi, por, më pas, u sulmuan nga **Pulat Timuri**, Hani i Hordhisë së Artë në 1361, dhe qytetet e tyre kryesore u shkatërruan. Kur **Emir Timuri**, Hani i Hordhisë së Artë në vitin 1391, drejtoi fushatat e tij në **Toktamësh**, qytetet e bullgarëve u shkatërruan sërish. Pas kësaj, bullgarët jetuan në Hanatin e Kazanit.⁶



Pikturë, që i dedikohet hyrjes së bullgarëve turq në fenë Islame, në vitin 310/922



*Xhamia Idil
Devleti i Parë Musliman Turk: Bullgarët e Vollgës (Idilit).*

6 Në vendin e cituar.

Një shtet tjetër turk musliman ishte dhe Devleti **Karahanllë** (Ilighanllë) (840-1212 e.s.), që u vendos në Afganistan dhe në disa zona të Turkestanit, nën drejtimin e të mirënjohurit **Satuk Buğra Han** (emri i tij në gjuhën arabe është '**Abd el-Kerim**'), i cili vdiq në vitin 344/959. Turqit, identiteti i të cilëve ishte zhytur tashmë në fenë Islame, luftuan kundër vëllezërve të tyre të mëparshëm: shamanistëve dhe budistëve. Ata, gjithashtu, luajtën një rol të rëndësishëm për përhapjen e Islamit në Indi, ku dërguan shumë *gazve* (ekspedita të xhihadit) gjatë periudhës 351-582/963-1186. **Mahmudi i Gaznes** (388-421/998-1186) dhe pasardhësit e tij, drejtuan 17 ekspedita të tilla. Ushtria turke muslimane që u ndesh në këto beteja ishte e përbërë nga arabë, persë dhe ushtarë të tjerë të këtyre zonave. Ata flisnin një gjuhë të thjeshtëzuar të quajtur "Ordu", që në gjuhën turke do të thotë "Ushtri". Fjala e ditëve të sotme "Urdu", duket se e ka origjinën e saj nga fjala turke "Ordu".

Themeluesi i Devletit të Madh të Selçukëve (429-552/1038-1157), është biri i Dukakut nga Klani Kënëk i Oguzit. Sulltani i tij Tugrull (**Tuğrul**) **Beu**, i biri i Mikailit, i biri i Selçukut, marshoi drejt Bagdadit në krye të ushtrisë së tij në vitin 450/1059, për të çliruar Halifin e Abasidëve nga komploti shiit-bujit. Për nder dhe respekt të Halifit, **Tugrulli** e drejtoi personalisht kalin e Halifit.⁷ Më pas ai u martua me vajzën e Halifit (455/1063) dhe transmetohet se gjatë festimeve të dasmës, turqit kërcyen vallet e tyre folklorike.

Halifi ia riktheu autoritetin e tij të përbotshëm **Tugrull Beut** dhe i dha edhe titullin **Sulltan**.

1.2 "Hapja" e Anadollit ndaj Islamit

Fet'h është një fjalë arabe që ka kuptimin "të hapësh". Në praktikat dhe terminologjinë islame do të thotë: "të hapësh" një vend ndaj Islamit, ose "t'i familjarizosh banorët e një vendi me

7 Yazijzade Ali, *Tevarih-i Al-i Selçuk*, redaktor Abdullah Bakir, Stamboll: 2009, fq. 51.

Islamin dhe vlerat e tij"; "të heqësh kufijtë artificialë midis të krijuarve dhe urdhrave të Krijuesit". Islami, duke qenë feja e *fitres* (karakterit të natyrshëm), u ekspozohet, u paraqitet bano-rëve të një vendi, për t'i bërë ata të aftë të njohin dhe të perceptojnë, se këto urdhra janë në përputhje me instinktet e tyre të brendshme dhe me sistemin kompleks të besimit. Popujt e vendit të hapur ndaj Islamit, nuk janë të detyruar të konvertohen në fenë islame; në rast të kundërt rezultati do të ishte të kishte shumë hipokritë. Muslimanët paguajnë taksën **oshr**, 1/10 e grurit dhe jomuslimanët paguajnë **haraxh** për produktet e tyre. Mënyra më e mirë për të bërë një vlerësim të fakteve historike është krahasimi; duhet të kujtojmë se në atë kohë, dhe më pas, kishte një nënshtrim të tmerrshëm të jokrishterëve në Evropë.

Muslimanët erdhën në rajonin e Anadollit, si fillim nëpërmjet ekspeditave të xihadit, gjatë periudhës së **Halifit të Dytë Omer b. el-Hattab** (13-23/634-644) të drejtuar nga *sahabi* (shok i Pejgamberit a.s.), **Ijaz b. Ganm**, 18/639. Pasi mbërriti në Harran, Ijaz b. Ganm vazhdoi për në Dijarbakër me këtë ekspeditë. Më pas, muslimanët drejtuan një ekspeditë tjetër xihadi në rajonin e Anadollit, gjatë periudhës së Halifit të Tretë **Othman b. Affanit** (23-35/644-656). Më tej, ata erdhën në rajonin e Anadollit nën drejtimin e Emevitëve; **Sufjan b. Avf**, mbërriti në Skutari në krye të ushtrisë muslimane dhe flota mbërriti në Gadishullin e Kapëdagë, në bregdetin jugor të Detit Marmara, duke i ardhur në ndihmë dhe ushtrisë rrethuese. Rrethimi i Kostandinopojës nga muslimanët vazhdoi deri në vitin 60/679, duke përfunduar me lidhjen e një Traktati 30 vjeçar për Paqe me Perandorinë Romake.⁸

Halifi i Abasidëve, **Harun er-Rashidi**, e mundi Perandorin romak **Nikiforin**, në Ereqli, pranë qytetit të Konjas në vitin 192/807, dhe për të përlurur perandorin, e detyroi atë dhe familjen e tij të

8 Ahmed Muhtar el 'Abbadi dhe es Sejjid 'Abdulaziz Salim, *Tarihu'l Bahrijeti'l Islamijeh*, Bejrut 1972, fq. 32-33.

paguante taksën **xhizje**.⁹ Një Halif tjetër i Abasidëve, **El-Me'muni**, e mundi gjithashtu ushtrinë romake në Eregli në 215/830. **Halifi Mu'tesim** mundi perandorin romak **Teofilin** në vitin 222/837, dhe shkatërroi **Amoriumin**,¹⁰ qendrën kryesore romake në Anadoll. Por të gjitha këto fitore ishin të përkohshme; muslimanët nuk do të vendoseshin përfundimisht në rajonin e Anadollit, derisa turqit selçukë të arrinin ta hapnin atë ndaj Islamit.



Amoriumi në Anadollin Perëndimor, pranë Emirdagë në fshatin Hisarkoj.

Perëndimorët germuan – pas 12 shekujsh – qytetet e tyre historike për të groposur praninë islame dhe për të pretenduar me kalimin e kohës që këto zona iu përkisnin atyre.

Perëndimorët e germuan të kaluarën e tyre kulturore, me qëllim groposjen e prezencës muslimane në rajonin e Anadollit,

9 *Xhizje* është një taksë islame që sovrani musliman iu vë jomuslimanëve; Devleti Musliman merr në mbrojtje *dhimmiun* (jomusliman, që jeton nën sundimin musliman), jetën, dinjitetin dhe pronën e tij.

10 Sipas burimeve arabe, *Amorium* është **Amurijeh**; shtrihet midis Ankarasë dhe Emirdagut. Kur i riu **Selman el-Farisi** ishte në kërkim të besimit të vërtetë, ai vizitoi Mosulin, Nusejbin dhe kaloi më pas në Amurijeh, duke qëndruar në këto qendra së bashku me priftërinjtë, përfaqësuesit e besimit të predikuar nga Profeti musliman **Isa b. Merjem** (p.q.m.t.) (të gjithë profetët janë muslimanë: ata iu nënshtruan urdhrave dhe vullnetit të Allahut; Islam do të thotë nënshtrim ndaj vullnetit të Krijuesit), para daljes së Pejgamberit të Fundit, dhe më pas shkoi në Gadishullin Arabik, ku takoi Profetin Muhammed (Paqja qoftë me të), dhe përqafoi Mesazhin e Fundit.

duke i vënë të diplomuarit dhe administratorët e vendit në gjumë nëpërmjet futjes në përdorim të konceptit të “trashëgimisë njerëzore”. [Por, në të njëjtën kohë, *shkatërrimi* i xhamive osmane, ndërtesave në Bosnjë dhe në Kosovë (për të mos përmendur këtu vende të tjera ish-osmane), nuk ka *asnjë* rëndësi, ato duhet të zhduken; pasi ato ndërtesa NUK janë “trashëgimi njerëzore”; ato janë jozyrtare!]

Turqit selçukë, të cilët zotëruan Persinë, Sirinë dhe Kaukazin, rifilluan xhihadin e tyre në rajonin e Anadollit.¹¹ **Çagrë (Çağrı) Bej**, pasardhësi i Mikail Beut, i biri i Selçuk Beut, arriti në Kaukaz në vitin 1015, nga ku u angazhua në ekspeditat e xhihadit drejt Anadollit Lindor. Tugrull Beu, një pasardhës tjetër i Mikail Beut, hyri në territorin e Anadollit në vitin 1054, dhe arriti deri në Erzurum. Të gjitha këto arritje ishin veprimtari për njohjen e terrenit. Beteja që do të vendoste të ardhmen e Anadollit, u zhvillua në Manzikert, më 26 gusht 1071. Sulltani selçuk **Muhammed Alp Arslan** ibn Davud, (455-465/1063-1072) komandoi ushtrinë muslimane, që marshoi përmes Persisë për në Anadoll. Në shenjë mbështetje dhe përgëzimi ndaj ushtrisë muslimane, Halifi i Abasidëve urdhëroi të kryhej një falje në emër të tyre në të gjitha xhamitë e Hilafetit. Megjithatë, pati edhe një përpjekje për të arritur një marrëveshje paqësore. Gjatë një dialogu të ashpër midis perandorit romak arrogant **Romanus Diogenus** (sundoi 1068-1071) dhe negociatorit kryesor të muslimanëve, **Sav Tigin**, ky i pari deklaroi me sarkazëm se kuajve të tij shumë shpejt do t’iu jepej ujë në Hemedan, në kryeqytetin Selçuk. Ndërsa i fundit në mënyrë sfiduese tha se kuajt me të vërtetë do të ishin në Hamedan, por ai nuk ishte i sigurt se ku do ta kalonte perandori dimrin e ardhshëm, që do të thotë se kuajt e tij do të merreshin si plaçkë lufte dhe se jeta, dhe e ardhmja e perandorit do të ishte në rrezik. Ndërkohë që

11 Ata e quajtën Anadollin “Bilad-i Rum”, ose “Rum”, për arsye se, në atë kohë, ishte nën zotërimin e romakëve (Rum) të Lindjes. Në fakt, perandoria kishte origjinë latine (romake), por ishte helenizuar nga ana kulturore.

diplomacia nuk arriti të vendoste paqen, dy ushtritë zhvilluan një betejë të ashpër në Malazgirt (Manzikert), në pjesën lindore të rajonit të Anadollit, një pasdite të premte, më 26 gusht 1071. Edhe pse ushtria muslimane me vetëm 54.000 luftëtarë, u përball me një ushtri të madhe prej 200.000 luftëtarësh të krishterë, forcat e Islamit e fituan këtë betejë të paharrueshme, e cila përcaktoi të ardhmen e Anadollit. Jobsimtarët u tërhoqën dhe perandori u kap rob.¹² Edhe pse më pas u lirua nga selçukët, perandori u vra nga njerëzit e tij.

Gjatë zotërimit të Anadollit nga Devleti i Selçukëve, si sundimtar i pjesës qendrore u caktua komandanti **Sylejman**, pasardhës i **Kutallmëshit**.¹³ Ai e themeloi kryeqytetin në Konja dhe e trajtonte popullin e tij në mënyrë dinjitoze dhe të sjellshme. Sylejmani u kërkoi atyre të paguanin taksa të arsyeshme dhe nuk ndërhyri në besimin e tyre fetar. Në të njëjtën kohë, ai shfrytëzoi me mjeshtëri grindjet dhe konfliktet e brendshme midis familjeve romake, për të përfiturar më shumë territore. Ai arriti në fakt kështu të aneksonte shumë pjesë të perandorisë romake, duke përfshirë edhe Iznikiun (Nikean), të cilin e ktheu në kryeqytet.¹⁴ Në vitin 473/1080, e zgjeroi territorin e tij deri në brigjet e Detit Marmara dhe Egje, duke e detyruar kështu Perandorin romak, **Aleks Komnenin**, të paguante një taksë vjetore. Territori që ishte nën degën e tij, të Dinastisë së selçukëve,

12 Ishte hera e parë që një perandor romak kapej rob nga një ushtri muslimane. Claude Cahen: *La Turquie Pre-Ottomane*, Stamboll-Paris, 1988, fq. 8.

13 Neşri, I, *vepër e cituar*, fq. 26. *Kut allmësh* do të thotë një person që ka përfutur *kut* (shenjteri), bekim. Por, studiuesit perëndimorë e lexojnë këtë term Kutlumus, që nuk ka asnjë kuptim (shiko, për shembull S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 7; C. Cahen, *La Turquie Pre-Ottomane*, (Stamboll-Paris 1988), fq. 1, dhe Bertold Spuler: *The Muslim World, Part 1, The Age of Caliphs* (Leiden: 1960), fq. 118. Duke qenë të huaj, atyre u mungon sfondi dhe mendjemprehtësia e nevojshme, dhe shpesh përsërisin në mënyrë të verbër gabimet dhe vlerësimet e pasakta të njëri-tjetrit.

14 Yilmaz Öztuna, përkthyer nga Adnan Mahmud Selman dhe redaktuar nga Dr. Mahmud Ansari: *Tarihu'd Devleti'l 'Uthmaniije* (Stamboll 1408/1988), fq. 68.

njihej si “Sulltanati i Rumit”, dhe sulltanët quheshin në gjuhën arabe “Cezarët e Romës”, si shenjë treguese e zotërimit të tyre në pjesën lindore të Perandorisë “Romake”. Nga fundi i shekullit të 11-të, selçukët e Anadollit, luftuan kundër valës së parë të Kryqëzatave. Një murg i quajtur **Pierre l’Hermit**, i hipur mbi shpinën e një gomari, duke shkuar nga një fshat në tjetrin, i nxiti të krishterët e Evropës të ngriheshin të bashkuar kundër muslimanëve, për të marrë Jerusalemin dhe vende të tjera të rëndësishme për të krishterët. Në këtë mënyrë, ai luajti rolin kryesor për fillimin në vitin 1097 e luftërave plaçkitëse që u quajtën “Kryqëzata” dhe që do të vijonin me qindra vjet. Gjatë Fushatës së Katërt të Kryqëzatave, për shembull, të krishterët evropianë pushtuan Kostandinopojën në vitin 1204, dhe e plaçkitën atë. Dinastisë Romake iu desh të largohej nga qyteti; një degë e saj vazhdoi të qëndronte në Trebizond nën emrin **Perandoria Pontus**, ndërsa, dega tjetër e saj vazhdoi të qëndronte në Anadoll, në **Nike**, dhe arriti të kthehej në Kostandinopojë në vitin 1261.

Menjëherë pas vdekjes së **Sylejman Shahut**, komandantët e tij u angazhuan në një luftë të ashpër për pushtet, që përfundoi me ndarjen e Anadollit në provinca të vogla, secila me nga një guvernator të pavarur. Guvernatori më i njohur i asaj periudhe ishte **Emir Çaka**, i cili gjatë periudhës 488/1095, “hapi” shumë pjesë të Anadollit perëndimor ndaj Islamit, të tilla si: qytetin Foça dhe Urla, dhe ishujt e Sokias dhe Sisamit, në rajonin e Egjeut. Ndërkohë, Sulltani i Selçukëve **Borkyjaruk (Börküyaruk)** caktoi në vitin 487/1094, pasardhësin e Sylejmanit, **Këllëç Arslan**, si guvernator të Anadollit. Në vitin 603/1206, Turqit Selçukë i dhanë fund zotërimit të krishterë në qytetin Antalja, që shtrihej në brigjet e Mesdheut, dhe e “hapën” këtë qytet të rëndësishëm ndaj Islamit. Gjatë periudhës së Sulltanit selçuk **Gijaseddin Kejhusev**, turqit selçukë zhvilluan betejën e tyre të fundit në Antakja, kundër romakëve për të fituar Anadollin në vitin 607/1210.

Sulltani më i madh i selçukëve të Anadollit, ishte **Alaeddin Kejkubad**. Me të ardhur në pushtet në vitin 616/1219, ai ndërtoi një arsenal armatimesh për flotën e selçukëve në Allaije, në bregdetin e Detit Mesdhe. Nga ana tjetër, popullsia e Sudakes në Krime, keqtrajtonte tregtarët që kishin marrëdhënie tregtie me Anadollin dhe për këtë arsye **Alaeddin Kejkubadi** dërgoi **Husameddin Çobanin** në këtë vend. Pasi lundroi nga Sinopi, Husameddin Çobani arriti në Sudak në vitin 625/1228 dhe pasi vendosi sundimin e tij, i caktoi popullit Sudak, pagesën e taksave.



*Medreseja me Dy Minare Çifte Minareli Medrese,
në Erzurum (nga periudha selçuke)*

Me afrimin e kërcënimit mongol, Halifi i Abasidëve, **el-Mustensir Bil-lah**, pajtoi selçukët e Anadollit me Ejubitët në vitin 633/1236. **Alaeddin Kejkubadi** vdiq në vitin 634/1237, pasi gjatë një banketi konsumoi mish shpendi të egër.

1.3 Pushtimi mongol i Anadollit

Mongolët, të cilët në atë kohë quheshin “Tatarë”¹⁵, gjatë shekullit të 13-të, pushtuan pjesën veriore të Detit Kaspik dhe Detit të Zi, si dhe Persinë, Irakun dhe Sirinë. Komandanti mongol **Bajxhu Nojin**, pasi e pushtoi Erzurumin në rajonin e Anadollit në vitin 640/1242 ai e shkatërroi qytetin. Sulltani selçuk **Gijasuddin Kejhusev II** iu drejtua qytetit Sivas në krye të 50.000 kalorësve. Komandantët me përvojë e këshilluan atë të priste përforcime, por komandantët e tjerë në përcjelljen e tij menduan se meqë mongolët kishin vetëm 40.000 kalorës, përforcimet ishin të panevojshme, por në të vërtetë, mongolët kishin 60.000 kalorës, dhe ushtria e selçukëve pësoi disfatë gjatë **Betejës së Kosedagës (Kösedağı)** në vitin 641/1243. Selçukët u detyruan t’iu paguanin çdo vit tatarëve (mongolëve) një sasi të caktuar taksash, dhe t’iu jepnin një numër kafshësh të tyre.



Xhingiz Hani

15 Në burimet bashkëkohore, mongolët janë quajtur, gjithmonë tatarë. Barthold thotë se termi “mongol” ka zëvendësuar termin “tatar”, pas periudhës së Xhingiz Hani: “Tatar”, *Encyclopedia of Islam* (Leiden: 1934) IV, fq. 701. Por, termi “mongol” përdorej në pjesën lindore dhe ai “tatar” u përdor në pjesën perëndimore. Pra, peçenekët, kipçakët dhe popujt e tjerë turq, që jetonin nën administratën tatarë (mongole), quheshin gjithashtu tatarë sipas administratorëve të tyre. Ky fakt, shpjegon pse turqit që jetonin në veri të Detit Kaspik dhe Detit të Zi quhen “tatarë” edhe në ditët e sotme.

Pas Betejës së Kosedagës, disa nga tatarët (mongolë) u vendosën në Anadoll dhe sulltanët selçukë u kthyen në kukulla në duart e pushtuesve. Fiset turke, të cilat ishin vendosur nga selçukët në zonën në kufi me Perandorinë Romake, u gjendën në një pozicion lufte për mbijetesë. Sulltani i fundit selçuk **Gijasuddin Mesud** vdiq në vitin 1308. Pas vdekjes së tij, administrimi i Anadollit i kaloi një guvernatori të përgjithshëm tatar (mongol).

Popullsia tatare (mongole) nuk ishte e mjaftueshme për të zotëruar gjithë rajonin e Anadollit. Për pasojë, shumë bejlike (emirate) turke u krijuan nga copëzat e shpërndara të selçukëve. Emirati më i madh ishte ai i Karamanit, ku përfshihej dhe kryeqyteti Konja, si dhe bejliket e Germijanit. Emirati më i vogël që u krijua, ishte Emirati Osman. Tokat e Emiratis Osman ishin të vendosura në Rrugën e Mëndafshit. Selia osmane dimërore, Sogyt, ishte shumë pranë kësaj rruge me rëndësi të madhe historike. Nikea, që ishte e vendosur në rajonin e Anadollit, ishte caktuar si kryeqyteti i Perandorisë Romake në vitin 1204, kur vala e Kryqëzatës së Katërt pushtoi Kostandinopojën. Kur Perandoria Romake u rivendos në Kostandinopojë, në vitin 1261, ajo u kthye sërish në kryeqendrën e kësaj perandorie. Ky fakt, arriti ta dobësojë fuqinë e perandorisë mbi guvernatorët lokalë romakë, *tekmurë*, në Anadoll. Çdo *tekmur*, sillej sikur të ishte një sovran i pavarur. Kjo bëri që ky rajon të ishte edhe më i cenueshëm, por faktori më i rëndësishëm ishte elementi “njerëzor”. Sundimtarët e parë dhe korniza administrative e Emirateve (Bejlikeve) Osmane, ishin më të përkushtuarit ndaj Islamit, ishin simboli për shpëtimin dhe lumturinë e të gjithë njerëzimit. Pra, ata ishin përcaktuar për të realizuar bashkimin e Anadollit musliman.



Tyrbeja e Ertuğrul Gaziut

KAPITULLI 2

THEMELIMI I DEVLETIT OSMAN¹⁶


2.1 Ertugrull (Ertuğrul) Gaziu

Themeluesit e Devletit Osman janë prej fisit Kajë të familjes Oguz. Ertugrull Beu hyri nën shërbimin e Sulltanit selçuk, Gijaseddin Kejhusev III (1264-1283) në vitin 1279.¹⁷ Ertugrull Beu shërbeu si uç bej i selçukëve. Sulltani selçuk i dha atij qytetin e vogël Sogyt si rezidencë dimërore dhe Domaniçin si kullotë verore. Ertugrull Beu vdiq dhe u varros në Sogyt. Viti i

16 Emërtimi zyrtar ishte: *Devlet-i Alije-i Omanijje-i* (Devleti Sublim Osman) dhe më pas: *Saltanat-ë Senijje* (Sulltanati i shkëlqyer). Struktura socio-politike osmane kurrë nuk u vetëquajt perandori (imparatorijë). Edhe shteti nuk është i rëndësishëm për osmanët, pasi Devleti është vetëm një “mjet” për të zbatuar urdhrat e përcaktuar (urdhrat e shpallura nga qielli prej Krijuesit); nga ana tjetër, strukturat e tjera socio-politike të quajtura në gjuhët perëndimore: *state*, *etat*, *reich*, dhe *staat* (shtet), janë entitete legjislativë dhe ekzekutive; ato, pas nënshkrimit të Traktatit të Westfalias (1648), morën të drejtën “për të përligjur”. Për më tepër, ishte e pamundur për muslimanët të mos kishin një halif: një *hadith sherif* thotë se “çdo musliman që kalon një natë të vetme pa një *bej’at* (betim për besnikëri sipas mënyrës Islame) në qafën e tij, e kalon këtë natë si një person që jeton në rrethana të *xhahilijetit* (injurancës).” Ebu Ja’la el Ferra Muhammed, el Ahkamkus Sultaniijeh (Surabaya: 1394/1974), fq. 20.

17 Ismail Hakkı Uzunçarşılı, *Osmanlı Tarihi*, Ankara, Türk Tarih Kurumu, 1982, v. I, fq. 103.

vdekjes së tij pranohet të ketë qenë në 1281. Më pas fisi Kajë zgjodhi të birin e tij Osman si prijësin e tyre.¹⁸



Osmani fëmijë lëkundej nga gjyshja e tij në degën e kësaj pisha (çam). Kjo pemë gjendet në fshatin Domur, në Domaniç, Kytahja

2.2 Osman Gaziu 1289-1324

Osman Gaziu lindi në Sogyt, në vitin 652/1255.¹⁹ Ai u caktua si Bej i Sogytit nga sulltani i selçukëve në vitin 683/1284. *Menshura* (Dekreti i emërimit) fillonte me citimin e ajetit nga Kur’ani²⁰ “(O Muhamed) Thuaj: “O Allah, Zotërues i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin atij që do ...” Sulltani selçuk deklaroi se pozita e tij ishte “*zil-lullahi fil Arz*” (Hija e Allahut mbi Tokë),²¹ dhe siç dihet, ky ishte dhe titulli i Halifit.

18 Neşri (Mehemmed), *Kitab-ı Cihan-Numa*, redaktuar nga F.R. Unat dhe M.A. Köymen, Ankara, TTK, 1949, vëll. I, fq. 78. Neşri thotë se xhaxhai i Osmanit, Tundari, bëri **bej’at** (betimin për besnikëri sipas mënyrës Islame).

19 Ibn-i Kemal, *Tevarih-i Al-i Osman*, botim i Şerafettin Turan, Atatürk Kültür, Dil ve Tarih Yüksek Kurumu, Ankara: 1999, vëllimi I, fq. 60.

20 *Al-i Imran*, 26.

21 Feridun Beğ, *Mexhmua-i Mynsheat-i Selatin*, Stamboll 1274, vëll. I, fq. 48-49. Duhet theksuar se, pothuajse asnjë nga orientalistët nuk e përmend faktin që sulltani i selçukëve të Anadollit ishte Halif. Pas shkatërrimit të

Halifi-Sulltani selçuk i kërkoi Beut të ri të sapocaktuar, që të ishte mirënjohës ndaj Krijuesit dhe i dashur me njerëzit, të krijuarit, për të cilët ai do të mbante përgjegjësi. Nga ana tjetër, në ato vite, rreth vitit 1284, popujt e Evropës ishin kryesisht të përbërë nga fshatarë të quajtur skllëvër. Asnjë skllavi nuk i lejohej të largohej nga toka ku punonte; ai ishte rob së bashku me familjen e tij. Në rastet kur toka shitej edhe ata shiteshin bashkë me të, sikur të ishin kafshët e fermës; kur një vajzë martohej, ajo detyrohej të kalonte natën e parë të martesës me pronarin e tokës, praktikë kjo e quajtur **jus primae noctis** (e drejta e natës së parë). Është e rëndësishme dhe interesante të theksohet: se ndërkohë që në Evropë njerëzit trajtoheshin si të mos ishin qenie njerëzore të vërteta, njerëzit në Anadoll, trajtoheshin si “ata, mirëqenia e të cilëve u ishte besuar nga Krijuesi sundimtarëve” (*emanet-i ilahi*). Në fakt, edhe emërtimi i njerëzve të sunduar në vendet muslimane dhe atyre jomuslimane, është shenjë treguese e ndryshimit si në përjasje, ashtu edhe në trajtim: në Islam, njerëzit e sunduar quheshin **ra`ijjet** (shumësi: ra`aja), që do të thotë “ai për të cilin kujdesesh, që e merr nën kujdes”. Njerëzit në Evropë quheshin në gjuhën angleze “**subjects**” që do të thotë “ata që ishin vënë nën kontroll”.

Hilafetit Abasid në Bagdad, në vitin 656/1258, selçukët e Anadollit (446-718/1074-1308), u kthyen në forcën kryesore muslimane që përfaqësonin Hilafetin *de facto*. Halifët Abasidë, që atëherë ishin nën tutelën e memlukëve, ishin vetëm kukulla në duart e tyre.



Anadulli nën sundimin e Ilhanëve (mongolëve)

Halifi-Sulltani selçuk nuk kishte pasardhës. Duket se ai vuri re tek Osman Gaziu, disa aftësi dhe një forcë të madhe për të qenë pasardhësi i tij. Ai i theksoi dëshirat e tij për të ardhmen e Beut të ri dhe bejlikut (emiratit) të tij, duke thënë:

*ve evvelul gajthi reshshun thumme jensekib*²²

(Fillimin e një rrebeshi e tregon një pikë e vogël shiu, më pas ai shpërthen).

Në këtë mënyrë, ai donte të tregonte se Bejliku i vogël osman do të zgjerohej më vonë, në një oqean të gjërë.

Halifi vazhdoi ta nxiste **Osman Beun** që të ishte i ndershëm dhe të sillej në përputhje me vlerat e Islamit: *Fe men hafe Allaha havvefe `anhu kul-le shej' ve men lem jehafil-lahe havvefuhu kul-le shej'*. (Ai, që ka frikë nga Allahu, Allahu bën që të gjithë të kenë frikë prej tij, dhe kush nuk ka frikë nga Allahu, Allahu bën që ai të ketë frikë nga të gjithë.) Gjithashtu, sulltani e këshilloi atë edhe mbi çështjet fiskale, duke marrë citime nga Kur'ani: *"Ve la texh'al jedeke magluleten ila`unukike ve-la tebsut'he kul-le best."* [Dhe mos e bëj dorën të lidhur për qafe (mos u bëj koprrac), e as mos e shtri atë plotësisht] (*el-Isra*, 29). Halifi-

22 Po aty, I, fq. 49, rreshtat 18-19.

Sulltan theksoi përgjegjësinë politike të një muslimani: “*Ve faddala-Llahu el muxhahidine `ala el ka'idine exhren `adhimen*” [Allahu i ka lartësuar muxhahidinët (të angazhuar në Luftën e Shenjtë) mbi ata që mbeten pas. (*en-Nisa*, 95)]; “*Vel-ledhine xhahedu fina lenehdijennehum subulena*” [E ata, të cilët luftuan për hir Tonë, Ne me siguri do t'i orientojmë Rrugëve Tona (*el-Ankabeut*, 69)]. Gjithashtu, ai e nxiti Beun të çrrënjoste politeizmin në përputhje me urdhëresat e Allahut: “*Ja ejuhu-l-ledhine amenu in tensuru-Llahe jensurkum ve juthabbit ekdamekum*” [O ju besimtarë, nëse ju ndihmoni Allahun, Allahu, gjithashtu, do t'ju ndihmojë dhe do të bëjë që të qëndroni të fortë mbi këmbët tuaja në luftime.] Sulltani citoi dhe një ajet që i përket betejës së Bedrit (në vitin 2/624), gjatë të cilës komuniteti i parë musliman, arriti fitoren e tij të parë në histori: “*Lijehlike men haleke `an bejjinetin ve jehja men hejje `an bejjinetin*” që tregon vazhdimësinë e të njëjtit Devlet Musliman: Pejgamberi (s.a.v.s.), Halifët e Drejtë, Emevitët, Abasidët, Selçukët e Mëdhenj dhe Selçukët e Anadollit. Beut të ri iu kërkua që të zbatonte edhe *sheriatin* (Ligjin e Islamit) në të gjitha sferat e jetës: “*Va lekum fi'l kisasi hajatun*” [Në masën e dënimit ka jetë për ju (*el-Bekare*, 179)], si dhe të zbatonte *shuran*: “*Va shavirhum fi'l emr*” [...dhe konsultohu me ta në të gjitha çështjet (*Al-i Imran*, 159)]. Sulltani e përfundoi *Menshuranë* (Dekretin e emërimit) e tij duke shpjeguar qëndrimin që Beu duhej të kishte ndaj fqinjëve të botës së krishterë: “*Ve in xhenehu li's selmi fexhneh leha*” [Në qoftë se ata, anojnë kah paqja ano dhe ti kah ajo] (*el-Enfal*, 61)], dhe “*Ve evfu bi'l ahdi inne'l ahde kane mes'ula*” [Dhe përmbushni zotimet. Me të vërtetë, për zotimet ka përgjegjësi. (*el-Isra*, 34)].²³

Devleti Osman, në të vërtetë, i zbatonte këto udhëzime dhe njëhej veçanërisht për devotshmërinë dhe mirëkuptimin që kishte

23 *Mynsheat*, vëll. I, fq. 48-55. Ne e dimë që sulltani selçuk i dërgoi daille dhe shenja të tjera inaugurimi Osman Gaziut (Neşri, I, fq. 110) dhe është shumë e natyrshme që një *menshurë* të dërgohej së bashku me këto. Edhe pse ai i cituar në *Mynsheat* nuk është original, është të paktën një shenjë treguese e thelbit dhe konceptit që duhet të ishte.

me njerëzit. Osman Gaziu i ftonte shpesh të varfrit dhe besimtarët për darkë një herë në tre ditë, iu jepte veshmbathje nevojtarëve dhe ndihmonte gratë, të cilave u kishin vdekur bashkëshortët.²⁴

Midis njerëzve të afërt të Osman Gaziut ishte dhe Shejh Edebaliu, i cili ishte *sufi* i devotshëm, i arsimuar, i pasur dhe i ditur, edhe pse ai bënte një jetë modeste dhe asketike. Është faktuar se Osman Gaziu kishte parë një ëndërr, në të cilën kishte parë hënën të dilte nga kraharori i Shejhut dhe të hynte në kraharorin e tij; dhe një pemë që dilte nga kërthiza e Osman Gaziut, dhe që rritej duke u përhapur në një zonë të gjerë, nën hijen e së cilës kishte male dhe lumenj. Ndërkohë që, Osman Gaziu këtë ëndërr ia tregonte Shejh Edebaliut, ky i fundit i thotë me gëzim Osmanit se Allahu i Plotfuqishëm i kishte dhuruar atij dhe pasardhësve të tij sovranitetin e gjithë botës. Shejh Edebaliu vajzën e tij, Malhun Hatun, e martoi me Osman Gaziun.²⁵

24 Neşri, *Kitab-i Cihan-Nüma*, (Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1949), vëllimi I, fq. 72. Jo vetëm historia osmane, por edhe gjithë historia e Islamit është nën invadimin kulturor perëndimor jomusliman; **e gjithë historia e Islamit duhet të rishkruhet duke u bazuar në burime origjinale dhe me metodologji analitike.** Një nga pikat që perëndimorët e kanë konsoliduar edhe në mendjet e muslimanëve, është ideja e gabuar se sistemi i Hilafetit përfundoi kur tatarët (mongolët) e pushtuan Bagdadin, në 1258, dhe e vranë Halifin. Është e vërtetë që Halifi Abasid, që ishte vendosur në Egjipt në vitin 1260, ishte vetëm një figurë simbolike; por, **de facto**, Hilafeti vazhdoi të ekzistonte nëpërmjet Selçukëve të Mëdhenj, të cilët përfaqësonin pushtetin ushtarak dhe politik të Islamit, dhe më pas me pasardhësit e tyre, Selçukët e Anadollit.

25 Neşri, I, fq. 82.



Foto e tyrbes të Shejhut Edebali në Bilexhik

Në atë kohë, në rajonin e Anadollit ishte formuar organizata islame e të rinjve e quajtur **Ahijeh**, e cila ishte vazhdimësi e organizatës **Futuvveh**. **Ibn Battuta**, që vizitoi Anadollin në vitin 736/1336, bën një përshkrim të detajuar të kësaj organizate:

“Ne qëndruam këtu në kolegjin e qytezës, drejtori i të cilit ishte Shejh Shibabu’d Din el-Hemevi. Tashmë, në të gjitha territoret e banuara nga turkmenët në Anadoll, në çdo rreth, qytezë dhe fshat, mund të gjesh pjesëtarë të organizatës së njohur si Ahijje ose Vëllazëria e Re. Në asnjë vend të botës nuk kenë për të gjetur burra më të prirë për të mirëpritur të huajt, kaq të gatshëm për të shërbyer ushqim, për të përmbushur dëshirat e të tjerëve, për të shtypur njerëzit e ligj dhe për të

vrarë ndihmësit e tyre,²⁶ të cilët bashkohen me ta.²⁷ Edeballi ishte një nga shejhët e kësaj organizate, që i dha mbështetje të konsiderueshme Osman Gaziut, ndërsa prijësit e kësaj organizate apo vëllazërie **Ahi Shemseddin**, djali i tij **Ahi Hasan** dhe **Xhendereli**²⁸ **Kara Halil**, patën rëndësi të veçantë në themelimin e Bejlikeve Osmane (Principatave, Emirateve).²⁹ Në fillimin e shekullit të 13-të, grupet e rëndësishme *futuvveh*, që përfaqësonin një lloj urdhri kalorësiak islamik, u kthyen në një modë të përgjithshme në botën qendrore muslimane. Pasi u riorganizuan nën drejtimin e Halifit të fundit të plotfuqishëm Abasid **En-Nasir li Dinil-lah** (575-622/1180-1225), grupet futuvveh patën pasues të shumtë në Anadollin e asaj periudhe. Anëtarëve të saj iu dha titulli *ahi*, *kardesh* (vëlla) ose *xhevanmerd* (trim, burrëror). Organizata futuvveh nuk ekzistonte vetëm në qytete, por edhe në fshatra dhe gjatë marshimeve. Ajo kishte vende takimi dhe shtëpiza, të cilat ishin të ndërtuara si imitim i atyre të vëllazërive të sufive, që ishin përhapur në të gjithë botën islame gjatë shekullit të 13-të. Kjo organizatë, gjithashtu, kishte përcaktuar rregulla dhe rite të ngjashme me vëllazëritë e lartpërmendura. Në këto organizata përfshiheshin njerëz nga fusha të ndryshme të shoqërisë, që nga figurat politike, prijësit, tregtarët e pasur, shejhët, dijetarët, mjeshtrit e zejtarisë, e deri edhe te endacakët e papunë, madje dhe të gjithë artizanët e qyteteve u anëtarësuan në të. Në veçanti në qytetet e mëdha, shegertët e rinj përbënin numrin më të madh të pjesëmarrësve në to. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 13-të, kur autoriteti i administratës qendrore ishte mjaft i lëkundur, prezenca e kësaj

26 Fjala e përdorur në tekst është fjala në gjuhën arabe *shurat* dhe nuk ka të bëjë me *shurta* (forcë policore), ashtu siç deklaroi Gibb. Mund të ketë kuptimin "ata që shkaktojnë lëndime".

27 Ibn Battuta, *Travels in Asia and Africa, 1325-1354* (Londër: 1983), përkthyer nga H.A.R. Gibb, fq. 125. Ibn Battuta (703-770/1304-1369) shëtit në të gjithë botën muslimane.

28 Ky është një titull që e ka prejardhjen nga Xhandare, një fshat që i përket qytezës së Sivrihisarit, që ndodhet midis Ankarasë dhe Eskishehirit.

29 I.H.Uzunçarşılı, *Osmanlı Tarihi*, I, fq. 106.

organizate u ndje fuqishëm dhe në mënyrë të vazhdueshme. Ajo luajti një rol aktiv në jetën e qyteteve dhe ishte kthyer në një faktor të rëndësishëm politik.³⁰

Duke marrë në konsideratë këto fakte, është e qartë se banorët muslimanë të Anadollit ishin të mirorganizuar. Mes tyre në shekullin e 14-të, katër të tilla do të ishin organizatat më kryesore:

Ahijan-ë Rum: Organizata e të rinjve të Anadollit.

Baxhijan-ë Rum: Organizata e zonjave të Anadollit.

Abdalan-ë Rum: Organizata Sufite e Anadollit.

Gazijan-ë Rum: Organizata e Anadollit e luftëtarëve të Luftës së Shenjtë.³¹

Këto organizata tregojnë arritjen e një standardi të lartë të disiplinës në Devletin musliman të selçukëve, edhe pas mposhtjes së tyre ushtarake nga mongolët. Organizata *Ahije* (futuvveh) duket se i kishte rrënjët e saj në një vërejtje të përmendur nga Pejgamberi i Fundit Muhammed (Paqja qoftë me të), në një nga betejat e tij, kur ai e quajti njërin nga luftëtarët, Safvanin, një *feta* (djalë i ri fisnik dhe guximtar). Kështu, organizata e tij futuvveh (të rinjtë Sufi) u kthye në një institucion dhe vazhdoi të ekzistonte ndër shekuj. Ajo “ishte një shprehje shembullore e cilësive të fisnikërisë, ndershmërisë, besnikërisë dhe guximit. Vëllezërit e *fitjanit*, duhej të jetonin duke iu afruar këtyre cilësive ideale, përfshirë dhe mikpritjen bujare ndaj të huajve që vinin për vizitë.”³²

30 M. Fuad Köprülü, *The Origins of the Ottoman Empire*, përkthyer dhe botuar nga Gary Leiser. (New York: 1992), fq. 68-69.

31 İ.H. Uzunçarşılı, *Osmanlı Devleti Teşkilatından Kapıkulu Ocakları* (Ankara: T.T.K., 1984), vëll. I, fq. 1.

32 Në librin e tij *The Adventures of Ibn Battuta: A Muslim Traveler of the 14th Century* (Londër:1986), Ross E. Dunn thotë se fytyvveh “duket se ka hyrë për herë të parë në Azinë e Vogël nga Irani ...” (fq. 146). Në fakt, turqit selçukë e morën Iranin nën kontrollin e tyre, ndërsa po avanconin nga Turkestani, dhe sovranët Selçukë të Anadollit (Rum) ishin pasardhësit e tyre. Tashmë, kemi prova të mjaftueshme për të menduar që ata e sollën fytyvven nga Turkestani, ku sunduan sipas parimeve të Islamit. Pra, nuk

“Për sa i përket zhvillimit ekonomik dhe ndarjes shoqërore të punës, shoqëria turke në Anadollin e shekullit të 13-të, ishte një nga shoqëritë më të përparuara të periudhës së fundit të Mesjetës. Devleti i selçukëve të Anadollit në shekullin e 13-të, që ishte dhe shëmbëllimi politik i kësaj shoqërie, ishte një Devlet i centralizuar, me institucione të mirorganizuara dhe të forta. Ai ruante traditën politike dhe administrative të Devletit të Selçukëve të Mëdhenj, të cilët në shekullin e 11-të, ishin vendosur dhe sundonin zonën e Turkestanit Lindor deri në brigjet e Detit Marmara, dhe nga Kaukazi deri në Gjirin Persik. Edhe në aspektin kulturor, Selçukët e Anadollit arritën një nivel të lartë. Përveç shkollave fillore, të cilat ishin ndërtuar pranë çdo xhamie për t’iu mësuar fëmijëve shkrim dhe lexim, medresetë ishin ndërtuar kudo. Për më tepër, për shkak të pushtimit mongol, një pjesë e madhe studiuesish, poetësh dhe mistikësh nga vendet Lindore (të botës muslimane) iu drejtuan rajonit të Anadollit, dhe u vendosën atje. Ata rritën nivelin e veprimtarive intelektuale në Anadoll dhe fituan famë të merituar në medresetë e selçukëve.”³³ Të gjitha këto krijuan një mjedis të qëndrueshëm për Devletin Osman.

Ahinjtë ishin të përbërë nga të rinj të pamartuar; ata punonin gjatë ditës dhe pasdite mblidheshin në *teqe*. Ata hanin së bashku dhe strehonin këdo pa dallim race, feje etj., që rastiste të vizitonte vendin e tyre. Përveç kësaj, ata vepronin edhe si forcë policore vullnetare. *Ahije* ishte një organizatë ideale joqeveritare. Nuk e teprojmë nëse themi se gjatë shekullit të 13-të, njerëzit në Anadoll, edhe pse jetonin nën sundimin mongol, ishin në kushte më të mira se qytetarët e Nju Jorkut, Çikagos, Moskës apo Shën Petërburgut, dhe se qytetarët jogjermanë në Gjermaninë e shekullit të 20-të dhe 21-të, për sa i përket aspektit të sigurisë.

është aspak e ekzagjeruar të themi se shoqëria muslimane në Anadoll ishte në atë kohë tejet e kulturuar dhe e mirorganizuar.

33 M. Fuad Köprülü, *The Origins of the Ottoman Empire*, fq. 69-70.

Sipas një raporti të dokumentuar, Osman Gaziu ishte i ftuari i një imami gjatë një nate në një fshat. Në ditët e asaj kohe, shtëpitë kishin mure të trasha dhe dritare të mëdha, që mundësonte vendosjen e objekteve të ndryshme mbi to. Mikpritësi i tha Osman Gaziut: “A mund të përkulesh pak, pasi ka diçka pas teje te dritarja, që duhet ta marr”. Osman Gaziu e pyeti se përse bëhej fjalë, dhe mikpritësi ia ktheu se ishte Fjala e Allahut që iu shpall Pejgamberit të Fundit. Osman Gaziu kishte mbetur i heshtur dhe pa lëvizur. Por, kur mikpritësi e la vetëm, në kohën kur do të flinin, ai u ngrit, mori *gusl* (pastrimin e madh) dhe e kaloi gjithë natën në mënyrë të respektueshme ndaj Kur’anit.³⁴

Sipas një poeme që lidhet me **Mevlana Xhelaluddin Rumiun**, Ertugrull Beu do ta vizitonte atë sa herë që të ndodhej në qytetin e Konjas. Në një nga vizitat e tij tek Shejhu i Madh, ai morri me vete dhe djalin e tij të vogël, Osmanin. Mevlana, që kishte dëgjuar se sulltani selçuk i asaj kohe ishte lidhur me një shejh *kelenderi*, tha: “Nëse sulltani ka gjetur një baba për veten e tij, ne kemi gjetur një djalë”, dhe u lut për Osmanin e vogël.³⁵

Osman Beu e hapi qytetin e Karaxhahisarit ndaj Islamit në vitin 687/1288³⁶ dhe kapi rob *tekfurin* (guvernatorin) e tij. Ai dërgoi nipin e tij **Ak Temur** me *humsul ganaim*³⁷ te Sulltani selçuk Gijaseddin Mesud II, i cili ishte mjaft i kënaqur nga kjo fitore kundër romakëve. Në shenjë vlerësimi, ai i dërgoi Osman Beut, një flamur, një *tuğ*, një daulle, një trumpetë dhe një mantel

34 Neşri, *vepër e cituar*, fq. 72-74.

35 Müneccimbaşı Ahmed Lütfullah, *Cami’ud Düvel*, botuar nga Ahmet Ağırakça, Stamboll 1955, fq. 56.

36 Neşri, I, fq. 86; Ibn Kemal, *Tevarih-i Al-i Osman*, botuar nga Şerafettin Turan (Ankara: 1991), vëllimi I, fq. 105-106. Sipas Neşri, Sulltani ishte Alaeddini II, dhe sipas Ibn Kemalit, ishte Gijaseddini; Në atë kohë sulltani duhet të ketë qenë Gijaseddini. Duhet theksuar, se Eskishehiri iu dha si dhuratë Osman Beut nga sulltani i selçukëve dhe se në një pjesë të vjetër e këtij qyteti, në parkun përballë “Liceut Atatürk”, gjendet një xhami e quajtur Xhamia e Alaeddinit.

37 Është një praktikë islame që *humsi* (1/5) i *ganimedit* (pre e luftës) t’i dërgohet *Bejtul Malit* (thesarit qendror të Devletit).

nderi, së bashku me një kalë të çmuar. Të gjitha këto dhurata arritën një pasdite, kur Osman Beu urdhëroi lodërtarët të luanin muzikë me daullen dhe trumbetën, para derës së tij, ku ai qëndronte duke dëgjuar. Sulltani ia dhuroi atij edhe qytetin e Eskishehirit.³⁸ Për arsye se sulltani selçuk nuk kishte djalë,³⁹ ai duket se kishte parë me të vërtetë tek Osman Beu trashëgimtarin e tij. Daullet dhe trumbetat u rritën në numër dhe në formë, duke formuar **mehterin**, bandën ushtarake osmane, që më pas u kthye në model për bandat evropiane.



Mehteri (Banda ushtarake osmane)

Banda **Tablhane** (mehteri) iu dërgua Osman Beut në vitin 1289. Sulltanët osmanë, ushtarakët dhe nëpunësit administrativë, dëgjonin mehterin e tyre, gjatë ekspeditave të xhihadit deri në periudhën e **Sulltan Mehemmedit II** (Fatih), që e dëgjonte duke qëndruar i ulur;⁴⁰ në kohën kur Devleti i selçukëve kishte marrë fund shumë kohë më parë, dhe Devleti Osman në atë kohë ishte fuqia kryesore sundimtare.

38 Ibn Kemal, I, fq. 106.

39 Neşri, I, fq. 108.

40 Neşri, I, fq. 108; Ibn Kemal, I, fq. 107.

Mbi monumentet e selçukëve të Anadollit, qëndronte simboli i një skifteri me dy kokë. Mund të arrijmë në përfundimin se simboli i skifterit me dy kokë, ishte dhe në flamujt e selçukëve; por nuk dihet nëse skifteri me dy kokë, ishte dhe mbi flamurin që iu dërgua Osman Gaziut, nga Sulltani selçuk i Anadollit.

Nga ana tjetër, jemi në dijeni se *hutbeja* e parë në emër të Osman Gaziut u mbajt gjatë faljes të së Xhumasë (të Premtes) në vitin 688/1289, në **Karaxhahisar**.⁴¹ Meqenëse përmendja e emrit gjatë faljes të së Xhumasë është **një shenjë sovraniteti, duhet të pranojmë se themelimi si devlet sovran i OSMANIT u shpall në vitin 1289**; jo ashtu si përsëritet shpesh: në vitin 1299.⁴² Duhet të kujtojmë në këtë rast, se **Namazi i parë i së Xhumasë** u fal nga **Pejgamberi i Fundit Muhammed** (Paqja qoftë me të) në **Iuginën Ranuna**, gjatë hixhretit nga Meka në el-Medine,⁴³ kur ai ishte plotësisht i lirë, nuk kishte asnjë autoritet tjetër dhe ishte i pavarur. Dihet që Namazi e së Xhumasë është një detyrim shumë i përcaktuar (*farz 'ajn muakkad*) për çdo musliman të lirë dhe të pavarur, ndërkohë që një skllavi, nuk i jepet e drejta ta falë këtë namaz. Sipas ligjeve islame (*fikh*), duhet të ketë një numër të caktuar besimtarësh për ta falur Namazin e së Xhumasë, si dhe duhet të kryhet me **lejen e autoritetit** më të lartë të vendit. Kur **Tursun Fakih** dhe **Edebaliu**, po diskutonin në qytetin Karaxhahisar, pasi ky ishte populluar dhe njerëzit kishin nevojë për të falur *Namazin e së Xhumasë*, **Osman Beu** pyeti se ku qëndronte problemi. Pasi mësoi se për të falur këtë Namaz në bashkësi, duhej të merrej leje nga sulltani i kohës, ai reagoi ashpër: “Unë nuk jam nën sovranitetin e askujt (*taht-i hukumet*); unë jam vetë sulltan; unë e kam hapur këtë vend ndaj

41 Ibn Kemal, *Tevarih-i Al-i Osman*, redaktuar nga Şerafettin Turan, Ankara: 1991, I, fq. 112-113; Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 110.

42 Sipas Neşri, (vepër e cituar) (I., fq. 110), Sulltani selçuk Alaeddin, i dërgoi Osman Beut, nëpërmjet Ak Timurit, daullen dhe flamurin, shumë vite para hapjes së qytetit Bilexhik (në vitin 698/1299) ndaj Islamit (si shenjë sovraniteti).

43 Ibn Hisham, *es Sijretun Nebevijeh*, Kajro: 1375/1955, botimi i dytë, vëll. I, fq. 494.

Islamit me shpatë në dorë. Nuk kam qenë kurrë i nënshtruar ndaj askujt. Nuk kam as pronar, as sulltan. A nuk është e mjaftueshme leja ime, a nuk është autorizimi im i mjaftueshëm? Nëse me “Sulltani i Kohës” nënkuptoni sovranin e Anadollit, çfarë pushteti mund të mbajë ai në territorin tim? Kush është ai? As njerëzit e vendit tim nuk ia kanë nevojën dhe as sovraniteti im nuk varet prej tij, dhe prejardhja ime nuk është më poshtë se prejardhja e tij⁴⁴”. Osman Beu caktoi **Tursun Fakihun** si *Hatibin* që do të recitonte *Hutben* ditëve të premte dhe i dha *ixhazet* (leje, autoritet) për të falur *Namazin e së Xhumasë* në xhemat, në vitin 688/1289. I pari *Namaz i së Xhumasë* u fal në Karaxhahisar dhe *Namazi i Bajramit*, për të parën herë u fal në Eskishehir në emër të Osman Beut.⁴⁵ Nga ana tjetër, në një nga burimet e hershme osmane, theksohet se “Osman Gaziu kishte fituar pavarësinë deri në një farë mase, por kishte mbajtur *hutbe* në emër të sulltanit selçuk në shenjë respekti të plotë ndaj tij.”⁴⁶

Entiteti socio-politik i krijuar nga Osman Beu, më pas nga vetë ata u quajt “*Devlet-i Alijje-i Osmanijje*” (Devleti Sublim Osman). Termi *Devlet* në konceptin dhe praktikën islame, është vetëm një **mjet për zbatimin** e rregullave ekzistuese të quajtura *shariat*, të cilat u shpallën nga Allahu, Krijuesi, ashtu sikurse besojnë të gjithë muslimanët. *Devleti* nuk është ligjvënës, por zbatues. Nga pikëpamja ligjore, strukturore dhe funksionale, *State, Etat, Staat, Reich*, (shtet), në vendet evropiane, janë entitete krejtësisht të ndryshme. Me fjalë të tjera, **nuk është as e saktë, dhe as e**

44 Ibn Kemal, I, fq. 112.

45 Ibn Kemal, I, fq. 113

46 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 108.

İ.H. Uzunçarşılı thotë se Osman Beu, sillej në mënyrë të pavarur në vitin 1299, për arsye se nuk kishte mbetur asnjë autoritet selçuk, pas largimit të Alaeddin Kejkubadit III në vitin 1299. Por, Osman Beu ishte nën sundimin e mongolëve dhe në vitin 1302, ai i dërgoi përforcime sovranit mongol, Gazan Mahmud Han, për fushatën e tij në Siri, ndaj Osman Beu nuk ishte i pavarur: *Osmanlı Tarihi*, I, fq. 108, poshtëshënimi 1. Por, **përmendja e emrit gjatë Hutbes**, është shumë e rëndësishme për praktikën dhe traditën islame, është një nga dy shenjat, simbolet e sovranitetit. Shenja tjetër është përdorimi i *sikkës* (monedhës).

*pranueshme të emërtojmë Devletin Osman si State, Etat, Staat apo Reich (shtet), për të mos shtuar këtu dhe përdorimin e termit Empire (Perandori). Pas Traktatit të Vestfalias (1648), këto entitete socio-politike të quajtura State, Etat, Staat apo Reich, në vendet evropiane, morën fuqi **legjislative**. Ata *përligjin*, ndërkaq, **kanunet** e sjella nga administrata osmane **nuk** janë legjislacion, por, në thelb, ishin në varësi të Islamit dhe traditës lokale, për aq kohë sa kjo traditë nuk është në mospërputhje me parimet themelore të Islamit. Me fjalë të tjera, termi *kanun* është i barasvlershëm me një listë urdhëresash. Përderisa “**vendet dhe popujt janë të veçantë, dhe nuk mund të ndërhyjnë kaq lehtë në identitetin e njëri-tjetrit, me përjashtim të disa rasteve të kufizuara dhe specifike**”⁴⁷, është e **papranueshme** që Devleti Osman të emërtohet si State, Etat, Staat ose Reich, për të mos përmendur këtu edhe përdorimin e termit Empire (Perandori).⁴⁸*

Tharmi Islam, i hedhur nga **Shejhu Edebali**, në brumin osman, gjatë procesit të krijimit, është një faktor thelbësor dhe mjaft i rëndësishëm. Nëse ndikimi i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës i këtij shejhu, shumë të arsimuar dhe të mirinformuar, te themeluesi i Devletit Osman dhe te biri i tij Orhan Beu do të anashkalohej, shkrimi i historisë së tij, do të ishte i detyruar të ndiqte një rrugë të gabuar. Osman Beu ishte një sundimtar trim dhe i aftë, por për të qenë një themelues nevojiten aftësi të tjera. Ai u udhëhoq nga Shejh Edebaliu dhe u tregua shumë i aftë në hedhjen e themeleve të Devletit mbi baza të forta islame. **Enver Pasha**, që luajti një rol shkatërrimtar në

47 R. Emerson, *From Empire to Nation* (Cambridge, Massachusetts: Shtëpia Botuese e Universitetit Harvard, 1967) fq. vii. Theksimi është shtuar.

48 Chris Cook, *Dictionary of Historical Terms* (Londër: Macmillan, 1983), fq. 152. Theksimi është shtuar. “Nga shekulli i 15-të e në vazhdim, Spanja, Portugalia, Holanda, Franca dhe Britania filluan krijimin e perandorive tejoqeanike.” J.M. Roberts, *The Hutchinson History of the World*, (Londër: Hutchinson, 1987), fq. 835. Theksimi është shtuar. “...disa nga fuqitë e vjetra perandorake të tilla si: Rusia, Franca dhe Britania e Madhe, vazhduan t’i zgjerimin me përmasa të mëdha perandoritë e tyre. Të tjerat qëndruan në vend dhe u reduktuan në territor; përfshirë atë holandeze, spanjolle dhe portugeze.”

rënien e Devletit Osman, ishte gjithashtu i vendosur, mjaft i mençur dhe i guximshëm, por aftësitë e tij nuk arritën ta drejtonin atë në rrugën e suksesit.

Në një nga luftimet Osman Beu arrestoi **Kose (Köse) Mihalin**, Tekfurin e Harmankajasë, por e liroi atë shumë shpejt në shenjë vlerësimi të trimërisë së tij. Nga ana e tij, Kose Mihali, u kthye në një nga njerëzit më besnikë të Osman Gaziut dhe i tregoi atij për organizimin e një komploti të tekfurëve që e rrethonin, për ta vrarë Osman Gaziun në një ceremoni martesë, ku ai ishte ftuar të merrte pjesë. Por, Osman Beu arriti t'i shpëtonte këtij komploti dhe më pas t'ia bashkëngjiste Islamit dy qytetet Bilexhik dhe Jarhisar. Ai e martoi djalin e tij, Orhan, me vajzën e Tekfurit të Jarhisarit në vitin 698/1299.⁴⁹ Ajo zonjë, **Nilyfer Hatun**, ishte nëna e **Sylejman Pashait** dhe **Murad Gaziut**. Më pas, Osman Beu dërgoi një nga komandantët e tij, **Turgut Alpin**, për të rrethuar kështjellën e Inegolit (İnegöl) dhe më vonë u bashkua me të për ta hapur këtë qytet ndaj Islamit. Më pas radhën do ta kishte qyteti i **Jenishehirit**, i cili u kthye në kryeqytetin e bejlikut. Turkmenët (Turkomanët) u transferuan në jetën urbane në këtë qytet të ri.



Harta e Bejlikut Osman (Hüsejin Dağtekin)

49 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, I, fq. 107.

Kur ushtritë evropiane, që u nisën për Kryqëzatën e Katërt, pushtuan dhe plaçkitën Kostandinopojën, në vitin 1204, Perandoria Romake e Lindjes e kaloi kryeqytetin në Iznik (Nike). Me rimarrjen e Kostandinopojës në vitin 1261, kryeqyteti kaloi sërish nga Izniku (Nike) në Kostandinopojë dhe në këtë mënyrë u lehtësua kontrolli i saj ndaj tekfurëve në Anadoll. Nga ana tjetër, shumë turq, pasardhës të Oguzit, që kishin ardhur në territorin e Anadollit për të shpëtuar nga mongolët, iu bashkuan forcave osmane gjatë procesit të hapjes së qytet pas qyteti ndaj Islamit, në kurriz të Perandorisë Romake Lindore.

Duke pasur mbështetjen e Kostandinopojës, që iu dërgoi atyre 2.000 ushtarë, tekfurët rifilluan veprimtarinë e tyre kundër Osmanit, por Osman Beu i theu ato forca të bashkuara gjatë një beteje në qytetin e Kojunhisarit, në vitin 701/1302, beteje gjatë së cilës përvetësoi dhe një pjesë të madhe të tokave rreth qytetit të Bursës. Tashmë radhën e kishte qyteti i Izmitit. Kur rajoni i Ullubadit u hap ndaj Islamit, tekfuri i Ullubadit i dorëzoi Osman Beut, tekfurin e Kites, i cili ishte arratisur pasi Osman Beu i kishte premtuar se as pasardhësit e tij dhe as ai vetë nuk do ta kalonin urën e lumit Ullubad. Ky premtim u mbajt për vite me radhë. Sulltanët osmanë hapën territore të gjera ndaj Islamit, jo vetëm në rajonin e Anadollit, por edhe në zemër të Evropës, por asnjëri nga ata nuk e kaloi urën mbi lumin Ullubad gjatë luftimeve; ata e kaluan lumin me varkë.⁵⁰

Duke u ndodhur përballë kësaj sfide dhe duke u përpjekur të ndalonte luftën mongole kundër osmanëve, Perandori bizantin **Andronikos II**, në vitin 708/1308, i ofroi për martesë sovranit mongol në Persi motrën e tij, **Marën**. Por ky i fundit, duke qenë se ishte tepër i angazhuar me çështjet e brendshme dhe me luftën kundër sulltanit memluk, që kishte nën sundimin e tij Egjiptin, Hixhazin dhe Sirinë, nuk mund ta mbështeste perandorin. Megjithatë, Osman Beu u përgatit për një përballje ushtarake, veçanërisht, pasi u njoftua se Sulltani ilhanli

50 Neşri, I, fq. 114-116.

(mongol) (680-716/1281-1316) kishte urdhëruar grumbullimin e një ushtrie prej 30.000 luftëtarësh për t'u ndeshur me osmanët.⁵¹

Ndërkohë duke u familjarizuar me osmanët e hershëm, të cilët jetonin mbi bazën e besimit të tyre, Kose Mihali e pranoi me dëshirën e tij fenë islame në vitin 713/1313. Ai mori emrin **Abdullah Mihal** dhe luftoi përkrah Osman Beut, në shumë beteja, nëpërmjet të cilave arritën të hapnin ndaj Islamit qytetet e Mekejes, Akhisarit dhe Gejves.⁵² Deri nga mesi i shekullit të 16-të, pasardhësit e Mihal Gaziut do të komandonin forcat **akënxhinj** (komando sulmuese) në Evropë dhe disa prej tyre ishin komandantë me famë.⁵³

Megjithatë, **Osman Beu** nuk u angazhua personalisht në çdo betejë pas vitit 720/1320, pasi një sëmundje e rëndë e bëri atë të paaftë për të luftuar mbi kalë. Djali i tij, **Orhan Beu** mori në kontroll çështjet e Devletit pas vdekjes së të atit në vitin 726/1326, gjatë betejës për hapjen e qytetit të Bursës ndaj Islamit, dhe u varros atje në *Gymyshly Kymbet*.⁵⁴

51 Uzunçarşılı, *Osmanlı Tarihi*, I, fq. 110.

52 OT, I, fq. 111.

53 Forcat *akënxhinj* ishin forca të kalorësisë së lehtë; ata ishin *muxhahidinë* jashtëzakonisht të guximshëm, të fortë dhe të stërvitur mirë. Një *Akënxhi bej* (komandant), njihje më shumë se një gjysëm dyzine gjuhësh të huaja lokale. Ai i përzgjidhte vetë ushtarët e tij, kishte nën komandën e vet me mijëra *akënxhinj* dhe i përgjigjej drejtpërdrejtë *Divan-ë Hymajunit* (qeverisë qendrore osmane) me qendër në Stamboll. Asnjë administrator lokal, *Sanxhak Bej*, apo madje dhe *Bejlerbej*, nuk kishte të drejtë të ndërhynte në çështjet e tij administrative apo organizative. Forcat *akënxhinj*, hynin në tokat e armiqve duke u vendosur në krye të ushtrisë kryesore dhe shpërndaheshin përreth në formë të degës së një peme. Asnjë fshat apo qytet në pjesën qendrore të Evropës, në shekullin e 16-të, nuk ishte i sigurt nëse nuk do të kishte kalorës *akënxhinj* në mëngjes në rrugët e tyre.

54 OT, I, fq. 117.



Tyrbeja e Osman Gaziut, Bursa

Në testamentin që i la djalit të tij, Orhan Gaziut, Osman Gaziu e porosiste: *“Nëse dikush të udhëzon për diçka që nuk është urdhëruar nga e Vërteta Sublime (Hakk Teala, që do të thotë Allahu subhanehu ve tala), mos e prano. Mos bëj atë që Allahu (s.v.t.) nuk e ka urdhëruar. Konsultohu me ulematë e sheriatit për ato çështje që nuk i di.”*⁵⁵

Osman Gaziu vendosi rregulla të bazuara në parimet e xhihadit për Devletin e tij:

*“Atij që unë i jap në zotërim një timar, nuk duhet t’i merret pa pasur arsye. Pas vdekjes së zotëruesit, timari do t’i jepet djalit të tij. Nëse djali është tepër i vogël në moshë, për të marrë pjesë në ekspeditat e xhihadit, shërbëtorët e tij do ta zëvendësojnë atë, deri sa ai të jetë në moshë të aftë për të luftuar. Kushdo që do t’i bindet këtij urdhri, Allahu qoftë i kënaqur me të. Nëse dikush do t’i këshillojë pasardhësit e mi të kundërtën e këtij rregulli, Allahu mos qoftë i kënaqur me të.”*⁵⁶

55 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 145.

56 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, botuar nga Nihal Atsız, Ankara, Ministria Turke e Kulturës dhe e Turizmit, 1985, fq. 28-29.

Siç dihet, sistemi *ikta'* u praktikua në kohët e hershme të Islamit, nga Pejgamberi i Fundit Muhammed (Paqja qoftë me të); kjo praktikë u vazhdua më tej nga osmanët, të cilët e quajtën *timar*: një copë tokë që i jepej për t'u administruar një ushtaraku apo një komandanti, në shenjë vlerësimi ndaj trimërisë së tij gjatë xhihadit, dhe ky ushtarak apo komandant, në këmbim do të stërviste një numër të caktuar luftëtarësh për xhihad.

Kështu, Osman Gaziu kishte hedhur bazat e një Devleti Islamik dhe kishte ndërmarrë fushata luftarake të xhihadit, për të "hapur toka të reja ndaj Islamit", në përputhje me "Urdhëresat Hyjnore".

2.3 Orhan Beu 1324-1360

Orhan Beu, ose "Ihtijarud Din Orhan Bej", siç e quante Ibn Battuta,⁵⁷ mori në dorëzim ushtrinë në kohën e babait të tij. Ai hapi qytetin e Mudanjës ndaj Islamit në vitin 721/1321. Ndërkohë që rrethimi i Bursës ishte në proces, **Konur Alpi**, hapi territorin ndërmjet kufirit osman dhe Detit të Zi, ndërsa **Akçakoxha** hapi tokat përreth Izmitit. Më pas, Gazi Orhan Beu vendosi nën kontroll Atranosin (Orhaneli), një pikë strategjike për Bursën, dhe vazhdoi të mbante nën rrethim Bursën derisa u dorëzua në vitin 726/1326.⁵⁸

Kur Orhan Beu u vendos në postin e sundimtarit, **Alaeddin Beu** mori kontrollin e ushtrisë dhe u bë **bejlerbej**, por më pas, ai u tërhoq dhe qëndroi në fermën e tij në fushën e Kytahjas (Kütahya). Në kohën kur ishte bejlerbej, ai e ndryshoi ngjyrën e kuqe të

57 *Rihlatubni Battuta* (Bejrut: 1384/1964), fq. 308. Megjithatë, ai e quante veten "Shuxhauddin Orhan bin Fahrudin Osman." Shiko İ.H. Uzunçarşılı, "Gazi Orhan Beğ Vakfiyesi", në *Bellelen*, (Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1941), vëll. 19, fq. 280-283.

Pitcher ka shkruajtur mbi veprën e Ibn Battutës: "Një përshkrim admirues dhe i paanshëm i Azisë së Vogël është dhënë nga udhëtari i shquar, që kaloi drejt e nëpër zemrën e gadishullit, në vitin 1333." D.E. Pitcher, *An Historical Geography of the Ottoman Empire*, (Leiden: E.J. Brill, 1972), fq. 5.

58 *OT*, I, fq. 118.

kapelës bork (börk),⁵⁹ që mbanin ushtarët osmanë, në ngjyrë të bardhë. Alaeddin Beu gjithashtu e ndihmoi Çandarllë (Xhendereli) Kara Halilin, për krijimin e njësiteve të këmbësorisë.⁶⁰

Orhan Beu e ktheu qytetin e Bursës në kryeqytet. Ndërkohë **Akçakoxha** hapi qytetin e **Kandëras** ndaj Islamit dhe **Karamursel Gaziu** hapi brigjet jugore të Gjirit të Izmitit. **Akçakoxha** dhe togeri i tij, **Abdurrahman Gaziu**, i hapën qytetet Ajdos dhe Samandëra ndaj Islamit, duke e shtyrë kështu kufirin osman drejt Bosforit dhe brigjeve të Detit të Zi. Ky fakt e alarmoi Perandorin romak **Andronikos II** (1328-1341), që kaloi Bosforin dhe u ndesh me Orhan Gaziun në Pelekanon, që shtrihej midis Darëxhas dhe Eskihsarit. Por në vitin 728/1328, ai pësoi disfatë dhe iku për të shpëtuar jetën e tij. Izniku (Nikea), që qëndroi nën rrethimin osman, u dorëzua në vitin 731/1331.⁶¹ Gratë e romakëve, që kishin humbur bashkëshortët e tyre për shkak të luftës apo të urisë, u martuan me luftëtarët gazinj osmanë, që qëndruan në Iznik për të mbrojtur qytetin.⁶² Osmanët e trajtonin mirë popullin e tokave të hapura ndaj Islamit dhe popullin e rrethuar e këshillonin të dorëzohej, dhe të jetonte në paqe me ta; pasi shumë popullsi e krishterë kishte ardhur në qytetin e Iznikut, ndërkohë që ai ishte i rrethuar.⁶³ Ky qëndrim shpjegon lehtësinë me të cilën osmanët hapën hapësira të mëdha tokash ndaj Islamit, brenda një kohe shumë të shkurtër. Për shembull, kur djali i madh i Orhan Gaziut, Sylejman Pasha, iu afrua qytetit Tarakllë, banorët e krishterë i dorëzuan atij kështjellën e tyre pa luftuar, dhe ishin të lumtur

59 Kjo kapele e quajtur *börk* gjatë periudhës osmane ishte e bërë prej shajaku të qepur. *Börku* i gokturqve në Turkestan, ishte i bërë nga lëkura e qingjit me lesh në të.

60 Neşri, I, fq. 154; *Mufassal Osmanlı Tarihi*, vëll. I, fq. 69.

61 Hoxha Sa'deddin Efendi, *Tacu't Tevarih*, Stamboll 1279, I, fq. 43; *OT*, I, fq. 120.

62 Neşri, I, fq. 158. Në Iznik, në mbledhjen e Këshillit të Nikeas, në vitin 325, u reduktua numri i ungjijve: nga 72 në vetëm 4, që pranohen edhe sot nga ata të cilët quhen të krishterë.

63 Shiko poshtëshënimin 62.

që do të jetonin nën sundimin musliman. Gjithashtu, një pjesë e madhe e fshatrave të rrethinave e pranuan fenë islame me dëshirën e tyre.⁶⁴

Pas Bursës, Izniku u kthye në kryeqytetin osman dhe Osman Gaziu e ktheu kishën katedrale **Aja Sofja** (Hagia Sophia/Shën Sofja) në xhami. Ai, gjithashtu, ktheu një manastir në medrese dhe ndërtoi një *imaret*, institucion përkuqdesjeje për pleqtë dhe të varfërit. Ai caktoi **el-Haxh Hasanin**, një *murid* të Shejh Edebaliut, si kryetar të këtij *Imareti*.⁶⁵ **Është e rëndësishme të theksojmë se, në fillimet e shekullit të 14-të, muslimanët kishin institucione të tilla bamirësie dhe filantropie, ndërkohë që në Evropë ende praktikohej rendi skllavopronar dhe despotizmi. Në të vërtetë, Mesjeta (395-1453) është periudha më e errët për evropianët, por duhet të quhet “Periudha e Shkëlqimit” për muslimanët. Orhan Gaziu vendosi Mevlana Davud Kajseriun në postin e *muderrisit* (profesorit) të medresesë.⁶⁶ Një *imaret* tjetër u ndërtua në qytetin e Iznikut në emër të **Nilyfer Hatunes**, bashkëshortes së Orhan Gaziut, ndërkohë që djali i tij, **Sylejman Pasha** (1316-1358), ndërtoi një medrese tjetër.**

64 Neşri, I, fq. 163-165.

65 Neşri, I, fq. 162.

66 Shiko poshtëshënimin 65.



Medreseja e Sylejman Pashait

Pra, nga pjesa e parë e shekullit të 14-të, në aspektin shoqëror dhe arsimor, osmanët ishin superiorë ndaj romakëve. Në këtë periudhë, në fakt, mbizotëronte një dallim i theksuar midis civilizimit islam dhe atij të krishterë. Ata që jetonin nën administratën e Devletit Musliman, ishin në realitet në kushte më të mira jetese krahasuar me të krishterët e Perandorisë Bizantine, për të mos përmendur këtu Evropën, popujt e së cilës i kishin provuar të gjitha llojet e shfrytëzimit, dhe nuk kishin as kohë dhe as interes, për krijimin e institucioneve të tilla filantropike. Për më tepër, muslimanët kishin në atë kohë banja publike dhe private, ndërkohë që të krishterët i shkatërronin ato. Në atë periudhë kur koncepti i pastërtisë ishte me rëndësi të veçantë për fenë islame, për të krishterët e asaj kohe, konsiderohej si diçka përlulëse, siç shkruan dhe Robert Xh Skraton (Robert J. Scrutton):⁶⁷

“Murgjit vetëorturues qëndronin me ngadhënjim në mes të ndyrësisë. Në veprën e tij *Historia e Inkuizicionit*, Lorente përmend shumë shembuj të konvertuarish nga Muham-

67 Robert J. Scrutton, *Nature's Way to Nutrition and Vibrant Health*, (Kaliforni: 1977), fq.16.

medanizmi, që fshikulloheshin me kamxhik deri në vdekje dhe më pas hidheshin në burgje të pista, pasi vazhdonin të merrnin abdestet e përditshme të fesë së tyre të mëparshme. Inkuizicioni ndaloi pastrimin publik dhe pastrimin personal të trupit. Meqenëse larja ishte një zakon pagan, të gjitha banjat publike madje dhe të gjitha banjat e mëdha nëpër shtëpitë private u shkatërruan.”⁶⁸

Në të vërtetë ndërtimi dhe përdorimi i banjave publike, dhe private ishte shumë i mirënjohur në vendet muslimane në atë kohë, ndërkohë që të krishterët ishin mësuar t’i shkatërronin ato. Kur muslimanët e hapën qytetin e Iznikut ndaj Islamit, ata ndërtuan aty banja publike; në atë kohë situata në Evropë përshkruhet nga një autor perëndimor në paragrafin e më poshtëm:

“Rrugët dhe banesat ishin të mbushura me jashtëqitje njerëzish dhe kafshësh. Të krishterët e fëlliqur dhe qelbanikë, nga mbretërit deri te njerëzit e zakonshëm, ishin përplot me plagë të infektuara dhe me sëmundje. Çmenduria solli dënimin e vet, murtajën e tmerrshme. Njerëzit besonin se Zoti po i ndëshkonte për mëkatet e tyre dhe nuk e kuptonin që vetë ia kishin sjellë vetes ndëshkimin. Shembulli i gjithësisë për shëndetin, që e mësonin profetët e Zotit nuk mund të injorohet pa u ndëshkuar.”⁶⁹

68 Shiko poshtëshënimin 67, cituar nga Henry Buckle, *History of Civilization*, vëll. II, fq. 44.

69 Robert J. Scrutton, *vepër e cituar*, fq. 17.



Imareti i Nilyfer Hatunes

Atmosfera shpirtërore dhe morale, që buronte nga Shejh Edebaliu dhe ndjekësit e tij, mbizotëronte në jetën shoqërore të osmanëve. Shoqëria ishte e organizuar mirë dhe drejtësia ishte vendosur. Të varfërit përbënin një pjesë të vogël të shoqërisë aq sa: “ishte shumë e vështirë, gati dhe e pamundur, të gjeje një të varfër që t’i paguhej *zekati*.”⁷⁰

2.4 Hilafeti: Qëllimi dhe ideali i osmanëve

Duke qenë muslimanë më të devotshëm nga Bejliket e tjera, osmanët ishin të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kishin ndaj Islamit. Ata u përpoqën në veçanti të rigjallëronin *hilafetin*, me anë të luftërave të xhihadit, të cilat ata i ndërmerrnin kundër Perandorisë Bizantine, aso kohe superiore, por që ishte e dobët nga brenda. Kjo është e qartësuar në një *berat* që Orhan Gaziu ia dërgonte djalit të tij të madh **Sylejman Pashait** në 734/1332, nëpërmjet të cilit ai e caktonte atë anëtar të *divanit* (qeverisë osmane) dhe *Mirimiran* (Komandant Suprem) të forcave osmane. Pasi i kujtonte atij detyrat e mbrojtjes së kufijve të Islamit, përkujdesjes për mirëqenien e popullit të tij dhe sigurimit të drejtësisë, babai i shprehte qartë të birit se “**të gjithë njerëzit**

70 Neşri, I, fq. 186.

nën sundimin tonë” duhet të përfaqësohen në “Divanin tonë” dhe “Ngase e kemi për detyrë t’i ngjallim funksionet e fesë dhe të Devletit, sipas praktikës së sulltanëve të mëdhenj që funksiononin si Halifë.”⁷¹

Në atë kohë, popujt e Evropës nuk kishin asnjë të drejtë. Ata jetonin në **skllavëri**; shiteshin së bashku me kafshët kur shitej toka; vajzat kalonin natën e parë të martesës me pronarët feudalë të tokave, në vend që ta kalonin me bashkëshortët e tyre (kjo praktikë *ligjore* quhej **jus primae noctis**). Ndërsa popujt të besimeve të ndryshme fetare, nën sundimin osman, jetonin në kushte tepër njerëzore: jeta, nderi, besimi dhe prona e tyre ishin të mbrojtura nga Devleti, praktikë kjo e pranuar si një *detyrë qiellore*. Siç dihet, popujt në Evropë, me anë të dekretit të **Perandorit romak Kostandin**,⁷² ishin të lidhur me tokën që e punonin dhe ktheheshin në skllavër, dhe nuk mund të largoheshin nga ai vend.

Osmanët hapën qytetin e Gemlikut ndaj Islamit në vitin 734/1334, më pas, Armutllunë në bregun jugor të Detit Marmara dhe qytetin e Izmitit, në vitin 737/1337, administrimi i të cilave iu besua Sylejman Pashait, pasardhësit të parë të Orhan Gaziut. Një vit më vonë, u hap dhe Yskydari (Skutari).⁷³ Kur qyteti me famë dhe më rëndësi të madhe i Iznikut, u kthye në kryeqendrën e Devletit Osman, kryeqyteti i mëparshëm, Bursa, iu dha për administrim **Murad Beut**, djalit të dytë të Orhan Gaziut, dhe u quajt **“Sanxhaku i Beut”**.⁷⁴

Devleti Osman deri atëherë ishte përmbajtur nga luftimi kundër ndonjë vendi musliman, por ata ishin të angazhuar në veprimtaritë e xhihadit kundër Perandorisë Bizantine. Si shumë *guvernatorë* të tjerë, **Axhlan Beu**, qëndroi sovran në **Bejlikun e Karesit**, pas rënies së Dinastisë selçuke. Ai vdiq në vitin 1335,

71 Feridun Beğ, *Memcu'a-i Münshat-i Selatin*, Stamboll, 1274, vëll., I, fq. 69.

72 Michael H. Hart. *The 100, A Ranking of the Most Influential Persons in History*, (Malajzi: Golden Books Center, Sidnej, Bhd 1989), fq. 164.

73 OT, I, fq. 119.

74 Neşri, I, fq. 162.

duke lënë pas dy djem: **Tursun Beun**, që shoqërohej me Orhan Gaziun dhe **Demirhan Beun**, i cili mori dhe administrimin e këtij bejliku. Por populli i Karesit nuk e pranoi Demirhanin, për këtë arsye në vendin e tij u dërgua Tursun Beu. Ky i fundit, megjithatë i tha Orhan Gaziut se do të ishte i kënaqur nëse do të merrte qytetet Këzëllxha Tuzla dhe Mahrama, dhe se mund t'i jepte sipas dëshirës qytetet Ballëkesir, Bergama dhe Edremit.⁷⁵ Për të nxitur hapjen e territoreve të reja ndaj Islamit, sundimtarët osmanë vendosën në krye të territoreve të reja të përvetësuar, komandantë ushtarakë të aftë. Disa nga këto territore morën emrat e komandantëve dhe i ruajnë ata edhe në ditët e sotme: Koxhaeli (vendi i Koxhasë), *vilajeti*, qendra administrative e të cilit ishte Izmiti, u quajt sipas **Akçakoxhas**, dhe Karamursel, në bregun jugor të Detit Marmara, sipas **Karamursel Gaziut**. Orhan Gaziu e pranoi kërkesën e Tursun Beut, dhe ata marshuan së bashku drejt Ballëkesirit, nga ku Demirhan Beu iku për në Bergama. Por Tursun Beu u vra nga një shigjetë, ndërsa po i afrohej kështjellës së qytetit për të biseduar me të vëllanë. Megjithatë, Orhan Gaziu shpalli në vitin 735/1334-1335 një amnisti të përgjithshme dhe për pasojë shumë njerëz iu nënshtruan. **Demirhan Beut** iu fal jeta; ai u dërgua në Bursa, ku dhe vdiq dy vjet më vonë nga një plagë që kishte marrë. Orhan Beu e la administrimin e qytetit Karesi në duart e djalit të tij të madh, Sylejman Pashait, dhe u kthye në Bursa.⁷⁶

75 Neşri, I, fq. 165.

76 Neşri, I, fq. 166.



Harta e Ballkanit në mesin e shekullit të 14-të

Aneksimi i *Bejlikut* të Karesit nga osmanët në vitin 735/1334-1335 dhe hapja e territoreve deri në Çanakkale, lehtësoi avancimin e tyre drejt pjesës evropiane. Komandantët guximtarë dhe me famë të Bejlikut të Karesit si: **Haxhi İlbeji (İlbeği)**, **Exhe Halil** dhe **Gazi Fazëll**, u bashkuan me forcat osmane duke i dhënë një shërbim shumë të madh ushtresë.⁷⁷ Ky veprim ushtarak ishte vazhdimi i ekspeditës së xihadit kundër jobesimtarëve, në bashkëpunim me forcat e tjera fqinje muslimane, që i përkisnin të njëjtës origjinë, besimi, gjuhe, tradite dhe të njëjtit botëkuptim. Duke pasur si qëllim kryesor *“kefereji kem’ ve Myslimini xhem”* (nënshtrimi i të pafeve dhe bashkimi i muslimanëve), **Orhan Gaziu** mori në konsideratë idenë e kapërcimit të Detit Marmara, në mënyrë që të përhapte Islamit në anën tjetër të këtij deti.⁷⁸ **Por është e rëndësishme të theksohet në këtë rast, se Orhan Gaziu nuk mendonte të zgjeronte territorin e tij në kurriz të bejlikeve të tjera muslimane në Anadoll**, ndërkohë që pjesa më e madhe e bejlikeve ishte e angazhuar në veprimtari të pavlerë. Kur ai i tregoi për këtë dëshirë djalit të tij, **Sylejman Pashait**, ai iu përgjigj me fisnikëri: *“Nëse më urdhëroni mua, shërbëtorin tuaj të përrulur, unë do të kaloj*

77 OT, I, fq. 123.

78 Neşri, I, fq. 172.

detin, për hir të Allahut dhe të Pejgamberit të Fundit. Unë do të çrrënjos errësirën e jobesimtarëve në atë rajon dhe do t'i ndriçoj ata me dritën e Islamit."⁷⁹

Pasi mori lejen e babait të tij, Sylejman Pasha u këshillua me dy ish-komandantë të Karesit, **Exhe Beun** dhe **Gazi Fazëllin**, të cilët i treguan atij mundësinë për kapërcimin e detit në pjesën më të ngushtë të tij. Në këtë mënyrë, ata e kaluan detin mbi një varkë, kapën një fshatar dhe u kthyen së bashku me të. Sylejman Pasha i dha atij një sërë dhuratash për të siguruar ndihmën e tij gjatë sulmit të **Kështjellës Çimbeni**. Së bashku me një grup prej 80 ushtarësh të zgjedhur, Sylejman Pasha kaloi ngushticën e Dardaneleve dhe hyri në kështjellën e Çimbenit gjatë natës. Ditën tjetër, ai mori disa anije për të zbarkuar nga Anadulli në Çimbeni, me më shumë se 200 luftëtarë *muxhahidinë*. **Exhe Beu** iu drejtua Limanit të Akçës, ku do-gji anijet e lidhura romake dhe muslimanët hapën një kështjellë tjetër të quajtur **Ajashilunje**. Shumë njerëz u transferuan nga **Edinxhiku**, në jug të Detit Marmara, në zonën evropiane të çliruar nga muslimanët, ndërkohë që ushtarët e krishterë të dy kështjellave, u dërguan në Karesi në Anadoll. Luftëtarët vullnetarë gazinj vazhduan të transferoheshin në territorin e ri musliman. Për pasojë, një forcë e bashkuar ushtarake e krishterë zhvilloi një betejë të ashpër me ushtrinë muslimane, gjatë të cilës pësuan disfatë dhe u shpërbënë në vitin 758/1357.⁸⁰ **Jakub**

79 Neşri, I, fq. 172. Autori i *Mynsheatit* u kritikua për dokumentet në lidhje me fillimet e Devletit Osman. Por, Neşri, i cili është një nga studiuesit e burimeve më të hershme të historisë osmane, përmend këtu këtë qasje, botëkuptim dhe shpirt të gatshëm për të vepruar. Jam i mendimit se kjo mënyrë sjelljeje nga ana e osmanëve duhet marrë në konsideratë, siç e përmend Neşri.

80 *Oruç Beğ Tarihi*, redaktuar nga Atsız, Tercüman 1001 Temel Eser, Stamboll 1972, faq 36; *Aşıkpaşoğlu Tarihi*, redaktuar nga A. Nihal Atsız, Kültür ve Turizm Bakanlığı, Ankara 1985, fq.52-53.; Neşri, I, fq. 184. Perëndimorët në përgjithësi varen nga kjo temë mbi të cilën ka shkruar Cantacuzen. Por, ai humbi luftën për pushtet dhe u tërhoq në një manastir në vitin 1355; dhe shumë trajtime në veprën e tij u kritikuan dhe

Exhe e hapi ndaj Islamit zonën që në ditët e sotme quhet Exheabad në Gadishullin Gelibollu, ndërsa **Gazi Fazëlli** e shoqëronte atë. Varret e dy heronjve gjenden sot në këtë vend.⁸¹

Vendet evropiane të krishtera, i kushtuan vëmendje vendosjes së osmanëve në Gelibollu, por ata nuk patën kohë të ndesheshin me të sapoardhurit, për shkak të konflikteve që kishin midis tyre. Megjithatë, osmanët kishin marrë masat kundër çdo lloj sulmi të mundshëm nga Serbia, Bullgaria, Hungaria apo edhe nga ndonjë aleancë e romakëve me Venedikun; ata morën të gjitha brigjet e Detit Marmara deri në Tekirdag (Tekirdağı), dhe vendosën atje popullsinë muslimane të ardhur nga Anadulli, ndërkohë që dërguan në Anadoll, në Karesi, disa nga të krishterët që ishin ushtarakë të fuqishëm.⁸²

Gazi Sylejman Pasha hapi ndaj Islamit Mallkaranë dhe Keshanin, duke ndërprerë kështu rrugën Stamboll-Edrene. Ai vdiq aksidentalisht në një gjueti në Bollajër (Bolayır), në vitin 760/1359. Babai i tij, **Orhan Gaziu**, vazhdoi të dërgonte turkmenë drejt tokave muslimane evropiane, por ai vdiq dy muaj pas djalit të tij⁸³ dhe u varros në Bursa.

Kur e caktoi djalin e tij më të madh Sylejmanin si komandant suprem të territoreve të reja në vitin 733/1332, Orhan Gaziu përcaktoi përgjegjësitë e tij si vijon: “të mbrojmë kufijtë e Islamit, të kujdesemi për popullin dhe mirëqenien e tyre. Nëse nuk mundemi, Krijuesi nuk do të jetë i lumtur me ne dhe kështu Devleti ynë nuk do të vazhdojë të mbijetojë.” Orhan Gaziu vazhdoi duke thënë: “Halifët e mëdhenj u sollën në përputhje me udhëzimet e Kur’anit. Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë.

u hodhën poshtë nga studiuesi i të njëjtës periudhë, Grigoras: I.H. Uzunçarşılı, *Osmanlı Tarihi*, vëll., I, fq. 138, poshtëshënimi 3.

81 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 55; Neşri, I, 184.

82 *OT*, I, fq. 157-158.

83 Ismail Hami Danişmend, *Izahlı Osmanlı Tarihi Kronolojisi*, Stamboll 1971, vëll., I, fq. 32.

Bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë.” (*el-Maide*, 8)”. Ai i kujtoi djalit të tij nevojën për të mbrojtur territoret muslimane dhe nevojën për të përhapur Islamin në toka të tjera të reja, duke cituar një sërë ajetesh nga Kur’ani: “Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga të mirat e Tij” (*Ali Imran*, 170). “Kush i tejkalon dispozitat e Allahut, pikërisht të tillët janë zullumqarë” (*el-Bekare*, 229).

Ai citoi, gjithashtu, nga thëniet e Pejgamberit të Fundit: “Të zbatosh drejtësi për një orë, është më mirë se të adhurosh për 70 vjet” (d.m.th. si plotësim i pesë faljeve ditore). Në përfundim, Orhan Gaziu e nxiti djalin e tij të ishte zemërgjerë dhe t’i shpërblente njerëzit për shërbimet e tyre.⁸⁴

Kur njoftoi babanë e tij për hapjen e tokave të reja ndaj Islamit në Rumeli, Sylejman Pasha tha se i kishte dhënë *dizdarit* (komandantit të kështjellës) dhe *erenlerëve* (gazinjëve sufi), *ulufe* (pagën) e tyre dhe *timarin* (iktanë).⁸⁵ Përdorimi nga ai i fjalës *er e n* në këtë rast është mjaft interesant, pasi nënkupton se pjesa më e madhe e ushtarëve vullnetarë, në kështjellat e reja të sapopërvetësuarra, për të mos thënë të gjithë, ishin luftëtarë gazi sufi, që vepronin në përputhje me traditën e hershme të Islamit *ri b a t*. Ky fakt tregon se Devleti Osman ishte themeluar që në fillimin e tij, mbi bazën e vlerave dhe parimeve të larta të fesë islame, të cilat siguronin për njerëzimin lumturinë si në këtë botë, ashtu edhe në botën e përtejme. Gazinjtë sufi ishin shumë të edukuar, si në aspektin moral, ashtu edhe në atë shpirtëror, nën udhëheqjen e një shejhu (mjeshtri shpirtëror), i cili kishte arritur një nivel të lartë në sferën shpirtërore; ata ishin të përkushtuar ndaj aktiviteteve të *xihadit*, pasi fitonin luftën e brendshme me vetveten e tyre, duke arritur kështu një standard të lartë moral. Ata pozicionoheshin në kufijtë në vazhdimësi të *ri b a t i t*. Qëllimi dhe ideali i tyre ishte të “kënaqnin Krijuesin”, që është qëllimi më i lartë për çdo musliman të ndërgjegjshëm.

84 *Münsheat*, I, fq. 69-70.

85 Shiko poshtëshënimin 84.

Në fakt, Devleti Osman ishte një mjet për zbatimin mbi tokë të urdhëresave të Krijuesit. Nga ana tjetër, është e vështirë për historianët perëndimorë, të cilët kanë “mësuar” gjatë “arsimi-mit” të tyre, se Islami në vetvete është çështja më e rrezikshme për Evropën dhe Perëndimin, t’i kuptojnë dhe vlerësojnë fitoret e arritura nga muslimanët, dhe ky paragjykim ishte ngulitur thellë në mendjen dhe ndërgjegjen e tyre; ata i shikojnë dhe i interpretojnë këto fitore, nga pikëpamja e fitoreve imperialiste të ushtrive të tyre. Ata nuk do të arrijnë të kuptojnë se “motivi dhe pikënisja” janë krejtësisht të ndryshme.

Jo vetëm historianët dhe studiuesit perëndimorë, të cilët vijnë nga një sfond kulturor tërësisht i ndryshëm, por edhe disa të ashtuquajtur historianë turq, të lindur muslimanë, të cilët e shikojnë vetveten si “të huaj”, “të ftohtë” ndaj fesë islame, në të vërtetë, nuk mund ta kuptojnë “faktin osman”, pasi atyre u mungon “pjesëmarrja psikologjike”, që është thelbësore “për të qenë në gjendje për ta kuptuar faktin osman” dhe që është në natyrën e sfondit të domosdoshëm.

Kur Orhan Gazi u angazhua për sigurimin e “*të drejtave të njerëzve*”, evropianët jetonin praktikisht në skllavëri. Shtrirja e osmanëve në Evropë, kishte sjellë ballafaqimin e drejtpërdrejtë të dy vizioneve dhe dy qytetërimeve të ndryshme me njëri-tjetrin (Islamin dhe Krishterimin).

Nën udhëheqjen e Osman Gaziut, çdo njeri i aftë duhet të regjistrohej në radhët e ushtrisë; e sidomos në radhët e ushtrisë kalorësiake, lëvizja e shpejtë e së cilës ishte e nevojshme për të mbrojtur zonat kufitare. Ushtarët mblidheshin gjatë *gazavateve* (luftërave të shenjta) dhe iu lejohej të ktheheshin për t’u marrë me tokat e tyre, kur gjendja e luftës kishte mbaruar. Gjatë rrethimit të qytetit Bursa, Orhan Gaziu, e kishte kuptuar se kalorësia ishte e shkëlqyer gjatë betejave të shkurtra, por jo për luftëra afatgjata, dhe se për to ishte e nevojshme këmbësoria. Kështu që, ai krijoi njësinë e këmbësorisë të quajtur *jaja*, si dhe


formoi njësi të rregullta kalorësish, të quajtur “*muselem*”⁸⁶ që fjalë për fjalë do të thotë “përrjashtuar nga taksat”. Në këtë mënyrë, këtyre ushtarëve u ishte dhënë ky privilegj, si këmbim ndaj shërbimit të tyre ushtarak. Të dy njësitë ushtarake, *jaja* dhe *muselem*, përbënin ushtrinë e plotë osmane.

Orhan Gaziu caktoi kompensimin për *huffazët* (ata që mësonin përmendësh Kur’anin Famëlartë) dhe për dijetarët. Përgjithësisht, njerëzit gëzonin një standard të lartë jetese dhe shumë pak prej tyre kishin nevojë për *zekat*.⁸⁷ Ihtijaruddin Orhan Beu ndoshta ishte më i madhi, më i forti dhe më i pasuri nga të gjithë bejlerët turkmenë.

86 İ.H. Uzunçarşılı, *Osmanlı Devleti Teşkilatından Kapukulu Ocakları*, (Ankara, 1984), vëll. I, fq. 1- 3.

S. Shaw thotë se: “Ushtria e re ishte e përbërë nga të krishterët dhe muslimanët turq, por ndërkohë që osmanët i drejtoheshin rajonit të Ballkanit nën drejtimin e Muradit, numri i të parëve ishte më i madh”, cituar nga *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey* (Cambridge, 1976) vëll., I, fq. 25. Por, ky vlerësim nuk është i drejtë. Është e vërtetë që osmanët në ushtrinë e tyre kishin një numër të caktuar ushtarësh të krishterë që drejtuesit e krishterë ishin të detyruar t’i jepnin si tagrë lufte, por ata ishin vetëm një pakicë. Është me të vërtetë qesharake dhe e palogjikshme, që një ushtri muslimane të jetë kryesisht e përbërë nga të krishterë, përdërisa funksioni i saj kryesor është të hapë territore të reja ndaj Islamit dhe të zbatojë Shariatën.

87 Neşri, I, fq. 186.



Sarkofagu i Orhan Gaziut, Bursa

2.5 Gazi Sulltan Muradi 1360-1389

Murad Beu erdhi në Bursa pas vdekjes së babait të tij dhe mori drejtimin e Devletit Osman, me vendim të *Ahinjve* (fitjan)⁸⁸. Në fakt, Murad Gaziu ishte kreu i *Ahinjve*;⁸⁹ ky fakt pati një ndikim të rëndësishëm për caktimin e tij si sovran. Por, Perandoria Romake përfitoi nga rasti me vdekjen e Orhan Beut, duke pushtuar disa nga territoret e reja të përvetësuara nga muslimanët në Evropë. **Llalla Shahin Pasha, Haxhi Ilbeji dhe Evrenos Beu** u vendosën në bregun e Detit Marmara, në pritje të ardhjes së Hanit të ri, pas zgjidhjes së çështjeve të Devletit në Anadoll. Ata ishin të vendosur për të mbrojtur tyrben e Sylejman Pashait në Bollajër.⁹⁰ Vëllai i Murad Hanit, Sylejman Pasha, kishte përvetësuar Ankaranë në vitin 755/1354, por, pas vdekjes së Orhan Gaziut, Beu i Karamanit kishte nxitur *Ahinjtë*

88 Sipas Neşri, Murad Hani u bë sovran në vitin 760/1359: I, fq. 190.

89 OT, I, fq. 531.

90 OT, I, fq. 159.

për të marrë pushtetin atje. Udhëtari me famë, Ibn Battuta, na jep informacion të gjerë për *Ahinjtë*:

“Një vëlla i ri ose një *ahi* në gjuhën e tyre, është i përgjedhuri nga të gjithë anëtarët e zanatit (esnafit) të tij, ose nga djem të rinj, të pamartuar, ose nga ata që bëjnë një jetesë aske-tike, për të qenë prijësi i tyre. Kjo organizatë njihet, gjithashtu, si Futuvveh ose Urdhri i Rinisë. Prijësi ndërton një strehë dhe e pajis atë me qilima, llamba dhe sende të tjera të nevojshme. Anëtarët e komunitetit të tij punojnë gjatë ditës për të fituar jetesën dhe i sjellin në fund të ditës prijësit ato që kanë fituar. Me ato që kanë fituar, ata blejnë ushqime, fruta dhe gjëra të tjera, që i nevojiten strehës ku jetojnë. Nëse një udhëtar vjen në qytet, ata e strehojnë atë ditën që vjen; këto furnizime në strehë i shërbehen atij për gostitje si mysafir i tyre dhe ai qëndron me ta derisa largohet nga qyteti. Nëse nuk ka të ardhur në qytet, ata mblidhen për të konsumuar ushqimin dhe më pas këndojnë, dhe kërcëjnë. Të nesërmen ata iu kthehen punëve që bëjnë dhe sjellin te prijësi fitimin e ditës së punës. Anëtarët e kësaj organi-zate quhen *fitjan* (të rinj) dhe prijësi i tyre, siç përmendëm dhe më lart, quhet *ahi*.”⁹¹

Me sa duket *ahinjte* mendonin se Devleti Osman ishte në procesin e bashkimit të muslimanëve në Anadoll. Kështu, kur Murad Hani marshoi drejt Ankarasë, në vitin 763/1362, ata ia dorëzuan atij qytetin me dëshirën e tyre.⁹² Edhe Murad Hani ishte një Shejh Ahi;⁹³ edhe ky ishte një fakt që mund të ketë luajtur një rol të rëndësishëm për marrjen e këtij vendimi.

91 Ibn Battutah, *Travels in Asia and Africa, 1325-1354*, përkthyer nga H.A.R. Gibb (Londër: 1983),

fq. 125-126.

92 Neşri, I, fq. 190-192.

93 *Tarih vesikalari dergisi* 4, dhjetor 1941, cituar nga OT, I, fq. 531: Murad Gaziu caktoi të quajturin Musa si Ahi në Mallkara, në Rajab 767/mars 1366.

Me marrjen e Ankarasë, u arrit zgjerimi i territoreve osmane drejt lindjes dhe u krijua mundësia që ata të mblidhnin luftëtarë për hapjen e territoreve të reja ndaj Islamit në Evropë.

Murad Hani u rikthye në Bursa, atje ku kishte ardhur dhe **Llalla Shahin Pasha**. Sulltani e caktoi atë si *Bejlerbeun* e parë dhe ata kaluan së bashku Detin Marmara drejt pjesës evropiane.

Situata në Ballkan

Ndërkohë që osmanët ishin të angazhuar në zhvillimin e xhihadit në rajonin e Ballkanit, situata politike atje ishte në këtë gjendje:

Trakia Lindore, Selaniku dhe territoret përreth, disa nga brigjet e Peloponezitet dhe Epiri Jugor, ishin në varësi të Perandorisë Romake. Rajoni Verilindor i Ballkanit ishte nën administrimin e Bullgarisë. Pjesa e Veriore e Serbisë dhe Serezi, deri diku, ishin nën hegjemoninë serbe. Në Veri të Epirit, kishte serbë, shqiptarë dhe principata katolike shqiptare të madhësive të ndryshme; këto principata ishin nën ndikimin e Republikës së Venedikut dhe Mbretërisë së Napolit.⁹⁴

Murad Hani hapi ndaj Islamit qytetin Çorlu dhe Lyleburgaz në vitin 763/1361-2,⁹⁵ shkatërroi muret rrethuese të tyre dhe urdhëroi vendosjen e turkmenëve të Anadollit atje. Osmanët vazhduan të avanconin në atë rajon; për të shmangur çdo përforsim apo ndihmë të mundshme, nga kryeqyteti i Kostandinopojës drejt Edrenesë (Adrianapojës). **Evrenos Beu** aneksoi qytetet Mallkara dhe Ipsala, ndërkohë që **Haxhi Ilbeji** e mori qytetin Aleksandropoja (Dedeğaç), dhe portin e tij në vitin 761/1360. Më pas edhe Dimetoka (Dydimothikhon) u hap ndaj Islamit. Osmanët i mundën ushtritë romake që ishin të etura për t'i rimarrë këto territore. Nga viti 762/1361, **Sulltan Muradi** hapi ndaj Islamit qytetin Edrene dhe e shpalli kryeqytet të tijin

94 OT, I, fq.161-162.

95 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 56.

në vitin 770/1368. Edrene ishte qendra e Trakisë, si dhe qyteti i dytë për nga rëndësia pas Kostandinopojës, në Perandorinë Romake. Ai shtrihej në zonën ku bashkoheshin lumenjtë Meriç (Marica) dhe Tunxha; në vendin ku kryqëzoheshin rrugët e Ballkanit; dhe në rrugën Kostandinopojë-Vjenë. Pra, hapja e qytetit Edrene ndaj Islamit, ishte një përfitim shumë i rëndësishëm ushtarak për osmanët. Në këtë mënyrë, ata u vendosën përfundimisht në Kontinentin e Evropës.⁹⁶

Turqit osmanë, ishin të angazhuar vendosmërisht për t'i transferuar muslimanët nga Anadulli dhe për t'i vendosur ata në territoret e reja të përvetësuara. Ata i trajtonin njerëzit e këtyre vendeve mjaft mirë, duke iu dhënë atyre liri të plotë besimi fetar dhe duke iu siguruar kushte të pranueshme jetese. Sipas rregullave të vendosura nga **Stefan Dushani**, Mbreti i Serbisë, fshatarët, për shembull, duhet të punonin dy ditë në javë për pronarët e tyre; ndërkohë që osmanët iu kërkonin atyre të punonin vetëm 3 ditë në vit për *spahiun* (administratorin osman) e tyre. Osmanët e kishin ndaluar, gjithashtu, shfrytëzimin e fshatarëve nga drejtuesit e tyre lokalë. Ky trajtim njerëzor i bindi fshatarët të mos kundërshtonin dhe ta pranonin me dëshirë sundimin osman. Një shembull i kësaj është edhe qëndrimi kundërshtues i popullit të krishterë të rajonit të Ballkanit ndaj ftesës së pronarëve apo sovranëve për t'iu bërë rezistencë osmanëve.⁹⁷

Ideali i *gazarë*, luftës së shenjtë, nuk ishte vetëm një faktor themelor për krijimin dhe zhvillimin e Devletit Osman, por ishte vetë arsyeja e ekzistencës së tij. Por, xhihad nuk do të thotë të shkatërrosh medoemos botën e jobesimtarëve, *Daru'l-harb*, por, para së gjithash, ta nënshtrosh atë dhe ta kthesh në *Daru'l-islam* (mbretërinë e vlerave të Islamit). Pra, sulltanët e parë osmanë ishin kryesisht të interesuar për përhapjen e

96 Danişmend, I, fq. 39.

97 Halil İnalçık, *The Ottoman Empire*, përkthyer nga Norman Itzkowitz dhe Colin Imber (Londër, 1973) fq. 13.

Islamit dhe jo për plaçkën e përfiturar nga lufta. Për këtë arsye, ata nuk hezitonin asnjëherë t'iu jepnin pjesë të mëdha toke komandantëve të tyre, të cilët hapnin territore të reja ndaj Islamit.⁹⁸ Kur Sulltan Muradi i dërgoi një *Name-i Hymajun* (letër) Sovranit të Emirateve të Karamanit, më 1 Rabi' eth-Thani 767/16.12.1365, ai e quajti kryeqytetin e tij Bursa, **Daru'l-hilafet** (Selia e Hilafetit).⁹⁹ Kur komandanti **Evrenos Bej** i hapi ndaj Islamit qytetet Gymlxhine, Seerrai (Siroz) dhe Bitola (Manastir), Sulltani osman, Murad, i dha të gjitha këto zona si *sanxhak*, duke i dhënë edhe titullin **Emirul Mu'minin**,¹⁰⁰ mbi të gjithë gazinjtë (muxhahidinë) në ato *vilajete*. Ai shtoi: "...Por mos gaboni të mendoni se 'unë i kam hapur vilajetet e Rumelisë me shpatën time'. Përkundrazi, duhet të dini me siguri se ato vilajete **i përkasin Allahut s.v.t., pastaj Pejgamberit të tij, e më pas, me urdhër të Allahut, pas Pejgamberit të Tij, ato i përkasin Halifit**. Është e vërtetë që ju na dhatë të vërtetën dhe favore. Dhe ne, në përgjigje të së vërtetës dhe shërbimit tuaj, ju favorizua; ne kemi nxitur zhvillimin tuaj në tre mënyra: së pari, ne ju drejtuam si **Emirul Mu'minin**. Së dyti, ju dhuruam një mantel nderi (*hil'et-i fahireh*). Së treti, ju dërguam një daulle dhe **Flamurin**¹⁰¹ **e Pejgamberit të Nderuar e të Respektuar** dhe një *tuğ...*"¹⁰² **Është e qartë nga berati i tij, se Sulltani osman, Muradi, e shikonte veten si Halif**. Babai i tij, që në vitin 1332, kishte shprehur në mënyrë të veçantë etjen e osmanëve për të rigjallëruar strukturën e Hilafetit dhe për t'i dhënë vlerën që i takonte, dhe Sulltan Muradi u quajt si i tillë nga emirati më i madh që ekzistonte në atë kohë në rajonin e Anadollit, Bejluku i

98 Për këtë lloj pikëpamje shiko Feridun Beğ, *Münsheat-i Selatin*, I, fq. 72.

99 Feridun Beğ, *Münsheat-i Selatin*, I, fq. 90, rreshti 25.

100 Ky titull iu dha për herë të parë **Abdullah b. Xhehshit** nga Muhammedi (s.a.v.s), kur ai u dërgua në krye të grupit të muhaxhirinëve për të kontrolluar aktivitetin e Kurejshëve. Përdorimi i të njëjtit titull nga osmanët, shumë shekuj më vonë, tregon vazhdimësinë e kulturës dhe vlerave islame.

101 Mund të supozojmë se *kelime-sh-shehadet* ishte shkruar mbi këtë flamur.

102 *Münsheat*, I, 87.

Karamanit, si dhe nga **Xhanëbek Hani** i Hordhisë së Artë.¹⁰³ Në të vërtetë, Devleti Osman ishte kthyer në atë kohë, në *forcën* muslimane luftarake, e cila ishte e angazhuar në mënyrë njafte aktive në fushatat e vazhdueshme të xhihadit kundër jobesimtarëve. Faktikisht, siç thotë edhe **Ebu Ja'la el-Ferra**, “Në rastin kur një musliman dominon mbi muslimanët e tjerë dhe bëhet Halif, nuk është e ligjshme për askënd që beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, të kalojë qoftë edhe një natë të vetme pa e pranuar atë si prijësin e tij (*Imamen alejhi*). Qoftë ky prijës një njeri i devotshëm ndaj besimit, apo një mëkatar, **ai është prijësi i muslimanëve.**”¹⁰⁴ Për më tepër që ky prijës ishte tepër i devotshëm ndaj besimit të tij.

Perandoria Romake i nënshtrohet Devletit Osman

Sulltan Muradi vazhdoi veprimtarinë e tij të *fet'hut* (hapjen e territoreve të reja ndaj Islamit); duke përdorur pozitën strategjike të Edrenesë, ai dërgoi **Llalla Shahin Pashanë** në drejtim të veriut në qytetet Filibe dhe Zagra, **Evrenos Beun** në drejtimin e Trakisë Perëndimore, për ta hapur qytetin Gymylxhine ndaj Islamit. **Llalla Shahin Pasha** e hapi ndaj Islamit qytetin Filibe, duke e privuar në këtë mënyrë Perandorinë Romake nga përfitime të tilla si: orizi dhe taksat që ata mbledhnin nga lugina Meriç (Marica). Hapja e qytetit Filibe ndaj Islamit, shënoi zgjerimin e territorit osman si një pengesë ndaj bullgarëve dhe grekëve, që ishin përpjekur të bënin qëndresë në brigjet e Detit Egje, duke e penguar këtë lidhje midis tyre.¹⁰⁵

103 *Münshet*, I, 95; Karaman Oğlu uroi Sulltan Muradin, duke përdorur titullin **zil-lullah** me rastin e hapjes së qyteteve Edrene, Filibe, Zagra dhe Gymylxhine ndaj Islamit. Xhanibek Hani e përgëzoi atë për arritjen e tij të fundit: shpalljen e Edrenes si kryeqytetit, duke iu referuar kryeqytetit të ri si **daru'l-hilafet**: I, fq. 97.

104 el-Ferra', Ebu Ja'la Muhammed ibn el-Husejn, *el-Ahkamus Sultanijeh*, (Surabaja, Indonesi, 1394/1974), fq. 20.

105 *OT*, I, fq. 165; Stanfrod J. Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, (ribotim) Kembrixh 1976, vëllimi I, fq. 18.

Perandori romak **Joanis** (1341-1391), nënshkroi një traktat me **Doxhin (Dukën) e Venedikut**, në korrik të vitit 1361, por shumë shpejt e kuptoi se ky traktat nuk do të bënte të mundur tërheqjen e forcave osmane nga Trakia, për shkak se osmanët e kishin vendosur popullsinë e tyre turke në këtë territor, duke i sjellë ata nga Anadulli, dhe ata i mbronin brigjet e tyre me mjaft forcë. Perandoria Romake ishte në prag të rënies, pasi ajo ishte kthyer në një Perandori tepër të dobët; të ardhurat e saj të përgjithshme siguroheshin vetëm nga mbledhja e taksave nga dogana e Selanikut (Thesaloniki) dhe e Kostandinopojës, si dhe nga mbledhja e taksave bashkiake të Kostandinopojës (Stambollit). Në këto kushte, Perandori Joanis, nënshkroi një pakt me Devletin Osman në vitin 1364, me anë të të cilit ai deklaronte se tokat e hapura ndaj Islamit iu përkisnin osmanëve. Nëpërmjet këtij traktati, Perandori romak pranoi se, në mënyrë të drejt-përdrejtë ose indirekte, nuk do të përpiqej t'i përvetësonte këto toka, nuk do të bashkëpunonte më armiqtë kundër osmanëve; do t'i dërgonte forcat e tij ushtarake nën shërbimin e Sulltan Muradit, kurdoherë që ai t'i kërkonte, në rast të një sulmi të mundshëm ndaj Emirateve në Anadoll, duke u kthyer kështu në vartës të nënshtruar të Sulltanit osman. Ky traktat, nënkuptoi kthimin e Sulltan Muradit në kryezetin zyrtar dhe ligjor të Perandorisë Romake.¹⁰⁶

Beteja e Sërpsëndëgë (Sırpsındığı) 1364

Komandanti romak, që ua dorëzoi osmanëve qytetin Filibe dhe u largua së bashku me familjen e tij drejt Serbisë, iu drejtua Uroshit V, duke thënë se ushtarët turq ishin të pakët në numër, dhe e nxiti atë të sulmonte forcat osmane, duke shtuar se në të kundërt situata do të përkeqësohej. Papa Urbani V, gjithashtu, u bëri thirrje të krishterëve, që të krijonin një front ushtarak të bashkuar kundër muslimanëve osmanë. Në këtë mënyrë, mbretërit e Hungarisë, Serbisë dhe Bullgarisë, si dhe Princi i Vllahisë

106 İsmail Hami Danişmend, *İzahlı Osmanlı Tarihi Krnoolojisi*, I, fq. 42.

formuan një Ushtri Kryqtare prej 50-60.000 luftëtarësh, të udhëhequr nga mbreti hungarez Lajosh. Në atë kohë, Murad Hani ishte i angazhuar në rrethimin e qytetit Biga në Anadoll, ndërsa kryqtarët ishin të vendosur që t'i dëbonin osmanët nga territori i Evropës. Nëse Mbreti Lajosh (Louis), do të arrinte të kishte sukses në këtë luftë, mundësitë ishin që ai të merrte kontrollin mbi bullgarët dhe të përhapte katolicizmin në Evropën Lindore.¹⁰⁷ Forcat e bashkuara ushtarake të krishtera, marshuan drejt Edrenesë. Bejlerbeu Llalla Shahin, njoftoi Sulltan Muradin për krijimin e kësaj situatë të rrezikshme dhe dërgoi një forcë zbulimi nën drejtimin e Haxhi Ilbejit që arriti në vendngjarje vetëm pak kohë pasi Ushtritë e Bashkuara të krishtera kishin kaluar lumin Meriç. Kryqtarët, dukeshin të bindur për fitore, pasi nuk ishin përballur me asnjë rezistencë derisa mbërritën në Edrene. Edhe pse numri i ushtrisë së tij ishte më i pakët nga ai i ushtrisë evropiane, Haxhi Ilbeji i sulmoi armiqtë gjatë natës nga tre drejtime të ndryshme. Të krishterët, që raportohet të kenë qenë të dehur, u gjendën në befasi dhe pësuan disfatë, madje disa prej tyre u mbytën në lumin Meriç, ndërsa mbreti hungarez Lajosh arriti të shpëtonte nga vdekja me shumë vështirësi. Kjo betejë u zhvillua në vitin 765/1364 dhe u quajt Beteja e Sërpsëndëgë (Disfata e serbëve).¹⁰⁸ Kjo ishte përpjekja e parë e krishterëve të bashkuar, nga shumë të tilla, për një aksion kundër osmanëve.¹⁰⁹ Mbreti hungarez Lajosh, ndërtoi Kishën Maria-Zell në Istirja, në shenjë falënderimi ndaj Maries.¹¹⁰ Murat Hydavendigari ndërtoi një xhami në Bilexhik, një imaret në Jenishehir, një teqe për Pustin Push Babanë, një xhami në kështjellën e Bursës, një imaret, një medrese, një hamam (banjë publike), një *han* (hotel për udhëtarët) në

107 OT, I, fq. 167.

108 OT, I, fq. 168.

109 Stanford Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 18.

110 Danişmend, I, fq. 42; OT, I, fq. 168.

Çekirge, Bursa, në shenjë falënderimi ndaj Allahut për fitoren ndaj ushtrisë së krishterë.¹¹¹



*Xhamia e Hydavendingarit, Bursa,
ku kati i sipërm ishte medrese.*

Për shkak të zgjerimit të pamasë të territorit dhe të ushtrisë së tyre, osmanët krijuan postin e Kadiaskerit, që do të administronte çështjet *shariatike* (religjioze-juridike) të ushtarëve, dhe i pari që u caktua në këtë detyrë ishte *kadiu* i Bursës, Xhendereli Kara Halili (v. 789/1387).¹¹² Osmanët u përpoqën të rekrutonin robërit e luftës në ushtrinë e tyre, por kjo nuk pati shumë sukses, për arsye se disa prej tyre dezertuan. Në këtë mënyrë, ata krijuan një metodë të re për përgatitjen e ushtarakëve muslimanë, nga radhët e popujve të vendeve të pushtuar të Ballkanit. Studiuesi **Mevlana Kara Rystem**, argumentoi se përderisa *Sheriati* ia jep Devletit 1/5 e përfitimeve të luftës, një në pesë rob luftime duhet të shkojë në *Bejtyl'Mal*, Thesarin e Devletit Islam.¹¹³

111 OT, I, fq. 169.

112 OT, I, fq. 166.

113 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 196.

Kështu, **Kadiaskeri Kara Halil** e zbatoi këtë metodë për rekrutimin e ushtarëve të rinj për Devletin Osman.¹¹⁴ Rrjedhimisht, ata robër të luftës u dërguan në fshatra për të mësuar gjuhën turke dhe për të jetuar në një mjedis islam. Nëpërmjet kësaj praktike, që u quajt “Tyrke vermek” (dhënia turqve), u formua ushtria osmane e *jeniçerëve*.¹¹⁵ Fjala *jeniçeri* do të thotë “ushtar i ri”. Duhet të theksojmë se kapela e mbajtur nga jeniçerët, quhej boruk (*börük*) ose bork (*börk*); po ai emër që përdorej edhe nga Gokturqit në Turkestan, madje përpara shfaqjes së tyre, edhe pse kishte ndryshuar formën. Është tepër e rëndësishme të theksojmë gjithashtu se orientimi islamik i këtyre të rinjve, në shekullin e 14-të dhe të 15-të, nuk u arrit në institucionet zyrtare të arsimit, të cilat kishin një kurrikulum të caktuar, dhe profesorë të specializuar. Përkundrazi, u realizua në një mënyrë jo-formale, përmes kontaktit me njerëzit, gjë që tregonte se Islami ishte kthyer në atë kohë në një mënyrë jetese dhe në një kod morali lehtësisht të zbatueshëm. **Me fjalë të tjera, popullsia osmane turke e Anadollit kishte krijuar, në terma sociologjike, kulturën e saj dalluese islame, që ia kalonte asaj që kishin evropianët e krishterë të periudhës së shekullit të 14-të dhe 15-të.** Historia na tregon se kur dy kultura janë në garë me njëra-tjetrën, kultura më e fortë i zë vendin kulturës tjetër. I njëjtit ishte dhe rasti i kulturës së lashtë greke, kundër romakes dhe i asaj mongole kundër kulturës së Islamit, edhe pse si romakët, ashtu edhe mongolët, arritën fitore të shumta ushtarake në fushëbetejat. Nëse kultura Islame e osmanëve, nuk do të kishte qenë mjaftueshmërisht e fuqishme, për t’i frymëzuar ata të rinj që ta pranonin Islamin dhe kodin e tij të etikës, ndoshta do të kishte qenë e pamundur që Devleti Osman të mbijetonte dhe të zgjeronte territoret e tij.

Nën drejtimin e Osman Gaziut, çdo musliman i aftë ishte një luftëtar *muxhahid*. Megjithatë, zgjerimi i pamasë i territoreve

114 Kur’an, *el-Enfal*: ajeti 4. Ajeti vazhdon të shpjegojë se ku duhet të shpenzohet 1/5 nga Devleti Islam.

115 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 198.

osmane, bëri që Devleti Osman të kishte nevojën e një ushtrie të rregullt dhe të përhershme. Orhan Gaziu (1324-1362) për herë të parë themeloi ushtrinë e rregullt osmane të përbërë nga trupa e këmbësorisë, të quajtur *jaja* dhe trupa e kalorësisë të quajtur *muselem*. Meqenëse zonat e reja të hapura ndaj Islamit, ishin të banuara kryesisht nga të krishterët, gjatë sundimit të Sulltan Muradit (1362-1389), osmanët praktikuan një metodë të re të rekrutimit të kësaj popullsie në ushtrinë osmane, të quajtur *devshirme*. Fëmijët e krishterë në ato zona merreshin për t'u rritur në një ambient islam. Në këtë mënyrë, ata rekrutoheshin përfundimisht në forcën e re ushtarake osmane, të quajtur *jeniçeri* (ushtarë të rinj).

Hapja e qytetit Biga ndaj Islamit

Qyteti Biga, në tokën e Ballkanit, ishte nën hegjemoninë e Katalanëve. **Sulltan Murad Hydavendigari**, synonte ta hapte këtë qytet ndaj Islamit, që të mos i mbetej pas shpine asnjë forcë armike, kur ai të nisej drejt Evropës për t'u përballur me forcat e krishtera. *Fet'hi* (hapja ndaj Islamit) i këtij qyteti ndodhi në vitin 1363 apo 1364.

Trupat katalanase ishin ushtarë mercenarë evropianë. Ata ishin marrë në shërbim nga Perandori romak **Andronikos II Paleologos**, në vitin 1303, dhe në këtë forcë përfshiheshin endacakë nga Sicilia, Aragona, Navarra, Franca, Italia, Gjermania dhe zona të tjera të Evropës. Kushdo që i paguante ata, kishte të drejtë t'i përdorte në shërbimin e tij, kundër kujt të dëshironte. Ata drejtoheshin nga një udhëheqës gjerman, **Rozher (Roger) de Flor**. Mbiemri i tij gjermanisht ishte "Blum"; dhe kur ai u vendos në krye të këtyre endacakëve, mbiemri i tij, që në gjermanisht do të thotë "lule", u kthye në spanjisht "flor". Pasi rekrutoi rreth 10.000 endacakë, Rozheri, i vendosur nën shërbimin e Mbretit të Sicilisë, luftoi kundër Napolit; por, pasi u gjend i papunë pas nënshkrimit të traktatit të paqes, ai i ofroi shërbimin e tij perandorit romak. Perandori, që ishte lodhur

nga avancimet e forcave turke në Anadoll, e pranoi shërbimin e tij. Rozher de Flor dhe endacakët e tij, u nisën nga Sicilia me 26 luftanije dhe zbarkuan në Kostandinopojë. Sipas marrëveshjes që kishin arritur, ai mori nga perandori titullin “**Megadukas**” (Duka i Madh), dhe, për më tepër, ai lidhi martesë me një princeshë romake, mbesë e perandorit. Katalanët, pasi u vendosën në qytetin Erdek në rajonin e Anadollit, në vitin 1303, filluan sulmin, por banorët e krishterë, së bashku me muslimanët, iu shkaktuan atyre disfatë dhe shkatërrim.

Në këtë mënyrë, në vitin 1306, ata u dërguan në pjesën evropiane të Perandorisë Romake, nën pretekstin për të shërbyer kundër bullgarëve. Katalanët lanë një pjesë të forcave të tyre në Biga dhe në Erdek, në rajonin e Anadollit. Ata vazhduan të shtoheshin në numër nëpërmjet rekrutimeve të reja nga Franca, Italia dhe Spanja, dhe u kthyen në një katastrofë të vërtetë për popullin e krishterë të asaj pjese të perandorisë. Perandori vendosi t’i përdorte sërish kundër osmanëve të Anadollit dhe bëri një marrëveshje të re me Rozherin, duke i dhënë atij titullin **Cezar**, që, sipas përdorimit romak, ishte një titull nën rangun e perandorit. Në historinë romake, Rozheri konsiderohet si i huaji i parë që e mori këtë titull. Por, djali i perandorit dhe partneri i tij në sundim, **Mihaili**, në atë kohë, ishte në Edrene (Adrianapojë), dhe kur **Cezari, Rozher de Flor** mbërriti në Edrene, në vitin 1307, për t’u përshëndetur me shokun e tij përpara se ai të largohej nga Anadoll, ai dhe disa nga shoqëruarit e tij u vranë gjatë gostisë. Katalanët në Anadoll u spastruan nga Sulltan Murad Hydavendigari.¹¹⁶

Dubrovniku hyn nën protektoratin e osmanëve në 1365

Republika e Dubrovnikut (Raguzës) shtrihej në pjesën jugperëndimore të Bosnjës dhe në brigjet e Detit Adriatik. Duke qenë se kishte një shtrirje të vogël territoriale dhe tokë të

116 Danişmend, I, fq. 43-45.

papunueshme, ishte më tepër e angazhuar me veprimtarinë tregtare. Në vitin 1365, kjo Republikë arriti një marrëveshje me Devletin Osman, sipas të cilës pranoi që t'i paguante Devletit Osman 500 monedha floriri në vit, në këmbim të mbrojtjes së osmanëve, dhe lirisë së tregtimit në rajonin lindor të Mesdheut. Tugra (**Tuğra**) (Firma e Sulltanit) vendosej në fund të marrëveshjeve, gjatë periudhës së administrimit të selçukëve dhe Bejlikeve të tjera turkmene në Anadoll. Në këtë mënyrë, *Tuğra* e Sulltan Muradit u vu edhe mbi këtë marrëveshje midis Republikës së Dubrovnikut dhe Devletit Osman. Nëpunësi zyrtar, që ishte i ngarkuar të vendoste firmën *Tuğra* të Sulltanit quhej **Tuğra-kesh** dhe nënshkrimi i këtij akti ishte një ngjarje shumë e rëndësishme. Pohimi se Sulltan Muradi e futi dorën e tij në bojën e shkrimit dhe më pas e vendosi atë mbi marrëveshjen për ta firmosur, nuk është i saktë. Dihet me siguri se babai i tij, **Orhan Gaziu**, kishte *Tuğran* e tij që më parë; këto lloj pohimesh pasqyrojnë vetëm qëndrimin e ndikuar subjektiv dhe paragjykses të disa studiuesve. Kjo marrëveshje konsiderohet si marrëveshja e parë e vazhdueshme e paqes me një entitet shoqëroropolitik evropian nga ana e osmanëve, si dhe **dokumenti i parë** që e ktheu Devletin Osman në trashëgimtarin e Perandorisë Romake.¹¹⁷

Humbja e Galipolit (Gelibollu)

Perandori romak **Joanis V Paleogog**, që e kishte pranuar **Murad Hydavendigarin** si kryezotin e tij, nuk mund ta pranonte për një kohë të gjatë këtë situatë. Për këtë arsye, ai shkoi fshehurazi në Hungari, për të takuar **Mbretin Lajosh** dhe e nxiti atë kundër osmanëve. Ndërkohë që kthehej nga Bullgaria, Perandori **Joanis** u arrestua dhe u burgos në Kështjellën e Nikopolit, me urdhër të mbretit bullgar **Shishman**, i cili kishte si qëllim të merrte pëlqimin e sulltanit.¹¹⁸ **Por, ndërkohë, Papa**

117 Danişmend, I, fq. 45-46.

118 Danişmend, I, fq. 46.

shpalli në Krishtlindjet e vitit 1366 një kryqëzatë të re kundër osmanëve. Perandori romak, mbreti i Hungarisë dhe qytet-shtetet e Italisë, ishin të gjitha të ftuara të merrnin pjesë në këtë Kryqëzatë. Vetëm nga Duka i Savojës, **Amadeus II**, erdhi përgjigje serioze dhe me flotën e tij u mor Galipoli dhe iu dorëzua Perandorisë Romake.¹¹⁹ Por, Devleti Osman nuk u ndikua shumë nga humbja e Galipolit, pasi ata kishin arritur të vendoseshin qëndrueshëm në Traki. Si përgjigje ndaj marrjes së Galipolit, Murat Hydavendigar i zhvendosi turkmenët nga rajoni i Anadollit në Traki dhe transferoi një pjesë të popullsisë së krishterë nga Trakia në Anadoll.

Osmanët vazhduan të toleronin çifutët dhe të krishterët, të cilët në terminologjinë islame quheshin “Ehl-i Kitab” (Ithtarët e Librit). Osmanët vazhduan t’i mbronin ata, shpirtat, pronën dhe nderin e tyre, duke marrë vetëm taksën *xhizje* prej tyre.¹²⁰ Për shkak të trajtimit të mirë nga Devleti Osman, disa të krishterë të Ballkanit pranuan fenë islame me dëshirën dhe vullnetin e tyre. Madje grupe të tilla si Bogomilët, zgjodhën

119 Stanford J. Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, Cambridge: (e ribotuar) 1991, vëll., I, fq. 19.

120 Pothuaj të gjithë studiuesit perëndimorë deklarojnë gabimisht se Devleti Osman trashëgoi të gjitha institucionet e tij nga Kostandinopoja. S. Shaw nuk bën përjashtim kur thotë se: “Struktura ekzistuese e taksave si dhe praktikës feudale të krijuara nën sundimin bizantin u ruajtën me shumë pak ndryshime, (*vepër e cituar*, I, fq. 26). Por, duke qenë se osmanët përfaqësonin Islamin, kjo, në fakt, ishte arsyeja e ekzistimit të Devletit të tyre. Në këtë mënyrë, ata zbatuan Sheriatin dhe ligjet e tij, ashtu siç shkruhet qartësisht edhe në Kur’an dhe Sunnet, për çdo aspekt të jetës, për shembull: institucioni *xhizje*, me anë të të cilit muslimanët ishin të autorizuar të mbledhnin para nga jobesimtarët në kthim të sigurisë që Devleti musliman u jepte atyre. “Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar (haram) atë që e ndaloi Allahu dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë, prej atyre të cilëve u është dhënë libri, derisa ta japin *xhizjen* në dorë e duke qenë të mposhtur.” (*et-Tevbe*, 29). Pejgamberi i Fundit Muhammedi (Paqja qoftë me të), mori *xhizje* nga Peshkopi i Ajles në 9 /630. Populli i Xherbas dhe Azruhut, gjithashtu, iu paguante *xhizje* muslimanëve në atë kohë: Ibn Hisham, në *Siretun Nebevijeh*, Kajro, 1375/1955, vëll. II, fq. 525.

Islamin për të shpëtuar nga shtypja e krishterë.¹²¹ Pretendimi i disa perëndimorëve se këta njerëz zgjodhën Islamin për të mos paguar taksën *xhizje* nuk është i vërtetë dhe është i pa-pranueshëm, për vetë faktin se ata që pranonin Islamin duhet të paguanin *zekatin*, taksën që paguanin muslimanët.

Rikthimi për të hapur territore të reja në Evropë

Osmanët vazhduan avancimin e tyre për të hapur territore të reja në Evropë ndaj Islamit. **Timurtash Pasha** (v.1404) i mori qytetet Këzëllagaç (Kızılağaç) dhe Janbollu (Yanbolu) nga bullgarët, ndërsa **Llalla Shahin Pasha** mori qytetet Ihtiman dhe Samakov në vitin 768/1368. Një vit më pas, **Sulltan Muradi** mori nga Bullgaria Ajdosin (Ajtes), Karinabadin dhe Sozopolin, si dhe Hajrabollun (Hayrabolu) nga Perandoria Romake në vitin 769/1368. Ai rihapi, gjithashtu, Kërklarelinë (Kırklareli) ndaj Islamit.¹²² **Llalla Shahin Pasha** mundi **Carin bullgar Ivan Shishman** dhe **mbretin serb** në Samakov, në vitin 774/1371. Osmanët u përballën sërish me serbët në 774/1371, në **Çirmen**, dhe si e thyen e shpërndanë ushtrinë e tyre. Kjo fitore u dha osmanëve mundësinë për të pasur qasje në rrugët e tregtisë me Maqedoninë, ndërsa, menjëherë pas kësaj fitoreje, **Gazi Evrenos Beu** e hapi qytetin Gymylxhine ndaj Islamit. Kara Halili, i cili ishte ngritur në gradën e Vezirit dhe kishte marrë emrin **Hajreddin Pasha**, hapi ndaj Islamit qytetet e Kavalas, Dramas, Zihnes (Alistati), Serezit dhe Verojës (Karaferje). **Evrenos Beu** u vendos në Serez duke e kthyer këtë qytet në bazën e tij. Në vitin 774/1372, u hap dhe qyteti Kostendil (Köstendil), ndërkohë që **Sulltan Muradi** mori kështjellat e Inxhegizit dhe Çatallburgazit, në vitin 775/1373. Pas fitores në betejën e Sërpsëndëgë kundër serbëve, osmanët morën dhe Rumelinë, duke e vendosur sundimin e tyre edhe në Maqedoni, pas fitores së tyre të dytë në Çirmen në vitin 1372. Fillimisht, u mendua se osmanët erdhën

121 Stanford J. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 19.

122 OT, I, fq. 170.

në Rumeli për prenë e luftës, siç ishte rasti dhe me Emiratet e Ajdënit (Aydn), Saruhanit dhe Karesit. Por, pasi e aneksuan Maqedoninë pas betejës së dytë në Çirmen, u kuptua se osmanët kishin arritur deri në këtë vend për t'u vendosur në këtë zonë. Megjithatë, **Sulltan Muradi** i kishte ndaluar veprimet ushtarake në Rumeli pas vitit 1373 dhe e kishte drejtuar vëmendjen e tij drejt rajonit të Anadollit.¹²³

Nga ana tjetër, **perandori romak** shkoi në Romë për të siguruar mbështetjen e **Papës Urban V**, në vitin 771/1369; ai kërkoi faljen e Zotit që kishte qenë ortodoks dhe u pendua **duke u kthyer në katolik!** Por, popujt e Perandorisë nuk pranuan ta ndiqnin atë dhe të ktheheshin në katolikë. Pas hapjes së Çatallxhas dhe Inxhegizit ndaj Islamit, duke mos pasur mundësi të largohej as nga Stambolli, **Perandori Joanis V**, i dërgoi lajm **Sulltani Murad Hydavendigarit** duke kërkuar mbrojtjen e tij. Në këtë rast, pakti i vasalitetit, i nënshkruar dhe i shkëlur nga ana e romakëve, u rinovua me garanci prej tyre. Sipas këtij traktati, perandori romak dërgoi peng djalin e tij **Theodorin**, në oborrin osman dhe pranoi detyrimin për të dërguar ushtarët e tij nën shërbimin e sulltanit, sa herë që ai t'i kërkonte.¹²⁴



Xhamia e Timurtash Pashait, Bursa

123 OT, I, fq. 173.

124 Danişmend, *vepër e cituar*, I, fq. 51-56.

Me rekomandimin e **Timurtash Pashait**, osmanët krijuan dhe njësi të rregullta kalorësiake me pagesë, që u quajtën *sipahi*, të cilët ishin bijtë e *devshirmesë*. Ata, gjithashtu, përmirësuan organizimin *timar*, që ishte bazuar në praktikën e **Pejgamberit të Fundit Muhammed** (s.a.v.s), i cili ua dha tokat e territoreve të reja të hapura ndaj Islamit disa individëve të caktuar, në këmbim të shërbimeve të tyre për Devletin e tij. Për arsye se muslimanëve iu kërkohesh në Kur'an të ndiqnin Sunnetin [praktikën e Pejgamberit (s.a.v.s)], "Sigurisht ju keni një shembull shumë të mirë tek Pejgamberi i Allahut" [*el-Ahzab*, 21], ata e ndoqën këtë praktikë. Ky sistem u quajt **ikta** dhe është praktikuar, dhe zbatuar nga devlete të ndryshme islame. Pasi e trashëguan këtë sistem nga paraardhësit e tyre selçukë, osmanët e quajtën këtë sistem **timar** (tëmar). Sipas këtij sistemi, spahinjët do t'i shfrytëzonin tokat që u jepeshin si këmbim, për krijimin e një numri të caktuar ushtarësh kalorës të armatosur, dhe pjesëmarrjes aktive në fushatat e **xhihadit**, sa herë që ishte e nevojshme. **Por, sistemi timar ishte i ndryshëm nga sistemi feudal i Evropës**, në të cilin pronarët e tokave zotëronin tokën dhe njerëzit që jetonin në të. Ata ishin madje të lirë të kalonin natën e parë me një vajzë të re skllave të sapomartuar, një praktikë kjo që ishte e njohur me shprehjen latine *jus primae noctis*. Në sistemin *timar* osman, *spahiu*¹²⁵ mbante përgjegjësinë e jetës, nderit dhe pronës së banorëve që jetonin në timarin e tij. Njerëzit quheshin *ra'ijjet* (ata për të cilët kujdesej)¹²⁶ dhe ata gëzonin liri të plotë të besimit të tyre fetar. *Ra'ijjet* muslimanë

125 Nuk duhet ngatërruar me kalorësinë qendrore, që po ashtu quhej *sipahi*. *Spahiu timar* ishte një ushtar trim i fushatave të xhihadit, të cilit i jepej një copë tokë së bashku me fshatrat në të dhe **autoriteti për të mbledhur taksa** në emër të Devletit, por ai **nuk ishte pronar** i tokës apo i fshatrave.

126 Disa studiues të painformuar e përkthejnë termin *timar* apo '*ikta*, si *feudalizëm*. Por duhet të theksojmë se këto terma duhet të qëndrojnë ashtu siç janë, pasi ato përmbajnë kuptime specifike të cilat janë të veçanta për shoqëritë muslimane. Përkthimi i këtyre termave në gjuhë të tjera do të shtrembëronte kuptimin e tyre të vërtetë.

paguanin *zekat* dhe *'oshr*, ndërsa ato jomuslimanë paguanin *xhizje*.¹²⁷

Viti 1373 u pasua nga një periudhë paqeje, me pushimin e armiqësive, kohë kjo gjatë të cilës Sulltan Muradi martoi djalin e tij më të madh, Jëlldërëm Bajezidin, në vitin 780/1378, me Devlet Hatunen, vajzën e Sylejman Shahut, sovranit të Emirateve të Germijanit. Ky i fundit iu ofroi osmanëve si pajë të vajzës së tij qytetet: Kytahja, Tavshanllë, Emet dhe Simav, ndërsa vetë u tërhoq në qytezën e vogël të Kulasë.¹²⁸ Kjo është domethënëse, pasi Emiratet e Germijanit, një nga *bejliket* më të mëdha që e trashëgoi Devletin selçuk të Anadollit, ishte bërë pjesë e Devletit Osman pa gjakderdhje. Në atë kohë, Devleti Osman, që përfshinte edhe një pjesë të Evropës, ishte kthyer në devletin më të fuqishëm ndër *bejliket* e tjera, dhe turkmenët e Anadollit ishin drejt bashkimit të tyre nën udhëheqjen e tij.


Sulltan Muradi bleu nga **Hysejin Beu** i Hamidelisë qytetet e: Akshehirit, Jallvaçit, Bejshehrit (Beğshehri), Sejdishehrit, Karaagaçit (Karaağaç) dhe Ispartës, të cilët supozoheshin të ishin në pronësinë e tij private duke paguar 80.000 monedha floriri.¹²⁹ Kjo ishte një ngjarje tjetër domethënëse, që tregon supremacinë që kishin arritur osmanët në këtë zonë. **Në vend që të prisnin përfshirjen e paevitueshme me forcë, nëse do të ishte e nevojshme, nga ana e Devletit Osman, *bejliket* fqinje të Anadollit preferuan ta bënë këtë në mënyrë të vullnetshme.** Duke pasur të njëjtin sfond fetar, kulturor dhe etnik me osmanët, popullsia e këtyre zonave e mirëpriti bashkimin me këtë entitet suprem dhe të gjerë politik.

127 *Xhizje* është përkthyer si një "tagrë për kokë", por duhet të kujtojmë këtu se **xhizje** do të thotë "një lloj kompensimi". Rrënja e kësaj fjale është **xheze** (të kompensosh). Meqenëse asnjë jomusliman nuk ishte i detyruar të merrte pjesë në fushatat e xihadit, atëherë, ai paguante në vend të shërbimit ushtarak si "kompensim" një sasi të caktuar parash, sipas nivelit të tij ekonomik. Gratë, të moshuarit, fëmijët dhe zyrtarët fetarë nuk paguanin.

128 OT, I, fq. 174.

129 OT, I, fq. 175.

Megjithatë, osmanët mund t'i kishin aneksuar këto vende, ashtu sikurse edhe territore të tjera fqinje, me ushtrimin e forcës dhe pa pasur nevojën të paguanin një shumë kaq të madhe parash. Por duke qenë mbajtësit e flamurit të Islamit, ata e ndjenin se kishin përgjegjësinë e tyre të bënin ç'ishte e mundur që t'i bashkonin të gjithë besimtarët në një Devlet, duke mos derdhur gjakun e vëllezërve të tyre muslimanë në mënyrë të panevojshme dhe pa marrë në konsideratë në këtë rast se sa para do të paguanin për këtë detyrë fetare dhe çështje fisnike. Ky qëndrim që mund të vihet re përgjatë gjithë historisë osmane nuk zotëroi në të njëjtën periudhë në Evropën barbare.



Tyrbeja e Devlet Hatunes, Bursa

Duke rifilluar mësymjen e tyre drejt Evropës, osmanët morën Ishtipin (Shtipin), që shtrihej në bregun e majtë të lumit Vardar, në vitin 782/1380, dhe Sofjen, në vitin 787/1385, ndërkohë që **Jahshi Beu**, i biri i Timurtash Pashait, hapi qytetin e Nishit në vitin 788/1386. Në këtë kohë, të krishterët në përgjithësi, kishin arritur ta kuptonin fuqinë e ushtrisë osmane. Për të qenë i sigurt, despoti i Serbisë, **Llazari**, me vullnetin e tij,

propozoi të shtonte numrin e ushtarëve që ai duhej të dërgonte në shërbimin e sulltanit, sipas një traktati të mëparshëm me osmanët.¹³⁰

“Traktati i arritur midis Bizantit dhe Gjenovës, në vitin 1386, është një shembull shumë i mirë që tregon fuqinë e Sulltan Muradit, pas fushatës së Nishit. Ky traktat, teksti i të cilit është ruajtur deri në ditët e sotme, u nënshkrua nga Gjon Andronikus Palaeologos, *podesta* (administrator) i Peras dhe ambasadorit të Gjenovës. Gjon Palaeologos u detyrua të jetonte në paqe me të birin e tij, Andronikusin, si dhe të dërgonte ushtrinë e tij në luftë kundër gjithë armiqve të Gjenovës “me përjashtim të Murat Beut dhe turqve të tij”. Gjenovezët, nga ana e tyre, prematuan se do të mbronin Kostandinopojën, kundër të gjithë armiqve të çdo kombësie, përjashto këtu Murat Beun e lartpërmendur dhe turqit, të cilët vepronin sipas vullnetit të tij.” **Në të gjithë traktatin, është treguar kujdes që Muradi të përjashtohet nga të dyja palët nënshkruese**¹³¹ për të shmangur ndëshkimin nga ai. Duhet të kujtojmë se Gjenova, që në atë kohë ishte një fuqi e rëndësishme në Evropë, kishte një flotë detare të fuqishme dhe zotëronte koloni, që shtriheshin në shumë brigje, deri në brigjet e Krimesë.

Qyteti Edrene shtrihej në rrugën nga Kostandinopoja deri në malet e Ballkanit dhe ishte qyteti i dytë i Perandorisë për nga rëndësia. Me hapjen e qytetit Filibe ndaj Islamit, osmanët hynë midis bullgarëve dhe grekëve. Edhe qyteti Nish shtrihej në një pikë të rëndësishme strategjike. Të gjitha këto suksese nuk mund të ishin arritur, pa pasur njohuri të konsiderueshme të strategjisë gjeografike të Evropës.¹³²

Me ndihmën e Evrenos Beut të akënxinjëve, **Xhendereli Halil Hajreddin Pasha** e hapi ndaj Islamit qytetin e Bitolës

130 OT, I, fq. 176.

131 H.A. Gibbson, *The Foundation of the Ottoman Empire, A History of the Osmanlis up to the Death of Bayezid I, 1300-1403*, (Frank Cass and Co. Ltd, 1968), fq. 162-163. Theksimi është shtuar.

132 Stanford J. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 17.

(Manastirit) dhe të Ohrit në vitin 787/1385. Ndoshta do të duhej të përmendnim në këtë rast se Islami mbron të drejtat e *dhimmive* (popullsisë jomuslimane) nën administrimin musliman. *Ajetet* e mëposhtme e tregojnë këtë:

“Allahu ju urdhëron që t’u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve (jo vetëm muslimanëve)” [*en-Nisa*, 58].

“Ne të zbritëm ty (Muhammed) librin (Kur’anin), me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi Allahu ...” [*en-Nisa*, 105].

“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të Allahut, edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve, ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfanjak, pse Allahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t’i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, Allahu hollësisht di çka punoni”. [*en-Nisa*, 135].

Janë edhe disa *hadithe*, të cilët e bëjnë të detyrueshme për muslimanët mbrojtjen e të drejtave të *dhimmive*, që janë nën mbrojtjen e tyre. Osmanët ishin shumë të zellshëm ndaj zbatimit të kësaj urdhërese. Popujt e rajonit të Ballkanit ishin kaq të lumtur nën sundimin osman, sa që qëndruan të qetë gjatë luftërave osmane kundër forcave të bashkuara të krishtera evropiane.¹³³

Në Evropë pati përpjekje për krijimin e një Aleance Ballkane, ku do të përfshiheshin serbët, bullgarët dhe vllahët. **Ali Pashai**, i cili mori titullin Vezir-i a’zam (Veziri i Madh), pas vdekjes së babait të tij, Halil Hajreddin Pashait, në vitin 789/1387, për të parandaluar këtë aleancë përshkoi me shpejtësi Ballkanin dhe i hapi ndaj Islamit Pravadin, Shumnun dhe Tërnovën, kryeqytetin e Mbretërisë së Bullgarisë. **Mbreti bullgar Shishman** u strehua në kështjellën e Nigbollut (Niğbolu)

133 OT, I, fq. 184.

(Nikopolit). **Sulltan Muradi** erdhi me një ushtri tjetër dhe e hapi Nigbollun në vitin 790/1388 ndaj Islamit. Në këtë mënyrë Bullgaria e mesme u hap ndaj Islamit; Mbretit Shishman iu fal jeta dhe mbeti si një guvernator osman.¹³⁴

Para vitit 772/1370, **Alaeddin Beu** i Karamanit, lidhi martesë me të bijën e Sulltan Muradit, Melek Hatunen.¹³⁵ Bejliku i Karamanit ishte një nga bejliket më të mëdha në rajonin e Anadollit, që doli në shesh pas Devletit Selçuk. Për më tepër, drejtuesit e Bejlikut të Karamanit kishin lidhje fisnore me fiset e bejlikeve selçuke dhe ky bejlik kishte trashëguar kryeqytetin Konja. Kështu që, ata e shikonin veten si pasardhës të selçukëve. Por, osmanët ishin bejlerët më të përkushtuar ndaj Islamit; angazhoheshin në fushatat e xhihadit, hapnin territore të gjera të Evropës ndaj Islamit dhe u bënë kryezotë të Perandorisë Romake. Duke qenë, gjithashtu, i vetëdijshëm për zgjerimin osman në Anadoll, Alaeddin Beu, megjithatë, planifikoi të hapte qytetet që osmanët i kishin blerë nga Bejliku i Hamidogllusë (Hamidoğlu). Ndërkohë që osmanët ishin të angazhuar me luftërat në Rumeli, ai nxiti Mbretin e Bosnjës në luftë kundër tyre, ndërkohë që ai vetë hapi Bejshehrin në vitin 788/1386. Me këtë akt armiqësor nga ana e një prijësi musliman, **Muradi** mbloodhi zyrtarët e lartë dhe iu drejtua i emocionuar: “Unë jam përpjekur të bëj më të mirën për çështjen e Islamit, duke lënë shtëpinë time dhe të gjitha rehatitë, duke marshuar në distanca të largëta njëmujore në territoret e *kafirëve*, dhe ky njeri i marrë i ka sulmuar muslimanët, dhe u ka shkakuar atyre dëme. “O *muxhahidinë!* Çfarë duhet të bëj me këtë njeri mizor? Ata më tërheqin vëmendjen nga fushatat e xhihadit dhe më bëjnë që të luftoj kundër muslimanëve! Nëse i lë dhe vazhdoj xhihadin, muslimanët do të vuajnë nga këto veprime. Nëse e lë atë, kjo do të sillte shmangien e shpatave të *muxhahidinëve* kundër tyre.” Megjithatë, Muradi e kaloi këtë mëdysheje, duke marrë një

134 Danişmend, I, fq. 76.

135 OT, I, fq. 46. Emri i saktë është Melek Hatun dhe jo Nefise Sulltan.

vendim të guximshëm për të luftuar kundër ushtrisë së Karamanit, për shkak se Beu i tyre e kishte ndaluar atë çdo vit që të niste luftë kundër të pafeve. Dhe, ngritja në luftë kundër atyre të cilët i ndalonin muslimanët të angazhohen në fushatat e xihadit, është xihadi më i madh.”¹³⁶ Në këtë mënyrë, ai dhe ushtria e tij marshuan kundër beut të Karamanit dhe e mundën atë në vitin 789/1387, duke rihapur Bejshehrin. Megjithatë, me kërkesë të së bijës, ai e fali dhëndrin e tij, i cili iu nënshtrua krejtësisht dhe pa kushte. Fitorja e osmanëve kundër njërit prej bejlikeve më të mëdha dhe më të fuqishmet e Anadollit, Bejlikut të Karamanit, rriti më tepër famën e tyre. Për pasojë, bejliket e tjera dërguan formacionet e tyre ushtarake për të luftuar kundër armiqve të krishterë në Betejën e Kosovës.¹³⁷ Thuhet se në luftën kundër Karamanit, osmanët eksperimentuan për herë të parë artilerinë, dhe se suksesi që patën nxiti Muradin të përdorte të njëjtin armatim gjatë luftërave kundër ushtrive të krishtera të Llazarit.¹³⁸ Me këtë sukses të arritur ndaj njërit prej ish-bejlikeve (emirateve) më të mëdha të Anadollit, Devleti Osman u kthye në superfuqinë kryesore muslimane. Megjithatë, Halifi *de-fakto* e ndjeu se duhej të siguronte pranimin zyrtar nga Halifi formal Abasid, i cili asokohe qëndronte në Kajro. Prandaj, ai nisi dhurata në Egjipt nëpërmjet një të dërguari, i cili u kthye me një *ixhazet* (autorizimin) për një qeveri Sheriati, që do ta zbatonte Sheriatin (në gjuhën osmanishte turke: *tenfiz-i hykumet-i sherijje*) në çdo fushë të jetës, dhe i dha Murad Hanit titullin Sulltan i Rumi (Sulltan i Anadollit). Pra, ai në këtë mënyrë u quajt zyrtarisht **Sulltan Murad** dhe devleti i tij **Devlet-i 'Alijje-i Osmanijje** (Devleti Sublim Osman), ndërsa ndjekësit dhe populli i tij, **Osmanë** (që i përkasin Osmanit).¹³⁹ Titulli “Sulltan” shënoi konsolidimin dhe zyrtarizimin e pozicionit të tij, dhe për pasojë, emiratet e tjera më të vogla të Anadollit, u ndjenë të detyruara të dërgonin formacionet e tyre

136 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 216-230.

137 OT, I, fq. 249.

138 Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 21.

139 Mustafa Nuri Pasha, *Netajxhul Vuku'at*, Stamboll, 1327, I, fq. 13.

ushtarake, për të marrë pjesë në fushatat osmane të xhihadit kundër jobesimtarëve.



*Hartë e kufijve osmane në kohën
kur Sulltan Murad Hydavendingari ndërroi jetë*

Lufta e parë e Kosovës 791/1389

Duke e konsoliduar kështu sovranitetin osman në Anadoll, **Sulltan Muradi** kaloi në Evropë për t'u ballafaquar me ushtrinë e bashkuar të krishterë, të krijuar nga despoti serb, **Llazari** (1371-1389). Në atë kohë, **Evrenos Beu** u kthye nga Hixhazi pas kryerjes së Haxhit. Prezenca e tij ishte e rëndësishme për ngritjen e moralit të ushtrisë osmane që u përforcua edhe nga formacionet ushtarake të dërguara nga bejliket e Kastamonus, Germijanit, Hamidit, Tekes, Menteshes dhe Ajdënit.¹⁴⁰ Jeniçerët u vendosën në vijën e parë dhe në qendër, ndërsa artileria u pozicionua përpara tyre. Me sugjerimin e Evrenos Beut, 1000 harkëtarë u vendosën në radhën e parë të çdo krahu të ushtrisë muslimane osmane dhe secili prej tyre ishte po aq i shkathët, dhe i fortë sa **Sa'd b. Ebi Vekkasi**.¹⁴¹ "Burimet që tregojnë

¹⁴⁰ OT, I, fq. 253.

¹⁴¹ Neşri, I, fq. 294. Është interesante të theksohet se harkëtarët osmanë muslimanë në betejën e (Fushë-)Kosovës në vitin 791/1389, ishin në nivel të barabartë me harkëtarin e mirënjohur të Pejgamberit (s.a.v.s). Sa'd b.

numrin e ushtarëve, dallojnë mjaft, por me sa duket Bashkimi Ballkanik arriti të mbliidhte rreth 100.000 luftëtarë, ndërkohë që Muradi kishte jo më tepër se 60.000 luftëtarë.¹⁴² Osmanët hodhën idenë e vendosjes së gamileve përpara ushtrisë së tyre, për t'u mbrojtur, por kjo ide nuk u zbatua. Ushtria aleate evropiane ishte e përbërë nga njësitë: serbe, hungareze, vllahe (rumune), polake dhe çeke.

Ndërkohë që bëheshin këto përgatitje, **Ali Pasha** recitoi ajetin "Sa e sa grupe të vogla me dëshirën e Allahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha! All-llahu është me durimtarët." (*el-Bekare*, 249) dhe *hadithin* "Kush e thith pluhurin e xhihadit, nuk do të nuhasë tymin e Ferrit" (el-Buhari, *el-Xhami'us Sahih, Kitabul Xhihad*:17).¹⁴³ Ndërsa gjithsecili po flinte atë natë të errët; "në të cilën ishte e pamundur të dalloje një qenie njerëzore nga një kalë", **Sulltan Muradi**, u ngrit, mori abdest, fali dy rekate të *salat el-haxheh*, ra me ballë për tokë (*sexhde*) dhe u lut deri në agim në këtë pozicion. Ai iu drejtua Allahut: "O Zot! Sovraniteti, prona, dhe qeniet njerëzore të përkasin Ty. Ti ia jep sovranitetin atij që Ti dëshiron.¹⁴⁴ Sa për mua, unë jam shërbëtori Yt i përlurur. Ti e di se çfarë mendoj unë dhe Ti i di qëllimet e mia më intime.¹⁴⁵ Sovraniteti, sundimi dhe pasuria aspak nuk janë synimet e mia. Nuk kam ardhur këtu për të fituar skllëvër meshkuj dhe femra. Të përgjërohem me shumë sinqeritet për kënaqësinë Tënde (*rida*).¹⁴⁶ O Zot! Unë

Ebi Vekkas, i cili hodhi 1000 shigjeta në Betejën e **Uhudit** në vitin 3/625. Ky fakt tregon se modeli i një harkëtarë musliman është Sa'd b. Ebi Vekkas, dhe se motivi i avancimit të osmanëve drejt Evropës ishte Islami. Pra, edhe një herë, kjo dëshmon vazhdimësinë e vlerave të njëjta në Devletin Osman, si dhe natyrën e tij Islame.

142 Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 21.

143 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 278-282.

144 *Kur'an, Ali Imran*, 26.

145 Një musliman beson se "Ai (Allahu) e di të fshehtë, madje edhe më shumë se kjo." (*Kur'an, Ta-Ha*, 7).

146 Xhihadi (Lufta e Shenjtë) është detyrim për muslimanët: "Juve ju është bërë obligim lufta, ndonëse ju e urreni atë. Por mund që ju të urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një

vetësakrifikohem me zell për këta muslimanë këtu. Të lutem mos i lejo këta *kafirë* (jobesimtarët në Mesazhin e Fundit) të mposhtin dhe të asgjësojnë këta besimtarë në betejë. O Zoti im! Mos më bëj mua shkaktar për vdekjen e kaq shpirtave muslimanë.¹⁴⁷ Bëji këta muslimanë *mensur* dhe *muzzaffer* (fitimtarë).¹⁴⁸ Pranoj dhe jam i gatshëm të vetë-sakrifikohem për hir të ushtarëve të Islamit. Të lutem mos më bëj të shikoj vdekjen e këtyre besimtarëve. O Zoti im! Më bëj mik në fqinjësinë (*xhivar*) Tënde, shpagoi shpirtat e besimtarëve me shpirtin tim. Ti më ke bërë mua një *gazi* (luftëtar në luftën e shenjtë) që më parë, ndaj ma mundëso ta arrij gradën e *shehidit* (martirit) në fund."¹⁴⁹ Ky citim dhe citime të tjera tregojnë qëndrimin me dashuri atërore dhe të kujdesshme të sulltanëve osmanë për popullin e tyre, si dhe dëshirën e tyre të madhe për të mos derdhur gjakun e tyre pa nevojë.

Si përfundim, beteja e parë e ashpër e Kosovës u zhvillua në vitin 791/1389. Në këtë betejë, osmanët përdorën artilerinë e tyre me shumë sukses. Në fillim, krahu i majtë i ushtrisë u zbraps nga sulmi i ashpër, por krahu i djathtë shumë shpejt kundërsulmoi dhe i shkatërroi armiqtë. Luftimet vazhduan deri pasdite dhe nga fundi i betejës Murad Gaziu u godit nga një fisnik serb, i quajtur Milosh Obiliç, i cili u hoq sikur dëshironte të puthte yzengjitë e Murad Gaziut, por që e mashtroi atë, dhe e

send, e ai është dëm për ju. Allahu e di (fundin e çdo sendi) e ju nuk dini. (*el-Bekare*, 216.) Pra, Sulltan Muradi po bënte detyrën e tij për të kënaqur vullnetin e Krijuesit të tij."

147 Sulltan Muradi, që njihej për devotshmërinë e tij fetare, si duket kishte në mend një *hadith sherif* të Pejgamberit të Fundit, ku sovranit i kërkohet të shikojë sjelljen e tij personale (Muslim, *Kitabul Imareh*, 21). Megjithatë, Muradi përgjithësisht konsiderohet si një *veli* (njëjësi i *Evlja*), ashtu si thotë dhe Neşri: "Të gjithë ishin të sigurtë për Velajetin e tij" (Neşri, I, fq. 306).

148 Duhet theksuar se Sulltan Muradi përdor fjalët në gjuhën arabe *mensur* dhe *muzaffer* për të theksuar zotimin e tij ndaj konceptit të Islamit, sipas të cilit fitorja vjen vetëm nga Allahu. Këto dy fjalë do të thonë "fitore" dhe janë në formën pjesore pasive (*ism meful*) në arabisht; nënkuptimi është kur një person **bëhet fitimtar**.

149 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 284-286.

goditi me një kamë të fshehur në mëngën e tij.¹⁵⁰ Megjithatë, Murad Gaziu vazhdoi të qëndronte në krye të forcave të tij ushtarake. Por ai do të zbulonte shumë shpejt, se plaga që kishte marrë ishte fatale. Për këtë arsye, ai thirri djalin e tij më të madh, Bajezidin, dhe e caktoi atë Han, duke marrë dhe lejen, dhe aprovimin e zyrtarëve të lartë të Devletit Osman. Ndërkohë që Muradi vdiq si martir guximtar, Llazari, që ishte kapur rob, u ekzekutua.¹⁵¹ Organet e brendshme të Sulltan Muradit u varrosën në vendin ku ai ra si martir,¹⁵² ndërsa trupi i tij u dërgua dhe u varros në Bursa.



Meshhed-i i Hydavendingarit, Kosovë

Beteja e Kosovës ishte fitorja e parë e osmanëve kundër një force të madhe të përbërë nga aleatët evropianë. Ajo e shkatërrroi dhe rezistencën e fundit të organizuar në rajonin e Ballkanit, në pjesën jugore të Danubit, dhe e hapi Serbinë Veriore

150 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 304. OT, I, fq. 256.

151 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 306. OT, I, fq. 257.


152 Në këtë vend u ngrit një tyrbe dhe u quajt **Meshhed-i Hydavendingar** (vendi ku ra martir Hydavendingari) dhe vizitohej nga muslimanët, që jetonin aty afër. Përballë tij, në shekullin e 20-të, serbët ndërtuan një statujë të madhe të Milosh Obiliçit.

ndaj sundimit osman, duke e lënë Hungarinë si vendin e vetëm të rëndësishëm kundërshtar në pjesën e Evropës Juglindore. Kjo nënkuptonte se Serbia, ashtu si dhe Bullgaria, tashmë ishte përfundimisht nën kontrollin osman, edhe pse, si dhe më parë, osmanët vazhduan të vendosnin sundimin e tyre nëpërmjet prijësve vasalë.¹⁵³

Struktura administrative osmane

Ishte në traditën e turqve t'iu jepnin djemve të tyre të parë titullin pasha. Në këtë mënyrë, Sylejmani, djali më i madh i Orhan Gaziut, u quajt Sylejman Pasha. Sulltan Muradi e emëroi Xhendereli Kara Halilin si vezir me titullin "Hajreddin Pasha", i cili u zëvendësua pas vdekjes, në vitin 787/1385, nga djali i tij Ali Pasha (809/1407). Zyrtarët e lartë konsideroheshin si djemtë e mëdhenj të sulltanit dhe për pasojë iu jepej gjithashtu titulli Pasha. Pas hapjes së territoreve të reja në Evropë, Llalla Shahin Pasha u caktua Bejlerbeg (emirul umeri) i Rumelisë dhe u pasua në këtë post nga Timurtash Pasha. Kur ky i fundit dhe disa bejlerë të tjerë u ngritën në gradën e vezirit, Ali Pasha u veçua nga ata duke u quajtur vezir-i a'zam. Ndërsa në Anadoll u caktua një Bejlerbeg tjetër me seli në Ankara.

153 Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 22.



Banjë publike e ndërtuar nga Muradi I

Osmanët caktuan një *sanxhakbej* për çdo *sanxhak* (rajon), dhe një *kadi* (gjykatës i *shariatit*) i cili kishte fuqi ligjore, dhe ekzekutive në çdo *kaza* (qytezë). Gjatë fushatave të xhihadit, kadiu i kryeqytetit osman shoqëronte ushtrinë. Xhendereli Kara Halili u caktua gjatë viteve të para të periudhës së Sulltan Muradit, në postin e ri të *kadiaskerit* (gjykatësit ushtarak), ndërsa *shehzadet* (bijtë e sulltanit) u caktuan *sanxhakbej* në Anadoll për t'u trajnuar në administratë. Një post tjetër ishte ai i *defterdarit*, që ishte përgjegjës për çështjet fiskale të Devletit.¹⁵⁴ "Kaza" do të thotë "qarku" për të cilin përgjigjet *kadiu*. Me fjalë të tjera, kadiu osman kryente detyrën e kryetarit të bashkisë dhe të guvernatorit të qytetit, prokurorit publik, gjykatësit, drejtorit të arsimit, drejtorit të *vakëfit* (fondacioneve fetare) të gjitha së bashku.

¹⁵⁴ *Netajixh*, I, fq. 15-16.



Xhamia e Shehadetit (në kujtim të rënies dëshmor të Muradit), Bursa

2.6 Sulltan Jëlldërëm Bajezid Hani 1389-1402

Pas fitores në betejën e Kosovës,¹⁵⁵ osmanët përvetësuan një pjesë të madhe të Serbisë. Ndërkohë, trupi i Sulltan Muradit u dërgua në Bursa ku do të varrosej. Në këtë qytet u ndërtua tyrbe dhe një xhami në kujtim të tij.

Jëlldërëm (Vetëtima) Bajezidi u martua me Olivera Despinën, vajzën e Llazarit, duke fituar kështu miqësinë dhe besimin e serbëve. Ata pranuan t'ia jepnin luftëtarët e tyre ushtrisë së Jëlldërëm Bajezidit, por, në të njëjtën kohë,

155 Sanxhaku (flamuri) i ngritur në Kosovë, është vendosur në Muzeun Usharak të Harbijes, në Stamboll, me mbishkrimin *kelime-i shehadetin*.

nëpërmjet kësaj gruaje, në oborrin Osman hyri pija dhe argëtimi.¹⁵⁶

Hoxha Firuz Beu depërtoi në pjesën veriore të Bullgarisë dhe e hapi qytetin Vidin ndaj Islamit, kaloi Danubin dhe sulmoi disa rrethe të Vllahisë.¹⁵⁷ Jëlldërëm Bajezidi priti përfaqësues nga Venediku dhe Gjenova, që erdhën në Edrene (Edime) për ta uruar atë. Ai rinovoi marrëveshjet e tregtisë me ta, por nuk harroi të përmendte dhe qëllimin e tij për të avancuar drejt Romës. Në këtë mënyrë, ai deklaroi pozicionin e tij ndaj botës së krishterë dhe u përpoq të arrinte një pakt me memlukët kundër valëve të Kryqëzatave në Evropë.¹⁵⁸

Nga ana tjetër, bejliket: e Ajdënit, Saruhanit, Menteshes, Germijanit, Hamidit, Tekes dhe Kadi Burhaneddinit krijuan një aleancë nën udhëheqjen e Bejlikut të Karamanit. Ata hynë në territorin osman, ndërkohë që Jëlldërëm Bajezidi ishte i angazhuar në Rumeli. Sapo mori njoftimin për sulm, ai u kthye në Anadoll me një ushtri të fuqishme. Bajezid Hani drejtoi vëmendjen e tij nga Bejliku i Ajdënogllut (Aydinoğlu).¹⁵⁹ Beu i Ajdënit organizoi ceremoni të veçanta për nder të Devletit Osman. Ai urdhëroi mbajtjen e *hutbes* për Namazin e së Xhumasë në emër të sovranit osman, si dhe përdorimin e *sikkës* (monedhës) osmane, duke qenë se të dyja këto ishin shenja të sovranitetit. Megjithatë, osmanët ua lanë administrimin e *vakëfeve* ish-drejtesve të tyre, djemve të Beut të Ajdënit,¹⁶⁰ të cilët, nën sundimin osman, vazhduan të përparonin dhe të ishin të respektuar. Administrimi i *vakëfit* nënkuptonte garantimin mjaft të mirë të jetesës; *muteveliu* (administratori) i *vakëfit* mblidhte gjithë të ardhurat, harxhonte sasinë e nevojshme për detyrat e caktuara dhe jetonte me pagën e marrë nga të

156 Danişmend, *vepër e cituar*, I, fq. 87.

157 Danişmend, *vepër e cituar*, I, fq. 85.

158 Danişmend, I, fq. 86.

159 Danişmend, I, fq. 86, 88.

160 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, red. nga Nihal Atsız (Ankara, 1985), fq. 67.

ardhurat e *vakëfit*. Me pak fjalë, posti i *mutavel-liut*, i siguronte atij dhe pasardhësve të tij një jetesë të mirë.

Bajezid Hani mori në vitin 792/1390 bejlikun (emiratin) e Saruhanit dhe provincën e Menteshesë, pa ndonjë luftë serioze.¹⁶¹ Bejliket e tjera të Anadollit shpejt kuptuan se osmanët ishin të vendosur për të krijuar bashkimin e forcave muslimane në këtë rajon. Ndaj dhe ata iu bashkuan gradualisht Devletit Osman në një mënyrë apo tjetrën.

Bajezid Hani e hapi qytetin Allashehir (Filadelfia) ndaj Islamit, duke ia marrë atë Perandorisë Romake. Ky vend kishte mbetur si një ishull mes Bejlikeve muslimane. Duhet theksuar se për të marrë kështjellën e Allashehirit, **Bajezid Hani** e shfrytëzoi **Joanisin V**, pasi ai e kishte marrë fronin romak me ndihmën e Bajezidit së bashku me djalin e këtij të fundit, **Manuelin II**, dhe forcat romake për marrjen e kështjellës së Allashehirit.¹⁶²

Ndërkohë, Bajezid Hani marshoi drejt Evropës, nëpërmjet Gelibollusë, për të përhapur Islamin, si kreu i një strukture shoqëro-ro-politike, qëllimi i ekzistencës së të cilit ishte të zbatonte detyrën e xihadit, si dhe të aneksonte Hungarinë. Gjatë rrugës u zbulua një spiun, me gjasë i dërguar nga Perandoria Romake, për të paralajmëruar Hungarinë nga çdo sulm i pritur osman. Me sugjerimin e **Kara Timurtash Pashait**, Bajezid Hani, si fillim, vendosi ta merrte vetë Kostandinopojën, kryeqytetin e Perandorisë Romake, dhe, në të vërtetë, e rrethoi këtë qytet. Jëlldërëm Bajezid Hani i kërkoi Joanisit V Paleologos të ngrinte rrethimin e Stambollit dhe perandori pranoi. Pas vdekjes së perandorit, Bajezid Hani i kërkoi djalit të Perandorit, Manuel II Paleologos, perandorit të ri, që të lejonte krijimin e një lagjeje turke në Stamboll, ndërtimin e një xhamie, vendosjen e një gjykate nën drejtimin e një kadiu osman, si dhe ta rriste tagrën që i paguhej prej tyre Thesarit Osman. Duke u

161 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 312.

162 Danişmend, *vepër e cituar*, I, fq. 89-91.

mbështetur në muret rrethuese të qytetit, si dhe mbështetjen nga Evropa, perandori nuk i pranoi këto kërkesa. Për këtë arsye, Jëlldërëm Bajezidi e rrethoi qytetin, duke marrë të gjitha tokat përreth qytetit deri në kufirin e murit rrethues. Rrethimi zgjati 7 muaj dhe gjatë kësaj periudhe uria mbizotëroi në qytet. Perandori Manuel kërkoi ndihmën e Evropës. Duke qenë se u njoftua se **Mbreti Hungarez Zigismundi (Szigismund)** po përgatitej për të marshuar me ushtrinë e tij drejt Bullgarisë, Jëlldërëm Bajezidi pranoi të ngrinte rrethimin e qytetit me kusht që:

1. Perandoria Romake t'iu jepte 700 shtëpi muslimanëve, të cilët do të krijonin lagjen e tyre turke në Stamboll.
2. Të vendosej një gjykatë muslimane në Sirkexhi, në Stamboll.
3. Devleti Osman të emëronte një kadi në këtë gjykatë.
4. Të ndërtohej një xhami në Stamboll.
5. Osmanëve t'iu jepej toka midis Gallatas dhe Kagët'hanes (Kağıthane) (jashtë mureve rrethuese të qytetit), vend në të cilin ata do të vendosnin një garnizon.
6. Të rritej shuma e parave që Perandoria Romake i paguante si tagër Thesarit Osman.
7. Thesarit Osman t'i jepej 1/10 e fitimit nga taksat e mbledhura nga pemishtet dhe të mbjellat jashtë mureve rrethuese të qytetit.

Perandori Manuel II i pranoi këto kushte, dhe një garnizon osman prej 6000 ushtarësh u vendos në zonën midis Gallatës dhe Kagët'hanes, që ishte nën sundimin e Gjenovës.¹⁶³

Pasi e ktheu me anë të këtij traktati Perandorinë Romake në një Perandori jo efektive, Jëlldërëm Bajezidi drejtoi vëmendjen e

163 Danişmend, I, fq. 94-95. Kuptohet që një lagje turke dhe një gjykatë u vendosën në Stamboll në vitin 1400, I, fq. 123.

tij në frontin e Rumelisë, u përball me një ushtri të madhe hungareze në **Nagy-Oloz**, dhe e mundi atë në vitin 793/1391.¹⁶⁴

Në vitin 793/1391, Sulltani memluk i Egjiptit, që ishte dhe mik i Halifit Abasid në mërgim, e quajti Jëlldërëm Bajezidin – “Hija e Allahut mbi Tokë” dhe “Sulltanin e Muslimanëve”;¹⁶⁵ fakt ky që tregon fuqinë politike dhe ushtarake që kishte fituar Devleti Osman.

Bajezid Hani ndërtoi, në bregun e Bosforit të Anadollit, Gyzelxhe Hisarin.¹⁶⁶ Pas rrethimeve të shumta me intervale, Perandoria Romake pranoi të paguante 10.000 monedha floriri si tagër vjetore.¹⁶⁷

Me Perandorinë Romake, Bullgarinë dhe Serbinë nën vasalitetin Osman, Hungaria mbeti fuqia e vetme në Evropë, që i rezistonte mësymjes osmane. Territorët që zotëronte kjo fuqi shtriheshin nga Dalmacia në veri, deri në Beograd në jug, dhe njihej nga prijësit vllahë dhe nga moldavët si kryezot i tyre. **Mbreti Hungarez Zigismund** (1387-1437) bëri përpjekje për të nxitur botën e krishterë kundër turqve, por drejtuesit perëndimorë evropianë ishin të angazhuar në zgjidhjen e problemeve të tyre. Ndër të tjera, situata në Hungari nuk ishte në gjendje të mirë, për shkak të përçarjeve të brendshme ndërmjet baronëve dhe administratës qendrore, si dhe ndërmjet fshatarëve ortodoksë dhe fisnikëve katolikë.¹⁶⁸

Mbreti Zigismund, si pasardhës i dinastisë së Luksemburgut, u zgjodh mbret i fronit të Hungarisë, kur mbreti i fundit hungarez, Luisi, vdiq pa lënë pas një trashëgimtar. Ai u zgjodh Mbret i Hungarisë, për shkak të statusit të tij si dhëndër i

164 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 69; Danişmend, I, fq. 95.

165 Feridun Beğ, *Mexhmu'a-i Münsheat-i Selatin*, I, fq. 116. *Zil-lullah* do të thotë se Halifi, ndryshe nga Papa, ka pushtet shpirtëror dhe të përbotshëm në bashkësinë e tij.

166 Data e ndërtimit të Gyzelxhe Hisarit ndryshon sipas burimeve në vitet 1391 dhe 1397. *OT*, I, fq. 291, poshtë-shënimi 2.

167 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 72; Danişmend, I, fq. 123.

168 Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 31.

mbretit të ndjerë. Duke qenë se merrte tagër nga Republika e Venedikut, qëllimi i parë i Mbretit Zigismund, ishte të merrte Perandorinë Gjermane dhe Mbretërinë e Polonisë dhe të Bohemisë. Megjithatë, ai nuk ishte krejtësisht indiferent ndaj avancimit osman drejt Evropës, dhe përhapjes së Islamit në këtë vend. Në këtë mënyrë, Zigismundi sulmoi qytetin Nigbollu, të cilin osmanët e kishin marrë në vitin 794/1392, por Jëlldërëm (Vetëtima) Bajezidi erdhi menjëherë nga Anadollu në skenën e luftës dhe Zigismundi u largua nga Nigbollu, duke arritur të arratisesh nga fushëbeteja pa u kapur rob.¹⁶⁹ Jëlldërëm Bajezidi shkatërroi mbretërinë vasale bullgare, duke marrë dhe kryeqytetin e tyre, Tërnovo, në vitin 795/1393, si dhe pjesën më të madhe të vendit, me përjashtim të Dobruxhës dhe Vidinit, që mbetën nën sundimin e princërve të vegjël bullgarë.¹⁷⁰

Në vazhdim të përmbushjes së detyrimit të xhihadit, Jëlldërëm Bajezidi i hapi ndaj Islamit qytetet e Selanikut dhe Jenishehirit (Larisa), në Xhumadel Ahire 796/prill 1394. Më pas, osmanët avancuan drejt veriut të Shqipërisë përgjatë lumenjve Buna dhe Drini, duke përvetësuar territoret në jug dhe jugperëndim të Shkodrës. Në atë kohë, në Shqipëri, kishte feudalë të vendit dhe me prejardhje të tjera. Këta feudalë ishin në varësi qoftë të venedikasve, që vinin nga perëndimi, ose të osmanëve nga lindja, të cilët ishin në procesin e përhapjes së fesë islame në rajon.¹⁷¹

Ndërkohë, Beu i Karamanit, që më parë kishte qenë një nga bejliket më të fuqishëm të Anadollit, planifikonte të zgjeronte territoret e tij në Anadoll, në dëm të osmanëve, të cilët atëherë ishin të angazhuar me fushatat e tyre të xhihadit në Evropë. Pas sulmit të tij kundër territoreve osmane të pjesës së Anadollit, Bajezid Hani vazhdoi në këtë rajon dhe arriti në Konja, kryeqytetin e Bejlikut të Karamanit. Por, Beu i Karamanit u

169 Danişmend, I, fq. 98.

170 Danişmend, I, fq. 98; Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 31.

171 Danişmend, I, fq. 102.

arratis, ndërsa populli i Konjas vullnetarisht e dorëzoi qytetin nën sundimin dhe sovranitetin osman, veprim ky që u ndoq edhe nga qytete të tjera si: Aksaraji, Nigde (Niğde) dhe Kajseri, duke demonstruar kështu qëllimin e mirë dhe drejtësinë e administratës osmane. Bajezid Hani marshoi për ta marrë qytetin Kastamonu nga Bejliku Xhandarogllu (Jandaroglu), në vitin 794/1392.¹⁷²

Ai mori qytetin e Samsunit nga Bejliku Khanik në 800/1398, si dhe Sivasin, Tokatin dhe Kajserin nga Devleti i Kadi Burhaneddinit në 801/1399,¹⁷³ ndërkohë që qyteti i Sivasit iu bashkua me dëshirë Devletit Osman, dhe beu i Erzinxhanit u betua për besnikëri, duke u emëruar edhe guvernator nën sundimin osman. Jëlldërëm Bajezid Hani hapi ndaj Islamit qytetin e Mallatjas në vitin 798/1396 dhe qytezat Darende, dhe Divriği (Diivriği).¹⁷⁴ Qyteti i Amasjas iu bashkua gjithashtu me dëshirë Devletit Osman. Në atë kohë, Devleti Osman u bë i njohur për angazhimin e tij ndaj çështjes së Islamit, si dhe për dëshirën e zjarrtë për të bashkuar muslimanët e Anadollit nën drejtimin e tij. Kështu, muslimanët në grupe iu bashkuan atij.

Duke ndjekur këshillën e djalit të Xhendereli Halil Pashait, Ali Pashait, rrogat e kadive u rritën; u vendos që një kadi do të merrte 20 *akçe* në 1000 *akçe* për gjykimin e akteve të trashëgimisë, si dhe 2 *akçe* për hartimin e një dokumenti ligjor.¹⁷⁵

Beteja e Nigbollut (Niğbolu) (Nikopolit) 798/1396

Mbreti i Hungarisë katolike, **Zigismundi** (1386-1437), filloi të ndërjegjësohej për prezencën osmane pranë mbretërisë së tij, por duke qenë se nuk dëshironte të hynte në bisedime apo të bënte një kompromis me Devletin Musliman, ai iu drejtua shteteve evropiane për të krijuar një forcë të bashkuar të

172 OT, I, fq. 276.

173 OT, I, fq. 298-299.

174 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 74.

175 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 72. *Oruç Beğ Tarihi*, fq. 55.

krishterë kundër osmanëve. Nga ana tjetër, Perandoria Romake, kishte mbetur si një ishull i vogël i rrethuar nga zotërimi i tokave osmane: një situatë kjo që e vinte tepër në siklet Evropën e krishterë. Në këto kushte, nevoja që **Perandori romak Manuel**, t'iu drejtohej për ndihmë strukturave shoqëroro-politike evropiane, si dhe thirrja e **Papa Bonifacios IX**, për organizimin e një kryqëzate kundër Devletit Osman, u treguan të efektshme. Në këtë mënyrë, Papa shpalli në vitin 1394 krijimin e një **Kryqëzate** tjetër kundër muslimanëve, duke formuar kështu një ushtri të madhe prej 200.000 ushtarësh nën drejtimin e Mbretit të Hungarisë. Hungarezë, kalorës të famshëm francezë, tre kushërinj të mbretit francez, kalorësit bavarezë të Gjermanisë, belgët, holandezët, venedikasit, kalorësit e Zvicrës, kryqtarët e Britanisë, kalorësit e Skocisë, Savojës dhe Rodosit, vllahët (rumunët) dhe bullgarët morën pjesë në këtë forcë të bashkuar armike. Kjo ushtri e madhe kryetare u ndihmua, gjithashtu, edhe nga forcat e flotës detare të krishterë: flota venedikase, që ishte një nga flotat më të fuqishme të kohës, bashkë me flotën detare të Kalorësve të Rodosit (Shën Xhonit), që kishte një fuqi të konsiderueshme, dhe flota romake morën për detyrë patrullimin, dhe mbajtjen nën kontroll të zonës së Ngushticës së Dardaneleve dhe Bosforit. Ata, në vitin 798/1396, avancuan drejt qytetit të Kostandinopojës për ta çliruar atë, pasi ishte rrethuar prej 5 vitesh, si dhe për të çliruar Tokën e Shenjtë nga zotërimi i muslimanëve. Ata duhet të kenë pasur shumë besim në vetvete pasi mburreshin se: "Sikur qielli të bjerë, ne do ta mbajmë lart me shtizat tona". Ushtria e bashkuar e krishterë e plaçkiti Serbinë, edhe pse mbreti ortodoks i qëndroi besnik traktatit, me sa duket për shkak të frikës nga hakmarrja e Bajezidit.

Për shkak të këtij avancimi masiv evropian, Sulltan Bajezidi e tërhoqi pjesërisht ushtrinë e tij nga rrethimi i Kostandinopojës dhe iu drejtua Edrenesë, duke arritur në qytetin Nikopolis (Niğbolu), që Sulltan Muradi ia kishte marrë mbretit bullgar Shishman, ku dhe gjeti kështjellën të rrethuar nga forcat e

krishtera. Kryqtarët nuk e kishin menduar se Bajezidi do të mbërrinte kaq shpejt në skenën e luftës dhe u gjendën në befasi. Jëlldërëm Bajezidi, një ushtarak tepër i guximshëm, kaloi vetë pranë radhëve rrethuese të kryqtarëve gjatë natës, iu afrua kështjellës dhe i thirri Komandantit të Kështjellës “Bre Dogan!” (O Dogan!), i cili iu përgjigj “Si urdhëron, Sulltani im!”, duke e ditur se asnjë tjetër përveç Jëlldërëm Bajezidit do t’i drejtohej atij në emër. Pas një bisede të shkurtër mbi situatën, duke ngritur kështu moralin e muxhahidinëve të rrethuar, Jëlldërëm Bajezidi u kthye tek ushtria e tij.

Ushtria osmane, e grupuar në formën e gjysmëhënës, u sulmua fillimisht nga kalorësia franceze, e cila nuk donte të humbiste nderin e saj në sy të hungarezëve, edhe pse **Zigismundi** i kishte paralajmëruar që të kishin shumë kujdes. Qendra e saj u tërhoq për pak kohë dhe kalorësia franceze vazhdoi sulmin e saj. **Zigismundi** u përpoq t’i shpëtonte, por nuk arriti dhe kur pa se jeta e tij u vu në rrezik, ai u arratis me varkë drejt flotës së krishterë, që ishte pozicionuar në lumin Danub për të mbështetur ushtrinë e kryqtarëve. **Zigismundi** lundroi drejt Kostandinopojës përmes Detit të Zi dhe më tutje përmes Ngushticës së Dardaneleve drejt Dalmacisë derisa arriti në vendin e tij, në Hungari, në rrugë tokësore.¹⁷⁶ Një person i quajtur **Shiltberger (Schiltberger)** nga Bavaria, që ishte kapur rob nga osmanët në këtë betejë dhe kishte kaluar kohë në Gelibollu, ka thënë se osmanët i radhitën robërit e betejës së Nigbollut përgjatë brigjeve të Gelibollut, dhe ndërsa varka e mbretit Zigismund kalonte, i thirrën atij që të merrte dhe robërit me vete.

“Bajezidi bashkoi kontingjente të ndryshme nga Anadulli dhe i largoi forcat sulmuese armike (25 Shtator 1396), duke vrarë ose mbytur në lumin e Danubit me mijëra kalorës dhe udhëheqësit e tyre, ndërsa përpiqeshin ta kalonin lumin. Mijëra të tjerë u burgosën, duke përfshirë këtu fisnikë të ardhur nga e

176 OT, I, fq. 286.


gjithë Evropa, të cilët u liruan vetëm pasi për ta u paguan shuma të mëdha në monedha floriri.¹⁷⁷ Mes tyre ishte dhe **Gjoni i Patrembur (Jean sans Peur)**, nipi tepër krenar i mbretit francez së bashku me më shumë se 20 fisnikë francezë, të cilët u dërguan në Bursa dhe Mihaliç.

Ata qëndruan të burgosur për më shumë se një vit dhe u liruan pasi për ta u paguan 200.000 monedha floriri. Në të gjithë Francën u vendosën taksa shumë të larta dhe u mblodhën para nga Republika e Venedikut, Mbretëritë e Hungarisë dhe Qipros për të liruar këta robër lufte. Me fitoren e kësaj beteje, sundimi osman në rajonin e Ballkanit u konsolidua dhe më shumë, duke u kthyer në këtë mënyrë në një sundim të padiskutueshëm.¹⁷⁸ **Sulltan Bajezidi** i përdori fitimet e kësaj beteje për të ndërtuar **Ulluxhaminë** (Xhamia e Madhe) në Bursa. Ky veprim thekson edhe më shumë dallimet midis dy palëve: në perëndim ngriheshin statuja ose harqe triumfi për të përkujtuar fitoret, ndërsa osmanët ndërtonin xhami, streha etj., për përdorim publik, për arsye se Islami ndalon shpenzimet e tepërta dhe të padobishme (*israf*).

Kali i Jëlldërëm Bajezidit u qëllua, ndërsa ai vetë u plagos gjatë kësaj beteje, por ai pasi e ndërroi kalin vazhdoi të luftonte, duke mos iu kushtuar vëmendje plagëve që kishte marrë.


177 Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 33.

178 Danişmend, I, fq. 104-106.



Ulluxhami, Bursa

Pas fitores së madhe kundër forcave të bashkuara të krishtera në betejën e Nikopolisit në 21 Dhulhixhxe 798/25 shtator 1396, osmanët përvetësuan pjesën e mbetur të territorit të mbretërisë bullgare, ndërsa gazinjtë muslimanë thirrën *akënxhinjtë* (sulumesit) dhe sulmuan Vllahinë dhe Hungarinë.



Tyrbja e Sylejman Çelebiut, autorit të mevludit, në Bursa.¹⁷⁹

179 Sylejman Çelebiu ishte *imam* i *Ulluxhamisë* në Bursa. Kur dëgjoji se një *vaiz* (predikues) e kishte kuptuar dhe interpretuar ajetin: “Ne nuk bëjmë

Ndërkohë, **Sulltan Bajezidi** rrethoi sërish Kostandinopojën. Megjithatë, asokohe Devleti Osman ishte i kujdesshëm për të mbajtur marrëdhënie paqësore me gjenovezët dhe venedikasit. Duke qenë fuqi supreme në det, këto fuqi mund t'i ndalonin, nëse dëshironin, ushtritë osmane të kalonin Bosforin apo Ngushticën e Dardaneleve.¹⁸⁰ Duke qenë se nuk kishte armë aq të rënda, për të shkatërruar muret e forta rrethuese të Kostandinopojës, strategjia e Jëlldërëm Bajezidit ishte që ta sulmonte qytetin, kur të rrethuarve t'iu ishin mbaruar të gjitha rezervat ushqimore dhe për pasojë, populli t'iu vetëdorëzohej osmanëve. Në fakt, pati raste kur popullsia zbriste nga muret e qytetit për shkak të urisë. Nëse **Emir Timuri** nuk do të kishte ardhur me një ushtri të madhe, Jëlldërëm Bajezidi, me shumë mundësi, do ta kishte hapur në atë kohë qytetin e Kostandinopojës ndaj Islamit.¹⁸¹

Sulltan Bajezidi dërgoi trupat e tij të *akënxhinjve* në More. Ndërkohë që Beu i Karamanit, **Alaeddin Ali**, përfitoi nga angazhimi i osmanëve në Evropë, për ta sulmuar qytetin e Ankarasë dhe për të kapur rob **Sarë Timurtash Pashanë**. Pasi mësoi se **Jëlldërëm Bajezidi** i kishte mundur kryqtarët në betejën e Nigbollut, ai e liroi Timurtash Pashanë dhe u mundua të mbante marrëdhënie të mira me sulltanin osman. Por pasi vendosi nën kontroll situatën në Rumeli dhe pasi la ushtrinë e

asnjë dallim midis pejgamberëve të Tij" (*el-Bekare*: 285), sikur: "të gjithë pejgamberët janë të barabartë në shkallë", ai shkroi *Vesiletun Nexhat* në osmanishten turke, përgjithësisht të njohur si *mevlid* dhe që është recituar në të gjitha festat për synet, dasma, ceremonitë mortore etj., për të theksuar superioritetin e Pejgamberit të Fundit Muhammed (Paqja qoftë me të), duke treguar në hollësi jetën e tij. Nuk ka asnjë dallim midis profetëve sa i përket asaj që janë të Dërguar.

180 OT, I, fq. 289.

181 OT, I, fq. 291. Në librin e tij *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey* (Cambridge, 1988), fq. 34, S. Shaw pretendon se Bajezidi e la idenë e rrethimit pasi "këshilltarët e tij të krishterë iu lutën atij për këtë". Por, ai nuk përmend asnjë emër të tyre dhe për më tepër, Bajezidi nuk ishte nga ata që drejtoheshin nga këshillat e të tjerëve. Më e saktë do të ishte të thuhej se tërheqja e tij u ndikua nga kërcënimi i shtuar nga Emir Timuri.

tij në More, Jëlldërëm Bajezidi u drejtua për në Anadoll në 799/1397, dhe avancoi drejt qytetit të Konjas, kryeqendrës së Bejlikut të Karamanit. Ushtria osmane e shkatërroi ushtrinë e Beut të Karamanit në betejën që u zhvillua në Akçaj. Kur ushtria osmane mbërriti në Konja, ishte koha e të korrave; dhe kur populli i Konjas pa se ushtarët osmanë nuk e prekën grurin e tyre, që ishte shpërndarë në zonën jashtë qytetit, por kërkuan që ta blinin atë, ata vendosën që ta dorëzonin qytetin¹⁸², dhe këtë e bënë që të kurseheshin jetët dhe prona e tyre.¹⁸³ Qytetet e Aksarajit, Nigdes dhe Larendes u përvetësuan në vitin 800/1398; disa pjesë të tokave të Karamanit, në jug të maleve të Taurusit (Torosit), mbetën jashtë territorit osman në atë kohë, por Bejlikut të Karamanit, që ishte më i madhi në atë kohë, i erdhi fundi. Kjo situatë rriti prestigjin e Devletit Osman. **Ahmed Beu**, Emiri i Amasjas, që ishte lodhur nga presioni i **Kadiut Burhaneddin**, iu drejtua në vitin 795/1393 **Jëlldërëm Bajezidit**, duke i thënë atij se dëshironte t'i dorëzonte qytetin e Amasjas dhe në këmbim të merrte titullin *sanxhakbej*, kërkesë kjo që u pranua nga Bajezidi.¹⁸⁴ Jëlldërëm Bajezidi mori qytetet e: Sivasit, Tokatit dhe Kajserit nga Bejliku i kadiut Burhaneddin, në 801/1399, dhe u kthye në Bursa. Në atë kohë, kadiu Burhaneddin kishte pranuar vasalitetin e memlukëve të Egjiptit dhe Shamit, kur e kuptoi se Devleti Osman ishte bërë shumë i fuqishëm dhe më prestigjioz pas betejës së Nikopolisit dhe fitores ndaj Bejlikut të Karamanit. Qyteti i Mallatias ishte në zotërimin e Bejlikut të Kadiut Burhaneddin. Jëlldërëm Bajezidi dëshironte që Sulltani memluk **Nasirud Din Farak** t'ia dorëzonte qytetin e Mallatias, duke i dhënë fund në këtë mënyrë Bejlikut të Kadiut Burhaneddin dhe për pasojë, edhe Mallatja duhet të hynte brenda kufijve osmane. Pasi pa që kjo dëshirë nuk iu plotësua, Jëlldërëm Bajezidi marshoi me ushtrinë e tij drejt qytetit të Mallatjas dhe popullata ia dorëzoi qytetin.

182 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 73; *Oruç Beğ Tarihi*, fq. 55-56.

183 *OT*, I, fq. 295-296.

184 *OT*, I, fq. 277-278.

Bajezidi i aneksoi qytetet e Divrigisë dhe Darendes që u takonin memlukëve. **Mutaharten Beu** i Erzinxhanit, i cili kishte pranuar vasalitetin e **Emir Timurit**, u betua për besnikërinë e tij ndaj **Jëlldërëm Bajezidit** dhe vazhdoi të qëndronte si bej i qytetit nën sundimin osman. Në atë kohë, ishte i mirënjohur fakti që Devleti Osman dëshironte t'i bashkonte të gjithë muslimanët e Anadollit nën flamurin e tij.

Përpara zhvillimit të betejës së Ankarasë në vitin 804/1402, Devleti Osman kishte marrë pothuajse të gjitha territoret muslimane nën Devletin Selçuk, si dhe kishte hapur ndaj Islamit territore të gjera në Evropë, deri në Danub. Kjo arritje e madhe ishte përmbushur në mënyrë të mrekullueshme vetëm në një periudhë kohore njëshekullore. Një shtetar i njohur, **Mustafa Nuri Pasha**, ka radhitur faktorët e këtij suksesi unik si më poshtë:

1. Sulltanët e hershëm osmanë, iu bindën Ligjit të *Sheriatit* në mënyrë të padiskutueshme.¹⁸⁵ Ata e vendosën administratën ligjore, ekskluzivisht, në duart e kadive, të cilët emëroheshin në çdo qytet apo qytezë të Devletit Osman.
2. Osmanët i mbetën besnik në konsekuencë Devletit Musliman Selçuk dhe nuk u rebeluan asnjëherë kundër tij. Krijuesi i shpërbleu ata për këtë, pasi është e detyrueshme që muslimanët t'i binden sundimtarit, që zbaton rregullat e Islamit, siç thuhet edhe në Kur'an: "Binduni Allahut dhe Pejgamberit të Tij dhe *Ulu'l Emr* (përgjegjësit) nga ju." [*en-Nisa*, 59].

185 Sulltan Jëlldërëm Bajezidi supozohej të dëshmonte, por Kadiu i Bursës, **Shemseddin Fanari**, ngurroi ta pranonte atë si dëshmitar, për arsye se Bajezidi nuk mori pjesë në namazin e përbashkët me xhemat (*salatu xhema'ah*), edhe pse ishte i preokupuar me çështjet zyrtare. Pas kësaj, Jëlldërëm Bajezidi ndërtoi një xhami përballë pallatit të Shemseddin Fanarit, në mënyrë që të kishte mundësi të merrte pjesë në kongregacionet: Osman-zade Taib, *Hadikatus Selatin*, cituar nga Danişmend, I, fq. 141.

3. Rënia e Devletit Selçuk dhe dobësimi i Perandorisë Romake, përgatiti kushtet për krijimin dhe zgjerimin e Devletit Osman.
4. Pozicioni strategjik i osmanëve u dha atyre avantazh për të zhvilluar fushatat e xhihadit, kundër *kafirëve* (të pafeve), si dhe të merrnin përfitime të mëdha materiale, gjë që inkurajoi pjesëmarrjen e një numri të madh luftëtarësh *gazinj* (*muxhahidinë*) në fushatat e xhihadit.
5. Osmanët i respektonin *ulematë* (njerëzit e ditur) dhe iu dhanë komandantëve të tyre autoritetin për administrimin e territoreve të tyre, duke i nxitur në këtë mënyrë ata, që të ishin besnikë ndaj Devletit të ri musliman. Ata ishin gjithashtu shumë të zellshëm për të përhapur fenë Islame dhe për të zbatuar ligjin e *Sheriatit*, në ato zona ku ndërtuan institucione publike dhe bamirësie të tilla si: banja publike, *medrese*, xhami etj.¹⁸⁶

Emir Timuri dhe Jëlldërëm Bajezidi

Ndërkohë që Bajezidi ishte i angazhuar në fushatat e xhihadit në Evropë, në Turkestan u shfaq një sovran tjetër turk. Ky ishte **Emir Timuri** apo Tamerlani, ashtu siç ai njihet në Perëndim. Kryeqyteti i tij ishte Samarkanda, në Uzbekistanin e sotëm, por ai vazhdoi të avanconte,¹⁸⁷ duke marrë toka të reja në Azi. Fushata e tij pushtuese frikësoi sundimtarin e Bagdadit, Ahmedin e Xhelajirit (784-813/1382-1410) dhe vasalin e tij Kara

186 Mustafa Nuri Pasha, *Netajixhul Vuku'at*, I, fq. 11-12.

187 Emir Timuri urdhëroi kuzhinierët e tij që të përgatisnin një ushqim të tillë që ushtarët të kishin mundësi të hanin ndërsa kalëronin mbi shpinën e kuajve të tyre, që të mos humbisnin kohë duke ndaluar për të ngrënë. Kështu, sipas urdhrit të tij, ata përgatitën një ushqim të përbërë nga orizi, disa perime dhe qepë, ushqim ky që konsumohet dhe në ditët e sotme në Uzbekistan.

Hitleri, gjithashtu, nuk dëshironte që ushtria e tij të humbiste kohë për të ngrënë dhe i urdhëroi ata të merrnin me vete racione në formën e tabletave që përmbanin proteina, fibra, vitamina etj., në doza ditore, por, rezultati ishte i pavlerë, pasi ushtarët filluan të vuanin nga konstipacioni, për shkak të mungesës së celulozës.

Jusufin, sovranin e Tebrizit.¹⁸⁸ **Emir Timuri** (736-807/1336-1405) iu drejtua **Jëlldërëm Bajezidit**, në mënyrë që t'i largonte këta dy sundimtarë, por ky i fundit e kundërshtoi me zemërim duke thënë se ishte një mënyrë joetike. Përpjekje të mëtejshme diplomatike (negociatorët dhe korrespondenca zyrtare) nuk patën asnjë sukses, për të arritur një zgjidhje të mosmarrëveshjeve midis të dyve dhe përfundimisht, në vitin 802/1400, Emir Timuri avancoi dhe e mësyu garnizonin osman në Sivas, ku pati dhe shumë të vrarë.

Ndërkohë që sulltani po rrethonte Kostandinopojën, ai mori lajmin e rënies së Sivasit dhe për pasojë, u nis për në Anadoll me nxitim, por nuk arriti ta kapte Timurin, i cili marshoi së bashku me ushtrinë e tij drejt jugut, për t'u ndeshur kundër memlukëve të Egjiptit,¹⁸⁹ dhe pushtoi Biladu'sh-Shamin (Sirinë), në vitin 803/1401. Në atë kohë, sulltani i memlukëve vdiq dhe u pasua nga një sovran fëmijë. Ky kalim pushteti solli protesta në radhët e memlukëve dhe rrjedhimisht i hapi rrugën avancimit të Timurit.

"Timuri, i cili hezitoi paksa të marshonte me ushtrinë e tij kundër Jëlldërëm Bajezidit, që kishte fituar një famë të madhe pas fitores në betejën e Nigbollut, e shikonte veten si pasardhës të ilhanllinjëve dhe selçukëve të Anadollit, dhe dëshironte të mbante *status quonë* në rajonin e Anadollit, dhe vendosi si qëllim të vetin të shfaroste çdo entitet që do të ishte kundër tij. Në fakt, ai i shihte osmanët si një nga bejliket e Anadollit Perëndimor që duhet t'i bindej. Përpjekjet e Bajezidit për të ndryshuar balancat në Anadoll dhe për ta bashkuar këtë rajon, ishin një goditje për cilësinë e tij të patronazhit dhe kujdestarisë".¹⁹⁰

Emir Timuri e vlerësoi këtë situatë të krijuar dhe e dinte se nuk do të arrinte asgjë kundër Bajezidit me forcat që kishte;

188 *Netajixh*, I, fq. 11.

189 Stanley Lane-Poole, *Turkey*, (Londër, 1986), fq. 65.

190 Feridun Emecen, "Kuruştan Küçük Kaynarca", *Osmanlı Devleti Tarihi*, vëllimi I, fq. 19, botim i *Zaman*, Stamboll 1999.

kështu, ai solli njësi të përzgjedhura nga Turkestani dhe kaloi dimrin në Karabag (Karabağ), në Azerbajxhan. Ai mund të kishte marrë në atë kohë Kinën, që po kalonte një periudhë kaosi dhe konfuzioni pas vdekjes së perandorit, por ai mendonte se ishte thelbësore të merrej si fillim me Sulltan Bajezidin, që ishte një kërcënim për Irakun, el-Xheziren, dhe Azerbajxhanin.¹⁹¹ Arsyeja e vërtetë e konfliktit midis Timurit dhe Bajezidit, ishte dëshira e Timurit për hegjemoni botërore dhe ndjenja personale e madhështisë së Bajezidit, i cili kishte arritur deri në atë kohë fitore dhe suksese të njëpasnjëshme.

Shtetarët osmanë, të cilët vlerësonin situatën dhe fuqinë e Timurit, e nxitën Jëlldërëmin të pranonte vendosjen e paqes dhe e këshilluan atë t'i dërgonte Timurit një misionar. Bajezidi, në një letër të tijën, deklaroi se nuk kishte asnjë arsye për përbuzje të ndërsjellë, dhe se ai kishte qenë i angazhuar në *xhihad* si të gjithë paraardhësit e tij.

Megjithatë, Emir Timuri dëshironte që Bajezidi të pranonte menjëherë një sërë kushtesh përfundimtare: ai duhet të pranonte pa kushte supremacinë e Timurit, t'i dërgonte peng njërin nga djemtë e tij dhe t'i dorëzonte atij Kara Jusufin. Për më tepër, ai duhet t'iu kthente qytezën Kemah drejtuesve të saj të mëparshëm, si dhe t'iu dorëzonte sundimtarëve të mëparshëm të gjitha territoret që osmanët kishin marrë në Anadoll.

Bajezidi, që nuk kishte provuar asnjë humbje deri në atë kohë, i refuzoi me zemërim këto kushte dhe të dy ushtritë u përballën në fushën e Çubukut, pranë Ankarasë, në vitin 804/1402.¹⁹² Ndërkohë që Timuri kishte në radhët e ushtrisë së tij elefantë, osmanët përdorën artilerinë dhe ushtarët serbë, të cilët iu ishin dhënë osmanëve si përfitim nga luftërat e mëparshme. Gjatë betejës, disa kalorës nga Anadoll shkuan drejt ushtrisë së Timurit kur panë të valëviteshin në anën tjetër fla-

191 OT, I, fq. 306-307.

192 Danişmend, I, fq. 127.

mujt e bejlerëve të tyre të mëparshëm.¹⁹³ Mongolët, që në atë kohë qubeshin tatarë, kur pushtuan Anadollin, pasi shkatërruan selçukët në Kosedagë, në vitin 1243, kishin lënë disa nga njësitë e tyre ushtarake në Anadoll në mënyrë që të parandalonin ringritjen e selçukëve. Jëlldërëm Bajezidi, i cili kishte përvetësuar zonat ku ishin vendosur ata mongolë (tatarë), nuk merrte taksa prej tyre, por i përdorte ata në luftë. Emir Timuri fshehtas ra në kontakt me mongolët e këtyre zonave (të cilëve burimet osmane iu referohen si “Kara Tatarë”) dhe iu premtoi atyre sovranitetin e Anadollit. Kështu që edhe këta mongolë (Kara Tatarë) iu bashkuan ushtrisë së Timurit.¹⁹⁴ Për pasojë, ushtria osmane u tërhoq dhe Veziri i Madh, Ali Pasha, u arratis së bashku me *Shehzade* (princin pasardhës) Sylejman Çelebinë; ndërkohë, pasardhësi (tjetër) *Shehzade* Mehemed Çelebi, që ishte në prapavijë, u largua për në Amasja. Jëlldërëm Bajezidi luftoi me guxim, por u rrethua nga ushtarët e Timurit, të cilët e kapën rob.¹⁹⁵ Bajezidi vdiq në hidhërim në Akshehir¹⁹⁶ dhe u varros në Bursa. Ai u transportua në një barelë me shufra, që më vonë u kthye në një legjendë sipas së cilës thuhej se ishte mbajtur në një kafaz të hekurt.

Emir Timuri arriti fitore të tjera duke pushtuar qytetin Iznik (Nikea), Bursa dhe qytete të tjera që shtriheshin përgjatë bregdetit. Ai ua rrëmbeu Izmirin (Smirna) kalorësve trima të Shën Xhonit dhe iu ktheu drejtuesve të mëparshëm bejliket e vogla, që osmanët ua kishin marrë në Anadoll.¹⁹⁷ Kalorësit e Shën Xhonit e kishin marrë portin e Izmirit nga Bejliku i Ajdënogllusë në vitin 745/1344. Një sukses i madh ishte dhe marrja e kështjellës së Izmirit nga Emir Timuri në vitin 805/1402. Ai ia dha Izmirin Bejlikut të Ajdënogllusë, i cili ishte

193 Neşri, I, fq. 350.

194 Mustafa Nuri Pasha, *Netajixhul Vuku'at*, I, fq. 24.

195 OT, I, fq. 313.

196 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 80. Neşri, I, 358.

197 Stanley Lane-Poole, *Turkey*, fq. 72-73.

një nga bejliket e Anadollit, që ai kishte arritur të rigjallëronte.¹⁹⁸ Timuri nuk e kaloi Detin Marmara drejt Evropës dhe për këtë arsye pjesa evropiane osmane mbeti e paprekur. Djali më i madh i Jëlldërëm Bajezidit, **Sylejman Çelebi** drejtonte pjesën evropiane të territorit osman.

Emir Timuri u dërgoi letra Mbretit të Francës **Sharlit VI** dhe Mbretit të Anglisë **Henri IV**, duke i njoftuar ata për suksesin e arritur, dhe për faktin se e kishte mundur personin, të cilin ata nuk kishin arritur ta mundnin në Nikopolis.¹⁹⁹

Bajezidi u kritikua nga Mustafa Nuri Pasha²⁰⁰ si njeri “i rrëmbyer dhe krenar” dhe gjithashtu, thoshte se: “Ai duhet të kishte pritur para se të hapte të gjitha bejliket e Ajdënit, Menteshesë, Hamidit, Germijanit dhe Isfendijarit.”²⁰¹ Edhe Stenli Lejn-Pul (Stanley Lane-Poole) kishte për të thënë këtë për humbjen e ushtrisë osmane: “Fuqia osmane dukej sikur kishte humbur përgjithmonë. Me një goditje, Timuri, “Tatari Fisnik”,²⁰² kishte marrë sovranitetin e Anadollit dhe ishte dhe

198 Danişmend, I, fq. 138-139.

“Kalorësit e Shën Xhonit” ishin një urdhër fetaro-ushtarak. Të rinj nga e gjithë Evropa erdhën dhe hynë në këtë urdhër. Ata ishin ushtarë të mirëpërgatitur për të luftuar kundër muslimanëve, veçanërisht “turqve jobesimtarë” (pasi ata nuk e pranonin Jezusin, paqja qoftë me të, si Zotin e tyre).

199 OT, I, fq. 314.

200 Ai kishte pozicionin e “Defter-i Hakani Nazërë” (përgjegjës për çështjet fiskale) nën sundimin e Sulltan Abdulhamidit II dhe libri i tij mbart vlera të mëdha.

201 Mustafa Nuri Pasha, *Netajixhul Vuku’at*, I, fq. 21.

202 Timuri NUK është vetëm tatar. Vetë kjo fjalë nënkupton se ai ishte me origjinë turke. Në turqishten e Lindjes (Çagataj) shqiptohet “Timur” dhe në turqishten perëndimore (osmanishte) shqiptohet “Demir” që do të thotë “Hekur”. Termi “tatar” apo “tartar” është përdorur për t’iu referuar **mongolëve**, të cilët pushtuan pjesën më të madhe të botës në kohën e tyre, duke përfshirë këtu hapësira të mëdha turke, që shtriheshin nga brigjet lindore të Detit Kaspik deri në Kinë, si dhe në brigjet veriore të Detit Kaspik dhe Detit të Zi. Për shembull, Ibn el Ethir në librin e tij *el Kamil fit Tarih* (Bejrut, 1398/1978), kur përshkruan ngjarjet e vitit 617/1220, përmend “ardhjen e **tatarëve** në Turkestan” (fq. 239); “Sovrani i tyre **Xhingiz Hani**” (fq. 239); “Hyrja e **tatarëve** në qytetin Dijarbakër dhe el-

një numër i madh armiqsh në Evropë, që prisnin rastin për të marrë në dorë sundimin e provincave turke atje. Hungarezët, polakët, bullgarët, shqiptarët, vllahët dhe shumë popullsi të tjera të provincave turke ishin të gatshme që të hidheshin në revoltë brenda kufijve të territoreve turke. Ata mendonin se armiku i tyre kishte rënë një herë e përgjithmonë.”²⁰³

Xhezireh në 628/1231” (fq. 384). Pra, është e qartë se **mongolët në atë kohë quheshin “tatarë”**. Turqit në Turkestan dhe në pjesën veriore të Detit Kaspik dhe Detit të Zi u pushtuan nga mongolët dhe jetuan nën sundimin e tyre, dhe **ata u quajtën “tatarë” sipas sundimtarëve të tyre**. Me kohë, përdorimi i termit “mongol” mbizotëronte në rajonin lindor të territorit mongol, ndërsa termi “tatar” vazhdoi të përdorej për pjesën që mbetej: Bathold, “Tatar”, *Encyclopaedia of Islam*, (Leiden: 1934), vëllimi IV, fq. 701. Tatarët (Mongolët) e vërtetë në ato zona u përzien me kalimin e kohës gjithmonë e më shumë me popullsinë turke. Një shembull i mirë që ilustron këtë është **Tataristani** në Federatën e sotme ruse. Popullsia muslimane e Tataristanit flet dialektin turk të quajtur Kipçak dhe ata janë pasardhës të turqve bullgarë dhe Kipçakë. Për sa i përket **Timurit**, ai fliste dialektin e Turqisë Lindore (Çagataj). Stërgjyshi i tij i pestë mund të ketë qenë në shoqërinë e Çagataj Hanit, nipit të Xhingiz Hanit, por mongolët (tatarë) ishin turqizuar pas katër gjeneratash, siç tregon edhe vetë Emir Timuri. Është e qartë se **Emir Timuri** nuk fliste gjuhën mongole, por gjuhën turke të lindjes, si popullata në Uzbekistan. Shaw, gjithashtu, në mënyrë të gabuar, mendon se Timuri ishte tatar, pasi ai shkruan: “Pushtuesi tatar i fuqishëm i Iranit, Timurlani” (Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 32.)

203 Stanley Lane-Poole, *vepër e cituar*, fq. 74.



Medreseja e Jëlldërëmit

Vlerësimi

Humbja e osmanëve ndaj Timurit mund të shpjegohet nga shumë shkaqe: Ushtria e Timurit ishte tepër rigorozë dhe e disiplinuar, dhe në thelb ishte më e madhe në numër nga ushtria osmane. Ushtria osmane përbëhej nga 8.000 ushtarë serbë jomuslimanë, pjesëmarrja në luftë e të cilëve mendohet se u konsiderua si një shenjë e keqe për osmanët. Aksidentalisht, u pretendua në mënyrë të drejtë apo të gabuar, se Sulltan Muradi u ndëshkua në betejën e Kosovës, ku u vra, nga që luftoi kundër Beut musliman të Karamanit. Për më tepër, territoret e reja të përvetësuar nga osmanët, nuk kishin qenë për një kohë të mjaftueshme nën sundimin osman, në mënyrë që dhe ta pranonin atë plotësisht, dhe për pasojë, ata kaluan në krahun e Timurit, duke parë që me të ishin bashkuar edhe ish-bejlerët e tyre. Përveç të gjitha këtyre, është raportuar se zyrtarët dhe oficerët e lartë nuk ishin entuziastë për zhvillimin e kësaj beteje kundër muslimanëve dhe për këtë arsye, nuk kishin luftuar trimërisht kundër Timurit. Megjithatë, duke qenë i ndërgjegj-

shëm se e gjithë përgjegjësia e kësaj beteje binte mbi shpatullat e tij, sulltani vazhdoi të luftonte vetëm me disa qindra ushtarë deri në fundin e hidhur, edhe pse ai mund të ishte tërhequr dhe të ishte larguar po të dëshironte.²⁰⁴

Beteja e Ankarasë ishte një shkak i madh gëzimi për Perandorinë Romake. **Perandori Joanis VII** i dërgoi **Emir Timurit** me ngut lajmëtarë, duke i paraqitur atij vasalitetin e tij dhe duke i paguar tagrën që ua paguante osmanëve. Pas këtij veprimi, Timuri i kërkoi perandorit të përgatiste një flotë për t'i dërguar trupat e tij në Evropë. Por, perandori romak, duke pasur frikë se tashmë do të binte në duart e Timurit, i dërgoi lajmëtarët e tij tek Papa dhe në Senatën e Venedikut, duke iu kërkuar atyre ndihmë. Ndërkohë Timuri nuk dëshironte ta rëndonte lidhjen e tij me Anadollin duke kaluar Detin Marmara dhe për këtë arsye, hoqi dorë nga kjo ide. Në vend të kësaj, ai vendosi të marshonte drejt Kinës, duke pranuar ndërkohë vasalitetin e Ferexhit, Sulltanit memluk të Egjiptit.

Edhe *shehzadet* osmanë i paraqitën Timurit vasalitetin e tyre: **Sylejman Çelebiu**, që kishte shpallur sundimin e tij ndaj Edrenesë, dërgoi **Shejhun Ramazan** tek Timuri. **Isa Çelebiu**, që kishte kontrollin e Bursës dhe Ballëkesirit, dërgoi **Shejh Kutbeddinin**, ndërsa **Mehemmed Çelebiu**,²⁰⁵ që ishte në Amasja, dërgoi **Sofu Bajezidin** tek Timuri. Nga ana tjetër, Emir Timuri dërgoi **Shehzade Mustafain** së bashku me trupin e babait të tij. Emri i Timurit shihet edhe në monedhat e

204 Mustafa Nuri Pasha, *Netajixhul Vuku'at*, I, fq. 13-15.

205 Shqiptimi i saktë i këtij emri në atë kohë duhet të ketë qenë "Mehemmed", dhe jo "Mehmed", siç përdoret përgjithësisht. Shiko për shembull H. A. R. Gibb, *A History of Ottoman Poetry* (Londër: 1900, ribotuar 1958), fq. 392-393. Në këtë libër, emri i poetit shkruhet "Mehemmed", që në ditët e sotme, shumë mund ta lexojmë "Mehmed". Kjo tregon se ky emër lexohej "Mehemmed" në shekullin e 15-të. Një shembull tjetër jepet edhe në librin *Gazavat-ë Sulltan Murad b. Mehemed Han*, botuar nga Halil İnalçık dhe Mevlüt Oğuz (Ankara: 1978), ku tregohet mbi betejat e zhvilluara në Izladi dhe Varna (1443-1444) nga Sulltan Muradi II. Titulli i këtij libri i referohet këtij sundimtari osman, Mehemedit të Parë.

Mehemmed Çelebiut, që datojnë në vitin 806/1403-04, si shenjë e vasalitetit.²⁰⁶

Periudha e trazirave 1402 – 1413

Pas kapjes rob të Jëlldërëm Bajezidit, djemtë e tij u përpoqën të merrnin Devletin. **Emir Sylejmani** dhe **Musa Çelebiu**, njëri pas tjetrit, morën drejtimin e territoreve osmane të Evropës, ndërsa Mehemmed Çelebiu, mori pjesën e Anadollit të Devletit Osman, pasi kishte rrëzuar nga fronin vëllain e tij, Isa Çelebiun.

Më pas, Mehemmed Çelebiu shkoi në Evropë, ku mundi vëllain tjetër të tij Musa Çelebiun, duke siguruar kështu pozicionin si sulltan i vetëm në vitin **815/1412**.²⁰⁷ Megjithatë, periudha e trazirave vazhdoi për 11 vite të tjera. Është interesante të theksohet këtu, se ndërkohë që osmanët ishin të angazhuar në luftën civile, nuk u zhvillua asnjë revoltë në territoret e reja të përvetësuara në rajonin e Evropës. Popullsia e krishterë në atë rajon, për shembull, kishte qëndruar paqësore gjatë fushatave luftarake të suksesshme të Mustafa Çelebiut kundër serbëve. Nëse ata nuk do të kishin qenë të lumtur nën sundimin osman, ata do të ishin ngritur në kryengritje kundër tij, duke tërhequr kështu vëmendjen nga zhvillimi i xhihadit kundër të krishterëve të tjerë. Kjo tregon që administrata osmane ishte e drejtë dhe tolerante ndaj *dhimnive* të saj, dhe ne tani kemi dëshmi të mjaftueshme për ta pranuar si të vërtetë se ata parapëlqenin sundimin osman në vend të atij të krishterë. Popullsia ortodokse e Gadishullit të Ballkanit, për shembull, kishte preferuar administrimin musliman në vend të atij katolik,²⁰⁸ ashtu sikurse theksohet edhe nga Donald Edgar Piçer (Pitcher): “Karakteristika më dalluese e luftës 10-vjeçare për të marrë drejtimin e Perandorisë, që u zhvillua midis katër djemve

206 Danişmend, I, fq. 142-143.

207 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 84.

208 *OT*, I, fq. 325-326.

të Bajezidit, ishte se brenda kufijve të sulltanatit, ashtu siç ishte themeluar nga Sulltan Muradi I, mbizotëronte një besim mbresëlënës ndaj oborrit osman. Mbështetja mund të kalonte nga një vëlla tek tjetri, në varësi të karakterit dhe të rrethanave, por kishte pak mundësi, apo nuk kishte asnjë tendencë, për t'u larguar nga sundimi osman. Sigurisht që pjesëmarrja në luftë harxhonte energjitë më të mëdha të ushtrisë, megjithatë, nxitjet për të qenë gazi ishin ende të forta, që tregohet mjaft mirë edhe nga sulmet e vazhdueshme në territoret e krishtera, që arrinin tutje larg, deri në Moting (1408), në skajin veriperëndimor.²⁰⁹ Në këtë kontekst, osmanët e asaj kohe ishin më tolerantë ndaj popullsisë së krishterë nën sundimin e tyre, krahasuar me sjelljen e shteteve të sotme të krishtera, të ashtuquajtura shtete më të zhvilluara, ndaj muslimanëve që jetojnë në territorin e tyre. Me fjalë të tjera, **ajo që muslimanët arritën gjatë 5 shekujve të kaluar në këtë drejtim, nuk është arritur ende nga Perëndimi i krishterë. Kjo është një cilësi unike e Islamit për të cilën të gjithë muslimanët duhet të ndihen gjithmonë krenarë dhe të nderuar.**



Tyrbja e Shehnut Kutbeddin në Iznik

209 Donald Edgar Pitcher, *An Historical Geography of the Ottoman Empire*, (Leiden: E. J. Brill, 1972), fq. 58.

KAPITULLI 3

RIVENDOSJA

3.1 Çelebi Mehemmedi 1413-1421

Çelebi²¹⁰ **Mehemmedi** mbërriti në Bursa, pas largimit të Timurit nga Anadulli, por aty ishte **Isa Çelebiu**, shehzadeja tjetër. Ata u përballën me njëri-tjetrin dhe Isa Çelebiu u mund, u tërhoq, ndërsa Mehemed Çelebiu hyri në qytetin e Bursës. Ai kërkoi nga Germijanogllu (Germiyanoğlu) Jakub Beu t'i dërgonte trupin e Jëlldërëm Bajezidit, që ia kishte lënë në ruajtje atij, dhe ai e dërgoi atë me Musa Çelebiun. Funerali u mbajt në vitin 806/1403-04.

Sylejman Çelebiu, që ishte sovrani i pjesës evropiane, duke qenë se ishte djali i parë i Bajezidit, kishte për qëllim të shkonte në rajonin e Anadollit dhe ta aneksonte atë. Por, *Vezir-i a'zam*, Ali Pasha, mendonte se do të ishte më e favorshme që në këtë vend të dërgohej shehzadeja tjetër **Isa Çelebiu**. Në këtë mënyrë, Isa Çelebiu u dërgua së bashku me një trupë ushtarake, por pësoi disfatë nga Mehemed Çelebiu dhe u strehua tek Isfendijar Beu i Kastamonut. Më pas, Isa Çelebiu, me ndihmën e disa bejlikeve të Anadollit u përpoq edhe një herë ta mundte

210 **Çelebi** është një fjalë në turke që do të thotë **princ** ose **aristokrat**, dhe në disa raste edhe "**kunati**" i nuses. Por në këtë kontekst, është përdorur me kuptimin e princit dhe jo të aristokratit, siç supozon në mënyrë të gabuar Stanley Lane-Poole. (S. Lane-Poole, fq. 83). Të gjithë djemve të Sulltanit Bajezid iu dha titulli *çelebi*.

Mehemmed Çelebiun, por sërish nuk arriti dhe u largua. Mehemmet Çelebiu marshoi me ushtrinë e tij kundër bejlerëve të Izmirit, Saruhanit dhe Menteshesë, të cilët kishin ndihmuar Isa Çelebiun gjatë luftimeve të tij dhe i mundi ata, duke aneksuar Bejlukun e Saruhanit. Ndërsa Xhynejd Beu i Izmirit pranoi vasalitetin ndaj Çelebi Mehemedi.

Në këtë mënyrë, Mehemmed Çelebiut iu desh në fillim të luftonte kundër bejlikeve (emirateve, principatave) rebelë të Anadollit, që ishin rivendosur nga **Emir Timuri**. Ndërkohë që ai ishte i angazhuar në Rumeli, duke luftuar kundër Musa Çelebiut (v.1413), i cili ishte larguar së bashku me Sylejman Çelebiun dhe kishin sunduar pjesën evropiane të Devletit Osman, Mehemmed Beu i Karamanit rrethoi Bursën, por trupat ushtarake osmane e detyruan atë të largohej. Çelebi Mehemedi caktoi djalin e tij Muradin si sanxhakbeun²¹¹ e Amasjas dhe i besoi Hamza Beut detyrën e Llallasë të djalit të tij.²¹² Ai, gjithashtu, mori Izmirin nga Xhynejd Beu, duke e caktuar atë Sanxhakbej të Nigbollut (Nikopolis) dhe emëroi Aleksandrin, një të konvertuar në fenë islame dhe djalë i mbretit të Bullgarisë, si Bej të Izmirit dhe rrethinave të tij në vitin 817/1414.²¹³ Luftëtarët që e quanin veten “Kalorës të Shën Xhonit”, me qendër në ishullin e Rodosit, kishin filluar ndërtimin e një kështjelle në bregdetin e Izmirit. Çelebi Mehemedi e shkatërroi brenda një nate këtë kështjellë të pa ndërtuar plotësisht. Kryetari i kalorësve u zemërua me këtë veprim dhe tha se, nëse osmanët nuk do të lejonin rindërtimin e kështjellës në atë vend, një luftë e ashpër do të fillonte midis Devletit Osman dhe

211 Sipas administrit osman, *sanxhaku* ishte pjesë e provincës. *Sanxhakbeu* ishte kreu i strukturës ushtarake dhe administrative. Megjithatë, origjina e termi *sanxhak* ka kuptimin e një flamuri që valëvitet gjatë një beteje.

212 Termi *Llalla* (bashkëtingëllorja // shqiptohet me zë të thellë në këtë fjalë) ishte i njëjtë në kuptim për osmanët, siç ishte termi *Atabej* për selçukët; një njeri me përvojë dhe i edukuar, të cilit i besohej stërvitja dhe edukimi i *shehzades* (djalit të sulltanit).

213 *OT*, I, fq. 351.

Fuqive të Papatit, që do të thoshte shkatërrim i shumë zonave osmane. Mehemmed Çelebiu e dëgjoi me qetësi këtë kërcënim dhe iu përgjigj se ai ishte i drejtë me të gjithë, se kështjella kishte qenë një strehë për piratët, se u kishte shkaktuar shumë vuajtje muslimanëve të rrethinave, dhe se popullsia aty pranë kishte ngulur këmbë për ta prishur atë. Gjithashtu, ai shtoi se nuk do të lejonte që kështjella të rindërtohej në këtë vend dhe caktoi një vend tjetër, në jug, ku mund të ndërtohej. Pra, piratët evropianë ndërtuan kështjellën Petronion në qytetin Bodrum (Halikarnasos). Me vendosjen e osmanëve në brigjet e Egjeut, administratorët gjenovezë të qyteteve Foça, Midil-li dhe Sakëz pranuan drejtimin osman, si dhe t'u paguanin atyre taksa.²¹⁴

Pasi u rivendos nga Emir Timuri, Bejliku i Karamanogllut (Karamanoğlu) nuk ishte i kënaqur edhe pse iu dhanë disa qytete të tjera shtesë nga tokat që kishte në zotërimin e tij më parë. Për këtë arsye, pushtoi edhe Bejlikun e Germijanit.²¹⁵ Ky bejlik i madh, pasi kishte trashëguar qytetin e Konjas, kryeqytetin e selçukëve, e shikonte veten si bejlik që do të bashkonte Anadollin nën flamurin e tij, në vend të Devletit Osman që në atë kohë ishte në një fazë rënie.

Duke pasur edhe mbështetjen e Jakub Beut të Germijanit dhe Isfendijar Beut të Xhandarit, i cili kishte dërguar djalin e tij Kasim Beun në krye të ushtrisë, ushtria osmane marshoi drejt Karamanogllut.

Ushtria osmane rifitoi Akshehirin, Saidelin, Bejshehrin, Otluk hisarin, të cilat më parë kishin qenë nën zotërimin e tyre, si dhe disa vende të tjera, pa hasur në rezistencën më të vogël. Ata rrethuan Konjan, por për shkak të shirave, nuk mundën ta merrnin dhe u nënshkrua një traktat për paqe me Mehemmed Beun e Karamanit. Më pas, duke parë që ushtria osmane ishte e lodhur dhe që Çelebi Mehemmedi ishte i angazhuar në Xhanik, Mehemmed Beu i Karamanit sulmoi sërish. Beteja u zhvillua në

214 OT, I, fq. 350-351; Danişmend, I, fq. 176.

215 Danişmend, I, fq. 173.

fushën e Konjës dhe Mehemed Beu u mund, dhe u largua drejt Tashelisë. Djali i tij, Mustafa Beu qëndroi në Konja. Bajezid Pasha, Veziri i Madh, luajti një rol tepër të rëndësishëm, duke ndikuar për faljen e Mehemed Beut nga osmanët dhe në vitin 818/1415 u nënshkrua një traktat. Sipas këtij traktati, osmanët do të rimerrnin Bej pazarin (Beğpazarı), Sivrihisarin, Akshehirin, Jalvaçin, Bejshehrin dhe Sejdishehrin, që më parë kishin qenë në zotërimin e tyre, por që i ishin dhënë Karamanogllut nga Timuri. Me këtë traktat, Karamanogllu pranoi të mbështeste osmanët, duke iu dhënë atyre ushtarë kur ata të kishin nevojë.²¹⁶ Pra, në këtë mënyrë, ishte evident fakti që Devleti Osman ishte i vetmi që kishte arritur të bashkonte muslimanët e Anadollit, duke e kthyer Bejlikun e Germijanit në vasalin e tyre dhe duke e vendosur Bejlikun e Karamanit në pozitën për të paguar tagër dhe për të vendosur disa nga ushtarët e tij nën komandën osmane.

Konflikti i parë detar osmano-venedikas

Flota osmane filloi të zhvillohej nga fundi i shekullit të 14-të, me aneksimin e bejlikeve të Saruhanit, Menteshesë dhe Ajdënit, duke siguruar kështu brigjet në Detin Egje. Jëlldërëm Bajezidi ndërtoi një kantier detar në Gelibollu dhe filloi aktivitetin e flotës me ndihmën e disa marinarëve vullnetarë. Në atë kohë, Republika e Venedikut ishte forca zotëruese në Mesdhe me një flotë detare të madhe. Venediku kishte si synim zotërimin e pjesës lindore të Mesdheut, duke qenë se kishte kolonitë e saj në Shqipëri, Greqi, brigjet e Moresë, si dhe në Qipro.

Ishujt e Kikladit shtriheshin në këtë rrugë detare dhe ishin kryesisht zona shkëmbore. Republika e Venedikut ia shiti këta ishuj **Pietro Zenos**, duke përcaktuar se dukati që do të krijohet do të ishte në varësinë e saj. Për shkak të keqtrajtimit të lundërtarëve muslimanë nga Pietro Zeno, osmanët përgatitën

216 OT, I, fq. 352-353.

flotën e tyre në Gelibollu dhe sulmuan ishujt Kiklad, dhe më pas ishullin Egriboz (Eğriboz), në vitin 818/1415, duke zënë robër dhe duke përfituar plaçkë luftime. **Admirali Pietro Lorendano** iu drejtua Gelibollut dhe shkatërroi flotën osmane një vit më vonë.²¹⁷ Ndërkohë që Devleti Osman përgatitej të rimëkëmbej nga kjo disfatë, kryengritja e **Shejhut Bedreddin**, u kthye në një rrezik në atë kohë, ndaj përgatitjet për ringritje nuk arritën të përfundonin.²¹⁸

Tagra e Mirçetas, vojvodës së Vllahisë

Musa Çelebiu ishte martuar me vajzën e Mirçetas, vojvodës së Vllahisë. Një pjesëtar i fisit të tij, **Dan**, kishte kontestuar Mirçetan në postin e tij. Çelebi Mehemmedi e mbështeti Danin, ndërsa Mirçeta iu drejtua Mbretit hungarez **Zigismund** për ndihmë. Çelebi Mehemmedi marshoi me ushtrinë e tij kundër ushtrisë së Mirçetas dhe e mposhti, duke i imponuar pagesën e një tagre, duke i marrë djalin si peng dhe duke e detyruar Mirçetan t'i dërgonte atij ushtarë gjatë fushatave luftarake. Në vitin 819/1416, Devleti Osman ndërtoi kështjellën e Jergogyt (Yergöğü) (Giurgu) në krahun tjetër të Danubit, në mënyrë që të siguronte nënshtrimin e vojvodës Mirçeta.

Gjithashtu, Çelebi Mehemmedi marshoi me ushtrinë e tij drejt Hungarisë, për shkak të mbështetjes që Mbreti Zigismund i kishte dhënë Mirçetas, dhe si mori kështjellën e **Shën Severinit**, rrethoi qytetin e **Bedkersburgut**. Forcat osmane nuk arritën ta hapnin këtë qytet ndaj Islamit, për shkak të trupave ushtarake që vinin nga Austria në ndihmë të tyre.²¹⁹

Bejliku i Xhandarogllut (Jandarogllu)

Kasim Beu i familjes së Bejlikut të Xhandarogllut kërkoi ndihmën e osmanëve kundër babait të tij, **Isfendijar Beut**. Ata

217 OT, I, fq. 354-355; Danişmend, I, fq. 174-175.

218 OT, I, fq. 355.

219 Danişmend, I, fq. 175-176.

pranuan ta ndihmonin dhe për pasojë, rrethuan qytezën e **Sinopit** në Bejlikun e Xhandarogllut. Por, ky i fundit pranoi sovranitetin osman, mbajti *hutbe* dhe *sikke* në emër të sulltanit, si shenjë të pranimit të tij. Isfendjar Beu ua dorëzoi osmanëve dhe jo djalit të tij, Kasim Beut,²²⁰ tërë bejlikun e tij (me përjash-tim të qyteteve Kastamonu dhe Bakër Kyresi). Qytezat osmane Tosja, Çankërë dhe Kalexhik, të cilat më parë ishin marrë nga Timuri dhe i ishin dhënë *Bejlikut* të Xhandarit, u kërkuan nga Mehemed Çelebiu që t'i riktheheshin. Ai i mori ato pa pasur nevojën të luftonte.²²¹

Problemi me Mustafa Çelebiun

Ndërkohë Mustafa Çelebiu (v. 1422), që ishte kapur rob së bashku me babain e tij Jëlldërëm Bajezidin, ishte liruar dhe kishte qëndruar për pak kohë në qytezën Nigde, në Bejlikun e Karamanit. Më pas, **Perandori romak Manuel** (sundoi 1391-1425) e transferoi atë në Evropë, si pjesë e fushatës së tij, për të nxitur krijimin e problemeve në territorin osman, duke vënë në lojë një *shehzade* kundër tjetrit. Për këtë arsye, **Çelebi Mehemedi** marshoi me ushtrinë e tij kundër Mustafa Çelebiut, që ishte strehuar në kështjellën e Selanikut (Thesalonikës), që ishte nën zotërimin romak. Kur Sulltan Mehemedi i kërkoi perandorit romak t'i dorëzonte Mustafa Çelebiun, ky i fundit iu përgjigj: "Mustafai do të qëndrojë këtu i burgosur deri sa ti të jetosh." Për këtë arsye, Çelebi Mehemedi e tërhoqi rrethimin e kështjellës së Selanikut dhe pranoi t'i paguante Perandorit Manuel një shumë vjetore prej **300.000 akçe**, për të mbuluar shpenzimet e Mustafa Çelebiut dhe burrave të tij për aq kohë sa ata do të ishin të burgosur.²²²

220 OT, I, fq. 357.

221 *Netajixh*, I, fq. 30.

222 OT, I, fq. 370-371.

Fundi i ndër-sundimit

Gjatë turbullirave të shkaktuara pas kapjes së Jëlldërëm Bajezidit, territori osman në rajonin e Anadollit u zvogëlua në disa sanxhakë: sanxhaku i Bursës, Izmitit, Ankarasë dhe Amasjas. Osmanët humbën Selanikun në Rumeli dhe disa zona të tjera në Serbi. Për shkak të krijimit të kësaj situate, shtetet e krishtera që u paguanin taksa osmanëve e ndaluan pagesën e tyre, por ata nuk kishin guximin dhe fuqinë të krijonin një forcë të bashkuar kundër osmanëve. Përkundër këtij shqetësimi në Devletin Osman, nuk u formua asnjë identitet tjetër politik dhe udhëheqësit e guximshëm, dhe të mirënjohur ushtarakë, të tillë si djemtë e Mihalit dhe Evrenosit, i qëndruan besnikë Devletit Osman.²²³

Nëse Jëlldërëm Bajezidi nuk do të ishte mundur, djali i tij më i madh, Emir Sylejmani, me shumë mundësi do t'ia kishte zënë vendin dhe kështu do të kishte vazhduar jetesën luksoze dhe pompoze që kishte mbizotëruar në kohën e babait të tyre. Por, Çelebi Mehemmedi, që tashmë kishte kaluar nëpër mundime dhe vështirësi të shumta, ishte i përgatitur të sundonte. Ai ishte i vendosur dhe i pjekur, dhe në këtë mënyrë, ai arriti me sukses të bashkonte dhe të siguronte stabilitetin e Devletit Osman.²²⁴

223 *Netajixh*, I, fq. 54-55.

224 *Netajixh*, I, fq. 55.



Xhamia e Gjelbër, Bursa

Emir Sylejmani filloi të ndërtonte një xhami në kryeqytetin Edrene dhe Musa Çelebiu e vazhdoi ndërtimin e saj, derisa kjo xhami u përfundua nga Mehemed Çelebiu në vitin 816/janar 1414. Kjo xhami njihet si “Eski Xhami” (xhamia e vjetër). Çelebi Mehemmedi ndërtoi në Bursa, Xhaminë e Gjelbër, një *medrese*, një *imaret* dhe Tyrben e Gjelbër. Pasi mori në vitin 823/1420 qytetet Hereke, Darëxha, Gebze, Kartall dhe Pendik, që shtriheshin në brigjet e Detit Marmara, të ardhurat që mblidheshin prej tyre ai i kaloi në një vakëf për institucionet e ndërtuara. Këto qytete iu morën Perandorisë Romake si një përgjigje ndaj mbështetjes që Perandoria i dha Mustafa Çelebiut. Frika e Perandorit Manuel arriti deri në atë shkallë, sa që ai dërgoi një misionar në Edrene për të biseduar për marrëdhëniet miqësore, por që në të vërtetë e kishte dërguar për të zbuluar qëllimin e Mehemed Çelebiut, nëse do të marshonte drejt Kostandinopojës, pasi kishte dëgjuar fjalë të tilla.²²⁵

225 OT, I, fq. 372.



Eski Xhami, Edrene

Çelebi Mehemmedi u sëmur në Edrene. Pasi e kuptoi se nuk do të shërohej, ai ftoi vezirët e tij Bajezidin, Çandarllëzade Ibrahimin dhe Haxhi Ivaz Pashanë, dhe iu kërkoi atyre që ta mbanin të fshehur lajmin për vdekjen e tij, derisa i biri Muradi, sanxhakbeu i Amasjas, të mbërrinte dhe të merrte postin e të atit, për shkak se afati i mbajtjes në burg të Mustafa Çelebiut në ishullin Limni nga perandori romak ishte në varësi të jetëgjatësisë të të atit. Ishte mjaft e qartë se perandori romak, sapo të merrte lajmin e vdekjes së Mehemed Çelebiut, do ta lironte Mustafa Çelebiun për të nxitur një luftë civile në territoret osmane. Shehzade Muradi ishte ftuar të shkonte në Edrene, por i ati i tij ndërroi jetë para se ai të mbërrinte atje. Vdekja e sulltanit u mbajt sekret deri në momentin që sulltani i ri mbërriti.²²⁶ Çelebi Mehemmedi është Përtëritësi (Muxheddid) i Shekullit të 9-të (sipas kalendarit Hixhri).

226 *Oruç Beğ*, fq. 78; *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 93.

3.2 Sulltan Muradi II 1421-1451

Gjatë kalimit të pushtetit, pas vdekjes së Çelebi Mehemmedit dhe ardhjes në sundim të djalit të tij, Muradit, disa bejlerë që dëshironin të ishin të pavarur nga osmanët si: Beu i Ajdënit, Menteshesë, Saruhanit dhe Hamidit u rebeluan.²²⁷ Kalimi i pushtetit nga babai tek i biri, ishte një praktikë që zbatohet në çdo vend në atë kohë dhe Devleti Osman doli nga periudha 11-vjeçare e ndërprerjes së sundimit. Vdekja e Çelebi Mehemmedit nxiti disa bejlerë të ktheheshin në bejlerë të pavarur dhe për pasojë, rivendosja e Devletit, duke i bashkuar edhe të gjitha bejliket (emiratet, principatat) nuk ishte një detyrë e lehtë.

Nga ana tjetër, Perandoria Romake e diskutonte dhe e vlerësonte situatën e krijuar sipas interesave të saj. Grupi i drejtuar nga **Joanisi**, djali i perandorit dhe partneri i tij në sundim, ishte i mendimit se ata duhet të mbështesnin Mustafa Çelebiun dhe ta bënë atë Sulltan të Rumelisë. **Perandori** i vjetër **Manuel** dhe grupi që e përkrahte, preferonte të mbështeste Muradin. **Joanisi** dhe përkrahësit e tij ishin këmbëngulës në mbështetjen ndaj Mustafa Çelebiut, që kishte premtuar t'iu jepte atyre Gelibollun dhe ky qëndrim u pranua.

Gjenerali **Dimitrijos Laskarius** u dërgua në ishullin Limni për t'u takuar me Mustafa Çelebiun. Ata nënshkruan një marrëveshje sipas të cilës: Mustafa Çelebiu do t'i bindej perandorit; do t'i dërgonte peng të birin; do të hiqte dorë nga qytetet Thesalia, Gelibollu dhe brigjet perëndimore të Detit të Zi deri në Vllahi, në Perandorinë Romake. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, Mustafa Çelebiu erdhi së bashku me Xhynejd Beun dhe disa njësi ushtarake romake drejt Gelibollut dhe më pas, iu drejtuan Edrenesë për të shpallur atje Sulltanatin në Dhilka'de 824/tetor 1421.²²⁸ Xhynejd Beu i Izmirit (Bejliku i Ajdënogllut) u bë vezir i këtij sulltani të ri. Pra, pjesa evropiane u vendos nën sundimin e Mustafa Çelebiut, ndërsa pjesa e Anadollit qëndroi

227 *Oruç Beğ*, fq. 78.

228 *OT*, I, fq. 376-377.

nën sundimin e Muradit.²²⁹ Perandoria Romake arriti të përmbushte me sukses planin e saj, për të përçarë Devletin Osman në dy pjesë.

Edhe pse administrata osmane e quajti “Mustafai Dyzme (i rrejshëm)”, këtij *Shehzade* iu bashkuan bejlerët e famshëm *akënxhinj*, djemtë e Evrenosit dhe të tjerë. Mustafa Çelebiu kaloi në rajonin e Anadollit dhe të dy ushtritë osmane u përballën me njëra tjetrën në Ullubad, ku do të ndodhte një katastrofë. Në këtë situatë kritike, një bej *akënxhi* (sulmues), **Mihalogllu (Mihalogllu) Mehmed** (v.1423), shkoi gjatë natës deri te lumi Ullubad dhe siguroi mbështetjen e disa bejlerëve *akënxhinj* ndaj Sulltan Muradit. Përveç kësaj, **Haxhi Ivaz Pasha**, veziri i Sulltan Muradit, i dërgoi një letër Mustafa Çelebiut, ku i shkruante, se beu dhe personalitete të tjera me influencë në pjesën osmane të Evropës, kishin vendosur të dezertonin dhe të bashkëpunonin me sulltanin. Në një letër tjetër drejtuar Xhynejd Beut, veziri i Mustafa Çelebiut, **Ivaz Pasha**, shkruante: “Ju jeni një njeri fisnik, një bej dhe personi për të cilin ju keni pranuar të jeni vezir, nuk është e sigurt nëse është Mustafa Çelebiu i vërtetë. Sulltan Muradi ju premton një pozicion të mirë në administratën osmane.” Po atë natë, **Haxhi Ivaz Pasha** mori me vete disa ushtarë deri te vendi që e saktësonte në letrën e tij dhe thirri: “Urime për shpërblimin e Sulltan Muradit”. Mustafa Çelebiu dyshoi se do ta arrestonin dhe për këtë arsye u arratis. Të njëjtën veprim bëri dhe Xhynejd Beu. Për pasojë, në vitin 825/1422, ushtarët e Mustafait iu bashkuan trupave të sulltanit dhe u vunë në ndjekje të **Mustafa Çelebiut**.²³⁰ Ky i fundit u kap dhe u ekzekutua në Edrene.²³¹ Nëse nuk do të kishte qenë mendjemprehtësia e **Haxhi Ivaz Pashait**, me mijëra luftëtarë mund të ishin vrarë në këtë luftë civile. Në fakt, osmanët pranonin të sakrifikonin jetët e *shehzadeve*, për të shmangur çdo lloj përpjekje për luftë civile, që mund të rrezikonte unitetin e Devletit Osman, sado e

229 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 93.

230 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 95.

231 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 98; *Netajixh*, I, 32.

largët të ishte kjo përpjekje. Për ta, **“gjithçka i përkushtohej Devletit dhe Devleti synonte mirëqenien e popullit.”**

Sulltan Muradi ishte i vendosur të ndëshkonte Perandorinë Romake për këtë kurth të tmerrshëm. Nga ana tjetër, Perandori Manuel dhe bashkëpunëtori i tij, Joanisi, u frikësuan. Ata i dërguan sulltanit, **Lakanasin** dhe **Marko Ganisin** së bashku me disa dhurata, me pretekstin për ta uruar atë, por në të vërtetë shkuan për të zbuluar qëllimet e sulltanit. Por, Sulltan Muradi e kundërshtoi ardhjen dhe dhuratat e tyre.²³²

Sulltan Muradi rrethoi Kostandinopojën në shenjë hak-marrjeje ndaj veprimeve të ndërmarra nga Perandoria Romake, që në vitin 1422, e sollën Devletin Osman në pragun e katastrofës. Por gjatë këtij rrethimi, Perandori i vjetër Manuel nxiti Iljasin, Llallanë (profesorin) e Mustafa Çelebiut, vëllain më të vogël të Muradit dhe sanxhakbeun e Hamidelisë, për të ngritur krye dhe për të shpallur pavarësinë. Bejlerët e Karamanit dhe Germijanit u përfshinë gjithashtu në këtë veprim. Kjo ushtri mbërriti në Bursa, por pushtimi i këtij qyteti, u shmang për shkak të dhuratave që iu dhanë Llallasë. Më pas, ata shkuan në qytetin e Iznikut, ku dhe krijuan një qeveri. Duke qenë i përballur me këtë kërcënim serioz, Sulltan Muradi e tërhoqi rrethimin e Kostandinopojës, sulmoi Iznikun dhe ekzekutoi Mustafa Çelebiun.²³³ **Mund të jetë e arsyeshme të besojmë se osmanët e mësuan dhe e zbatuan praktikën e vëllavrasjes nga administratorët e Perandorisë Romake, të cilët në këtë aspekt, ishin një model.**²³⁴ Nga ana tjetër, **“Duket se është një rregull**

232 OT, I, fq. 388-389.

233 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 99; *Netajixh*, I, fq. 33.

234 Anthony Bryer, *Peoples and Settlement in Anatolia and Caucasus, 800-1900*, (Londër: ribotimet Variorum, 1988), vëllimi IV, fq. 485, shënimi 3. Ky informacion është publikuar më parë në një artikull me titullin “Historianët grekë mbi turqit: rasti i martesës së parë bizantino-osmane”, në *Writing of History in the Middle Ages* (Oxford: Shtypi Klarendon, 1981), botim në të cilin shkruhet si vijon: **“Për sa i përket vëllavrasjes, është e vërtetë se Komneni i Madh Andronikos III, ekzekutoi vëllezërit e tij Mikael dhe Georgi kur mori fronin e Trebizondit në vitin 1332,**


që një princ turk nuk kënaqej kurrë me asgjë më pak se postin e sulltanit; dhe kthehet në një çështje nevojë të domosdoshme, jo në një çështje dyshimi xheloz, për t'ia bërë të pamundur atij arritjen e ambicies që kishte.”²³⁵

Perandoria Romake shpëtoi nga rrethimi duke përdorur dhe duke viktimizuar Mustafain e ri. Studiuesit perëndimorë e përmendin vëllavrasjen në Devletin Osman, por nuk përmendin faktin që ata e mësuan dhe e zbatuan këtë praktikë nga romakët! Është e sigurt se kjo vëllavrasje e administratorëve u praktikua mbi **Mikaelin** dhe **Georgin**, në vitin 1332, dhe se e para vëllavrasje mes pushtetarëve osmanë, ndodhi në vitin 1389.

përpara cilitdo rasti të njohur të vëllavrasjes osmane.” Theksimi i këtij paragrafi është bërë nga unë. Për më tepër, është një fakt i mirënjohur që Irena verboi djalin e saj 6 vjeçar, Kostandinin VI dhe sundoi Perandorinë Romake me emrin Augusta për 5 vjet: “Ajo (Irena) e transformoi qeverisjen e saj për djalin e saj Kostandinin VI në bashkëqeverisje dhe pas rrëzimit, dhe verbërimit të tij (797), qeverisi perandorinë si një sundimtare e vetme”. (*The Cambridge Medieval History*, botuar nga J.M. Hussey, Cambridge: 1967) IV, pjesa II, fq. 5.

“... Perandoresha Irena, bukuria perandorake, e cila si sundimtare e rriti djalin e saj në mënyrë të tillë, që ai të mos ishte i përgatitur për privilegjet mbretërore, dhe kur ai megjithatë u shpall, ajo e hoqi atë nga fronti dhe e verboi. Më pas, ajo mori emrin Shën Irena, pasi Kisha mbante mend vetëm devotshmërinë që ajo tregonte ndaj figurave...” Herbert J. Muller, *The Uses of the Past: Profiles of Former Societies*, (New York: Libraria e Re Amerikane, 1954) fq. 16. **Dhe është e panevojshme të thuhet se, ne nuk jemi në dijeni të ndonjë rasti vëllavrasjeje apo ndonjë praktike tjetër të ngjashme në radhët e turqve përpara osmanëve.**

235 Stanley Lane-Poole, *Turkey*, fq. 83. Ai përdor termin “perandori” në vend të termit “sulltanat”.



Xhamia e Haxhi Bajram Veliut, një Shejh i madh sufi, që ishte bashkëkohës i Sulltan Muradit II, Ankara

Situata në Rumeli

Ndërkohë që Sulltan Muradi ishte i zënë me këto probleme në Anadoll, princi i Vllahisë (Rumania Jugore e ditëve të sotme), **Vlad Drakul**, kaloi Danubin dhe plaçkiti territoret osmane. Vlad Drakuli kishte rrëzuar nga fronti Danin dhe e kishte zëvendësuar atë. Titulli i tij **Drakul** do të thotë **Satana**. **Firuz Beu** u dërgua në luftë kundër këtij Satanai dhe e mundi atë. Drakuli u detyrua të paguante taksa dhe t'ia dërgonte peng dy djemtë e tij osmanëve.²³⁶ Gjithashtu, ishte e nevojshme që Devleti Osman të rimerrte tokat e humbura në Shqipëri, gjatë periudhës së ndërprerjes së sundimit, në mënyrë që të mbronte dhe të vendoste sundimin e tij në rajonin e Ballkanit. **Isa Beu**, djali i Evrenos Beut, u dërgua në krye të një ushtrie të fuqishme në Shqipëri dhe avancoi në këtë territor deri në brigjet e Detit Adriatik. **Gjon Kastrioti** u mund gjatë këtyre fushatave

²³⁶ Neşri, *Cihan-Nüma*, Ankara, Turkish Historical Society, 1957, vëllimi II, fq. 578; *Netajixh*, I, fq. 36.

luftarake dhe djali i tij, **Gjergji**, u mor peng dhe u dërgua në Edrene. Në këtë vend, ai u konvertua dhe u quajt **Iskender Bej (Skënder Beu)**, por, më pas, ai do ta mohonte fenë dhe do t'i shkaktonte probleme Devletit Osman. **Isa Beu**, djali i Evrenos Beut, shkatërroi muret e qytetit të Korintit dhe hyri në More në vitin 826/1423.²³⁷

Situata në Anadoll

Ndërkohë që Sulltan Muradi ishte i zënë me vëllain e tij Mustafain, **Isfendijar Beu** i Bejlikut të Xhandarogllut pushtoi qytetet Çankëre, Tosja dhe Kalexhik, që ishin aneksuar nga osmanët, gjatë periudhës së Çelebi Mehemmedit. Ushtria osmane u përball me ushtrinë e Isfendijar Beut pranë Bollusë. Isfendijar Beu u mund dhe u largua drejt Sinopit. Megjithatë, ai u fal pasi u betua për besnikëri dhe përkrahje ndaj osmanëve në vitin 827/1423.²³⁸

Aneksimi i Bejlikut të Menteshesë 829/1425

Mehmed Beu i Menteshesë ishte midis bejlerëve, bejliket e të cilëve u rigjallëruan nga Emir Timuri, pas Betejës së Ankarasë. Pas vdekjes së tij, i biri, Iljasi, mori postin e Beut të Menteshesë. Gjatë luftës për pushtet midis shehzadeve osmanë, **Iljas Beu** mbështeti **Isa Çelebiun**, por në fund, në 817/1414, njohu sundimin e **Mehemmed Çelebiut** dhe nxori në qarkullim monedhën me emrin e tij në shenjë sovraniteti. Pas vdekjes së Iljas Beut në vitin 824/1421, dy djemtë e tij, që ishin mbajtur peng në pallatin osman, u arratisën dhe shkuan në qytetin e Menteshesë, ku u bënë sundimtarë të këtij vendi. Por **Sulltan Muradi**, i cili ishte i vendosur të krijonte bashkimin e Anadollit nën flamurin osman, shkoi në Mentеше, i kapi dhe i burgosi

237 Danişmend, I, fq. 190.

238 OT, I, fq. 393-394.

ata në kështjellën e Tokatit. Në këtë mënyrë, ai arriti të aneksonte Bejlikun e Menteshesë në vitin 829/1425.²³⁹

Aneksimi i Bejlikut Ajdënoğlu (Aydinoğlu) 829/1426

Xhynejd Beut iu dha Bejliku i tij i mëparshëm i Ajdënoğllut (Izmirit), dhe ai përdori çdo rast të mundshëm për ta zgjeruar territorin e atij bejliku në dëm të osmanëve. Sa herë që forcat osmane niseshin në luftë kundër atij, ai tërhiqej dhe kur ata largoheshin, ai fillonte sërish përpjekjet për ta zgjeruar këtë bejlik. Për këtë arsye, Bejlerbeu i Anadollit **Hamza Beu** dhe **Jahshi Beu** u dërguan kundër tij dhe e mundën atë. Bejliku i Ajdënoğllut u aneksua në vitin 829/1426.²⁴⁰

Bejliku Karamanoğlu (Karamanoğlu)

Ndërkohë që **Sulltan Muradi** ishte në pjesën evropiane të Devletit Osman, Mehemmed Beu i Karamanit, u përpoq të pushtonte kështjellën e Antaljas në vitin 830/1426, por ai vdiq gjatë këtij rrethimi.²⁴¹ Djali i tij, **Ibrahim Beu**, shkoi në Konja, por xhaxhai i tij, **Ali Beu**, e kishte marrë ndërkohë në dorë sundimin e Karamanit. Kështu, Ibrahim Beu u arratis së bashku me të vëllain, Isain, dhe u strehua tek Sulltan Muradi. Ky i fundit ju siguroi atyre mbrojtje dhe i martoi me dy motrat e tij.²⁴²

239 Neşri, II, 586; OT, I, fq. 400.

240 OT, I, fq. 401.

241 Kur Beu i Karamanit sulmoi territorin osman, në mungesë të sulltanit, që ndodhej në Evropë, një nga oborrtarët e tij tha me sarkazëm: "Sulltani ynë në këtë anë, dhe vëllai juaj, Janko, nga ana tjetër, po përpiqen të shkatërrojnë osmanët; besoj se për një kohë të shkurtër muslimanët do të bien nën këmbët e jobesimtarëve.", cituar nga Osman Turan, në: *Türk Cihan Hakimiyeti Mefkûresi Tarihi*, (Stamboll: Shtëpia Botuese Nakışlar, 1979), II, fq. 341.

242 Neşri, II, fq. 592; *Netajixh*, I, fq. 34.

Aneksimi i Bejlikut të Germijanit 832/1429

Jakub Beu II i Germijanit (sundoi 1387-1390, 1402-1429) kishte arritur një moshë të thyer pa pasur një djalë, që do ta trashëgonte bejlikun e të atit. Ai e donte shumë Sulltan Muradin, nipin e motrës së tij (bashkëshortja e Jëlldërëm Bajezidit, Devlet Hatun). Në 831/1428, Jakub Beu, që ishte më shumë se 80 vjeç, u nis për të vizituar Sulltan Muradin II. Ai u prit me respektin më të madh, pothuajse në të gjitha qytetet osmane gjatë rrugës së tij. Në qytetin Bursa, atë e takoi e gjithë popullsia e qytetit, ku ai vizitoi varret e sulltanëve osmanë dhe u shpërndaui pará qytetarëve. Ai vizitoi edhe **Shejhun Emir Sulltan**, Sufiun e Madh, dhe i puthi dorën në shenjë respekti. Kur ai mbërriti në qytetin e Edrenesë, ai u prit me aq shumë nderime sa që dhe Sulltan Muradi i dhuroi një sasi të madhe parash. Duke qenë se ishte një njeri shumë zemërgjerë, **Jakub Beu** e shpërndaui gjatë gjithë rrugëtimit të tij të gjithë pasurinë. Kur mbërriti në Gelibollu, ai i dërgoi lajm Sulltan Muradit duke i thënë: “Nuk më kanë mbetur më para, as për të paguar taksën e kalimit. Lejoje vëllain tim të më dërgojë para xhepi.” Sulltan Muradi i dërgoi atij një shumë të madhe parash duke i kthyer me shaka një përgjigje: “Hakk Te’ala më ka dhënë një vëlla të tillë që të ardhurat e mia nuk janë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e tij, si plotësim i të ardhurave të vendit të tij.”²⁴³ **Jakub Beu** e caktoi Sulltan Muradin si trashëgimtarin dhe pasardhësin e tij me testament, më pas u largua dhe u kthye në Kytahja. Edhe pse Jakub Beu kishte dy vëllezër, **Iljasin** dhe **Hëzërin**, si dhe nipër, ai zgjodhi Sulltan Muradin II si trashëgimtarin e tij. “Është e sigurt se pamundësia për t’i rezistuar Devletit Osman pati ndikim në preferencën e tij të përzgjedhjes, por, megjithatë, ky veprim i këtij njeriu të moshuar meriton vlerësim.”²⁴⁴ Pasi ai vdiq një vit më vonë, në vitin 832/1429, qyteti i Kytahjas u aneksua nga Devleti Osman. Kështu, me

243 Neşri, II, 604-606.

244 Danişmend, I, fq. 194.

përrjashtim të Bejlikeve të Karamanit dhe Xhandarogllut, i gjithë rajoni i Anadolllit, u bashkua nën sovranitetin osman. Drejtuesit e dy bejlikeve të lartpërmendura qëndronin në fuqi, në saj të mbështetjes së osmanëve, ndaj, për këtë arsye, edhe ata ishin nën ndikimin e tyre.²⁴⁵



Xhamia e Emir Sulltanit, Bursa.

Hapja e Selanikut dhe Janjas ndaj Islamit

Kështjella e Selanikut, e cila ishte marrë nga Jëlldërëm Bajezidi, u rimor nga Perandoria Romake pas betejës së Ankarasë. Sulltan Muradi dërgoi djemtë e **Evrenos Beut** së bashku me **Turahan Beun**, për të rrethuar Selanikun. I biri i **Manuelit, Andronikosi**, ishte despot i Selanikut. Popullsia e

245 *Netajixh*, I, fq. 35.

këtij qyteti, për shkak të vuajtjes nga uria, vendosi t'ia shiste qytetin Republikës së Venedikut, me kusht që Venediku t'iu jepte atyre ushqim dhe t'i trajtonte mirë, pavarësisht nëse Andronikosi do të pajtohej apo jo me këtë veprim. Venedikasit i pranuan këto kërkesa me kusht që populli të betohej për besnikëri ndaj tyre dhe e blenë qytetin e Selanikut për 50.000 monedha floriri. Andronikosi, që u sëmur rëndë, u dërgua në qytetin e Moresë në vitin 826/1423.

Sulltan Muradi nuk ishte dakord me marrjen e Selanikut nga venedikasit, megjithatë, në atë kohë, kishte probleme më shqetësuese që duhet t'i zgjidhte. Për këtë arsye, ai nuk e rinovoi traktatin për paqe me Republikën e Venedikut, ndërkohë që rinovoi traktatet me drejtuesit e Midil-lit, Sakëzitet dhe Rodosit. Republika e Venedikut dërgoi në Edrene misionarë për ta rinovuar këtë traktat, por Sulltan Muradi u tha atyre: "Selaniku është qyteti që e kam trashëguar nga babai im; gjyshi im, Bajezidi, e mori atë me forcë nga Perandoria Romake; nëse administrimi i këtij qyteti do të ishte në duart e romakëve, do të ishte e arsyeshme, që ata të ankoheshin nëse do të kishin pësuar ndonjë padrejtësi. Nga ana tjetër, ju jeni latinë, popull i Italisë, ndaj, cila është arsyeja për ndërhyrjen tuaj në këtë rajon? Ose e lini këtë qytet të lirë dhe largohuni me pëlqimin tuaj, ose do të vij unë."

Dhe në të vërtetë, **Sulltan Muradi** e rrethoi qytetin e Selanikut në vitin 833/1430 dhe më pas e hapi atë ndaj Islamit. Kjo ngjarje shkaktoi hidhërim të madh për Venedikun dhe pjesën perëndimore të Evropës. Sulltan Muradi vendosi në Selanik familje muslimane që i solli nga Jenixheja e Vardarit dhe nga qytete të tjera. Ai i caktoi popullsisë së krishterë Kishën e Ajadimitrit dhe kishat e tjera i ktheu në xhami.

Pas vdekjes së Despotit të Epirit **Karlotoxhi**, që e kishte njohur sundimin osman në këtë qytet, djemtë e tij filluan luftën mes tyre për pushtet. Njëri nga djemtë, **Menoni**, kërkoi mbështetjen e osmanëve. **Karaxha Pasha** u dërgua për të ndihmuar

Menonin, por popullsia që ishte mërzhitur nga kjo luftë për pushtet dhe që kishte filluar të pëlqente sundimin direkt nga osmanët, kërkoi ndihmën e sulltanit. Pasi e pranoi dëshirën e tyre, sulltani dërgoi Karaxha Pashanë, të cilit populli i dorëzoi qytetin e Janjës. Në 835/1431, atje u dërguan muslimanë për t'u vendosur.²⁴⁶

Aleanca serbo-hungareze me Karamanin

Despoti serb **Vulakogllu (Vulakoğlu)** luajti një rol të rëndësishëm për lidhjen e aleancës midis **Mbreti hungarez Zigismund** dhe **Ibrahim Beut** të Bejlikut të Karamanit (sundoi 1426-1464). Ushtria hungareze rrethoi Gyverxhinlikun (Kolombok) në brigjet e Danubit dhe Ibrahim Beu sulmoi dhe pushtoi Bejshehrin, të cilin osmanët e kishin blerë nga Bejliku i Hamidogllut (Hamidoğlut). Me këtë sulm të dyfishtë nga dy krahë, Sulltan Muradi nuk u hodh në sulm kundër asnjërit prej tyre, por qëndroi në Edrene në pritje. Ai dërgoi **Sinan Pashanë**, Bejlerbeun e Rumelisë, në ndihmë të ushtrisë që luftonte në Gyverxhinlik. Ndërkohë që Sinan Pasha priste të merrte informacione mbi rrethuesit, nga robërit e luftës, **Akënxhë Sinani**, Sanxhakbeu i Vidinit, sulmoi ushtrinë hungareze duke deklaruar: "Kuajt tanë do t'i shkatërrojnë stallat e tyre nga paniku që do të krijohet prej oshtimës së artillerisë"; dhe në të njëjtën mënyrë, edhe **Sinan Pasha** u hodh në sulm nën jehonën e daulleve duke thirrur *tekbire*. Ushtria, që kishte rrethuar qytetin, u mund dhe u largua e tmerruar duke mbishkelur njëri-tjetrin. **Zigismundi** (Mbret i Hungarisë 1388-1437 dhe Perandor i Gjermanisë 1411-1437) me vështirësi i shpëtoi vdekjes, duke lënë pas mjetet e rënda të transportit të ushtrisë së tij. Shumë nga ushtarët e tij u mbytën në lumin e Danubit. Në këtë mënyrë, në vitin 837/1434, kështjella e Gyverxhinlikut shpëtoi nga pushtimi.²⁴⁷

246 OT, I, fq. 408-411.

247 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 114; Neşri, II, fq. 616.

Pas një viti, Sulltan Muradi kaloi në rajonin e Anadollit dhe marshoi kundër Ibrahim Beut të Karamanit, që u tërhoq në qytetin Tasheli dhe shkroi një letër ku i kërkonte ndjesë sulltanit. Sulltani e fali atë me kërkesë të bashkëshortes së Ibrahim Beut, që ishte dhe motra e tij.²⁴⁸

Fushata në Rumeli

Kur Sulltan Muradi u kthye nga fushata e tij në Karaman, ishte radha e Despotit serb të ndëshkohej; **Is'hak Beu**, Sanxhak-beu i Shkupit, e kishte informuar sulltanin se Despoti serb kishte luajtur një rol të rëndësishëm në lidhjen e aleancës midis Karamanogllut dhe Mbretit të Hungarisë.

Ndërkohë që Sulltan Muradi po përgatitej për të marshuar me ushtrinë e tij kundër Despotit serb, ky i fundit lajmëroi se e bija e tij, për të cilën ishte vendosur të martohej me sulltanin, ishte gati të nisej për atje. Sulltani e priti nusen,²⁴⁹ por nuk zhvilloi asnjë ceremoni martesore duke thënë: “Nuk është e nevojshme të zhvillojmë asnjë ceremoni martesore për vajzën e këtij *kafiri*”, dhe nuk e mbajti nusen në kryeqytetin Edrene, por e dërgoi në Bursa, pasi ishte ende i inatosur me babanë e saj. Ai mori në Edrene bashkëshorten e tij të parë, Hatixhe Hatunen, mbesën e Isfendijar Beut të Bejlikut të Xhandarit. Kjo zonjë ishte dhe e ëma e Fatihut (hapësit) të Stambollit (ndaj Islamit).²⁵⁰

Bejlerbejtë Sinan Pasha, Is'hak Beu dhe Turahan Beu sulmuan Shqipërinë.²⁵¹ Ndërkohë që Sulltan Muradi ishte i angazhuar me Karamanogllunë në Anadoll, Mbreti i Hungarisë, **Zigismundi**, kishte dërguar njësitë e tij ushtarake për të sulmuar dhe për të plaçkitur rrethinat e Allaxhahisarit.²⁵² Pasi i kishte ndëshkuar dhe frikësuar aleatët e Mbretit Zigismund,

248 Neşri, II, fq. 618; *Netajixh*, I, fq. 36.

249 Ajo ishte Maria Brankoviç; babai i saj ishte Gjorgje Brankoviç dhe e ëma ishte motra e Perandorit të Trabzonit; *OT*, I, fq. 413.

250 Neşri, II, fq. 620.

251 *Oruç Beğ Tarihi*, fq. 85.

252 *OT*, I, fq. 416.

duke arritur kështu ta izolonte atë, Sulltan Muradi, vendosi të marshonte kundër tij. Pasi u kthye nga fushata luftarake në Karaman, në vitin 840/1437, sulltani urdhëroi **Ali Beun**, djalin e Evrenos Beut, të fillonte sulmet për të hapur rrugën drejt Hungarisë. Për një periudhë kohe një mujore, Ali Beu sulmoi tokat e Hungarisë dhe në kthim tha: “Sulltani im! A nuk është për të ardhur keq që një vend kaq i bukur, të qëndrojë në duart e *kafir*it !”²⁵³ Me këtë thënie të tij manifestohet arsyeja e ekzistimit të Devletit Osman. Ata e shikonin veten si përfaqësues dhe përcjellës të Mesazhit të Fundit, Islamit, dhe si mjet të zbatimit të Urdhëresave të Shenjta të Krijuesit në mbarë botën. Ndërsa në Kur’an thuhet: “... me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi më të mirë.” [el *Enbija*, 105]. Për këtë arsye, është më se e natyrshme, që në çdo vend, veçanërisht në vendet më të mira të botës, ata që i përulën dhe i nënshtrohen urdhëresave të Krijuesit (që do të thotë muslimanët), që përpiqen t’i përhapin këto urdhëresa dhe t’i kthejnë ato në epërsi, duhet të sundojnë. **Kjo pikë është shumë e rëndësishme: ekspansioni i osmanëve ishte domosdoshmëri e “besimit”, “të qenët” një Devlet që zbatonte Urdhëresat e Shenjta mbi Tokë. Ekspansioni i imperialistëve perëndimorë nuk ka asnjë kuptim tjetër veç faktit që “ata që kanë në dorë fuqinë, mund të bëjnë gjithçka që dëshirojnë, dhe se ata mund ta përdorin këtë fuqi për përfitimet e tyre”,²⁵⁴ ashtu sikurse do të vepronte dhe një njeri primitiv. Kjo për arsye se qëndrimi i tyre nuk varej nga *Haku*.²⁵⁵ Në terminologjinë Islame, *Hak* është një nga atributet e Allahut. Muslimanët e quajnë atë ‘Hakk Te’ala’ (Haku Sublim).**

Në këtë sulm të fuqishëm, aleatët e mëparshëm të Hungarisë, Despoti i Serbisë, **Brankoviçi**, dhe Vojvoda i Vllahisë, **Vlad**

253 Neşri, II, fq. 622.

254 Duket se mentaliteti perëndimor nuk ka ndryshuar shumë edhe në ditët e sotme në mbarë botën; uria, deprivimi qëndrojnë jashtë sferës së tyre.

255 Termi *Hak* ka kuptime të ndryshme. Disa prej tyre janë: e vërteta, realiteti, drejtësia, e drejta, ajo që të takon.

Drakul, morën urdhra nga sulltani dhe iu bindën së bashku me ushtarët e tyre komandave të **Ali Beut**.²⁵⁶

Në vitin 841/1437, **Sulltan Muradi** kaloi Danubin dhe hyri në territorin e Transilvanisë. **Brankoviçi**, Despoti serb (sundoi 1427-1450), dhe Princi i Vllahisë, **Vlad Drakul** (sundoi 1432-1446), u bashkuan me ushtrinë osmane dhe morën gjashtë kështjella, ndërsa Mbreti i Hungarisë nuk doli në skenë,²⁵⁷ pasi në atë kohë, **Zigismundi**, Perandor i Gjermanisë dhe Mbreti i Hungarisë, kishte vdekur, ndërsa dhëndri i tij, **Alberti**, kishte marrë fronin si Mbreti i Hungarisë, dhe një vit më pas u zgjodh edhe Perandor i Gjermanisë.²⁵⁸

Me përfundimin e fushatës luftarake në Hungari, **Gjorgje Brankoviçi**, besnikëria e të cilit po zbehej, u ftua në Edrene për të sjellë çelësat e Semendires, por ai shkoi te Mbreti i Hungarisë dhe njëherësh Perandori i Gjermanisë, **Albert**. Forcat ushtarake osmane rrethuan Semendiren dhe **Is'hak Beu**, i cili ishte kthyer në zonën që ai e njihte mjaft mirë, pasi kishte përfunduar detyrimin e tij të *haxhit*, mori komandën e forcave muslimane dhe e hapi kështjellën ndaj Islamit. Ndërkohë, një ushtri e madhe hungareze mbërriti në këtë vend dhe **Gazi Is'hak Beu**, dhe **Osman Beu**, nipi i **Timurtash Pashait**, u përballën me këtë ushtri dhe e mundën atë. Nga kjo betejë, ata përfituan shumë robër lufte dhe një sasi të madhe *ganimedi* (plaçkë lufte). Historiani i mirënjohur **Ashëk Pashazade** mori pjesë në këtë betejë.²⁵⁹ Sho i shpjegon në mënyrë të admirueshme arsyet për këto fitore të mëdha, si më poshtë vijon:

“Në të gjitha këto përparime drejt Evropës, Muradi përfitoi nga të gjitha tensionet shoqërore, fetare dhe ekonomike që po copëtonin shoqërinë brenda territorit të armiqve të tij. Ai ishte i aftë t’iu ofronte fshatarëve të shtypur të Ballkanit një revolucion

256 Danişmend, I, fq. 2014.

257 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 118; *Oruç Beğ Tarihi*, fq. 87.

258 *OT*, I, fq. 416 dhe poshtëshënimi 2.

259 *OT*, I, fq. 418.

shoqëror, liri nga tirania e pronarëve të tyre feudalë. Brenda rajonit të Ballkanit, luftërat e shteteve për pushtet i kishin dhënë fund autoritetit qendror, duke lejuar, në këtë mënyrë, fuqizimin e mëtejshëm të manjatëve të mëdhenj feudalë dhe nënshtrimin e kultivuesve ndaj kushteve tiranike të pagesës së taksave dhe punës së sforcuar. Në kontrast me këtë situatë, kudo që osmanët themelonin administratën e tyre, e gjithë toka kthehej në pronësi të sulltanit. Shteti vendosi kontroll dhe vëzhgim të rreptë për çifligarët, ndërkohë që iu dha fund detyrimeve mbi pronën dhe punës së sforcuar – kjo e fundit u zëvendësua me një taksë lehtësisht të pagueshme, e njohur si taksa e plugimit (*çift resmi*). Në këtë mënyrë, pjesa më e madhe e popullsisë së Ballkanit ishte më pasive kur bëhej fjalë për të mbështetur ushtritë e drejtuesve të tyre dhe ushtritë kryqtare në luftën kundër muslimanëve.”²⁶⁰



Medreseja Muradije, Bursa.

Në Bohemi kishte filluar një garë për pushtet që pothuajse ishte shndërruar në luftë pas vdekjes së **Albertit** – një situatë

260 S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 50-51.

kjo që përgatiste kushtet e përshtatshme për Devletin Osman. Për këtë arsye, Sulltan Muradi ngarkoi **Ali Beun**, djalin e Evrenos Beut, të merrte Beogradin, që shtrihej në bregun jugor të Danubit, dhe që ishte me rëndësi të madhe strategjike. Ata e rrethuan Beogradin në vitin 843/1439, arritën të hynin dhe në qytet, por nuk u arrit *fet'hi* (hapja) i tij.²⁶¹

Lufta me hungarezët vazhdonte. **Mezid Beu** hyri në Transilvani me një forcë *akënxhë* në vitin 845/1442, shkatërroi një njësi ushtarake hungareze dhe rrethoi qytetin **Hermanshtad**. Në këtë kohë hyri në skenë **Janosh Hunjadi**, dhe Mezid Beu, që ishte midis këtyre dy forcave luftarake, ra martir dhe forcat osmane pësuan disfatë. Kjo betejë i dha një famë të vërtetë **Janosh Hunjadit** në mbarë Evropën. Në mënyrë që të shlyente këtë humbje, **Kula Shahin Pasha**, Bejlerbeu i Rumelisë, u dërgua në luftë kundër hungarezëve, por për shkak të krenarisë së tij dhe nënvlerësimit për të marrë masat paraprake, ai dhe ushtria e tij u shkatërruan në Vazag nga **Janosh Hunjadi**. Pas këtyre fitoreve të njëpasnjëshme kundër osmanëve, u krijua një ushtri kryqtare dhe mbreti i Hungarisë dhe Polonisë, **Ladislavi**, u vendos në drejtimin e kësaj ushtrie, ndërsa **Janosh Hunjadi** në pozicionin e komandantit suprem të saj. Kjo ushtri e madhe shkatërroi ushtrinë osmane në Moravë dhe Izaldi. Atëherë, midis Devletit Osman dhe Mbretit të Hungarisë, Ladislavit, u nënshkrua traktati i paqes i **Edrene-Segedinit** për 10 vjet, më 25 Rebi'ul Evvel 848/12 korrik 1444.²⁶²

Duke arritur në këtë mënyrë sigurinë për pjesën evropiane, **Sulltan Muradi** marshoi me ushtrinë e tij kundër **Ibrahim Beut** të Bejlikut të Karamanit, që kishte sulmuar territoret osmane në Anadoll. Muradi kishte nevojë për *fetva* (mendim ligjor dhe leje) për të luftuar kundër një Devleti Musliman dhe ai e mori *fetvanë* për të luftuar kundër Beut të Karamanit nga këshilli i juristëve, të përbërë nga juristë të katër *medhhebeve*: Shafi'iu **Ibn Haxher el-**

261 OT, fq. 419.

262 OT, fq. 419-427; Danişmend, *vepër e cituar*, I, fq. 209-210.


Askalani (v.852/1448), Hanefiu Kadilkudat dhe Shejhulislam **Sa'deddin ed Dejri** (v.868/1462), Malikiu Kadilkudat dhe Shejhulislam **Bedreddin et Tunisi** (v.853/1449), Hanbeliu Kadilkudat dhe Shejhulislam **Bedreddin Bagdadi** (v.857/1453).²⁶³ Ibrahim Beu nuk mund të përballej me Sulltan Muradin dhe për këtë arsye u tërhoq sërish drejt Tashelisë. Ai ishte i martuar me motrën e Sulltan Muradit dhe pasi dërgoi bashkëshorten që t'i kërkonte falje në emrin e tij, ai kërkoi paqe nga sulltani. Sulltan Muradi e fali atë dhe me Bejlikun e Karamanit u arrit marrëveshje për paqe.

3.3 Abdikimi i Sulltan Muradit

Ndryshe nga bashkëkohësit e tij në Evropë dhe gjetiu, Sulltan Muradi, nuk ishte një sovran absolut që do të qëndronte në pushtet deri në ditët e fundit të jetës së tij. Përkundrazi, ai ishte një *gazi* (luftëtar në luftën e shenjtë kundër jobesimtarëve); një sundimtar i arsyeshëm, si dhe një *sufi* dhe një *veli* i devotshëm. Sipas një historie, ai kishte parë në ëndërr tre engjëj që ndriçonin në qiell, mbi tre vende të ndryshme në oborrin e xhamisë, që ai kishte ndërtuar në Edrene.²⁶⁴ Ai ngriti nga një shtyllë prej mermeri të gjelbër, në secilin nga këto vende që të mos shkeleshin nga këmbë njeriu dhe këto tri shtylla qëndrojnë ende në vendet ku u ngritën, në oborrin e xhamisë së tij.

263 OT, fq. 428, poshtë-shënimi 1.

264 Edhe pse e mirënjohur me emrin "yç sherefli" (që ka tre "sherefe", apo vende për thirrjen e ezanit në minare), në të vërtetë, kjo xhami ka 4 minare.



Tri shtyllat e mermerit në oborrin e Xhamisë Yç Sherefeli, Edrene

Ashtu sikurse veproi edhe Sufiu i Madh, **Ibrahim Ibn Adham** (*kuddise sirruhu*)²⁶⁵ (v.166/783), Muradi hoqi dorë nga froni vullnetarisht. Megjithatë, përpara se të abdikonte, ai u këshillua për këtë çështje me Vezirin Halil Pasha dhe mori masat e nevojshme për t'ia kaluar pushtetin në mënyrë paqësore, djalit të tij, Mehemmedit, Sanxhakbeut të Magnisë (Manisës). Kështu, Muradi u tërhoq në vitin 1444 në Magnisa, me shpresën për ta kaluar pjesën tjetër të jetës me lutje paqësore dhe në qetësi.²⁶⁶ Ai kishte bërë të pamundurën për të ruajtur unitetin e Devletit, për të siguruar unitetin e muslimanëve në

265 Ibrahim Ibn Adham Mensür ishte një princ në Belh, i cili u bë Sufi i madh (*veli*) dhe hoqi dorë nga froni. Ai ra martir gjatë një fushate të xihadit kundër romakëve. (IA, V, 886).

266 Neşri, II, fq. 647; *Oruç Beğ Tarihi*, fq. 92; Solakzade Mehmed Hemdemi, *Solakzade Tarihi*, (Stamboll, 1298) fq. 173. Sipas burimeve osmane, ai u tërhoq në qytetin Manisa, ndërsa, S. Shaw thotë, pa përmendur asnjë fakt të besueshëm, se ai u tërhoq në qytetin Bursa (S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 52).

vendin e tij dhe me dorëheqjen që dha nga posti i sulltanit, kur ai mendoi se ishte koha, Muradi tregoi madhështinë e bujarisë dhe guximit të tij. Duhet të kuptojmë se ai nuk mund ta kishte bërë një gjë të tillë më parë: le të supozojmë se ai ia linte pushtetin xhaxhait të tij, Mustafa Çelebiut, dhe tërhiqej në një fermë, por pa kaluar shumë kohë, disa njerëz do t'i mblidheshin rreth, dhe do ta nxisnin atë ta rikthente pushtetin me shpresën për të fituar për veten e tyre poste në administratën e re, nëse do të bazoheshim në sjelljen dhe qëndrimin e njëjtë të disa militantëve partiakë në ditët e sotme. Nga ana tjetër, disa nga zyrtarët e lartë mund të nxitnin dyshimet e Mustafa Çelebiut për qëllimet e Muradit. Pra, Muradi mund të mos kishte pasur një jetë të paqetë dhe të qetë. Në atë kohë, nuk kishte demokraci që të lejonte ish-sundimtarët të tërhiqeshin të qetë drejt rezidencave të tyre në një mjedis paqedashës.

Armiqtë e Devletit Osman, e nuhatën përparësinë që do të kishin me kalimin e pushtetit nga veterani Murad te djali i tij pa përvojë: **Kardinali Cezarini**, përfaqësuesi i **Papës**, iu drejtua menjëherë **Mbretit Ladislav**, duke i thënë se kjo ishte e vetmja mundësi për t'i larguar turqit nga rajoni i Evropës. **Kardinali Kondolmieri**, që drejtonte flotën e Papatit, që përbëhej prej 65-70 anijesh, dhe që, në atë kohë, ndodhej në Detin Egje, i dërgoi një letër Mbretit të Hungarisë, ku i bënte thirrje të përfitonte nga kjo mundësi, duke shtuar se ai do të nisej për në Galipoli, që t'i ndalonte turqit të kapërcenin Ngushticën e Dardaneleve drejt Evropës. **Perandori romak Joanis Paleologos** i dërgoi gjithashtu, një letër Mbretit të Hungarisë për të njëjtën çështje.²⁶⁷ Nga ana tjetër, edhe **Ibrahim Beu** i Karamanit, dëshironte të përfitonte nga kjo situatë dhe për pasojë, iu dërgoi lajm armiqve evropianë, se nëse ata do të sulmonin nga ana e tyre, edhe ai ishte i gatshëm të sulmonte nga Anadoli. Ai deklaroi se Sulltan Muradi, për shkak të sëmundjes së tij mendore, ishte i detyruar të jepte dorëheqjen dhe t'ia kalonte Hilafetin djalit të tij 12-

267 Danişmend, I, fq. 213.

vjeçar.²⁶⁸ Kështu, me iniciativën e Komandantit të famshëm hungarez **Janosh Hunjadi**, sovranët e Hungarisë, Gjermanisë, Hercegovinës, Vllahisë, Bogdanit dhe Venedikut formuan një ushtri të bashkuar aleate kundër osmanëve. **Papa** i çliroi ata nga detyrimi për marrëveshjen e mëparshme të armëpushimit 10-vjeçar, me pretekstin se betimet që bëheshin me “të pafetë” nuk ishin të detyrueshme të zbatoheshin.²⁶⁹

Armata e bashkuar e krishterë, kaloi kufirin osman, ndër-kohë që flota venedikase u pozicionua në Ngushticën e Dardaneleve, duke e bllokuar atë në mënyrë që të mos lejonte asnjë lëvizje të osmanëve nga Anadulli për në Evropë. I përballur me këtë situatë kritike dhe i nxitur nga vezirët e tij, Sulltan Mehemedi II, thirri babain, Muradin, i cili kaloi Bosforin drejt Evropës, pasi Ngushtica e Dardaneleve ishte bllokuar nga anijet e flotës së krishterë. Ky kalim u bë i mundur vetëm pasi iu pagua Gjenovës nga një monedhë floriri për çdo ushtar.²⁷⁰ Ushtria osmane, edhe pse mjaft inferiore në numër, u përball me ushtrinë e të krishterëve në Varna më 28 Rexheb 848/10 nëntor 1444. **Sulltan Muradi** ngriti lart, të kapur në majën e një heshte, në krye të ushtrisë së muslimanëve **Traktatin e Segedinit**, për t’iu kujtuar të krishterëve shkeljen e betimit. **Janosh Hunjadi** sulmoi dhe shkatërroi krahun e majtë të ushtrisë osmane, ndërsa krahu i djathtë i kësaj ushtrie zbrapsi forcën sulmuese vllahë. Pjesa qendrore e ushtrisë osmane u detyrua të tërhiqej, edhe pse **sulltan Muradi** qëndroi duke luftuar në fushëbetejë së bashku me një numër të vogël jeniçerësh. Kur u zu në pozicion të vështirë, ai mori në konsideratë mendimin për t’u tërhequr, por Komandanti i ushtrisë së tij, **Karaxha Beu**, ishte i ndërgjegjshëm për ndikimin që do të kishte kjo lëvizje mbi moralin e ushtrisë së tyre, dhe e ndaloi atë duke e kapur nga kapistra e kalit. I dëshiruar për të marrë fronin e Hungarisë, **Janosh Hunjadi** i provokonte fisnikët

268 *Netajixh*, I, fq. 38.

269 S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 52.

270 *OT*, I, fq. 434.

hungarezë dhe i nxiste kundër turqve, por i braktiste ata gjithnjë në fushën e betejës në momentin e fundit, duke i lënë të mundeshin nga turqit. Në të njëjtën mënyrë, ai e shtyu mbretin e Hungarisë të sulmonte duke i thënë: “Ushtria turke ishte shkatërruar; tani është më mirë të sulmohesh sulltanin.” I nxitur nga Janosh Hunjadi, **Mbreti Ladislav** avancoi deri pranë vendit ku luftonte sulltani. Njëri prej ushtarëve jeniçerë të sulltanit, **Timurtashi**, e goditi njëren këmbë të kalit të mbretit me një sëpatë, duke arritur ta rrëzonte kalin dhe mbretin, ndërsa një oficer tjetër jeniçer, **Hëzëri**, ia preu kokën mbretit. Koka e Ladislavit u ngul mbi majën e një shtize dhe ushtria muslimane thirri njëzëri *tekbir*. Kjo i frikësoi ushtarët e krishterë, të cilët u kthyen nga kishin ardhur, por shumë prej tyre u vranë në fushën e betejës gjatë rrugës së kthimit.²⁷¹ “Me vështirësi të madhe, Hunjadi arriti t’i shpëtonte ushtrisë osmane, ndërkohë që me mijëra kalorës vriteshin. Shpresat e evropianëve për një fitore kryqtare u shkatërruan. Fati i Perandorisë Bizantine u vulos. Prestigji otoman u rrit më tepër në të gjithë botën muslimane dhe sundimi otoman i pjesës juglindore të Evropës u sigurua edhe një herë.”²⁷²

I tërbuar për shkak të tradhtisë së Ibrahim Beut, djali i Sulltan Muradit II, Mehemmedi, i dërgoi atij një letër në të cilën i shprehte zemërimin e tij. Kjo letër fillonte me një citim nga Kur’ani: “Në zemrat e tyre kanë sëmundje” [*el Bekare*, 10], dhe vijonte: “Me nxitjen dhe kandisjen e të pabesëve të këtij rajoni (Anadollit), moria e të pafeve e shkeli marrëveshjen dhe sulmoi ... por me ndihmën e Allahut, muslimanët i mundën ata në Varna.” Ai e përfundoi këtë letër me një thënie të mirënjohur të Pejgamberit (s.a.v.s) të cituar pas hapjes së qytetit të Mekës ndaj

271 Neşri, II, fq. 653; *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 128. Lord Kinros, *The Ottoman Centuries, the Rise and Fall of the Turkish Empire* (New York, 1977), fq. 91: Mbreti Hungarez Lazlo “u hodh nga kali dhe u vra në fushën e betejës, koka e tij u ngul në majën e një heshte, ndërsa një heshtë tjetër kishte shpuar një kopje të fletës së traktatit të shkelur, si për t’iu shërbyer trupave osmane si një mësim për pabesinë e të krishterëve.”

272 S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 53.

Islamit në vitin 8/630, "I lavdëruar qoftë Allahu, që ndihmoi robin e Tij dhe mbështeti ushtrinë e tij."²⁷³

Pas betejës së Varnës të vitit 1444 dhe me kërkesën e të birit, Mehemmedit, Sulltan Muradi mori sërish pozitën e sundimtarit dhe i biri u kthye në sanxhakun e Manisës. Kur u nis drejt Varnës, Sulltan Muradi u përpoq të kalonte Ngushticën e Dardaneleve, por ajo ishte e bllokuar nga flota venedikase, forca më e fuqishme detare e shekullit të 15-të. Osmanët iu kundërpërgjigjën këtij bllokimi duke avancuar drejt Gadishullit të Moresë (Peloponezitet), që në atë kohë ishte nën sundimin e Venedikut. **Sulltan Muradi** arriti të shkatërronte fortifikimet e armikut dhe të merrte nën kontrollin e tij këtë gadishull në vitin 850/1446. Despoti i gadishullit kërkoi faljen e tij.²⁷⁴

Beteja e dytë e Kosovës 852/1448

Janosh Hunjadi luajti një rol kryesor për nënshkrimin e një traktati tjetër midis sovranëve të Polonisë, Çekisë, Vllahisë dhe Bogdanit, kundër osmanëve. Ata krijuan një armatë të madhe të krishterë që kaloi Lumin Danub dhe mbërriti në Kosovë. Sulltan Muradi, nga ana e tij, mblodhi një ushtri të madhe, e cila u përball me armikun në Betejën e Dytë të Kosovës, në vitin 852/1448. Përpara zhvillimit të betejës, Sulltan Muradi, fali dy rekate *haxhe* namaz dhe iu lut Krijuesit t'i falte fitoren kundër jobesimtarëve.²⁷⁵ Sulltan Muradi ia dërgoi lajmëtarët e tij Janoshit për të vendosur një traktat për paqe, por ai nuk pranoi.²⁷⁶ Të dyja ushtritë pritën një ditë dhe një natë, më pas, filluan gjuajtjet me artileri, armë zjarri dhe me shigjeta.²⁷⁷ Beteja zgjati dy ditë dhe dy net dhe ushtria e krishterë u mund; **Janosh**

273 Feridun Beğ, *Münsheat*, vëll. I, fq. 233-235.

274 *Oruç Beğ, vepër e cituar*, fq. 93; *Netajixh*, I, fq. 39.

275 Neşri, II, *vepër e cituar*, fq. 665.

276 Hammer, përkthyer nga *Ata*, vëll. II, fq. 273, cituar në OT, I, fq. 447.

277 *Lütfi Paşa Tarihi*, fq. 163, cituar në OT, I, fq. 447.

Hunjadi u arratis gjatë natës dhe dy **banë**²⁷⁸ u vranë, ndërsa bani i Çekisë dhe bani i Polonisë u kapën rob. Princi i Polonisë arriti të maskohej, u shit si një rob ordiner lufte dhe pasi iu shit disa herë personave të ndryshëm, arriti të fitonte lirinë e tij.²⁷⁹ Sulltan Muradi e pyeti banin e Çekisë: “Pse sulmuat kundër nesh, kur ne nuk treguam ndaj jush armiqësi?” Ai iu përgjigj se kishte qenë e caktuar që ai të ishte një rob lufte në këtë situatë. Më pas, ai i ofroi Sulltan Muradit 10 kështjella dhe rrethinat e tyre, mbledhjen e taksave nga çdo cep i vendit të tij dhe shërbimin me 5.000 ushtarë çdo vit. Por, sulltani iu përgjigj duke thënë: “Nuk kam nevojë për ato gjëra që ti m’i ofron”. Dhe pastaj, *kafiri* iu përgjigj: “Ai që i kundërvihet një sulltani të fuqishëm dhe të pasur, nuk meriton tjetër veç fatkeqësisë”. Dhe ai u ekzekutua.²⁸⁰ Qëndrimi që mbajti Sulltan Muradi, është në përputhje të plotë me *ajetin* që iu kushtohet robërve të kapur në betejën e Bedrit (të vitit 2/624).²⁸¹ Ky qëndrim tregon, se vlerat e

278 Në gjuhën sllave *ban* do të thotë “princ”, “sovrani në gradë të ulët”: Mehmet Zaki Pakalin, *Osmanlı Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü*, Stamboll, 1993, vëll. I, fq. 158.

279 *Netajixh*, I, fq. 40.

280 Neşri, vëll. II, fq. 672.

281 Ajetet 67, 68 të Sures *el-Enfal*, u shpallën në lidhje me robërit e betejës së Bedrit. Veprimi dhe qëndrimi i Sulltan Muradit është në përputhje me këto ajete.

Një luftë e zakonshme mund të bëhet për shkaqe terroresh apo tregëtie, hakmarrjeje apo lavdie ushtarake – të gjitha këto “të mira të përkohshme të kësaj bote”. Një luftë e tillë është e dënueshme. Por, një luftë xihadi ndërmerret në kushte të rrepta të caktuara nga rregullat e Islamit dhe vetëm në emër të çështjes së Allahut. Të gjitha motivet e tjera të ulta përjashtohen rreptësisht. ...Edhe Jezusi, misioni i të cilit ishte më i kufizuar, ka thënë: “Mos mendoni se kam ardhur për të sjellë paqen mbi tokë: Unë nuk kam ardhur për të sjellë paqen, por një shpatë.” (Mateu, X, 34), cituar nga Abdullah Yusuf Ali, *Holy Qur’an*, fq. 431, poshtëshënimi 1234.

Ajetet 67-69 të Sures *el-Enfal*, u shpallën kur Profeti i Bekuar vendosi t’iu falte jetën robërve të kapur në betejën e Bedrit, dhe i mbajti ata peng, kundër dëshirës së Omerit, që donte që ata të ekzekutoheshin për krimet e tyre të mëparshme. Profeti i Bekuar i mori këto ajete si qortim dhe ato kanë, në përgjithësi, kuptimin që as një çerek nuk duhej të jepej në këtë betejë të parë.

Islamit vazhdonin të ekzistonin edhe në një kontinent tjetër, pas shumë shekujsh, dhe se osmanët kishin vepruar në pajtim me parimet islame. Në të vërtetë, do të ishte më e lehtë dhe më e favorshme për Sulltan Muradin, të mblidhte taksat çdo vit dhe të përfitonte pasuri botërore, se sa të kërcënonte dhe të përpiqej të frikësonte armiqtë e tij fuqishëm.

Ia vlen të theksojmë këtu se ushtria osmane ishte tepër e kujdesshme për të mos i shkaktuar dëmtime të panevojshme popullit dhe pronës së tyre. "Çdo ushtar", sipas Neshriut, "që dëmton edhe një fije të vetme kashte, do të rrihet (si ndëshkim). Pra, ishte e zakonshme që kalorësia të ngrinte kokën e kuajve sa herë që kalonte në arat me grurë, që të mos i lejonin kuajt e tyre të hanin grurin."²⁸² Kjo sjellje e civilizuar dhe njerëzore, në të vërtetë, është e kërkuar në parimet e Islamit dhe në fakt është ndjekur nga muslimanët. Ebu Bekri (r.a.) (11-13/632-634), për shembull, i kishte dhënë urdhër të rreptë ushtrisë muslimane që të pajtohej me këtë sjellje të disiplinuar, që nuk iu shkonte ndërmend perëndimorëve gjatë periudhës së errët të Mesjetës, ndoshta edhe në ditët e sotme.

Pas betejës së Kosovës, **Sulltan Muradi** martoi djalin e tij Mehemedin me Sitti Mykrime Hatunen, të bijën e Sylejman Beut të Dulkadirit.²⁸³

Ndërkohë që robërit e luftës duhet të trajtohen ndershmërisht (*el-Insan*, 8), në betejë nuk duhet të kemi frikë ta vrasim armikun.

282 Neşri, *vepër e cituar*, II, fq. 662.

283 Neşri, II, fq. 674.



Muradije, Bursa

Siguria dhe mirëqenia, gjatë periudhës së sundimit të Sulltan Muradit, ishin faktorë kaq mbizotërues dhe kaq të vendosur, sa që shumë njerëz të besimeve të ndryshme dhe të përkatësive të ndryshme racore, u shpërngulën në rajonin e Anadollit, për të jetuar atje në paqe dhe qetësi.²⁸⁴ Sulltan Murad Han Gaziu i trajtonte ushtarët dhe *ra'ijjetin*²⁸⁵ e tij mjaft mirë. *Ulemaja, sulehaja* dhe *ehlut tesavvuf*, në përgjithësi, ishin në kushte mjaft të mira. Në vitin 829/1426, ai ndërtoi një *imaret*²⁸⁶ dhe një xhami në Bursa. “Ai caktoi 30 *hafëzë*²⁸⁷ dhe 40 *muhal-lilë*,²⁸⁸ që kishin detyrën të recitonin çdo ditë 70.000 *tehlile* dhe

284 Neşri, II, fq. 676.

285 Në administratën osmane, njerëzit e qeverisur quhen “ra’ijjet” (shumësi ra’aja). Ra’ijjet do të thotë “ai për të cilin kujdesesh. Ky është një koncept islam dhe tepër i ndryshëm nga “i nënshtruar” i sunduesve evropianë të Mesjetës.”

286 Institucion që i ofronte popullit ushqim dy herë në ditë.

287 Një *hafiz* është një person që mëson përmendësh të gjithë Kur’anin; një praktikë kjo e zakonshme për imamët e Turqisë edhe në ditët e sotme.

288 Muhal-lil: personi që reciton *tahlil* (La ilaha illallah: Nuk ka zot tjetër veç Allahut).

*sevabet*²⁸⁹ nga këto t'ia kushtonin shpirtit të “Zotërisë së dy botëve” (*Sejjidul Kavnejn*) Muhammed Mustafasë, për shpirtrat e të gjithë profetëve, për shpirtrat e etërve të tyre, si dhe për shpirtrat e të gjithë besimtarëve. Ai ndërtoi një medrese në krah të asaj xhamie dhe një tyrbe për vete, midis xhamisë dhe medresesë. Në testament ai la amanet që pas vdekjes ajete nga Kur'ani të recitoheshin pa ndërprerje pranë tyrbes së tij. Përveç kësaj, ai ndërtoi edhe një xhami, një medrese, një *daru'l-hadith*,²⁹⁰ dhe një *mevlevihane*²⁹¹ në Edrene, ndërtimi i të cilave zgjati 10 vjet (1437-1447). Ai caktoi edhe 40 persona të tjerë, të cilët do të recitonin *suren el-En'am* dhe *sevabin* do t'ia kushtonin shpirtit të babait të tij Mehemmed Hanit; 5 persona të tjerë që do të recitonin *salavat* për shpirtin e Pejgamberit të Fundit Muhammed (Paqja qoftë me të). Ai caktoi shumë njerëz që do të recitonin çdo ditë *La ilahe il-lallah* dhe do ta kushtonin *sevabin* për shpirtin e besimtarëve. Ai ndërtoi, gjithashtu, një *imaret* në Ergene (Uzunkopry/Uzunköprü) dhe i dërgonte çdo vit 3.500 monedha floriri **Halilur Rahmanit** (Hebron), **Mekës** dhe **Medinës**. Sulltan Muradi i ktheu fshatrat e **Ballëk Hisarit** pranë Ankarasë në vakëfe, të ardhurat e të cilave i dërgoheshin qytetit të **Mekës**. Ai iu shpërndante zakonisht 1.000 monedha floriri *sejjidëve* në çdo qytet ku mund t'i takonte ata. **Haxh Isa Dede**, një nga ndjekësit (*muridë*) e Emir Sulltanit, i tha Sulltan Muradit, që ai duhej të përgatitej për vdekjen sepse ishte shumë pranë. Sulltan Muradi e mori shumë seriozisht këshillën, ftoi të birin e tij, Mehemmedin, të vinte nga Manisa dhe pas kësaj u sëmur në Edrene,

289 Shpërblimi i Allahut për një veprim të devotshëm.

290 *Daru'l-Hadith*: një institucion i dedikuar për mësimin e traditave të Pejgamberit të Fundit Muhammed (Paqja qoftë me të).

291 *Mevlevihane*: një godinë e ndërtuar me të gjitha kërkesat për ithtarët e **Xhelaeddin Rumiut** (dervishëve vërtitës) në mënyrë që ata t'i kryenin ritualet e tyre dhe të jetëonin në të; një teqe e Urdrhit Mevlevi.

ku edhe ndërroi jetë në vitin 855/1451.²⁹² Megjithatë, vdekja e tij nuk u njoftua derisa i biri erdhi nga Manisa dhe më pas trupi i sulltanit u përcoll drejt Bursës për t' u varrosur.²⁹³



Tyrbja e Sulltan Muradit, Bursa

Mënyra më e mirë për të kuptuar dhe vlerësuar ngjarjet historike, si dhe situatën e shoqërive në histori, është krahasimi. Gjatë çerekut dhe gjysmës së parë të shekullit të 15-të, shoqëria muslimane ishte në kushte shumë të mira, si në aspektin material, ashtu edhe në atë moral. Ndërsa shoqëria evropiane ishte në periudhën e “errët” të Mesjetës. Njerëzit e shoqërisë osmane, nëse ishin të varfër, ushqeheshin në imarete dhe përveç kësaj, mirëqenia e tyre shoqërore ishte e garantuar nëpërmjet institucionit islam të zekatit. Nga pikëpamja morale, prijësit dhe ndjekësit e urdhrave fetare, *elhut tesavvuf* siguronin dhe vendosnin një nivel të mirë në shoqëri. Individët nuk ishin të veçuar apo të humbur në shoqëri; përkundrazi, besimtarët

292 Neşri, II, fq. 680. Duhet të theksojmë se tyrbeja e tij nuk është e mbuluar nga një çati, me shumë mundësi për të lejuar shiun të bjerë mbi varrin e tij, për arsye se shiu është shenjë e mëshirës nga Allahu dhe në gjuhën turke quhet “rahmet” (mëshirë).

293 *Netajixh*, I, fq. 40.

takoheshin në xhami, teqe dhe ata që ishin në nevojë, ndihmoheshin nga të tjerët. Një numër i madh vakëfesh ishin në veprim që nga periudha e Orhan Gaziut. Gjatë periudhës së Jëlldërëm Bajezidit në raste lindjeje, martese dhe morti, njerëzit recitonin poemën *Vesilatun Nexhat*, që quhej nga publiku *mevlid/mevlud* dhe bënte fjalë për jetën e Pejgamberit të Fundit, e shkruar nga **Sylejman Çelebiu**, që ishte imami i Ullu Xhamisë në Bursa, në kohën e Jëlldërëm Bajezidit. **Muhamedije**, shkruar nga Shejhu **Jazëxhëogllu (Yazıcıoğlu) Mehemed**, po ashtu ishte gjerësisht e lexuar nga publiku. Pra, shoqëria osmane ishte në shekullin e 15-të, një shoqëri e ngritur. Ndërkohë që popujt e Evropës jetonin në papastërti, të munduar nga sëmundjet; ndërsa jetesa e tyre ishte në robëri.

Ky sfond solid i përgatitur nga Sulltan Muradi i hapi rrugën djalit të tij, Mehemedit, për tu rritur në rrethana të përshtatshme dhe për të arritur suksese të mëdha.

KAPITULLI 4

KTHIMI NË NJË SUPERFUQI

4.1 Fatih Sulltan Mehemed Hani 1451-1481

Mehemmedi II erdhi në fron në vitin 855/1481²⁹⁴. Ai ishte i arsimuar, kishte mësuar një gjysmë duzine gjuhësh të huaja dhe ishte një poet me emër si shumë sundimtarë të tjerë osmanë. *Mehlesi* (pseudonimi i tij si shkrimtar) në poezi ishte **avni**. Për më tepër, ai pati një karrierë të shquar politike dhe ushtarake, dhe njihet edhe në ditët e sotme sidomos dhe suksesin e tij të veçantë për rrëzimin përfundimtar të Perandorisë Romake. Siç dihet, Perëndimi ka tre elemente bazë që përbëjnë kontekstin kulturor: Greqinë e Lashtë, Perandorinë Romake dhe Krishterimin. Për këtë arsye, perëndimorët nuk mund të harrojnë faktin që Fatihu i dha fund Perandorisë Romake Lindore. Nga njëra anë, ata e kritikojnë atë padrejtësisht dhe nga ana tjetër e admirojnë, duke u përpjekur madje edhe ta paraqesin me origjinë joturke, nga ana e nënës së tij, duke shtrembëruar faktet historike. Si pjesë e fushatës së tyre këmbëngulëse për të shtrembëruar Historinë Osmane, studiuesit perëndimorë janë përpjekur të fshehin origjinën e tij turke, duke pretenduar se nëna e tij ishte Maria, Stela apo një princeshë e Francës. Në të vërtetë, ky është edhe një gabim tjetër i madh, pasi nëna e tij ishte një zonjë turke

294 Neşri, II, *vepër e cituar*, fq. 682; Tursun Beğ, *Tarih-i Ebül Feth*, (Stamboll, 1977), fq. 36-37.

më emrin Hyma Hatun.²⁹⁵ *Hamami* (banja) ku ajo u la përpara se të shkonte nuse në vitin 872/1424, te babai i Fatihut, Muradi II, është ende në fshatin **Çajërxhëk** (Çayırçık) të qytetit Kastamonu. Rrënojat e këtij hamami, ende quhen *gëlin hamamë* (hamami i nuses) dhe popullsia vendase, çdo vit zhvillon aty pari festime të quajtura *fetih shenlikleri*. Hatixhe Hyma është e bija e Ibrahim Beut, djalit të Isfendijar Beut të Kastamonut. Është e rëndësishme të theksojmë këtu, se të ardhurat që mblidheshin nga ky hamam, dhuroheshin për popullin e Mekës dhe Medinës; ai ishte **vakëf për el-Haramejn esh Sherifejn**.²⁹⁶

Gruaja e dytë e Sulltan Muradit, **Despina Maria**, vajza e despotit serb, iu kthye të atit pas vdekjes së Sulltan Muradit; dhe nëse ajo do të kishte qenë nëna e vërtetë e Fatihut, ajo me shumë siguri do të kishte qëndruar si *valide sultan* (nëna sulltaneshë e sundimtarit). Perandori i fundit romak, **Kostandini**, i kërkoi despotit serb vajzën e tij për martesë dhe ai pranoi, por **Despina Maria** iu përgjigj se ajo ishte betuar “të mos martohej më nëse Zoti do ta shpëtonte atë nga jobesimtarët”²⁹⁷ dhe e refuzoi propozimin e Perandorit.²⁹⁸

295 Regjistrat e gjykatës në Bursa, Nr. 31 (fq. 35), 201 (fq. 64) dhe 375 (fq. 40), citohet në Günvar Otmanbölük, “Fatih Annesi Özbeöz Türktür” (Nëna e Fatihut është me origjinë të pastër turke). Gazeta *Türkiye*, më 13 janar 1992, fq. 8, për të konfirmuar edhe një herë origjinën e saj turke, përmend gjithashtu faktin që ajo ishte vajza e Beut të Isfendijarit: Mehmed Süreyya, *Sijill-i Osmani*, (Stamboll, 1308), fq. 21; Neşri, II, fq. 682; Danishmned, I, fq. 190. Disa evropianë pretendojnë se nëna e Fatihut ishte e krishterë dhe se tyrbeja e saj ishte në Gallata, Stamboll, por ky pretendim është i pabazë. Nëna e tij ishte muslimane turke dhe tyrbeja e saj gjendet në Bursa: Danişmend, *vepër e cituar*, I, fq. 202.


296 Fazıl Çifci, *Candaroğlu İsmail Bey, Şahsiyeti ve Eserleri*, Kastamonu, 1996, S. 61-62, 64.

297 Për ata që i përkisnin besimit të “krishterë”, turqit ishin “jobesimtarë”, për arsye se ata nuk e pranoin Jezu Krishtin (Paqja qoftë me të) si zot, si birin e Zotit, etj. Për muslimanët, ata që e quanin veten të “krishterë” ishin ndjekës të librit të shfuqizuar dhe quheshin “Ehlul Kitab” (Ithtarët e Librit), dhe një burri musliman i lejohet të martohej me një grua të Ithtarëve të Librit.

298 OT, I, fq. 415, poshtëshënimi 4.

Një përpjekje e dytë për të falsifikuar dhe për të errësuar origjinën e vërtetë të Fatihut, është ai i Anri Matjé (Henry Mathieu), në librin e tij: *La Turquie et ses différents peuples*, në të cilin ai deklaroi, pa paraqitur *asnjë* dokument, se e ëma e Fatihut nuk ishte me origjinë serbe, por italiane, dhe se e kishte emrin Stela. Sipas tij, ajo ishte kapur robinjë nga piratët turq, kur ishte 7 vjeç, kishte ndryshuar pronarë dhe si përfundim ishte martuar me Sulltan Muradin. Në të vërtetë, do të na duhej të prisnim të paktën edhe tetëdhjetë vite deri në vitin 1510, për t'i parë turqit vullnetarë muxhahidinë, të quajtur piratë nga evropianët, të fillonin të lundronin në Detin Mesdhe si një fuqi që mund të merrej në konsideratë. Pra dhe ky pretendim qesharak është krejtësisht i pabazë, dhe **shërben si një shembull për të treguar se si evropianët e trajtojnë historinë osmane!**

Një pretendim tjetër i ngjashëm që vjen nga imagjinata e një ambasadori francez, është hedhur në të njëjtën mënyrë poshtë nga historianët osmanë të tillë si **Peçuji** dhe **Xhevri**. Në të vërtetë, ajo është muslimane dhe tyrbja e saj ndodhet në Muradije, Bursa, dhe quhet *Hatunije Kynbedi*.²⁹⁹



Hatunije Kynbedi (Tyrbja e nënës së Fatihut), Muradije, Bursa

299 Danişmend, *vepër e cituar*, I, fq. 200-202.

Ibrahim Beu i Karamanit u përpoq edhe një herë ta përdorte situatën delikate kundër Devletit Osman. Ai nënshkroi një traktat me Republikën e Venedikut, pushtoi qytetin Alaije dhe nxiti disa fisnikë nga emiratet e Germijanit, Menteshesë, Saruhanit dhe Ajdënit që t'i shkëpusnin tokat e tyre nga Devleti Osman, duke iu dërguar atyre përforcime kur ata sulmuan territorin osman.³⁰⁰ Për t'u mbrojtur ndaj çdo sulmi të mundshëm të **Janosh Hunjadit**, sulltani i ri la pas **Dajë Karaxha Pashanë**, Bejlerbeun e Rumelisë, në territorin e tij në Evropë³⁰¹ dhe u nis me nxitim drejt Akshehirit dhe Bejshehrit. Ibrahim Beu i Karamanit u tërhoq sërish për në Tasheli, ku ai kërkoi paqe. Më pas, ai i ktheu Devletit Osman qytetet e Akshehirit, Bejshehrit dhe Sejdishehrit, qytete këto që Sulltan Muradi kishte qenë i detyruar t'i jepte gjatë periudhës së situatës kritike, para betejës së Varnës. Kufiri midis dy Devleteve ishte qyteza Ëllgën (Ilgin). Ibrahim Beu pranoi t'i jepte ushtarë Devletit Osman gjatë fushatave të xhihadit.³⁰²



Gelin Hamamë, Çajërzhëk, Devrekani, Kastamonu

300 *Netajixh*, I, fq. 40.

301 Tursun Beğ, *vepër e cituar*, fq. 38.

302 *OT*, I, fq. 453.

Osmanët u detyruan t'i paguanin **Gjenovës** 40.000 mone-dha floriri për të kaluar Bosforin, kur po niseshin për t'u përballur me ushtritë e krishtera në Varna, në vitin 848/1444. Dhe për sa kohë që Kostandinopoja, si një entitet armik, ekzistonte në qendër të territoreve osmane, bashkësia e Devletit Osman në të dyja kontinentet nuk ishte e sigurt. Mbi të gjitha, kur Mehemedi II ishte nisur për të luftuar kundër Bejlikut të Karamanit, **Perandori romak Kostandini** dhe Senati, i kërkuan Devletit Osman të dyfishonte shumën që ky i fundit i paguante për "shpenzimet" e **Shehzade Orhanit**, i cili mbahej peng në Kostandinopjë. Ata shtuan se, në të kundërt, Shehzade Orhani do të dërgohej në territoret osmane në Rumeli, një veprim ky që me shumë siguri, do të shkaktonte një luftë civile në territorin osman. Për këtë arsye, ishte një nevojë e ngutshme për Devletin Osman që të shmangte këtë burim telashesh në mes të territorit të tij.

Ndërkohë që kthehej drejt kryeqytetit Edrene, Sulltan Mehemedi II nuk arriti të kalonte nëpërmjet Gelibollut drejt pjesës evropiane të Devletit të tij, për shkak se anijet e flotës së krishterë kishin bllokuar Ngushticën e Dardaneleve. Në këtë mënyrë, ai kaloi Bosforin nga Gyzelxhe Hisari, kështjella e ndërtuar nga Bajezidi në bregun e Bosforit në pjesën e Anadollit dhe urdhëroi ndërtimin e një kështjelle tjetër në bregun evropian.³⁰³ Ai caktoi **Firuz Again** si *dizdar* (komandant) të kështjellës së re, që njihej me emrat Rumeli Hisarë dhe Bogazkesen (Boğazkesen) (kështjella që ndan Bosforin).

303 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 137; Neşri, *vepër e cituar*, II, fq. 688.



Kështjella Rumeli Hisarë, Stamboll

Hapja e Kostandinopojës ndaj Islamit 857/

29.05.1453

Sipas një *Hadithi Sherif* të raportuar nga **Ahmed b. Hanbeli**,³⁰⁴ **Pejgamberi i Fundit Muhammed** (Paqja qoftë me të) ka thënë:

Qyteti i Kostandinit me siguri që do të hapet ndaj Islamit; sa komandant i mirë është ai që do të arrijë ta hapë dhe sa ushtri e mirë është ajo që do të jetë nën komandën e tij.

Edhe pse qyteti i Kostandinopojës iu kishte rezistuar me forcë dhe me këmbëngulje shumë sulmeve të mëparshme të muslimanëve, Sulltan Mehemmedi ishte i vendosur ta hapte atë ndaj Islamit. Dhe nuk kishte më asnjë person të aftë në Evropë, që të organizonte një kryqëzatë tjetër e të drejtonte fushatën. Forcat ushtarake të krishtera ishin të lodhura nga 4-vjeçari i

304 Ahmed b. Hanbel, *el Musned*, 4/335.

fundit, gjatë të cilit kishin pësuar humbje të mëdha, edhe me betejën e Varnës dhe të Kosovës. I përballur me këtë rrezik të pashmangshëm, perandori romak iu drejtua fuqive evropiane për të kërkuar ndihmë prej tyre.³⁰⁵ **Papa Nikolasi V** dëshironte të bashkëpunonte, me kusht që perandori të pranonte të zbatonte vendimin që u mor në Firence, për të bashkuar Kishën Katolike me Kishën Ortodokse; të përmendej emri i tij gjatë mbledhjes së shenjtë në Kishën Katedrale të Shën Sofias (Aja Sofja) në Kostandinopojë; dhe të rikthehej në pozitën e mëparshme Kardinali Gregorius, i cili ishte shfuqizuar nga ky post në vitin 1450. Por disa nga fisnikët në Kostandinopojë, mes të cilëve ishin dhe **Duka i Madh Notarasi** dhe **Genadiosi**, nuk ishin dakord për bashkimin e dy kishave. I pari raportohet të ketë thënë: **“Do të preferoja më shumë të shikoja çallmën turke në Kostandinopojë, në vend të kapelës së Kardinalit”**. Edhe Genadiosi, të cilin Fatihu do ta caktonte Patriark pas *fet’hit* (hapjes së Kostandinopojës), ishte kundër bashkimit të Kishës Ortodokse me Kishën Katolike, për arsye se toleranca që osmanët praktikonin ndaj popullit jomusliman nën sundimin e tyre, ishte e mirënjohur, dhe se administrata e tyre preferohej më tepër, mbi të gjitha administratat e tjera.³⁰⁶ Është një fakt i ditur që toleranca dhe modestia janë elementë të veçantë për ata që janë të fuqishëm, dhe që kanë besim në vetvete. Ai që është i dobët, është larg tolerancës dhe përpiqet të fshehë dobësinë e tij nëpërmjet imponimit të pamjes.

305 OT, I, fq. 464.

306 OT, I, fq. 465-467.



Muret rrethuese të Kostandinopojës

Është e natyrshme që çdo shoqëri në të njëjtën kohë të jetë në të njëjtin nivel në çdo aspekt: në atë shoqëror, kulturor, në letërsi, në arte, teknologji dhe ekonomi, ashtu sikurse është edhe shembulli i enëve të komunikimit në fizikë. Një shoqëri, nuk mund të ketë një nivel të lartë të vlerave morale dhe një nivel të ulët të çështjeve materiale. Nëse ka një nivel të ulët material, është shumë e vështirë që ajo shoqëri të arrijë një nivel të lartë në çështjet morale. Osmanët në atë kohë, kishin një nivel shumë të lartë moral dhe teknik; nuk është për t'u habitur që ata e kishin kaluar edhe Evropën në aspektin teknik. Topi, i quajtur **shahi** (mbretëror), i cili u farkëtua në Edrene për një periudhë kohe 3-mujore, ishte shumë i madh; ai tërhiqej nga 50 çifte qeshë dhe 200 burra u përdorën për të mbajtur baraspeshën e tij gjatë rrugës drejt Kostandinopojës. Rruga midis Edrenesë dhe Kostandinopojës u nivelua më parë nga 200

punëtorë dhe 50 karrocierë. U deshën dy muaj për të çuar topin në vendin ku do të luftohej. Fakti që ky top u farkëtua nga Urbani, është ekzagjeruar nga disa studiues. Së pari, Urbani ishte vetëm njëri prej punëtorëve që mori sulltani. Ai iu drejtua Fatihut, ndërkohë që përgatitej për *fet'hin* dhe ndërtimi i kështjellës së Bogazkesenit vazhdonte. Në atë kohë, kishte shumë përpunues të aftë për artilerinë si: **Saruxha Pasha** dhe **Mimar Muslihuiddini**, i cili më parë kishte farkëtuar shumë topa dhe kishte dhënë ndihmesën e tij për skicimin e projektit. **Hoxha Saduiddini** thotë se “topi që u farkëtua nga Saruxha Pashai ishte punuar nga 300 *kantarë* bakër.” Historiani Ali e mbështet këtë fakt në librin e tij *Kynhyl Ahbar*.³⁰⁷ Talenti i Urbanit ishte i lidhur vetëm me farkëtimin; por pika më e rëndësishme e ndërtimit ishte përllogaritja balistike, që u krye nga vetë Sulltani.³⁰⁸ Për më tepër, artileria e farkëtuar nga **Urbani**, ishte plasaritur dhe krisur pas gjuajtjes së predhave të para, dhe topat që ishin farkëtuar nga farkëtarët muslimanë u përdorën gjatë rrethimit.

Kostandinopoja kishte arritur të mbrohej me sukses ndaj sulmeve të mëparshme të muslimanëve. Për këtë arsye, Sulltan Mehemmedi ishte tepër i kujdesshëm gjatë parapërgatitjeve për hapjen e këtij qyteti ndaj Islamit. Rrethimi i Kostandinopojës filloi ditën e **Premte**, më 6 prill 1453. Muret rrethuese ishin shumë të forta, të larta dhe dyfish të trasha. Jashtë tyre ishte hapur një hendek uji 7 metra i gjerë, që ushtria osmane duhet të

307 Danişmend, I, fq. 235.

308 Schluberger, *Le Siege et la prise de Constantinople par le Turcs*, (Paris, 1915), fq. 57: Il (Orban) avouait cependant ne pas connaitre les questions de jet et de protee des projectiles, on dirait aujourd'hui les questions de balistique. Mais Mahomet se fit fort de regler par lui-meme ces details, pourvu qu'Orban lui fournit l'instrument tant desire. (Schluberger, *Rethimi dhe marrja e Kostandinopojës nga turqit*, (Paris, 1915), fq. 57: Megjithatë, ai (Urbani) nuk kishte njohuri mbi çështjet e projektimit dhe hedhjes së gjyleve, të cilat në ditët e sotme i quajmë çështje të balistikës. Por, Mehemmedi ishte i vendosur për t'i zgjidhur vetë këto detaje, mjaft që Urbani t'i siguronte atij instrumentin kaq shumë të dëshiruar. Cituar nga Danişmend.

kapërcente që të arrinte ta merrte këtë qytet të fortifikuar. Megjithatë, muret përgjatë gjirit të Bririt të Artë (Halixh: gj) ishin relativisht të dobëta, por romakët e kishin vështirësuar hyrjen e flotës osmane në këtë pjesë, pasi kishin lidhur një zinxhir të fortë çeliku përgjatë grykës së hyrjes së gjirit.³⁰⁹



Zinxhiri prej çeliku

Ushtria osmane sulmoi për herë të parë natën e 18 prillit, kur u përpoq të hynte nëpërmjet disa të çarave që bëri në muret rrethuese të qytetit, por u zbraps. Ndërkohë, Papa dërgoi në ndihmë të të rrethuarve tre anije gjenovase, që mbërritën në Kostandinopojë më 20 prill. Edhe pse kishte qëndruar me trimëri, edhe pse kishte humbur madje edhe njërin sy gjatë betejës në det, *Kapudan-ë Derjai* osman (Komandanti i Flotës Detare), **Balltaogllu (Baltaoğlu) Sylejman Beu**, nuk arriti t'i

309 OT, I, fq. 470. Ky zinxhir ruhet në ditët e sotme në Muzeun Ushtarak, në Harbiye, Stamboll.

ndalonte ata³¹⁰ për shkak të numrit të vogël të anijeve të tij. Megjithatë, ai u shkarkua nga detyra dhe në vendin e *Kapudan-ë Derja* u caktua **Hamza Beu**.³¹¹

Osmanët bënë një lëvizje tjetër natën e 21-22 prillit: ata shtynë drejt gjirit ³¹² 70 anije nga **Tophane** drejt **Kasim Pashait** mbi një rrugë rrëshqitëse me trungje prej druri, për të rrënuar pjesën e mureve relativisht më të dobëta. Kjo arritje i demoralizoi së tepërmi romakët.

Fatih Sulltan Mehemedi, pasi bëri të gjitha përllogaritjet e nevojshme balistike, **shpiku një gjyle-hedhës** dhe e përdori këtë armë të re për të goditur anijet romake dhe latine në gjirin e Birit të Artë.

Romakët, tashmë të demoralizuar, kërkuan të nënshkruanin një traktat paqeje duke iu ofruar osmanëve të gjitha tokat që zotëronin deri në muret rrethuese të Kostandinopojës; emërimin nga Devleti Osman të zyrtarëve që do të përgjigjeshin për sigurinë dhe pagesën e çdo lloj tagre që do të kërkonin osmanët. Por, sulltani i ri osman iu përgjigj: “Ose do ta marr Kostandinopojën, ose ajo do të më marrë mua” dhe kërkoi nënshtrimin e qytetit.³¹³

Ushtria muslimane ndërmori dhe një sulm tjetër më 6 maj, pas perëndimit të diellit, por nuk arriti të hynte brenda mureve të qytetit.³¹⁴ Më 12 maj, disa ushtarë osmanë arritën të hynin nëpërmjet të çarave që hapën në murin rrethues, por u zbrapsën nga romakët, të cilët ishin shumë të shpejtë për të dërguar

310 Ibn-i Kemal, *Tevarih-i Al-i Osman, VII. Defter*, botuar nga Şerafettin Turan (Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1991), fq. 5.

311 OT, I, fq. 477-478.

312 Ibn-i Kemal, *Tevarih-i Al-i Osman, VII. Defter*, fq. 52; OT, I, fq. 481. Lordi Kinross me dëshirë imagjinoi se ideja e zgjuar e Fatihut për bartjen e anijeve të tij me rrugë tokësore “me siguri i ishte futur atij në kokë nga një italian që ishte nën shërbimin e tij.” (The Ottoman Centuries; the Rise and Fall of the Turkish Empire, New York, 1977, fq. 103)

313 Danişmend, I, fq. 246.

314 OT, I, fq. 482.


njësi të reja ushtarake në pikat më të dobëta.³¹⁵ Sulltan Mehemedi II kishte ndërtuar kulla të lëvizshme luftarake. Kulla e parë u ndërtua nga inxhinierët dhe punëtorët për 4 orë, pranë hendekut të ujit, përballë mureve të Topkapusë. Ajo qëndronte mbi çikrikë, në mënyrë që të mund të lëvizte dhe ishte më e lartë se muret rrethuese të qytetit. Romakët e dogjën atë kullë të lartë, por osmanët ndërtuan kulla të tjera. Kjo tregon se osmanët ishin më superiorë se romakët edhe në aspektin teknik. Beteja vazhdoi me shkëmbimin e gjuajtjeve me shigjeta dhe me armë zjarri.

Nga fundi i rrethimit, disa ambasadorë hungarezë mbërritën për të lajmëruar se **Janosh Hunjadi** nuk ishte më në ngarkim të administratës në Hungari dhe se Mbreti i ri **Lazlo** ishte i vendosur të marshonte në krye të një ushtrie të madhe drejt territorit osman, nëse osmanët nuk do ta ngrinin rrethimin e tyre në mënyrë të ngutshme. Ata njoftuan se pala hungareze kishte anuluar traktatin 3-vjeçar për paqe. Ky kërcënim dhe njoftimi se flota venedikase ishte duke ardhur në ndihmë të Perandorisë Romake, e vendosën sulltanin e ri në një pozitë të vështirë. Ai mblodhi dinjitarët e tij fisnikë për të diskutuar rreth situatës. Vezir-i A'zam, **Halil Pasha**, i cili kishte përvojë dhe i njihnte qëllimet dhe madhësinë e armatës Kryqtare, ishte i mendimit se osmanët duhet ta ngrinin rrethimin e tyre, duke i ngarkuar Perandorisë Romake një shumë të madhe si tagër lufte. Nga ana tjetër, **Zaganos (Zaĝanos) Pasha** mendonte se Kostandinopoja nuk mund të merrte ndihma, por edhe nëse do të mund të ndihmohej, nuk do të ishte një ndihmë aq e madhe, sa të mund të ndryshonte situatën. **Shejhu Akshemseddin** dhe disa fisnikë të tjerë, e mbështesnin pikëpamjen e këtij të fundit, dhe vendimi përfundimtar ishte që rrethimi të vazhdonte.

Osmanët mësuan se një flotë luftarake e krishterë e Venedikut apo e Papës, kishte mbërritur në ishullin Sakëz, në brigjet e Detit Egje. Për këtë arsye, osmanët i mbajtën peng ambasada-

315 OT, I, fq. 483.

dorët hungarezë për të parë rezultatin e sulmit të fundit. Fjalë dhe biseda të trishtuara qarkullonin në radhët e ushtarëve, për shkak të rrethimit të tejzgatur dhe sulltani nuk e kishte të lehtë. Por, një letër inkurajuese e **Shejhut Akshemseddin** drejtuar Sulltanit, ngriti moralin e tij.³¹⁶ Me këshillën e Shejhut Akshemseddin, Mjeshtrit Shpirtëror të sulltanit, *muxhahidinët* sulmuan vetëm pak çaste pas faljes së namazit të *subhit* (sabahut)³¹⁷ të ditës së Martë, më 29 maj, dhe ushtria muslimane hyri fitimtare në qytet nëpërmjet portës Topkapu. Ka të dhëna se perandori romak u vra gjatë rrëmujës, edhe pse ishte përpjekur të arratisë drejt Portës Pemton.³¹⁸ Për shkak të faktit që Stambolli (Kostandinopoja) ra dhe ndryshoi sundimtarët në një ditë të Martë, grekët romakë e shikonin atë ditë si ditë që sjell tersllëk.



Një nga sanxhakët (flamujt), i cili u përdor gjatë hapjes së Kostandinopojës ndaj Islamit

316 OT, I, fq. 485.

317 Ibn Kemal, *vepër e cituar*, VII, fq. 62.

318 Ibn Kemal, *vepër e cituar*, VII, fq. 73.

Rrethimi i Kostandinopojës zgjati 53 ditë. Nderi për hapjen e këtij qyteti ndaj Islamit i takonte sulltanit të ri osman, Mehemmedit II, që në atë kohë ishte në moshën 21-vjeçare, dhe që nga ajo ditë u quajt **Fatih** (hapës i një vendi të rëndësishëm ndaj Islamit). Në këtë mënyrë, themelimi i Devletit Osman ishte kompletuar mbi baza të forta. Tashmë rruga e osmanëve drejt zbatimit të qëllimit të tyre të vetëm dhe arsyes së qenies së tyre: zgjerimi i territoreve për të përhapur më tej Islamin, ishte e hapur. Fatihu e ktheu katedralen e Hagia Sofias (Aja Sofjas), vendit ku kurorëzoheshin perandorët romakë, në Mesxhid Xhami dhe aty u zhvillua dhe falja e parë e së Xhumasë; *hutbeja* u mbajt nga **Shejhu Akshemseddin**³¹⁹ në emër të sulltanit.³²⁰ Titulli i sulltanit ishte *Sulltanul Berrejn Hakanul Bahrejn Emirul Mu'minin*,³²¹ *Kami'ul Fexhereti vel Mushrikin, es*

319 Shems ed-Din ibn Muhamed ibn Hamzah, lindur në Damask në 792/1390 dhe një pasardhës i Shihabud Din Umer Suhraverdi (v. 632/1234), autori i "*Avarif ul Me'arif*", linja e të cilit arrin deri te Ebu Bekr es-Siddiku. Akshemseddini u bë *murid* i të famshmit *veli* Haxhi Bajramit, i cili jetoi gjatë periudhës së Sulltan Muradit II. Kur ndërroi jetë, Shejhu i tij, Haxhi Bajrami, në vitin 833/1429-30, ai e caktoi atë në vendin e tij të Mjeshtrit Shpirtëror. Fatih Mehemedi dëshironte të ishte *muridi* i tij i devotshëm, por Shejhu nuk pranoi, sepse ai dëshironte që Mehemedi t'ia kushtonte të gjithë kohën e tij administrimit të Devletit. Shejhu shkoi në Gojnyk (Göynük), ku kaloi dhe pjesën tjetër të jetës. (Orhan F. Köprülü-Mustafa Uzun, "Akshemseddin", *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*, vëllimi II, fq. 299-301).

320 Münecçimbaşı, *Camiü'd Düvel*, fq. 247.

321 *Emirul Mu'minin* është titulli i Halifit; pjesa më e madhe e historianëve dhe studiuesve perëndimorë, thonë se: aneksimi i Egjiptit në vitin 1517, nga Javuz Sulltan Selimi dhe marrja e Hilafetit, nuk u arrit nga osmanët. Ata deklarojnë, për të mbështetur pretendimet e tyre, se në burimet bashkëkohore historike të osmanëve nuk është përmendur asnjë ceremoni në lidhje me këtë. Kjo është e vërtetë, pasi nuk ka pasur nevojë të bëhej një ceremoni e tillë. Por ideali i osmanëve filloi me sunduesin e dytë Orhan Gaziun për t'u bërë sulltanë, që do të përfaqësonin në të njëjtën kohë edhe Hilafetin (Feridun Beğ, *Münshheat*, I, fq. 69). Sulltan Muradi e shikonte veten si Halif (*Münshheat*, I, fq. 87). Djali i tij, Jëlldërëm Bajezidi, u quajt në vitin 1391 *zil-lullah* (hija e Allahut), që ishte dhe titulli i Halifit të përdorur nga Sulltani i Egjiptit, i cili e mirëpriti dhe Halifin *simbolik* të Abasidëve në sulltanatin e tij. Sulltani i Horasanit, **Husejn Bajkara**, i drejtohej Jëlldërëm Bajezidit me të njëjtin emër (*Münshheat*, I, fq. 306).

Sulltan ibnus Sulltan Mehemmed bin Murad Han (Sulltani i dy Kontinenteve; Hakani i dy deteve; Princi i besimtarëve; Nënshtruesi i atyre që i shmangen të vërtetës dhe i politeistëve, Sulltani, biri i Sulltanit Mehemmed Hani, i biri i Murad Hanit).³²²

Devleti Osman ishte fuqia e vetme islame që mund të përballej me jobesimtarët. Me hapjen e Kostandinopojës, Fatihu kishte arritur një pozitë shumë të lartë në botën islame. **Roli që luajti Shejhu Edebali për themelimin e Devletit ishte shumë i rëndësishëm; por, po kaq i rëndësishëm është edhe roli që luajti Shejhu Akshemseddin, për ta ngritur Devletin Osman në pozitën e një superfuqie, duke udhëhequr Fatihun, dishepullin e tij. Në të vërtetë, është tepër e vështirë, pothuajse e pamundur, të bësh një vlerësim të fakteve dhe misionit të osmanëve, strukturës shoqërore dhe gjithçka tjetër që lidhet me Devletin Osman, pa kuptuar më parë shtrirjen e Tesavufit në atë entitet.** Përveç të huajve, madje edhe historianët turq, të cilët nuk janë thellësisht të ndërgjegjshëm dhe nuk arrijnë të vlerësojnë rolin e luajtur nga Tesavufi në krijimin, dhe zhvillimin e shoqërisë osmane, janë të detyruar të përngjasojnë me një recepsionist hoteli, që pyet një shkrimtar për profesionin e tij, dhe që ka marrë përgjigje se ky i fundit e fiton jetesën me anë të një stilolapsi, e shikon atë si një “shitës të thjeshtë stilolapsash.”

(Për këtë temë mund të shikoni *Münsheat*, I, fq. 307, 326, 327, 330, 345, 346, 365, 375-377, 379, 500, 515). *Emirul Mu'mini* është një titull tjetër që i drejtohet Halifit dhe që është përdorur për herë të parë nga Halifi **Omer b. el-Hattab**.

322 Tursun Beğ, *vepër e cituar*, fq. 33.




Aja Sofja në Stamboll

Merita e Mehemmedit për hapjen e Stambollit ndaj Islamit, 50 vite më parë mund të kishte qenë edhe e Jëlldërëm Bajezidit, nëse Timuri nuk do të kishte udhëhequr luftën e tij në Anadoll³²³, duke vonuar kështu mundësinë e Devletit Osman për t'u kthyer në një superfuqi. **Fatih Sulltan Mehemmedi** shpalli një amnisti të përgjithshme dhe transferoi një numër të madh muslimanësh nga Anadulli në Stamboll (Kostandinopojë). Ai emëroi si Patriark të Kishës Ortodokse **Genadiosin** dhe u dha të gjithë jomuslimanëve liri të plotë besimi. Një tolerancë e tillë ishte e paimagjinueshme për Evropën, madje nuk është e ligjërueshme as nga politikanët perëndimorë të ditëve të sotme.

Si përfaqësues të së njëjtës kulturë, osmanët, ishin në dijeni të faktit që sahabiu i madh (shok i Profetit a.s.) **Ebu Ejjub el-Ensari**, ishte varrosur jashtë mureve të qytetit, kur ai kishte ardhur në Kostandinopojë me ushtrinë e tij muslimane në vitin 49/669, por ata nuk e dinin vendin e saktë të varrit të tij. Sulltan Fatih Mehemmedi i kërkoi Mjeshtrit të tij Shpirtëror, **Shejhut**

323 *Netajixh*, I, fq. 55.

Akshemseddin, ta përcaktonte vendin dhe ai arriti ta gjente atë përmes *mukashefes*.³²⁴ Kështu, Fatihu ndërtoi aty një tyrbe dhe një xhami të bukur, në përkujtim të këtij Sahabiu të madh. Halifët pasardhës e vizitonin varrin e tij për **el-Bereke** (për të marrë bekimin), dhe nga kjo pikë, niseshin ekspeditat e tyre të xhihadit drejt Evropës. Tashmë është një traditë e famshme e popullsisë muslimane të Stambollit, të vizitojnë këtë vend përpara ceremonive martesore dhe ceremonive të synetit. Kjo zonë quhet Ejyp (versioni në gjuhën turke për Ejjub) dhe Sahabiu i madh njihet me emrin **Ejyp (Ejup) Sulltan**. Fama dhe respekti i thellë që ka ky Sahabi i madh në popull, është një shenjë treguese e vazhdimësisë së kulturës dhe traditës islame ndër shekuj, ndër njerëzit në territoret e ndryshme dhe të largëta.



Mauzoleumi i Sulltan Ejupit

324 *Mukashefe*: zemra e një *veliu* (besimtari të devotshëm), për arsye se është e pastruar nga njollat e shqetësimeve (ma'siva) të kësaj bote kalimtare, është e gatshme të marrë dhe të reflektojë si një pasqyrë e pastër njohuritë nga e padukshmja.



Xhamia e Sulltan Ejupit, Stamboll

Sipas periodizimit perëndimor të historisë, hapja e Stambollit ndaj Islamit, është një nga pikat kthesë që shënoi përfundimin e periudhës së Mesjetës dhe fillimin e periudhës Moderne. Osmanët e kthyen Stambollin në një metropol të Islamit, ndërkohë që banorët e krishterë të këtij qyteti në asnjë rast nuk u përdoqën. Përkundrazi, ata u lejuan të qëndronin aty dhe trajtoheshin në mënyrë të pranueshme, dhe të sjellshme, dhe vazhdojnë të gëzojnë liri të plotë besimi edhe në ditët e sotme. Stambolli vazhdon të jetë Selia e Patrikanës së Kishës Ortodokse greke. Në rast se, në atë kohë bota e krishterë do të kishte arritur një fitore të tillë, ndaj një kryeqendre muslimane, nuk do të kishte qenë e vështirë të parashikohej shtypja shkatërrimtare e tyre, për shkak se “pjesa më e madhe e popullsisë së Evropës, në periudha të ndryshme kohore, ka qenë e papërmbajtshme.” Në shekullin e 13-të, francezët shfarosën Albigenianët dhe 4 shekuj më pas edhe Hugenotët; spanjollët shfarosën Mavarët;

anglezët shfarosën indianët e Amerikës së Veriut, dhe u përpoqën në shekullin e 17-të të asgjësonin irlandezët.³²⁵

Me pak fjalë, pas aneksimit të Stambollit, që u kthye në një metropol të rëndësishëm islam, Sulltan Fatihu i kumtoi një *fet'hname* (letër fitoreje) sovranit të Egjiptit, **Inal Shah**, (sundoi 857-865/1453-1460). Pas *Bismil-lah*, në letër citoheshin dy ajete nga Kur'ani: "O Allah! Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do, e lartëson atë që do dhe e përul atë që do. Çdo e mirë është vetëm në dorën Tënde, vërtetë, Ti ke mundësi për çdo gjë." [*Ali Imran*, 26]. "Luftojini ata që nuk besojnë në Allahun dhe as në Ditën e Kiametit" [*et-Tevbe*, 29]. Më tej, ai citon një thënie të Pejgamberit të Fundit Muhammed (s.a.v.s): "Atij që i pluhurosen këmbët për çështjen e Allahut, Krijuesi e ndalon atë të hyjë në Ferr." Letra përfundonte me thënien e Pejgamberit, që i siguronte muslimanëve se ata do të arrinin ta hapnin qytetin ndaj Islamit dhe se osmanët do ta ndërmerren këtë ekspeditë të xhihadit, në përputhje të plotë me urdhëresat Hyjnore, ashtu si përmendet edhe në Kur'an, "Luftoni kundër jobesimtarëve që ju qëndrojnë pranë" [*et-Tevbe*, 23]. Së bashku me këtë letër *fet'hname*, sulltani osman i dërgoi sulltanit të Egjiptit edhe disa dhurata të çmuara.³²⁶

Një *fet'hname* tjetër iu dërgua **Shejhut të Meke el-Mukerremes**, në të cilën Sulltan Fatihu shkruante: "Po ju dërgojmë këtë letër për të lajmëruar dhuratën që Allahu na fali këtë vit, një fitore që nuk e ka parë syri dhe që nuk e ka dëgjuar veshi më parë: hapja e Kostandinopojës ndaj Islamit". Në letër, më pas, citohej *ajeti 20* nga *Sureja el-Fet'h*: "Allahu ju premtoi juve pre të shumta, që do t'i merrni, e këtë jua shpejtoi ...", dhe një thënie e Profetit (s.a.v.s.): "Parajsa ka 100 shkallë, Allahu i ka përgatitur ato shkallë për ata që luftojnë për Çështjen e Tij

325 A.J.P. Taylor, *The Course of German History*, (Londër, Routledge paperback, 1988), fq. 2.

326 Feridun Beg, *Münsheat-i Selatin*, I, fq. 235-239.

(për Islamin) dhe largësia midis dy shkallëve është si largësia midis Qiejve dhe Tokës.”³²⁷

Një letër *fet’hname* e tretë, iu dërgua sovranit të Iranit, **Xhahan Shah** (1405?-1467), ku Sulltan Fatihu e njoftonte se muslimanët muxhahidinë kishin arritur ta çlironin këtë qytet në emër të Islamit, nëpërmjet ndihmës shpirtërore të Krijuesit dhe në përputhje me *ajetin* që i përkiste ngjarjes së hapjes së Mekës ndaj Islamit: “Ne të dhamë ty (O Muhammed) një fitore të qartë.” [*el-Fet’h*, 1] Ai vazhdon, më tej, duke thënë se muxhahidinët kishin të njëjtin zell si bashkëfetarët e tyre që e hapën Mekën ndaj Islamit dhe në lidhje me këtë citon *ajetin*: “Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve ...” [*el-Fet’h*, 4].³²⁸

Është me rëndësi të madhe të theksojmë se, në letër-përgjigjen e tij, **Xhahan Shahu**, citonte disa *ajete* nga Kur’ani: “Ne të kemi bërë mëkëmbës mbi tokë.” [*Sad*, 26] Nëpërmjet këtij citimi, ai mendohet se e kishte pranuar faktin që pas hapjes së Kostandinopojës ndaj Islamit dhe rënies së Perandorisë Romake, sulltani osman ishte kthyer **de facto** në zëdhënësin dhe **Udhëheqësin e muslimanëve**. Faktikisht, të gjitha fuqitë e tjera muslimane në atë kohë ishin të angazhuara në mosmarrëveshje dhe grindje me njëra-tjetrën dhe osmanët ishin luftëtarët e vetëm muslimanë që luftonin në zemër të Evropës së krishterë për çështjen e Islamit. Hapja e Kostandinopojës ndaj Islamit pati kundërveprime të mëdha në Evropën e krishterë. Sipas Abbas Hamdanit: “Rënia e Kostandinopojës në vitin 1453, rigjallëroi lëvizjen e kryqëzatave në Evropë. **Princi Henri** (i Portugalisë) veproi duke lundruar me anijen e tij deri në Afrikë dhe duke arritur deri te sundimtarët e krishterë të Lindjes. Ai e shfrytëzoi, gjithashtu, këtë rast duke krijuar monopole tregtie dhe duke e përjashtuar veten nga 1/10 e zakonshme që i paguante Papës. Të gjitha këto janë konfirmuar nëpërmjet një deklarate të Papatit, më 8 janar 1455. Sundimtari i ardhshëm portugez, **Dom**

327 *Münsheat*, I, fq. 239-243.

328 *Münsheat*, I, fq. 245-249.

Zhao II, dërgoi një njësi zbuluese inteligjente që përmes mem-lukëve të Lindjes së Mesme të vendoste lidhjet me Perandorin e Etiopisë për zbulimin e burimeve të tregtisë së erëzave në Lindje. Ky mision u drejtua nga dy njohës të gjuhës arabe, **Pero de Kovilja (Covilha)** dhe **Alfonso de Pavia**. Në të njëjtën kohë, Bartholomeu Diaz arriti në Kepin e Shpresës së Mirë.³²⁹

Sipas evropianëve, data e hapjes së Kostandinopojës ndaj Islamit, që quhet në terminologjinë e tyre “rënia” e Kostandinopojës në duart e “turqve jobesimtarë”,³³⁰ shënoi një ngjarje që ndryshoi historinë botërore dhe se viti 1453 nuk duhet të harrohet. Ata pretendojnë se periudha e errët e Mesjetës (nga pikëpamja evropiane) përfundoi me datën e kësaj ngjarjeje, falë studuesve të larguar nga Kostandinopoja, që luajtën një rol të rëndësishëm për fillimin e periudhës së Rilindjes. Faktikisht, nivelet kulturore dhe shoqërore janë të kushtëzuara të jenë të lidhura si rrjedhja në enët e komunikimit në fizikë. Dijetarët romakë kanë debatuar për gjininë e engjëjve dhe numrin e krahëve të tyre; se si një i pasur mund të hyjë në Parajsë, pasi deveja të futet në vrimën e një gjilpëre. Në vitin 1453, Kostandinopoja ishte e kalbur në çdo drejtim dhe është më se e palogjikshme të pritej *çfarëdo* e mirë prej saj, çfarëdo ndihme prej saj për civilizimin. Kur ushtria osmane rrethoi qytetin, askush nuk u shqetësua për këtë, pasi ishin nisur në grupe drejt hipodromit për t’i parë të gjelbrit dhe blutë. Siç dihet, studiuesit që patën ndikim të madh në fillimin e Rilindjes, u transferuan nga Moreja (Peloponezi) drejt Evropës Qendrore dhe Perëndimore.

329 Abbas Hamdani, "Ottoman Response to the Discovery of America and the New Route to India" *Journal of the American Oriental Society*, vëllimi 101 (1961), fq. 325.

330 Ata që e quajnë veten “të krishterë”, besojnë se Jezu Krishti (Paqja qoftë me të) është biri i Zotit; ndërsa muslimanët besojnë se Jezu Krishti (Paqja qoftë me të) është një Profet dhe muslimanët besojnë në të gjithë Profetët. Kështu që ata që e quajnë veten “të krishterë” i shikojnë muslimanët si “jobesimtarë”, për arsye se ata nuk e pranojnë Profetin Jezu Krisht si Zot, Krijues, Mbështetës etj.

Në fakt, në vend të periodizimit euro-centrik, ngjarjet më të rëndësishme në historinë botërore mund të radhiten si më poshtë:

1. Përmbytja e Noes (Paqja qoftë me të). (4000 p.e.s)*
2. Lindja e Jezu Krishtit (Paqja qoftë me të).4001
3. Hixhreti i Muhammedit (Paqja qoftë me të).4622
4. Beteja e Ajn Xhalutit (Disfata e parë e madhe e mongolëve, të cilët, më parë, shikoheshin si të “pamposhtur”) (1260 e.s. plus 4000).5260
5. Martin Luteri fillon Protestantizmin (1517 e.s. plus 4000).5517
6. Revolucioni Francez (1517 e.s. plus 4000).5789
7. Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik (1991 e.s. plus 4000).5991

Pra, viti 2011 e.s. i korrespondon vitit **6011**, që duhet të jetë e pranueshme për **pjesën më të madhe** të popullsisë botërore.

Perandori romak kishte nënshkruar me Papën një traktat për të marrë ndihmën e botës së krishterë, dhe për këtë arsye, **Kardinali Izidor**, i dërguari i Papës, udhëhoqi një ceremoni fetare në Katedralen e Aja Sofjas, më 12 dhjetor 1452. Në këtë mënyrë, u proklamua bashkimi i Fesë Ortodokse me Fenë Kato- like. Kjo do të thoshte se pas hapjes të Kostandinopjës ndaj Islamit, nga Sulltan Fatihu, në vitin 1453, **nuk kishte më asnjë konflikt midis Katolicizmit dhe Ortodoksisë dhe se Krishterimi Lindor ishte nën hegjemoninë e Kishës Perëndimore**. Kjo ishte një situatë në kundërshtim të plotë me dëshirat, tendencat, traditën e grekëve të Stambollit. Nga ana tjetër, Devleti Osman, nuk ishte në favor të bashkimit të krishterimit. Për këtë arsye, Sulltan Fatihu caktoi si **Patriark** në një ceremoni madhështore, **Genadios Skolariosin**, që ishte kundër bashkimit të dy kishave. Në këtë mënyrë, **Kisha Ortodokse siguroi pavarësinë e saj nga Kisha Katolike**.

*. Werner Keller, *The Bible as History* (përkthyer nga William Neil, Britani e Madhe: 1967), fq. 51.

Kadiu i parë i Stambollit është **Hëzër Beu**, nga familja e të famshmit **Nasreddin Hoxha** (Xhuha). Lagjja ku ai u vendos quhej Kadikoj (Kadıköyü) (fshati i Kadiut) dhe ky vend mban këtë emër edhe në ditët e sotme. Shumë familje turke u shpërngulën nga Anadulli në Stamboll dhe lagjet në të cilat ato u vendosën mbajnë edhe në ditët e sotme emrat e qyteteve nga ata erdhën, si Karaman, Aksaraj,³³¹ Çarshamba.

Hapja e Stambollit ndaj Islamit, u përshëndet nga shumë vende islame, të cilat dërguan urimet e tyre dhe u shoqërua edhe me mbërritjen e shumë komiteteve të administratës së krishterë, që kishin të njëjtin qëllim si: Perandoria Pontus e Trebizondit; Mbretëria e Serbisë; Republika e Dubrovnikut (Raguzës); Moreja despotike, që qeverisej nga Dimitrios dhe Tomas, vëllezër të perandorit të fundit romak, Kostandin Paleologos; administrata gjenovase e Ishullit të kolonizuar Sakëz; Dukati gjenovas i Ishullit Midil-li; disa prej tyre ishin të gatshëm t'i paguanin tagra Devletit Osman.

Hapja e Stambollit ndaj Islamit nga Mehemedi II, ishte një ngjarje e shënuar dhe e rëndësishme, dhe vetë sulltani me të drejtë ishte i ndërgjegjshëm se kishte marrë në dorë drejtimin e botës muslimane: “Me hapjen e Kostandinopojës, bota muslimane njohu Mehemedin si prijësin e Luftës së Shenjtë kundër krishterimit. Tashmë, ai mund të pretendonte se ishte superior mbi të gjithë sundimtarët e tjerë osmanë, duke përfshirë këtu edhe sulltanët fqinjë memlukë dhe mund të kërkonte të drejtën të merrte vendin e këtyre të fundit si prijës të pelegrinazhit drejt Qyteteve të Shenjta.”³³²

Xhihadi kundër Serbisë

Duke u mbështetur te hungarezët, mbreti serb **Gjorgje Brankoviç**, sulmoi territoret osmane në vitin 858/1454. **Fatih** marshoi drejt Serbisë dhe mori kështjellën e Ostrovicës, njërën

331 Danişmend, I, fq. 263-268.

332 S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 60-61.

nga dy kështjellat më të rëndësishme të Serbisë dhe u kthye në Edrene, duke lënë pas **Mehemmed Beun**³³³, të birin e Firuz Beut, me 30.000 ushtarë të fuqishëm në mbrojtje të kësaj zone. **Janosh Hunjadi**, komandanti hungarez, e shfrytëzoi rastin e largimit të Fatihut dhe në krye të një ushtrie shumë të madhe, së bashku me Mbretin Brankoviç, sulmoi befasisht dhe kapi rob Mehemmed Beun në Krushevc. Me të marrë njoftimin e kësaj ngjarjeje, Fatih Mehemedi, e drejtoi ushtrinë drejt Serbisë, por Janosh Hunjadi u arratis drejt Hungarisë. Mbreti hungarez u nënshtrua dhe pranoi të paguante çdo vit një tagër prej 30.000 monedhash floriri.

Një vit më pas, Fatih Mehemedi vazhdoi të hapte ndaj Islamit territore të reja në Serbi dhe mori dhe qytezën Novo-bërdo. Në këtë kohë, Janosh Hunjadi nxiste mbretin Brankoviç për t'i bërë qëndresë sulmit osman. Por midis tyre ishin krijuar marrëdhënie të ftohta, për shkak të diferencave të tyre sektare. Nga ana tjetër, Fatihu ishte shumë tolerant ndaj besimeve të tjera dhe Brankoviçi e pyeti Janosh Hunjadin: "Cili do të ishte qëndrimi yt ndaj Ortodoksisë serbe, nëse do t'i mundnim turqit?" Janoshi iu përgjigj: "Unë do të ndërtoj kisha katolike në të gjithë Serbinë." Ndërsa, kur Fatih Mehemedi iu drejtua e njëjta pyetje, ai iu përgjigj: "Lejohet ndërtimi i një kishe ortodokse pranë çdo xhamie". Kjo tolerancë e osmanëve pati një ndikim të rëndësishëm për shtrirjen e tyre drejt Ballkanit.

Fitorja në Berat të Shqipërisë

Ndërkohë që Mehemedi II kishte rrethuar qytetin e Kostandinopojës, shqiptarët e shfrytëzuan këtë rast dhe sulmuan forcat osmane në zonën e tyre, dhe i mundën më 12 Rebī'u-l-ahir 846/22 prill 1453. Fatih Mehemedi dërgoi **Isa Beun**, të birin e Evrenos Beut, në krye të 40.000 kalorësve për t'u hakmarrë ndaj disfatës së shkaktuar nga shqiptarët, si dhe

333 Shqiptimi i saktë i këtij emri është "Mehemmed", jo "Mehmed" siç u ndryshua më pas.

për të vazhduar misionin e përhapjes së Islamit në këtë rajon. Isa Beu me ushtrinë e tij mundi prijësin shqiptar **Skënder Beu** më 10 Sha' ban 857/26 korrik 1453, në betejën që u zhvillua në Berat, në Shqipëri, edhe pse kjo e fundit, kishte marrë nga mbreti i Napolit përforcime me luftëtarë. Në këtë betejë, më shumë se gjysma e ushtrisë së bashkuar shqiptaro-italiane u vra dhe shumë nga të mbijetuarit u kapën rob.³³⁴

Rrethimi i Beogradit

Lumi Danub ishte kufiri midis territorit islam në Evropë dhe botës së krishterë; jugu iu përkiste muslimanëve dhe veriu të krishterëve. Beogradi shtrihet në bregun jugor të lumit Danub, dhe në atë kohë ishte nën sundimin e Hungarisë. Osmanët e ndjenë si domosdoshmëri që ata ta merrnin nën kontroll këtë qytet, për t'i siguruar muslimanët në Serbi, kur ata të përballëshin me ushtritë e bashkuara të krishtera, që sulmoheshin nga veriu, dhe të ishin të aftë të vazhdonin xhihadin e tyre drejt Hungarisë. Kështu, Sulltan Fatih Mehemmedi, marshoi me ushtrinë e tij drejt Beogradit në vitin 860/1456, ndërsa një grup anijesh muslimane mbërriti në vendin e luftës nëpërmjet lumit Danub. Por gjatë përpjekjeve të tij për të nënshtruar qytetin, sulltani u përball me vështirësi të mëdha, për shkak të pozitës strategjike të këtij qyteti, në vendin ku bashkoheshin lumenjtë Danub dhe Sava, që serbëve iu mundësonte marrjen e përforcimeve të shpejta dhe të sigurta. Për më tepër, qyteti ishte i fortifikuar mirë dhe ishte hapur një hendek rrethues uji, dhe për këtë arsye rrethimi i tij nuk mund të arrihej plotësisht. **Karaxha Beu** kishte kërkuar leje për ta kaluar Danubin, por kjo nuk ishte pranuar nga bejlerët e Rumelisë, me arsyetimin se ky kalim do të rrezikonte të gjithë ushtrinë muslimane. Nëpërmjet Danubit, Beogradi merrte përforcime edhe nga mbreti hungarez. Për shkak të gjithë faktorëve të lartpërmendur, muslimanët

334 Danişmend, I, fq. 272-278.

nuk arritën ta hapnin këtë qytet dhe u tërhoqën pas një beteje të ashpër me armikun.³³⁵

Gjatë rrethimit të Beogradit, fuqitë e vendeve të krishtera evropiane kishin formuar një ushtri kryqëzate aleate kundër osmanëve. Me nxitjen e **Papës Kaliksus III**, të familjes **Borxhia**, dhe përpjekjeve të priftit italian **Xhovani di Kapistrano (Giovani di Capistrano)**, u krijua një ushtri e fuqishme prej 60.000 luftëtarësh, që u rekrutuan nga Italia, Gjermania dhe Bohemia për ta mbrojtur Beogradin nga osmanët. **Janosh Hunjadi** i Hungarisë ishte bashkuar në ndihmë të kësaj force me ushtarët e tij dhe kishte sjellë dhe 200 anije në lumin e Danubit. Flota osmane u detyrua të tërhiqej dhe flota e krishterë zotëroi Danubin. Vetëm në një rast, ushtria osmane arriti të hynte në qytet, por Kapistrano i zmbropsi forcat osmane, pasi ai kishte marrë shumë përforsime. Fatih Mehemedi e drejtoi personalisht ushtrinë e tij gjatë përpjekjeve për të depërtuar në qytet, por ai u plagos nga një heshtë dhe u detyrua të ndalonte sulmin. Gjatë këtyre luftimeve, Bejlerbeu i Rumelisë, **Karaxha Pasha** dhe **Hasan Aga** i jeniçerëve, ranë dëshmorë. Në anën tjetër, u plagosën **Janosh Hunjadi** dhe **Xhovani di Kapistrano**. Këta të dy, më vonë iu dorëzuan plagëve dhe vdiqën.

Hapja e Serbisë ndaj Islamit në 863/1459

Mbreti serb, **Gjorgje Brankoviç**, vdiq në vitin 860/1456 dhe vendin ia zuri i biri, **Llazari**. Por edhe ai vdiq pak kohë pas ardhjes në fron. Në këtë mënyrë u ngrit problemi i trashëgimisë, përkatësisht me sundimin dhe administrimin. **Mara**, e bija e Brankoviçit, ishte martuar me Sulltanin osman, Muradin II, dhe ishte njerka e Fatih Mehemedit. Serbët e quanin atë **Carica**. Në këtë mënyrë, edhe Fatihu ishte midis atyre që pretendonin se kishin të drejtën e sundimit të Serbisë. Pretendentët e tjerë ishin: dy vëllezërit e Marës; vejusha e Lllazarit, **Elena**; dhe

335 Neşri, *vepër e cituar*, II, fq. 723-725; Tursun Beğ, *vepër e cituar*, fq. 80-83.

Mbreti i Bosnjës si dhëndër i Llazarit. Duke e ditur se nuk do të ishte e aftë të mbronte e vetme Serbinë kundër turqve, mbretëresha Elena ia transferoi të drejtën e saj Papës, i cili pasi dërgoi një kardinal atje, pranoi që ta merrte sundimin e Serbisë.³³⁶

Ushtria osmane marshoi drejt Gadishullit të Moresë (Peloponezit) dhe në vitin 861/1457, hapi atje disa territore ndaj Islamit, ndërkohë që Fatihu kaloi dimrin në qytetin e Yskypit (Üsküp) (Shkupit). Ai, gjithashtu, dërgoi Vezir-i A'zamin **Mahmud Pashanë**, në disa zona të Serbisë, për t'i hapur ato ndaj Islamit, ndërkohë që me ushtrinë e tij marshoi drejt Semendires (Smederevës), që në atë kohë ishte kryeqyteti i Serbisë. Kështjella e Semendires iu dorëzua përfundimisht Fatihut, duke bërë të mundur aneksimin e plotë të Serbisë në vitin 863/1459.³³⁷ Ky veprim u justifikua me faktin se Fatihu kishte të drejtën e tij si një nga pretendentët trashëgimtarë.³³⁸ Rezultati ishte që Serbia shpëtoi nga konfliktet e sigurta që do të krijoheshin midis pretendentëve të ndryshëm dhe serbët jetuan për shekuj me radhë nën sundimin osman, duke qenë plotësisht të lirë të ushtronin besimin e tyre fetar dhe praktikat e tyre ortodokse. Në anën tjetër, nëse mbështetësit e Papës, që vepronte në emër të mbretëreshës Elena, do të kishin qenë të suksesshëm, serbët ndoshta do detyroheshin ta ndryshonin besimin e tyre, nga ortodoks në katolik. Ata nuk do të ishin toleruar të mbeteshin ortodoksë.

Hapja e Pontusit ndaj Islamit në 865/1461

Fakti që Stambolli ishte tashmë nën zotërimin osman, i frikësonte fuqitë evropiane dhe krijoi tek ata një pësjtjellim alarmues. Gjithashtu, venedikasit dhe gjenovezët, që ishin dy fuqitë e mëdha detare të asaj kohe dhe që jetonin në kushte

336 Danişmend, I, fq. 279-280.

337 Tursun Beğ, *vepër e cituar*, fq. 91-105.

338 Danişmend, I, fq. 283.

mjaft të mira në saj të kolonizimit dhe tregtisë, u gjendën në një situatë jo të volitshme. Nga kjo situatë u arrit në përfundimin se ishte e nevojshme të arrihej një aleancë me shtetet e tjera në kufijtë lindorë të territoreve osmane, në mënyrë që të rrethohej armiku i tyre i përbashkët.

Papa Piu II, e filloi këtë fushatë duke dërguar **Ludovikun** drejt Gjeorgjisë në vitin 862/1458. Ludoviku arriti të krijonte me sukses një aleancë me Perandorinë Pontus të Trebizondit, Gjeorgjisë, dhe me Devletin turkoman Akkojunllu (Ak Kojunllu).³³⁹ Perandori i Pontusit kishte martuar vajzën e tij Katerina (Despina) me **Uzun Hasanin**, Padishahun e Devletit Akkojunllu, me shpresën se ky i fundit do ta ndihmonte atë në rast nevoje kundër osmanëve. Uzun Hasani (sundoi 1453-1478), sovrani i Persisë Perëndimore dhe Anadollit Lindor, sulmoi qytetin osman të Amasjas. Sulltan Fatihu, pasi bëri përgatitjet e nevojshme, e drejtoi ushtrinë e tij drejt Lindjes, ndërkohë që edhe flota osmane lundroi në Detin e Zi. Fatihu nuk e tregonte asnjëherë destinacionin e tij gjatë fushatave të xihadit, ndërsa thënia e tij: “Nëse një qime e vetme nga mjekra ime, do ta merrte vesh se ku po shkoj, unë do ta prisja atë menjëherë”, është e famshme. Si fillim, ai marshoi drejt Amasras, që shtrihej në brigjet e Detit të Zi dhe që ishte nën sundimin e Gjenovës. Edhe flota osmane mbërriti po aty. Gjenovasit iu paguanin tagër osmanëve, por ata ishin të dëmshëm për mjedisin musliman. Sundimtari gjenovas, duke e ditur se qëndresa ishte e kotë, u dorëzua dhe Amasra u aneksua në vitin 864/1460 pa luftë.³⁴⁰

Më pas, ushtria osmane iu drejtua Sinopit, që ishte nën drejtimin e Bejlikut turkoman Xhandarogllu. Sundimtari i këtij beljiku, **Ismail Beu**, ishte një person i arsimuar dhe i ditur. Në mënyrë që të mos zhvilloheshin luftime, osmanët i kërkuan atij të bashkohej me ta në përputhje me “*ed Dinu en Nasiha*” (Feja

339 Uzunçarşılı, *Osmanlı Tarihi*, Ankara, 1983, vëllimi II, fq. 52, poshtëshënimi 1.

340 Ibn Kemal, *Tevarih-i Al-i Osman*, vëllimi V, fq. 179.

është këshillë e mirë). Duke qenë një person i arsimuar dhe i ndërgjegjshëm, Ismail Beu e dorëzoi bejlikun e tij dhe u bashkua me Devletin Osman, edhe pse Sinopi kishte një kështjellë të fortifikuar mirë, kishte 400 armë zjarri, 2000 artiljerë dhe disa anije në port; ai shmangu gjakderdhjen. Ismail Beu u trajtua mjaft mirë, u nderua dhe u respektua. Të ardhurat e mbledhura nga taksat e Jenishehirit, Inegolit dhe Jarhisarit iu caktuan si *dirlik* (të ardhura për të jetuar në komoditet). Më pas, ai u caktua si *saxhakbej* i Filibes në Evropë dhe jetoi një jetë të nderuar.³⁴¹ Me këtë veprim, ai fitoi një pozitë me famë të lartë në shoqëri, ndërkohë që osmanët arritën një sukses tjetër për qëllimin e tyre, atë të bashkimit të Anadollit. Në atë kohë, Bejliku i Karamanit ishte i vetmi që mbeti jashtë territoreve të kontrolluara nga osmanët.



Hamami i Ismail Beut, Devrekani, Kastamonu.

341 Tursun Beğ, *vepër e cituar*, fq. 107-108; *Netajixh*, I, fq. 42.

Veprimi i Ismail Beut është një akt i rëndësishëm dhe mjaft domethënës. Ai hoqi dorë nga autoriteti i tij si sovran i pavarur, por u kthye në një personalitet të rëndësishëm për administratën osmane, Devletin bashkues të muslimanëve në Anadoll dhe në Evropë.

Padishahu Uzun Pasha dërgoi nënën e tij, **Sare Hatunen**, për t'i kërkuar falje Sulltan Mehemmedit dhe për ta bindur atë të mos e merrte Trebizondin, vend që ai mendonte se ishte qëllimi i sulltanit. Sulltan Fatihu ishte një përkrahës i rreptë i vlerave morale të Islamit dhe kishte një respekt të madh për zonjën, por në aspektin fetar, ai ishte i mendimit se duhej t'i jepte fund Perandorisë së Pontusit.³⁴² Ai dërgoi **Mahmud Pashanë** në krye të ushtrisë, për ta parandaluar perandorin që të arratisej në ndonjë vend tjetër. Sulltan Fatihu i shoqëruar nga vetë **Sare Hatun** vazhdoi marshimin, edhe pse në disa raste rruga mbi kalë ishte e pakalueshme. Sare Hatun shprehu shqetësimin e saj duke i thënë Fatihut: “O bir, sa mundim të rëndë ke marrë mbi shpatullat e tua për qytetin e Trabzonit,” dhe Fatihu iu përgjigj: “Nënë, ky mundim nuk është ndër-marrë për hir të qytetit të Trabzonit, por për hir të Allahut. Ne mbajmë shpatën e Islamit. Nëse nuk do ta ndërmerrnim këtë mundim, ne nuk do ta meritonim emrin “gazi” (luftëtar në Luftën e Shenjtë), dhe ne do të ishim gjendur në një pozitë të turpshme në Botën e Përtejme përballë Hakut Sublim (Allahut).”³⁴³ Me këto pak fjalë, por që ishin shumë të sakta dhe shprehëse, sulltani i shpjegoi asaj me saktësi synimet dhe misionin e Devletit Osman. Ai arriti në Trebizond dhe e gjeti atë të rrethuar nga anijet osmane që ai kishte dërguar aty. Perandori **David Komneni** u detyrua të dorëzohej dhe për pasojë Perandoria e Pontusit, themeluar nga romakët në vitin 1204 e.s., kur evropianët e Kryqëzatës së 4-të pushtuan Kostandinopojën, ra në vitin 865/1461.³⁴⁴ Perandori i fundit,

342 *Netajixh*, I, fq. 42.

343 *Neşri*, II, fq. 752.

344 *Tursun Beğ, vepër e cituar*, fq. 110; *OT*, II, fq. 55.

David Komneni dhe familja e tij u dërguan në Stamboll dhe më pas në Edrene, ku osmanët i dhanë atij edhe një *has* (një pjesë të madhe toke për të jetuar), në afërsi të Ustruma Karasu, si dhe një shumë vjetore prej 300.000 akçe (monedha në qarkullim e osmanëve). Në vend që ai të tregohej mirënjohës ndaj mirësisë dhe bujarisë së treguar, ish-perandori mbajti korrespondencë me bashkëshorten e Uzun Hasanit, një veprim ky që mund të kishte qenë i rrezikshëm për osmanët, pasi Uzun Hasani ishte kreu i Devletit të fuqishëm Akkojunllu dhe rival i osmanëve. Të vendosur për të mbajtur bashkimin e Devletit të tyre me çdo kusht, osmanët në mënyrë të shpejtë dhe të vendosur, u morën me këtë rrezik të madh. Perandori dhe djali i tij u burgosën në Edrene dhe më pas në vitin 867/1463, u ekzekutuan në Stamboll.³⁴⁵

Hapja e territoreve të reja ndaj Islamit në Shqipëri

Gjatë periudhës së sundimit të Sulltan Muradit II, disa vende në Shqipëri ishin hapur ndaj Islamit. Ishte e vështirë të avancohej në ato toka të thepisura dhe të pakalueshme. Mbreti i Napolit dhe i Aragonës, **Alfonsi V**, synonte të krijonte një perandori në rajonin e Ballkanit dhe të Mesdheut. Për këtë arsye, ai nxiti Skënder Beun (Gjergj Kastriotin), që ishte rritur në pallatin osman, të arratisej, dhe ai u angazhua në përpjekje armiqësore kundër Devletit Osman në Shqipëri.

Me nxitjen e **Papës**, u nënshkrua një traktat midis Skënder Beut dhe Mbretit të Napolit në vitin 855/1451. Sipas këtij traktati, Mbreti i Napolit duhet të mbështeste dhe të ndihmonte Skënder Beun, që e kishte frikë Devletin Osman dhe në këmbim

Duke rrëfyer për hapjen e Pontusit ndaj Islamit, Ibn Kemali thotë se Sulltan Fatihu ishte Halifi: "... *ol vilayet havza-i, himayet-i Padishah-i Hilafet-penahda dahil olduğunu beyan eyler*", *vepër e cituar*, vëllimi VII, fq. 194. Ai i jep atij emrin e njëjtë kur i referohet ceremonisë së synetit të djalit të Fatihut, Xhemit: "*Hazret-i Padishah-i Hilafet-penahda ...*", *vepër e cituar*, vëllimi VII, fq. 296.

345 OT, II, fq. 55-57.

ai do ta njihë Mbretin, Alfons V, si sundimtarin e tij. Kështu, duke u përpjekur t'i shmangej sovranitetit osman, Skënder Beu ishte në procesin e nënshtrimit ndaj Mbretit të Napolit. Tre vjet pas nënshkrimit të traktatit, në monedhat që qarkullonin në Shqipëri u gdhend emri i Mbretit të Napolit. Një përfaqësues i mbretit ishte në qytetin e Krujës. Republika e Venedikut, gjithashtu, kishte interesa në rajon dhe kishte disa vende në zotërim, por kur Devleti Osman mori qytetin e Stambollit, në vitin 857/1453, Venediku pësoi një humbje të madhe në Lindje, dhe për këtë arsye mendoi se ishte më e rëndësishme të drejtonte energjitë e saj atje, ndaj hoqi dorë nga lufta me Skënder Beun.

Në vitin 859/1455 **Skënder Beu** rrethoi qytetin e Beratit, i cili ishte nën zotërimin osman, por nuk arriti gjë me këtë rrethim. Për më tepër ushtria shqiptare, që ishte e mbështetur nga një numër i madh ushtarakësh napolitanë, ishte mposhtur keq nga një bej akënxhë, djali i **Evrenos Beut**. Kjo ishte goditje e rëndë për namin e **Skënder Beut**. Mbreti i Napolit, që nuk dëshironte ta humbiste hegjemoninë e tij në Shqipëri, shpejtoi t'i dërgonte përforcime Skënder Beut dhe e bindi dhe Papën të dërgonte përforcimet e tij. Në këtë mënyrë u bashkuan një numër i madh ushtarësh nga Franca, Gjermania dhe Serbia në vitin 860/1456 për të shpëtuar Shqipërinë.

Pas vdekjes së **Alfonsit V**, Mbretit të Napolit dhe të Aragonës, në vitin 868/1458, Skënder Beu humbi një mbështetës të fortë. Për këtë arsye, ai u detyrua të njihë sovranitetin osman dhe në vitin 864/1460 t'i paguante Devletit Osman tagër. Por i nxitur nga Papa dhe ambasadori i Venedikut, ai e shkeli traktatin në vitin 866/1462, dhe iu kthye konfliktit armiqësor. Usharët turq Akënxhinj sulmuan; nuk pati asnjë rezultat të qartë, por pozita e Skënder Beut vazhdoi të përkeqësohej.

Papa Piu II ishte në procesin e përgatitjes së një kryqëzate të re kundër Devletit Osman. Për këtë arsye Devleti Osman e la mënjanë problemin me **Skënder Beun**, që zakonisht strehohej

në malet e larta shkëmbore, kur ishte në situatë të vështirë dhe në vitin 867/1463, nënshkruan një traktat paqeje me të.³⁴⁶

Skënder Beu (Gjergj Kastrioti), i cili u kthye në një mjet në duart e venedikasve dhe hungarezëve, në vitin 868/1464 e shkeli sërish traktatin i nxitur nga këto fuqi të krishtera, dhe u hodh në sulm kundër ushtarëve osmanë. Në këto luftime **Ballaban Beu** arriti t'i mundte shqiptarët. Pas rënies dëshmor të **Jakub Beut**, gjatë betejave të fundit, Sulltan Fatihu vendosi të marshonte personalisht drejt Shqipërisë.

Sulltan Fatihu hapi disa kështjella të rëndësishme gjatë fushatës së tij në vitin 870/1466 dhe rrethoi qytetin e Krujës, kryeqendrën e Gjergj Kastriotit/Skënder Beut. Ishte tepër e vështirë, për të mos thënë e pamundur ta nënshtroje kështjellën e Krujës, që ishte ndërtuar në një pikë shumë të lartë dhe të thepisur. Për këtë arsye, Sulltan Fatihu ndërtoi kështjellën e Elbasanit pranë saj, për të kontrolluar atë qytet dhe për ta kthyer rajonin në një vend të banueshëm, duke siguruar kontrollin e vazhdueshëm të atyre zonave. Ballaban Beu u caktua në drejtimin e rrethimit të kështjellës së Krujës.

Gjergj Kastrioti/Skënder Beu, për shkak të sëmundjes së malaries, ndërroi jetë në vitin 872/1468 në qytetin e Lezhës dhe Kruja u mor nga venedikasit. Gjergj Kastrioti jetoi si peng në oborrin osman në Stamboll dhe kur u konvertua në musliman, mori emrin Iskender (Skënder) Bej. Por, ai u arratis dhe u kthye në femohues, për këtë arsye ai u varros në Kishën e Shën Nikollës në Lezhë. Kruja ishte marrë nga osmanët, por kur Gjergj Kastrioti u arratis, ai e fitoi atë me dredhi. Si përfundim, në vitin 883/1478, Devleti Osman e hapi Krujën ndaj Islamit. Si rezultat, lufta për të marrë Shqipërinë, midis Republikës së fuqishme të Venedikut dhe Devletit Osman, mbaroi me fitoren e këtij të fundit.³⁴⁷

346 OT, II, fq. 64-67.

347 Danişmend, I, fq. 305, 311, 339.

Princi Vlad i Vllahisë, Gjakatari

Vlad Tepesh (sundoi në vitet 1446-1462), i biri i **Drakulas** (sundoi në vitet 1432-1446), që u rrit në oborrin osman, në vitin 1456, me ndihmën e osmanëve, arriti të merrte titullin Vojvoda (Princ) i Vllahisë. Si fillim, ai tregoi ndaj Devletit Osman besnikërinë e tij dhe paguante rregullisht tagër.³⁴⁸ Por, ai do t'iu kundërvihet osmanëve pas aneksimit të Trabzonit, duke bashkëpunuar fshehurazi me Hungarinë kundër tyre. Ai, madje, vrau Hamza Beun e Nishit dhe kishte fituar famë për faktin se i ngulte mbi hunj viktimat e tij. I zemëruar nga mashtrimi i Vladit, në vitin 866/1462, Sulltan Fatihu marshoi me ushtrinë kundër tij deri sa arriti në Vidin. Së bashku me ushtrinë e Sulltan Fatihut, mbërriti në Vidin nëpërmjet lumit të Danubit edhe një flotë osmane, por ata nuk e gjetën Vladin. Më pas Vladi komplotoi për vrasjen e Fatihut, gjatë sulmit të një nate, por dështoi në planin e tij dhe u largua drejt Hungarisë. Për këtë arsye, Sulltan Fatihu caktoi vëllain e Vladit, **Radulin** (sundoi 1462-1479), si Vojvodë të Vllahisë.³⁴⁹ Mbreti i Hungarisë, **Matjash Korveni** (sundoi 1458-1490) nuk e pranoi kërkesën e Vladit për ndihmë dhe e burgosi atë, ku dhe vdiq i turpëruar.³⁵⁰

Ndërkohë, flota osmane bllokoi ishullin Midil-li, që ndodhet pranë brigjeve të Anadollit. Duke qenë një territor me banorë shumica nga Gjenova, ky ishull ishte kthyer në bazë telashesh për muslimanët, derisa u dorëzua në vitin 866/1462.³⁵¹

348 Tursun Beğ, *vepër e cituar*, fq. 111.

349 Ibn Kemal, VII, fq. 217.

350 Po aty, fq. 118.

351 Enveri, *Düsturname*, botuar nga M. Halil Yinanç (Stamboll, 1928), fq. 100; Danişmend, I, fq. 298.

Enveriu, i cili, në vitin 869/1464-5 shkruajti librin e tij për Mahmud Pashanë, Sadrazamin e Fatihut, shkruan se pas hapjes së ishullit ndaj Islamit, Fatihu thirri *ezanin*, fq. 101. Thirrja e *ezanit* pas hapjes së një territori të ri ndaj Islamit, ishte një praktikë e osmanëve, për të treguar se një vend nuk ishte më në duart e jobesimtarëve dhe se ishte kthyer në *Daru'l-Islam*.

Hapja e Bosnjës ndaj Islamit

Hapja e Stambollit ndaj Islamit, e vuri rrugën e tregtisë midis Detit të Zi dhe Mesdheut, nën sundimin osman, ndërkaq hapja e Serbisë ndaj Islamit, shtrirja e shpejtë e osmanëve drejt perëndimit, shkaktuan një shqetësim të madh dhe alarm për perëndimin e krishterë. Papa ndërmori organizimin e një Kryqëzate të re, si dhe u vendosën marrëdhënie të fshehta midis Uzun Hasanit, rivalit të territorit lindor të osmanëve dhe Republikës së Venedikut, fuqisë së madhe detare të kohës. Njëri nga ata që iu përgjigj me entuziazëm thirrjes së Papa Piut II për organizimin e një Kryqëzate, ishte mbreti i Bosnjës, **Stefan Tomasheviç**. Duke pasur një organizim të mirë të rrjetit të tij të informatorëve, Sulltan Fatihu mori në kohën e duhur lajme për të gjitha këto veprime dhe u mendua se si duhej të vepronte.

Sadrazami Mahmud Pasha u nis në krye të pararojës drejt Bosnjës, dhe Sulltan Fatihu arriti ta aneksonte atë, për Devletin Osman, në vitin 867/1463.³⁵² Popullsia e krishterë **Bogomile** në Bosnjë, ishte shumë e ngjashme me atë muslimane në aspektin fetar: ata e njihnin dhe e pranonin **Jezu Krishtin** si një Profet dhe rob të Zotit, por jo si birin e Zotit. Bogomilët kishin dhe një emër tjetër: Pataren. Për këtë arsye, osmanët i quanin ata Poturogullarë (Potur oğulları) (djemtë e Poturit). Ky grup i madh e përqafoi fenë islame brenda një kohe shumë të shkurtrë. Mjaft i kënaqur me këtë konvertim masiv, Sulltan Fatihu dëshiroi t'iu bënte atyre një favor. Dhe, ashtu sikurse ata dëshiruan, ai i mori boshnjakët nën shërbimin ushtarak dhe në pallat, ashtu siç dëshironin ata; pasi ishin shumë besnikë në shërbimin e tyre.³⁵³

Tashmë objektivi tjetër i osmanëve ishte Hercegovina, mbreti i së cilës gjysmën e vendit ia dorëzoi Devletit Osman në shenjë të besnikërisë dhe vullnetit të tij të mirë që kishte ofruar,

352 Tursun Beğ, *vepër e cituar*, fq. 121-128; Danişmend, I, fq. 300-301; OT, II, fq. 82.

353 OT, II, fq. 84-85.

që i biri të vihej në shërbimin e sulltanit osman. Mbreti i Hercegovinës vdiq pak kohë më pas dhe osmanët aneksuan dhe pjesën e mbetur të Hercegovinës. Djali i tij, i mirënjohur si **Hersegzade Ahmed Pasha**, pasi deklaroi si fenë e tij Islamit, u emërua vezir dhe më pas sadrazam.³⁵⁴ Trajtimi njerëzor i Fatihut dhe i pasardhësve të tij ndaj banorëve të rajonit, u dha atyre frymëzimin për t'iu bashkuar në masë besimit Islam.

Republika e Raguzës

Fuqia e Venedikut ishte gjithmonë një faktor për t'u shqetësuar për Republikën e Dubrovnikut (Raguzës). Për këtë arsye, ky vend e njohu me vullnetin e tij të lirë praninë osmane në Bosnjë, i ofroi besnikërinë Devletit dhe premtoi se do t'i paguante 75.000 kurush çdo tre vjet. Si një gjest tjetër për t'u mbrojtur kundër çdo sulmi të mundshëm nga Venediku, ata iu ofruan osmanëve një pjesë të territorit të tyre në kufi me Venedikun. Gjerësia e territorit që ata i dhanë osmanëve ishte një distancë e largët, që mund të matej me një orë e gjysmë. Në këtë mënyrë, banorët e Dubrovnikut jetuan të sigurt dhe të qetë nën mbrojtjen osmane, për më shumë se 400 vjet, derisa **Napoleon Bonaparti** e pushtoi në vitin 1215/1800 këtë Republikë, që më pas do të përfshihej nën administrimin e Austrisë.³⁵⁵

354 Një person i konvertuar arrin deri në personin e *parë* pas sulltanit. Kjo tregon dhe provon faktin që Devleti Sublim Osman, vepronte në përputhje me parimet themelore të Islamit; cilido që meriton një post e merr atë, pa dallim origjine dhe race; nuk kishte asnjë strukturë socio-politike në atë kohë. Por, perëndimorët këmbëngulin për ta paraqitur Devletin Islam të osmanëve si Devlet Turk, duke i hequr në këtë mënyrë identitetin e tij islam dhe atë ua paraqesin muslimanëve të tjerë si një fuqi "perandorake" e "huaj".

A është e mundur për një vend perëndimor, që në ditët e sotme të ketë një president apo një kryeministër të një race tjetër, i cili së fundmi është bërë shtetas i këtij vendi? Kush është më "njerëzor", "kush vepron sipas parimeve njerëzore" apo më "moderne": Devleti Sublim Osman apo një shoqëri/shtet bashkëkohor perëndimor?

355 *Netajixh*, I, fq. 69-70.

Hapja e Moresë (Peloponezit) ndaj Islamit

Njëri nga sklleverit e osmanëve grabiti një shumë të madhe parash nga Thesari i Athinës dhe u arratis drejt Koronës, që shtrihej në jug të Moresë (Peloponezit) dhe që ishte nën zotërimin e Venedikut. **Isa Beu**, djali i Evrenos Beut, kërkoi që skllavi të kthehej së bashku me shumën e parave që kishte marrë, por venedikasit nuk pranuan ta kthenin skllavin me pretekstin se ai ishte i krishterë, duke mohuar kështu edhe vjedhjen. Pas këtij veprimi, osmanët e hapën ndaj Islamit qytetin Argos, që ishte nën sundimin venedikas dhe aneksuan tokat e tjera rreth Inebahtës (Lepantos). Në këtë mënyrë, filloi lufta osmano-venedikase, që zgjati 16 vjet (1463-1479). Në të vërtetë, kjo ngjarje ishte vetëm një pretekst për luftë. Shkaqet e vërteta ishin se Papa kishte nënshkruar një aleancë të re me fuqitë e krishtera kundër osmanëve dhe të krishterët e Evropës ishin marrë vesh me Bejlikun e Karamanogllut, si dhe me Uzun Hasanin, Padishahun e Akkojunllusë kundër osmanëve. Në këtë kontekst, mbreti i Hungarisë nënshkroi një traktat me Republikën e Venedikut më 12 Shtator 1463, në Petervaradin, sipas të cilit venedikasit do t'i sulmonin osmanët nga fronti detar i Moresë dhe Shqipërisë, ndërkohë që hungarezët do t'i sulmonin ata nga Bosnja. Republika e Venedikut mori në shërbimin e saj Skënder Beun dhe e ndihmoi atë duke i dërguar ushtarë, para dhe municione. Mbreti i Hungarisë, **Matjash Korveni**, hyri në territorin e Bosnjës, por u largua shumë shpejt prej aty, pasi **Mahmud Pasha** iu afrua rajonit një vit më vonë. Pas kësaj, ushtria osmane duke lënë Bosnjën, marshoi drejt Moresë dhe hapi të gjitha qytezat e gadishullit ndaj Islamit. Në vitin 870/1466 Republika e Venedikut arriti të mbante vetëm disa kështjella në këtë rajon, të cilat i kishte në zotërim përpara luftës.

Aneksimi i Bejlikut të Karamanit

Pas vdekjes së Ibrahim Beut të Karamanit në vitin 868/1464, në krye të këtij bejliku u vendos djali më i madh, Is'haku, që kishte lindur nga lidhja e tij me një konkubinë. Por, vëllai më i vogël i Is'hakut dhe i biri i njëjës prej vajzave të Sulltanit osman, Çelebi Mehemmedit, **Pir Ahmet Beu** kërkoi ndihmën e Sulltan Fatihut kundër vëllait. Fatihu iu përgjigj kërkesës së tij dhe Pir Ahmed Beu u bë sundimtar i Bejlikut të Karamanit në vitin 868/1464.³⁵⁶

Në fillim, Pir Ahmed Beu i dha në shenjë falënderimi Devletit Osman qytetet e Aksshehirit, Bejshehrit, Ëllgënit dhe Sakllanhisarit, por më pas ai nënshkroi një traktat me Republikën e Venedikut kundër osmanëve, dhe, megjithëse kishte premtuar besnikëri, dhe bindje të pakushtëzuar ndaj tyre, ai nuk e mbajti fjalën për të mbështetur operacionet ushtarake të Sulltan Fatihut kundër **Uzun Hasanit**, Padishahut të Devletit Akkojunllu në Iran. Për këtë arsye, Sulltan Fatihu i shtyu operacionet ushtarake të planifikuara dhe marshoi me ushtrinë e tij kundër Bejlikut të Karamanit dhe e mori kryeqytetin Konja. Më pas, ai dërgoi Mahmud Pashanë në Larendë (Karaman) dhe e mori edhe atë, duke e aneksuar këtë bejlik të fundit në vitin 871/1466, me përjashtim të Tashelisë.³⁵⁷ Sulltani caktoi djalin e tij, Shehzade Mustafanë në drejtimin e administratës së kësaj province të re. Duhet theksuar fakti që Bejliku i Karamanit i humbi të gjitha territoret e tij përveç Tashelisë, por kjo familje kishte krijuar marrëdhënie të ngushta me Republikën e Venedikut dhe Uzun Hasanin. Për këtë arsye, ata do të largoheshin nga skena e historisë në vitin 879/1474, kur osmanët morën dhe qytetin e tyre të fundit, Silifke.

Ndërkohë, **Mahmud Pashai** drejtoi flotën osmane nga Gelibollu dhe e aneksoi nga zotërimi venedikas, kundër të cilëve lufta vazhonte, ishullin Egriboz, që ishte ishulli më i

356 Neşri, II, fq. 780.

357 Danişmend, I, fq. 306.

madh në Detin Egje, në vitin 873/1469.³⁵⁸ Aneksimi i ishullit shënoi fundin e hegjemonisë 260 vjeçare të Republikës së Venedikut si fuqi e madhe detare e asaj kohe.

Beteja e Otlukbelit 878/1473

Pas ikjes së tij nga kryeqyteti Konja, **Pir Ahmed Beu** u përpoq të fitonte mbështetjen e **Uzun Hasanit**, që ishte një turk Akkojunllu dhe kishte themeluar Devletin e tij në Iran; që kishte marrë Irakun dhe Azerbajxhanin dhe kishte mundur në betejën e Arasit të vitit 1469 Hanin e Turkestanit, Ebu Sa'îd (830-873/1427-1469). Uzun Hasani e shikonte veten me të drejtë si trashëgimtarin e ligishëm të Il-Hanllëve dhe Timurive. Ai dërgoi **Jusuf Mirzain**, djalin e xhaxhait të tij, në territorin osman dhe e shkatërroi qytetën Tokat.³⁵⁹ Ai, gjithashtu, lidhi aleancë me Republikën e Venedikut kundër Devletit Osman dhe dërgoi lajmëtarë në ishullin e Rodosit, në përpjekje të krijimit të një aleance me ata që u vetëquajtën “Kalorës të Shën Xhonit”.³⁶⁰ Uzun Hasani mbajti lidhjet me Papën, Mbretin e Hungarisë, Polonisë, Napolit, me vojvodën e Bogdanit (Moldavisë) kundër osmanëve. Ndërkohë, forcat detare të krishtera shkatërruan kështjellat e qyteteve të Mugllas (Muğla) dhe Antaljas, morën takim me të dërguarit e Uzun Hasan Beut dhe u rikthyen në ishullin e Rodosit. Uzun Hasani u kërkoi aleatëve t'i dërgonin armë, artiljerë etj. Në të vërtetë, ata ia dërguan të

358 *Netajixh*, I, fq. 43.

359 Oruç Beğ, *vepër e cituar*, fq. 123; Neşri, II, fq. 802.

360 Ushtarët e ishullit të Rodosit u vetëquajtën “Kalorës të Shën Xhonit”. Ata ishin të origjinave dhe prejardhjeve të ndryshme, dhe vinin nga vende të ndryshme të Evropës për “të luftuar kundër jobesimtarëve turq”, siç i përshkruanin ata osmanët, dhe kishin një përgatitje ushtarake shumë të disiplinuar. Në të njëjtën kohë, fjala “turk” nuk u përdor vetëm për t’iu referuar osmanëve, por u kthye edhe në një sinonim për “musliman”, për arsye të faktit që Islami përfaqësohej nga turqit osmanë. Me pak fjalë, “konvertimi i një perëndimori në fenë islame, ishte konvertimi i tij në turk”, edhe në rastet kur konvertimet zhvilloheshin në Fez apo Isfahan. (Bernard Lewis, *The Emergence of Modern Turkey*, Oxford University Press: 1968), fq. 13.

gjitha, por nuk arritën në kohë. Për të justifikuar luftën kundër osmanëve, **Uzun Hasani** u kërkoi atyre t'i jepnin Trabzonin me pretekstin se ai ishte i lidhur me perandorin e tij të fundit ³⁶¹ dhe kur forcat Akkojunllu hynë në territorin osman, beteja ishte e pashmangshme.

Sulltan Fatihu kishte për qëllim të siguronte mbrojtjen e kufijve në perëndim të Devletit Osman, përpara se të marshonte në drejtim të Uzun Hasanit dhe ushtrisë së tij. Për këtë arsye, ai kërkoi nënshkrimin e një traktati paqeje me Republikën e Venedikut. Por duke qenë se kjo e fundit vendosi si kusht rimarrjen e ishullit Egriboz, që ishte hapur rishtazi ndaj Islamit, negociatat për vendosjen e paqes nuk patën sukses.³⁶²

Sulltan Fatihu marshoi kundër Uzun Hasanit dhe ata u përballën në Otlukbeli, afër Erzurumit, në pjesën lindore të Anadollit. Fillimisht, osmanët pësuan humbje të rënda, por shumë shpejt ata do të fillonin një sulm të suksesshëm me artilerinë e tyre, drejt qendrës së ushtrisë Akkojunllu. Në këtë betejë, që u zhvillua në vitin 878/1473, Uzun Hasani mezi arriti t'i shpëtonte vdekjes. Ushtria osmane fitimtare, nuk u vu në ndjekje të ushtarëve Akkojunllu dhe nuk shkuan më tutje, pasi nuk dëshironin ta shkatërronin atë vend musliman. Qëllimi i betejës së tyre ishte t'i jepnin një mësim Uzun Hasanit dhe ata e arritën këtë.³⁶³ Në shenjë falënderimi për fitoren e tij të lavdishme, sulltan Fatihu liroi 400 skllevër dhe konkubina.

Sulltan Fatih Mehemmedit i vinte keq që Uzun Hasani, një turk musliman, kishte krijuar aleancë me të krishterët kundër vetes së tij. Në *fet'Inamen* që i dërgoi sundimtarit të Horasanit, Husejn Bejkara, ai e njoftoi për këtë veprim të pahijshëm të Uzun Hasanit.³⁶⁴

361 OT, II, fq. 96, poshtëshënimi 1.

362 OT, II, fq. 97.

363 Tursun Beğ, *vepër e cituar*, fq. 166; Neşri, II, fq. 816; Ibn Kemal, VII, fq. 354.

364 OT, II, fq. 103.

Darab Beu, kujdestari i Shebinkarahisarit në pjesën e Anadollit, e dorëzoi qytetin pa bërë asnjë qëndresë dhe osmanët e shpërblyen atë duke i dhënë titullin Sanxhakbej të Çirmenit, në Evropën osmane.³⁶⁵ Ky ishte një shpërblim i zakonshëm, që osmanët iu jepnin muslimanëve të tjerë, të cilët nuk iu kundërviheshin atyre dhe kjo buronte nga dëshira për t'i bashkuar të gjithë muslimanët, dhe për të shmangur gjakderdhjen. Në këtë mënyrë u trajtuan Ismail Beu i Isfendijarit dhe Darab Beu i Shebinkarahisarit, të cilët dolën mbi bejlerët e tjerë të Devletit Osman.

Hapja e qyteteve Kefe dhe Azak ndaj Islamit 880/1475

Gjatë shekullit të 15-të, Gjenova ishte një fuqi madhore detare dhe kishte në zotërim kolonitë e Kefes, Azakut dhe Mankupit në brigjet veriore të Detit të Zi, dhe Detit Azak. Mallrat që vinin nga Kabuli, nëpërmjet Astrahanit dhe dy rrugëve të Persisë, dërgoheshin drejt Evropës, duke kaluar nëpërmjet porteve të këtyre qyteteve në Detin e Zi.

Sulltan Fatih Mehemmedi e drejtoi vëmendjen e tij në Krime, për të shtypur në dy fronte vojvodën e Bogdanit (Moldavisë), si dhe për të ndaluar shtrirjen e Knjazit të Moskës, që në atë kohë ishte Ivani III Vasiljeviç. Entiteti i Moskës ishte përpjekur të hiqte qafe hegjemoninë e devleteve Kipçak, që u krijuan me rënien e Kok Orda (Hordhisë së Artë), pas disfatës që i shkaktoi Emir Timuri në vitin 1396. Knjazi i Moskës ishte përpjekur të zgjeronte zotërimet e vendit të tij drejt veriut dhe perëndimit. Gruaja e tij, **Zoe (Sofia)**, kishte pasur shumë ndikim tek **Ivani III**. Ajo ishte e bija e **Tomasit**, vëllait të perandorit të fundit romak **Kostandin Paleologos**. Kur Sulltan Fatihu aneksoi pjesën jugore të Moresë në vitin 1460, Despoti i Moresë, Tomas Paleologos u largua drejt Italisë me një anije venedikase dhe përfitoi strehim nga **Papa**. Ai vdiq në Romë dhe vajza e tij

365 *Netajixh*, I, fq. 45.

Sofia qëndroi atje nën mbrojtjen e Papës. Papa Pali II kishte planifikuar ta martonte këtë vajzë romake me dikë që do t'i shërbente edhe luftës kundër Devletit Osman. **Kardinali Besarion**, që ishte me origjinë greke, i rekomandoi atij Ivanin III, Knjazin e Moskës. Kështu, Papa dërgoi lajmësit e tij tek Ivani III dhe ai e pranoi me mirënjohje të thellë propozimin. **Princesha Sofia** u dërgua nuse nga Papa në Moskë në vitin 877/1472. Shumë studiues dhe figura të artit nga Greqia, nga Perandoria Romake dhe nga vende të ndryshme shkuan në Moskë për këtë rast, dhe më pas u vendosën atje ku edhe themeluan një qendër të re kulture greko-italiane. **Pra, kjo martesë që u lidh në vitin 1472, shënoi një ngjarje të rëndësishme për krijimin e Rusisë.** Knjazi i Moskës ishte përpjekur dhe më parë të çlirohej plotësisht nga Devletet Kipçak; në anën tjetër, ai vendosi lidhje politike me mbretëritë evropiane dhe me Uzun Hasanin, rivalin më të fuqishëm të osmanëve në lindje. Tani që ai ishte martuar me një princeshë romake, ai pretendonte se ishte trashëgimtari i fronit të Perandorisë Romake, duke mbajtur edhe stemën e perandorisë që ishte një shqiponjë me dy koka. Por, ai nuk arriti ta kthente Moskën në qendrën e Ortodoksisë; ky pretendim më pas krijoi një rrymë të fuqishme në politikën e carëve.

Fatih Sulltan Mehemedi ishte tepër i kujdesshëm në ndjekjen e ngjarjeve që ndodhnin në botë, veçanërisht me çështjet që i përkisnin Devletit Osman. Për pasojë, ai nuk mund ta kishte nënvlerësuar një ngjarje kaq të rëndësishme dhe të rrezikshme në të njëjtën kohë.

Ai dërgoi në Krime, Gedik Ahmed Pashanë, në krye të një flote osmane të përbërë nga 300 anije. Ushtria osmane ankoroi në Kefe, që ishte kolonia më e rëndësishme e Gjenovës në brigjet e Detit të Zi dhe ata rrethuan kështjellën së bashku me ushtarët e Krimesë. Me ndihmën e veprimeve të **Skuerkiafikos (Squerciafico)**, një gjenovas që ishte kapur që më parë nga Sulltan Fatihu, dhe të ushtarëve të Krimesë e Armenisë në qytet, Kefe u dorëzua. Të njëjtin fat patën edhe Azaku dhe kolonitë e tjera të Gjenovës. Mankupi u hap ndaj Islamit në

vitin 880/1475.³⁶⁶ Me kërkesë të *ulemasë* dhe fisnikëve të tjerë të Krimesë (Kërëm), osmanët rrethuan **Mengli Gërajin** (v.1515) në 880/1475.³⁶⁷ Duke vendosur në këtë mënyrë një barrierë kipçake midis territoreve osmane dhe Ruisë, Sulltan Fatihu mori masat kundër shtrirjes së Ruisë drejt jugut. Vendet e hapura ndaj Islamit në veri u zgjeruan deri në afërsi të territorit të Kirkazit.³⁶⁸ Deti i Zi ishte në procesin e kthimit në një liqen musliman; vetëm brigjet e Kaukazit në lindje dhe brigjet e Bogdanit (Moldavisë) në perëndim, mbetën jashtë kufijve të territorit osman.

Hapja e rajoneve të reja evropiane ndaj Islamit

Vojvoda i Bogdanit, **Petru Aron**, duke kuptuar se nuk ishte e mundur t'i bënte qëndresë Devletit të fuqishëm, në vitin 859/1455, hyri nën zotërimin osman duke marrë si detyrim të paguante 2000 monedha floriri çdo vit. Pasardhësi i tij **Stefan Cel Mare**, me ndihmën e hungarezëve dhe polakëve, në krye të një ushtrie të fuqishme prej 50.000 luftëtarësh në vitin 879/1475 iu shkaktoi disfatë njërive ushtarake osmane në Rakovica, që ishin të lodhura gjatë rrugës së kthimit të tyre nga rrethimi i Shkodrës. Veprimin e **Papës**, që i dha atij titullin **Athleta Christi** (Kampioni i Krishtit), osmanët e kishin të pamundur ta pranonin. Për këtë arsye, Sulltan Fatihu, marshoi me ushtrinë e tij kundër Stefan Cel Mares. Në të njëjtën kohë që ai hyri në Bogdan, në krye të *Ordu-ju Hymajun*, siç e quanin osmanët³⁶⁹,

366 Danişmend, I, fq. 333-334.

367 *Netajixh*, I, fq. 46. Pjesët e tjera të Krimesë u aneksuan më pas në mënyrë paqësore nga Javuz Selimi, nipi i Fatihut.

368 *Aşıkpaşaoğlu Tarihi*, fq. 184-185.

369 Duke e parë veten si "përfaqësues të Islamit", të "Mesazhit të Fundit Hyjnor", osmanët i emërtuan disa objekte të rëndësishme si **hūmayun**; që i përket **Hūma-s**, një shpendi që fluturon shumë lart apo zogut legjendar feniks. Pra, **hūmayun** do të thotë "që i përket qiellit", **qiellor**. Në këtë mënyrë, *Ordu-yu Hūmayun* do të thotë Ushtria Qiellore; *Divan-ë Hymajun*: Divani Qiellor; *Myhr-i Hymajun*: Vula Qiellore e Sulltanit; *Donanma-jë Hymajun*: Flota Qiellore; *Hatt-ë Hymajun*: Shkrimi Qiellor i Sulltanit, etj.

inxhe donanma (flota e lehtë) osmane lundroi nëpërmjet Danubit dhe mori brigjet e Besarabisë, zotëroi grykën e lumit Danub dhe hapi Akkirmanin ndaj Islamit. Sulltan Fatihu mundi vojvodën e Bogdanit në Akdere/Valea Alba, në vitin 881/1476. Pas kësaj fitoreje të arritur, osmanët mund ta kishin marrë të gjithë territorin e Bogdanit, nëse mortaja nuk do të ishte përhapur në ushtri. Ata u kthyen për këtë arsye dhe jo për shkak të qëndrës së ushtrisë bogdane.

Osmanët vazhduan shtrirjen e territoreve të reja ndaj Islamit në Evropë: ndërkohë që **Omer (Ömer) Beu**, i biri i Turhan Beut, sulmonte madje edhe vendet që ndodheshin fare pranë kufirit të Venedikut, midis të cilave u radhit edhe rënia e kështjellës së Krujës/Akçahisarit, në vitin 883/1478. Edhe Shkodra u rrethua, por nuk arriti të hapej ndaj Islamit. Për shkak të relievit shkëmbor e të thepisur, Sulltan Fatihu nuk arriti të dërgonte atje armët e zjarrit, por ndërtoi topa shumë të mëdhenj ndërkohë që kishte rrethuar kalanë. Komandanti që mbronte kalanë ishte venedikasi **Antonio da Lezze**. Gjatë rrethimit të Kalasë së Shkodrës, osmanët përdorën bomba të përbëra nga vaji i ullirit, dylli, squfuri dhe disa substanca të tjera. Duket se në atë kohë osmanët ishin superiorë në aspektin teknologjik. **Ahmed Beu**, i biri i Evrenos Beut, vazhdoi rrethimin e Shkodrës në krye të një ushtrie prej 40.000 luftëtarësh.

Republika e Venedikut u detyrua të nënshkruante një traktat paqeje me Devletin Osman, që do t'i jepte fund luftës 15-veçare, pasi Venediku e kuptoi se, edhe pse u krijua aleanca ndërmjet Papës-Venedikut-Napolit-Hungarisë-Akkojunllusë-Karamanit, osmanët vazhduan shtrirjen e tyre në Evropë. Në të njëjtën kohë edhe mbreti i Napolit **Ferdinandi**, dhëndri i tij, **Matjash Korveni** dhe mbreti i Hungarisë ishin në procesin e lidhjes së një traktati paqeje me osmanët, pasi kishin kuptuar se nuk do të ishin të aftë të përballeshin me ta. Republika e Venedikut kuptoi, gjithashtu, se Kalaja e Shkodrës nuk do të arrinte të rezistonte gjatë, për të mos përmendur këtu edhe faktin që Venediku kishte pësuar humbje të mëdha në tregti,

për arsye të tejzgjatjes së luftës. Një traktat paqeje u nënshkrua më 3 Dhilka' de 883/26 janar 1479 në Stamboll, sipas të cilit Republika e Venedikut i la Devletit Osman Shkodrën, dhe disa troje të tjera të Shqipërisë; Venediku do t'i paguante Devletit 200.000 monedha floriri si dëmshpërblim lufte, si dhe 12.000 monedha të tjera floriri në vit për të përdorur portet osmane. Lidhja e këtij traktati ishte një sukses politik për sadrazamin osman, Piri Mehemed Pashanë dhe siguroi vendosjen e përhershme të osmanëve në territorin e Shqipërisë.

Hapi tjetër ishte drejt Italisë. Pas rënies së Perandorisë Romake të Bizantit në duart e Sulltan Fatih Mehemmedit, ishte radha e Romës.³⁷⁰ Fatihu dërgoi në Itali **Gedik Ahmed Pashanë** për të hapur **Otranton** ndaj Islamit. Ai arriti ta merrte së bashku me disa kështjella në zonat përreth Mbretërisë së Napolit në vitin 884/1479. Prania e ushtrisë osmane në territorin italian e frikësoi së tepërmi Krishterimin: "Roma ishte në panik dhe Papa po planifikonte të arratisëj drejt veriut të vendit bashkë me pjesën më të madhe të popullsisë."³⁷¹ Por, Devleti Osman do ta humbiste territorin e tij në Itali nga të krishterët pas dy vitesh, kur Sulltan Bajezidi II ishte i zënë me konfliktin mes tij dhe vëllait, Xhem.³⁷²

Vdekja e Sulltan Fatihut

Fitoret e lavdishme që arriti Sulltan Fatihu nuk ishin të mjaftueshme për t'i dhënë satisfaksion zellit dhe devotshmërisë fetare të tij. Për këtë arsye, në krye të një ushtrie tjetër, ai marshoi drejt Anadollit pa përcaktuar qëllimin e tij të saktë. Ndoshta ai planifikonte ta kapte armikun në befasi, duke u bazuar në fjalën e urtë: "Ndihmoji punët e tua nëpërmjet fshehtësisë", por ndërkohë që ndodhej në Gebze, Sulltan Fatihu

370 Danişmend, I, fq. 332, 336, 342-343.

371 S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 69-70.

372 *Netajixh*, I, fq. 47.

në vitin 886/1481 vdiq në mënyrë të papritur në moshën 51-vjeçare.³⁷³ Stenli Lejn-Pul ka shkruar për këtë ngjarje:

“... Muhammedi po përgatiste një fushatë të madhe, synimin e të cilës asnjëri nuk e di, kur papritur vdiq. Është e vështirë të kuptohet se ç’mund të vinte pas Romës. *Sed Dis aliter visium*. Vdekja e pushtuesit shpëtoi Evropën.”³⁷⁴

Gjatë Hilafetit të Sulltan Fatihut, Devleti Osman kishte arritur një nivel të lartë teknologjik në krahasim me nivelin evropian dhe dy topat që ai prodhoi për rrethimin e Kostandinopojës ishin një risi për kohën. Kështjella e Otrantos e ndërtuar nga Gedik Ahmed Pashai në Itali, ishte e fortifikuar aq mirë sa që të krishterëve iu desh një kohë e gjatë për ta pushtuar. Osmanët kishin arritur një nivel të lartë edhe në fushën e industrisë, me prodhimin e mallrave të tilla si porcelani dhe qilimat. Për më tepër, edhe pse në kohëra të hershme, në shekullin e 15-të, ata ishin aq të ndërgjegjshëm për rreziqet natyrore, sa që kishin ndaluar zhvillimin e agrikulturës në zonat kodrinore, pranë Bririt të Artë, për të mos shkaktuar gërryerjen e tokës duke mbjellë në anët e saj bimë të tilla që mbanin dheun fort nga rrëshqitjet.³⁷⁵ **Safranbollu**, që ndodhet pranë qytetit Kastamonu në Anadoll është një qytezë tipike osmane, që fatmirësisht ka ruajtur formën dhe strukturën e saj origjinale deri në ditët e sotme. Kjo qytezë është një shembull i mirë i një qyteti musliman dhe na kujton mënyrën se si njerëzit më parë mund të jetonin si “qenie njerëzore”, duke ndërtuar shtëpi në mënyrë të atillë, që të mos pengonin depërtimin e rrezeve të diellit apo ajrosjen, secila e veçuar dhe e projektuar sipas modelit të jetës së përditshme islame.³⁷⁶ Në Japoni, ndërtesat e

373 Neşri, II, fq. 842.

374 Stanley Lane-Poole, *Turkey* (Londër: 1986). Edhe pse, përgjithësisht, ky libër konsiderohet i vjetëruar, autori në të jep shumë informacione të sakta dhe vlerësime për disa çështje.

375 *Netajixh*, I, fq. 62.

376 Është një pjesë origjinale si Safranbollu në qytetin Kastamonu. Shtëpia e një koloneli, që i përket erës së osmanëve në Safranbollu, është kthyer në shtëpi muze. Ajo quhet **Kajmekam Konağë** (Konaku i kolonelit,

larta i paguajnë dëmshpërblim ndërtesave të tjera, për arsye se ato ndalojnë rrezet e diellit. Ky është një veprim mjaft i civilizuar. Një qëndrim i ngjashëm mbizotëronte edhe në shoqërinë osmane shekuj më parë.

Gjatë Hilafetit të Sulltan Fatihut, Devleti Osman kufizohej nga Irani (Persia) dhe **mamlukët** në Azi, dhe me Venedikun, Hungarinë dhe Poloninë në Evropë. Në pjesën më të madhe të rasteve, këto shtete ishin kaq të dëshpëruara që arrinin t'i shkaktonin një humbje Sulltan Fatihut, sa që iu dërgonin osmanëve lajmësit e tyre për të kërkuar falje dhe paqe. Në ato raste, kur sulltani vendoste t'i jepte një përgjigje pohuese, ai iu dërgonte atyre një *ferman-ë ali* (dekret sublim), me anë të të cilit i paralajmëronte ata se do të ishin të sigurt për aq kohë sa do të ishin miqësor ndaj palës së tyre. Dhe osmanët nuk denjonin të pranonin asnjë dokument nga pala tjetër.³⁷⁷

Botëkuptimi i **Sulltan Fatihut** është shprehur mjaft mirë edhe në vargjet e poezisë së tij:

Imtisal-i "Xhahidu fil-lah" ollubdur nijjetym
Dîn-i Islamun muxherred gajretydyr gajretym
Fazl-ë Hakk u himmet-i Xhynd-i Rixhalullah ile
Ehl-i Kyfry ser te ser kahr ejlemekdyr nijjetym.

"Qëllimi dhe vendimi im është t'i bindem urdhrin të Allahut: të përpiqem dhe të luftoj në rrugën e Allahut (s.v.t). Të gjitha përpjekjet e mia bëhen vetëm për hir të fesë islame. Me hirin e Allahut dhe me ndihmën shpirtërore të një ushtrie të muslimanëve të mëdhenj (shumë shejhë të urdhrave sufite), unë jam i vendosur t'i shkatërroj gjithnjë jobesimtarët."

kajmekamit) dhe vlen të vizitohet: projekti i mjedisëve të brendshme të kësaj shtëpie është bërë për të lehtësuar mënyrën e jetesës islame.

377 *Netajixh*, I, fq. 69.

Sulltan Fatih Mehemedi e ktheu Katedralen e Aja Sofjas (Hagia Sophia), vendin ku zakonisht kurorëzoheshin perandorët romakë, në një xhami për të cilën ai themeloi shumë vakëfe, siç shpjegon edhe Lord Kinross në pasazhin që vijon: “Si pjesë e dhuratës për Aja Sofjan, xhamisë së parë të madhe të Stambollit, Mehmed Pushtuesi urdhëroi ndërtimin e një *bedesteni*, një pazari ose tregu të madh të mbuluar, me qindra dyqane dhe depo, së bashku me mijëra dyqane të tjera në rrugët dhe tregjet përreth saj. Kjo ishte, në fakt, një qendër tregtie dhe biznesi, ku tregtarët mund të mbanin në mënyrë të sigurt mallrat e tyre dhe të mblidheshin për të bërë biznes. Kur Mehmedi ndërtoi xhaminë e tij të madhe, kishte 8 medrese përreth saj, në të cilat çdo ditë mësonin 600 studentë, një shkollë fillore, një bibliotekë, dy bujtina për udhëtarët, një mensë, vende gatimi, të cilat iu jepnin ushqime të varfërve dhe një spital në të cilin kishte me shërbim pa pagesë, një specialist okulist, një kirurg, një farmacist dhe kuzhinierë që përgatishnin ushqimin për pacientët sipas urdhrave të mjekut. Ky ishte shërbimi arsimor dhe shëndetësor pa pagesë i Shtetit Islam të ndihmës sociale në mesjetë.”³⁷⁸ *Medreseja* ishte në nivelin e universitetit. Sulltan Fatihu tregonte respekt të thellë ndaj studiuesve, shkrimtarëve dhe artistëve, të cilët i tërhiqte në Stamboll. Për shembull, ai mori **Ali Kushçun** nga Samarkanda, së bashku me familjen e tij dhe i dha atij një sasi të madhe parash. **Gjatë Hilafetit të Sulltan Fatihut, rastet e grabitjeve në rrugë dhe prostitucionit ishin pothuajse raste të harruara; nëse një grua largohej me një sasi të madhe floriri për një rrugë dy-ditore, gjithkush ishte i sigurt se ajo do të kthehej pa dëmtime.** Sulltani jepte dënime të rënda për shkelësit e ligjit.³⁷⁹ Me pak fjalë, gjatë mesit të shekullit të 15-të, shoqëria osmane ishte mjaft e mirë dhe e këndshme: gjithsecili, pa dallim race, feje, etj., jetonte në paqe dhe siguri, pa pasur frikë fare. Nga ana tjetër, në shoqërinë romake mbizotëronin

378 Lord Kinross, *The Ottoman Centuries, the Rise and Fall of the Turkish Empire*, (New York: 1977), fq. 20.

379 Neşri, II, fq. 838-840.

veset shoqërore. **Xhenkins (Jenkins)** është shprehur kështu për këtë situatë të mjerueshme: “Në të gjitha shtresat e shoqërisë mbizotëronte prostitucioni, që inkurajohej nga izolimi i rreptë i grave në shoqërinë xhentile... Zakonisht, ky izolim kishte për tendencë promovimin e lidhjeve të një karakteri kriminel midis të dy sekseve. Edhe pse licenca e ushtrimit të prostitucionit, që ishte dhënë nga Kostandini i Madh, ishte hequr, edhe pse pronarët e shtëpive publike ndëshkoheshin rëndë, e keqja nuk kontrollohej asnjëherë. Pronarët e haneve, të tavernave dhe të banjave publike rregullisht i shtonin fitimet e tyre, duke mbajtur prostitutat, varfëria e të cilave dhe premtimet mashtruese që u bëheshin nga protektorët shëtitës, siguronin furnizime të pashterueshme. Pjesa më e madhe e këtyre krijesave zavalle jetonin në kushtet më të ndyra, duke dhënë shërbimin e tyre për disa gjysmë peni dhe duke transmetuar sëmundjet që merrnin për shkak të profesionit të tyre. Ato zakonisht gjendeshin mes grindjeve të të dehurve dhe trazirës. Numri i saktë i tyre nuk mund të përlllogaritet saktësisht, por nuk gabohemi nëse themi se ato ishin me mijëra.”³⁸⁰

Njësoj, krahasuar me pozitën e tyre në shoqërinë romake, skllëverit gëzonin një status prestigjioz në Devletin Osman. Ata mund, dhe në fakt kishin arritur, të bëheshin vezirë, nëpunës të Devletit dhe zyrtarë të rangut të lartë. **Jenkins** na jep këtë panoramë të errët të pozitës së skllëvërve në Perandorinë Romake: “... Kushtet e skllëvërve ishin në varësi të rrethanave dhe karakterit të pronarëve të tyre. Njerëzit e dashur të një qytetari të pasur, mund të kishin qenë në gjendje më të mirë dhe mund të kishin qenë të besuar në një autoritet më të lartë në krahasim me një njeri të lirë. Ai mund të jetë një mik i afërt dhe i dashur i fëmijëve të aristokratëve. Ai mund të ishte i parfumuar dhe të vishej me rroba mëndafshi, por ai kishte pak ose asnjë të drejtë ligjore. Ndërsa punëtori servil në një pronë, si

380 R.J.H. Jenkins, “Social Life in Byzantine Empire”. *The Cambridge Medieval History*, vëllimi IV, pjesa II, botuar nga J.M. Hussey, (Cambridge Univesity Press:1967, 1978), fq. 88-89.

pasuria e patundshme e mjerë e ndonjë tirani çnjerëzor apo imoral, mund të jetonte zhytur në prostitucion dhe degradim, sa që vdekja, edhe kur vinte në vuajtje mizore, siç ndodhte shpesh, nuk mund të shihej si diçka tjetër veçse si çlirim i mëshirshëm. Shpeshësia dhe vrulli me të cilin kishat në të gjitha kohërat shfryheshin kundër keqtrajtimit të skllëvërve e bënë më të vërtetë faktin që ky keqtrajtimit të ishte mjaft i zakonshëm.”³⁸¹

Nga evidencat e lartpërmendura, është e arsyeshme të besojmë se shoqëria muslimane e shekullit të 15-të, ishte shumë më e mirë se të ashtuquajturat shoqëri të civilizuar të shekullit të 21-të, për të mos përmendur këtu krahasimin me shoqërinë perëndimore të asaj kohe. **Me pak fjalë, civilizimi i sotëm perëndimor teknikisht i avancuar, por i rrënuar shpirtërisht dhe moralisht, nuk ka arritur ende standardin që kishin arritur muslimanët 5 shekuj më parë.** Për më tepër, në kundërshtim të trajtimit barbar të krishterëve ndaj muslimanëve të mundur në Spanjë dhe Portugali, Sulltan Fatihu u fali robërve jomuslimanë të luftës liri të plotë besimi fetar, si dhe caktoi Genadiosin si Patriarkun e Kishës Ortodokse greke.

Civilizimi është për “qenien njerëzore”, për të jetuarit e tij në komoditet dhe larg frikës. Fakti është që civilizimi perëndimor nuk mund të sigurojë këtë, atëherë, ai duhet të shqyrtojë mangësitë dhe në këtë mënyrë, automatikisht, feja islame do të vijë në agjendë. Mendimtarë, studiues, shkrimtarë duhet të mendojnë për këtë çështje pa e paragjykuar atë. Nëse mbështetësit e civilizimit perëndimor do të jenë të guximshëm për t’u përballur me këtë fakt dhe për ta vlerësuar atë, të pajtohen me Islamin dhe të zbatojnë vlerat kryesore të tij, atëherë dhe civilizimi zotërues do të ketë një mundësi për të mbijetuar. Në rast të kundërt, mund të shikojmë se nuk do të ketë të ardhme për të, përderisa në të përfshihen dhe mbështetet gjithçka përveç “qenies njerëzore”. Pa dyshim, vetëm zhvillimet shken-

381 Shiko poshtëshënimin 380.

core dhe teknike në duart e personave që nuk e vlerësojnë aspektin moral, mund të shërbejnë vetëm për shkatërrim. Dhe besimi zotërues në botën perëndimore, që quhet “Krishterim”, ku përfshihen të gjitha sektet dhe organizatat kishtarë, është shumë larg “atij” besimit që predikoi Jezu Krishti,³⁸²dhe nuk është i mjaftueshëm për t’i përmbushur njerëzimit nevojat e tij morale. Nuk është e nevojshme të jesh një fallxhor për të parë këtë fakt. Mjafton që vetëm të çlirohesh nga paragjykimi për Islamin dhe nga shpëlarja e trurit kundër tij.

Superioriteti musliman ishte kaq mbizotërues, sa që të krishterët u detyruan t’i drejtoheshin nga dëshpërimi magjisë dhe supersticioneve, në mënyrë që të gjenin një lloj ngushëllimi për veten. Kështu kishte fjalë se një çlirimtar do të shfaqej për t’i shpëtuar ata nga zotërimi musliman. Sipas **Artur Goldshmitit (Arthur Goldschmid)**: “Në të vërtetë, evropianët besonin se diku, përtej tokave të përvetësuarra nga Islami, ata mund të gjenin një sundimtar të plotfuqishëm të krishterë, të cilin ata e quajtën **Prester Xhon**. Ata shpresonin se ky mitik i fuqishëm, do të sulmonte forcën kërcënuese muslimane, duke shpëtuar kështu krishterimin perëndimor. Nga fundi i shekullit të 13-të, mendohej se **Prester Xhoni** ishte mongol, dy shekuj më vonë evropianët do ta kërkonin atë në Etiopi. Të ndikuar nga ky kombinim i çuditshëm i frikës dhe shpresës, Papati dërgoi misione për të marrë takime me Perandorinë Mongole dhe, nëse do të ishte e mundur, t’i konvertonte ata në të krishterë. Në atë kohë, katolicizmi kishte pak për t’iu ofruar mongolëve, por disa prej tyre përshtatën një formë të krishterimit me emrin

382 Për ta ilustruar më mirë këtë fakt, është e mjaftueshme të kujtojmë se Jezu Krishti (Paqja qoftë me të), fliste në gjuhën **Aramaikë** dhe ishte një **Profet** që ishte kthyer në një zot të Trinisë. Dita e tij e lindjes ndryshon me tetë vjet nga data që është pranuar zyrtarisht si dita e tij e lindjes. Duke filluar me erën e re, ai duhet të ketë lindur në pranverë (sipas Lukës: II, 8) dhe jo në dhjetor. Asnjë nga Ungjijtë nuk është shkruar gjatë jetës së tij, pasi ata më të hershmit janë shkruar disa dekada pas vdekjes së tij në latinisht, hebraisht dhe në greqishten e lashtë.

Nestorianizëm, që ekzistonte rëndom në Irak, Iran dhe në Azinë qendrore.”³⁸³

Mbi këtë çështje **Abbas Hamdani** ka shkruar si më poshtë: “Portugezët dhe spanjollët e mbartën frymën mesjetare të *Rekonkuistas* në zbulimet e tyre të rrugës së re drejt Indisë dhe Botës së Re. Portugezët kishin si qëllim të merrnin Mekën, me shpresën për ta këmbyer atë me Jerusalemin. Ata vendosën, gjithashtu, lidhje me mbretin e Etiopisë, duke e identifikuar atë me Prester Xhonin ... *Ditarët* e Kolombit tregojnë se *empresa de las Indias* e tij, përfshinte një plan madhor për të kontaktuar me mongolët dhe Hanin e Madh të Lindjes që ishte pro krishterimit, duke iu rënë rreth e përqark tokave islame në Lindjen e Mesme, duke hapur një rrugë të re tregtie me Lindjen, në mënyrë që të kapërcente territorin e memlukëve, dhe duke kombinuar forcat e krishterimit perëndimor dhe lindor, me anë të një lëvizjeje gjithëpërfshirëse për kthimin e Jerusalemit dhe *casa santa* të tij. Plani i **Kolombit** ishte një shembull i vonë që ndiqte traditën e **Marko Polos** (1295), *Liber secretorum* të **Marino Sanudos** (1321), punën jetësore të **Papa Piut II** (1458-1465), dhe vepra të tilla si ajo e **Kampanusit**, *Oratio* (1471).”³⁸⁴

Sipas mendimit tim, Devleti Osman nuk ishte themeluar fuqishëm deri në kohën që aneksoi Stambollin. Është e vërtetë që ai ishte kthyer në një strukturë të fuqishme shoqëro-politike, por në fakt ishte i cenueshëm nga vetë qendra e tij me intrigat e krijuara kundër tyre midis Perandorisë Romake dhe fuqive të tjera evropiane dhe bejlikeve të Anadollit. Devleti Osman nuk ishte i sigurt, ishte në një rrezik të vazhdueshëm nga brenda, në qendrën e territorit të tij. Vetëm pas hapjes së Kostandinopojës ndaj

383 Arthur Goldschmidt Jr., *A Concise History of the Middle East*, (Boulder, Kolorado: 1988), fq. 123.

384 Abbas Hamdani, “*Ottoman Response to the Discovery of America and the New Route to India.*” *Journal of the American Oriental Society*, vëllimi 101, (1981), fq. 323-330.

Islamit, u bë e mundur që Devleti Osman të kthehej në “Superfuqi”. Për këtë arsye, periudha përpara hapjes së Kostandinopojës ndaj Islamit, mund të shihet si “themelimi” i Devletit Sublim Osman.

PJESA E DYTË

EKSPANSIONI

1481-1699

KAPITULLI 5

5.1 Sulltan Bajezid Veliu 1481-1512

Bajezidi, djali i parë i Fatihut dhe Sanxhakbeu i Amasjas, trashëgoi nga i ati fronin osman në 1481. Por vëllai i tij më i vogël, Xhemi (1459-1495), Sanxhakbeu i Karamanit (Konjas), e sfidoi postin dhe autoritetin e tij, vendosi nën kontroll qytetin e Bursës dhe shpalli në hutben e së Xhumasë, pretendimin e tij për pavarësi. Dy vëllezërit zhvilluan një betejë të ashpër në fushën e Jenishehirit, në të cilën ushtria e Xhemit pësoi humbje dhe ai u detyrua të tërhiqej në qytetin e Konjas. Më pas, ai iu drejtua Sulltanit memluk Kajëtbaj në Egjipt, nga ku u nis dhe për Haxh së bashku me familjen e tij në vitin 1481.¹

1 Perëndimorët përpiqen të nënvlerësojnë profilin islamik të Devletit Osman, duke thënë se sulltanët osmanë nuk e kryenin detyrën e Haxhit. Kjo është një dredhi shumë e thjeshtë: leximi i historisë së prapthi, thjesht një **anakronizëm**. Kjo do të thotë të bëjmë një vlerësim të kushteve nga shekulli i 14-të deri në shekullin e 19-të, me ato të shekullit të 20-të. Deri në vitin 1517, Hixhazi (Arabia Saudite), vendi ku ndodhet Ka'beja, nuk ishte pjesë e territorit osman, por e memlukëve, pra territor i devletit rival. Kështu që, për të kryer Haxhin, sulltani osman duhet të kishte kaluar përmes territorit të memlukëve së bashku me të afërmit dhe ushtrinë e tij të përbërë nga mijëra luftëtarë. Ky do të kishte qenë një "problem sigurie" për të dy Devletet. Kur Shehzade Xhemi e kreu Haxhin, ai ishte një njeri krejtësisht i lirë; dhe nuk kishte asnjë përgjegjësi në sturkturën e Devletit Osman.

Ndërsa, një sulltan osman për të shkuar nga Stambolli për në Hixhaz dhe për t'u kthyer do t'i duheshin 8-9 muaj. Duhet të kujtojmë në këtë rast, se edhe në shekullin e 20-të, me gjithë lehtësitë e telekomunikacionit, ndërkohë që Mbreti i Libisë ishte larguar nga vendi i tij, **Kadafi** e përmbysi atë dhe mori në dorë administrimin e Libisë në vitin 1969. Do të ishte e

Kur **Xhemi** u kthye në Kajro,² Sulltan Bajezidi i dërgoi atij letra me anë të lajmëtarëve të tij, në të cilat i thoshte dhe i ofronte atij një azil paqësor në qytetin e shenjtë të Jerusalemit, si dhe i jepte të gjitha të ardhurat e mbledhura nga provinca e Konjas (Karamanit). Por ky i fundit këmbëngulte të merrte të gjithë pjesën e Anadollit të Devletit Osman, që do të thoshte ndarja e Devletit në dy pjesë. Për pasojë, sulltanit nuk i mbetej asnjë alternativë tjetër, veçse të dërgonte Gedik Ahmed Pashanë për të shtypur kryengritjen e tij. Megjithatë, Xhemi planifikonte të shkonte në territorin evropian osman për t'u përballur me të vëllain,³ me ndihmën e Kalorësve të Rodosit, të cilët i kishin

pamundur që një sulltan osman të kalonte një kohë kaq të gjatë jashtë vendit të tij.

Një arsye tjetër e rëndësishme është se në shekullin e 16-të, kur Hixhazi iu bashkua Devletit Osman, Portugalia dhe Spanja ishin dy fuqi shumë të mëdha të krishterimit, sa që Papa e kishte ndarë hegemoninë botërore midis tyre. Këto të dyja kolonizuan Amerikën Qendrore dhe atë të Jugut: edhe në ditët e sotme ajo pjesë e kontinentit quhet Amerika "Latine" (që do të thotë katolike), dhe atje flitet spanjisht dhe portugalisht. Oqeani Indian u kthye në një "Oqean portugez". Ata depërtuan edhe në rajonin e Detit të Kuq, por u zbrapsën. Portugezët dëshironin ta pushtonin Mekën dhe ta këmbenin atë me Jeruzalemin! Për këtë arsye, nëse sulltani do të udhëtonte për atje, do të duhej të shoqërohej nga mijëra luftëtarë për sigurinë dhe vendosjen e tyre, etj. Nga ana tjetër, kufijtë me botën e jobesimtarëve do të ishin më të mundshëm për t'u shkelur pas mungesës së sulltanit në Stamboll. Pas portugezëve, fuqi të tjera të krishtera i zëvendësuan ata në këto ujra, kështu që *Ordu-ju Hymajun* nuk u largua e gjitha nga Stambolli për një xhihad drejt Evropës. Pjesa qendrore ishte në Stamboll dhe një korpus i madh iu bashkua për udhë, si përrëndëjtë që bashkohen me një lumë.

Një arsye tjetër është se: duke filluar nga Mehemmed Çelebiu dhe duke vazhduar deri në vitet e Luftës së Parë Botërore, sulltanët osmanë dërgonin çdo vit në Hixhaz *surreh*. *Surreh* ishte një komision që mbante dhe dërgonte dhurata, para dhe ushqime për popullin e el-Haramejn esh-Sherifejn (Mekës dhe Medinës). Kryetari i komisionit quhej *surreh emini* dhe ai përfaqësonte sulltanin. Padyshim që ai e kryente Haxhin, dhe si një *vekil* (përfaqësues) i sulltanit e kryente atë në emër të tij. Ky dërgim i *vekil* (bedel), është i pranueshëm dhe praktikohet edhe në ditët e sotme nga muslimanët. Bedeli *vekil* e kryen Haxhin për veten e tij dhe në emër të atij që e dërgon, duke paguar shpenzimet për të.

2 İsmail Hakkı Uzunçarşılı, *Osmanlı Tarihi*, II, fq. 166.

3 Stanley Lane-Poole, *Turkey*, (ribotim) Londër, 1986, fq. 142.

premtuar se do ta mirëprisnin dhe se do t'i gjenin atij një rrugëkalim drejt Evropës. Këto zhvillime u përshkruan kështu nga Lejn-Pul: "Megjithatë, Mjeshtri i Madh i Rodosit, D'Obyson (D'Aubusson), ishte një diplomat tepër dinak, për të sakrifikuar përfitimet që ai mendonte se do të arrinte nëpërmjet Urdhrit të Kalorësve të tij, dhe pasi mori garanci nga Princi Xhem e bindi atë të nënshkruante një traktat, sipas të cilit në rast se ai do të merrte fronin, Urdhri i Kalorësve do të përfitonte shumë. Më pas, ai me mprehtësinë e tij hyri në bisedime me Sulltan Bajezidin, me qëllim që të sigurohej se sa florin ishte në gjendje të paguante ai sovran për ruajtjen e sigurt të vëllait të tij të pabindur. Do të ishte më se e drejtë të përmendim këtu se Bajezidi, që nuk e njihnte në natyrën e tij mizorinë, bëri gjithçka që ishte e mundur për të rënë dakord me Xhemin. Në të vërtetë, ai ishte i ashpër dhe nuk bënte lëshime, ndërkohë që vëllai i tij kishte shfaqur armiqësi të hapur. Përgjërimit të hallës së tij, për të qenë i mëshirshëm me të vëllain, ai iu përgjigj: "nuk ka asnjë lidhje familjare midis prijësve". Megjithatë, ai i propozoi vëllait të tij t'i rikthente autoritetin mbi provincën e Karamanit, që Xhemi kishte qeverisur më parë, por jo fronin e tij, me kusht që ai të tërhiqej dhe të jetonte në paqe në Jerusalem. Nga ana e tij, Xhemi nuk synonte asgjë tjetër përveç autoritetit të pavarur dhe kjo nuk mund të ishte e pranueshme nga sulltani. "Perandoria,"⁴ tha ai, "është një nuse, mirësitë e të cilës nuk mund të ndahen". Duke qenë se të gjitha bisedimet dhe përpjekjet për marrëveshje nuk patën sukses, ai dëgjoi propozimet e Mjeshtrit të Madh dinak, dhe si përfundim pranoi t'i paguante atij një shumë vjetore prej 45.000 dukatesh, për aq sa ky do ta mbante nën mbikëqyrjen e tij Xhemin.⁵ I njëjti autor i krishterë e ka përshkruar me komentet e mëposhtme mashtrimin e Kalorësve të Shën Xhonit: "Kalorësit e Shën Xhonit kishin shumë vende

4 Fjala që Sulltan Bajezidi përdori është "**Sulltanat**" dhe jo "**Imparatorije**" (Perandori), siç përdoret në mënyrë të shtrembëruar nga Stanley Lane-Poole, *vepër e cituar*, fq. 142.

5 Po aty, fq. 145.

nën komandë dhe ata zgjodhën për mikpritjen e Xhemit atë që kishin në Nicë, në jug të Francës. Ai shkoi atje në vitin 1482, krejtësisht i pavetëdijshëm për kurthet që po ngriheshin kundër tij.

Ai dëshironte të nisej menjëherë drejt Hungarisë, prej nga propozoi të ngrinte në revoltë pasuesit e tij në Turqi, por kalorësit e refuzuan me mirësjellje këtë qëllim të tij. Me pretekstet e tyre, kalorësit planifikonin ta mbanin këtë të burgosur në Nicë për muaj me radhë ... Ndërkohë Mjeshtri i Madh D'Obyson, po drejtonte "një tregti" të mirë në rolin e gardianit të burgut. Të gjithë sunduesit evropianë, qëndronin në ankth për të marrë në duart e tyre këtë pretendent të fronit osman, madje ishin të gatshëm të paguanin shuma të mëdha me para të thata, që të arrinin të gëzonin edhe ata privilegjin e "përdorimit" të këtij instrumenti, veçanërisht të rrezikshëm kundër paqes së sulltanit. D'Obysoni nuk ishte kundër përfitimit të parave nga këto shtete, por në të njëjtën kohë, ai nuk dëshironte të hiqte dorë nga i burgosuri i tij, dhe ndërkohë që e mbante atë fort, nuk mendonte se nderi i urdhrit të tij kalorësiak do të njollosej, kur mori nga gruaja e mjerë e Xhemit, 20.000 dukate si shpajim për çlirimin e bashkëshortit të saj. Të këtij lloji karakteri kalorësiak ishin kalorësit e Rodosit ndërsa njerëz të tillë si D'Obysoni, kisha i bënte kardinalë."⁶

Qëllimi i Mbretit të Francës ishte të përdorte Xhemin kundër Devletit Osman, megjithatë, ai e mori Xhemin nga kalorësit dhe e vendosi atë nën mbikëqyrjen e Papës. Autori perëndimor i lartpërmendur përshkruan qartazi moralin e Evropës në atë kohë: "... Nga gjithë kjo përrallë melankolike, përfundimi i çuditshëm që nxjerrim është se me sa duket në botën e krishterë nuk kishte asnjë njeri të ndershëm që të ndjente keqardhje për të burgosurin; asnjë që të dilte kundër intrigave të pandershme dhe të korruptuara të Mjeshtrit të Madh, Papës dhe Sharlit VIII. Secili prej tyre garonte kundër

6 Po aty, fq. 146.

tjetrit për çmimin e mizorisë dhe turpit. Bajezidi mund të quhet i falur për arsye se dëshironte të shikonte vëllain e tij në siguri të plotë, po ç'mund të themi për Kishën e Krishterë dhe për prijësin e një Urdhri religjioz kalorësish, të cilët tradhtuan me zell të madh një refugjat të braktisur, për të përfituar florinjte e jobesimtarit? Kur lexojmë historitë mbi heroizmat e kalorësve të Rodosit dhe Maltës, do të ishte më mirë të kujtonim edhe historinë e Princit Xhem, si dhe të peshojmë mirë vlerën që kalorësia do të merrte me anë të kësaj tradhtie.”⁷

Një shkrimtar tjetër evropian thekson të njëjtën pikëpamje duke thënë: “Është e panevojshme të themi se një sulltan më se i aftë otoman, nuk do të ishte përpjekur për të ndërmarrë një fushatë në shkallë të gjerë kundër fuqive evropiane, ndërkohë që vëllai i tij dhe njëkohësisht pretendenti i fronit otoman, mbahet si i burgosur prej tyre. Nëse Xhemi do të ishte i lirë, i gjithë territori otoman do të ishte ndarë automatikisht në dy pjesë dhe me dhjetëra mijëra luftëtarë muslimanë do të ishin vrarë në luftë civile. ... Mbajtja e një të burgosuri kaq të rëndësishëm u përdor në shumë raste si kërcënim ndaj sigurisë së Bajezidit dhe shërbeu si një fre për veprimtarinë e tij...”⁸

Ky incident shpreh qartazi këmbënguljen e sulltanëve osmanë, për të mbajtur të pacenuar bashkimin e Devletit me çdo kusht. Ata nuk hezitan asnjëherë të zgjidhnin çështjet, në rast se njëri nga pjesëtarët e fisit të tyre do të krijonte mosmarrëveshje. Kuadri kushtetues i sulltanatit ia kishte dhënë pushtetin dhe e kishte kufizuar atë brenda Familjes së Osmanit. Mirëpo, turqit nuk kishin qenë iniciatorë të sistemit të trashëgimisë në Islam. Pionierë të saj kishin qenë emevitët. Megjithatë, turqit që iu bashkuan me dëshirë fesë islame, e konsideruan këtë sistem si një dukuri që ishte në përputhje me praktikën e tyre para-islame. Për më tepër, duhet të kuj-

7 *Turkey*, fq. 151.

8 Donald Edgar Pitcher, *A Historical Geography of the Ottoman Empire*, (Leiden, E.J, Brill: 1972), fq. 98.

tojmë se sistemi i monarkisë ishte mbizotërues në Evropën e asaj kohe. Për sa i përket praktikës osmane të vëlla vrasjes, ne duhet të kujtojmë gjithmonë faktin që *kjo ishte një praktikë Bizantine, që më pas u ndoq nga osmanët.*⁹

Deri në atë kohë, sovranët evropianë nuk kishin treguar asnjë kundërshtim ndaj autoritetit të Papës. Por mbreti i Francës, **Sharl VIII**, që dëshironte ta merrte Xhemin prej Papës, hyri në Romë duke sfiduar autoritetin e tij. Xhemi shkoi në Napoli së bashku me mbretin francez, plani i të cilit ishte të shkonte në Durrës dhe Vlorë, dhe më pas të marshonte drejt Stambollit, duke përdorur Xhemin për të sfiduar edhe autoritetin e Sulltan Bajezidit.¹⁰ Por, Papa e kishte helmuar Xhemin me një helm që kishte efekte të ngadalta dhe ai vdiq në dëshpërim në vitin 900/1495. Në testamentin e tij, ai shkroi se dëshironte të varrosej në **Daru'l-Islam**, në mënyrë që asnjë evropian të mos merrte në të ardhmen identitetin e tij, për të përfituruar territore dhe të shkaktonte gjakderdhje midis muslimanëve. Trupi i tij u dërgua dhe u varros në Bursa.¹¹

9 Anthony Bryer, *Peoples and Settlement in Anatolia and Caucasus 800-1900*. (Variorum Reprints, Londër: 1988) IV, fq. 485, poshtëshënim 3. Është botuar më parë në një artikull me titullin "Greek Historians on the Turks: the case of the first Byzantine-Ottoman marriage, në *The Writing History in the Middle Ages, Essays presented to Richard William Southern*, (redaktuar nga R.M.C. Davis dhe J.M Wallace-Hadrill) Oxford: Clarendon Press, 1981. Theksimi është shtuar.

Është e rëndësishme të theksojmë se Bryer, përpiqet të zhvlerësojë ndikimin që pati praktika romake e vëllavrasjes për osmanët, duke thënë se romakët ishin një entitet i vogël ndërsa osmanët ishin një fuqi e madhe. Por çështja më e rëndësishme nuk qëndron në madhësinë e tyre, por që kjo praktikë ishte në origjinë një model romak.

10 Danişmend, *vepër e cituar*, I, fq. 390-397.

11 Solakzade, *Tarih* (Stamboll: 1297 Hixhri), fq. 290-291.

Osmanët nuk mund të gjenin një zgjidhje për problemin e praktikës së sulltanatit që ishte trashëguar nga emevitët nëpërmjet abasidëve dhe selçukëve. Ata viktimizonin vëllezërit e tyre për të shmangur luftën civile, duke u përpjekur ta zgjidhnin këtë çështje brenda rrethit të tyre familjar. **Duhet kujtuar se, osmanët e mësuan dhe e praktikuan vëllavrasjen nga romakët:** Anthony Bryer, *Peoples and Settlement in Anatolia and the*

Pas vdekjes së Xhemit edhe trupi i tij u kthye në një çështje të rëndomtë parash për evropianët: Sulltan Bajezidi II dërgoi një lajmëtar në Napoli në Sha'ban 900/maj 1495 për t'iu kërkuar francezëve, që ishin sovranë atje në atë kohë, trupin e vëllait të tij, por ata nuk pranuan. Në shkurt të vitit 1496, sulltani dërgoi një lajmëtar tjetër dhe francezët iu përgjigjën se do t'ia shisnin trupin për 50.000 monedha floriri. Kur Mbreti i Napolit, **Frederiku**, shpëtoi Italinë nga francezët, sulltani i kërkoi atij trupin e vëllait, por mbreti i kërkoi atij 5.000 monedha floriri. Ndërkohë edhe Papa i kërkonte Mbretit të Napolit trupin për t'ua shitur osmanëve! Më pas në vitin 904/1498, **Sulltan Bajezidi II** i dërgoi Mbretit të Napolit lajmëtarin e tij, në krye të një luftanije dhe i kërkoi t'ia dorëzonte trupin brenda 8 ditësh, në të kundërt forcat osmane do të pushtonin brigjet e Italisë. Dhe mbreti u detyrua t'i jepte trupin e vëllait.¹²

Ekspedita drejt Bogdanit

Ndërkohë që Bajezidi ishte i angazhuar në zgjidhjen e çështjes së Xhemit, Mbreti i Bogdanit sulmoi pjesën osmane të Vllahisë.¹³ Për këtë arsye, në vitin 889/1484, **Bajezidi II** u nis drejt tij në krye të *Ordu-ju Hymajun* (Ushtrisë Qiellore). Në atë kohë, Devleti Osman kishte lidhur traktate paqeje me Republikën e Venedikut dhe Hungarinë, prandaj kufijtë në Ballkan ishin të sigurt. Situata për Devletin Osman ishte e favorshme

Caucasus, 800-1900, (Londër: Variorum Reprints, 1988), IV, fq. 485, poshtëshënimi 3, publikuar më parë: *The Writing of History in the Middle Ages: Essays presented to Richard William Southern*, redaktuar nga R.M.C. Davis dhe J.M. Wallace-Hadrill (Oxford Clarendon Press, 1981). "Greek Historians on the Turks: the case of the first Byzantine-Ottoman marriage." Në artikullin e tij, **Bryer** thotë se **Komneni i Madh Andronikos III, ekzekutoi vëllezërit e tij Mikael (Mihail) dhe Georgi (Jorgo) ditën që ai mori fronin si Perandor i Trebizondit në vitin 1332**, dhe se përpara kësaj date, nuk ka patur asnjë praktikë tjetër vëllavrasjeje në administratën osmane. Për këtë arsye, nuk ka asnjë dyshim se praktika e vëllavrasjes ndër osmanët kishte modelin e saj te romakët.

12 Danişmend, I, fq. 406.

13 Netajixh, I, fq. 48.

për ta aneksuar pjesën tjetër, pasi zotëronte tre të katërtat e brigjeve perëndimore të Detit të Zi. Sulltan Bajezidi filloi ndërtimin e *imaretit*, *medresesë* dhe *bimarhanes*¹⁴ së tij në brigjet e Lumit Danub, në Edrene.¹⁵



Bimarhaneja në Edrene

Vojvoda i Vllahisë dhe Hani i Krimesë, **Mengli Gëraj**, ishin të ftuar të merrnin pjesë në këtë fushatë. Fillimisht, u mor kështjella **Kili**, që ndodhej në bregun e majtë të lumit Danub dhe që ishte porta e Bogdanit, për në Detin e Zi. Më pas, ushtria osmane rrethoi kështjellën e **Akkermanit**, që ishte vendosur në hyrje të grykës së lumit Dnjestër në veri. Hani i Krimesë **Mengli Gëraj** iu bashkua në krye të një ushtrie prej 50.000 kalorësish. Kështjella ishte e fortifikuar mjaft mirë dhe ishte e rrethuar nga një hendek uji në pjesën tokësore, megjithatë, ajo u dorëzua pas

14 *Bimarhane* ishte një spital i specializuar për trajtimin e të sëmurëve mendorë. Pacientët kuroheshin **me anë të muzikës**. Mjekët i bënin të sëmurët të dëgjonin një *mekam* të veçantë për sëmundje të ndryshme. Ndërsa në Evropën e asaj kohe, të sëmurët mendorë, zakonisht digjeshin pasi mendohej se ata ishin “të pushtuar” nga xhindet. Duhet të theksojmë në këtë rast, se ky trajtim është praktikuar sërish nga As.Prof.Dr. **Rahmi Oruç Güvenç**, në Universitetin Marmara, në Stamboll (Rr. Almedar, Nr: 18.3, Sulltanahmet, Stamboll, tel: 0090 212 526 90 31; 0090 212 526 90 32).

15 Lütfi Paşa, *Tevarih-i Al-i Osman*, Stamboll 1341 H, fq. 192.

12 ditë luftimesh. Në këtë mënyrë, territori osman u shtri deri në veri dhe arriti të bashkonte me turqit e veriut, popullin e Krimesë. Kili dhe Akkermani në brigjet e Detit të Zi, duke qenë se ishin portet kryesore të zhvillimit të tregtisë, ishin edhe dy pika strategjike për Bogdanin. Kjo bëri që më pas, osmanët ta dominonin më lehtë këtë vend. Vojvoda i Bogdanit, **Stefan Cel Mare**, u përpoq t'i merrte këto dy porte, por nuk arriti. Si përfundim, ai e kuptoi se ishte e pamundur të përballej me Devletin Osman dhe pranoi vartësinë prej tij, duke i paguar Thesarit të Devletit 4.000 monedha floriri. **Mengli Gëraj**, duke qenë se ishte pjesë e kësaj fushate, i hapi ndaj Islamit të gjitha territoret që shtriheshin në pjesën veriperëndimore të Detit të Zi, duke i kthyer në një entitet shumë të rëndësishëm në rajon. Një sasi e madhe plaçke lufte (*ganimet*) iu dha Hanit të Krimesë dhe vojvodës së Vllahisë nga Devleti Osman. **Sulltan Bajezidi II** caktoi që pjesa nga *ganimeti* i Devletit Osman të shkonte për institucionet publike dhe ato të arsimit të tilla si: xhami, medrese, imarete, bimarhane, të cilat ishin ndërtuar në Edrene.¹⁶

Ndihma ndaj muslimanëve të Andaluzisë

Në atë kohë, muslimanët e Andaluzisë kishin pësuar disfatë nga të krishterët dhe Andaluzia ishte duke u humbur në favor të botës së krishterë. Mirëpo, flota osmane nuk ishte aq e fortë sa të sundonte Mesdheun, kështu që iu desh të priste dhe një gjysmë shekulli për të arritur një pozitë më të fuqishme.¹⁷ Megjithatë, Bajezidi II dërgoi **Kemal Reisin** në ndihmë të bashkëfetarëve të Andaluzisë. Kjo ngjarje është përshkruar si

16 OT, II, fq. 182-184.

17 Historianët dhe studiuesit perëndimorë luajnë me anakronizimin, duke thënë se Devleti Osman, që deklaronte se ishte kampioni i Islamit, nuk e shpëtoi Andaluzinë, por në të vërtetë osmanët bënë ç'ishte e mundur për ta shpëtuar këtë vend. Në fakt, ata nuk mund të arrinin deri në Spanjë në rrugë tokësore, duke eliminuar të gjithë botën e krishterë. Flota osmane u bë e fuqishme vetëm pas fitores së betejës detare të Prevezës, më 28 shtator 1538, kur ata shkatërruan flotën e krishterë detare. Qyteti i fundit musliman Grenada, në Andaluzi (Spanjë), ra në vitin 1492!

më poshtë: “Duhet të përmendim një nga veprimet më mbresëlënëse të flotës turke, që në përgjigje të kërkesës për ndihmë nga Grenada, në betejën e fundit me Kastijën, Bajezidi dërgoi Kemal Reisin për të bastisur bregun spanjoll. Flota ishte përdorur si mjet lufte edhe në vitin 1487, dhe pas rënies së Grenadës në vitin 1492, u përdor për të shpëtuar një numër të madh refugjatësh dhe për t’i transportuar ata drejt Afrikës së Veriut. Kjo ishte ndërmarrja e parë e osmanëve në Mesdheun Perëndimor, por ishte edhe një shenjë paralajmëruese e sukseseve të marinarëve turq, një shekull më pas, ku arritjet e para të kësaj periudhe ishin sulmet e Kemal Reisit në ishujt Baleare, Sardenjë dhe Pianoza (pranë ishullit të Elbës), në vitin 1501.”¹⁸ Muslimanët e Andaluzisë i kërkuan ndihmë **Hëzër Hajreddin Beut** (që më pas mori titullin Pasha), i cili dërgoi për ta 36 anije nga Algjeria. Gazinjët vullnetarë osmanë arritën të dërgonin 70.000 muslimanë nga Andaluzia në Algjeri.¹⁹ Pas vdekjes së Xhemit, osmanët ishin të lirë të sulmonin territoret evropiane dhe arritën të aneksonin Inebahtën (Lepanton) e venedikasve në vitin 904/1499 dhe kështjellat e Motonit dhe Koronës, në More në vitin 905/1500.²⁰

Xhihad drejt Lehistanit

Në vitin 895/1484 u nënshkrua një traktat paqejë midis **Bajezidit II** dhe mbretit të Lehistanit (Polonisë), **Kasimir Jagellon IV**. Devleti Osman kishte interesim për Bogdanin dhe nga ana tjetër, edhe Hungaria në perëndim dhe Polonia në veriperëndim të Bogdanit ishin të interesuara për të. Vojvodët e Bogdanit i paguanin tagër mbretërve të Hungarisë. Pra, kishte tre rivalë për Bogdanin. I angazhuar me çështje të tjera në

18 D.E. Pitcher, *vepër e cituar*, fq. 99. Sulltani osman Bajezidi II emëroi Kemal Reisin si “Kaptan Pasha” në vitin 1495. Më pas, ai u angazhua në një sërë betejash detare të suksesshme kundër fuqive evropiane. Shiko: Piri Reis, *Kitab-ı Bahriye*, Stamboll: 1935, fq. 11.

19 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 310-311.

20 Katip Çelebi, *Tuhfetü'l Kibar fi Esfari'l Bihar*, Stamboll: 1329, fq. 40.

vende të ndryshme, Sulltani osman Bajezidi II kishte lidhur një traktat paqeje tre vjeçar me mbretin polak, traktat ky që rino-vohej çdo tre vjet.²¹

Djali i Kasimirit, **Jan Alberti**, që në vitin 897/1492 mori fronin e mbretërisë së Polonisë në vitin 902/1497, iu drejtua me ushtrinë e tij Bogdanit, që në atë kohë ishte nën mbrojtjen e osmanëve. Vojvoda i Bogdanit, **Stefani**, iu drejtua Devletit Osman duke i kërkuar ndihmë për të përballuar këtë sulm të Polonisë. Mbreti i Hungarisë, **Vladislavi**, u përpoq të lidhte Poloninë me traktatin e nënshkruar midis Hungarisë dhe Devletit Osman, në mënyrë që të shmangte marshimin e osmanëve kundër Polonisë, por Devleti Osman nuk pranoi.

Në verën e vitit 903/1498, drejt Lehistanit (Polonisë) u nis Sanxhakbeu i Silistrës dhe një komandant akënxhë, Malkoçoğlu **Bali Bej (Malkoçoğlu Bali Beğ)**, në krye të një ushtrie prej 40.000 luftëtarësh. Këta luftëtarë akënxhinj u drejtuan në fushatën e tyre edhe nga Vojvoda i Bogdanit. Ata kaluan Lumin Turla (Dnjestër) nëpërmjet urës së ndërtuar mbi lumë dhe arritën të hynin në Lehistan. Ata morën kështjellën e Krakovit, që ishte vendosur në bregun e lumit Turla, kështjellën e Drecnit, Glagorit, Kancugës, Gelenbanjas në brendi, e madje dhe kështjellën e Braklavit, që shërbente si rezidencë verore për mbretin, dhe i shkatërruan të gjitha. Më pas luftëtarët akënxhinj u kthyen në Akkerman, brenda territorit osman.²²

Marrëdhëniet osmane-memluke

Gjatë sundimit të Sulltan Muradit I, filluan marrëdhëniet e para midis osmanëve dhe memlukëve dhe u zhvilluan më tej me Jëlldërëm Bajezidin, dhe veçanërisht pas aneksimit osman të Bejlikut të Karamanit, dhe bejlikeve të tjera në rajonin e Anadollit, kur këto dy fuqi u kthyen në vende fqinje. Në atë

21 Danişmend, *İzahlı Osmanlı Tarihi Kronolojisi*, Stamboll:1971, vëllimi I, fq. 391.

22 OT, II, fq. 184-185.

kohë, memlukët dominonin Egjiptin, Hixhazin, Sirinë, Jemenin dhe disa pjesë të tjera të Anadollit. Osmanëve nuk iu pëlqente qëndrimi i memlukëve ndaj bejlikeve të Ramazanogllut (Ramazanoglu) dhe Dulkadirogllut (Dulkadiroglu). Nga ana tjetër edhe memlukëve nuk iu pëlqente aneksimi osman i Bejlikut të Karamanit në Anadoll. Ata e pritën Xhemin në Kajro, sikur ai të ishte një sulltan dhe kjo ishte një ngjarje që shkaktoi rritjen e tensionit, që u shoqërua me përballjet e para midis tyre në Çukurova, në vitin 890/1485. Por, Sulltani hafsit i Tunizisë, **Ebu Zekerija Jahja**, e frenoi këtë krizë dhe luajti një rol tepër të rëndësishëm për arritjen e paqes midis këtyre dy fuqive muslimane në vitin 896/1491.²³

Përfundimi i hapjes së Moresë ndaj Islamit

Pas vdekjes së shehzades Xhem, osmanët kishin më tepër mundësi për të rifilluar veprimet e tyre në Evropë; të krishterët nuk kishin më një shehzade që mund të nxiste një luftë civile brenda territorit osman. Venedikasit, të cilët zotëronin pjesën perëndimore të Moresë, kërkuan krijimin e një aleance kryqtare kundër osmanëve. Për ta arritur këtë, ata kërkuan ndihmën e Perandorit të Gjermanisë, Papës dhe Mbretit të Anglisë, Francës, Spanjës, Napolit, Polonisë dhe Hungarisë.

Papa u përpoq të nxiste një kryqëzatë të re kundër osmanëve dhe midis Venedikut, Papës dhe Hungarisë u lidh një traktat, në pranverën e vitit 1500, që u bë publik vetëm një vit më pas, në vitin 1501, gjatë festimeve të një dite të shënuar të krishterë. Ata planifikonin të sulmonin njëkohësisht nga toka dhe nga deti. Admirali venedikas, **Pizaro**, pushtoi ishullin osman, EGINE. Flotat detare të Venedikut dhe Spanjës pushtuan ishullin Kefalonia dhe një flotë tjetër detare, që mbartte 15.000 luftëtarë francezë, ankoroi në ishullin Zanta. Flota e Mbretit të Aragonës dhe Sicilisë mbërriti në ishullin e Korfuzit. Por flota

23 Tursun Beğ, *Tarih-i Ebu'l Feth*, fq. 201; Katip Çelebi, *vepër e cituar*, fq. 22.

më e rëndësishme franceze, që ishte e përbërë nga 200 anije nën komandën e Admiralit **Ravenshtajn (Ravensteyn)**, bllokoi ishullin Midil-li (Mitolene) që është shumë pranë bregut të Detit Egje, në pjesën e Anadollit. Nipi i Mbretit të Francës ishte së bashku me ta. Sanxhakbeu i Manisës, shehzade **Korkuti**, dërgoi ushtarë në ndihmë të garnizonit osman të ishullit dhe kur flota osmane mbërriti, flota franceze u tërhoq. Nipi i mbretit të Francës u vra dhe koka e tij u shfaq në publik. Nga ana tjetër, *gazinjtë* osmanë arritën ta hapnin përfundimisht Morenë ndaj Islamit, duke ua marrë atë venedikasve në vitin 907/1502. Më pas, Devleti Osman dhe Republika e Venedikut lidhën një traktat në Rexheb 908/dhjetor 1502, sipas të cilit Inebahtë (Lepanto), Motoni, Korona dhe kështjellat e tjera më të vogla, do të qëndronin nën sundimin e osmanëve. Ndërkohë që Kefalonia ishte nën zotërimin e Venedikut dhe ishulli Santamavra u rimor nga osmanët.²⁴

Përhapja e Shiizmit në Anadoll

Edhe pse paraardhësit e tij ishin Sufi Sunnitë, **Shah Ismail Safevi** (sundoi 1502-1524) qëllimisht dhe për shkaqe të tjera politike e konvertoi Iranin nga Devlet Sunnit në Devlet Shiit, dhe ekzekutoi në mënyrë të pamëshirshme prijësit fetarë, të cilët e kundërshtuan këtë ndryshim.²⁵ Pas themelimit të Devletit të tyre Safevit, ata "falsifikuan qëllimisht faktet për origjinën e tyre". Qëllimi i tyre i vërtetë i deklaramit të origjinës së tyre Shiite, bëhej për arsye se ata dëshironin të diferencoheshin nga otomanët dhe për arsye se synonin të siguronin simpatinë e të gjitha elementeve heterodokse. Për të arritur këtë qëllim, ata shkatërruan në mënyrë sistematike çdo fakt apo evidencë që tregonte se Shejhu Safi ed-Din Is'hak, themeluesi i *tarikatis* Safevid, nuk ishte Shiit (ai me shumë mundësi ishte një Sunnit i

24 OT, Ankara 1983, II, fq. 224.

25 R.M. Savory, "Safevid Persia", *The Cambridge History of Islam*, Cambridge: C.U.P. ribotim 1980, vëllimi I A, fq. 398.

medhhebit Shafi'it) dhe ata falsifikuan dëshmi për të provuar se Safevidët ishin *sejjidë*, që do të thotë pasardhës të drejtpërdrejtë të Profetit. Ata krijuan një gjenealogji të dyshimtë, duke e gjurmuar origjinën e familjes Safevide nga Imami i shtatë Musa el-Kazim i Dymbëdhjetë Imamëve, një gjenealogji që është ndjekur nga burimet e mëvonshme Safevide dhe është përfshirë në tekstet e një vepre hagiologjike mbi jetën e Shejh Safi ed-Dinit, një sërë anekdotash të krijuara për të vërtetuar pretendimin e Safevidëve se ishin *sejjidë*. Nëse i shikojmë nga një pikëpamje e paanësishme, pjesa më e madhe e këtyre anekdotave duken të thjeshta, për të mos thënë naive.²⁶

Të gjitha këto veprime u ndërmorën për shkak të faktit se Shahu Ismail kishte vetëm dy opsione: të mundte memlukët dhe osmanët, të cilët ishin “përfaqësuesit” e Islamit ose t’i bindej njërit prej tyre, nga që duhet të ekzistojë vetëm “një” drejtues në Islam. Në fakt, ai nuk dëshironte t’i bindej asnjërës prej këtyre fuqive, por në të njëjtën kohë ishte tepër e vështirë, gati e pamundur t’i mundje ata. Për këtë arsye, kalimi nga Sunizmi në Shiizëm dukej si rruga e vetme e zgjidhjes. Në të vërtetë nuk kishte **asnjë arsye** që Irani, i cili ishte i dominuar nga turqit, të kalonte nga Sunnit në Shiit. Mosmarrëveshja mes Hazreti Aliut dhe Mu’avijes kishte mbetur prapa me kalimin e shekujve. Kur Mu’avije b. Ebi Sufjan erdhi në pushtet në vitin 40/661, mbështetësit e Hazret Aliut (Shiitët) vazhduan luftën e tyre dhe familja e Emevitëve u rrëzua në 132/750, dhe u zëvendësua me familjen e Abbasit, xhaxhait të Profetit (s.a.v.s.). Emevitët dominuan botën muslimane për 90 vjet (661-750) dhe pas tyre muslimanët jetuan nën administrimin Abbasid (751-1258). **Turqit jetuan në Turkestan në vitin 40/661 dhe nuk kishin hyrë ende në Islam. Kur ndodhi Tragjedia e Kerbelasë në 10 Muharrem 61/10 tetor 680, turqit ishin akoma në Turkestan; ata nuk kishin të bënëin me këto çështje.** Nëse çështja është nderimi i Ehli Bejtit (familjes së Hazreti Muham-

26 Po aty, fq. 394.

medit) dhe dashuria për ta, është e pamundur të gjesh një Sunnit (ndjekës të sunnetit, traditës së Profetit), i cili nuk e do dhe nderon Ehli Bejtin; nuk ka asnjë në radhët e Sunnitëve me emrin Jezid. **Për këtë arsye dhe vetëm për motive të përbotshme, Irani u konvertua në Shiit përmes shtypjes.**

Shahu Ismail drejtoi një fushatë të fuqishme për të përhapur Shiizmin në Anadoll dhe dërgoi një numër të madh agentësh për këtë çështje. Ndërkohë Bajezidi II tashmë në një moshë të thyer, mendonte seriozisht për të abdikuar në favor të djalit të tij më të madh, shehzade Ahmedit, Sanxhakbeut të Amasjas, i cili kishte një reputacion si dashamirës, bujar dhe ishte shumë popullor midis vezirëve. Por, shehzadi i dytë, Korkuti (1470-1513), që ishte përkrahës i njerëzve të arsimuar dhe marinarëve, punoi fshehurazi kundër tij dhe u përpoq të fitonte mbështetjen e ushtrisë. Megjithatë, përpjekjet e tij dështuan dhe kaloi nga Manisa në drejtimin e sanxhakut të Antaljas. Ahmedi u caktua në Manisa dhe në vitin 1511 u nis për të shtypur, por pa sukses, një kryengritje të organizuar në Anadollin Perëndimor nga njëri prej agentëve të Shah Ismailit, të quajtur Shahkullu (robi i Shahut). Në fakt, Shahkullu u vra gjatë betejës, por Ali Pasha, që luajti një rol të rëndësishëm në arritjen e këtij suksesi, vazhdoi të përparonte në mënyrë të panevojshme dhe ra martir. Forcat e osmanëve nuk i ndoqën pas kryengritësit. Kjo situatë e paqëndrueshme në Anadoll nxiti shumë pjesëtarë të ushtrisë dhe të qeverisë t'i drejtoheshin për ndihmë, ndaj këtij rreziku në rritje, Selimit, shehzades së tretë, që ishte shumë i aftë.²⁷

27 Ahmed Uğur, *The Reign of Sultan Selim I in the Light of Selim-Name Literature*, Berlin: Klaus Schwarz Verlag, 1985, fq. 192.

KAPITULLI 6

LUFTA PËR UNITETIN ISLAM

6.1 Javuz Sulltan Selim Hani 1512-1520

Shehzadeja i tretë, Selimi, Sanxhakbeu i Trabzonit ishte në dijeni të veprimtarisë së Shah Ismailit në Anadoll. Pasi mësoi për marrjen e planifikuar të fronit nga vëllai i tij, Ahmed, Selimi kërkoi të emërohej si sanxhakbej i Rumelisë (në Evropën osmane). Por, kjo kërkesë e tij u kundërshtua, për arsye se praktika tradicionale osmane nuk lejonte emërimin e asnjërit nga shehzadet si sanxhakbej në Rumeli. Atëherë, Selimi shkoi në Kefe, në Gadishullin e Krimesë dhe më pas në Rumeli me 10.000 luftëtarë. Me mbërritjen e tij në Silistre, ai kërkoi të fliste me të atin e tij personalisht dhe pas disa diskutimesh, u vendos që ai të emërohej Sanxhakbej i Semendires (Smederevës) në Rumeli, dhe që asnjë prej shehzadeve të tjerë nuk do të emërohej si *veliahd* (princ i kurorës). Duke e ditur se Bajezidi ishte më tepër i prirur për t'i kaluar sulltanatin Ahmedit, djalit të tij më të madh, dhe se në fakt, ai do ta thërriste atë në Stamboll, Selimi arriti në Çorllu dhe vezirët ngritën perdet e karrocës së Bajezidit për t'i thënë: "Shikoje ushtrinë e djalit tënd që thotë se ka ardhur vetëm për të të puthur dorën". Ata qëlluan në të njëjtën kohë me armë kundër Selimit, i cili u detyrua të luftonte edhe pse pa dëshirë. Megjithatë, pas pak kohe, Selimi u tërhoq dhe Sulltan Bajezidi u kthye në Stamboll.

Ndërkohë, shehzade Ahmed i ishte duke pritur me ankth në Malltepe, për të marrë një ftesë nga Stambolli. Por, *jeniçerët* që e kishin admiruar guximin dhe heroizmin e Selimit gjatë luftimit, nuk ishin në favor të Ahmedit që nuk i kishte dhënë një zgjidhje problemit të Shiizmit. Shehzadeja tjetër, Korkuti, ishte një njeri i arsimuar dhe me ndërgjegje të pastër e me shpirt artisti, por nuk ishte një luftëtar i mirë, dhe përpos të tjerave, ai nuk kishte asnjë pasardhës që të ndiqte linjën e trashëgimisë osmane. Për këtë arsye, *jeniçerët* (bërthama e ushtrisë osmane) ngulmuan: “Ne nuk pranojmë asnjë sulltan tjetër veç Selimit.” Në këtë mënyrë, shehzade Ahmed i u kthye në sanxhakun e tij, kur Selimi mori letra nga fisnikët që e ftonin të shkonte në Stamboll. Ai kaloi Danubin e ngrirë dhe mbërriti në Stamboll në vitin 918/1512, ku u takua me babain e tij dhe kalëruan së bashku mbi kuaj. Sulltan Bajezidi i ofroi postin e kryekomandantit të ushtrisë, me kusht që ai të marshonte menjëherë kundër Shah Ismailit, por Selimi këmbënguli se ishte më e rëndësishme për të që të merrte drejtimin e sulltanatit, në mënyrë që kjo detyrë të arrihej me sukses. Sidoqoftë, Sulltan Bajezidi abdikoi²⁸ në moshën 65-vjeçare. Ai u nis për në Mallkara dhe vdiq gjatë udhëtimit në Sogtyldere (Söğütüldere).²⁹

Ndërkohë në Evropë po zhvilloheshin veprimtari të rëndësishme imperialiste dhe aventureske. Abbas Hamdani bën një përshkrim përmbledhës të kësaj situatë si vijon: “Në Evropë, Portugalia dhe Spanja filluan shtrirjen e tyre detare pas zbulimit të Amerikës dhe Kepit të Shpresës së Mirë. Raporti i Diazit në vitin 1488 dhe raporti i Koviljës në 1492, bindi Dom Zhoan për lehtësinë e arritjes deri në Indi dhe në Orientin e Largët në rrugën detare nëpërmjet Kepit të Shpresës së Mirë. Lajmi i zbulimit të Indisë nga Kolombi, mund të ketë vonuar planet e Zhoas, por meqë më pas u kuptua se Kolombi kishte zbuluar një kontinent të ri që nuk ishte India, kjo rigjallëroi

28 Xhelalzade Koxha Nishanxhë Mustafa, *Kitab-i Measir-i Selim Hani*, TSMK, H. 1415, 63 a.

29 Po aty, 64 a.

këmbënguljen dhe vendosmërinë e drejtuesit të Portugalisë për të dërguar një ekspeditë të re në drejtim të jugut. Në vitin 1479, duke u sjell rreth Kepit, Vasko de Gama ndoqi rrugën përgjatë bregut verior të Afrikës, deri sa mbërriti në Malindi (Zanzibari i sotëm). Atje, ai takoi një drejtues lundrimi të mirënjohur arab, **Ahmed ibn Mexhidin**, i cili ishte dhe autor i librave që trajtonin këtë temë. **Ky i fundit ndihmoi portugezët të kalonin Oqeanin Indian dhe të arrinin deri në Kalikut (Kalkuta), në bregun perëndimor të Indisë jugore, që ishte qëndresa kryesore e Lindjes për tregtinë e erëzave.** Erëzat e Indisë iu bashkuan në këtë mënyrë floririt, fildishit dhe skllëvërve të Afrikës Perëndimore. Portugezët vendosën kolonitë e tyre përgjatë gjithë rrugës së re drejt Indisë...³⁰


Portugezët ndoqën me ngulm ambiciet e tyre dhe pushtuan porte të reja në Oqeanin Indian. Në fakt, ata e kthyen atë në "Liqen Portugez" dhe ndaluan lundrimin e muslimanëve atje. Ishte një sekret i ditur që të krishterët ishin ambiciozë për të pushtuar qytetin e shenjtë të Mekës dhe ta shkëmbenin atë me Jerusalemin. Ata, madje, menduan të ndryshonin drejtimin e rrjedhjes së Nilit nëpërmjet Etiopisë, drejt Detit të Kuq për ta ngordhur urie Egjiptin.³¹

Sulltan Selimi ishte ende dyshues ndaj qëllimeve të vëllezërve të tij, Ahmedit dhe Korkutit, edhe pse i kishte dhënë këtij të fundit Midil-lin përveç Sanxhakut të tij të Saruhanit (Manisës). Ahmed i rrethoi Konjën, por u detyrua të tërhiqej në Mallatja. Që të arrinte të kuptonte qëllimet e ardhshme të vëllezërve të tij, Selimi u dërgoi atyre letra të falsifikuara në emër të fisnikëve osmanë, sipas të cilave ata "ftoheshin" të merrnin sulltanatin në Stamboll. Të dy vëllezërit e tij, me t'iu afruar Stambollit, u ekzekutuan. Historia e vonë osmane është plot me probleme të tilla mes pjesëtarëve të oborrit të sundimtarëve, që

30 Abbas Hamdani, "Ottoman Response to the Discovery of America and the New Route to India", *Journal of American Oriental Society*, vëllimi 101 (1981), fq. 325. Theksimi është shtuar.

31 Po aty, fq. 327.

i kushtuan shumë Devletit. Në mënyrë që të shmangte kaosin e mëtejshëm dhe një situatë të paqëndrueshme, Sulltan Selimi nuk kishte asnjë alternativë tjetër, përveçse të merrej me vëllezërit e tij në këtë mënyrë të ashpër. Ai është quajtur shpesh “Javuz”, që në Turqinë e shekullit të 16-të, kishte kuptimin “i dhunshëm dhe i vrazhdë”. Megjithatë, duket se populli e admironte atë aq shumë, sa që kuptimi i kësaj fjale ndryshoi në “i vendosur, i fuqishëm dhe i aftë”. Pjesa më e madhe e historianëve osmanë thonë se, nëse njëri prej shehzadeve do të ishte arratisur në Iran, apo Egjipt, sulltani osman nuk do të kishte qenë i aftë të ndërmernte asnjë veprim. Sulltani ishte tepër i mërzhitur, madje dhe kishte qarë.³² Por, këto veprime të dhunshme ishin të pashmangshme, në mënyrë që sulltani të merrte fuqinë, të ruante bashkimin dhe qëndrueshmërinë e Devletit, si dhe të ndërmernte përgjegjësitë e tij historike.



Xhamia e Javuz Selimit në Stamboll

Beteja midis Javuzit dhe Ismailit

Javuz Sulltan Selimi ishte një Sunnit i devotshëm dhe si i tillë ai ishte i zotuar plotësisht ndaj idealit të bashkimit në Islam. Ai i shprehu këto qëllime dhe synime në poezinë e tij të famshme të mëposhtme:

Milletymde ihtilaf u tefrika endishesi

Kushe-ji kabrimde hatta bi-karar ejler beni

Ittihad oldu hyxhum-i hasmi def'a çaremyz

*Ittihad etmezse millet dagidar ejler beni.*³³

Kuptimi i mosmarrëveshjeve mes muslimanëve

Do të më shqetësojnë edhe në varrin tim

Bashkimi është rruga jonë për të zmrapsur sulmin e armikut

Nëse muslimanët nuk do të bashkohen, kjo do të më lëndojë shumë.

Pasi përfitoi kontrollin e plotë dhe të lirshëm të Devletit Osman, **Sulltan Selimi** urdhëroi administratën e tij të merrte në shqyrtim çështjen e Shiizmit në Anadoll. Nga ky studim rezultoi se, propaganda e shiizmit në Anadoll kishte arritur të tërhiqte mbështetjen e 40.000 njerëzve për Shah Ismailin, i cili kishte ekzekutuar 60.000 Sunnitë në Azerbajxhan. Në shenjë hakmarrjeje të këtij krimi, Javuzi ekzekutoi shumë nga krerët shiitë në Anadoll dhe shumë të tjerë i burgosi. Pasi iu dha këtë goditje të rëndë Shiitëve të Anadollit, Javuz Sulltan Selimi u nis drejt Iranit në vitin 1514 për të zgjidhur çështjen e kërcënimit shiit të Safevitëve atje. **Shah Ismaili** asokohe kishte arritur të sfidonte edhe sundimin e memlukëve dhe u kishte propozuar të krishterëve të Evropës se ai do ta sulmonte Sirinë nga veriu, nëse ata do të sulmonin në të njëjtën kohë nga Mesdheu.³⁴ Osmanët u

33 Faik Reşad, *Tarih-i Edebiyyat-i Osmaniyye*, (Stamboll), fq. 230.

34 Ibn Iyas, *Bedai'u'z Zuhur fi Weka'i'id Duhur*, red. nga Muhammad Mustafa, (Kajro:1960), vëllimi IV, fq. 191.

përpoqën të lidhnin një traktat me memlukët kundër Safevitëve të Iranit, por asnjë rezultat konkret nuk u arrit nga kjo përpjekje. Memlukët kishin zgjedhur asnjësinë në këtë konflikt dhe gjithçka që ata bënë ishte dërgimi i disa trupave në Alepo, për të mbrojtur kufijtë e tyre atje, kundër dy fuqive veriore.³⁵

Javuz Sulltan Selimi i dërgoi një letër **Shah Ismailit** me anë të së cilës i kërkonte atij të pendohej dhe të hiqte dorë nga armiqësitë dhe dhuna, duke cituar Kur'anin Fisnik: "Kush bën ndonjë të keqe ose e ngarkon veten, pastaj kërkon falje tek Allahu, ai e gjen Allahun Falës dhe Mëshirues."³⁶ [*en-Nisa*, 110]. Por, Shahu ishte kokëfortë dhe i papërkulur. Më pas, Javuz Sulltan Selimi i dërgoi një letër tjetër Shah Ismailit në të cilën i shkruante: "Po nisem kundër teje, le të bëhet ajo që ka dekretuar Hakk Te'ala, mos thuaj që u kape në befasi apo se nuk pate kohë të mblidhje ushtarët."³⁷ Në këtë mënyrë, Javuz Selimi avancoi në drejtim të tij me një ushtri prej 100.000 luftëtarësh. Ai i dërgoi atij një mesazh të fortë me anë të të cilit e sfidoi për luftë, por Shah Ismaili nuk kishte aftësinë dhe kurajën asokohe për një përballje të tillë, dhe për pasojë u tërhoq drejt Iranit. Ushtria osmane e kërkoi ushtrinë e tij në pjesën perëndimore të Iranit për dy muaj,³⁸ por pa sukses. **Ustazhllu Mehmet Hani** ishte komandanti i frontit perëndimor të ushtrisë së Shah Ismailit; duke e ditur se nuk do të ishte i aftë t'i bënte ballë ushtrisë osmane u largua nga provinca, pasi shkatërroi qytete, qyteza, fshatra dhe gjithçka tjetër që ndodhej atje, dhe më pas u bashkua me Shahun. Ushtria osmane kishte filluar të ndjente lodhjen, ndërsa ushtria armike nuk shihej askund. Prandaj, jeniçerët u revoltuan dhe gjuajtën drejt tendës së Javuz Selimit, gjatë pushimit të ushtrisë në fushën e Eleshgirdit, pasi ata dëshironin të ktheheshin. Por në këtë rast doli në pah vullneti i hekurt i **Javuz Selimit**: pa treguar as shenjë më të vogël të

35 Po aty, IV, fq. 372-376.

36 Koxha Nishanxhë, *vepër e cituar*, 93 b.

37 Lütfi Paşa, *Tevarih-i Al-i Osman*, fq. 208.

38 OT, II, fq. 263; Solakzade, *Tarih*, fq. 369; Netajixh, I, fq. 73.

frikës, ai kalëroi drejt jeniçerëve dhe iu tha: “Nuk kemi mbërritur ende aty ku dëshirojmë dhe nuk jemi ndeshur ende me armikun; nuk ka asnjë mundësi që të kthehemi mbrapsht pa u ndeshur me ta, madje edhe mendimi për një gjë të tillë do të ishte një imagjinatë e papranueshme. Është për të ardhur keq që ndjekësit e Shahut janë të përgatitur për t’u vetësakrifikuar për hir të tij; ndërsa ne, tashmë, kur kemi arritur në kufi për t’i bërë ata që sillen në kundërshtim me Sheriatin, t’i drejtojmë në Krugën e Drejtë, disa të dobët përpiqen ta bëjnë këtë fushatë të xhihadit jofrytëdhënëse. Sigurisht që unë nuk do të shmangem dhe nuk do të kthehem; unë do të shkoj me ata që i binden *Ulul Emrit*, derisa të arrijmë atje ku duhet. Ata që i kanë zemrat e dobëta, ata që mendojnë për familjet e tyre dhe dëshirojnë të kthehen me pretekstin e vështirësisë për të marshuar, të vepronë si të dëshirojnë. Nëse ata zmbropsen, do të thotë se ata e lënë fushatën që është ndërmarrë për hir të *Din-i Mybin*, Islamit. Nëse preteksti është mungesa e ushtrisë armike, ata janë përballë nesh. Nëse jeni burra, ejani pas meje, në të kundërt, unë do të vazhdoj i vetëm!” Dhe ngau kalin e tij duke i turpëruar jeniçerët, që e ndoqën pas të gjithë së bashku.³⁹ Në fjalimin e tij u përmbodh shkurtimisht qëllimi i ekzistimit (*raison d’etre*) të entitetit osman: prania e osmanëve, jeta e tyre i kushtohet Islamit, osmanët do të luftonin kundër fisit të tyre, turqve, për hir të Islamit; pasi Devleti Osman përfaqësonte Islamin Sunnit dhe se ishte i mendimit që kundërshtari është jashtë Islamit. Osmani është i mendimit se kushdo që kthehet mbrapsht nga një fushatë e tillë xhihadi, shihet si femohues. Pika më e rëndësishme në këtë çështje është se nuk duhet të ketë asnjë lloj hezitimi tek asnjëri nga ushtarët osmanë. Ata autorë perëndimorë që përpiqen ta tregojnë Develtin Osman si një fuqi turke imperialiste, **nuk mund ta shpjegojnë Betejën e Çalldëranit** midis dy ushtrive turke. Sjellja guximtare e Javuz Selimit ndryshoi rrjedhën e historisë, pasi, nëse ai do të ishte zbutur dhe do t’iu ishte

39 OT, II, fq. 264, poshtëshënimi 2.

bindur pesimizmit të jeniçerëve, Shah Ismaili, territori i të cilit shtrihej deri në Indi, do të kishte përhapur autoritetin e tij edhe në Anadoll. Propaganda e tij e fshehtë kishte fituar shumë mbështetës edhe në Rumeli. Për këtë arsye do të kishte qenë shumë e vështirë që Devleti Osman të mbante territoret e tij në Evropë dhe për pasojë do të ishte rrënuar përpara Evropës së krishterë.

Si përfundim, **Shah Ismaili** u përball me ushtrinë osmane në 920/gusht 1514 në **Çalldëran**. Kalorësia osmane ishte e lodhur, ndërsa kalorësia e Safevitëve ishte e vrullshme, por artilleria që dispononin osmanët e baraspeshonte situatën. Ushtria osmane mbërriti në vendin ku do të zhvillohej beteja duke përshkuar një distancë prej 2.500 km. Në fakt, Shahu u përpoq ta lodhte ushtrinë osmane dhe kështu ta shkatërronte ushtrinë e rraskapitur.

Me të arritur në Çalldëran, Javuz Selimi mblodhi *mexhlisin* e luftës, për të diskutuar dhe vendosur nëse duhet ta lejonte ushtrinë të pushonte apo të sulmonte menjëherë kundër armikut. Vezirët ishin të mendimit që ushtria të pushonte, vetëm *bashdeftedari Piri Mehmed Çelebiu* argumentoi se mund të kishte shiitë të fshehtë në radhët e ushtrisë osmane që mund të propagandonin kundër zhvillimit të luftimeve kundër Shahut, dhe se beteja duhet të fillonte menjëherë. Duke admiruar këtë argumentim, Javuz Selimi tha: “Ky është i vetmi njeri që ka mendim. Është për të ardhur keq që ai nuk është ende një vezir!”, dhe u vendos që ata të sulmonin armikun në agimin e mëngjesit tjetër.⁴⁰ Piri Mehmed Çelebiu (që më pas mori titullin Pasha) u bë më pas vezir dhe sadrazam (Vezir i Madh) në vitin 1518. Mosha madhore e tij nuk ishte e favorshme, që në atë kohë (1514) ai të emërohej si vezir. E rëndësishme është të jesh i vetëdijshëm ndaj aftësive dhe vlerave të njerëzve, dhe Javuz Selimi ishte i aftë në këto çështje. “Piri Mehmed Pasha, që u caktua *vezir-i a'zam* (Vezir i Madh) nga fundi i periudhës së Javuz

40 OT, II, fq. 266-268.

Selimit, e vazhdoi punën e tij edhe gjatë fillimit të periudhës së Sulltan Sylejmanit (të Madhërisëm). Ai ishte me origjinë turke, që është një fakt i rrallë për administratën osmane, dhe ishte dhe një burrë shteti i madh.”⁴¹

Beteja filloi në agimin e datës 2 Rexheb 920/23 gusht 1514. Kalorësia safevite sulmoi krahun e majtë të ushtrisë osmane, forcat *azeb* (këmbësoria e lehtë) nuk arritën të tërhiqeshin në kohën e duhur, para pushkëve dhe për këtë arsye, krahu i majtë i osmanëve pësoi humbje të rënda, ku Bejlerbeu i Rumelisë dhe disa bejlerë të tjerë u martirizuan.⁴² Por, Bejlerbeu i Anadollit, **Sinan Pasha** qëlloi me artilerinë e rëndë, duke i çoroditur armiqtë dhe duke e detyruar kalorësinë e tyre të shpërndahej dhe të largohej. **Shah Ismaili** i shpëtoi me vështirësi vdekjes⁴³ dhe si përfundim ia mbathi nga kishte ardhur me disa plagë të marra në trup. Pra, ushtria osmane i kishte shkaktuar një humbje të rëndë ushtrisë safevite⁴⁴ dhe Selimi hyri në Tebriz,

41 I.H. Danişmend, *Izahlî Osmanlı Tarihi Kronolojisi*, Stamboll 1971, vëllimi II, fq. 15-16.

42 Lütfi Paşa, *Tevarih-i Al-i Osman*, Stamboll 1341 H, fq. 230.

43 Koxha Nishanji, *vepër e cituar*, 102 a – 105 a.

44 R.M. Savory nuk mund ta fshehë hidhërimin e tij ndaj fitores osmane kundër Shiitëve Safevitë: "... dhe nuk ka asnjë dyshim që Safevitët mund të kishin përdorur artilerinë e rëndë dhe pushkët e dorës, nëse do të kishin dashur. Është thënë se Safevitët, ashtu si bashkëkohësit e tyre, memlukët e Egjiptit dhe të Sirisë, e kishin quajtur përdorimin e armëve të zjarrit si një mënyrë joburrërore dhe jokalorsiake. Pavarësisht arsyeve të neglizhimit Safevit në këtë aspekt, është e qartë se si fillim ishte në rend të parë superioriteti osman në përdorimin e armëve të zjarrit, që i bëri ata të mundnin Safevitët në Çalldëran." "Safevid Persia" në: *The Cambridge History of Islam* (Cambridge: C.U.P. 1980), 1A, fq. 400.

Në kundërshtim me këtë, i njëjti autor është i lumtur për faktin që Irani ishte kthyer në një lloj shqetësimi në mesin e botës Sunnite muslimane: "Veprimi i parë i Ismailit pas ardhje në pushtet, ishte të shpallte mënyrën Shiite të Islamit si besimin fetar të një shteti të ri; ishte pa diskutim, veprimi më domethënës i gjithë sundimit të tij. Duke marrë këtë hap, ai nuk bëri vetëm një diferencim të qartë të shtetit të ri nga Perandoria Osmane, fuqia kryesore në botën islame në atë kohë, e cila në një situatë të kundërt mund të kishte përfshirë edhe Persinë në territoret e zotëruara prej saj, por iu kishte dhënë të varurve të vet një sens bashkësie që i lejonte krijimin e shtetit, në aspektin modern të fjalës. Që nga pushtimi

kryeqytetin e Safevitëve, ku u mbajt dhe *hutbeja* në emër të tij, më 18 Rexheb 920/8 shtator 1514. Javuz Selimi transferoi rreth një mijë njerëz të shkencës dhe të arteve nga Tebrizi në Stamboll; shumë prej tyre ishin sjellë nga Shahu Ismail, nga Horasani dhe ishin me origjinë turke. Kjo ishte një traditë që kishte filluar me Sulltan Fatihun për të sjellë në kryeqendrën e Devletit në Stamboll, njerëz të arsimuar dhe të arteve. Mes tyre ishte dhe *muezzini*⁴⁵ **Hafiz**⁴⁶ **Mehmedi** i Isfahanit dhe djali i tij, **Hasan Xhani**.⁴⁷

Javuz Selimi qëndroi disa kohë në Tebriz dhe qëllimi i tij ishte që të kalonte dimrin në Karabag,⁴⁸ për të marshuar më pas

arab në shekullin e 7-të, Persia kishte qenë më tepër një entitet gjeografik se sa politik.” (fq. 398).

Sipas R.M. Savory, ky veprim (i kalimit nga Sunnitë në Shiitë) “lejoi krijimin e shtetit në aspektin modern të fjalës”. Por, në fakt, aspekti më i rëndësishëm i termit “shtet modern” është **sekularizmi**, ndërsa kjo lëvizje, në fakt, ishte e bazuar plotësisht në një pikëpamje **religjioze**. Nga ana tjetër, përdorimi i frazës “pushtim arab”, për t’iu referuar hapjes së Persisë ndaj Islamit, është absolutisht i pavend, pasi Persia ishte pushtuar në emër të **Islamit** dhe për të.

Në lidhje me rezultatet katastrofike për botën islame të kthimit të Iranit në një fuqi Shiite shiko: M.A. Hraydi, **el Hurub’l ‘Uthmanijje-el-Farisjeh ve atharuha fi inhisari’l meddi’l Islami ‘an Urubba** (Luftërat osmano-perse dhe ndikimi i tyre në kufizimin e valës Islame nga Evropa), Kajro: 1408/1987.

Dy gabime të tjera që Savory përmend është emërtimi i entitetit politik osman si “Perandori” dhe pretendimi se territoret osmane ishin “dominione”.

- 45 *Muezzin* është personi, që thërret ezanin si dhe ndihmësi i imamit në detyra të ndryshme fetare.
- 46 *Hafiz/hafëz* është personi, që mëson përmendësh Kur’anin Fisnik, një praktikë kjo që ende vazhdon edhe në Turqinë e sotme. Pjesa më e madhe e imamëve nëpër xhami dhe disa *muezzinë* janë memorizues të të gjithë Kur’anit Fisnik.
- 47 Danişmend, II, fq. 15. Hasan Xhan është babai i Koxha Sadedin Efendisë, Shejhuislamit të mirënjohur si dhe historianit dhe autorit të **Taxhu’t Tevarih**.
- 48 Në shekullin e 20-të, armenët u vendosën nga britanikët në Karabaë dhe numri i tyre në këtë vend u shtua dhe nga rusët. Në mënyrë që t’i jepnin fjalës turke Karabağ (kopësht i errët) një kuptim negativ, rusët i shtuan edhe një fjalë tjetër: Nagorno, duke e kthyer në këtë mënyrë në Nagorno-Karabag.

një vit më vonë kundër Shah Ismailit.⁴⁹ Por, ushtarët osmanë ishin të lodhur dhe të përmalluar për vendin e tyre dhe për këtë arsye sulltani vendosi të kthehej. "... Nuk do të jepej më një mundësi për një pan-Turanizëm të tillë si në rastin kur Selimi I, fitimtari i betejës së Çalldëranit të vitit 1514, të marshonte përmes Iranit duke u bashkuar me uzbekët turkmenë kundër herezisë Shiite, për të përkrahur frontin nomad kundër kërcënimit moskovit. Por, jeniçerët nuk pranuan ta ndiqnin, kështu që Selimi u kthye kundër memlukëve. Baburi kishte nisur aventurën e tij në Indi dhe vendi islam i stepave filloi luftën e tij të gjatë dhe humbëse kundër Ruisë."⁵⁰ Sulltan Selimi e kaloi dimrin në Amasja dhe mori nga komandantët Safevitë qytetet Kemah dhe Diyarbakër në pranverën e vitit 1515. Ndërkohë, Mevsili, Urfa dhe disa pjesë të tjera të Anadollit Lindor dhe Irakut u aneksuan të gjitha nga osmanët.



Xhamia e Sulltan Selimit në Damask

49 OT, II, fq. 264-268.

50 D.E. Pitcher, *An Historical Geography of the Ottoman Empire*, Leiden: E.J. Brill, 1972, fq. 124.

Të dyja ushtritë luftuese gjatë betejës së Çalldëranit ishin kryesisht turke, por beteja nuk kishte baza racore apo kombëtare, pasi asnjëra nga këto nuk merrej në konsideratë në shekullin e 16-të. Përkundrazi, ky ishte një aspekt doktrinar sipas të cilit turqit osmanë luftuan për hir të Sunnetit, ndërsa turqit nën administrimin e Safevitëve luftuan për sundimin e Shiizmit.

Fushata kundër memlukëve

Beu i Bejlikut të Dulkadirit, Alauddevle (1479-1515), ishte në përkrahje të memlukëve dhe për këtë arsye, sulmoi disa njësi ushtarake osmane. Pas këtij sulmi, Vezir-i A'zam Sinan Pasha u dërgua kundër tij me nipin e Alauddevles, Ali Beun, djalin e Shehsuvar Beut (1515-1522). Alauddevle dhe oficerët e tij u vranë gjatë betejës, Bejliku i Dulkadirit u aneksua në territorin osman dhe **Ali Beu** u caktua guvernator i kësaj province të re.⁵¹

Sulltani memluk **Kansu Gavri** ishte i shqetësuar nga zgjerimi osman në drejtim të territorit të tij dhe për këtë arsye, kërkoi që *hutbeja* e së Xhumasë në provincën e Dulkadirit të mbahej në emër të tij. Meqenëse ky ishte një simbol i rëndësishëm i sovranitetit në praktikën islame, sulltani osman e kundërshtoi fuqimisht. Si një Sunnit i devotshëm, **Javuz Sulltan Selimi** planifikonte ta përfshinte Iranin në territorin e Devletit të tij dhe të vendoste Islamin Sunnit në këtë vend. Ai i dha udhëzime *Divan-ë Hymajunit*⁵² që të përgatiste një forcë ushtarake për këtë detyrë dhe ta pajiste mirë me ushqime dhe armatime të

51 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 376; Netajixh, I, fq. 75.

52 *Hüma* (hyma) është një shpend legjendar, që mendohej se fluturonte shumë lart. Kështu që *hümayun* (hymajun) do të thotë: që i përket Hymas, zogut që fluturon shumë lart, që i përket Qiellit, **Qiellor**. Për arsye se osmanët e shikonin veten si "përfaqësues" të "Mesazhit të Fundit Qiellor, Islamit", ata e quajtën divanin e tyre, institucionin e tyre qendror vendimmarrës, **Divan-ı Hümayun/Divan-ë Hymajun** (Divani Qiellor). Nuk është e nevojshme të theksojmë në këtë rast se është një **shtrembërim** dhe është e **papranueshme** që ky institucion të quhet "Këshill Perandorak".

mjaftueshme për një *sefer*⁵³ tre-vjeçar. Në vitin 922/1516, sulltani dërgoi një pararojë prej 40.000 luftëtarësh të komanduar nga Veziri **Sinan Pasha**, por kur ai mbërriti në Malatja, emirët e provincave nuk e lejuan atë të përparonte më tej. Pas disfatës së betejës së Çalldëranit, **Shah Ismaili** iu ishte drejtuar memlu-këve të Egjiptit, në mënyrë që të siguronte mbështetjen e tyre kundër sulltanit osman, duke pretenduar se motivi përfundimtar dhe qëllimi i këtij të fundit ishte që, pasi të merrte Iranin, të merrte edhe Egjiptin. Memlukët e Egjiptit, që në atë kohë ishin një fuqi kryesore në atë zonë, u ndikuan nga kjo propagandë dhe përdorën madje edhe fuqinë, dhe diplomacinë e tyre, për të bindur emiratet e vogla që shtriheshin përgjatë kufirit osmano-memluk, se ishte në interes të tyre që t'i ndalonin osmanët nga përparimi i tyre drejt Iranit. **Kansu Gavri**, sulltani memluk, u nis drejt Sirisë, që në atë kohë ishte nën sundimin memluk, në krye të një ushtrie të fuqishme prej 50.000 luftëtarësh. Kjo lëvizje e tij mund të ishte e zbatueshme nga një perspektivë e përbotshme, por nga ana tjetër e minoi legjitimitetin e memlu-këve si mbrojtës të Islamit Sunnit, të cilët i dhanë strehim politik në Kajro, Halifit Sunnit Abasid dhe ishin zyrtarisht mbrojtësit e Vendeve të Shenjta të Mekës, Medinës dhe Jerusalem. Tashmë, ata ishin duke mbështetur forcat Shiite të Iranit kundër kampionëve Sunnitë të fesë, osmanëve. Pasi mësoi nga Sinan Pasha, ardhjen e sulltanit memluk në Siri, sulltani osman diskutoi tërësisht situatën me Divanin e tij. Ai, gjithashtu, i dërgoi sulltanit memluk lajmëtarët në Alepo (Haleb), që t'i shpjegonin atij se osmanët kishin për qëllim purifikimin e Iranit nga

53 Osmanët e quanin fushatën e xihadit *sefer*. Ushqimet e tyre ishin *sofra* (ta'amul musafir). Është mjaft interesante të theksojmë këtu se: emri i sures së pestë në Kur'anin Fisnik është *el Maide* (shtrimi i tryezës). Turqit osmanë e quanin tryezën mbi të cilën hanin, *sofra*, për arsye se e kalonin pjesën më të madhe të kohës së tyre në *sefer*. Vetëm një periudhë prej 28 vjetësh (1740-1768), në të gjithë historinë osmane, shënohet si një periudhë gjatë së cilës nuk u zhvillua asnjë *sefer* (fushatë xihadi). Për këtë arsye, përdorimi i fjalës **sofra**, që përdoret edhe në turqishten e sotme, është **suvenir nga xihadi**.

Shiizmi, përpara se të zinte rrënjë në këtë vend. Por, memlukët i burgosën lajmëtarët osmanë të sulltanit dhe i liruan ata vetëm nën presionin që u krijua nga përparimi i *Ordu-ju Hymajun*.⁵⁴ Edhe pse **Kansu Gavri** kërkoi falje dhe i dërgoi lajmëtarët e tij **Sulltan Selimit**, ky i fundit ishte i bindur se memlukët nuk ishin të sinqertë, dhe se mund të ishin duke bashkëpunuar në fshehtësi me Iranin. Do të kishte qenë e rrezikshme, nëse *Ordu-ju Hymajun* do të kishte përparuar drejt Iranit; prapavija e ushtrisë nuk do të ishte e fuqishme dhe vendi mund të ishte ekspozuar ndaj një pushtimi të forcave memluke, ose *Ordu-ju Hymajun* mund të ishte gjendur në mes të dy forcave kundërshtare. Përderisa, Shahu Ismail nuk dukej në skenë, nuk kishte asnjë rrezik serioz nga Lindja. Për këtë arsye, ai e drejtoi ushtrinë e tij drejt Jugut dhe u ndesh në një betejë me **Kansu Gavrin** në **Merxh Dabik** pranë Alepos, në vitin 922/1516⁵⁵, ku ushtria e memlukëve pësoi disfatë, Kansu Gavri u vra dhe osmanët aneksuan kështu Biladu'sh-Shamin (Sirinë dhe Palestinën).

“Turqit hynë në territorin arab në një kohë kur ndryshime të mëdha ekonomike po ndodhnin në Lindjen e Mesme, një ndryshim i menjëhershëm, që po i kthente këto toka në vende ekonomikisht të parëndësishme dhe që në fakt, i kërcënonte ato me shkatërrim tërësor. Në vitet e para të shekullit të 16-të, baza e strukturës ekonomike arabe ishte shkatërruar dhe pasojat e këtij shkatërrimi ishin të dukshme edhe para mbërritjes së turqve në këtë vend. Deri në fillimet e shekullit të 16-të, baza e zhvillimit arab ishte tregtia nga India në Evropë, që kalonte kryesisht nëpër duart e tyre dhe që i sillte Perandorisë Memluke, ku përfshiheshin Siria dhe Hixhazi, të ardhura të mëdha nga taksat doganore. Por nga fillimi i shekullit të 16-të, rruga e tregtisë së Indisë kishte kaluar nga arabët te portugezët,

54 *Ordu-ju Hymajun*, në perceptimin osman është: **Ushtria Qiellore**, siç është shpjeguar edhe në poshtëshënimin e lartpërmendur nr. 53.

55 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 383-388; Lütfi Paşa, *vepër e cituar*, 249-250.

nëpërmjet Kepit të Shpresës së Mirë dhe rënia e sasisë së të ardhurave, pati ndikimin e saj në shumë mënyra, duke ulur dhe sasinë e përfituar nga taksat e drejtpërdrejta, që mblihdeshin nga mallrat e Indisë dhe Evropës.”⁵⁶

Në atë kohë, Devleti i memlukëve ishte i dobët dhe nuk kishte mundësi të përballej me Evropën e re të shekullit të 15-të dhe të 16-të. Ekonomia dhe tregtia e tyre pësoi tkurje, veçanërisht pas zbulimit të rrugës së re nëpërmjet Kepit të Shpresës së Mirë. Fuqitë e krishtera tashmë ishin në Oqeanin Indian, Detin e Kuq dhe Xhude, ndërsa portugezët kishin shkatërruar plotësisht flotën e memlukëve në betejën e Diut, pranë brigjeve të Indisë. I shqetësuar për të mbrojtur *el-Haramejn esh-Sherifejn* nga kërcënimi i portugezëve, Devleti Osman dërgoi 30 luftanije me 300 armë drejt Egjiptit në mbështetje të çështjes islame. Por, korsarët që u vetëquajtën Kalorës të Shën Xhonit i kapën këto ndihma. Sulltani osman, Selimi, dërgoi edhe 400 armë të tjera dhe dy tonë barut me oficerë osmanë dhe teknikë ushtarakë, për të ndërtuar luftanije në Egjipt. Pas disfatës që i shkaktoi Kansu Gavrit në Merxh Dabik, Sulltan Selimi i kishte ofruar sulltanit të ri memluk, **Tumanbej**, sundimin e padiskutueshëm të Egjiptit dhe përfundimin e armiqësisë, me kusht që memlukët të njihnin sovranitetin e osmanëve duke mbajtur *hutben* në emër të sulltanit dhe duke hedhur në qarkullim monedhën osmane, në Dhilkade 922/dhjetor të vitit 1516. Në letrën që sulltani i dërgonte **Tumanbeut**, ai shkruante se ky i fundit ishte “një skllav që kalonte në duart e ndryshme të pronarëve të tij”, ndërkohë që ai ishte pasardhës sundimtar prej 20 brezash. Nëse **Tumanbeu** do t’i paguante atij çdo vit *haraxh* për Egjiptin dhe nëse do t’i bindej sulltanit, ai do të merrte titullin *vali* i Egjiptit deri në Gaza. Në të kundërt, Javuzi do të sillej në një mënyrë shumë të ashpër ndaj tij. Pasi lexoi këtë letër, **Tumanbeu** u frikësua dhe qau.⁵⁷ Por me mbështetjen dhe nxitjen e disa

56 George William Frederic Stripling, *The Ottoman Turks and the Arabs*, 1511-1574, Filadelfia: Porcupine Press, 1977, fq. 15.

57 OT, II, fq. 287, poshtëshënimi 1.

memlukëve mendjengushtë, ai e refuzoi këtë ofertë.⁵⁸ Për arsye se “sulltani i ri memluk dhe fisnikët e Egjiptit, ishin të mendimit që aneksimi osman i Kilikjas dhe Sirisë do të ishte i përkohshëm, dhe se Javuzi nuk do të ishte i aftë të arrinte deri në Egjipt, dhe do të kthehej nga Palestina, ashtu sikurse kishin vepruar edhe forcat e Xhingiz Hanit dhe Timurit, ata shpresonin t’i rimerrnin ato toka, kur sulltani osman të kthehej në Anadoll. Në fakt, kur sulltani osman i kërkoi vezirit të tij, Junus Pashait, të marshonte drejt Egjiptit, ky i fundit iu përgjigj se kjo ishte tepër e rrezikshme. Por, Sulltan Selimi mendonte se fitorja do të ishte e përkohshme, nëse nuk do të merrnin dhe territorin ku përfshihej Egjipti dhe për këtë arsye vendosi ta aneksonte.”⁵⁹ “Historiani Ali Efendi, autori i *Kynhy'l Ahbar*, ka thënë se, kur Sulltan Selimi aneksoi Damaskun, aty ndodhej dhe një person i ditur dhe i njohur që jetonte në *i'tikaf* (i tërhequr), në tyrben e *esh Shejh el-Ekber* (Muhjiddin Arabi), që ishte i mirë në *'ilmi'xh Xhefr*. Sulltan Selimi e kishte zakon që sa herë që vizitonte tyrben e **Muhjiddin Arabiut**, të bashkëbisedonte me këtë *mu'tekif*. Një ditë Javuz Selimi e pyeti këtë njeri të njohur për përpjekjen e tij për të kaluar shkretëtirën e Egjiptit. Ky i fundit iu përgjigj se “marrja nga ana juaj e Egjiptit, është përmendur në Kur'anin e Shenjtë, prandaj drejtohu atje pa humbur kohë.” Dhe kur Selimi e pyeti se “si, dhe ku është shpjeguar kjo?”, njeriu i ditur recitoi: *Lekad Ketebna fiz Zeburi min ba'didh Dhikri ennel Erda jerithuha 'Ibadijes Salihun [el-Enbija,105]*, dhe, më pas shtoi: “kur fjala *arz* përmendet me *el (mu'arref bil lam)*, do të thotë Egjipt, dhe kur e njëjta fjalë përmendet pa *elif lam*, atëherë i referohet tokës së romakëve. Dhe vlera numerike e *ve lekad*, që përmendet në *ajet*, është 140; **vlera numerike e emrit tënd (Selim) është gjithashtu 140**. Vlera numerike e fjalës *Dhikr* është 920, që tregon datën e këtij veprimi, veçanërisht “Robërit

58 Mahmud Thabit esh-Shazuli, *el Mes'eletush Sharkijeh: diraseh vethaikijeh 'ani'l Hilafeti'l 'Uthmanijeh* (Kajro: Maktabat Wahbah, n.d.) fq. 73-74.

59 OT, II, fq. 288.

Tanë të mirë do të trashëgojnë”, do të thotë që ti je “një rob i mirë për Allahun.”⁶⁰ Mund të mendojmë në këtë mënyrë se edhe ky paralajmëtar pati ndikimin e tij në vendimin e Sulltan Selimit, përderisa në atë kohë, këto lloj njohurish shikoheshin si të pranueshme. Njerëzit dhe ngjarjet duhet të vlerësohen në lidhje me rrethanat në të cilat kanë ndodhur dhe janë zhvilluar kundrejt sfondit të tyre.

Pra, Sulltan Selimi e kaloi dimrin në Damask dhe më pas u nis drejt Egjiptit. Por nuk ishte një detyrë e lehtë të arrije deri në Egjipt. Përpara ushtrisë osmane shtrihej shkretëtira Sinai, të cilën nuk kishte guxuar ta kalonin as Aleksandri i Madh i Maqedonisë dhe as mongolët. Ndërsa Javuz Selimi hyri në shkretëtirë, e kaloi atë dhe mbërriti në Egjipt. Memlukët e prinin ushtrinë osmane në **Rejdanijeh**. **Tumanbeu** kishte mbledhur 20.000 luftëtarë, si dhe disa artiljerë që i kishte sjellë nga **Frangistani** (Evropa Perëndimore) dhe ushtarët e tij ishin të pajisur me armatura mbrojtëse.⁶¹ Topat e tyre ishin fiksuar në drejtimin e vendit nga ku pritej të mbërrinin osmanët, por **Javuz Selimi** kaloi me ushtrinë e tij rreth malit **Mukattam** dhe e kapi ushtrinë e memlukëve në befasi, dhe në një pozicion luftarak të atillë që artileria e memlukëve u kthye në të panevojshme.⁶² **Tumanbeu**, një luftëtar guximtar, u detyrua të ikte. Disa nga ushtarët e tij kishin sulmuar mbi njësitë ushtarake të **Javuz Selimit**, por ai nuk u plagos pasi kishte qenë me njësitë që kaluan rreth malit Mukattam. Beteja e Rejdanijes u zhvillua në 28 Dhilhixhxe 922/22 janar 1517 dhe një njësi ushtarake osmane ishte pozicionuar në Kajro për të mbrojtur qytetin.

60 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 427-428.

Vlera numerike e Ebxhed (xhefr) në letrat e lartpërmendura janë si vijon: vav; 6 lam; 30 kaf; 100 dal; 4 **ve lekad**; 140 sin; 60 lam; 30 ja; 10 mim; 40 **selim**; 140 dhal; 700 kaf; 20 ra; 200 dhikr; **920**. Duhet të theksojmë këtu se Selimi hyri në Egjipt në Dhulhixhxe 922/janar 1517 (pas vitit 920).

61 Feridun Beğ, *Mexhmû'a-i Mynsheat-i Selatin*, Stamboll 1274 H, vëllimi I, fq. 484-485.

62 Lütifi Paşa, *vepër e cituar*, fq. 256-257; Hoxha Sa'deddin Efendi, *Taxhu't Tevarih*, Stamboll 1862, vëllimi II, fq. 354.

Javuz Selimit i pëlqente disi trimëria e Tumanbeut dhe e gjykoi të arsyeshëm mendimin për ta caktuar atë *vali* të *ejaletit* (provincës) të ri. Ai ia bëri të ditur këtë Tumanbeut nëpërmjet një të dërguari, por ky i fundit nuk e pranoi dhe vrau të dërguarin e sulltanit.⁶³ Pak ditë më pas, Tumanbeu befasi ndërmori një sulm të ashpër dhe luftimet nëpër rrugët e Kajros zgjatën tre ditë. Edhe pse u përpoq të largohej, Tumanbeu u kap dhe u arrestua. Si përfundim, Javuz Selimi hyri fitimtar në Kajro më 23 Muharrem 923/15 shkurt 1517.⁶⁴ Menjëherë, **Javuz Selimi** e fali namazin e së Xhumasë në **Xhaminë e Melik Muejjetit** dhe kur *hatibi* përmendi emrin e tij gjatë *hutbesë* si: "*Hadimu'l Haramejn esh-Sherifejn*", duke shtruar *sixhaden* (qilimin e faljes) e tij, ai ra me fytyrë përtokë dhe qau nga gëzimi.⁶⁵

Javuz Selimi dëshironte ta caktonte Tumanbeun si *vali* të provincës së re osmane, por ky i fundit nuk pranoi, pasi ishte kokëfortë dhe i vështirë për t'u kënaqur me titujt. Në këtë mënyrë, ai iu dorëzua Ali Beut, djalit të Shehsuvar Beut dhe në përfundim Tumanbeu u dënua me varje në Babuz Zuvejleh, në vendin ku më parë ishte ekzekutuar Shehsuvar Beu nga memlukët.⁶⁶ Trupi i tij mbeti i varur në litar për tre ditë, për t'i bindur njerëzit se ai kishte vdekur dhe varrimi i tij ishte i denjë për një sundimtar. Javuz Selimi mori pjesë në *salatul xhenazen* e tij dhe shpërndau një sasi të madhe parash për shpirt të Tumanbeut.⁶⁷

Duke qenë një Devlet musliman i devotshëm dhe i përkushtuar për të zbatuar Ligjin e Islamit (Sheriatin) në çdo

63 Lütfi Paşa, *vepër e cituar*, fq. 264.

64 Solakzade, *Tarih*, (Stamboll:1279), fq. 400; Danişmend, vëllimi II, fq. 32-36. Historiani dhe kadiaskeri osman (më pas Shejhulislam) **Shemsuddin Ahmed** Ibn Kemal datoi: **Fatihü Memalikil 'Arab** (923); OT, II, fq. 290, poshtë-shënimi 1. Aktualisht: fa 80, elif 1, te 400, ha 8, mim 40, mim 40, elif 1, lam 30, kaf 20, elif 1, lam 30, 'ayn 70, ra 200, ba 2 : **923**.

65 Münejjimbaşı, *Sahaifu'l Ahbar*, III, fq. 567; OT, II, fq. 290, poshtëshënimi 1; *Netajixh*, I, fq. 78.

66 *Netajixh*, I, fq. 78.

67 OT, II, fq. 292.

aspekt të jetës, osmanëve iu duhej një *fetva* për t'u angazhuar në këtë luftë kundër memlukëve. Në këtë rast, u bënë dy *fetva* nga të cilat njëra ishte e bazuar mbi parimin e mirënjohur musliman: “*Men e’ana mulhiden fe-huve mulhid*” (ai që ndihmon një jobesimtar është edhe vetë jobesimtar), duke iu referuar në këtë mënyrë mbështetjes indirekte të memlukëve ndaj Shahut Ismail. Parimi i dytë bazohet në mendimin që “muslimanët duhet të shikojnë që monedha e tyre, në të cilën shkruhet *kelimetu’sh shehadet*, nuk duhet të përdoret nga jobesimtarët, pasi ata mund ta prekin këtë *kelime* të shenjtë me duart e tyre të pista pasi kanë dalë nga tualeti. Por nëse këta muslimanë nuk e vëzhgojnë dhe nuk e zbatojnë rreptësisht këtë udhëzim, atëherë bëhet domosdoshmëri që të vriten.”⁶⁸

Javuz Selimi organizoi administrimin e Egjiptit. **Ebu’l Berekat ibn Muhammed el-Hasani**, Sherifi i Mekës dhe i Medinës, dërgoi djalin e tij me çelësat e këtyre vendeve të shenjta për Javuz Selimin, në mënyrë që të siguronte besnikërinë dhe përuljen e tij ndaj sultanit. Nga ana e tij, Javuzi i konfirmoi Sherifit pozicionin që kishte dhe i dërgoi atij *Syrre* (para dhe dhurata) për popullin e Mekës dhe Medinës. Gjithashtu, ai emëroi dy kadinj të famshëm në **el-Haramejn esh-Sherifejn** dhe së bashku me ta dërgoi 200.000 dukate (monedha floriri), që do të shpërndareshin për njerëzit e varfër.⁶⁹

Në këtë mënyrë Hixhazi (Arabia) iu bashkua me vullnetin e saj, pa asnjë diskutim, superfuqisë muslimane dhe komandantët memlukë, që në atë kohë komandonin në disa pjesë të Jemenit, bënë të njëjtën gjë. Në atë kohë, Deti i Kuq ishte kthyer pothuajse në një liqen osman, që përdorej nga Devleti Osman për të kontrolluar veprimtarinë e portugezëve, si dhe për të

68 Koxha Nishanxhë, *vepër e cituar*, 143 a.

69 Hoxha Sa’deddin, *Taxhu’t Tevarih*, Stamboll 1279, II, fq. 371-379; Netajixh, I, fq. 82.

bllokuar përpjekjet e tyre për të formuar me abisinianët një front të krishterë kundër fuqive fqinje muslimane arabe.⁷⁰


Sherifi Ebu Numej, djali i Sherifit Ebu'l Berekat, qëndroi një muaj në Kajro dhe u kthye me *beratin* e konfirmimit të këtij të fundit në postin e tij. Çdo vit, Devleti Osman i dërgonte njësi ushtarake në rotacion, nga 7 *oxhakë* që ishin stacionuar në Egjipt, për të mbrojtur Mekën dhe Medinën. Dhe në rastet kur ishte e nevojshme, ata dërgonin disa njësi ushtarake edhe në Siri. Sherifi i Mekës kishte qasje në Thesarin e Egjiptit dhe në të ardhurat nga taksa kufitare e Xhiddes (Arabia Perëndimore). Shuma e parave që vinte nga Egjipti, quhej "*atijje hymajun*" dhe si plotësim, Sherifi merrte monedha floriri nëpërmjet *syrre-i hymajun*. Pas vdekjes së babait të tij në vitin 941/1525, **Sherifi Ebu Numej** u caktua si Emir i Mekës në moshën 25-veçare. Në vitin 948/1542, portugezët hynë papritur në zonën e Detit të Kuq dhe vendosën ushtarët e tyre në Xhidde, duke u përpjekur të pushtonin kështjellën. Sanxhakbeu i Xhiddes rezistoi me trimëri dhe Sherifi Ebu Numej mbërriti në fushën e betejës së bashku me nomadët, që kishte arritur të mblidhte për të luftuar. Ata i zbrapsën forcat portugeze dhe Sherifi Ebu Numej u shpërblye duke marrë gjysmën e të ardhurave të mbledhura nga taksat doganore të Xhiddes, praktikë kjo që u ndoq edhe për pasardhësit e tij.⁷¹

Republika e Venedikut, që kishte ishullin e Qipros në zotërimin e saj dhe iu paguanin memlukëve *haraxh*, filluan t'i paguanin këtë tagër Devletit Osman, pas aneksimit të Egjiptit nga ky i fundit.⁷²

70 Abdu'l Aziz Muhammed esh-Shinavi, *ed Devleh el-'Uthmanijeh, devleh islamijeh mufteren 'alejha*, (Kajro: 1980), vëllimi I, fq. 20-21."

71 OT, II, fq. 426-427.

72 Danişmend, II, fq. 45. Venedikasit dërguan **Kontarinin** dhe **Moçenigon** në Kajro, për të deklaruar se do t'i paguanin Devletit Osman 8.000 dukate në vit, shumë kjo që më parë iu paguhej memlukëve kur ata sundonin Egjiptin dhe Sirinë. OT, II, fq.292-293.



Emanat-ë Mukaddeseh në Pallatin Topkapu: Shpatat e Resulullahut

Hilafeti Osman

Sipas një *hadithi sherif, ummeti* (bashkësia) musliman duhet të ketë një Halif.⁷³ Për këtë arsye, është mjaft e natyrshme që *cilido* Devlet Musliman *i fuqishëm* të ketë Hilafetin dhe të përfaqësojë Islamin. Edhe osmanët duket se kanë pasur të njëjtin mendim, si një superfuqi muslimane në Evropë, në zemrën e krishterimit, dhe si fuqia *e vetme* që zbaton detyrën e *xhi-hadit*; ata ishin *përfaqësues* të Islamit dhe kreu i Devletit të tyre ishte Halifi. Ky fakt ilustron në mënyrë të qartë edhe në letyrën që Murad Hydavendigari (1362-1389) i dërgon Beut të Karamanit, me datë 1 Rebiuth-Thani 767/16 dhjetor 1365, në të cilën i referohet kryeqytetit të tij si **daru'l-hilafe** (Selia e Hilafetit).⁷⁴ Në të vërtetë, Devleti Osman e ka përfaqësuar Hilafetin që nga periudha e Murad Hydavendigarit. Për shembull, me rastin e hapjes së Edrenesë ndaj Islamit, **Xhanëbek Hani** i Kok (Kök) Ordas (Hordhisë së Artë), iu drejtua Murad Hydavendigarit si

73 El-Muslim, *el Xhami'u's Sahih, Kitabu'l Imareh*, 58.

74 *Münsheat*, I, fq. 90, rreshti 31.

“Sulltanul Guzat vel Muxhahidin, *Zil-lullah*”, dhe duke iu referuar Edrenesë si “*Edirne mekarr-ë Hilafet*”.⁷⁵ Isfendijar Beu i Kastamonus iu drejtua gjithashtu Murad Hydavendigarit si “*Hazret-i Hilafet-menkabet*”.⁷⁶ **Jëlldërëm Bajezidi**, djali i tij u quajt në vitin 793/1391 nga sulltani i Egjiptit, që strehoi Halifin Abasid në “hije” në vendin e tij, si “*zil-lullah*” (Hija e Allahut, një titull që i jepej Halifit).⁷⁷ Kur Devleti Osman iu shkaktoi disfatë në betejën e Nigbollusë (Nikopolit) forcave të bashkuara evropiane të krishtera në vitin 798/1396, kreu i Devletit, **Jëlldërëm Bajezidi** u bë **de facto** kreu **më i lartë** i muslimanëve – Halif. Është interesante të theksojmë në këtë rast se ai ndërtoi **Ullu Xhaminë**⁷⁸ në Bursa, duke shpenzuar në këtë mënyrë *ganimetin* (plaçkën e luftës) të përfituar nga ushtria e Kryqëzatës në Nigbollu. Me hapjen e Kostandinopojës ndaj Islamit në vitin 1453, që i dha fund plotësisht Perandorisë Romake, Devleti Osman u kthye në superfuqinë e kohës dhe sulltani i tij ishte Halifi aktual i muslimanëve. Halifi i emëruar Abasid në Kajro nuk ishte tjetër veçse një figurë apo një kukull në duart e sundimtarëve memlukë të Kirkazit. Historiani osman, **Ibn Kemali** e përmend **Fatih Sulltan Mehemedin** si **Halif**.⁷⁹ Djali i Fatihut, **Bajezidi II** u adresua nga Padishahu i Horasanit, **Husejn Bejkara**, si “Halifet Allah fi’l enam, Hafizu thuguri’l Islam” (Halifi i Allahut mes Krijesave të Tij, Mbrojtësi i kufijve të Islamit), si dhe “el-Mu’ejjedd bi ta’jidi’l-lah, el-Meliku’l Mexhid, mu’ejjenen li’s Sulltanati ve’l Hilafeti” (i mbështetur nga Allahu, Sovrani i Lavdishëm, i caktuar nga Allahu për Sulltanatin dhe Hilafetin).⁸⁰ Në të njëjtën mënyrë, **Jakub Shahu**,

75 *Münsheat*, I, fq. 96, rreshti 27; dhe fq. 97 rreshti 8.

76 *Münsheat*, I, fq. 97, rreshti i fundit.

77 *Münsheat*, I, fq. 116.

78 Ullu Xhami është Xhamia e Madhe ku bëhet Falja e së Xhumasë. Hutbeja në të cilën përmendet emri i sovranit, mbahet gjatë namazit të së Xhumasë.

79 Ibn Kemal, *Tevarih-i Al-i Osman*, vëllimi VII, fq. 194, 296.

80 *Münsheat*, I, fq. 306, reshtat 25, 28.

në korrespondencën zyrtare, i referohej Bajezidit II si Halif.⁸¹ Pas vdekjes së këtij të parit, Bajezidi II i dërgoi një letër ngushëllimi djalit të tij, **Bajungur Mirza**, i cili në kthimin e përgjigjes së tij, iu referua Bajezidit II si sulltan dhe halif.⁸² Gjithashtu, në disa raste të tjera, Devleti Musliman Sunnit në Iran⁸³ dhe fisnikët e Devletit Akkojunllu iu referuan atij në të njëjtën mënyrë.⁸⁴ Edhe **Shah Ismaili**, që e kaloi Devletin Akkojunllu Sunnit të Iranit në një Devlet Shiit,⁸⁵ dhe **Shejhu'l Islami i Heratit**, Ahmed Taftezani⁸⁶ iu drejtuan Bajezidit II në të njëjtën mënyrë. Pasardhësi i tij, Javuz Selimi ishte i vetëdijshëm për pozitën e tij si Halif dhe u adresua si i tillë nga **'Ubejd Hani** i Samerkandit në vitin 929/1514,⁸⁷ para se të merrte Egjiptin. **Javuz Selimi** vazhdoi ta përdorte këtë titull edhe në korrespondencat me **Shah Ismailin**, përpara betejës së Çalldëranit,⁸⁸ si dhe pas marrjes së Egjiptit në vitin 923/1517. **Hutbeja e Hilafetit** në emër të tij u mbajt në Kajro.⁸⁹ **Me përfshirjen me dëshirë të Hixhazit në Devletin Osman**, arritja e krijimit të një bashkimi islam në territorin qendror musliman ishte plotësuar, duke kombinuar të gjitha aspektet shpirtërore, historike, tradicionale dhe funksionale të *ummetit*. Djali të Selimit, Sylejmanit të Madhërishtëm iu referuan me të njëjtin titull.⁹⁰ Faktikisht, Hilafeti vazhdoi të përfaqësohej nga sulltanët osmanë⁹¹ deri në

81 *Münsheat*, I, fq. 307.

82 *Münsheat*, I, fq. 326.

83 *Münsheat*, I, fq. 327.

84 Po aty, I, fq. 330.

85 Po aty, I, fq. 345-346.

86 Po aty, I, fq. 365.

87 Po aty, I, fq. 375-377.

88 Po aty, I, fq. 379.

89 Keşfi Mehmed Çelebi, *Keşfi'nin Selim-Namesi*, (botuar nga Şefaaettin Severcan), Kajseri 1995, fq. 189.

90 *Münsheat*, I, fq. 500, 515, 519.

91 Për shembull, kur Sulltani osman, Genç Osman (1618-622) u rrëzua nga fronti dhe u strehua te jeniçerët në vitin 1622, ata thirrën njëzëri: "Ne nuk të pranojmë si **Halif**, por ne nuk pranojmë as ekzekutimin tënd." (Na'ima, *Tarih*, II, fq. 227); pas ardhjes në fron të Sulltanit osman Mehmedit IV, në vitin 1648, sundimtari i **Marokut** iu drejtua atij me togfjalëshin **Hija e**

fund të Devletit Osman, si dhe pas një periudhe të caktuar gjatë Republikës së Turqisë, derisa u shfuqizua nga Asambleja e Madhe Kombëtare e Turqisë, më 3 mars 1924.

Hajri Beu, guvernatori i Alepos nën sundimin e memlukëve, që nuk bëri qëndresë kundër osmanëve, u shpërblye duke u emëruar si *vali* i Egjiptit Osman. **Javuz Selimi** u rikthye në Damask, ku ndërtoi një tyrbe, në vendin ku ishte varrosur Sufiu i Madh **Muhjiddin ibnul Arabi**, si dhe ndërtoi aty pranë një xhami dhe një *imaret*. Ai mori pjesë në Faljen e parë të së Xhumasë që u bë në atë xhami dhe caktoi të ardhurat e një *vakëfi*, që do të shkonin për ndihmën e këtyre institucioneve të bamirësisë.⁹²

Palestina mbeti një territor osman deri në fillim të Luftës së Parë Botërore. Gjatë kësaj periudhe shumëvjeçare, atje nuk pati asnjë trazirë në radhët e popullsisë, për shkak të drejtësisë së praktikuar nga Devleti Osman. Është interesante të theksojmë në këtë rast se, ish-Kryeministri i Izraelit **Ehud Barak** i tha ish-Presidentit të Turqisë, Sylejman Demirelit: “Një tetar osman, e qeveriste me qetësi këtë vend me 20 ushtarët e tij; tani, ne jemi në vështirësi ta qeverisim me një ushtri!”⁹³ Kjo shpjegon qëndrimin e mbajtur nga osmanët ndaj popullsisë së qeverisur, *ra’ijjetit*, si dhe pikëpamjen dhe praktikën e osmanëve.

Klasa qeverisëse në territorin e memlukëve ishte kirkaziane dhe jo arabe. Por, sovraniteti në Egjipt dhe Biladu’sh-Sham vetëm kishte kaluar nga një strukturë qeverisëse muslimane, në një strukturë tjetër më të fuqishme të Devletit Musliman. Në atë kohë, në territorin osman përfshihej edhe Nubia, dhe kufiri i saj arrinte deri në Savakin. Duke qenë se kishte marrë Hilafetin

Allahut mbi Krijesat e Tij, që është epiteti i **Halifit**, si dhe valvitës i flamujve të Sheriatit në fushat e drejtësisë. (BOA, NMD 7, fq. 246-247). Edhe Sundimtari i **Hokandës** iu adresua në vitin 1263/1846-47 **Sulltanit osman ‘Abdulmexhid** (1839-1861) si Halif (Zil-lu’s Subhan) (BOA, NMD 12, fq. 56.)

92 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 412; OT, II, fq. 295.

93 Gazeta *Hürriyet*, 30 Mars 2001; Gazeta *Akit*, 31 Mars 2001.

nga i quajhuri “Halif Abasid”⁹⁴ në Egjipt, Javuz Sulltan Selimi i dha vetes titullin *Hadimu’l Haramejni’sh-Sherifejn* (Shërbëtori i dy vendeve të Shenjta e të Nderuara).

Ndërkohë që ishte gjatë rrugës së tij të kthimit nga Egjipti, në krye të *Ordu-ju Hymajun*, Javuz Sulltan Selimi kërkoi që të bashkëbisedonte me Kadiaskerin e Anadollit, **Shemsuddin Ahmed ibn Kemalini**; po kur ata po kalëronin duke biseduar, kali i Kemalit kaloi mbi një pellg dhe e spërkati duke e mbuluar *kaftanin* (pelerinën) e Sulltan Selimit me baltë. Natyrisht, Kadiaskerit i erdhi shumë keq për këtë ndodhi, por Sulltan Selimi pasi hoqi *kaftanin* e tij tha: “**është një nder për mua, balta që u spërkat nga këmbët e kalit të një ‘alimi** (dijetari musliman); **le të shtrohet ky kaftan mbi sëndukun tim** (sarkofagun) **kur të vdes.** Dhe në të vërtetë ai *kaftan* u shtrua mbi sëndukun e tij në përputhje me dëshirën që pati.”⁹⁵

Ky aneksim i sulltanatit memluk ishte një sukses i madh për osmanët. Populli i Stambollit ishte përgatitur ta priste sulltanin me kremtime të mëdha. Por duke qenë një besimtar Sunnit i devotshëm, që aderonte etikën e Islamit, **Javuz Selimi** hyri në qytet nëpërmjet rrugës detare në qetësi gjatë natës dhe populli do ta mësonte mbërritjen e tij vetëm mëngjesin e ditës së nesërme. Veprimi i tij na kujton atë të Profetit të Shenjtë (s.a.v.s.), në kohën kur qyteti i Mekës u hap ndaj Islamit, kur ai u përkul aq shumë, sa që mjekra gati i prekte shalën e devesë së

94 Halifi i emëruar **Mutevekkil ‘Alallah** u strehua tek Sulltan Selimi, pas betejës së Merxh Dabikut. Pra, babai i tij, Halifi i mëparshëm **Mustemsik Bil-lah**, u caktua Halif si përfaqësues i të birit në Egjipt. Kur Javuz Sulltan Selimi e mori Kajron, ai e vendosi dhe e emëroi **Mutevekkilin**, të cilin e kishte sjellë me vete, në këtë post. Pas transferimit në Stamboll, **Mutevekkilit** ia hoqën favoret që kishte fituar, për shkak se kushërinjtë u ankuan për një sjellje joetike të tij dhe ai u burgos në vitin 925/1520. Pas vdekjes së Javuz Selimit, Sylejmani i Madhërishtëm e lejoi atë dhe disa të tjerë, që të ktheheshin në Kajro. Më pas, ai vdiq në këtë vend: OT, II, fq. 293-294.

95 Danişmend, II, fq. 45.

tij. Të jesh modest dhe jo arrogant, dhe i pasjellshëm, kur ke arritur një sukses apo një fitore, është një vlerë bazë e Islamit.

Javuz Sulltan Selimi futi praktikën e recitimit të Kur'anit Fisnik pandërprerë nëpër hapësirat e *Emanat-ë Mukaddese* (Reliktet e shenjta), të cilat i ndërtoi në Pallatin Topkapu në Stamboll. Ai caktoi 40 *hafizë* (memorizues të Kur'anit Fisnik) për këtë detyrë dhe merrte pjesë në seancat e leximit të Kur'anit. Kjo praktikë vazhdoi deri në rënien e Devletit Osman.

Çështjet detare

Javuz Sulltan Selimi nuk nënvlerësonte rëndësinë e lundrimet detar. Ndërkohë që ishte në Egjipt, ai priti **Selman Reisin**, komandantin e flotës në Detin e Kuq, gjatë Devletit Memluk. Më pas ai mori urdhrin për t'u nisur drejt Stambollit. Pasi u kthye nga Egjipti, Javuz Sulltan Selimi ndërtoi një kantier detar në Haliç (Briri i Artë) dhe urdhëroi ndërtimin e 150 anijeve të reja, ndërkohë që 150 anije ishin tashmë pjesë e flotës së tyre. Republikën e Venedikut e zuri paniku nga ky veprim dhe vazhdoi të paguante rregullisht haraxhin për ishullin e Qipros. Venedikasit e fortifikuan atë, si masë paraprake dhe filluan të kërkonin aleatë në Evropë. Nga ana tjetër, **Papa Leoni X** ishte angazhuar në përgatitjen e një Kryqëzate të re kundër Devletit Osman; ai dërgoi kardinalët e tij në Austri, Francë, Angli dhe Spanjë që të krijonte me ndihmën e këtyre vendeve një aleancë kundër osmanëve. Javuz Selimi krijoi kushtet që Spanja t'i shmangej kësaj aleance, duke i treguar ambasadorit të saj, që erdhi në Stamboll në vitin 1519, për kushtet e vizitorëve të krishterë në **Kishën Kamame**, në Jerusalem. Nëse Mbreti i Spanjës dëshironte të lidhte një traktat paqeje me të, duhej që ai të dërgonte delegatin e tij.⁹⁶

Aneksimi i Krimesë

Në vitin 880/1475, Devleti Osman mori disa zona bregdetare dhe qytetin Kefe nga gjenovasit, që i kishin vendosur dhe kolonitë e tyre në këtë vend. **Mengli Gëraj** ishte emëruar **Han** nga Fatih Sulltan Mehemmedi (1451-1481), me kërkesë të fisnikëve dhe të *ulemasë* së Krimesë. Javuz Sulltan Selimi pa një rival të fortë në këtë *Hanat* verior turk, pasi "kalorësve të tij iu duhej një ditë të përshkonin një largësi, që kalorësisë osmane do t'i duheshin 5 a 6 ditë, ndërkohë që kuajt e tyre nuk kishin nevojë për patkonj dhe ushtarët e Krimesë kalonin lumenj të rrëmbyer, duke notuar së bashku me kuajt e tyre; ushtarakët osmanë do të kërkonin një urë apo një varkë, që të kalonin përtej, ushtarët e Krimesë jetonin me një sasi të kufizuar ushqimesh, etj..."⁹⁷

Si një diplomat i mirë, **Javuz Selimi** i dërgoi Hanit të Krimesë, **Mengli Gërajit**, 20.000 akçe dhe secilit prej fisnikëve nga 300 akçe si rrogë, duke i kërkuar ngritjen e flamurit osman, dhe djali i Mengli Gërajit, **Sa'adet Gëraj**, të dërgohej në oborrin osman për t'iu arsimuar (në fakt si peng). Fisnikët nuk e pranuan këtë ofertë, por Mengli Gëraji (1478-1514), që ishte Han për të tretën herë, e pranoi propozimin e Sulltanit, duke u thënë: "Sulltani, e di që djali im, Sa'adet Gëraji, është shumë i rëndësishëm për mua, ndaj kërkon që ta edukojë atë në mënyrë që ai të jetë i aftë dhe i dobishëm për Krimenë pas meje, ... nëse ne nuk e pranojmë një propozim të tillë, ai do të niset kundër nesh me ushtri të madhe, me artileri dhe armë zjarri etj..." Pra, në këtë mënyrë, Krimea hyri së bashku me pjesë të tjera të mbetura nën zotërimin osman.⁹⁸ Në atë kohë, Krimea ishte aq e fuqishme, sa mund t'i rezistonte përparimit pushtues të Rusisë drejt Jugut, edhe pse më pas ishte Rusia ajo që u kthye në një forcë më të fuqishme, duke pasur si mbështetje edhe fuqitë e krishtera evropiane. Në këtë mënyrë, për dy shekuj e gjysmë,

97 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 428.

98 Po aty, fq. 429.

ky aneksim e mbrojti Krimenë ndaj gllabërimit të Rusisë. Duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit të 16-të, Rusia pushtoi të gjitha *hanatet* që ishin krijuar nga trashëgimtarët e Kök Ordas (Hordhisë së Artë), si fillim Hanatin e Kazanit në vitin 1552 dhe më pas të tjerat.⁹⁹

Kalorësit e Shën Xhonit (Kalorësit ndihmëtarë)

Hazreti Ademi është njeriu i parë dhe njëkohësisht edhe Profeti i Parë. Përgjatë gjithë historisë, Profetët iu dërgoheshin popujve për t'iu bërë thirrje atyre që të jetonin sipas rregullave të përcaktuara nga Krijuesi. Në Kur'anin Fisnik, Ligjet e Natyrës quhen **sunnetullah** (mënyra e drejtimit të çështjeve nga Allahu). Islam do të thotë "nënshtrim" (ndaj urdhrave të Allahut, Krijuesit) dhe kushdo që i pranon këto parime është një "musliman" (i nënshtruar i vullnetit të Allahut, Krijuesit). Për këtë arsye, sipas Islamit, **të gjithë Profetët**, duke filluar nga Ademi dhe duke përfshirë Nuhun (Noen), Ibrahimin (Abrahamin), Ejjubin (Jovin), Jakubin (Jakobin), Jusufin (Jozefin), Shuajbin, Musain (Mojsiun), Davudin (Davidin), Sulejmanin (Solomonin), Junusin (Jonah), Zekirijain (Zakarinë), Jahjanë (Gjonin), Isain (Jezusin) (Paqja qoftë me ta), iu dërguan në kohëra të ndryshme popujve, për t'i drejtuar ata në Rrugën e Drejtë, dhe **ata janë të gjithë muslimanë**. Edhe Pejgamberi i

99 Kök Orda (Hordhia e Artë; Zolotaja Orda) u themelua nga nipi i **Xhingis Hanit, Batu Hani** (v.1255-56). Popullsia, që jetonte në këtë Hanat ishte kryesisht e përbërë nga pasardhësit e kökturqëve, hunëve dhe bullgarëve, turqve Këpçakë. Ndërsa, Hani, komandantët dhe fisnikët që e rrethonin ishin me origjinë tatare (mongole). Për shkak se popullsia turke ishte në maxhorancë, tatarët (mongolë) u turqizuan, ashtu sikurse tregon dhe emiri i Hanit të tyre të fundit **Toktamëshi**. Kur Emir Timuri mundi Hanin Toktamësh që ishte duke u përgatitur për një fushatë lufte në Lituani në vitin 1396, Kök Orda u shkatërrua dhe nga kjo u krijuan 4 hanate në këtë territor: Kazani, Kërëmi (Krimea), Astrahani dhe Kasëmi (Sibir). Shkatërrimi i Kök Ordas u dha sllavëve (russëve), që ishin nën zotërimin e tij, një mundësi të artë për t'u zhvilluar dhe me kalimin e kohës, ata i shkatërruan të gjitha këto hanate turke.

Fundit, Muhammedi (Paqja qoftë me të), **iu dërgua gjithë njerëzimit** për t'i treguar Krugën e Drejtë dhe t'i bënte thirrje ta ndiqnin atë. Edhe Kur'ani i drejtohet **gjithë** njerëzimit. Dhe ai që thotë: “Nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe Muhammedi është i Dërguari i Tij”, bëhet musliman sipas përkufizimit.

Ajo që quhet “krishterim”, është shtrembëruar nga gjeneratat e mëvonshme: gjuha e folur nga Jezusi (Paqja qoftë me të) ishte **aramaïke**. Nuk ka asnjë ungjill në gjuhën aramaïke; ungjijtë më të hershëm janë shkruar në gjuhën hebraïke, greqishten e lashtë dhe në latinisht. Për më tepër, shtrembërimi dhe plotësimi ishte kaq i rëndomtë, sa që numri i librave të cilat u quajtën “ungjij” arriti deri në 72. Në vitin **325** në **Nike**, këshilli i 319 “etërve” pranoi vetëm 4 prej tyre: **sipas** Mateut, **sipas** Markut, **sipas** Lukës, **sipas** Juhanas (Gjonit), për të mos përmendur këtu letrat që u shkruajtën nga dishepujt.

Ata që ndoqën fazën e parë dhanë mesazhin e shtrembëruar dhe u vetëquajtën “të krishterë”, dhe duke injoruar, dhe duke mos pranuar Mesazhin e Fundit u përpoqën të luftonin kundër tij ndër shekuj. **Kjo ishte pika më tragjike në historinë e njerëzimit, veçanërisht për kohët moderne: “pavarësisht” krishterimit, qytetërimet perëndimore u krijuan pas periudhës së Rilindjes (që nuk ka të bëjë me krishterimin) dhe Reformimit (një lëvizje që u ngrit kundër autoritetit të kishës), dhe perëndimorët mashtrojnë veten, dhe përpiqen të mashtrojnë dhe të tjerët duke e quajtur këtë një civilizim “të krishterë”, duke mos lejuar në këtë mënyrë krijimin e qetësisë shpirtërore të njerëzimit. Dilema e botës perëndimore dhe ndikimi që ushtron te popujt e tjerë është se, ekziston një lulëzim i madh material dhe një entitet i vogël shpirtëror që i skicon ngjarjet, politikën, çështjet shoqërore etj., pa i zgjidhur problemet “njerëzore”; qenia njerëzore është e “humbur” në civilizimin bashkëkohor!**

Duke qenë tërësisht me tru të shpëlarë nga priftërinjtë e këtij “mesazhi të shtrembëruar paraprak” dhe duke paragjy-

kuar fazën e re, dhe përfundimtare të Mesazhit, gjatë fushatave të Kryqëzatave, evropianët pushtuan Jerusalem dhe disa pjesë të Biladu'sh-Shamit (Sirisë). Kur **Salahu'd Din el-Ejjubi** (Saladini) i rihapi më pas këto zona ndaj Mesazhit të Fundit Hyjnor, Islamit, Kryqtarët u vendosën në ishullin e Rodosit. Djem të rinj që vinin nga çdo anë e Evropës, hynë në radhët e urdhrit ushtarako-religjioz të Shën Xhonit, dhe kjo hordhi fanatike, fundamentaliste dhe mendjeshkurtër u quajt Urdhri i Kalorësve të Shën Xhonit. Si plaçkitës të stërvitur jashtëzakonisht mirë, ata sulmonin anijet dhe tokat e muslimanëve nga baza e tyre në ishullin e Rodosit. Kur **Javuz Sulltan Selimi** bëri të ditur qëllimin e tij për të risulmuar Iranin, në mënyrë që të shfaroste një herë e përgjithmonë nga ky vend shiitët, *ulemaja* i kujtuan atij se “do të ishte më mirë të hapte një fshat të krisherë dhe të drejtonte popullsinë e tij ndaj Islamit, sesa të përpiqej të merrte një vend kaq të madh”. Edhe administrata e nxiti Sulltan Selimin të hapte ishullin e Rodosit ndaj Islamit, por ai iu përgjigj: **“Unë dëshiroj të hap sa më shumë vende ndaj Islamit, ndërsa juve dëshironi që unë të kap disa çerdhe hajdutësh.”**¹⁰⁰ Pra, prijësi musliman i shikonte këta njerëz që vetëquheshin “Kalorës të Shën Xhonit” vetëm si hajdutë plaçkitës.

Vdekja e Sulltan Selimit

Në korrik të vitit 1520, Javuz Selimi u nis drejt Edrenesë, por gjatë rrugës ai u sëmur rëndë. Ndërsa ishte në shtratin e vdekjes, ai i kërkoi **Hasan Xhanit** t'i lexonte vargje nga sureja *Ja Sin*. Ata të dy filluan të recitonin të njëjtën sure dhe kur arritën në *ajetin* “*selamun kavlen min Rabbil Rahim*” (“Paqe!” do të jetë fjala prej Zotit Mëshirëplotë!) [*Ja Sin*: 58], Javuz Selimi ndërroi jetë në qetësi në 926/Shtator 1520.¹⁰¹

100 Netajixh, I, fq. 80.

101 Solakzade, *Tarih*, fq. 421.



Hartë e territorit osman gjatë sundimit të Javuz Sulltan Selimit

Synimi i pushtimeve evropiane të mëhershme në Lindje ishte të zhdukte muslimanët në bashkëpunim me mongolët. Por këtë herë, drejtuesit e Indisë e kishin përqafuar Islamin dhe evropianët ishin gjithnjë e më shumë të interesuar për tregtinë e erëzave. Në këtë mënyrë, faktori tregtar mbizotëroi mbi faktorin fetar në lëvizjen e evropianëve drejt Oqeanit Indian dhe Lindjes së Largët. “Ndikimi i tregtisë së portugezëve në Lindje vazhdoi edhe pas vdekjes së Albakerkit (Albuquerque), por monopoli portugez i tregtisë në Lindje u thye nga konkurruesit holandezë dhe anglezë, interesat tregtare të të cilëve nuk i shpëtuan motivit kryqtar.”¹⁰²

Javuz Sulltan Selimi, nga ana tjetër, dëshironte të shkonte në Indi, por jo për arsye të tilla tregtie. Ai kishte mendimin se

102 Abbas Hamdani, *vepër e cituar*, fq. 327.

kapja e stërgjyshit të tij si rob nga Emir Timuri, qëndronte si një njollë “mbi dinastinë tonë”, që mund të hiqej vetëm me anë të pushtimit të Indisë, që në atë kohë drejtohej nga nipërit e Emir Timurit. Veziri i tij i Madh e këshilloi të mos përpiquej të merrte një vend kaq të largët, duke i argumentuar se kishte kaluar më shumë se një shekull që nga ajo ngjarje dhe se Devleti Osman e kishte pastruar plotësisht këtë njollë, nëpërmjet suksesit të tij të madh të arritur me hapjen e territoreve të gjera ndaj Islamit. Por, Javuzi iu përgjigj se ai dëshironte të shkonte në Indi nëpërmjet një kanali tek el-Suvejsh (Suez), që do të lidhte në këtë mënyrë Mesdheun me Detin e Kuq dhe Oqeanin Indian.¹⁰³

103 Netajxh, I, fq. 81. Është e rëndësishme të theksojmë se **historianët dhe studiuesit perëndimorë i janë referuar gjithmonë Devletit Turk të pasardhësve të Timurit në Indi, me emrin Mughal (Mogul).**

KAPITULLI 7

SUPERFUQIA BOTËRORE

7.1 Kanuni Sulltan Sylejmani (i Madhërishëm) 1520-1566

Shehzade Sylejmani u thirr nga Manisa në Stamboll për t'u bërë sulltan osman. Por, guvernatori i Biladu'sh-Shamit (Sirisë), **Xhanberdi Gazali**,¹⁰⁴ përfitoi nga ky transferim pushteti, për të rigjallëruar Devletin Memluk. Ai u vetëshpall sundimtar me titullin **Melik Eshref** (mbreti më i nderuar), mbajti *hutben* në emrin e tij dhe fabrikoi monedhën *sikke*. Ai iu dërgoi **Shah Ismailit** dhe guvernatorit të Egjiptit, **Hajri Beut**, lajmëtarët e tij për t'iu kërkuar atyre bashkëpunim. **Hajri Beu** mendonte se kjo ishte e pamundur, edhe pse në të njëjtën kohë, e ndjeu se provokimi i armiqësisë me **Xhanberdi Gazaliun** nuk do të ishte në interes të tij, ndaj i ktheu përgjigje se do t'i bashkohej në rebelim, nëse Xhanberdi Gazaliu do ta rrethonte Alepon. Dhe Xhanberdi Gazaliu e rrethoi Halebin (Alepon) me 20.000 luftëtarë, por ai u përball me një qëndresë shumë të fortë. Ndërkohë, Shehsuvarogllu (Şehsuvarogllu) **Ali Beu** mbërriti në

104 Xhanberdi Gazaliu ishte një rob i liruar nga Melik Eshref Kajëtbeu dhe ishte ndër bejlerët memlukë më me influencë gjatë administratës së Kansu Gavrit dhe Tomanbeut. Ai ishte falur nëpërmjet ndërmjetësit të Hajri Beut dhe ishte emëruar *Belerbej* i Biladu'sh Shamit (Sirisë), dhe *Sanxhakbej* i Jeruzalemit dhe Gazës: OT, II, fq. 307-308.

Alepo dhe i shkaktoi humbje Xhanberdi Gazaliut dhe veziri i tretë, **Ferhad Pasha** mbërriti me një ushtri kalorësish nga disa *sanxhakë* dhe me disa jeniçerë nga Anadulli, dhe koka e Xhanberdi Gazaliut u dërgua në Stamboll. Shtypja e revoltës së Xhanberdi Gazaliut brenda një kohe të shkurtër, prishi planet e Shah Ismailit. Me të dëgjuar që Xhanberdi Gazaliu ishte mundur, ai la kryeqytetin e Tebrizit dhe shkoi në provincën e Kazvinit, me pretekstin se do të kalonte verën atje.¹⁰⁵

Hapja e Beogradit ndaj Islamit

“Marrja e rajonit të Ballkanit hapi rrugën e një lufte botërore dyshekullore kundër fuqive evropiane.”¹⁰⁶ Lumi Danub ishte kufiri midis Devletit Osman dhe botës së krishterë. Pjesa veriore e kufirit i përkiste Evropës së krishterë, ndërsa pjesa jugore muslimanëve. Kështjella e Beogradit, duke qenë se kishte një pozitë të rëndësishme strategjike, e pozicionuar në bregun jugor të Danubit, paraqiste një nevojë të domosdoshme për aneksim. Osmanët e kishin rrethuar dy herë këtë kështjellë, por nuk kishin arritur ta merrnin. **Kanuni Sulltan Sylejmani** marshoi për në Beograd, që në atë kohë ishte nën zotërimin e Hungarisë, pasi ai qytet ishte me rëndësi tepër strategjike për osmanët. Përreth 50 anije transportuan furnizime duke lundruar nëpër Danub. Beogradi u rrethua për një muaj, derisa u hap ndaj Islamit në vitin 927/1521.¹⁰⁷ Banorëve të Beogradit iu dha liri e plotë të qëndronin në këtë vend dhe në çdo pjesë tjetër të territorit osman duke paguar *xhizje*.¹⁰⁸

105 OT, II, fq. 308-309.

106 I.M. Lapidus, *A History of Islamic Societies*, Cambridge: C.U.P. 1988, fq. 311.

107 Lütifi Paşa, *Tevarih-i Al-i Osman*, Stamboll: 1341 H, fq. 303.

108 Pechuyi Ibrahim, *Tarih-i Pechuyi*, Stamboll: Libraria Enderun, 1980, I, fq. 70.

OT, II, fq. 312: “Gjatë fushatës së Beogradit, në ushtrinë osmane kishte dhe elefantë. *Softat* (nxënësit) e *medreseve* në Edrene, Filibe dhe Sofje morën pjesë në këtë fushatë të parë xhahadi të drejtuar nga Kanuniu.

Hapja e Rodosit ndaj Islamit 928/1522

Ishulli i Rodosit, i pozicionuar gjatë rrugës detare Stamboll-Egipt, kishte qenë një burim i vazhdueshëm shqetësimi për muslimanët. Biladu'sh-Shami (Siria) ishte një vend osman, gjithashtu, dhe për këtë arsye, ky ishull ishte kthyer në pikën më të lartë të vlimit mes territoreve osmane. Për më tepër, të krishterët që u vetëquajtën “Kalorës të Shën Xhonit”, i ndihmuan nga kjo bazë e tyre memlukët kundër osmanëve, gjatë betejës së Rajdanijes.¹⁰⁹ Këta “kalorës” ishin tepër të angazhuar në veprimtari grabitjeje dhe piraterie ndaj tregtarëve dhe pelegrinëve muslimanë. Me pak fjalë, ishulli i Rodosit ishte vend i krishterë, me territorin e tij të gjerë dhe me fortesa dhe kështjella të fortifikuara mirë. Për këtë arsye, hapja e këtij vendi ndaj Islamit u kthye në një nevojë jetike për osmanët, për t’iu dhënë fund edhe veprimeve sulmuese të atyre piratëve.

Kanuni Sulltan Sylejmani kishte një flotë detare shumë të fuqishme, që ishte ndërtuar nga babai i tij, Javuz Sulltan Selimi; dhe *Donanma-jë Hymajun* shumë shpejt e bllokoi ishullin. Sulltan Sylejmani i Madhërishëm, u largua nga Marmarisi në pjesën e Anadollit dhe iu drejtua ishullit. Shumë luftëtarë erdhën nga Evropa në ishull për të marrë pjesë në mbrojtjen e ishullit Rodos.¹¹⁰ Kështjella ishte kaq e fortifikuar, sa që osmanëve iu deshën 6 muaj për të arritur të hapnin ndaj Islamit. “Kalorësit” e dorëzuan ishullin me këto kushte:

Të krishterët që do të qëndronin në ishull, do të gëzonin liri të plotë të ritualeve të tyre fetare.

Asnjë nga banorët e krishterë të ishullit, nuk do të merrej si *devshirme* (që të rritej si musliman dhe të kthehej në jeniçer).

Banorët e ishullit nuk do të paguanin taksa për pesë vjet.

Duke filluar nga kjo datë (1521), Beogradi u kthye në një nga bazat më të rëndësishme të ushtrisë osmane në Evropë dhe u quajt **daru'l-xihad**.”

109 OT, II, fq. 313.

110 Karaçelebizade (Shejhulislam), *'Abdülaziz, Ravzatu'l Ebrar*, Kajro: 1248 H, fq. 66.

Kushdo që dëshironte, ishte i lirë të largohej nga ishulli për tre vjet.

“Kalorësit” do të transportoheshin me anijet e osmanëve deri në portin e Kandijes në ishullin e Kretës.

Mënyra se si Urdhri i Kalorësve të Shën Xhonit e dorëzoi ishullin, tregon besimin që ata kishin tek osmanët, pasi Devleti Osman ishte i besueshëm, i mbante premtimet e dhëna dhe për këtë arsye kalorësit nuk kishin asnjë dyshim apo shqetësim, për sa i përket sigurisë së tyre pas dorëzimit.

Ata luftëtarë të krishterë, që u transportuan drejt Kretës sipas kushteve për dorëzimin e ishullit, më pas shkuan në ishullin e Maltës, e kthyen atë në një bazë të fortifikuar dhe vazhduan luftën e tyre kundër turqve dhe Islamit.



*Ish-Presidenti i Sh.B.A-së Regan, duke marrë “dekoratën e Maltës”
pasi ishte kundër kiretimit*

Në këtë dyluftim, artileria osmane dha prova të superioritetit të saj mbi artilerinë evropiane.¹¹¹ Osmanët, gjithashtu,

111 OT, II, fq. 315.

kontrollonin dhe kështjellat e Istankojit (İstanköyü) dhe Bodrumit. Pra, asnjë pirat evropian nuk kishte mbetur në tokën e Anadollit. **Kurdoğlu (Kurdoğlu) Muslihiddin Reisi** u emërua Sanxhakbej i Rodosit në vitin 928/1522.¹¹² Ndërkohë, sulltani osman dërgoi **Selman Reisin** në Jemen dhe Arden për të vendosur ligjin atje.¹¹³

Në këtë mënyrë siguria ishte garantuar në pjesën lindore të Mesdheut, por pas pak kohësh, kryengritjet e filluara në Egjipt do të bënin që përkohësisht sulltani osman të mos e përqendronte vëmendjen e tij në Evropë. Hajri Beu i mbeti besnik Devletit Osman, kur Xhanberdi Gazaliu u rebelua. Pas vdekjes së Hajri Beut në vitin 828/1522, në vendin e tij u caktua **Veziri Ahmed Pashai**, por ai ishte i zhgënjyer, për arsye se nuk i kishin dhënë titullin e *sadrizamit*. Kështu që, memlukët gjetën tek ai udhëheqësin për rebelim. **Ahmed Pashai** caktoi njerëzit e tij të besuar në vendet më të rëndësishme të administratës së Egjiptit dhe u vetëshpall Sulltan i Egjiptit në Rebül-evvel 930/janar 1524, ndërkohë fabrikoj monedhën *sikke* dhe u mbajt *hutbeja* në emër të tij, meqenëse ai u shpall udhëheqës shteti. Por, jeniçerët në kështjellën e Kajros, nuk e mbështetën dhe e kundërshtuan, ndërsa arroganca e Ahmed Pashait ktheu shumë njerëz kundër tij. Si përfundim, ai u vra një vit më pas, përpara se të ndërmerrej ndonjë veprim zyrtar kundër tij.

Sylejmani i Madhërishëm dërgoi Ibrahim Pashanë në Egjipt për të vendosur rregullin atje. **Ibrahim Pasha** i shtypi kryengritësit, vrau disa nga memlukët dhe emëroi disa të tjerë në disa poste në vende të largëta. Ai liroi njerëz që nuk kishin pasur mundësi të paguanin borxhet e tyre dhe që ishin burgosur për këtë arsye, duke i paguar ato nga Thesari i Devletit, rivendosi drejtësinë dhe u përpoq të fitonte njerëz në përkrahje të Devletit Osman. Ai riparoi kanalet vaditëse, uli taksat, themeloi vakëfe. Ai themeloi urdhrin *salijane* në të gjithë Egjiptin,

112 Katib Çelebi, *Tuhfetu'l Kibhar fi Esfari'l Bihar*, fq. 24.

113 Katib Çelebi, *vepër e cituar*, fq. 25.

në mënyrë që të parandalonte çdo rebelim tjetër të mundshëm. Çdo vit, të ardhurat do të ndaheshin; një pjesë do të dërgohej në el-Haramejn esh-Sherifejn (Mekë dhe Medinë); një sasi e caktuar do të dërgohej në Stamboll dhe pjesa që mbetej do të shpenzohej për Egjiptin. Bejlerbeu kontrollohej nga *defterdari*, *muftiu* dhe nga *subashi*. Të gjitha llojet e taksave në Egjipt do të mblidheshin nga nëpunësit zyrtarë të taksave. Në Egjipt nuk praktikoheshin sistemi *timar*. Ushtarakët në këtë vend i merrnin rrogat e tyre nga thesari dhe egjiptianët që hynin nën shërbimin e Devletit, punësoheshin në pjesë të tjera të territorit osman.¹¹⁴

Beteja e Mohaçit në vitin 932/1526

Për botën e krishterë, kurora e Shën Stefanit ishte simboli i superioritetit. Ajo ruhej nga **Mbreti Lajosh**, që në Evropë kishte marrë edhe titullin mbret mbi mbretërit. Por edhe mbreti i Francës dëshironte ta merrte atë për vete, kështu që, midis dy monarkëve të krishterë filloi lufta. Me mbështetjen e spanjollëve, hungarezët i mundën francezët, mbreti i të cilëve u detyrua të arratisesh dhe të strehohej në një kështjellë të fortifikuar, nga ku ai dërgoi ambasadorin e tij te sulltani osman, për t'i kërkuar atij që të tërhiqte vëmendjen e Mbretit të Hungarisë, në mënyrë që ai të arrinte të hakmerrej. Nga ana tjetër, hungarezët morën si iniciativë lidhjen e një traktati, ku do të përfshiheshin dhe polakët, si dhe vojvodët e Vllahisë dhe Bogdanit. Kjo ishte përpjekja e fundit për të përfshirë në një aleancë Vllahinë dhe Bogdanin, pasi ato ishin nën zotërimin osman. Këto zhvillime çrregulluan balancën e pushtetit dhe ndikimit në rajon.

Në këtë mënyrë, Sulltani osman **Sylejmani i Madhërishtëm** vendosi të marshonte drejt Hungarisë, ku dërgoi *Vezir-i A'zamin* (Vezirin e Madh), **Ibrahim Pashanë** (1523-1536) në krye të një force ushtarake. Pasi vizitoi tyrbet e **Ejup Sulltanit**, **Shejhut Ebu Vefa**, **Fatihut**, **Bajezidit** dhe **Javuz Selimit** për të marrë

114 Stanford J. Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, Cambridge: 1976, I, fq. 88-89.

uratën e tyre, Sulltan Sylejmani marshoi drejt Hungarisë së bashku me pjesën kryesore të *Ordu-ju Hymajun*, që ishte nën *Sanxhak-ë Sherifin* (Flamurin e Profetit).¹¹⁵ Ushtria hungareze, në të cilën përfshiheshin kalorës gjermanë, polakë, çekë, italianë dhe spanjollë priste në Mohaç. *Ordu-ju Hymajun*¹¹⁶ dhe Sulltani i Islamit kaluan lumenjtë Sava dhe Drava dhe mbërritën në Mohaç.¹¹⁷ Kalorësia e koracuar hungareze, prej 60.000 luftëtarësh, sulmoi qendrën e ushtrisë osmane (*Ordu-ju Hymajun*) në Mohaç më 20 Dhilka'de 932/29 gusht 1526. Ndryshe nga praktika që kishin ndjekur në luftërat e mëparshme, me këshillë të Sanxhakbeut të Semendirës (Smederevës), **Bali Beut** të akënxhinjve, ushtria osmane vendosi artilerinë në qendrën e saj, në vend që ta vendoste atë në krahët anësorë. Forcat hungareze u përqendruan në qendër dhe sulmuan me 300 armë zjarri mbi ta. Edhe Bali Beu me akënxhinjtë manovroi shpejt, duke e rrethuar ushtrinë e krishterë. Në këtë mënyrë, ushtria evropiano-krishterë pësoi disfatë dhe u shpërnda, në një betejë që zgjati vetëm dy orë. **Mbreti Lajosh** i Hungarisë ishte ndër viktimat e luftës dhe Buda, kryeqyteti i mbretërisë hungareze, u dorëzua pa bërë asnjë qëndresë.¹¹⁸ Devleti Osman nuk e aneksoi të gjithë Hungarinë, por mori kështjella të rëndësishme dhe strategjike. Osmanët aneksuan rajone në Bosnjë, që kishin qenë nën zotërimin e Hungarisë. Ata ishin të detyruar të luftonin në këto luftëra, për arsye se rivalët e krishterë ishin të vendosur t'i kthenin ata mbrapsht, drejt Dardaneleve dhe deri në Anadoll, dhe nëse do të ishte e mundur, edhe t'i shfarosnin të gjithë. Edhe në ditët e sotme vazhdon të ekzistojë një proverb serb, që thotë: "Nga

115 Solakzade, *Tarih*, fq. 451-452.

116 *Hüma* është një shpend legjendar që mendohet se fluturonte shumë lart. Pra, *hümayun* do të thotë "që i përket Hüma-s" dhe që shpendi që fluturon shumë lart i përket Qiellit, pra **qiellor**. Për arsye se osmanët e shikonin veten si "përfaqësuesit" e "Mesazhit të Fundit Qiellor, Islamit", ata e quajtën ushtrinë e tyre **ordu-ju hymajun: ushtria qiellore**.

117 Po aty, fq. 453-454; dhe **Lyfti Paşa** thotë se ushtria e krishterë kishte në radhët e saj edhe luftëtarë **rusë**: *Tevarih-i Al-iOsman*, fq. 324.

118 Solakzade, *Tarih*, fq.459; *OT*, II, fq. 324-326.

Adriatiku deri në Iran, nuk do të mbijetojë asnjë musliman.”¹¹⁹ Përveç motivacionit të xhihadit, osmanët ishin të detyruar të luftonin në Evropë për të mbijetuar kundër forcave agresive të bashkuara të krishterimit.

Sylejmani i Madhërishëm, pas fitores që kishte korrur, ia kishte shprehur dhe vetë një bindje të tillë ambasadorit hungarez, nga Transilvania, i cili ndodhej në Stamboll, duke i thënë se “Bota e krishterë grumbullonte re kërcënimi mbi stërgjyshërit e mi, por nga këto re, nuk ka rënë shi. Nëse ata (bota e krishterë) nuk do t’i kishin filluar këto luftëra, nuk do të kishte qenë e nevojshme të derdhej gjithë ky gjak.”¹²⁰ Nëse bota e krishterimit do të kishte parë punën e saj, osmanët, me shumë mundësi nuk do të kishin shkuar kaq larg, por do t’i kishin përqendruar fuqitë e tyre në Lindje, me vëllezërit e tyre Sunnitë në Turkestan dhe në Indi. Akënxiu (Sulmuesi), **Ali Bej**, i fisit të mirënjohur të Mihalogllut, shprehu të njëjtën ndjenjë në *gazavat-namen* e tij, ku ai thotë:

*Eger def’ olmaz ise bu belijje,
Ne Iznik kala, ne Konstantinijje.*¹²¹
Nëse nuk zbrapset kjo sfidë,
As Nikea, as Kostandinopoja nuk do të mbesin
(në zotërimin tonë).

119 **Od Jadrana do Irana neće biti Muslimana.**

Pra, historia e tragjedisë së Bosnjës është e qartë: serbët ishin të frustruar për arsye se kishin qëndruar “jashtë historisë”, për një periudhë 5 shekujllorë dhe fuqitë e krishterimit, nëpërmjet organizatës që quhet Kombet e Bashkuara, i lidhën duart e muslimanëve me mashtrime të tilla si embargo apo mënyra të tjera diplomatike, ndërkohë që, serbët e krishterë janë të lirë t’i masakrojnë ata.

120 Osman Turan, *Türk Cihan Hakimiyeti Mefkuresi Tarihi*, Stamboll, Shtëpia Botuese Nakişlar, 1979, vëllimi II, fq. 422.

121 Agah Sirri Levent, *Gazavatnameler ve Mihaloğlu Ali beyin Gazavatnamesi*, Stamboll, 1956, fq. 246, 254, 295; cituar në Osman Turan, *Türk Cihan Hakimiyeti Mefkuresi Tarihi*.

Rrethimi i parë i Vjenës 935/1529

Pavarësia e Hungarisë kishte marrë fund si pasojë e betejës së Mohaçit. Vdekja e Mbretit Lajosh pa lënë pas asnjë trashëgimtar për fronin, e la vendin në një kaos të plotë. Me këtë rast, dolën dy pretendentë për fronin: nacionalistët hungarezë që mbështesnin **Janosh Zapoljan** (v.1540), vojvodën e Transilvanisë; dhe disa fisnikë të Hungarisë, që mbështesnin Mbretin e Bohemisë dhe njëkohësisht Dukën e Austrisë, **Ferdinandin**, vëllain e Perandorit të Gjermanisë, **Karli V**, si dhe kunat i **Lajoshit**.

Në vitin 932/1526, Sulltan Sylejmani i Madhërishëm, caktoi **Janosh Zapoljan** si mbret të pjesës osmane të Hungarisë, me kusht që ai të pranonte vasalitetin e tij ndaj Devletit Osman,¹²² por **Ferdinandi** deklaroi se froni i Hungarisë i përkiste vetëm atij.¹²³ Zapolja ishte përzgjedhur si mbret i Hungarisë me shumicë votash nga fisnikët në Kuvendin e Tokajit (16 shtator 1527), por Ferdinandi arriti ta mundte Zapoljan në Tokaj (27 shtator 1527). Në reagim kundër pushtimit të Habsburgëve, Zapolja arriti një marrëveshje me osmanët (28 shkurt 1528), sipas të cilës ai rinjihte sovranitetin e sulltanit, në mënyrë që të siguronte një pushtim të ri për ta nxjerrë Ferdinandin jashtë loje. Sylejmani i Madhërishëm preferoi të kishte një Hungari autonome nën drejtimin e Zapoljas, që do të vepronte si amortizator ndaj dinastisë së Habsburgëve, në vend që të angazhonte trupat ushtarake apo dhe burime të tjera, që do të ishin të nevojshme për pushtimin dhe kontrollin e drejt-përdrejtë të vendit.¹²⁴

Sylejmani i Madhërishëm marshoi edhe një herë drejt Hungarisë dhe si rimori Budapestin, caktoi **Janosh Zapoljan**

122 Danişmend, II, fq. 127.

123 Karaçelebizade (Shejhulislam) 'Abdulaziz, *Ravzatu'l Ebrar*, Bulak, Kajro: 1248 H, fq. 99.

124 Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 92-93.

Mbret të Hungarisë në vitin 935/1529.¹²⁵ *Ordu-ju Hymajun* mori kështjellën e Estergomit dhe rrethoi Vjenën. Ndërkohë, Mbreti i Francës **Fransua (François) I** (1515-1547), ishte sulmuar nga **Karli V** dhe për këtë arsye kërkoi ndihmën e sulltanit osman kundër tij. Rrethimi i Vjenës e vendosi **Karlin V** në një pozitë tepër të vështirë, ndërkohë që ishte një ndihmë e madhe për **Fransuanë I**. Megjithatë, sulltani osman, nëpërmjet rrethimit të Vjenës, kishte për qëllim t'i jepte një mësim **Karlit V** dhe gjithë Evropës, por jo ta merrte Vjenën. Nëse ai do të kishte planifikuar që ta merrte atë, Sylejmani i Madhërisëm do të kishte sjellë atje artilerinë e rëndë bashkë me ushtrinë e tij dhe do të kishte marshuar drejt saj, për të arritur atje dy muaj më parë, që të arrinte ta hapte atë ndaj Islamit. Në tetor të vitit 1529, ai e ngriti rrethimin dhe u kthye në Stamboll.¹²⁶ "Por, rrethimi i Vjenës pati një sërë rezultatesh të rëndësishme. Së pari, siguroi zotërimin e Hungarisë nga otomanët dhe një marrëdhënie të re vasaliteti me Zapoljan. Së dyti, e la Austrinë dhe pjesën veriore të Hungarisë, kaq të rrënuar, sa që Ferdinandi nuk ishte i aftë të ndërmernte një kundërsulm të suksesshëm. Së treti, për rrjedhojë, arriti të forconte *status quonë* me Habsburgët, që drejtonin vendin në pjesën veriore dhe perëndimore të kufirit, ndërkohë që pjesa tjetër e vendit qëndroi nën drejtimin autonom të Hungarisë, duke shërbyer në këtë mënyrë si një amortizator midis superfuqive në veri dhe jug."¹²⁷

Fushata e tretë në Hungari 938/1532

Ferdinandi, vëllai i **Karlit V**, pretendonte se Hungaria duhet të ishte e tij dhe për këtë arsye e rrethoi sërish Budapestin. **Sylejmani i Madhërisëm** u vendos në një pozitë të tillë që e njohu **Karlin V** si "Mbret të Spanjës" dhe vëllain e tij, **Ferdinandin**, vetëm si "gubernator të Vjenës". Për këtë arsye,

125 Solakzade, *vepër e cituar*, I, fq. 471; OT, II, fq. 329.

126 Lütflü Paşa, *vepër e cituar*, fq. 338; Karaçelebizade, *vepër e cituar*, fq. 104; Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 473; OT, II, fq. 330.

127 Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 93.

me sulmin e ndërmarrë nga Ferdinandi mbi Budapestin, ai i deklaroi luftë të drejtpërdrejtë **Karlit V**, nga që nuk ishte e përshtatshme për të, që t'i shpallte luftë një guvernatori. Pra, ai sfidoi Gjermaninë, Austrinë dhe një nga dy superfuqitë detare të krishterimit në atë kohë, Spanjën! Sulltani osman e drejtoi *Ordu-ju Hymajunin* e tij drejt Hungarisë në vitin 938/Prill 1532, hyri në territorin e Hungarisë, iu drejtua pjesës veriperëndimore të saj duke marrë disa kështjella. Sulltani osman e sfidoi **Karlin V** në një përballje, por ai u largua i tmerruar. **Karli V** kishte një ushtri të përbërë nga shumë nacionalistë, por nuk guxoi të pranonte sfidën e sulltanit, pasi mendonte se nëse nuk do të fitonte, ai do të ishte në një pozitë shumë të vështirë. **Sylejmani i Madhërishëm** i dërgoi letra qortuese **Ferdinandit** dhe **Karlit V** duke iu referuar dështimit të tyre për t'u paraqitur.¹²⁸ Qëllimi i të Madhërishmit në këtë fushatë ishte të mundte **Karlin V** dhe të shkatërronte perandorinë e tij.¹²⁹ **Sulltan Sylejmani** u kthye në Stamboll në vitin 939/1532.

Ferdinandi arriti t'i rezistonte Devletit Osman vetëm nëpërmjet ndihmës së vëllait të tij, **Karlit V**. Perandori preferoi të mbante veten të zënë në pjesën perëndimore të Evropës dhe e këshilloi të vëllain që të binte në ujdi me Devletin Osman. Për këtë arsye, Ferdinandi iu drejtua osmanëve duke iu kërkuar atyre të lidhnin një traktat paqeje. Devleti Osman e pranoi këtë kërkesë, pasi fushatat në Hungari i kishin kushtuar shumë Thesarit dhe kishin sjellë moskujdesin ndaj pjesës lindore të Anadollit. **Tahmasb Hani** i Iranit, që kishte marrë vendin e babait, **Shah Ismailit**, pas vdekjes së tij në vitin 930/1524, kishte filluar të krijonte trazira në Anadollin Lindor. Për këtë arsye nëpërmjet traktatit u vendos paqja, me anë të së cilës, **Janosh Zapolja** u shpall mbret në disa pjesë të Hungarisë, ndërkohë që Ferdinandit iu lejua të drejtonte pjesët e tjera të këtij vendi. **Ferdinandi** nuk do t'i sulmonte ato pjesë të Hungarisë ku

128 OT, II, fq. 334.

129 Danişmend, II, fq. 144.

Janosh Zapolja drejtonte dhe do t'i paguante Thesarit Osman 30.000 monedha floriri si shumë vjetore për pjesën e Hungarisë që ai drejtonte.¹³⁰

Ndërkohë që **Sylejmani i Madhërishëm** ishte në Edrene, një komitet i dërguar nga **Emiri Rashid** i Basras, ku merrte pjesë dhe djali i tij, **Maniu**, dhe veziri **Mir Muhammed**, mbërriti për të dorëzuar çelsat e Basras, dhe për të deklaruar përluljen e Emirit ndaj sulltanit osman, më 26 Safer 944/24 korrik 1538.¹³¹ Emir Rashidi u emërua **Bejlerbej** i Basras dhe me këtë rast atij iu dërgua dhe një *berat* (dekreti i emërimit), një *tuğ* dhe një *sanxhak* (flamur). Pra, Basra dhe rrethinat e saj u vendosën nën mbrojtjen ndaj kërcënimit dhe rrezikut të Portugalisë.¹³²

Fushata e katërt në Hungari 948/1541

Janoshi ndërroi jetë në vitin 947/1540, duke lënë si trashëgimtar një fëmijë të mitur me emrin Ishtvan, ndaj **Ferdinandi** e rrethoi dhe një herë Budapestin. **Sylejmani i Madhërishëm** u nis sërish drejt Hungarisë në vitin 948/1541. Forcat ushtarake të Ferdinandit u përpoqën të shpëtonin duke u arratisur, por ata u rrethuan nga ushtria osmane dhe u vranë. **Ishtvani** u dërgua bashkë me nënën e tij në Transilvani (hung. Erdeli), që ishte qendra e babait të tij dhe ajo pjesë e Hungarisë që ishte nën drejtimin e Janoshit, u aneksua nga osmanët. Në këtë vend u shpall *Bejlerbejliku i Budinit* dhe **Sylejman Pasha**, me origjinë hungareze, u emërua si Bejlerbeu i parë i tij.¹³³ Pas fitores në Mohaç, një pjesë e Hungarisë ishte aneksuar, por Budapesti i ishte lënë Janosh Zapoljas, i cili paguante *haraxhin*, për shkak të territorit të gjerë që zotëronte. Pra do të ishte e vështirë për ta mbajtur dhe për ta mbrojtur këtë zonë. Por, pas vdekjes së

130 OT, II, fq. 336.

131 Danişmend, II, fq. 205-206.

132 OT, II, fq. 352-353, poshtë-shënimi 2.

133 OT, II, fq. 339.

Zapoljas, Budapesti iu bashkua qendrës, pasi në atë kohë ishte e lehtë të mbrohej.

Fushata e pestë në Hungari 950/1543

Ferdinandi e provoi sërish fatin e tij dhe e rrethoi përsëri Budapestin me një forcë ushtarake prej 80.000 luftëtarësh, ndaj dhe Sulltan Sylejmani u nis prapë drejt Hungarisë në krye të *Ordu-ju Hymajun* në vitin 950/1543. Kur **Ferdinandi** u njoftua se sulltani po afrohej, ai u tërhoq dhe osmanët aneksuan disa kështjella.¹³⁴

Ferdinandi kërkoi paqen në vitin 954/1547 dhe u lejua të drejtonte sërish një pjesë të Hungarisë, duke i paguar shumën vjetore prej 30.000 dukatesh Thesarit Osman. Edhe Karli V, Papa, Republika e Venedikut dhe Franca iu bashkuan këtij traktati paqeje që ishte lidhur për një periudhë 5-vjeçare.¹³⁵

Ndërkohë që *Ordu-ju Hymajun* u angazhua në luftë me Iranin, **Ferdinandi** i shkeli kushtet e paqes dhe sulmoi Erdelin në vitin 958/1551. **Kara Ahmed Pasha**, veziri i dytë i *Divani-i Hymajunit* osman, nisi një luftë që do të zgjaste deri në vitin 970/1562 dhe gjatë të cilës ai aneksoi Timishoarën pas një rrethimi 35-ditor. Duke qenë se sulltani osman ishte i shqetësuar për Iranin heretik, ai la në Rumeli (Evropën osmane) vetëm forcat ushtarake lokale dhe një numër të vogël trupash nga Stambolli që do të përballeshin me situatën në Hungari. Në atë kohë, pas abdikimit të **Karlit V**, Ferdinandi u shpall Perandor i Gjermanisë (1558-1564). Një traktat 8-vjeçar paqeje u lidh, sipas të cilit **Ferdinandi** la të lirë Erdelin.¹³⁶

134 OT, II, fq. 339.

135 OT, II, fq. 340.

136 OT, II, fq. 342.

FUSHATA NË EL-IRAKEJN DHE PUSHTIMI I BAGDADIT

Pas vdekjes së **Shah Ismailit** në vitin 930/1524, djali i tij **Tahmasb** (sundoi në vitet 1524-1576), mori fronin e Iranit. **Tahmasbi** ndoqi të njëjtën politikë armiqësore si i ati, duke dërguar ambasadorët e tij për të siguruar bashkëpunimin e **Karlit V** dhe **Ferdinandit** kundër osmanëve. Në atë kohë, osmanët kishin arritur marrëveshje paqeje me **Ferdinandin** dhe kishin dërguar Sadrazamin **Ibrahim Pasha** (1523-1536) në krye të një ushtrie kundër Iranit në shtator të vitit 1535. Osmanët arritën të merrnin kështjellat e Adilxhevazit, Erxhishit, Vanit dhe Ahlatit, dhe rimatorën kështjellën e Tebrizit në 941/1534. Në vitin 941/1534, **Sulltan Sylejmani i Madhërishëm** marshoi drejt Iranit në krye të një ushtrie tjetër osmane dhe mori Bagdadin. Ai përcakttoi vendin ku ishte varrosur **Ebu Hanife Nu'man b. Thabit** dhe ndërtoi një tyrbe, dhe një xhami të bukur në kujtim të këtij imami të madh. Sulltani urdhëroi, gjithashtu, edhe riparimin dhe mirëmbajtjen e tyrbes së **Abdulkadir Gejlanit**, Shejhut të madh sufist dhe vizitoi varrin e **Musa el-Kazimit**, pasardhës i **Hazret Aliut** dhe njërit prej Dymbëdhjetë Imamëve dhe tyrbet e disa muslimanëve të tjerë të mëdhenj.¹³⁷ Të gjitha këto dhe veprime të tjera, tregojnë

karakterin mirëdashës dhe të favorshëm të Islamit osmano-turk. Ndërkohë, Devleti Osman mori edhe **Katifin** dhe **Bahrejnin**.¹³⁸

Poeti turk më i talentuar, **Fuzuli** e mirëpriti këtë vizitë në Bagdad duke e përshkruar me fjalinë e mëposhtme:

Geldi Burxh-ë Evlijaje Padishah-ë Namdar

Sulltani i Famshëm erdhi në qytetin e Evlijave.¹³⁹

Por, ndërkohë që, Devleti Osman ishte i angazhuar me shtypjen e trazirave të brendshme që ekzistonin në botën islame, superfuqia detare e krishterë Portugalia, u përpoq të rrethonte tokat e muslimanëve. Abbas Hamdani e përshkruan këtë situatë si më poshtë:

“Midis viteve 1517-1519, osmanët morën Egjiptin, Sirinë dhe Jemenin dhe vendosën pushtetin e tyre në Mekë. Në vitin 1534, ata morën Bagdadin dhe në vitin 1546 Basrën. Në këto kushte, ata kishin mundësi të kontrollonin Detin e Kuq dhe Gjirin Persik, duke qenë të aftë të bllokonin përparimin e portugezëve nga Oqeani Indian drejt veriut, deri në Mekë dhe Kajro. Vëmendja jonë në këtë mënyrë tërhiqet drejt interesit të otomanëve në Afrikën e Veriut dhe në Perëndim, që në një mënyrë përbën një kundërveprim të Islamit ndaj zbulimit të Amerikës.”¹⁴⁰

Nga ana tjetër, duke qenë e angazhuar në beteja me Perandorinë Austriake, Franca kërkoi të lidhte marrëveshje me Devletin Osman, në mënyrë që të shqetësonte Perandorinë e Austrisë në Lindje dhe të fitonte pak qetësi. “Një ambasador francez, **Zhan (Jean) de la Foret**, arriti sulltanin tek sa ai po udhëtonte nga Iraku për në Azerbajxhan në maj 1535, duke i **propozuar atij një sulm të përbashkët kundër Habsburgëve**.

138 Karaçelebizade, *vepër e cituar*, fq. 120.

139 Solakzade, fq. 487; Shuma e vlerave numerike të fjalisë në gjuhën Turke është 941 (1534 e.s.): kaf (gaf-i farisi): 20, lam:30, dal:4, ja:10, ba:2, ra:200, xhim:3, elif:1, vav:6, lam:30, ja:10, elif:1, ja:10, he:5, pa:2, elif:1, dal:4, shin:300, elif:1, he:5, nun:50, elif:1, mim:40, dal:4, elif:1, ra:200.

140 Abbas Hamdani, “*Ottoman Response to the Discovery of America and the New Route to India*”, *Journal of the American Oriental Society*, 101, fq. 327.

Për pasojë, më pas u lidh një marrëveshje tregtie e quajtur Kapitulationet (18 shkurt 1536)... Dhe shumë shpejt francezët dhe otomanët lëvizën për të zbatuar **detyrimet e lidhjes mes tyre, për një sulm të përbashkët kundër Italisë**: forca e parë do të sulmonte në rrugë tokësore, nga veriu; ndërsa këta të fundit do të sulmonin në rrugë detare, nga jugu. ... Në drejtimin e një ushtrie prej 300.000 luftëtarësh, Sylejmani u nis nga Stambolli drejt Shqipërisë, nga ku flota do t'i transportonte ata për në Itali. **Në këtë pikë kyçe**, me një armatë të fuqishme otomane që kishte pushtuar brigjet e Shqipërisë për t'iu bashkuar Francës për një **pushtim të Italisë**, sulltani mësoi atë çka shumë prej pasardhësve të tij do të zbulonin në vitet më vonë: që **miqtë jobesimtarë do të hiqnin dorë nga të gjitha marrëveshjet e arritura, në ato raste kur ato nuk përputhen me interesat e tyre në Evropë**. Nën presionin e Papatit, **Karli V dhe Francis i** kishin dhënë fund konfliktit midis tyre, **kështu që Evropa mund të bashkohej kundër Islamit**.¹⁴¹

Fushata në Iran

Përfundimisht, Safevitët rimorën Tebrizin, por Bagdadi mbeti nën zotërimin e osmanëve dhe asnjë traktat nuk u arrit me Iranin. Vëllai i **Shahut Tahmasb, Elkas Mirza**, guvernatori i Shirvanit, pati kërkesë të tepruar dhe pati kundërshtime për fronin, dhe pas disfatës së tij në vitin 954/1547, u strehua tek osmanët,¹⁴²

141 Shaw, *vepër e cituar*, fq. 97-99, Theksimi është shtuar.

Kur Sylejmani i Madhërihëm u dha disa privilegje tregtarëve francezë, në këmbim të të njëjtit veprim të Francës ndaj tregtarëve muslimanë, kjo nuk arriti ta prekte pavarësinë e Devletit Osman, pasi në vitin 1536, Devleti ishte "superfuqi". Por me kalimin e kohës, këto privilegje u kthyen në një ngarkesë që s'mund të mbahej nga Devleti dhe më pas u quajtën "kapitulacione".

Një çështje tjetër që është e nevojshme të saktësohet, është se ushtria osmane nuk u nis nga Stambolli si një trupë e tërë; ushtarët *kapëkullu*, që ishin bërthama e ushtrisë, u nisën nga Stambolli dhe trupa e madhe iu bashkua gjatë rrugës në formën e strukturave të *timareve* të veçuara, të ngjashme me rrjedhat që i bashkohen një lumi.

142 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 507-508.

të cilët e trajtuan atë mjaft mirë. Me këshillën e tij, **Sulltan Sylejmani** u nis në krye të *Ordu-ju Hymajun* në vitin 955/1548, për të rimarrë territoret e kapura nga **Tahmasbi** dhe faktikisht, ai rimori kështjellën e Vanit.¹⁴³ Veziri i dytë **Ahmed Pasha**, u dërgua në Gyrxhistan (Gjeorgji) në vitin 956/1549 dhe hapi 15 kështjella ndaj Islamit dhe aneksoi një pjesë të provincës.¹⁴⁴




Hartë e kufijve osmane në kohën kur vdiq Sylejmani i Madhërishtëm

Shahu Tahmasb hyri në territorin osman dhe sulmoi disa kështjella. Në këtë mënyrë, **Sylejmani i Madhërishtëm** u rinis në krye të *Ordu-ju Hymajun* drejt Iranit në vitin 960/1553, por nuk arriti ta lokalizonte atë. Osmanët hynë në Nahçevan, Revan (Erevan) dhe Karabag. Megjithatë, duke u kthyer në Anadoll, sulltani kaloi dimrin në Amasja, ku në vitin 962/1555 ai bisedoi për një traktat për paqe me të dërguarit e Tahmasbit, që u mbajt nën vëzhgimin dhe kontrollin e të dy palëve deri pas vdekjes së Tahmasbit, në vitin 1576. Sipas atij traktati, Azerbajxhani,

143 Po aty, fq. 510.

144 Po aty, fq. 513.

kryeqyteti i tij, Tebrizi, Anadolli Lindor dhe Irak-ë Arab do të përfshiheshin të gjitha nën zotërimin osman.¹⁴⁵



Xhamia Sulejmaniye, Stamboll, nga Mimar Sinani, arkitekti më i shquar osman

Veprimtaritë e flotës detare

Devleti Osman, superfuqia e shekullit të 16-të, ishte po kaq superiore edhe në det. Komandanti më i aftë, në botë, i flotës detare të shekullit të 16-të, është **Hëzër Hajreddin Pasha** (Barbarosa), pasi ai mundi në **Prevezë** më 3 Xhumade'1 Ula 945/28 shtator 1538 flotën e forcave aleate të krishtera, nën drejtimin e Admiralit të famshëm **Andrea Doria**. Babai i tij **Jakub Spahiu**, ishte me origjinë nga fisi i Jenixhe Vardarit, por ai banonte në ishullin e Midil-lit pasi ai u hap ndaj Islamit në vitin 866/1462. Jakubi kishte katër djem: Is'hakun, Oruçin, Hëzërin dhe Iljasin. Edhe pse ishin *spahi* (kalarës), katër djemtë e tij ishin të apasionuar pas detit dhe lundrimit.¹⁴⁶ Duhet të theksojmë këtu se ata u nxitën për xhihad nga Kalorësit e Shën

¹⁴⁵ OT, II, fq. 360-361.

¹⁴⁶ OT, II, fq. 363.

Xhonit, të cilët e martirizuan Iljas Reisin.¹⁴⁷ Njëri prej tyre, **Oruč Reisi**, e kishte bazën e tij në ishullin e **Xherbas**, pranë Tunizisë dhe bashkë me vëllain e tij, **Hëzër Reisin**, lidhi një aleancë me **Ebu Abdil-lah Muhammedin**, Sulltanin hafsi të Tunizisë. Nëpërmjet asaj aleance, atyre iu lejohej ta kthenin Tunizinë në bazën e tyre operacionale, në këmbim të pagesës që detyroheshin t'i jepnin sulltanit, në përputhje me praktikën islamike, *humsu'l ganaim*, 1/5 e përfitimit që merrnin nga jobesimtarët.¹⁴⁸ Për pasojë, në vitin 919/1513, ata ndërmorën disa operacione të suksesshme detare, duke fituar një famë të madhe që tërhoqi një numër të madh vullnetarësh gazinj, detarë me origjinë turke që u bashkuan me ta, përfshi këtu edhe shtatë Reisë. Mes shtatë Reisëve ishin dhe **Kurdogllu Muslihuiddin Reisi** dhe **Muhjiddin Reisi**, nipi i Kemal Reisit.¹⁴⁹ **Baba Oruçi**, siç e quanin luftëtarët e tij *muxhahidinë* dhe vëllai i tij, **Hëzër Hajreddin Reisi**, nëpërmjet Muhjiddin Reisit i dërguan dhurata **Javuz Sulltan Selimit**, i cili si shpërblim iu dërgoi atyre dy anije. Në atë kohë, Devletet Muslimane në Afrikën e Veriut ishin në agoni dhe Spanja ishte e vendosur ta kthente të gjithë territorin e Afrikës së Veriut në një **Andaluzi** të dytë, duke bërë *rekonkuistan*, që nënkuptonte që muslimanët e tyre duhej ose të ktheheshin në katolikë, ose të përballeshin me masakrën. Në Tunizi kishte Hafsitë, Benu Zejan në el-Xhezair dhe Merininj në Marakesh, të gjitha këto entitete të dobëta.

Ulemaja dhe një grup fisnikësh nga el-Xhezairi (Algjeria) iu drejtuan **Oruč Reisit** dhe **Hëzër Reisit** për ndihmë kundër spanjollëve, të cilët kishin marrë dhe e kishin kthyer në garnizonin e tyre Bixhajen (Bougie) në Algjeri. Vëllezërit luftuan me trimëri kundër spanjollëve, por nuk arritën ta çlironin këtë qytet musliman nga pushtimi i krishterë, edhe pse në vitin 922/1516

147 Katib Çelebi, *Tuhfetu'l Kibar fi Esfari'l Bihar*, Stamboll: 1329 H, fq. 25.

148 Po aty, fq. 26.

149 OT, II, fq. 366.

ata morën qytetin Xhixhel dhe Xhezair.¹⁵⁰ Spanjollët u tërhoqën në ishullin Penon, që ishte përballë qytetit Xhezair dhe i kërkuan ndihmë **Karlit V**. Ky i fundit dërgoi një flotë në Xhezair, por spanjollët, gjithsesi nuk arritën ta rimerrnin territorin e humbur. Pasi u vendos në qytetin e Xhezairit, **Oruç Reisi** u përpoq të shtrihej drejt qendrës së vendit dhe të shpallte atje sovranitetin.¹⁵¹ Më pas, spanjollët nxitën Emirin e Tlemcenit (Tilimsanit) kundër tij dhe ai me të marrë lajmin e këtij kurthi që po i ngrihej, mori Tilimsanin, por spanjollët e rrethuan Oruç Reisin në atë vend. Spanjollët në këtë rast kishin mbështetjen e popullsisë muslimane vendase, të cilët ishin tepër të paditur për të kuptuar se ata po luftonin me një armik të fuqishëm të krishterë kundër bashkëbesimtarëve *gazinj*, që ishin atje për të parandaluar shndërrimin e Afrikës muslimane të Veriut në Afrikë latine katolike, në një Andaluzi të dytë. Megjithatë, Oruç Reisi së bashku me një grup mbështetësish të tij arriti të largohej duke kaluar lumin dhe gati sa nuk e shkatërroi urën që ishte ngritur mbi këtë lumë, dhe mbërriti në një vend të sigurt. Në këtë moment tepër kritik, spanjollët i arritën *gazinjtë* e plagosur, të cilët thirrën “*Baba*”, që ai t’i shpëtonte nga armiku”. **Oruç Reisi** ndaloi dhe u kthye mbrapsht për t’i shpëtuar shokët e tij *gazinj*, por ata të gjithë ranë aty martirë, në vitin 924/1518.¹⁵² Ai ishte 44 vjeç kur ra martir dhe i vëllai, **Hëzër Hajreddini**, mori drejtimin e el-Xhezairit.¹⁵³ Nëse Oruç Beu do të kishte qenë një

150 OT, II, fq. 366.

Oruç Reisi njihet me nofken “Barbarossa” (Mjekërkuqi) nga evropianët, për shkak të flokëve dhe mjekrës së tij të kuqe.

151 Gabriyel Kolen, *Korpus* (Paris: 1910), fq. 12; cituar në OT, II, fq. 368, poshtëshënimi 1: në mbishkrimin e kullës së Xhixhelit, që daton më 924/1518, shkruhet: *el Ka’im bi-Emril-lah el-Muxhahid fi Sebilil-lah Oruç b. Ja’kub*.

152 OT, II, fq. 367.

153 OT, II, fq. 367, poshtëshënimi 2: “**Gazi Oruç Beu** i Anadollit mori shtetin e el-Xhezairit (Xhezair-i Garb Dijari: Biladu Xhaza’ir’il Garb), dhe mori titullin **Sulltan Oruçi** në vitin 916/1510. Pas vdekjes së tij, detyrën e mori i vëllai, **Hajreddin Beu** dhe pasi mbërriti në Stamboll me 20 anije, ai u kthye në

komandant egoist dhe frikacak, ai mund të kishte arritur i sigurt tek anijet e tij. Por në vend që të shpëtonte vetë, ai zgjodhi të sakrifikohej në emër të nderit dhe respektit bashkë me shokët e tij gazinj, të cilët kishin qenë krah tij në shumë beteja kundër jobesimtarëve. **Sa mbresëlënëse** është ta krahasosh këtë sjellje madhështore dhe guximtare me atë të **Napoleon Bonapartit**, i cili e tradhtoi në vitin 1812 ushtrinë e tij të goditur nga acari në Rusi, dhe u kthye me një karrocë në Francë.

Pas martirizimit të Oruç Reisit, i vëllai **Hëzër Hajreddin Reisi**, që evropianët e quanin Barbarosa, e shkatërroi ushtrinë spanjolle prej 20.000 luftëtarësh që sulmuan qytetin Xhezair. Ai arriti të parashikonte rrezikun e pashmangshëm nga të krishterët dhe i kërkoi ndihmë Devletit Osman në vitin 925/1519.¹⁵⁴ Edhe pse kishte kohë që Hëzër Reisi ishte një *gazi* detar vullnetar, ai ishte në procesin e marrjes së një titulli zyrtari osman. Ai dërgoi katër anije me robër lufte dhe dhurata në Stamboll. Faktikisht, ai planifikoi të shkonte vetë atje, por fisnikët, ulemaja dhe tregtarët e Xhezairit, iu lutën atij të qëndronte për t'i mbrojtur nga superfuqia agresive e krishterë e asaj kohe, Spanja. Gjithashtu, ata i dërguan një letër sulltanit osman, ku e lavdëronin **Oruç Reisin** për martirizimin e tij dhe ngrinin lart të vëllain, **Hëzër Hajreddin Reisin**, për përpjekjet që bëri për t'i mbrojtur. Ata përmendën edhe faktin që ai qëndroi aty pas kërkesave të tyre.¹⁵⁵ Sulltani osman **Javuz Selimi**, që ishte i gëzuar, dërgoi një *berat* nëpërmjet të cilit e emëroi Hëzër Hajreddin Reisin, **Emir**, dhe i dërgoi atij një sasi të madhe pajimesh dhe një flamur. Ai, gjithashtu, i ofroi edhe një shpatë me gurë të çmuar që ia dërgoi me **Haxhi Hysejinin** dhe e lejoi atë të rekrutonte sa të dëshironte vullnetarë *gazinj* nga Anadulli për flotën detare.¹⁵⁶ **Në këtë mënyrë, Xhezairi u kthye në një provincë**

shërbëtor të Hanit, Sulltanit, dhe *mirimiran* (Bejlerbe) i kësaj province." (Ataji, fq. 94).

154 OT, II, fq. 368.

155 Bibloteka e Muzeut Topkapë Sarajë në Stamboll, E/6456.

156 Katib Çelebi, *Tuhfetü'l Kibar fi Esfari'l Bihar*, fq. 32-33; OT, II, fq. 338.

osmane në vitin 925/1519, edhe pse jobesimtarët kishin ende nën kontrollin e tyre ishullin shkëmbor të Penonit, që qëndronte përballë qytetit të Xhezairit me një kështjellë të fortifikuar në majë të shkëmbinjve. Ata qëllonin shpesh me armë zjarri dhe gjylehedhës, që çanin minaret e xhamive të qytetit, sa herë që muezzinët thërrisnin *ezanin*. Përfundimisht, Hajreddini luftoi kundër tyre dhe e mori ishullin Penon duke shkatërruar edhe kështjellën. Më pas, ai mbushi me dhé pjesën e detit që ishte midis qytetit dhe ishullit, duke lënë vetëm një gji dhe e lidhi ishullin shkëmbor me Xhezairin. Në këtë mënyrë u krijua Gjiri i Xhezairit. Spanja dërgoi në ishull nëntë anije në ndihmë të trupave spanjolle. Kur ata e kuptuan se ishulli ishte në duart e muslimanëve u kthyen mbrapsht me nxitim, por Hajreddini i zuri ata rob.¹⁵⁷

Sipas Stanford Shaw: “Janë disa tregues që dëshmojnë se ishin francezët ata që e nxitën Hajreddinin të hynte nën shërbimin e Sylejmanit, me shpresën se kjo do të shmangte përparimin e Habsburgëve drejt perëndimit (vepër e cituar, fq. 97).” Por Shaw nuk i përcakton këta “tregues”. Për më tepër, Hëzër Hajreddin Pasha kishte hyrë në shërbimin osman që në kohën e Hilafetit të babait të Sylejmanit, Javuz Sulltan Selimit. Arsyeya pse ai e bashkoi provincën e tij, dikur të pavarur, me vendin e sulltanit osman është shprehur në mënyrë të qartë në veprën, *Tuhfetu'l Kibhar* (fq. 32) të Katib Çelebiut, ku shkruhet se iu tha algerianëve: “Deri në ditët e sotme, unë ju kam mbrojtur, kam riparuar kështjellat tuaja dhe kam vendosur 400 topa. Tani e tutje, emëroni një *vali* (gubernur) tjetër sipas dëshirës tuaj; unë po largohem në rrugë detare.” Pas këtyre fjalimeve, ata i kërkuan të qëndronte. Hajreddin Beu iu përgjigj: “Emirët e Tunizisë dhe Tlemcinit janë kundër nesh. Nëse *hutbeja* dhe *sikkeja* (shenja të sovranitetit në traditën islame) do të konvertohen në emër të familjes osmane, unë do të qëndroj.” Ata pranuan dhe më pas, ai i dërgoi dhurata Sulltanit osman Javuz Selimit, dhe Algjeria iu bashkua territorit osman. Hëzër Hajreddin Pasha luftoi për të çliruar Afrikën e Veriut nga spanjollët e krishterë. Nëse francezët do ta kishin sulmuar Algjerinë, ai do të kishte luftuar edhe kundër tyre. Ishte tepër e nevojshme që Algjeria të bashkohej me Devletin e fuqishëm Osman kundër superfuqisë së krishterë, Spanjës.

157 Katib Çelebi, *Tuhfetu'l Kibar*, fq. 37. Është një **fakt që ndeshet rëndom**, se të gjitha kronikat osmane iu referohen armiqëve evropianë me termin “*kafir*”, “*kuffar*” (jobesimtarë, i pafe; tipari dallues etnik i të cilëve është i parëndësishëm). Kështu, në këtë rast, ne ndeshim edhe fjalinë (kur u morën anijet): “përveç atyre që ranë në luftë, dolën dhe 2700 *kafirë*.” Për

Muslimanët, që qëndruan në Andaluzi nën sundimin spanjoll, u lejuan fillimisht të praktikonin adhurimin e tyre, por më pas **Karli V** (1519-1558) e ndaloi rreptësisht këtë dhe i torturonte ata. Për këtë arsye, ata u larguan për t'u strehuar nëpër male dhe iu drejtuan **Hajreddin Beut** të Algjerisë, duke i kërkuar atij të ndërhynte për t'i shpëtuar. Hajreddin Beu dërgoi **36 anije** që iu shkaktuan disfatë spanjollëve dhe i morën muslimanët në bordin e tyre. 1.000 luftëtarë gazinj qëndruan roje dhe anijet ndërmorën shtatë udhëtime për të marrë rreth **70.000 mudexhhelë** (muslimanë andaluzianë), që i transportuan në provincën e Xhezairit. Për këtë arsye, pjesa më e madhe e popullit të Algjerisë duket se është me prejardhje andaluziane.¹⁵⁸

Me ftesë të **Sulltan Sylejmanit të Madhërishtëm**, Hajreddin Beu shkoi në Stamboll në vitin 940/1533 ku dhe paraqiti shërbimin e tij ndaj osmanëve. Ai u emërua **Bejlerbej** i provincës së **Xhezairit** (Algjerisë) dhe **Kaptan i Gelibollut**.¹⁵⁹ Gjatë rrugës së tij të kthimit nga Stambolli, ai sulmoi brigjet e Italisë.

Ndërkohë midis sulltanit hafsi, Hasanit të Tunizisë dhe vëllait të tij Rashidit kishte filluar lufta për pushtet.¹⁶⁰ **Karli V**

të bërë një përshkrim të strukturës sociale të Venedikut, që kishte qenë një superfuqi detare e botës së krishterë, gjatë shekullit të 16-të, Katib Çelebi shpjegon se **Doxhi** ishte kreu i Patriakatit etj; do të thotë **Dukë**: për të krishterët është e barabartë me rangun e **Bejlerbeut musliman**. Pra, për sa i përket osmanëve, kuadrove të tyre drejtues, intelektualëve dhe popullit musliman, ishin **dy botë të ndryshme**, *Nesarët* (të krishterët) dhe muslimanët. Është një fakt domethënës që një intelektual i madh, siç ishte **Katib Çelebi**, t'i referohet rangut të **Bejlerbeut** si një rang musliman dhe jo si një **rang turk**, për arsyen e thjeshtë që **nacionalizmi**, si një ide apo një lëvizje politike, **nuk ekzistonte** në atë kohë, dhe se turqit osmanë ishin përfaqësues të Islamit.

158 Katib Çelebi, *Tuhfetu'l Kibar*, fq. 40.

159 OT, II, fq. 372.

160 Sulltani hafsi Ebu Abdil-lah Muhammed vdiq në vitin 1525 dhe vendin e tij e zuri i biri, Hasani. Ai vrau 42 vëllezër nga 44 që kishte. Rashidi dhe Abdulmu'mini u arratisën dhe u fshehën te beduinët (nomadët). Hasani bënte një jetë shumë të shthurur, kështu që populli i Tunizisë e thirrte Rashidin, por Hasani u lajmërua për këtë dhe u përpoq ta kapte Rashidin. Ky i fundit u strehua nga Hëzër Hajreddini në qytetin e Algjerit: *Osmanli Tarih* (OT), II, fq. 372, poshtëshënimi 2.

dhe **Hajreddin Pasha** luftuan për këtë rajon të paqëndrueshëm; i pari dëshironte ta bashkonte me perandorinë e tij gjermano-spanjolle dhe i fundit dëshironte ta bashkonte me Devletin Musliman Osman. Përfundimisht, ishte Hajreddin Pasha ai që arriti ta merrte Tunizinë. Hasani kërkoi ndihmën e **Karlit V**, i cili përgatiti një flotë prej 500 anijesh dhe nën drejtimin e Admiralit të famshëm **Andrea Doria** në vitin 942/1535, mbërriti dhe vetë në Tunizi me një ushtri prej 25.000 luftëtarësh. **Hajreddin Pasha** i qëndroi sulmit për një kohë të gjatë, por nuk arriti të qëndronte gjatë kundër kësaj trupe të fortë dhe u detyrua të tërhiqej nga Tunizia në qytetin e Xhezairit.¹⁶¹ Më pas, ai u nis nga Xhezairi dhe në afërsi të Ishullit Majorka i arriti dhe i kapi anijet spanjolle, që mbanin në bordin e tyre robër muslimanë nga Tunizia. Ai i çliroi muslimanët dhe mbajti të krishterët si të burgosur lufte, dogji anijet e tyre, goditi Ishujt Baleare dhe u kthye në Stamboll.¹⁶²

Sulltan Hasani, që kishte marrë Tunizinë me ndihmën e spanjollëve, u rrëzua nga fronti nga djali i tij Ahmedi, në vitin 947/1540. Spanjollët, që erdhën bashkë me Ahmedin, kryen akte mizorie të çfarëdollojshme në këtë vend. Ata ndërtuan **bastione** në brigjet ku katolikët kishin planifikuar të vendoseshin. Bastioni ishte i fortifikuar mjaft mirë; qëllimi i tyre ishte ta kthenin Tunizinë në një Andaluzi të dytë, në një vend katolik spanjisht-folës, të gjitha këto në kuadrin e veprimtarive të **rikonkuistas**. Por, *muxhahidinët* osmanë u nisën me *Donanma-jë Hymajun* nën komandën e Sinan Pashait, në vitin 982/1574 dhe morën Tunizinë. Ata lanë në këtë vend një forcë prej 4.000 jeniçerësh për të ruajtur rajonin e Tunizisë. Nga viti 999/1591 filloi periudha e *Dajëve* (ose *Dejve*)¹⁶³, ndërsa ata u pasuan nga *Bejtë*, që mblidhnin taksat dy herë në vit.¹⁶⁴

161 OT, II fq. 373.

162 OT, II, fq. 374.

163 Për informacion më të detajuar mbi fillimin e *Dajëve* në Tunizi, shiko: Mehmet Maksudoğlu, "Tunus'ta Dayıların Çıkışı", *Ankara Üniversitesi*

Papa Pali III po përpiquej shumë që të arrinte paqen midis fuqive krisitiane dhe t'i bashkonte kundër fuqisë kryesore muslimane, osmanëve. Ai arriti të lidhte një marrëveshje 10-vjeçare midis **Fransuasë** dhe **Karlit V**, dhe i drejtoi ata kundër Devletit Osman. Edhe Republika e Venedikut u bashkua në këtë aleancë.¹⁶⁵

Ndërkohë që **Hëzër Hajreddin Pasha** ndodhej në Prevezë si *Kapudan-ë Derja* (Komandanti suprem i *Donanma-jë Hymajun*),¹⁶⁶ ai u bllokua nga flota aleate e krishterë, që ishte e përbërë nga flotat detare të **Papatit**, **Portugalisë**, **Spanjës**, **Venedikut**, **Gjenovës**, **Maltës** dhe fuqive të tjera evropiane. Flota e krishterë ishte e përbërë nga 302 anije, 60.000 ushtarë dhe ishte e armatosur me 2.500 armë zjarri, ndërsa flota muslimane kishte 122 anije, 8.000 *muxhahidinë* dhe 166 armë zjarri. Anijet e flotës muslimane u pozicionuan në formën e një gjysmëhëne. Në qendër të tyre qëndronte **Hëzër Hajreddin Pasha**, në krahun e djathtë **Salih Reisi** dhe në krahun e majtë **Sejdi Ali Reisi**. Prapa tyre qëndronin *gazinjtë* vullnetarë, nën komandën e **Turgut Reisit**. Flota e krishterë ishte nën komandën e **Andrea Dorias**, nën komandën e të cilit ishin edhe Admirali **Vinsent Kapello (Vincent Capello)** i flotës venedikase dhe Admirali **Marko Grimani** i flotës së Papatit. Flota e krishterë u pozicionua në tre linja, duke i kthyer pjesët e saj anësore drejt *Donanma-jë Hymajun*, në mënyrë që të gjuanin me armë zjarri drejt saj. Linja e parë ishte e përbërë nga luftanije të mëdha, që krijonte një front mbrojtës. Fakti që flota e krishterë ia kalonte flotës muslimane në numrin e anijeve, luftëtarëve dhe armëve të zjarrit, por që zgjodhi luftën mbrojtëse, tregon frikën e Andrea Dorias nga Hëzër Hajreddini.

Ilahiyat Fakültesi Dergisi, 1967, XIV, fq. 189-202. (në gjuhën arabe: *Zuhuru Dayat bi'l Kutri't Tunisi*).

164 Për informacion më të detajuar për transferimin e pushtetit nga *Dajët te Bejëti*, shiko: Mehmet Maksudoğlu, "Tunus'ta Hakimiyyetin Dayılardan Beylere Geçiş", *Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 1968, XV, fq. 173-186.

165 OT, II, fq. 374.

166 Donanma-ja Hymajun: Flota Osmane.

Hëzër Hajreddin Pasha e përçau flotën e bashkuar të krishterë dhe i çorientoi manovrimet e tyre duke bërë që anijet e krishtera të ishin të paafta për të komunikuar ndërmjet tyre. Flota e krishterë pësoi një disfatë kaq të madhe, sa që Andrea Doria dha urdhrin që dritat të fikeshin dhe u tërhoq i turpëruar. Në të vërtetë, në atë kohë, ky ishte një veprim i turpshëm dhe çnderues, që një admiral të sillej në këtë mënyrë për arsyen e vetme që të shpëtonte jetën. Me fundin e **Betejës së Prevezës** më 3 Xhumade'1 Ula 945/28 shtator 1538, osmanët përfundimisht u njohën si superfuqi detare në Mesdhe.¹⁶⁷ Në këtë betejë detare, komandantët e flotës vullnetare **Turgut Reisi, Murad Reisi, Salih Reisi**, Kaptan **Gyzelxhe** fituan një famë të madhe.¹⁶⁸

Në vitin 948/1541, **Karli V** sulmoi Xhezairin, me një ushtri shumë të madhe. Ata kishin marrë madje dhe shumë kuaj në bordin e anijeve të tyre.¹⁶⁹ Por, **Hasan Pasha**, djali i adoptuar i Hëzër Hajreddin Pashait, i shkaktoi disfatë **Karlit V**.¹⁷⁰ Së bashku me **Karlin V** ishin dhe ushtarë të Papatit, dhe kalorësit e Maltës (që më parë kishin qenë Kalorës të Rodosit). **Hernando Kortezi**, që kishte pushtuar Meksikën dhe kishte nënshtruar popullin në mënyrë të pamëshirshme, ishte gjithashtu një nga luftëtarët e flotës që u shkatërrua, që për pak i shpëtoi vdekjes. Flota spanjolle humbi 160 anije në këtë aventurë.¹⁷¹

Përderisa osmanët kishin mbështetur Francën kundër **Karlit V**, Hajreddin Pasha në pranverën e vitit 950/1543 u nis

167 Yılmaz Öztuna, *vepër e cituar*, I, fq. 295-296. Duhet të theksojmë këtu se në një libër të autorëve evropianë, beteja shumë e rëndësishme dhe kritike e Prevezës ose nuk përmendet (sikur të mos kishte ndodhur), ose është nënvlerësuar si e tillë. Shiko për shembull: Lord Kinross, fq. 226 dhe Dorothy M. Vaughan, *Europe and the Turk, A Pattern of Alliances 1350-1700*, Liverpool: 1954, fq. 124. Nga ana tjetër, ata e shtjellojnë disfatën e osmanëve nga të krishterët në Lepanto në vitin 1571.

168 *OT*, II, fq. 377-379.

169 Lütfi Paşa, *vepër e cituar*, fq. 392-395.

170 *OT*, II, fq. 398.

171 *OT*, II, fq. 380.

drejt Mesdheut me 115 anije; ambasadori francez **Polen de Lagard** ishte në bordin e anijes së tij. Kur flota mbërriti në **Rekio (Rechio)** pranë Napolit, asaj iu bashkua flota e Xhezairit me 41 anijet e saj. Ata morën Rekion dhe disa vende të tjera, dhe *Donanma-jë Hymajun* arriti në **Ostia**, port i **Romës**. Banorët atje u habitën, por edhe u siguruan. **Ushtarët muslimanë paguanin me çmim të plotë çfarëdolloj gjëje që blinin në qytetet bregdetare.** *Donanma-jë Hymajunit* iu bashkuan edhe anijet e Francës në Marsejë. Ata iu drejtuan së bashku Nicës, që ishte marrë nga **Duka i Savojës**, një aleat i **Karlit V** dhe arritën ta rimerrnin qytetin në 950/20 gusht 1543. Ndërkohë që vazhdonte rrethimi i kështjellës së brendshme të Nicës, artileria franceze pushoi zjarrin sepse u kishte mbaruar baruti. **Hëzër Hajreddin Pasha** e komentoi këtë veprim me sarkazëm: “Sa luftëtarë të këndshëm! Ata i mbushin anijet e tyre me verë dhe nuk harrojnë asgjë tjetër përveç barutit!” Më pas, ai iu kthye ambasadorit francez duke e qortuar: “Po bëje shaka kur na the në Stamboll se shteti juaj kishte bërë shumë përgatitje?”¹⁷²

Flota muslimane mbërriti në Tulon, ku do të kalonte dimrin dhe Hajreddin Pasha dërgoi lajmëtarët e tij në Gjenovë, për të bërë marrëveshje për çlirimin e Turgut Reisit, që kishte qenë i burgosur lufte atje për 3 vjet. Pasi ky i fundit u lirua, Hajreddin Pasha në shenjë vlerësimi për këtë admiral të madh, tha: “Turguti është më i mirë se unë”. Hajreddin Pasha vdiq në vitin 953/1546 dhe u varros në bregun e Beshiktashit, në Stamboll.

172 OT, II, fq. 382.



Tyrbeja e Hëzër Hajreddin Pashait, Beshiktash, Stamboll

Turgut Reisi, djali i një fshatari të quajtur Veli, kishte lindur në Menteshë në Anadoll. Ai ishte *gazi* detar vullnetar.¹⁷³ Më pas, u ngrit në detyrë dhe mori titullin *reis*. Ai e ktheu Mehdijen, që shtrihej në bregdetin afrikan, në bazën e tij detare për operacionet kundër fuqive jomuslimane dhe e hapi Tripolin (në Libinë e sotme) ndaj Islamit në vitin 958/1551, duke ua marrë atë piratëve të quajtur Kalorës të Shën Xhonit. Turgut Reisi iu bashkua Devletit Osman dhe u emërua Sanxhakbej i Karlielisë,¹⁷⁴ dhe shkoi në Prevezë, qendrën e sanxhakut të tij. Ai i shkaktoi një disfatë tjetër Admiralit të famshëm Andrea Doria në **Ponza** në vitin 959/1552.¹⁷⁵ Në mbështetje të francezëve kundër **Karlit V**, Turgut Reisi zbarkoi në Ishullin e Korsikës, që ishte nën zotërimin e Gjenovës, aleates së **Karlit V**, dhe si

173 Solakzade, *Tarih*, fq. 540.

174 Po aty, fq. 540; *OT*, II, fq. 386.

175 *OT*, II, fq. 386. Kjo disfatë e admiralit të famshëm i krishterë nuk përmendet në librin e Lord Kinross.

shkatërroi forcat armike që kishin ardhur në ndihmë të ishullit, mori kështjellën e fortifikuar të tij në 7 Ramazan 960/17 gusht 1553.¹⁷⁶

Më pas, në vitin 961/1554 **Turgut Pasha** mori titullin Bejler-bej i Trablusgarbit (Tripolit)¹⁷⁷ dhe bëri përpjekje të rimerrte Ishullin e Xherbas nga spanjollët. Një flotë aleate e krishterë me 200 anije nën komandën e **Andrea Dorias**, u përpoq të sfidonte pozitën e osmanëve në këtë ishull, por Devleti Osman dërgoi **Pijale Pashanë** në krye të 200 anijeve dhe u zhvillua **Beteja e famshme e Xherbas**. Në këtë betejë, muslimanët i shkaktuan një goditje të rëndë flotës së krishterë. **Andrea Doria** u arratis me vetëm 7 anije. Ishulli i Xherbas u rihap ndaj Islamit dhe **Turgut Pasha** u caktua në drejtimin e tij si guvernator, duke e përdorur këtë vend edhe si bazë detare.¹⁷⁸ Kështjella e Xherbas u mor më 7 Dhulka'de 967/30 korrik 1560.¹⁷⁹

Në vitin 972/1565 *Donanma-jë Hymajun* bllokoi ishullin e Maltës, bazën e piratëve të ashtuquajtur Kalorës të Shën Xhonit dhe rrethuan kështjellën e dytë atje. Pas mbërritjes së tij, **Turgut Pasha** zgjodhi të rrethonte kështjellën e parë, por ra martir gjatë betejës¹⁸⁰ dhe u varros në Tripoli pranë xhamisë dhe medresesë së tij.¹⁸¹

Veprimtaria osmane në Oqeanin Indian

Pas zbulimit të Kepit të Shpresës së Mirë nga **Vasko de Gama** në vitin 1498, portugezët zotëruan Oqeanin Indian dhe lundruan drejt Indisë dhe Lindjes së Largët nëpërmjet kësaj rruge të re. Në atë kohë, portugezët kishin marrë disa qytetet strategjike në brigjet e Detit të Kuq, përballë Oqeanit Indian dhe për pasojë, u përballën me osmanët në Basra, Hixhaz dhe

176 Danişmend, II, fq. 277.

177 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 541.

178 OT, II, fq. 388.

179 Danişmend, II, fq. 320.

180 Solakzade, fq. 570.

181 OT, II, fq. 389-390.

Jemen. **Bahadur Shahu**, Sulltani i Guxharatit në Indinë nënkontinentale, iu drejtua sulltanit osman në vitin 942/1535 për ndihmë kundër portugezëve.¹⁸² Devleti Osman përgatiti një flotë në portin e Suvejshtit (Suezit) nën komandën e **Sylejman Pashait**, që pasi mori Adenin në Jemen,¹⁸³ mbërriti në ishullin Diu në vitin 944/1537. Por, ai nuk mundi ta merrte këtë ishull dhe u rikthye në Jemen, pasi portugezët kishin vrarë **Bahadur Shahun** dhe djalin e tij. **Mahmud Shahu** lidhi aleancë me ta. Pas kthimit të Sylejman Pashait në Egjipt, portugezët hynë në rajonin e Detit të Kuq dhe u përpoqën të merrnin Xhiddën!¹⁸⁴ Por falë qëndresës guximtare të komandantit të kështjellës dhe ardhjes në kohë të Emirit të Mekës, **Sherif Numejit**, ata u sprapsën. Nëse portugezët do të kishin marrë Xhiddën, ata me gjasë do të kishin marshuar drejt Mekës dhe do të kishin kërcënuar Vendet e Shenjta. **Suksesi i osmanëve për ta ndaluar këtë rrezik është një fakt i mjaftueshëm për të justifikuar prezencën e tyre në Hixhaz dhe në Jemen.** Kjo fuqi e madhe muslimane nuk qëndronte atje për shkak të naftës, që do të zbulohej më vonë në shekullin e 20-të apo për ndonjë lloj tjetër përfitimi, por për të mbrojtur **el-Haramejn esh-Sherifejn** kundër sulmeve pushtuese të portugezëve në shekullin e 16-të dhe veprimtarive të tjera të të krishterëve evropianë imperialistë në ato zona. Portugezët u përpoqën ta digjinin pa sukses flotën osmane në Suez, edhe pse arritën të digjinin qytezën **Tur Sina** në vitin 950/1543.¹⁸⁵ Faktikisht, portugezët dhe spanjollët ishin

182 OT, II, fq. 392.

183 Solakzade, *Tarih*, fq. 500.

184 Lütfi Paşa, *Tevarih-i Al-i Osman*, fq. 420-422.

185 OT, II, fq. 397.

Prania osmane në Gadishullin Arabik ishte për mbrojtjen e Vendeve të Shenjta të Islamit. Për këtë arsye ishte e rëndësishme që osmanët të kontrollonin **Babul Mendebin**, për të parandaluar hyrjen e fuqive të krishtera evropiane në rajonin e Detit të Kuq. Nga ana tjetër, motivi i evropianëve ishte shfrytëzimi apo përfitimi. Për shembull, Kompania e Indisë Lindore e Çajit vepronte nën ndikimin e politikës britanike në Lindje. India ishte një vend i pasur në vitin 1858, kur britanikët e pushtuan atë. Ajo që ka ndodhur me Indinë pas sundimit britanik është e dukshme

dy superfuqi të krishtera në shekullin e 16-të. Për këtë arsye, **Papa e ndau botën midis këtyre dy fuqive të krishtera! Një shembull i mirë dhe tregues i këtij fakti është Amerika Jugore: Brazili flet portugalisht dhe gjithë pjesa tjetër flet spanjisht, dhe janë bërë Amerika Latine!** Devleti Osman luftoi kundër këtyre fuqive të krishtera nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, u detyrua të përballej dhe me Iranin që godiste nga pas.

Portugezët që e kishin konvertuar Oqeanin Indian në “oqean portugez”, pushtuan Adenin, por admirali osman i Suezit, **Piri Reisi** (1465-1554), e rimori qytezën dhe avancoi me një forcë detare prej 30 anijesh për të marrë Muskatën në vitin 1503-1504, që e realizoi pas një beteje të ashpër kundër portugezëve gjatë së cilës u përfshinë 70 prej anijeve të tyre. Portugezët u larguan drejt kështjellës së Hormuzit, të cilën Piri Reisi nuk arriti ta merrte dhe më pas shkoi në Basra. Pasi mësoi se qëllimi i portugezëve ishte të bllokoni Gjirin e Basras, në vitin 1508, Piri Reis u largua nga Suezit me tre anije dhe prej aty në Kajro. Megjithatë, ai u ndëshkua pasi nuk e vazhdoi rrethimin e Hormuzit dhe u largua nga Basra, duke lënë pas disa anije dhe ushtarë.¹⁸⁶ Devleti Osman e kishte për zakon t’i shpërblente me bujari sukseset, por në të njëjtën kohë i ndëshkonte rreptësisht dështimet edhe të zyrtarëve të lartë, shenjë kjo e një administrate të shëndetshme. Piri Reisi ishte një nga admiralët më të mirë të kohës dhe harta e tij që në vitin 1513 tregonte kontinentin e Amerikës. Abbas Hamdani shkruan: “E gjithë kjo tregon se otomanët edhe pse në periudhën e hershme, ishin të vetëdijshëm dhe të interesuar për zbulimin e Botës së Re, që në hartën e Piri Reisit ishte e shënuar me emrin “*Vilajet Antilia*”. Termi *vilajet* zakonisht i referohej njësisë administrative të

edhe në ditët e sotme; varfëria e këtij vendi është shembull tregues i sjelljes britanike. Duhet të theksojmë se nuk ka pasur ndonjë entitet të tillë si “Kompania osmano-jemenite e Kafes”. Për këtë arsye, historianët perëndimorë nuk duhet ta shikojnë shtrirjen osmane, si të ngjashme apo të njëjtë me veprimtaritë e tyre imperialiste.

186 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 534.

Perandorisë Otomane.¹⁸⁷ Pasi otomanët ishin të angazhuar në kundër-kryqëzatë në Oqeanin Indian dhe Detin Mesdhe, kundër atyre fuqive të mëdha që kishin zbuluar toka të reja, ata u shfaqën të gatshëm t'i ndiqnin armiqtë e tyre në Atlantik dhe ndoshta edhe përgjatë tij. Do të pohoja se interesat e otomanëve në Afrikën e Veriut dhe lëvizja e tyre e dëshpëruar drejt brigjeve perëndimore të Magribit janë vetë treguese të qëllimeve të Portës.¹⁸⁸ Nëse otomanët nuk mbërritën deri në Amerikë, kjo ndodhi pasi ata nuk arritën të merrnin brigjet e Atlantikut."¹⁸⁹

Pas Piri Reisit ishte **Murad Reisi**, ish-gubernator i Katifit, ai që do të emërohej si *Kapudan* i Suezit. Ai la Basran dhe luftoi kundër një flote të madhe portugeze jashtë Hormuzit. Por, ai u detyrua të kthehej në Basra,¹⁹⁰ pasi anijet portugeze ishin të projektuara për të lundruar në oqeanë dhe për këtë arsye ishin shumë më të mëdha dhe më të forta, kështu që flota osmane nuk mund të arrinte të përballej me to. Megjithatë, osmanët vazhduan të luftonin kundër portugezëve sa herë që gjenin një rast të volitshëm.

"Nga viti 1557 deri në 1562, turqit nga Suakini ndërmorën sulme të ndryshme në Abisini. Në vitin 1557, i gjithë komunikimi midis Etiopisë dhe Indisë u ndërpre."¹⁹¹

Sejdi Ali Reisi (v.1562), i cili u emërua si *Kapudan* (Admiral) i Suezit, lundroi në vitin 1554 me 15 anije nga Basra dhe u ndesh gjatë rrugës me një flotë portugeze prej 25 anijesh. Ai e mundi këtë flotë dhe mori 4 nga anijet e tyre. Ai, gjithashtu, shkatërroi një anije portugeze dhe disa anije të tjera u fundosën gjatë një beteje në Muskat, kurse pjesa tjetër u largua

187 Studiuesi, në mënyrë të pakujdesshme, përdor këtë fjalë shpifëse (perandori) dhe formën e shtrembëruar (Otomane), për të përshkruar Devletin Osman sipas shprehisë evropiane.

188 Porta (Sublime) (Bab-ë Ali) u përdor nga administrata osmane në shekujt e mëvonshëm. Gjatë shekullit të 16-të, i referohej si *Divan-ë Hymajun* (Divani Qiellor).

189 Abbas Hamdani, *vepër e cituar*, fq. 329.

190 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 534-535.

191 Stripling, *vepër e cituar*, fq. 97.

në errësirën e natës. **Sulltan Xhelalu'd Din Dinari** erdhi në ndihmë të muslimanëve kundër portugezëve.¹⁹²

Ndërkohë një stuhi e shtyu **Sejdi Ali Reisin** drejt Indisë, ku ai ia dorëzoi armët dhe pajimet e tjera të luftës guvernatorit të Suratit, **Rexheb Hanit**, nën sundimin e Sulltanit të Guxharatit. Për tre muaj, Sejdi Ali Reisi ishte i ftuar i Padishahut të Indisë, **Hymajunit**.¹⁹³ Ai i la pas ushtarët osmanë, të cilët preferuan të qëndronin në Indi dhe u kthye në Stamboll në vitin 963/1556, së bashku me 50 miq, pas një udhëtimi që zgjati 3 vjet.¹⁹⁴ Ai ia dhuroi librin e tij *Mir'atu'l Memalik* (Pasqyrë e vendeve) Sulltan Sylejmanit. Në këtë libër përshkruhej edhe udhëtimi i tij.

Ndërkohë, në vitin 972/1565, **Sulltani Alau'd Din** i Açehut, Sumatrës dhe Malakës i kërkoi sulltanit osman ndihmë kundër portugezëve. Ai i dërgoi Sulltanit të Açehut pajime dhe një grup specialistësh për ndërtim anijesh dhe farkëtim armësh. **Kurdogllu Hëzër Reisi**, i cili u emërua *Kapudan* i Suezit, do të ishte nisur drejt Lindjes, nëse Imam Mutahheri i sektit Zejdi, nuk do të kishte ngritur krye në Jemen, duke tërhequr vëmendjen e tij në këtë vend. Specialistët dhe pajimet e luftës i arritën Sulltanit të Açehut me dy anije dhe një pjesë e madhe e njerëzve vendosi të qëndronte në këtë vend me vëllezërit e tyre muslimanë. Kjo tregon lidhjen e fortë vëllazërore midis muslimanëve në atë kohë, që është shprehur me parimin islam: “Vendi i një muslimani është atje ku është Islami”, dhe në Kur’anin Fisnik “Besimtarët janë Vëllezër” [*el-Huxhurat*, 10]. Këta marinarë osmanë, të cilët lanë të afërmit dhe trojet e tyre, dhe vendosën të qëndronin përgjithmonë me njerëz që i takonin për herë të parë, duhet të jenë ndërjerë sikur të ishin mes vëllezërve të tyre.

“Kundër-kryqëzata kundër Malakës portugeze ishte një pasojë e natyrshme nga prejardhja e Açehas. Prej 120 vitesh, ky

192 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 536.

193 Solakzade, fq. 537.

194 OT, II, fq. 399.

shtet lidhi besimin dhe patriotizmin në mënyrë më të ngushtë se kudo tjetër në Indonezi, dhe krijoi për Açeun kontakte edhe më të ngushta me Azinë Perëndimore. Sulltani Ala'ed-din Riajet Shah el-Kahar (1537-1571) ndërmori hapin formal të nënshtrimit ndaj sulltanit turk, në këmbim të ndihmës së tij ushtarake kundër portugezëve. Kujtimi i kësaj lidhjeje afatshkurtër u mbajt i gjallë në Açe, nga Flamuri i kuq otoman, variante të ndryshme të të cilit u përdorën nga sulltanët, si dhe prej topit të madh lada sexhupak, që ruante dalamin (murin mbretëror) në qytetin Banda, në Açe.

Këto u dhuruan si nderim nga Halifi, në shenjë të mbrojtjes prej tij, për vasalët e tij më të largët.¹⁹⁵



Hëzër Hajreddin Pashai dhe marinarët e tij

195 Anthony Reid, *The Contest of North Sumatra, Atjeh, the Netherlands and Britain 1858-1898*, Oxford University Press, Universiteti Malaya Press 1969, fq. 2-3.

Xhiahadi ndaj Sigetvarit

Kështjella e Sigetvarit, që ishte në kufi me territorin musliman, ishte një burim i vazhdueshëm shqetësimi për ta.¹⁹⁶ Halifi-Sulltan tashmë ishte në moshë të thyer dhe kjo nxiti Austrinë që t'ia vononte Devletit Osman tagrën e saj vjetore. Edhe pse ishte i dobët nga shëndeti, **Sylejmani i Madhërishëm** vendosi të nisej për xhihad kundër perandorisë së madhe të krishterë. Teksa po nisej nga Stambolli, populli u lut: “O Allah! Ndihmoje sulltanin e Islamit dhe mbështeti muslimanët.” Ushtria muslimane rrethoi kështjellën e fortifikuar mirë të Sigetvarit, ku mbrojtësit e saj kishin siguruar një sasi të madhe municionesh dhe mallrash. Megjithatë, ushtria muslimane arriti të përvetësonte pjesën e jashtme të kështjellës në pak ditë dhe i vuri zjarrin pjesës së brendshme të saj. **Gjenerali** kroat, **Ruzunxhuk**, u përpoq të arratisë, por në përpjekje e sipër mbeti i vvarë. Muslimanët e hapën Sigetvarin ndaj Islamit duke thirrur: “**Nasrun min Allah ve Fet’hun Karib**”.¹⁹⁷ (Ndihma nga Allahu dhe një Fitore e menjëhershme).

Por gjatë rrethimit të kështjellës në vitin 974/1566, Halif-Sulltani ndërroi jetë¹⁹⁸ dhe shehzade Selimi, Sanxhakbeu i Kytahjas, mori vendin e tij si sulltani osman.¹⁹⁹

Në këtë rast u tha:

Shejd-i rah-ë Hakk Sulltan Sylejman

Martiri për çështjen e Hakkut (Allahut), Sulltan Sylejmani.

Vlerat numerike të germave (974) në këtë rresht tregojnë datën kur sulltani ndërroi jetë (sipas kalendarit që bazohet në Hixhretin islam).

Meqë ra fjala, Sulltan Sylejmani i Madhërishëm ishte një poet që njihej me pseudonimin “Muhibbi”. Rreshtat e më-

196 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 571.

197 *Kur’an, es-Saff*. 10.

198 Selaniki Mustafa Efendi, *Tarih-i Selaniki*, (red. nga Mehmet İpsirli), Stambolli: 1989, fq. 39.

199 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, II, fq. 575.

poshtëm janë disa nga vargjet e tij më të famshme që janë mbajtur mend ndër shekuj nga shumë njerëz:

Hallk içinde muteber bir nesne yok Devlet gibi

Ollmaja Devlet xihanda bir nefes sihat gibi.

Nuk ka gjë tjetër me kaq vlerë ndër popuj veç Devletit,

Dhe nuk mund të ketë një Devlet në këtë botë vetëm se një frymëmarrje e shëndetshme.²⁰⁰

Sulltan Sylejmani ishte i njohur për shkëlqimin dhe madhësitinë e tij. Është evidentuar se kur ishte në moshë të vogël ai vizitoi babain e tij, Selimin me një veshje zbukuruese dhe rrëzëllitëse. Babai i tij, Selimi kishte reaguar me sarkazëm: “O Sylejman, je veshur me gjithë këto gjëra të bukura! Çfarë do të veshë nëna jote (çfarë i ke lënë asaj për të veshur)?”. Kjo joshje vazhdoi gjatë periudhës së Selimit II dhe arriti kulminacionin në periudhën e sundimit të Muradit III. Detyra e vezirëve ishte të ndihmonin sulltanin nën supervizimin dhe drejtimin e Vezir-i A’zamt. Sylejmani i Madhërishëm e ngriti Ibrahim Again, që nuk kishte shumë përvojë në rangun e Vezirit të Madh dhe i dha atij edhe fuqinë e një autoriteti pothuajse të pakufizuar.

Nga fundi i sulltanatit të tij, ai ia besoi të gjitha çështjet e rëndësishme të Devletit Sadrazamt (Vezir-i A’zam), **Rustem Pashait** (1555-1561). Pasuesi i tij, **Selimi II**, e konfirmoi **Sokollu Mehmed Pashanë** (1565-1579), si sadrazam dhe i dha liri të plotë veprimi. Por me vdekjen e Sokollu Mehmetit, mënyra dhe procedura e emërimit në këtë post ndryshoi shumë. Vezirët futeshin në garë për këtë titull duke u paraqitur përpara sulltanit, familjes dhe miqve të tij më të afërt me dhurata të çmuara. Kjo solli krijimin e intrigave, një gjendje e paqëndrueshme dhe shkeljen e rregullit të vazhdimësisë hierarkike që e dëmtoi së tepërmi Devletin.²⁰¹ **Shmangia e Sylejmanit të Madhërishëm nga metoda tradicionale për emërimin e Vezir-i A’zamt rezultoi veçanërisht e dëmshme për strukturën e Devletit.**

200 *Devlet* në gjuhën osmanishte turke do të thotë pavarësi, përparim, fuqizim, mirëqenie dhe lumturi.

201 Netajixh, I, fq. 116.

KAPITULLI 8

FILLIMI I DOBËSIMIT

8.1 Selimi II 1566-1574

Selimi II shkoi në Stamboll dhe prej aty në Beograd, ku takoi *Ordu-ju Hymajunin* (Ushtrinë Qiellore), ku bëri dhe *bej'atin* (betimin për besnikëri), nëpërmjet të cilit ai u njoh zyrtarisht si Halifi-Sulltani Osman në vitin 1566. Ndërkohë që babai i tij, Sulltan Sylejmani, ishte nisur drejt Sigetvarit, kishte dërguar në Mesdhe në vitin 1566 Kapdan-ë Derjanë, **Pijale Pashanë**, në krye të *Donanma-jë Hymajunit* (Flotës Qiellore Detare). **Pijale Pasha**i hapi ndaj Islamit ishullin Sakëz që e mori nga 12 fisnikë gjenovas, të cilët nuk kishin arritur të paguanin tre vitet e fundit në afatin e caktuar tagrën që iu detyroheshin osmanëve²⁰² dhe që kishin mbështetur Kalorësit e Shën Xhonit gjatë rrethimit të Maltës.²⁰³ **Selimi II** konsolidoi pozitën e tij dhe në Stamboll u mblodhën për të uruar sulltanin e ri, të dërguar të vendeve të ndryshme, midis të cilëve ishte dhe ambasadori i Mbretit të Austrisë. Gjithashtu, u rinovua dhe traktati i paqes që ishte lidhur me Austrinë gjatë fushatës së Sigetvarit.²⁰⁴

202 BOA, *Mühimme Defteri* 5, fq. 543; Katib Çelebi, *vepër e cituar*, fq. 81.

203 İ.H. Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 6.

204 Netajixh, I, fq. 98.

Përpjekja për ndërtimin e Kanalit të Vollgës 1569

Ivani i Tmerrshëm i Moskës pushtoi Kazanin në vitin 1552. Turqit e këtij vendi iu drejtuan qeverisë osmane për të kërkuar ndihmën e tyre, në ndërtimin e një kanali në pikën më të afërt (11.5 km) midis lumenjve Ten (Don) dhe Itil (Vollga), që derdheshin në Detin e Zi dhe Detin Hazar (Kaspik).

Sadrazami osman Sokollu, emëroi Kasim Pashanë si Bejler-beun e Kefes dhe e instrukttoi atë që të ndërmernte projektin në fjalë.²⁰⁵

D.E. Piçer (Pitcher) ka shkruar për këtë projekt si vijon: “Rreth vitit 1560, turqit filluan të kuptonin rrezikun që vinte nga Rusia dhe Sylejmani planifikoi këtë plan të guximshëm për të bashkuar lumin Don me Vollgën nëpërmjet ndërtimit të një kanali. Ky plan u diskutua fillimisht në vitin 1563 dhe Sokollu Mehmedi u përpoq ta zbatonte në vitin 1569. Ishte kjo një skicë e guximshme por jo e pamundur, rezultati i të cilës do të ishte marrja nën kontroll e pjesës së poshtme të Vollgës dhe Kaspikut nga turqit dhe mundësimi i një lidhjeje direkte me armiqtë uzbekë të Persisë në Transaksoni.”²⁰⁶

Ky projekt ambicioz tregoi se osmanët kishin besim të madh në vetvete dhe në burimet e tyre. Për zbatimin i tij ishte e nevojshme të merrej Astrahani, në mënyrë që rusët të mbareshin larg territorit të basenit të poshtëm të lumit Vollga, si dhe pozicionimi i një flote në Kaspik, nëpërmjet rrugës së re detare që do të rrethonte rajonin e Kaukazit dhe në këtë mënyrë Persinë Qendrore. Gjithashtu, duhej të vendoseshin marrëdhëniet e drejtpërdrejta me hanatet e Azisë Qendrore, dhe duhej të ri-gjallëroheshin marrëdhëniet tregtare përgjatë rrugës nga Hvarezm, nëpërmjet Astrahanit drejt Krimesë, që duhej të vendosej nën kontrollin e sigurt osman.²⁰⁷ Osmanët i filluan punimet në këtë vend, por nuk arritën t’i përfundonin.

205 Uzunçarşılı, OT, III, pjesa I, fq. 35.

206 Donald Edgar Pitcher, *vepër e cituar*, fq. 122.

207 Halil İnalçık, *vepër e cituar*, I A, fq. 335.

Fakti që osmanët i kishin filluar gërmimet për ndërtimin e kanalit tregon se kjo zonë ishte nën zotërimin e tyre. Por të gjitha hartat perëndimore e tregojnë kufirin osman të vendosur më në jug të kësaj zone dhe në të njëjtën mënyrë, ata i përjashtojnë edhe territoret e tjera osmane në Gadishullin Arabik dhe Afrikë.

Sadrazami Sokollu zgjodhi një staf të pakualifikuar për këtë detyrë, ndërsa Hani i Krimesë, Devlet Gëraji, nuk ishte entuziast për arsye se kjo do të fuqizonte kontrollin osman mbi zotërimet e tij. E vetëdijshme për rrezikun e mundshëm nga Rusia, administrata osmane i përdorte turqit e Krimesë në një mënyrë shumë të dobishme kundër tyre. Hanët gjysmë të pavarur të Krimesë u bindën nga osmanët për të ngritur krye herë pas here kundër Ruisë. Si kalorës të shkëlqyer dhe mjeshtrë të luftimit, ata e sulmonin Rusinë pothuajse çdo javë, madje edhe gjatë dimrit, duke arritur ta mbanin në gjendje pritjeje ndër shekuj.

Hapja e Qipros ndaj Islamit

Territori Lindor i Mesdheut vazhdonte të ishte nën sovranitetin osman, por Qipro ishte një kërcënim dhe shqetësim i vazhdueshëm për supremacinë osmane. Piratët e Qipros, madje kishin guxuar të grabisnin kuajt që Bejlerbeu i Egjiptit i dërgonte si dhuratë Selimit, që në atë kohë ishte Sanxhakbej i Konjas. Për më tepër, Qipro qëndronte si bllokadë mbi rrugën e pelegrinazhit për në Hixhaz. Llalla Mustafa Pasha dhe Pijale Pasha u dërguan që të merreshin me këtë kërcënim. Ata e hapën kryeqytetin e Qipros, Lefkoshën në vitin 978/1570 ndaj Islamit, ndërkohë që Girne dhe Bafi u dorëzuan. Magoza qëndroi pak më shumë, pasi kishte një kështjellë të fortë, por edhe ajo u hap ndaj Islamit në vitin 979/1571.²⁰⁸ Kjo është përshkruar në një varg si më poshtë vijon:

208 Netajixh, I, fq. 100.

Alldë Këbrës adasën Shah Selim.

Shah Selimi mori Ishullin e Qipros.

Vlerat numerike të germave në këtë rresht tregojnë vitin 978 (1571).

Struktura administrative osmane në Qipro përshkruhet në këtë mënyrë: “Ottomanët e riorganizuan Qipron në përputhje me parimet e tyre standarde. Katolikët latinë që kishin krijuar klasën drejtuese në këtë ishull u eliminuan. U rivendosën privilegjet e dikurshme të Kishës Ortodokse greke së bashku me zotërimet e saj. U morën masa për të fituar popullsinë lokale dhe për zhvillimin e burimeve ekonomike dhe financiare. Ligji, sipas të cilit skllëvërit ishin të detyruar të punonin dy ditë në javë për pronarët e tyre të tokës, u shfuqizua. Një numër i madh emigrantësh turq, 70.000 sipas një përlllogaritje, u sollën me bagëtitë dhe orenditë e tyre nga Anadulli Qendror, sipas sistemit *syrçjyn* të zhvendosjes së detyruar dhe u vendosën në tokat e zbrazëta të Qipros.”²⁰⁹

Disfata e osmanëve në Inebahtë 979/1571

Aneksimi i Qipros nga osmanët nxiti krijimin e aleancës së 12-të të fuqive të krishtera kundër Devleti Osman. Në vitin 979/1571 anijet e Papatit, Spanjës dhe Venedikut u mblodhën nën drejtimin e **Don Huanit**, djalit të paligjshëm të **Karlit V**, dhe u hodhën në sulm kundër flotës osmane në Inebahtë (Lepanto). Marinari me përvojë, **Ulluç Ali Pasha** sugjeroi që flota osmane të mbrohej nën fortifikimin e kështjellës së Inebahtit, por Kaptan-ë Derja, **Myezzinzade Ali Pasha** e kundërshtoi atë dhe sulmoi flotën e bashkuar të krishterë, sipas urdhrave që mori nga Stambolli. Myezzinzade, që ishte një ushtarak trim, por që nuk ishte detar, ra martir gjatë betejës dhe flota osmane pësoi një disfatë të rëndë në vitin 979/1571.

209 Halil Inalcik, “*The Heyday and the Decline of the Ottoman Empire*”, *The Cambridge History of Islam* (Cambridge University Press, 1988, I A, fq. 337.

Megjithatë, nga pozicioni i tij si komandant i krahut të djathtë të flotës osmane, **Ulluç Ali Pasha** sulmoi krahun e majtë të flotës kundërshtare dhe i shkatërroi anijet e tij duke kapur anijen kryesore të Kalorësve të Shën Xhonit. Në këtë mënyrë, ai u ngrit në rangun e Kaptan-ë Derja të flotës osmane dhe u quajt Këllëç (Shpata) Ali Pasha. Evropianët shpresuan se flota, tashmë e paralizuar osmane, nuk do të arrinte të vepronte në mënyrë të suksesshme, të paktën për disa vite në vazhdim, por osmanët ndërtuan më shumë se 200 anije të reja gjatë dimrit dhe një vit më pas flota e tyre detare ishte gati për luftim. Sadrazami osman, Sokollu Mehmet Pasha i tha ambasadorit venedikas, Barbaro: “Siç e shikon, disfata në Lepanto nuk na ka çkurajuar dhe ka një dallim midis humbjes suaj dhe humbjes sonë. Ne morëm nga territori juaj një vend (Qipron), duke ju prerë në këtë mënyrë një krah dhe ju mundët flotën tonë, duke na hequr mjekrën. Ju nuk mund ta zëvendësoni një krah, por mjekra rritet sërish edhe më e dendur.”²¹⁰

Venediku, një nga superfuqitë detare të kohës, kishte braktisur aleatët e saj dhe kishte nënshkruar një traktat paqeje me osmanët, nëpërmjet të cilit ai njihte sovranitetin e osmanëve në Qipro, si dhe kishte pranuar të vazhdonte të paguante një shumë vjetore prej 300.000 monedhash floriri, që i paguanin që nga periudha e **Sylejmanit të Madhërishtëm**.

210 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 23.



Xhamia Selimije, Edrene

Përpyjekja tek Kanali i Suvejshit 980/1572

Osmanët kishin dërguar pajimet e tyre nga Suezit tek Sulltani i Açehtut. Portugezët që kishin marrë kontrollin e Oqeanit Indian, pengonin seriozisht rrugën e pelegrinazhit nga Lindja në Mekë. Si zëdhënës i muslimanëve dhe mbrojtës i Tokës së Shenjtë, Devleti Osman e ndjeu se mënyra më e mirë për të mbrojtur rrugën e Haxhit nga sulmi i portugezëve, do të ishte të hapnin një kanal në Suvejsh që do të lidhte Detin Mesdhe me Detin e Kuq, në mënyrë që të mundësohej kalimi i *Donanma-jë Hymajun* nga Mesdheu në Detin e Kuq, dhe në Oqeanin Indian për të luftuar kundër portugezëve atje. Në vitin 1568, Bejlerbeu i Egjiptit ishte instruktuar të përgatiste një studim fizibiliteti që do të analizonte në mënyrë të veçantë largësinë midis dy deteve, si dhe përshtatshmërinë e tokës për këtë plan. Është e vërtetë që osmanët nuk mundën ta realizonin këtë plan, por vetëm përpyekja e tyre për ta bërë këtë, është një shenjë treguese e qëndrimit të tyre serioz dhe ndjenjës së përgjegjësisë ndaj të gjithë muslimanëve në botë, duke përfshirë

këtu edhe ata që jetonin në Lindjen e Largët. Ndërsa, ndërhyrja e portugezëve në çështjet e vendeve të Lindjes së Largët, ishte e drejtuar kryesisht nga ambicia e tyre për kolonizim. Osmanët dëshironin të zbatonin një nga detyrat më thelbësore të Hilafetit, që në këtë rast ishte siguria për muslimanët e asaj pjese të botës dhe rrugës së tyre të Haxhit nga sulmi i portugezëve.

Aneksimi i Tunizisë

Menjëherë pas lidhjes së traktatit të paqes me Venedikun në vitin 1573, osmanët dërguan Vezirin **Sinan Pasha** (1520?-1596) në Tunizi për të thyer trekëndëshin e krijuar Sicili-Maltë-Tunizi, që ndante Xhezairin nga pjesa tjetër e territorit osman në Lindje. **Don Huani**, admirali i flotës së krishterë në Lepanto, shfrytëzoi mosmarrëveshjet që ishin krijuar midis anëtarëve të familjes sunduese hafsite, duke iu drejtuar me 90 anije brigjeve afrikane, ndërsa Bejlerbeu i Tunizisë,²¹¹ Hajdar Pasha u tërhoq në **Kejravan**. Në vend që të vendoste **Ahmedin** në postin e sovranit të Tunizisë, Don Huani e dërgoi atë dhe familjen e tij në mërgim në Napoli dhe në vitin 1580/1572 vendosi në këtë post vëllain e tij, **Mevlaj Muhammedin**. Ai la në Tunizi një grup ushtarësh spanjollë.²¹² Një forcë e bashkuar muslimane prej 300 anijesh nën komandën e **Vezirit Sinan Pasha, Kaptan-ë Derja Këllëç Ali Pashait** dhe Bejlerbeut të Xhezairit i zoi spanjollët në vitin **982/1574**, duke e shpëtuar në këtë mënyrë Tunizinë nga kolonizimi i Spanjë-Gjermanisë, pra nga perandoria e **Karlit V**, që në atë kohë ishte superfuqia më e madhe e krishterë në botë.²¹³ Nëse Devleti Osman dhe luftëtarët e pavarur vullnetarë gazinj nuk do ta kishin arritur këtë, Afrika e Veriut do të ishte kthyer që në shekullin e 16-të në "Afrikë Latine" duke iu bashkuar "Amerikës Latine". Imperialistët spanjollë dhe portugezë në atë kohë kishin marrë një nismë serioze për të "Latinizuar"

211 BOA, *Mühimme Defteri* 7, fq. 258 (R 975) (1568); Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 33.

212 Po aty, III, pjesa I, fq. 29.

213 Selaniki, *vepër e cituar*, fq. 97; Solakzade, *Tarih*, (Stamboll: 1297) fq. 594.

Amerikën e Jugut (që do të thotë ta katolicizonin dhe të impononin besimin, gjuhën dhe kulturën katolike). Ndërkohë që asnjë nuk i erdhi në ndihmë popullsisë indigjene të Amerikës, popullsia e Afrikës së Veriut pati fatin të kishte ndihmën e osmanëve fisnikë dhe trima. Pra, popullsia muslimane arabe e Afrikës së Veriut iu detyrohet osmanëve për prezencën e saj aq të veçantë. Nëse do të kishte ndodhur e kundërta, Xhezairi, Tunizia dhe Trablusgarbi (Libia) do të kishin ndarë të njëjtin fat me Andaluzinë (Spanja dhe Portugalia). E njëjta gjë vlen dhe për Marokun (Magribin) që shpëtoi me betejën e **Vadi's Sejlit** (986/1578), duke mos iu bashkuar orbitës katolike-portugeze, ashtu si Brazili.

Sulltan Selimi II ndërroi jetë në vitin 972/1574.²¹⁴ Ai ishte djali i Sulltaneshës Hyrrem (Rokselana) dhe ishte sulltani i parë osman që nuk e drejtoi ushtrinë e tij në luftë. Ashtu si gjyshi i tij, Javuzi, Selimi II e adhuronte Edrenenë dhe ndërtoi atje xhaminë e tij të famshme Selimije. Kjo xhami dhe kompleksi i saj (bashkë me kul-lijjen) u ndërtuan nga arkitekti gjeneral **Sinan**. Vërtetë ato janë një kryevepër e arkitekturës osmane.

8.2 Sulltan Muradi III 1574-1595

Shehzade Muradi, Sanxhakbeu i Manisës, mori drejtimin e Sulltanatit dhe Hilafetit osman në Stamboll në vitin 962/1574.²¹⁵

Marrëdhëniet me sulltanatin e Fasit (Magribit)

Sherifët Sa'adi vazhdonin të drejtonin Fasin në bashkëpunim aktiv me Spanjën, por kur kjo e fundit filloi të dobësohej, ata kërkuan miqësinë e portugezëve. Shumë shpejt rivaliteti dhe intrigat u bënë të dukshme midis pjesëtarëve të familjes drejtuese dhe fronti i **Mevlaji Muhammedit** u vu në rrezik nga xhaxhai i tij **Abdulmeliku**. Ai iu drejtua Devletit Osman për

214 Selaniki, *vepër e cituar*, fq. 98.

215 Po aty, fq. 99; Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 597.

ndihmë, ndërkohë që Muhammedi u hodh në duart e **Mbretit Sebastjan** të Portugalisë. Osmanët urdhëruan Bejlerbeun e Algjerisë, **Ramazan Pashanë**, që ta ndihmonte Abdulmelikun, ndërkohë që Mbreti Sebastjan u angazhua personalisht në ndihmë të Mevlaji Muhammedit, dhe mbërriti me një ushtri prej 80.000 luftëtarësh të krishterë të pajisur me 300 armë zjarri. Forcat muslimane osmane së bashku me Abdulmelikun e shkatërruan Sebastjanin në betejën e **Vadi's Sejlit** në vitin **986/1578**.²¹⁶ **Abdulmeliku** u bë sulltan i Magribit, por pak kohë pas kësaj fitoreje ndërroi jetë. Mbreti Sebastjan u mbyt ndërsa largohej nga fusha e betejës. Ai nuk la asnjë pasardhës dhe për këtë arsye vëllai i tij, **Henri** mori fronin e Mbretërisë së Portugalisë, edhe pse në vitin 988/1580 vendin e tij e mori Perandori i Spanjës, **Filipi II**.²¹⁷ Nëse portugezët do t'i kishin mundur Abdulmelikun dhe osmanët, Magribi do të ishte kthyer në një Brazil të dytë, që do të thotë në një vend katolik, folës i gjuhës portugeze.

Nga fundi i shekullit të 16-të, Devleti Osman ishte ende shumë i fuqishëm dhe arrinte të ishte një fuqi detare e përshtatshme për mbrojtjen e territoreve të gjera bregdetare, edhe pse jo aq e përshtatshme për përballje të ardhshme të mundshme kundër spanjollëve dhe portugezëve në Ngushticën e Gjibraltarit. "Spanja dhe Portugalia, nga ana e tyre, u angazhuan në mbrojtjen e perandorisë së tyre të gjerë dhe tregtisë kundër vendeve të reja sfiduese siç ishte Anglia, Holanda dhe Franca. **Prester Xhoni** dhe **Hani i Madh** i kishin shërbyer qëllimit të tyre utopik. **Floriri, skllëvërit dhe erëzat, si dhe kolonizimi i territoreve të zbuluara rishtazi, tashmë ishin më të rëndësishme se kryqëzatat kundër muslimanëve**. Në vitet e krijimit të kompanive të Indisë së Lindjes, përpjekjet për rimëkëmbjen e Jerusalemit, nuk ishin më faktori kryesor motivues në veprimin e tyre politik. Megjithatë, kujtimi i atyre ditëve

216 Netajixh, II, fq. 102-103.

217 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 46-48.

ende mbetet në disa emërtime vendesh në Amerikë si Mata-moros (Shën Xhejmsi, “Vrasësi i Maorëve”).²¹⁸

Lufta me Iranin (Persinë)

Pas vdekjes së Shahut të Iranit, **Tahmasbit**, filloi lufta për pushtet që do të përfundonte me ardhjen në fron të djalit të tij, **Ismailit II**. Duke deklaruar se ishte sunnit, Ismaili vrau një numër të madh shehzadesh dhe fisnikësh shiitë. Megjithatë, **Hudabendit**, shehzades pothuajse të verbër iu fal jeta për arsye mëshire. **Ismaili II** shkeli traktatin e paqes që ishte vendosur midis babait të tij dhe Devletit Osman. Ai siguroi përkrahjen nga disa bejlerë në Anadollin Lindor, por vdiq ose u vra në vitin 985/1577,²¹⁹ dhe periudha e pasuesit të tij ekstravagant, **Hudabende**, u karakterizua nga trazira dhe shqetësime të shumta në Iran. **Hursrev Pasha**, Bejlerbeu osman i Erzurumit, i bëri thirrje Stambollit, se ky ishte një çast i volitshëm për të bërë përpjekje për të aneksuar disa pjesë të Iranit. Në këtë mënyrë, **Llalla Mustafa Pasha** marshoi drejt Iranit në vitin 985/1577, e mposhti ushtrinë iraniane në **Betejën e Çëlldërit** dhe kapi rob një sërë fisnikësh dhe zyrtarësh safevitë.²²⁰ Më pas, në vitin 986/1578, ai përparoi dhe mori Tiflisin (Tbilisin) dhe Shirvanin, ndërkohë që **Ozdemirogllu (Özdemiroğlu) Osman Pasha** mori Dagestanin (Dağistan).²²¹ **Ferhad Pasha** mori Revanin në vitin 991/1583 dhe ushtria osmane vazhdoi fushatën e saj nën drejtimin e Ozdemirogllu Osman Pashait, derisa mori kryeqytetin Tebriz në vitin 922/1584. Ndërkohë që **Abbas Mirza** (sundoi në vitet 1587-1629) mori fronin si Shah, uzbekët sunnitë sulmuan Iranin nga Lindja. Duke u përballur me një sërë disfatash turpëruese, Irani më në fund u detyrua të lidhte një traktat paqeje me Devletin Osman në vitin 998/1590. Sipas Traktatit të Stambollit, Azerbajxhani do të qëndronte nën sundimin osman

218 Abbas Hamdani, *vepër e cituar*, fq. 329-330. Theksimi është shtuar.

219 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 55-56.

220 Solakzade, fq. 599.

221 Netajixh, I, fq. 103-104.

dhe Shahu garantoi se do të ndalte fushatën e abuzimeve, dhe ofendimeve ndaj Hazreti Ebu Bekrit, Hazreti Omerit dhe Hazret Aishes (r. anhum).²²²

Lufta me Austrinë

Në vitin 972/1565, midis Devletit Osman dhe Austrisë u lidh një traktat 8-vjeçar paqeje, i cili përcaktonte mundësinë e rinovimit të tij në të ardhmen. Megjithatë, komandantët kufitarë të të dyja palëve nuk arrinin më të gjenin justifikime për grindjet dhe aktet e tjera armiqësore. Sidoqoftë, në vitin 998/1590, traktati u rinovua për një periudhë tjetër 8-vjeçare, edhe pse Austria nuk pagoi tagrën e detyrueshme dhe nxiti vojvodat e Eflakut dhe Bogdanit të ngriheshin kundër kryezotëve të tyre osmanë. Në shenjë hakmarrje, **Tel-li Hasan Pasha**, vali i Bosnjës sulmoi Austrinë tre herë, por ai dhe shumë nga komandantët, dhe ushtarët e tij trima ranë martirë në vitin 1001/1593, gjatë njërit prej sulmeve (të akënshinjve) ku u shemb një urë.²²³ Pas kësaj tragjedie, osmanët i shpallën luftë Austrisë dhe Sadrazami **Sinan Pasha** arriti disa fitore në këtë fushatë. Pasi kaloi dimrin në Beograd, ai u rinis për luftë një vit më vonë dhe **Gazi Gëraji**, Hani i Krimesë, erdhi së bashku me 40.000 kalorës në mbështetje të tij. Forcat muslimane aneksuan kështjellën Janëkkale²²⁴ (Raab), që ishte ndërtuar midis Budinit (Budapestit) dhe Vjenës duke përfituar edhe një sasi pajimesh si plaçkë luftime. Të përballur me kërcënimin serioz musliman, Perandori i Gjermanisë dhe Austrisë, **Rudolfi II**, Mbreti i Erdelit dhe vojvodët e Eflakut dhe Bogdanit lidhën një traktat kundër osmanëve në vitin 1003/1595. Duke qenë se të dy vojvodët ishin brenda territorit osman, aleanca e tyre me armikun e krishterë, ishte një goditje e rëndë ndaj autoritetit dhe prestigjit të tyre që duhej zgjidhur me ngut. Ndërkohë që, osmanët ishin angazhuar me nënshtrimin e

222 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 63.

223 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 63.

224 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 620.

kryengritjes, austriakët arritën një sërë fitoresh në disa zona të tjera të konfliktit. Vojvoda i Eflakut u mund dhe u detyrua të largohej drejt Erdelit. Në këtë mënyrë, ushtria osmane arriti të aneksonte Bukreshin (Bukureshtin) dhe Trgovishten. Gjatë rrugës së kthimit, Sinan Pasha iu imponoi ushtarakëve të kapur rob, pagesën e taksave që u mblodhën mbi një urë në lumin e Danubit. Vetëm ata që paguanin taksën u lejuan të kalonin lumin në anën jugore. Megjithatë, angazhimi i ushtrisë osmane në këtë fushatë, shkaktoi dobësimin e saj dhe i dha mundësinë **Mihailit** të sulmonte sërish në vitin 1595. Akënxhinjtë, që kishin mbetur në bregun e majtë të lumit, luftuan kundër tij me trimëri, por shumë prej tyre ranë martirë në fushën e betejës, ndërsa ushtria muslimane pësoi dëme të rënda. Kjo goditje e rëndë shkaktoi rënien përfundimtare të Akënxhinjve,²²⁵ ndërkohë që kështjella Estergon u mor nga austriakët.²²⁶

Pak kohë para vdekjes së tij në vitin 1003/1595, **Sulltan Muradi III** organizoi një festë përrallore me rastin e ceremonisë së syneit të djalit të tij, Mehemmedit,²²⁷ që zgjati 40 ditë. Me iniciativën e tij, organizuesit e festës kërkuan që të shpërbleheshin duke u përfshirë në trupën e jeniçerëve, por Jeniçeri Agasë (Kryekomandanti Suprem i kësaj force), **Ferhadi**, nuk pranoi të plotësonte këtë kërkesë qesharake dhe dha dorëheqjen në shenjë proteste. Pasuesi i tij, **Jusufi** u përshtat me këtë kërkesë të paarsyeshme që do të ishte një hap domethënës drejt korrupsionit të organizimit jeniçer. Deri në atë kohë, sulltanët osmanë kishin qenë shumë të kujdesshëm për ta mbajtur këtë forcë të paprekur. Për shembull, Sylejmani i Madhërishëm ishte zemëruar shumë, pasi kishte mësuar se një pjesëtar i kësaj force kishte riparuar një pjesë të frerit të tij prej argjendi, që ishte prishur gjatë xhihadit në Sigetvar, sepse ai nuk mund ta konceptonte faktin që një artizan apo një tregtar, të mund të përfshihej në forcën e tij muxhahide. Për këtë arsye, ai e shkarkoi

225 Na'ima, *Ravzatu'l Husajn fi Hulasati Ahbari'l Haflikejn*, I, fq. 133.

226 Po aty, fq. 134.

227 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 620.

menjëherë këtë të huaj nga forca e tij ushtarake dhe e nxori atë në pension.²²⁸

8.3 Sulltan Mehemmedi III 1595-1603

Me këmbënguljen e jeniçerëve, **Sulltan Mehemmedi III** u nis për luftë në vitin 1004/1596, në krye të Ordu-ju Hymajun. Ai u shoqërua nga **Sa'adeddin Efendiu** (1536-1599), historiani i famshëm dhe autori i veprës *Taxhu't Tevarih* (Kurora e historive), mjeshër i sulltanit dhe i babait të tij, Muradit III.

Hapja e kështjellës Egri (Eğri) ndaj Islamit 1004/1596

Ordu-ju Hymajun arriti në Segedin ku u informua për rrethimin e kështjellës osmane të Hatvanit nga austriakët. Menjëherë u dërgua një forcë ushtarake osmane, por kështjella ra në duart e armikut para arritjes së asaj force. Megjithatë, ushtria osmane rrethoi një kështjellë tjetër, kështjellën e Egrit dhe sulltani, ashtu siç veproi dhe Halifi Omer b. Hattabi, i dha armikut një ultimatum, sipas të cilit ata ose duhet të përqafojnë Islamin, ose duhet të dorëzoheshin dhe të shkonin të qetë kudo që të dëshironin, në të kundërt ata do të përballeshin me luftën.²²⁹ Austriakët vendosën të luftonin dhe ushtria osmane e rimori kështjellën në vitin 1005/1596.²³⁰

Beteja e Haçovës 1005/1596

Kur *Ordu-ju Hymajun* mbërrit në Haçovë, ajo u përball me një forcë të krishterë prej 300.000 luftëtarësh të komanduar nga **Arkiduka Maksimiljani**, vëllai i Perandorit të Gjermanisë dhe Austrisë. Në këtë forcë ishin angazhuar austriakë, hungarezë, spanjollë, çekë, polakë, ushtarakë nga Firenca, Erdeli dhe

228 Netajixh, I, fq. 140-141.

229 Na'ima, *vepër e cituar*, I, fq. 145.

230 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 75.

Papati, dhe kishin në zotërim 100 armë zjarri. Sipas një dëshmitari, historianit të famshëm osman, **Peçuji Ibrahimit**, ushtria osmane përbëhej nga 100.000 luftëtarë.²³¹ Në ditën e dytë të betejës, austriakët ndërmoren një sulm të ashpër kundër qendrës së ushtrisë osmane, duke e vënë atë në pështjellim, duke i shpërndarë ushtarët dhe duke shkaktuar ikjen e shumë jeniçerëve dhe spahive. Ky ishte, për të cituar Na'imën, i njëjti pozicion në të cilin ishin gjendur muslimanët gjatë betejës së Hendekut në vitin 5/672, që në Kur'an përshkruhet në këtë mënyrë: "... zemrat ju erdhën në fyt ..." ²³² [el-Ahzab, 10]. **Sulltan Mehemmedi III** ishte duke kalëruar mbi kalin e tij duke mbajtur burden e Hazreti Muhammedit (Paqja qoftë me të), nën Sanxhak-ëu Sherifin (Flamuri i Ndershëm i Profetit s.a.v.s), kur **Sa'deddin Efendiu** (1536-1599) i mbajti fort frerët e kalit të sulltanit dhe i tha atij: "O Sulltani im! Mendimi i drejtë është që ju të qëndroni me vendosmëri në vendin tuaj; për arsye se është luftë dhe pjesa më e madhe e betejave që janë zhvilluar në kohën e paraardhësve tuaj u zhvilluan në këtë mënyrë, dhe inshallah në saj të mrekullisë së Muhammedit, Paqja qoftë me të, fitorja do të jetë në krahun e muslimanëve, gëzohu." **Sa'deddin Efendiu** vazhdoi t'i kujtonte sulltanit se "fitorja arrihet me këmbëngulje" dhe citoi këto vargje nga Kur'ani:

Inne me'al usri jusran [el-Inshirah, 6]

"Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi".²³³

Ushtarët austriakë hynë në tendat qendrore osmane dhe filluan të plaçkitnin, por kuzhinierët, druvarët dhe shërbyesit e tjerë të Ordu-ju Hymajunit arritën të mbroheshin dhe t'i sulmonin me sëpata duke bërë që armiqtë të largoheshin të terrorizuar. Ata thirrën: "Kafir kaçdë" (kafirët, jobesimtarët ia mbathën). Ky akt i guximshëm i nxiti ushtarët osmanë për t'u kthyer dhe për ta mundur armikun në tetor 1596, duke marrë

231 Po aty, III, pjesa I, fq. 76.

232 Na'ima, I, fq. 157.

233 Po aty, fq. 157-158.

edhe 95 armë zjarri (topa) nga gjermanët.²³⁴ Sulltan **Mehemedi III**, më pas, u kthye në Stamboll dhe osmanët nuk e shfrytëzuan këtë fitore për të përparuar më tej. **Peçuji**, një nga dëshmitarët e kësaj beteje, shkroi: "Ishte pothuajse e sigurt se nëse sulltani do të kishte kaluar dimrin në Budin apo në Beograd, dhe të ishte rihedhur në sulm kundër austriakëve, do të kishte qenë e mundur që të merrte të gjithë territorin deri në Vjenë, dhe të lidhte një traktat paqeje me kushte shumë të favorshme për të. Por, ushtria u kthye në Stamboll dhe u tregua zemërbutë për çështjet e luftës; në këtë mënyrë, armiku shfrytëzoi rastin për të marrë veten dhe për t' u përgatitur për luftë."²³⁵

Sadrazami **Ibrahim Pasha** së bashku me **Hasan Pashanë** rrethuan kështjellën e Kanixhes, që më pas u dorëzua. Por, osmanët me shpirtgjerësi i udhëhoqën banorët e saj në vend të sigurt dhe iu dhanë 200 deve për të transportuar orenditë e tyre, ku përfshiheshin edhe djepe dhe kotece pulash.²³⁶ Në vitin 1600, **Hasan Pasha** u emërua Bejlerbej dhe u caktua si mbrojtës i Kanixhes.²³⁷

Rrethimi i Kanixhes nga të krishterët

Një vit më pas, **Arkiduka Ferdinandi** në krye të një ushtrie shumë të madhe rrethoi kështjellën e Kanixhes, që ishte kthyer bashkë me rrethinat e saj në një vakëf për **el-Medine el-Munevveres**.²³⁸ Si përfaqësues të Hilafetit, osmanët shpesh i caktonin këto vakëfe për vendet e shenjta të Islamit.

Tirjaki Hasan Pasha me zgjuarsin e vuri në lojë austriakët kundër hungarezëve. Për pasojë, marrëdhëniet e tyre u përkeqësuan dhe hungarezët u tërhoqën nga fushë-beteja. Por, **Arkiduka Matijas**, që iu kishte marrë muslimanëve Stolni

234 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 76-79.

235 Cituar në *Netajixh*, II, fq. 6.

236 Na'ima, *vepër e cituar*, I, fq. 234.

237 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 83.

238 Na'ima, *vepër e cituar*, I, fq. 257.

Beogradin (Sekeshfehervarin), iu bashkua forcave rrethuese. Edhe pse numri i forcave mbrojtëse të kështjellës Kanixhe ishte vetëm 4.000, **Tirjaki Hasan Pasha** i dha disa goditje të rënda kundërshtarit, që humbi rreth 18.000 ushtarë. Vëllai i Papës u plagos rëndë në këtë betejë dhe më pas vdiq. **Hasan Pasha**, më 18 Tetor 1601, organizoi një sulm tjetër të guximshëm gjatë të cilit iu mori kundërshtarëve 45 armë zjarri (topa).²³⁹ Edhe pse **Arkiduka Ferdinand** iu përgjigj me një kundërsulm të padobishëm, gjatë të cilit humbi dhe 30.000 ushtarë, ai përfundimisht, u largua i turpëruar bashkë me 100 nga njerëzit e tij duke lënë thesarin dhe pajimet në fushën e luftës. Osmanët kishin marrë një mësim të hidhur nga armiqtë në Haçova, kur lakmia e tyre pas plaçkës së luftës e ktheu fitoren në një humbje shkatërrimtare. Për këtë arsye, **Hasan Pasha** i urdhëroi me vendosmëri gazinj të që të mos preknin asgjë para se armiku të tërhiqej plotësisht nga fusha e betejës. Respekti i tyre ndaj prijësit u tregua qartë me zbatimin në mënyrë të rreptë të porosisë së tij. Madje, ata pritën dhe ardhjen e **Hasan Pashait** një ditë më vonë për t'ua shpërndarë atyre *ganimetin*. Hasan Pasha hyri në tendën e **Ferdinandit**, fali dy rekate të shukur namazit dhe u përlot duke falënderuar Allahun e Plotfuqishëm për fitoren e madhe. Pasi nguli shpatën e tij në mesin e fronit të Ferdinandit, ai u ul mbi fron. Më pas, ai thirri shtatë luftëtarët e parë muxhahidinë që hynë në tendën e Arkidukës dhe iu tha: "Gjithçka, me përjashtim të fronit dhe municioneve në këtë tendë është e juaja." Ganimeti që përfituan ata nga kjo luftë ishte kaq i madh, sa që iu desh dy muaj kohë për t'i dërguar ato (pistoleta, pushkë, municione etj.) në kështjellën e Kanixhes.²⁴⁰ Tirjaki Hasan Pasha u ngrit në rangun e vezirit dhe shumë persona të tjerë që kishin luajtur një rol të rëndësishëm në këtë fitore u shpërblyen me bollëk.²⁴¹

239 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 88.

240 Po aty, III, pjesa I, fq. 89.

241 Na'ima, *vepër e cituar*, I, fq. 274; Netajixh, II, fq. 14.

Sulltani osman, **Halifi i Muslimanëve**, dërgoi për Hasan Pashanë dhe mbrojtësit e kështjellës së Kanixhes, Hatt-ë Hymajunin (Dekretin Qiellor) e mëposhtëm:

“Falënderimi i qoftë Allahut që na zgjodhi ne mes shumë robërve besimtarë të Tij dhe na dhuroi shumë fitore ndaj çështjes së muslimanëve, ndërsa përshëndetja qoftë mbi Zotërinë e Profetëve.” Më pas: “Ti je Bejlerbeu i Kanixhes dhe shërbyesi im me përvojë, dhe i maturi Vezir Hasan Pasha. Në këtë vit fatlum Ummetit të Muhammedit i është dhënë Ndihma Hyjnore dhe shërbimi që ke dhënë ti është paraqitur para portës më të lartë, përpjekja jote e palodhshme është vlerësuar, dhe emri yt është gdhendur mes emrave të fisnikëve të tjerë. Të uroj lumturi. Të jap titullin e Vezirit...”²⁴²

Mihaili, vojvoda rebel i Eflakut, e kishte kuptuar në atë kohë që ai nuk mund t’iu rezistonte sulmeve osmane dhe për këtë arsye u largua drejt Erdelit. Por, ai u ekzekutua në vitin 1010/1601 nga **Basta**, komandanti austriak që kishte lakmitë e tij në Erdel.²⁴³

Marrëdhëniet me jashtë

Në atë kohë, osmanët merrnin tagra nga vendet fqinje. Venediku paguante tagër për tokat që zotëronte pranë territorit osman, ndërsa austriakët paguanin çdo vit 30.000 dukate floriri. Ata, gjithashtu, iu dërgonin dhurata komandantit osman të kështjellës Estergon, guvernatorit të Budinit, Kadiut të Budinit dhe fisnikëve të Devletit Osman.

Polonia ishte përpjekur disa herë, edhe pse pa dobi, të nxiste vojvodat e Bogdanit kundër osmanëve, por ajo vetë në fund u nënshtrua nga osmanët dhe nga kalorësit e Krimesë. Pas kësaj, polakët u detyruan t’iu paguanin tagër Devletit Osman si dhe Hanatit të Krimesë. Kjo ngjarje nuk përmendet në librin e Lord Kinrosit.

242 Na’ima, *vepër e cituar*, I, fq. 279.

243 Po aty, III, pjesa I, fq. 94.

Në shekullin e 16-të, Rusia nuk kishte asnjë lloj marrëdhënie të rëndësishme me Devletin Osman, edhe pse rusët ishin hedhur disa herë në sulm kundër Hanatit të Krimesë dhe iu paguanin tagër atyre. Përfundimisht, ata pushtuan të gjitha territoret e Hanatit të Kazanit.

Gjatë viteve të sundimit të Sylejmanit të Madhërishtëm, spanjollët dhe austriakët kishin krijuar marrëdhënie armiqësore me Francën, ndërsa Devleti Osman lidhi një marrëveshje me Francën kundër tyre.²⁴⁴ Gjatë periudhës së Sulltanit të Madhërishtëm, në kulmin e fuqisë së tij, Devleti Osman përdori ndikimin dhe prestigjin e tij për të liruar **Mbretin e Francës Fransua I**, nga burgu i **Karlit V**. Për të mbështetur Francën kundër armiqve të përbashkët, **Sulltan Sylejmani** i dha Francës disa lehtësime në fushën e tregtisë, që i përjashtoi tregtarët francezë nga pagesa e çfarëdo takse jashtë taksës doganore, si dhe u dha të drejtën që mosmarrëveshjet mes njëri-tjetrit t'i zgjidhnin nëpërmjet konsujve të tyre. Gjithashtu, atyre iu dha dhe e drejta për të përdorur përkthyes, ndërkohë që të gjitha rastet, në të cilat përfshiheshin më shumë se 44.000 akçe, duhej të trajtoheshin para Kadiaskerit.²⁴⁵ **Këto privilegje nuk patën ndonjë ndikim të rëndësishëm mbi Devletin Osman të shekullit të 16-të**, por me kalimin e kohës këto i shkaktuan padrejtësi të mëdha dhe turpërim, që më pas, madje u njohën edhe me emërtimin "**kapitulacione**".

Faza e dytë e luftës me Iranin 1603-1612

Lufta midis osmanëve dhe austriakëve vazhdonte që nga viti 1001/1593, ndërkohë që Devleti Osman ishte i angazhuar për të shtypur disa kryengritje të brendshme. **Shahu Abbas** i Iranit (1586-1628), e shfrytëzoi këtë situatë të krijuar²⁴⁶ për të takuar një nga nënoficerët e Kontit të Eseksit, **Sir Antuan**

244 Netajixh, I, fq. 151.

245 Po aty, I, fq. 152.

246 Na'ima, *vepër e cituar*, I, fq. 327.

Shirlin (Sir Antoine Shirley), që në atë kohë ndodhej në Iran, si dhe për të dërguar në vitin 1599 ambasadorët e tij në Evropë për të lidhur një traktat kundër Devletit Osman. Ai i dha Sir Antuan Shirlejtit, që i shoqëroi këta të dërguar, disa letra adresuar **Papës, Perandorit të Gjermanisë, Mbretëreshës së Anglisë, Mbretit të Francës dhe Polonisë, dhe Presidentit të Republikës së Venedikut**.²⁴⁷ Raportohet madje se Shahu mbante një kryq “të varur në qafën e tij, nën këmishë, si shenjë nderimi dhe përvulje ndaj Jezu Krishtit’”.²⁴⁸ Abbasi mbeti një besimtar musliman, edhe pse në fakt, bëri shumë përpjekje për të vepruar në bashkëpunim me fuqitë perëndimore kundër turqve.²⁴⁹ **Shahu Abbas** mori Tebrizin në vitin 1603,²⁵⁰ disa qyteza të Azerbajxhanit dhe Revanin (Erivanin) pas një rrethimi që zgjati gjashtë muaj. Ndërkohë, Sulltani osman Mehemedi III ndërroi jetë.²⁵¹

8.4 Sulltan Ahmedi I 1603-1617

Pasardhësi i Mehemedit III, Ahmedi mori fronin pas vdekjes së babait të tij. **Sadrazami Javuz Ali Pasha** marshoi drejt Austrisë dhe **Sinan Pasha**, djali i Xhigalasë, u dërgua drejt Iranit.²⁵² Pas vdekjes së këtij të parit në vitin 1604, **Llalla Mehmed Pasha** mori vendin e tij si sadrazami osman. Ai pushtoi disa kështjella dhe rrethoi Estergonin, që u rihap ndaj Islamit në vitin 1605.²⁵³ **Sinan Pasha** nuk arriti të rimerrte qytetin Revan²⁵⁴ dhe në vitin 1605 kaloi dimrin në Van. Një vit më pas, ai u

247 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 64.

248 Pincon, *Relations* (Relatat), fq. 162, cituar në veprën e Dorothy M. Vaughan, *Europe and the Turk*, (Liverpool, University Press: 1954, ribotuar në 1976), fq. 210.

249 Shiko poshtë-shënimin 249.

250 Na'ima, *vepër e cituar*, I, fq. 334; Dorothy Vaughan (poshtëshënimi 249).

251 Na'ima, *vepër e cituar*, I, fq. 350; Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 65.

252 *Netajixh*, II, fq. 21.

253 Po aty, II, fq. 22.

254 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 65-66.

përpoq të merrte Tebrizin, por pa sukses dhe më pas ndërroi jetë në Dijarbakër. **Shahu Abbas** mori Shirvanin dhe Genxhen. **Kujuxhu Murad Pasha** vrau rebeluesit në Anadoll dhe në vitin 1019/1610 u emërua Serdar (Kryekomandant) i fushatës kundër Iranit. Ai marshoi drejt Shahut Abbas në Tebriz, por asnjë nga palët nuk guxoi të futej në betejë të hapur. **Murad Pasha** u kthye në Dijarbakër ku dhe vdiq.²⁵⁵ **Nasuh Pasha**, sadrazami osman, pranoi propozimin e Shahut për paqe. Sipas traktatit të paqes,²⁵⁶ Shahu duhet t'iu paguante osmanëve 200 ngarkesa mëndafsh çdo vit në këmbim të njohjes së tyre të sovranitetit të tij mbi territoret që kishte marrë.

255 Po aty, I, fq. 66.

256 Po aty, I, fq. 67.

KAPITULLI 9

SULLTANI OSMAN BIE NË NJË NIVEL ME PERANDORIN

9.1 Traktati i Zitvatorokut 1606

Lufta me Austrinë zgjati 14 vjet, ndërkohë osmanët kërkuan me ngut të vendosnin paqen me austriakët, që të përquendronin energjitë e tyre në zgjidhjen e problemeve të brendshme të Devletit. Në këtë mënyrë, u lidh në vitin 1015/1606 Traktati i paqes së Zitvatorokut për një periudhë 20-vjeçare. Ky traktat i dha sovranit të Austrisë emërtesën “Cezar” (Perandor), duke e zëvendësuar titullin e tij të mëparshëm mbret, dhe ambasadorët osmanë, që ishin “**Divan Çavushu**”, u ngritën në rangun “**Sanxhakbej**”. Të tjerat vjetore e Austrisë prej 30.000 dukatesh, që iu paguante osmanëve, u zëvendësua një herë e përgjithmonë nga pagesa e 2/3 të kësaj shume. Devleti Osman, nëpërmjet këtij traktati, fitoi kështjellat e Janëkut (Raab), Estergonit, Istoni Belgradit, si dhe disa kështjella të tjera që ishin pushtuar nga austriakët. Mirëpo, osmanët për herë të parë e pranuan dhe e njohën me këtë traktat sovranin austriak si të **barabartë** me sulltanin. Më parë, të gjithë sovranët barazoheshin me sadrazamin dhe jo me sulltanin. Për këtë arsye, ky traktat është dokumenti i parë që zyrtarisht shënoi rënien e statusit të sulltanit osman dhe që e barazvlerësoi me atë të sovranit evropian.²⁵⁷

257 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 98.

Faza e tretë e luftës me Iranin 1615-1618

Shahu Abbas nuk e mbajti premtimin e tij, për t'i dërguar Devletit Osman 200 ngarkesa mëndafsh, dhe arrestoi ambasadorët osmanë që ishin dërguar për të pyetur për këtë vonesë. Për këtë arsye, në vitin 1024/1615, **Sadrazami Mehemed Pasha** marshoi drejt Iranit. Edhe pse Shahu i liroi me nxitim ambasadorët, sadrazami vazhdoi përparimin e tij. Ai rrethoi Revanin, por nuk arriti ta merrte atë, dhe për këtë arsye, lidhi një traktat tjetër paqeje që e detyronte përsëri Iranin t'i dërgonte Devletit Osman 100 ngarkesa mëndafsh çdo vit. Mehemed Pasha u shkarkua nga detyra, pas dështimit të tij në Revan dhe kjo marrëveshje për paqe nuk u miratua nga sulltani osman. Sadrazami i ri, **Halil Pasha**, arriti në Tebriz në vitin 1617.

Kalorësit e Krimesë, që kishin fituar një famë të shkëlqyer gjatë shekujve, sulmuan Iranin dhe e detyruan Shahun të largohej në Erdebil në vitin 1618, dhe kërkuan edhe lidhjen e një traktati paqeje. Sipas këtij traktati, tagra që Irani i dërgonte Devletit Osman u reduktua nga 200 ngarkesa mëndafsh në vetëm 100.²⁵⁸

Sulltan Ahmedi vdiq në moshën 28-vjeçare në vitin 1026/1617 dhe nuk la asnjë shehzade në moshë madhore. Ai ktheu një numër të madh fshatrash të Egjiptit në vakëfe për popullin e varfër të el-Haramejn esh-Sheirfejn.²⁵⁹

9.2 Sulltan Osmani II 1618-1622

Ai u quajt Genç Osman (Osmani i Ri), që ishte një titull i përshtatshëm për atë, që ishte aktiv por pa përvojë, dhe ishte nën ndikimin e nënës së tij.

258 Po aty, III, pjesa I, fq. 68.

259 Solakzade, *Tarih*, fq. 696-697.

Fushata në Poloni

Lumi Turla (Dnjestër) vijëzonte kufirin midis Devletit Osman dhe Lehistanit. Edhe pse Hani i Krimesë ishte urdhëruar të mos organizonte asnjë akën (sulm) në Poloni, polakët shumë shpejt do të ndërhyenin në çështjet politike të Bogdanit dhe në vitin 1617 pushtuan kështjellën Hotin. Për këtë arsye, **Iskender Pasha**, Bejlerbeu i Ozit (Özi), u nis kundër tyre bashkë me kalorësit e Krimesë, dhe forca të tjera, dhe në betejën që u zhvillua pranë Jashit, forcat muslimane shkatërruan vojvodën e Bogdanit që kishte edhe ndihmën e 50.000 ushtarëve polakë.²⁶⁰ Koza-kët e Polonisë, megjithatë, kishin kaluar poshtë kufirit të lumit Ozi (Dnjepër) drejt Detit të Zi, dhe kishin sulmuar dhe plaçkitur Jenikojin (Yeniköy) në Bosfor. Kjo ngjarje e zemëroi **sulltanin Genç Osman**, që nuk pranoi t'i priste të deleguarit e mbretit polak dhe kundërshtoi ndërhyrjen e ambasadorit britanik. Ai vendosi të luftonte kundër Polonisë, dhe për këtë arsye u vu në krye të ushtrisë që u nis nga Stambolli në vitin 1030/1621 dhe mbërriti në Edrene dhe në Degirmenkojy (Değirmenköyü), vend ku ushtrisë së tij iu bashkua edhe vojvoda i Bogdanit, Aleksandri, dhe disa bejlerë. Por ky i fundit u shkarkua nga detyra për shkak të dështimit të tij në riparimin e urave dhe rrugëve, si dhe për furnizimin e ushtrisë me grurë. Në vitin 1030/1621, vendin e tij e mori **Ishtfan Tomsha**, një armik i betuar i polakëve.²⁶¹

Në shtator të vitit 1621, Ordu-ju Hymajun mbërriti në Hotin, por nuk arriti ta rimerrte kështjellën. Një trupë, prej 50.000 kalorësish të Krimesë, sulmoi duke depërtuar thellë në rajonin e Polonisë dhe e tmerroi popullsinë atje. Gjatë sulmit të katërt, më 14 shtator 1621, **Karakash Mehmed Pasha**, valiu i

260 Na'ima, *vepër e cituar*, II, fq. 175-176. Në këtë vepër Na'ima përmend se "Kafiri kishte 53.000 ushtarë, ndërsa Iskender Pasha kishte vetëm 10.000 ushtarë. Por, forcat e Islamit fituan siç ishte premtuar në *el-Bekareö* ajeti 249" ("Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri më të madhe").

261 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 131.

Budinit, u fut në fortifikatat e armikut jashtë kështjellës, dhe nëse nuk do të ishte vuarë në fushën e luftës, ai do të kishte ngritur flamurin osman.²⁶² Por, sadrazami **Hysejin Pasha** nuk dërgoi përforsimet që priteshin, me sa duket, për shkak të smirës, dhe për këtë arsye, ai u shkarkua dhe detyrën e tij e mori veziri **Dilaver Pasha**, Bejlerbeu i Dijarbakërit. Si përfundim, një traktat paqeje midis Devletit Osman dhe Polonisë u lidh më 1030/5 tetor 1621. Sipas këtij traktati, Bogdani do të merrte kështjellën e vogël Hotin dhe kufiri nuk do të ndryshonte. Për më tepër, banditët kozakë nuk do të ndërhynin në territorin osman dhe polakëve iu kërkua të vazhdonin t'i paguanin Hanit të Kërëmit 40.000 dukate, tagër që e paguanin që nga periudha e Sulltan Sylejmanit të Madhërishtëm.²⁶³

Mbretvrasja e Genç Osmanit 1622

Fushata e muslimanëve kundër Polonisë u drejtua nga vetë sulltani dhe nga Hani i Krimesë, Xhanëbek Gërjaji (1610-1623), ndërsa ushtria polake ishte nën komandën e djalit të mbretit. Megjithatë, kjo fushatë nuk pati sukses të plotë, për shkak të mosmarrëveshjeve të ashpra midis sulltanit dhe ushtarëve jeniçerë. **Sulltan Osmani II** mendonte se ishte e nevojshme të bëhej një rinovim në radhët e ushtrisë, madje edhe të zëvendësohej e tëra nga një trupë e re ushtarake. Por jeniçerët mendonin se sulltani i ri, që ishte nën ndikimin e një eunuku të zi nga Haremimi, ishte përgjegjës për situatën në përkeqësim. **Sylejman Agai**, eunuku, dhe **Omer Efendiu** (1623-1625), mësuesi i sulltanit, e kishin nxitur atë të krijonte një ushtri krejtësisht të re të përbërë nga ushtarë të përgatitur në Egjipt, Siri dhe Anadoll, dhe të nisej nga Stambolli për pelegrinazh. **Shejhulislam Esad Efendiu**, vjehri i sulltanit lëshoi një *fetva* (mendim ligjor dhe leje) që e lironte sulltanin nga kryerja e pelegrinazhit atë vit, me qëllim që të qëndronte në kryeqytet për të vendosur drejtësinë.

262 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 702.

263 Na'ima, *vepër e cituar*, II, fq. 201.

Mjeshtri shumë i nderuar shpirtëror në atë kohë, **Shejhu Aziz Mahmud Hydai**, kishte të njëjtin mendim për këtë çështje,²⁶⁴ por sulltani i shpërfilli këto fetva dhe vendosi të vazhdonte planin e tij të pelegrinazhit.

Jeniçerët dhe spahinjtë e kundërshtuan vendimin e sulltanit, për të shkuar në pelegrinazh, në një kohë të vështirë kur armiku ishte tek porta. Ata u mblodhën në Sheshin Sulltan Ahmed, u njoftuan për *fetvan* nëpërmjet Shejhulislamit që mbështeste qëndrimin e tyre, dhe kërkuan një dënim të rëndë për ata që e drejtonin sulltanin në rrugë të gabuar. Ata kërkuan, në veçanti, që Sylejman Agai, përgjegjësi i Haremit, të shkar-kohej nga detyra dhe të dërgohej në mërgim. Kur sulltani i kundërshtoi këto kërkesa të tyre, ata ngulmuan dhe më tepër, duke kërkuar dhe ekzekutimin e sadrazamit Dilaver Pasha, Defterdarit, Omer Efendiut dhe Sylejman Agait. Ata dërguan një grup studiuesish për të diskutuar çështjen e tyre me sulltanin, por ai i mbajti ata në pallatin e tij. Për këtë arsye, ushtarët filluan një rebelim të hapur kundër tij, hynë në pallatin e sulltanit dhe vendosën me forcë Mustafain si sulltan. Për pasojë, sulltan Osmani II u detyrua t'i dorëzonte Sylejman Again dhe Dilaver Pashanë, por ushtarakët nga ana e tyre e detyruan ulemanë t'i betoheshin për besnikëri Mustafait.²⁶⁵ Osmani II u strehua tek ata ushtarë jeniçerë që kishin marrë përsipër ta mbronin dhe t'i shpëtonin jetën, por, që i kishin bërë të qartë në të njëjtën kohë se nuk do ta pranonin më atë si Halif.²⁶⁶ Por, të nxitur nga sadrazami i ri, **Davut Pasha**, i cili shikonte te sulltani i rrëzuar nga fronti një rrezik të mundshëm për vetveten, disa nga jeniçerët e vranë Genç Osmanin në vitin 1031/1622.²⁶⁷

264 Po aty, II, fq. 211.

265 Po aty, II, fq. 218.

266 Po aty, II, fq. 227.

267 Po aty, II, fq. 229.

KAPITULLI 10

RIGJALLËRIMI

10.1 Sulltan Muradi IV 1623-1640

Mustafai zuri vendin e Osmanit II, por shumë shpejt do të rrëzohej nga fronti pasi kishte probleme të shëndetit mendor, dhe në vitin 1032/1623 u zëvendësua nga Muradi. Fjalja që vijon, në gjuhën turko-osmane, tregon datën e ardhjes në fron të sulltanit të ri:

Sulltan Murad(-ë) Rabi' olldë Padishah²⁶⁸

Sulltan Muradi i Katërt u bë Padishah.

Kur vlerat numerike të germave në këtë varg mblidhen të gjitha së bashku, rezultati tregon vitin 1032 (1632).

Marrja e Bagdadit nga Shahu i Iranit

Bekir Subashë i Bagdadit vrau valiun (gubernatorin) e Bagdadit, **Jusuf Pashanë**, dhe mori drejtimin e provincës në kundërshtim me Stambollin. Për këtë arsye, një forcë ushtarake nën drejtimin e **Hafëz Pashait** u dërgua në Bagdad për t'u marrë aty me situatën që po përkeqësohej. Ndërkohë, Bekir Subashë kërkoi ndihmën e **Shahut**, por Hafëz Pasha me mendjemprehtësi ia konfirmoi atij pozitën që kishte, për të shmangur ndërhyrjen iraniane në çështjet e brendshme të

268 Solakzade, *vepër e cituar*, fq. 737.

osmanëve.²⁶⁹ Edhe pse **Shahu i Iranit** kishte mbërritur me ushtrinë e tij në Bagdad, Bekir Subashë nuk e pa të nevojshme të bashkëpunonte me të. Ai, megjithatë, i kërkoi falje Shahut dhe i dërgoi atij disa dhurata duke u përpjekur ta bindte që të tërhiqte forcat ushtarake nga Bagdadi. Por, Shahu vendosi ta shfrytëzonte këtë rast dhe rrethoi qytetin. Për më tepër, ai fitoi dhe mbështetjen e **Mehmedit**, djalit të Bekir Subashit, duke e mashtruar atë me premtimin se ai do të merrte vendin e babait të tij. Mehmedi e ndihmoi duke i hapur portën e kështjellës dhe forcat perse hynë në qytet. Ata i shkaktuan qytetit dhe popullit mizori të shumëllojshme duke përfshirë këtu edhe përndjekjen e popullsisë sunnite, dhe vrasjen e Mehmedit dhe babait të tij.²⁷⁰

Ekspedita e Sulltan Muradit në Revan

I zemëruar nga plaçkitja në Bagdad, në vitin 1045/1638, sulltan Muradi, në krye të Ordu-ju Hymajun, marshoi drejt Revanit dhe rimori kështjellën e këtij qyteti.²⁷¹ Më pas, në vitin 1048/1638, ai iu drejtua Bagdadit dhe e gjeti Shahun e Iranit të fshehur nga frika në Kasr-ë Shirin.²⁷² Ushtria osmane rrethoi qytetin dhe "Muradi e drejtoi personalisht ushtrinë e tij, ndihmoi me duart e tij në hapjen e hendeqeve dhe kur persët dërguan një kampion të vendosur për t'i sfiduar rrethuesit në një luftim tek a tek, vetë Muradi e pranoi sfidën, dhe pas një dy-luftimi të ashpër i çau kafkën nga maja e kokës deri në mjekër, këtij gjiganti. Koraca me të cilën ai luftoi, një veshje e mrekullueshme prej metali të përpunuar dhe zinxhirash floriri, mund të shihet edhe sot e ekspozuar në Thesarin e Kostandinopojës."²⁷³ Pas një rrethimi që zgjati një muaj, Bagdadi u dorëzua dhe sulltani fitimtar vizitoi tyrben e **Imami Azam Ebu Hanifes** dhe e riparoi atë bashkë me atë të **Abdulkadir Gejlanit**, Shejhut

269 Na'ima, *vepër e cituar*, II, fq. 278.

270 Po aty, II, fq. 284-288.

271 Po aty, II, fq. 247.

272 *Netajixh*, II, fq. 53.

273 Stanley-Lane Poole, *Turkey*, fq. 220.

të madh sufi, dhe kështjellën e Bagdadit.²⁷⁴ Në përfundim, ai u kthye në Stamboll në prill të vitit 1048/1639,²⁷⁵ pasi lidhi dhe traktatin e paqes të Kasr-ë Shirinit me Iranin, sipas të cilit të dyja palët pranuan të shkatërronin kështjellat e tyre që ishin ndërtuar përgjatë kufirit.²⁷⁶ Si Sunnitë të devotshëm që ishin, osmanët këmbëngulën që paralajmërimi i mëposhtëm të shtohet në kushtet e traktatit: “Nëse duam të nderojmë marrëveshjen e paqes, duhet të ndërpriten dhe të parandalohen fyerjet për Ebu Bekrin, Omerin dhe nënën e besimtarëve, Aishe”.²⁷⁷

Sulltan Muradi ndërroi jetë një vit më pas. Ai kishte marrë drejtimin e Sulltanatit në një moshë shumë të re, dhe fillimisht kishte qenë nën ndikimin e nënës së tij **Sulltaneshës Kosem (Kösem)**. Por shumë shpejt ai do të çlirohej nga ky ndikim, dhe do të vendoste autoritetin e tij për drejtimin e Devletit Osman. Në një farë mënyre, ai ngjasonte me **Javuz Selimin**, stërgjyshin e tij, edhe pse nuk ishte aq i mirënjohur dhe i kulturuar sa paraardhësit e tij.²⁷⁸ Muradi ndaloi zyrtarisht konsumimin e alkoolit dhe duhanit, edhe pse ky ligj nuk u zbatua në realitet.

274 İ.H. Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 206.

275 *Netajixh*, II, fq. 53.

276 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 206.

277 BOA, *Name-iHmüyayun Defteri* (Ditari Hyjnor), Nr.7, fq. 4-6.

278 *Netajixh*, II, fq. 53-54.

KAPITULLI 11

RËNIA DHE RINGRITJA

11.1 Sulltan Ibrahim i 1640-1648

Vendin e sulltan Muradit e mori vëllai i tij, Ibrahim. Sadrazami **Kemankesh Kara Mustafa Pasha** bëri ç'ishte e mundur për të mbajtur administratën.

Fushata në Girit (Kretë)

Gjatë rrugës së tij për në Egjipt, Symbly Agai, një ish-zyrtar i oborrit osman, u ndal nga një bandë korsarësh të krishterë. Ata e martirizuan, ia morën të gjitha pasuritë që kishte me vete, dhe më pas i shitën në Girit (Kretë), një ishull venedikas. Osmanët dërguan drejt Kretës një forcë prej më shumë se 100 anijesh në pranverën e vitit 1055/1645.²⁷⁹ Sanxhakbejlerët e vendeve bregdetare dhe *Garb Oxhakllarët* (Trablusgarb (Libi), Tunizi dhe Xhezair) po ashtu iu bashkuan fushatës me forcat e tyre detare. Pas një rrethimi që zgjati 54 ditë, Kështjella e Hanjas iu dorëzua muslimanëve, të cilët e thirrën Ezanin Muhammedijje dhe ngritën aty flamujt muslimanë. Por osmanët i lejuan të krishterët të largoheshin nga qyteti, caktuan disa njësi ushtarake për të mbrojtur tregun,²⁸⁰ dhe nuk e prekën dhe as nuk e plaçkitën qytetin. Kjo sjellje e përsëritur e tyre, në

279 Na'ima, *vepër e cituar*, IV, fq. 112.

280 Po aty, IV, fq. 142-144.

kundërshtim me ideologjinë e krishterë, tregon qytetarinë e osmanëve dhe të shoqërisë së tyre.

Lufta midis Devletit Osman dhe Republikës së fuqishme detare të Venedikut, vazhdoi për vite me radhë, periudhë gjatë të cilës flota venedikase bllokoi Ngushticën e Dardaneleve që të parandalonte përforcimet për muxhahidinët në Girit. Ndërkohë, Sulltan Ibrahimin e rrëzuan nga fronti i tij në vitin 1058/1648 me pretekst çmendurinë.

11.2 Sulltan Mehmedi IV 1648-1687

Në ndjekje të traditës së familjes së tij, sulltan Mehmedi, shkoi te tyrbja e Ejub Sulltanit, për ceremoninë e përrurimit, të quajtur Këllëç Allajë (mbërthimi i shpatës së Islamit nga sulltani i ri) dhe më pas u kthye në pallatin e tij.²⁸¹

Monedha qarkulluese e Devletit Osman filloi gradualisht të zhvlerësohej, edhe pse sadrazamë të njëpasnjëshëm u përpoqën të ndalonin përkeqësimin e kësaj gjendjeje. Midis tyre, **Tarhunxhu Ahmedit**, që ishte emëruar sadrazam në vitin 1062/1652, i takon një meritë e veçantë në përpjekjet e tij për të frenuar shpenzimet e panevojshme dhe në zbatimin e masave të rrepta ekonomike. Me ndihmën e anijeve nga Garb Oxhakllarë (Trablusgarb (Libi), Tunizi dhe Xhezairi), flota osmane i shkaktoi disfatë flotës së Venedikut në vitin 1064/1654, vrau admiralin e saj **Françesko Morozinin** dhe kapi rob djalin e tij. Për arsye të kësaj gjendjeje, flota venedikase u detyrua të hiqte përkohësisht dorë nga Ngushtica e Dardaneleve, të cilën e kishte pasur nën kontrollin e saj për një kohë. Por, ajo iu kthye sërish kësaj pike strategjike në vitin 1066/1656, kur një stuhi e furishme iu shkaktoi humbje të dy palëve, si flotës osmane ashtu edhe asaj venedikase. Megjithatë, venedikasit arritën të merrnin kontrollin e situatës pasi morën ishujt Bozxhaada, Limni dhe Semen-

direk në Detin Egje, duke penguar në këtë mënyrë vijën detare Stamboll-Girit.

Kopryly (Köprülü) Mehmed Pasha

Me këshillë të **Mimar Kasëm Agait**, më 14 Shtator 1656, u emërua në postin e Sadrazamit, 70-vjeçari **Kopryly Mehmed Pasha**. Por, ai ngulmoi për përmbushjen e disa kushteve që i jepnin atij pushtet të pakufizuar në drejtimin e makinerisë së Devletit. Sulltani i miratoi të gjitha rekomandimet e tij duke i dhënë atij pushtet absolut për të emëruar njerëz të aftë dhe të ndershëm në postet publike. Vezirët dhe disa fisnikë të oborrit të sulltanit nuk lejoheshin të kishin një ndikim dominues në çështjet e brendshme të Devletit dhe Sulltani vendosi të mos dëgjonte as këshillën e tyre apo të ndonjë kundërshtari tjetër.²⁸²

Fisnikët ishin tejet të vendosur për t'u futur në luftë me Venedikun, për shkak të qëndrimit armiqësor të këtij të fundit, por kjo ishte një detyrë e vështirë, veçanërisht për shkak të një reduktimi të fondeve të Devletit për blerjen e pajimeve të luftës. Kjo çështje u diskutua gjatë një asambleje zyrtare, në të cilën vetë sulltani ishte i pranishëm. Nëna Sulltaneshë (nëna e Mehmedit IV), **Hadixhe Turhan**, raportohet të ketë thënë në këtë asamble: "Bëni ç'është e mundur për të hapur Giritin ndaj Islamit, dhe unë do të jap të gjitha stollitë dhe gurët e mi të çmuar, të gjitha enët prej ari dhe argjendi të kuzhinës së shtëpisë sime dhe të gjithë pronën time për këtë fushatë."²⁸³

Kopryly Mehmed Pasha, në vitin 1067/1657, u nis në krye të një flote osmane drejt Dardaneleve, duke marrë me vete edhe *Sanxhak-ë Sherifin* (Flamurin e Profetit). Njëri prej valive i quajtur **Muhammed Sadik** u lut, dhe me këshillën e tij 92 njerëz të devotshëm, emri i të cilëve ishte **Muhammed**, u përzgjodhën midis zyrtarëve në oborin osman, për të recituar **Suren el-Fatiha**, **92 herë në javë**, duke përfunduar ditën e premte me

282 Na'ima, *vepër e cituar*, VI, fq. 223.

283 *Netajixh*, II, fq. 68.

faljen e së **Xhumasë**, kur ata duhet të luteshin të gjithë për ndihmë dhe fitore.²⁸⁴ (Vlera numerike e germave të fjalës “Muhammed” është 92).

Flota detare e fuqishme venedikase iu drejtua brigjeve të Anadollit për t’u përballur me flotën osmane. Admirali venedikas, **Moceniko**, u përpoq të merrte anijen kryesore të osmanëve, kur një predhë goditi depon e armatimeve në anijen e tij dhe e shkatërroi atë, dhe flota e Venedikut u detyrua të tërhiqej. Sadrazami osman bëri **sexhdet’ush-shukur** për fitoren e arritur dhe u largua me flotën e tij nga Ngushtica e Dardaneleve, pasi rimori ishujt Bozxaada dhe Limni.²⁸⁵

Ekspedita në Erdel 1068/1658

Ndërkohë mbreti i Erdelit (Transilvanisë), **Rakoçi II**, lidhi marrëveshje me Suedinë, që në atë kohë ishte shteti më i fuqishëm i krishterë i Evropës. Ai, gjithashtu planifikonte të merrte Poloninë pa kërkuar pëlqimin e drejtuesit të tij, sulltanit osman. Polakët iu drejtuan për ndihmë Devletit Osman²⁸⁶, i cili kundërshtoi përfshirjen e Polonisë në Erdel dhe dëshironte të kishte në kufirin e saj një Poloni të dobët dhe të trazuar, që ishte vazhdimisht nën kërcënimin e kalorësve të **Kërëmit**. Megjithatë, **Rakoçi**, kishte pritshmëri të gabuara, duke menduar se sadrazami i aftë Kopyrly, do të zëvendësohej shumë shpejt nga një sadrazam tjetër, me të cilin ai do të arrinte të zgjidhte problemet. Kopyrly Mehmed Pasha u nis drejt Erdelit në vitin 1068/1658 dhe aneksoi kështjellën strategjike të këtij qyteti, kështjellën e Janovës. Por, shpejt, ai u detyrua të kthehej në Stamboll për shkak të problemeve dhe rrezikut që kishin krijuar kryengritjet e brendshme në Anadoll, dhe **Sejdi Ahmed Pasha**, valiu i Budinit, u caktua si kryekomandant i ushtrisë. Ai korri

284 Na’ima, *vepër e cituar*, VI, fq. 278.

285 *Netajixh*, II, fq. 69.

286 Na’ima, *vepër e cituar*, VI, fq. 331.

fitore ndaj **Rakoçit**²⁸⁷ dhe Divan-ë Hymajun (lit: Divani Qiellor, që do të thotë qeveria osmane) miratoi emërimin e **Apafi Mihalit** (sundoi në vitet 1661-1682) si mbret të Erdelit.²⁸⁸

Kopryly Mehmed Pasha mori autoritetin e Devletit dhe ndëshkoi rëndë administratorët lokalë të korruptuar dhe tiranikë. Në vitin 1071/1661, ai ndërtoi fortesat Kumkale dhe Seddulbahr në Dardanelet, që vizitoheshin nga sulltani dhe nëna e tij.

Lufta me Rusinë 1069/1659

Nga mesi i shekullit të 17-të, Rusia po ngrihej si një shtet i fuqishëm i Evropës Lindore, që kishte qëllime armiqësore kundrejt Ukrainës. Edhe pse Devleti Osman dëshironte ta mbante Rusinë larg Ukrainës, nuk arrinte t'iu përgjigjej thirrjeve për ndihmë kundër Rusisë të **Princit Viogorski** të Kozakëve ukrainas, pasi osmanët, në atë kohë, ishin të angazhuar në një luftë të ashpër për çështjen e Giritit me Venedikun, që zgjaste prej më shumë se 10 vjetësh, dhe në të njëjtën kohë, ishin të zënë me rebelimet e brendshme në Anadoll. Pra, ushtarët e Islamit ishin shpërndarë me detyrë në shumë vende, dhe nuk arrinin të përqendroheshin tek rreziku rus. Mbreti i Moskës vendosi të shfrytëzonte këtë rast për të thyer fuqinë osmane. Ai u përgatit me kujdes për këtë detyrë, për më shumë se 2 vjet, dhe dërgoi lajmëtarët e tij te Kozakët, për t'i nxitur ata në luftë kundër muslimanëve. Në veçanti, ai dëshironte të shkatërronte kalorësinë e fuqishme të **Kërëmit** që do t'ia lehtësonte atij sulmin e suksesshëm kundër Devletit Osman. Por Kozakët, të cilët kishin arritur një pozicion të vendosur dhe kishin marrë disa nga tokat e tyre me ndihmën e krimeasve, njoftuan **Mehmed Gërajin**, Hanin e **Kërëmit**, për qëllimet e rusëve. Në këtë mënyrë, Mehmed Gëraji marshoi me kalorësit e tij të famshëm dhe trupat osmane në Kefe drejt ushtrisë ruse në Ukrainën Veriore, që

287 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 382-385.

288 Po aty, fq. 386.

ishte e përbërë prej 350.000 luftëtarësh kryesisht vagabondë dhe të pastërvitur. Rusët pësuan disfatë në betejën e **Konotopit** më 1069/12 korrik 1659, gjatë së cilës ata humbën 120.000 nga luftëtarët e tyre, në radhët e të cilëve ishte dhe Kryekomandanti, **Princi Trubeçkoj**, dhe 50.000 luftëtarë të tjerë u kapën dhe u burgosën. Kjo betejë vendimtare arriti të shtynte për rreth një gjysëm shekulli pushtimin e Ukrainës nga Rusia. Sadrazami **Kopryly Mehmed Pasha**, tashmë në moshë tepër të thyer, vdiq në vitin 1071/1661 dhe në zbatim të testamentit që la, postin e tij e mori i biri, Kopryly Fazëll Ahmed Pasha.²⁸⁹

Fazëll Ahmed Pasha 1661-1676

Austriakët nuk pushuan asnjëherë së ndërhyri në çështjet e Erdelit, dhe për më tepër ata kishin ndërtuar kështjellën Zerinvavar pranë kështjellës së Kanixhes. Kur ata nuk e pranuan kërkesën e osmanëve për ta shkatërruar atë kështjellë, **Fazëll Ahmed Pasha**, më 1073/prill 1663, u nis me ushtrinë e tij osmane drejt periferisë së kështjellës së Ujvarit, në pjesën qendrore të Hungarisë. Edhe pse kështjella ishte marrë dhe më pas ishte fortifikuar nga austriakët, Fazëll Ahmed Pasha kaloi lumin Danub dhe iu afrua kështjellës, ku ishte afruar edhe **gjenerali** austriak **Montekukkuli** së bashku me përforcime të tjera. Por shumë shpejt, ai do të tërhiqej për shkak të një sulmi të ashpër osman, dhe në vitin 1073/1663, austriakët do të dorëzoheshin. Osmanët morën në përgjegjësi sigurimin e jetës dhe pronës së popullit austriak, dhe faktikisht kishin siguruar 400 karroca për transportin e plaçkës së tyre. Për më tepër, ata i drejtuan një letër perandorit austriak, ku e njoftonin se ushtarët e tij kishin bërë të pamundurën për të mbrojtur kështjellën Ujvar. Osmanët i qëndronin thënies se “derisa ushtarët *kuffarë* (jobsimtarë) nuk do të dalin nga kështjella, ushtarët e Islamit nuk do të futen brenda”. Përveç këtyre gjesteve shumë bujare dhe humane, ushtria fitimtare muslimane u dha austriakëve që po largoheshin

289 Mehmed Rashid Efendi, *Tarih*, Stamboll: 1281 H, I, fq. 16-20.

ushqim dhe iu mjekoi plagët ushtarëve austriakë në kështjellë.²⁹⁰ Ushtria osmane, pasi pushtoi kështjellën Zerivar në vitin 1077/1666, e shkatërroi atë. Në përfundim të këtyre betejave, u arrit traktati i Vasvarit.²⁹¹

Ekspedita në Girit

Pasi thirri Sadrazamin, Shejhulislamin, Kazaskerët dhe dinjitarët e tjerë të Devletit të tij, Sulltan Mehmedi IV u tha atyre: “Me përjashtim të kështjellës Kandije, i gjithë ishulli i Giritit, duhet të hapet ndaj Islamit. Ata që janë në Kandije sulmojnë anijet tregtare dhe grabisin besimtarët rrugës për në pelegrinazh. *Fet’hi* i saj (hapja e kështjellës ndaj Islamit) është domosdoshmëri.” Në vitin 1076/1666, sulltani e dërgoi Fazëll Ahmed Pashanë në Girit,²⁹² dhe e përcolli atë deri në Edrene. **Fazëll Ahmed Pasha** u nis për në Girit nëpërmjet Gadishullit të Moresë. Pas një rrethimi të kështjellës që zgjati 2 vjet e gjysëm, **Kandija** u hap ndaj Islamit më 1080/shtator 1669²⁹³ dhe muslimanët, 14 manastiret që gjendeshin atje i kthyen në xhami.²⁹⁴

Edhe pse kishte deklaruar paqen me Devletin Osman, Franca ishte një nga fuqitë evropiane që e ndihmoi më tepër Venedikun gjatë luftës së Giritit. Një trupë prej 15.000 luftëtarësh vullnetarë francezë, së bashku me Kalorësit e Urdhrit të Shën Xhonit dhe forcat e Papatit, luftuan kundër muslimanëve. Në përfundim të kësaj lufte, u lidh një traktat paqeje me Venedikun, sipas të cilit kështjella Kandije, me të gjithë topat dhe pajimet e saj të luftës, u kthye në një zotërim të osmanëve, ndërkohë që Venediku pranoi të përulej ndaj detyrimeve të Devletit, si dhe të kompensonte çdo anije osmane që ishte humbur në Mesdhe.²⁹⁵

290 Po aty, I, fq. 47.

291 *Netajixh*, II, fq. 76.

292 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 414.

293 Po aty, III, pjesa I, fq. 419.

294 Silahdar Fındıklı Mehmet Ağa, *Tarih*, I, fq. 525, Stamboll 1928 e.s.

295 *Netajixh*, II, fq. 78.

Ekspedita e sulltanit në Poloni

Me miratimin e osmanëve, Ukraina u nda midis Polonisë dhe Hanit të Kërëmit, dhe besnikëria e prijësit të Kozakëve, të quajtur "hatman", kalonte herë te Devleti Osman dhe herë te Polonia. Në këto vite, Franca, Britania, Holanda dhe Suedia ishin në procesin e kthimit në superfuqi. Për sa i përket Polonisë, ajo ishte ende më e fuqishme se Rusia, edhe pse jo aq e fuqishme sa kishte qenë më parë. Spanja dhe Venediku ishin gjithashtu drejt rënies, ndërsa ukrainasit ishin si rusët - ndjekës të Krishterimit Ortodoks, ndërsa polakët ishin Katolikë dhe synonin që t'i mbanin osmanët larg ndërhyrjeve në çështjet e Ukrainës. Divan-ë Hymajun i kishte dhënë **Hatman Dorosenkos** pjesën veri-perëndimore të Ukrainës dhe titullin Sanxhak-bej. Ai ishte vartës i Osmanëve dhe kishte marrë pjesë në ekspeditën kundër Austrisë (Gjermanisë) me 15.000 kalorës, nën drejtimin dhe komandën e Hanit të Kërëmit.

Pas sulmit të polakëve ndaj Dorosenkos, sulltani u nis me ushtrinë e tij kundër tyre në vitin 1082/1672. Ordu-ju Hymajun hyri në Poloni dhe pushtoi Kamanichen. Përfundimisht, në vitin 1083/tetor 1672, u lidh **Traktati i Buxhashit** me Poloninë sipas të cilit, mbreti i Polonisë do t'iu paguante osmanëve një tagër vjetor prej 22.000 dukatesh dhe se Podolja do t'iu dorëzonte osmanëve të gjitha kështjellat. Për më tepër, polakët duhet të largoheshin menjëherë nga Ukraina, që do të kalonte nën administrimin e **Hatman Dorosenkos**. Përfundimisht, Polonisë iu kërkua që t'iu paguante një tagër vjetore Hanëve të Kërëmit, që ishte caktuar që në kohën e Islam Gërajit në këmbim të premtimit se ata nuk do të ndërmerrnin asnjë sulm kundër Polonisë.²⁹⁶

Kopryly Fazëll Ahmed Pasha vdiq në vitin 1087/1676, dhe vendin e tij si sadrazam e zuri **Merzifonllu Kara Mustafa Pasha**.

296 *Netajixh*, II, fq. 79; *Uzunçarşılı, vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 424-425.

Ekspedita në Çehrin

Hatman Dorosenko deklaroi vartësinë e tij ndaj Rusisë, dhe planifikoi t'i jepte Çehrinin, që në atë kohë ishte kryeqyteti i Ukrainës. Për këtë arsye, ushtria osmane mbërriti në këtë vend, dhe u ndesh me një ushtri të përbërë nga 40.000 luftëtarë të fuqishëm rusë, nga të cilët 20.000 kishin hyrë në kështjellë. Megjithatë, kështjella u hap ndaj Islamit dhe ushtria ruse u tërhoq. Në vitin 1681, Devleti Osman lidhi një traktat paqeje me Rusinë sipas të cilit, Lumi Ozi (Dnjepër) u bë kufiri ndarës midis territoreve osmane dhe ruse.²⁹⁷

Rrethimi i dytë i Vjenës 1683

Pjesa më e madhe e popullsisë hungareze ishte katolike, ndërsa pjesa tjetër që jetonte në zonën qendrore të Hungarisë ishte ortodokse. Synimi i austriakëve që zotëronin këtë zonë ishte që ta kthente këtë minoritet në besimin e tyre katolik, dhe me kundërshtimin e këtij minoriteti, autoritetet austriake vranë, në vitin 1670, mbretin e tyre bashkë me disa princër të tjerë. Në shenjë proteste ndaj këtij akti, djali i mbretit, **Tokoli (Tököli) Imre**, u rebelua në vitin 1673 dhe u strehua si refugjat në Devletin Osman. Sadrazami **Merzifonllu Kara Mustafa Pasha** caktoi Bejlerbeun e Budinit, **Vezir Uzun Ibrahim Pashanë**, si kryekomandant të një ekspedite luftëtarësh që e kthyen **Tokoli Imrenë** në pushtet, në këmbim të një tagre vjetore prej 40.000 dukatesh. Në atë kohë, Devleti Osman ishte në kulmin e fuqisë së tij, ndoshta mund të quhej edhe "Superfuqia" Botërore. Statusi i Sadrazamit dhe i Shejhulislamit, nga ana protokollare, ishte i barabartë me atë të krerëve të shteteve evropiane me

297 Po aty, II, fq. 80. Mustafa Nuri Pasha, në këtë rast, na transmeton një bashkëbisedim midis sulltan Muradit I dhe vezirit të parë, Xhenderlei Halil Pashait, ku u vendos se një ekspeditë duhet të ndërmerrej vetëm nëse do të ishte e nevojshme, dhe nëse mundësia e një fitoreje do të ishte e madhe. Por, kjo nuk ndodhi në ekspeditën e Çehrinin, që Kara Mustafa Pashai e ndërmori për të provuar veten dhe për të siguruar postin e tij.

përrjashtim të statusit të Perandorit të Austro-Hungarisë. Kur mbretërit evropianë i dërgonin letra zyrtare sulltanit, ata i adresoheshin Sadrazamit dhe Shejhulislamit. Duke u ndjerë i lavdëruar dhe i vlerësuar nga **Reisul Kuttab Mustafa**, Sadrazami Kara Mustafa Pasha u nis drejt Vjenës në krye të një ushtrie shumë të madhe.²⁹⁸ Ky veprim ishte kundër këshillës së veteranit **Ibrahim Pasha**, që mendonte se përparimi drejt Vjenës duhet të ishte lënë për një kohë më të vonë, deri sa osmanët të merrnin gradualisht kështjellat që ishin përgjatë rrugës drejt saj, mendim ky, që ndante edhe **Tokoli Imre**.²⁹⁹ Rrethimi i Vjenës filloi më 1094/14 korrik 1683 dhe osmanët kapën rob 40.000 gjermanë gjatë rrugës së tyre, ndërsa akënxhinjtë dhe kalorësit e Kërëmit u shpërndanë në një territor të gjerë që ishte nën zotërimin e krishterë. Duke e lënë qytetin në duart e një gjenerali të aftë, Perandori i Austrisë u largua dhe u tërhoq në Pragë, ku u përpoq të mblidhte edhe ushtarë.³⁰⁰ “Faktikisht, Habsburgët kishin qëndruar mënjane me shpresën se do ta shmangnin një luftë të hapur me otomanët, ndërkohë që luftonin kundër francezëve në perëndim. Por, i ndikuar nga agjentët francezë, Kara Mustafai ishte i bindur se kishte ardhur koha e duhur për të marrë Vjenën, dhe të arrinte të merrte kështu atë, që sulltanët e tjerë nuk kishin mundur në të kaluarën.”

“Ndërkohë që një ushtri e madhe ishte mbledhur në Edrene, perandori krijoi një koalicion të ri evropian, që t’i bënte ballë këtij kërcënimi. Aleati i tij më i rëndësishëm ishte Jan Sobijeski i Polonisë. Papa Inocenti XI bëri thirrje për krijimin e një Kryqëzate të re kundër jobesimtarëve, duke shkuar aq larg sa t’i kërkonte ndihmë edhe Shahut të Iranit. Dhe, ndërkohë që opozita franceze anuloi pjesërisht efektet e thirrjes për ndihmë, ai ia doli të siguronte luftëtarë dhe para për Habsburgët nga

298 Silahdar, *vepër e cituar*, II, fq. 18-19.

299 Rashid, *vepër e cituar*, I, fq. 402.

300 *Netajixh*, II, fq. 82-83.

Portugalia, Spanja, Polonia, si dhe nga disa princër të Gjermanisë.”³⁰¹

Mustafa Pashai vendosi të mos ndërmerre një sulm masiv kundër Vjenës, sepse mendonte se qyteti do të dorëzohej pas një rrethimi që do të zgjaste për pak javë, pasi ai tashmë e kishte nënshtruar një herë një pjesë të madhe të perandorisë austriake, dhe në të njëjtën kohë, kërkonte të shmange plaçkitjen e paevitueshme të qytetit nga ushtarët osmanë. Por qyteti do të ishte marrë me sukses, nëse ushtria osmane do të ishte hedhur në sulm, ne vend që ta rrethonte qytetin për një kohë të gjatë.³⁰² Siç thotë dhe **Defterdar Sarë Mehmed Pasha**: “Nëse koha e rrethimit të një kështjelle i kalon 40 ditë, atëherë mundësia është e madhe që ajo të marrë ndihma nga jashtë. Rrethimi kishte vazhduar për më shumë se 50 ditë dhe ushtarët osmanë duhet të përshkonin largësi prej 15-20 orësh, për të gjetur bar për kuajt e tyre. Sadrazami duhet të kishte menduar më parë për sigurimin e ushqimit dhe ujit.”³⁰³

Mbreti polak **Jan Sobijeski** erdhi në mbështetje të Vjenës, në krye të një ushtrie të madhe të përbërë nga forca aleate, dhe **Mustafa Pasha** u detyrua ta ngrinte në 12 shtator rrethimin e tij që zgjati 2 muaj. Për pasojë, osmanët pësuan një disfatë të madhe, ku u vranë një numër i madh ushtarësh, dhe lanë pas dhe sasi të mëdha municionesh dhe pajimesh lufte,³⁰⁴ ndërsa kështjella Estergon ra në duart e austriakëve në nëntor të vitit 1683. **Mustafa Pasha** u ndëshkua duke u ekzekutuar në Beograd,³⁰⁵ edhe pse ai kishte fajësuar **Ibrahim Pashanë**, komandantin e krahut të djathtë të ushtrisë, që kishte qenë i pari që kishte pësuar humbje dhe e kishte dënuar atë me ekzekutim. Megjithatë, para se të ndodhte kjo, **Ibrahim Pasha** u kishte

301 S. Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 214.

302 Silahdar, *vepër e cituar*, II, fq. 93.

303 Defterdar Sarı Mehmet Pasha, *Zübde-i Vekayi'at*, (Tercüman 1001 Temel Eser, Stamboll: 1977), fq. 223.

304 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 453.

305 Silahdar, II, 121; *Netajixh*, II, fq. 84.

thënë ushtarëve të tyre: “Ky njeri (Mustafai) po më bën padrejtësi. Ai do të më ekzekutojë padrejtësisht. Megjithatë, thojni sulltanit të mos e ekzekutojë atë, pasi ai është njeriu “i vetëm” që mund ta rimarrë në dorë këtë situatë.”³⁰⁶

Politika e Kara Mustafa Pashait, i cili ishte padyshim një udhëheqës shumë i aftë, por kokëfortë dhe ambicioz, mund të ketë qenë një nga faktorët kryesorë për këtë disfatë. Megjithatë, kundërshtarët e tij në oborrin e sulltanit, shpejtuan të përfitonin nga krijimi i kësaj situatë kritike, duke ndikuar në vendimin që sulltani mori për ekzekutimin e tij. Edhe një herë thënia e Profetit (s.a.v.s): “Shmangni xhelozinë, sepse xhelozia i përpin veçoritë e mira, ashtu si zjarri përpin drurin” dëshmoi vërtetësinë. Por, ndoshta në këtë rast, është më i rëndësishëm fakti që zhvillimi islam duket se kishte filluar të rënnohej dhe ushtria e tij, arsyeja ekzistuese e së cilës ishte “të luftonte për Islamin”, po humbte gjithnjë e më shumë vlerat e saj. Gjatë rrethimit të Vjenës, një sjellje e turpshme dhe joislame kishte mbizotëruar midis ushtarëve. Këta ushtarë, madje, kishin konsumuar verë dhe kishin kryer tradhti bashkëshortore gjatë muajve të shenjtë.³⁰⁷ Sjellja shkatërrimtare, përbuzja dhe mendjemadhësia e tyre, gjatë rrethimit të Vjenës, ishte mjaft e ngjashme me sjelljen e ushtrive të krishtera të shekullit të 14-të. Një ushtri, që nënçmon mesazhin dhe misionin e saj dhe që shqetësohet më tepër për anën materiale dhe për kënaqësinë e paarsyeshme, është e caktuar të humbë.

Politika dashakeqe dhe mashtruese e qeverisë franceze ishte një faktor tjetër ndikues në disfatën dhe paaftësinë e osmanëve për t’u ringritur pas saj. Ishte Franca ajo që nxiti Kara Mustafa Pashanë të sulmonte Vjenën dhe që e tradhtoi aleatin e saj, Devletin Osman. Në këtë kontekst, Sho ka shkruar: “Luigji XVI e shfrytëzoi sulmin e otomanëve kundër Vjenës për të pushtuar Holandën spanjolle, në mënyrë që Habsburgët të mos

306 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 459.

307 Silahdar, II, fq. 91.

kishin mundësi të ndiqnin rrugën otomane të vitit 1683. Nëse Franca do të kishte vazhduar sulmin e saj, otomanët mund të kishin pasur mundësi të ringriheshin pas disfatës që pësuan në Vjenë. Por, ashtu siç kishte ndodhur shumë herë në marrëveshjet e otomanëve me Evropën, menjëherë pasi aleatët e tyre arrinin atë që dëshironin në përfundim, ata lidhnin një marrëveshje tjetër paqeje duke i braktisur otomanët.”³⁰⁸

Shfronësimi i sulltanit

Gjatë rinisë së tij, Sulltan Mehmedi IV kishte pasur nën shërbimin e tij asistentë të aftë, midis të cilëve ishte dhe Sadrazami Kopyryly Mehmed Pashai, si dhe disa vezirë të tjerë me autoritet të lartë nga kjo familje. Në këtë kohë, atij nuk iu mësua mjeshtëria e qeverisjes, por u rrit duke kaluar një jetë të lehtë dhe i pëlqente shumë gjuetia. Ulematë ia kujtuan atij disa herë se ishte e nevojshme të ishte serioz dhe të sillej mirë, por ai nuk i dëgjoji ata. Në këtë mënyrë, ushtria e pjesës evropiane të Devletit ngriti krye kundër tij. Ushtarët u afruan deri në Silivri, pranë Stambollit dhe kërkuan që ai të largohej (*hal*). Sadaret Kajmakamë (Zëvendës Sadrazami) Fazëll Mustafa Pasha thirri asamblenë e *Ehlu'l Hal-l vel Akd* (autoritetet religjioze), vezirë dhe pashallarë në Xhaminë Aja Sofja, në vitin 1098/1687, për të diskutuar këtë çështje. Ata vendosën ta shfronësonin sulltanin, dhe shkuan drejt pallatit të tij për t'i dhënë *bejatin* (betimin e besnikërisë sipas parimeve islame) Sylejmanit. Mehmedi u burgos dhe vdiq pas 5 vitesh në Edrene. Ai u dërgua më pas në Stamboll dhe u varros në tyrben e Bahçekapësë.³⁰⁹

Çështjet financiare

Devleti Osman ishte i pasur dhe i begatë gjatë sundimit të Muradit III. Përkundër luftërave të trashëgimtarëve të tij me Austrinë dhe Iranin, financat e Devletit ishin të qëndrueshme.

308 S. Shaw, *vepër e cituar*, fq. 217.

309 *Netajixh*, II, fq. 87.

Veçmas shpenzimeve për këto luftëra, Ahmed I mundi të përballonte shpenzimet e shumta për ndërtimin e xhamisë së tij dhe disa ndërtesave të tjera rreth saj. Por, me ardhjen në fronin osman të Mustafait, në vitin 1026/1617, gjendja financiare filloi të përkeqësohej. Kjo u shkaktua pjesërisht nga paqëndrueshmëria politike me zëvendësimin e tij vetëm pas 3 muajsh nga Genç Osmani, dhe më pas, ringjitja pas një periudhe tjetër 4-vjeçare, pas së cilës Muradi IV u bë sulltan, që do të thotë se Devleti Osman pati katër ndërrime sovranësh, brenda pesë vitesh. Për çdo ardhje në fron, ushtarëve u jepeshin “dhurata”, ndërkohë që nëna e Mustafait shpenzoi një shumë të madhe parash për komandantët ushtarakë, në mënyrë që të siguronte qëndrimin në fron të djalit të saj. Devleti u bë aq i pashpresë, sa që sulltan Muradi IV u detyrua të shkrinte sendet prej floriri dhe argjendi të pallatit, si dhe të merrte para hua nga disa tregtarë për t’iu dhënë “grantin për ardhjen në fron” jeniçerëve dhe spahinjve. Megjithatë, Muradi IV arriti ta kalonte këtë situatë deficitare, duke kufizuar numrin e ushtarëve jeniçerë dhe spahinj të ushtrisë osmane. Por aty nga fundi i shekullit të 17-të, zyrtarët e lartë filluan t’i emëronin në krye të timareve dhe zeameteve ata që iu jepnin atyre tarifin më të larta. Kjo shkaktoi një përkeqësim të rëndë në radhët e ushtarakëve. Për më tepër, një numër i madh personash të pakualifikuar filluan të pranoheshin në trupën e ushtarëve jeniçerë, për shkak të nepotizmit dhe korrupsionit. Si rezultat, Devleti Osman u detyrua t’iu paguante shumën të mëdha parash, një numër të madh njerëzish, nga të cilët pjesa më e madhe madje nuk ishte as profesioniste. Përkeqësimi i sistemit *timar*, në shekullin e 17-të, ishte një arsye tjetër që ndikoi në rënien e ushtrisë, pasi ata që merrnin drejtimin e timarit në mënyrë të paligjshme, ishin të paaftë, ose nuk kishin vullnetin e mirë që të rekrutonin ushtarët e duhur për luftë. Madje, ata arritën t’iu paguanin ryshfete disa bejlerbejve për të mos marrë pjesë në fushatat e luftës. Kjo rënie, në aspektin financiar dhe ushtarak, u vendos për një kohë të shkurtër nën kontrollin e Sadrazamit Kemankesh (Harkëtar)

Mustafa Pasha, i cili arriti të grumbullonte një sasi të mirë parash për thesarin e Devletit. Por pas tij u rikthye një situatë e paqëndrueshme financiare, dhe numri i ushtarëve në qendrën e ushtrisë u rrit sërish. Kopyryly Mehmed Pasha arriti ta përmirësonte edhe një herë situatën financiare dhe gjatë 30 viteve që do të pasonin, që do të thotë deri para disfatës së Vjenës të vitit 1683, financat e Devletit Osman ishin të qëndrueshme, pasi të ardhurat që mblidheshin nga eksporti (i grurit dhe mallrave të tjera) ishin të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e importit të limituar të mallrave nga Evropa (p.sh. sahate, sheqer etj.) gjatë shekullit të 17-të.³¹⁰ Megjithatë, korruptimi i zyrtarëve të lartë sillte herë pas herë deficite të buxhetit, siç është evidentuar edhe në një raport të përgatitur nga shtetari i famshëm Tarhunxhu.³¹¹

11.3 Sulltan Sylejmani II 1687-1691

Sulltan Sylejmani u përrua në vitin 1098/1687 tek tyrbja e Ejub Sulltanit,³¹² por vetëm një vit pas ardhjes së tij, austriakët morën Erdelin, Beogradin dhe kështjellat Ujvar dhe Egri. I gjendur para një situatë të vështirë, sulltani i ri emëroi **Fazëll Mustafa Pashanë** si Sadrazam në vitin 1100/1689, i cili kufizoi taksat për popullin, për shkak të luftërave të vazhdueshme dhe amendoi disa ligje si masë parandaluese ndaj kryengritjeve të mundshme të popullit të krishterë, që jetonte në territorin osman, që mund të nxitej nga austriakët dhe venedikasit.³¹³ Gjithashtu, në vitin 1101/1690, ai rimori Nishin, Semendiren dhe Beogradin.³¹⁴ **Sulltan Sylejmani II** ishte shumë i kënaqur nga fitoret që arriti *Serdar-ë Ekrem* (titull që iu dha Sadrazamit në xhihadin kundër jobesimtarëve, që do të thotë kryekomandanti më i nderuar). Në shenjë vlerësimi, sulltani hoqi gëzofin,

310 Po aty, II, fq. 99.

311 Po aty, II, fq. 100.

312 Rashid, *vepër e cituar*, II, fq. 21.

313 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 523.

314 Po aty, III, pjesa I, fq. 527.

kamën dhe kurorën e tij, dhe ia dha Sadrazamit e më pas u lut i përplotur për të.³¹⁵

Kur **Fazëll Mustafa Pasha** arriti të zmbrapste austriakët tej Danubit, ai e trajtoi *rajen* në këtë vend me njerëzi dhe bujari. Ai u dha atyre grurë, liroi të burgosurit e luftës dhe arriti të bindte emigrantët muslimanë të atyre zonave, të riktheheshin. Në këtë mënyrë, osmanët rifituan me sukses zonat kufitare.

11.4 Sulltan Ahmedii II 1691-1695

Sulltan Sylejmani II vdiq në Edrene, në vitin 1102/1691, dhe vendin e tij e zuri vëllai i tij, Ahmedii.³¹⁶ Pak para ardhjes së tij në fron, Serdar-i Ekrem, **Fazëll Mustafa Pasha**, ishte në krye të betejës kundër ushtrisë austriake në Salankamen. Ushtria osmane do të kishte fituar nëse udhëheqësi i tyre nuk do të kishte marrë plagë të rënda, ndërkohë që iu jepte kurajë ushtarëve të tij për të luftuar. Me martirizimin e tij, rrjedha e betejës ndryshoi krejtësisht dhe ushtria osmane u tërhoq duke marrë me vete Sanxhak-ë Sherifin (Flamurin e Profetit), por duke lënë në fushën e betejës armë dhe municione. Megjithatë, austriakët nuk guxuan t'i ndiqnin osmanët, edhe pasi Mustafa Kaptani kishte marrë në lumin Danub, 800 anije të tyre plot me grurë dhe municione.³¹⁷

Pra, Fazëll Mustafa Pasha kishte arritur një sukses të rëndësishëm, dhe mund të kishte rivendosur edhe fuqinë dhe dinamikën e mëparshme të Devletit Osman, nëse do të kishte arritur të jetonte disa vite më shumë. Ndërkohë, Sulltan Ahmedii II u nis me Ordu-ju Hymajun drejt Austrisë, por nuk arriti t'i gjente austriakët dhe u detyrua të kthehej në vitin 1104/1692 për të riparuar kështjellën e Beogradit. Në vitin 1693, Sadrazami Bozokllu Mustafa Pasha drejtoi ushtrinë osmane drejt Rusçkut, dhe më pas drejt Beogradit, ku ai i detyroi

315 Po aty, fq. 530.

316 *Netajixh*, III, fq. 7.

317 *Uzunçarşılı, vepër e cituar*, III, pjesa I, fq. 535.

austriakët ta ngrinin rrethimin e tyre nga vendi dhe të tërhiqeshin në bregun tjetër të lumit Danub. Ai u pasua në këtë post nga **Syrmeli Ali Pasha**, i cili rrethoi në vitin 1105/1694 ushtrinë austriake, që për të shpëtuar, u strehua në kështjellën Varadin për 22 ditë. Por më pas ai u detyrua të ngrinte rrethimin dhe të kthehej për shkak të një rrebeshi shiu të vazhdueshëm. Ndërkohë, në 1105/1694, flota venedikase kishte sulmuar dhe pushtuar ishullin Sakëz që ndodhej përballë Izmirit. Osmanët kishin filluar përgatitjet për rimarrjen e këtij ishulli, kur sulltani vdiq në vitin 1106/1695.³¹⁸ Ai u pasua nga Mustafa II, djali i Mehmedit IV.

11.5 Sulltan Mustafai II 1695-1703

Gjatë periudhës së sundimit të Mustafait II, osmanët rimorën ishullin Sakëz nga venedikasit. Në vitin 1695, Sulltan Mustafai II drejtoi Ordu-ju Hymajunin në Beograd, ndërkohë që austriakët u mblodhën në Erdel (Transilvani). Ai kaloi lumin Danub në Pançova (Pançevë) dhe u ndesh në Sis me trupën kryesore të ushtrisë austriake nën drejtimin e **Gjeneralit Veterani**. Muslimanët e mundën armikun dhe shkatërruan kështjellën e Sisit dhe atë të Lugosit,³¹⁹ por ushtria austriake mbloidi forcat e saj, dhe nën drejtimin e Princit Sakson rrethoi Tameshvarin. Sulltan Mustafai II u nis dhe një herë drejt tyre, duke kaluar nga Beogradi për në Pançova, ku dogji dhe 4 anije austriake në Danub. Duke u tërhequr nga Tameshvari, forcat austriake u përpoqën të zinin në pusi Ordu-ju Hymajunin në një shteg të ngushtë, por ata dështuan në këtë përpjekje të tyre duke humbur 15.000 luftëtarë. Për një kohë të shkurtër Ordu-ju Hymajuni i ndoqi pas, por si përfundim, u kthye në bazë. Rusët përfituan nga angazhimi osman në rajonin e Mesdheut, gadishullin e Moresë, Hungari dhe Poloni për të marrë kështjellën

318 *Netajixh*, III, fq. 10.

319 *Po aty*, III, fq. 11.

Azak, në vitin 1108/1696, ndërkohë që polakët rrethuan disa herë kështjellën e Kamanisches, por nuk arritën ta merrnin atë.³²⁰

Në vitin 1108/1697, Sulltan Mustafai II u nis me Ordu-ju Hymajun për një fushatë të tretë, por ndërkohë që ushtria po kapërcente lumin Tisa në Zanta, ura ra dhe vetëm 1/8 e ushtrisë arriti të kalonte në bregun e përtejme, ndërsa pjesa tjetër së bashku me sulltanin mbetën pas. Megjithatë, **Sadrazami Elmaz Mehmed Pasha** së bashku me disa pashallarë dhe me rreth 10 bejlerbejë u ndesh me austriakët në një luftim të ashpër, duke pasur vetëm pak ushtarë në dispozicionin e tij, luftim në të cilin ata ranë martirë, pasi i shkaktuan armikut humbje të rëndë. Sulltan Mustafai, që nuk arriti të merrte pjesë në këtë betejë, u kthye në Tameshvar, por austriakët nuk guxuan ta ndiqnin atë nga pas, duke u tërhequr në Erdel (Transilvani). Sulltani emëroi Sadrazamin e ri **Amxhazade Hysejin Pashanë**. Amxhazade, mbrojtësi i mëparshëm i kështjellës së Beogradit, ishte një gjeneral me përvojë që i njihte mirë austriakët. Ai kishte shprehur kundërshtimin e tij ndaj përparimit në masë të ushtrisë osmane, duke thënë gjatë asamblesë së Divanit: “Zakoni i austriakëve është të na sulmojnë ndërkohë që ne kalojmë mbi lumë, apo kur ne jemi duke ngritur kampet e luftës për t’u larguar. Është e nevojshme të kalojmë mbi disa lumenj të gjerë, për të arritur në Tameshvar dhe nuk është mirë që të avancojmë në atë drejtim, me një ushtri kaq të madhe: Sulltani le të qëndrojë në Beograd, dhe ne të dërgojmë njësi të vogla ushtarake për të sulmuar territorin austriak. Austriakët do të jenë të detyruar ta ndajnë ushtrinë e tyre në njësi të vogla dhe në këtë mënyrë ata do të lodhen.”³²¹ Nëse osmanët do të kishin dëgjuar këshillën e tij, ushtria e tyre nuk do të kishte pësuar humbje të mëdha. Vezirët si duket kishin ndarë të njëjtin mendim me të, por ata e kishin injoruar dukshëm atë, për arsye smire ndaj këtij konkurrenti të suksesshëm Sadrazam. Në mënyrë që të arrinin turpërimin dhe

320 Po aty, III, fq. 12.

321 Rashid, *vepër e cituar*, II, fq. 407-412.

dështimin e tij të plotë, vezirët e devshirmesë³²² e nxitën atë të ndërmerre vendimin fatal për të avancuar dhe për të kaluar disa lumenj. Nga shekulli i 17-të, zelli dhe angazhimi i elitës osmane në emër të çështjes dhe mesazhit të Islamit, fatkeqësisht kishte filluar të binte dukshëm. Megjithatë, mund të argumentojmë në mënyrë të arsyeshme se Devleti Osman vazhdonte të ishte i fuqishëm, pasi vazhdonte të ishte në drejtimin e xihadit në 4 fronte kundër armiqve të fuqishëm. Austriakët të cilët u detyruan të luftonin kundër francezëve në disa beteja, nuk arritën një fitore vendimtare në luftën e tyre kundër osmanëve, dhe për këtë arsye ishin në favor të vendosjes së paqes me ta. Venediku arriti disa fitore të suksesshme në gadishullin e Moresë, por flota e tyre ishte mundur nga osmanët disa herë në rajonin e Mesdheut.

Gjatë luftës së tyre 15-vjeçare me osmanët, polakët rrethuan disa herë kështjellën e Kamaniçes, por nuk arritën ta pushtonin atë, dhe Kalorësia e Kërëmit e kishte plaçkitur në mënyrë të vazhdueshme dhe i kishte shkaktuar dëme të rënda popullsisë. Për sa i përket rusëve, ata morën kështjellën e Azakut, edhe pse ata pretendonin se kishin marrëdhënie miqësore me Devletin Osman.

Nga fundi i shekullit të 17-të, Devleti Osman ishte i aftë të luftonte ende me një farë suksesi kundër 4 shteteve të fuqishme. Por shpenzimet e mëdha, për shkak të luftërave, e detyruan të vendoste taksa të rënda mbi popullsinë. Megjithatë, me kalimin e kohës osmanët u dukën se i kishin humbur shpresat për të rimarrë tokat që kishin humbur nga këta 4 armiq të krishterë të fuqishëm.³²³

322 Fëmijë të krishterë të marrë për t'u rritur sipas mënyrës së jetesës islame.

323 Netajixh, III, fq. 15.

PJESA E TRETË

RËNIA

1699-1922

KAPITULLI 12

12.1 RIFILLIMI I RËNIES

Sulltani Mustafa ishte tepër i zënë me gjueti në Edrene, dhe nuk angazhohej sa duhej për të kryer detyrat e tij në një mënyrë të drejtë dhe të mjaftueshme. Kjo bëri që në vitin 1115/1703, ushtarët dhe një pjesë e popullsisë t'i drejtoheshin Edrenesë në shenjë proteste ndaj tij dhe për ta zëvendësuar atë me të vëllain, Ahmedin. Sulltan Mustafai e kaloi pjesën tjetër të jetës në vetmi, i mbyllur në pallat,¹ derisa vdiq nga një sëmundje fatale, dhe u varros në tyrben e tij në Stamboll.²

Shekujt e parë të historisë së Devletit Sublim Osman ishin karakterizuar nga qëndrueshmëria administrative. Guvernatoret e provincave qëndronin në detyrën e ngarkuar për një kohë të gjatë, nga 10 deri në 20 vjet, dhe ishin për këtë arsye të aftë të kryenin detyrat e tyre me profesionalizëm. Por, me kalimin e kohës dhe me fillimin e rënies së pushtetit qendror, ata filluan të qëndronin për një periudhë kohe më të shkurtër në detyrë, që rrallë arrinte 3 deri në 5 vjet. Kjo paqëndrueshmëri u shoqërua me ryshfete dhe korrupsion. Në këtë mënyrë, Devleti, edhe kur ishte në kulmin e lulëzimit të tij, ishte mbartës i farës së rënies dhe keqësimit. Megjithatë, deri në shekullin e 17-të, ai vazhdoi të ishte mjaft i fuqishëm për të hapur ndaj Islamit territore të reja të tilla si: Kretën, Uxhvarin, Kanixhen, Podoljen dhe Ukrainën. Kjo u arrit më tepër për shkak të faktit,

1 S. Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, I, fq. 228.

2 Mustafa Nuri Pasha, *Netayicu'l Vukuat*, Stamboll 1327 H, III, fq. 19.

se çështjet fiskale, ushtarake dhe administrative, veçanërisht ato në qendër të Devletit, iu besoheshin ende personave të aftë. Si fillim, fëmijët e *devshirmesë* merrnin një edukim të mirë që në vegjëlinë e tyre të hershme, dhe më pas dërgoheshin jashtë kryeqytetit, për të ndihmuar guvernatorët dhe për të punuar krah tyre, në mënyrë që të fitonin përvojë në fushën administrative dhe atë ushtarake, që i kualifikonte ata si vezirë të aftë. Por, ky rregull filloi të shpërfilllej gjithnjë e më shumë, gjatë shekullit të 17-të, dhe pjesa më e madhe e tyre arritën të vendoseshin në poste të larta, në sajë të nepotizmit dhe intrigave, dhe jo për arsye të meritës së tyre personale. Ata kërkonin më tepër kënaqësinë, dhe bënë një jetë të shkujdesur. Rezultati i kësaj ishte dështimi administrativ dhe ushtarak, edhe pse disa drejtues të aftë arritën të gjenin rrugën e tyre deri në pushtet, dhe të ndalonin këtë situatë të çrregullt.³ Në këtë drejtim, situata në Devletin Osman Musliman, në shekullin e 17-të, ishte në mënyrë të habitshme e ngjashme me situatën në Spanjën e krishterë: “Në vitet 1600, Spanja, që kishte qenë një nga vendet më të fuqishme në Evropë, filloi të pësonte humbje të mëdha nga shpenzimet e luftës, si dhe të kishte një shërbim administrativ të fryrë dhe përhapje të korrupsionit. Nga fundi i shekullit të 17-të, të ardhurat mbulonin vetëm gjysmën e shpenzimeve të shtetit... Zhvlerësimet e vazhdueshme monetare, rritja e inflacionit dhe barra e një takse vrasëse e rrënuan industrinë dhe bujqësinë e Spanjës. Për pasojë, si një vend i varfëruar, Spanja e humbi influencën në rang global, pasi perandoria përfundoi në një copëz të fragmentizuar krahasuar me përmasat që kishte më parë.”⁴

3 *Netajixh*, II, fq. 89-90.

4 Harry E. Figgie Jr. dhe Gerald J. Swanson, *Bankruptcy 1995: The Coming Collapse of America and How to Stop It*, Nju Jork dhe Toronto: Back Bay Books: 1993, fq. 146.

12.2 Sulltan Ahmedi III 1703-1730

Sulltan Ahmedi III erdhi nga Edreneja në Stamboll ku rivendosi ligjin, por ai u detyrua t'iu jepte ushtarëve, të cilët e sollën në pushtet, fondin më të madh që mund të kishte paguar një sulltan për vendosjen e tij në fron. "Ushtarët e tjerë, që nuk kishin marrë pjesë në revoltë, filluan të kërkonin vlerësim dhe pagesë të barabartë për marrjen e pushtetit prej tij. Ata u mblodhën në Silivri, pranë Stambollit, me qëllimin që të rrëzonin familjen osmane dhe ta zëvendësonin atë me një princ nga familja e Hanit të Kërëmit, ose, ndoshta me një pasardhës nga lidhja martesore e Sokollu Mehmedit me vajzën e Selimit II, një linjë që vazhdoi edhe gjatë shekullit të 18-të."⁵ Por, sulltani arriti ta shtypte këtë rebelim të ushtarëve dhe e vendosi situatën nën kontroll.⁶

Beteja e Prutit 1711

Duke qenë se rusët kishin ndërtuar disa kështjella jashtë Orit, portës së Krimesë, osmanët morën guximin të ndërtonin *Jeni Kalenë* (Kështjellën e Re) në bregun e Detit Azak, në mënyrë që t'ua bllokoni atyre hyrjen në Detin e Zi. Në atë kohë, **Cari rus**, **Petër**, dhe Mbreti i Suedisë, **Karli XII** (sundoi 1697-1718), ishin të angazhuar në një luftë të ashpër kundër njëri-tjetrit, ku ky i fundit e humbi betejën dhe u plagos në Poltava, në vitin 1709. Ai u tërhoq në Bender, që ishte një qytet kufitar osman, por rusët e shkelën marrëveshjen e kufirit dhe e ndoqën atë nëpër qytet, duke i shkaktuar dëme të mëdha popullsisë. Për pasojë, *Ordu-ju Hymajun* u dërgua për t'u përballur me **Carin Petër**, nën drejtimin e Sadrazamit **Balltaxhë Mehmed Pashait**, ndërkohë që edhe *Donanma-jë Hymajun* u nis drejt Detit Azak. *Ordu-ju Hymajun* arriti të kalonte lumin e Prutit duke ndërtuar ura kalimi mbi të, edhe pse ushtria ruse u përpoq t'i

5 S. Shaw, shiko poshtë-shënimin 1.

6 *Netajixh*, III, fq. 19.

ndalonte ata në vitin 1123/1711. Ushtria osmane rrethoi ushtrinë ruse, ndërkohë që Hani i Krimesë ua preu rrugën rusëve që po tërhiqeshin.

Cari Petër u tërhoq në cepin e tendës së tij për shkak të situatës së pashpresë. **Marta Rabe**, që më vonë do të bëhej Perandoresha e Rusisë, me emrin **Katerina I**, organizoi një mbledhje me gjeneralët e ushtrisë ruse dhe i bindi ata të dorëzoheshin, duke iu thënë se nuk kishte asnjë rrugëzgjdhje tjetër. Më pas, ajo mori të gjitha paratë dhe stolitë e saj, duke shtuar këtu dhe një shumë parash të marra hua nga të tjerë, mblodhi një shumë prej 200.000 rublash, dhe ia dërgoi këtë shumë *Serdar-ë Ekremi*t (Kryekomandantit) Osman, duke i kërkuar atij vendosjen e paqes. Pretendimi se Katerina shkoi personalisht te Veziri i Madh Balltaxhë Mehmed Pasha, nuk duket i logjikshëm, dhe pretendimi se paratë bashkë me stolitë e saj u përdorën si ryshfet, është gjithashtu i pabazë, pasi ishte një traditë e kohës që dhurata të tilla t'iu dërgoheshin komandantëve fitimtarë.

Kur delegatët rusë mbërritën, **Balltaxhë Mehmed Pasha** organizoi një mbledhje me komandantët dhe dinjitarët në radhët e ushtrisë osmane. Ata diskutuan mbi propozimin e rusëve për paqe dhe vendosën që rusët duhet t'i pranonin të gjitha kërkesat e osmanëve. Komandantët dhe zyrtarët osmanë e pranuan propozimin e rusëve; arsyeja ishte se ata nuk kishin besim në veprimin e suksesshëm të ushtrisë osmane, pasi, një ditë më parë, ajo, për disa çaste, ishte tërhequr për shkak të zjarrit të furishëm që artileria ruse kishte hapur kundër tyre, edhe pse rusët nuk e kishin vënë re këtë veprim të osmanëve, për shkak të muzgut që kishte filluar të binte.⁷ “Themeluesi i Rusisë Moderne dhe ushtria e tij ishin dorëzuar plotësisht dhe gjendeshin në mëshirën e otomanëve. Ndërkohë që artileria otomane godiste kampin e Carit, duke i shkaktuar humbje të rënda, rusët

7 Ismail Hami Danişmend, *İzahlı Osmanlı Tarihi Kronolojisi*, Stamboll, 1972, vëllimi IV, fq. 3-4.

po vuanin gjithashtu edhe nga mungesa e ushqimeve dhe nevojave të tjera. Me situatën e krijuar, në të cilën rusët ishin nën mëshirën e tij, dukej sikur veziri i madh mund të kërkonte të arrinte dorëzimin e tyre pa kushte, marrjen e një territori të gjerë dhe përfitime të tjera. Por, edhe ai po përballej me probleme serioze. Ushtria e tij kishte mungesa furnizimesh për të vazhduar luftën, dhe nuk ishte e sigurt nëse tatarët do t'i qëndronin besnikë, apo nëse rusët do të sillnin përforcime nga veriu."⁸ Pas bisedimeve të gjata, u vendos që rusët të shkatërronin të gjitha kështjellat që kishin ndërtuar pas Traktatit të Karlovicit, si dhe t'iu kthenin osmanëve kështjellën e Azakut. Gjithashtu, u vendos si kusht që rusët nuk do të ndërhyjnë në çështjet e Kazakëve, që ishin nën kontrollin e Hanit të Krimesë dhe Polonisë, si dhe të bënin të mundur kthimin e sigurt në vendin e tij, në Suedi, të Mbretit Karl. Rusëve iu kërkua edhe që të largonin nga Stambolli ambasadorin e tyre, si dhe t'i paguanin tagër vjetor Hanit të Krimesë që ishte një detyrim i vendosur më parë.⁹

Sulltan Ahmedi II e ktheu **Karlin XII**, në vendin e tij, bashkë me disa dhurata të çmuara¹⁰ dhe 10.000 dukate për shpenzimet e rrugës. Mbreti i Suedisë dhe Hani i Krimesë nuk ishin të kënaqur me këtë traktat paqeje, dhe dëshironin që ushtria ruse të shkatërrohej në Prut, por osmanët ishin të kënaqur me koncesionet që kishin marrë nga rusët, pasi ata ishin të ndërgjegjshëm, për faktin që ushtria osmane nuk luftonte më, ashtu sikurse kishte luftuar dikur, dhe se rënia e saj kishte filluar. Në aspektin e aftësisë luftarake të ushtrisë, situata nuk

8 Stanford Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, I, fq. 230. Shaw duket se harron se Hani Tatar i Krimesë, Devlet Gërâji, ishte i mendimit se ushtria ruse duhej të shkatërrohej plotësisht, dhe se besnikëria e tij nuk kishte pse të diskutohej. Ardhja e përforcimeve për rusët nga veriu nuk ishte e mundur, sepse Kalorësia e shkëlqyer e Krimesë kishte bllokuar rrugën e tyre. Për këtë arsye, Shaw ka gabuar në këto dy pika.

9 OT, IV, pjesa I, fq. 85.

10 *Netajixh*, III, fq. 23-24.

ishte aq e mirë nga ç'dukej. Por, nga ana tjetër, uria kishte filluar të mbizotëronte në radhët e ushtrisë ruse. Ushtarët rusë kishin arritur në një gjendje të tillë, që hanin gjethe dhe lëvoret e pemëve, pasi i kishin mbaruar të gjitha furnizimet me ushqime. **Gjenerali** suedez, **Poniatovski**, i këshilloi ata të mos e sulmonin ushtrinë ruse, por të prisnin dorëzimin e saj, këshillë kjo që nuk u zbatua.¹¹ Njerëzit e oborrit osman patën ndikim në këtë vendim dhe ata nuk arritën ta vlerësonin në mënyrën e duhur situatën. Osmanët kishin qenë luftëtarë të mirë në fushën e betejës, por ata ishin në përgjithësi humbës të mëdhenj në tryezën e bisedimeve.

Lufta me Austrinë

Ndërkohë erdhi lajmi se disa anije muslimane të humbura në Mesdhe ishin sulmuar nga korsarët venedikas. Ndërsa popullsia e Moresë ishte Ortodokse, dhe tani që gjendej nën sundimin katolik të venedikasve, ishte pro osmanëve. Në atë kohë, Karadagu (Karadağ) (Mali i Zi – v.p.) u revoltua kundër Devletit Osman, por **Koprylyzade (Köprülüzade) Numan Pasha**, valiu i Bosnjës e shtypi këtë revoltë.

Venedikasit i strehuan rebelët e Karadagut osman. **Sadr-azami Ali Pasha** marshoi drejt Moresë, dhe në të njëjtën kohë edhe *Donanma-jë Hymajun* u nis drejt saj. Gadishulli i Moresë u rihap ndaj Islamit bashkë me disa qytete të tjera në vitin 1127/1715. Morea u nda në 1400 rrethe si "*këllëç timarë*" dhe **Ajdënlle Mehmed Agai** u caktua zyrtar i lartë i Moresë.¹²

Ali Pasha dërgoi një letër drejtuar austriakëve, për të siguruar asnjansinë e tyre, kur ai të ishte i angazhuar në luftën me Venedikun, duke u shpjeguar atyre se venedikasit kishin shkelur kushtet e Traktatit të Karlovcit. Por, austriakët ishin të ndërgjegjshëm për faktin që osmanët kishin rimarrë Morenë, që iu ishte lënë venedikasve sipas Traktatit të Karlovcit, dhe men-

11 OT, IV, pjesa I, fq. 89, Ankara 1995.

12 OT, IV, pjesa I, fq. 99-107.

donin se kishte ardhur radha e tyre për të humbur atë që kishin fituar nga i njëjti traktat. Austria kishte nënshkruar **Traktatin e Rashadit** me Francën, në vitin **1723**, pas luftërave të trashëgimisë, dhe dëshironte të fitonte kohë që të përgatitej për luftë kundër osmanëve. Ata kishin mbajtur të burgosur për 4 muaj të dërguarin osman, dhe më pas e kishin kthyer atë mbrapsht bashkë me një letër.

Austria nënshkroi një traktat me Venedikun më 15 prill 1716, dhe i dërgoi një letër Devletit Osman, në të cilën shkruhej se Morea duhej t'i jepej Venedikut.¹³ Për këtë arsye, **Sadrazami Ali Pasha** u hodh në luftë kundër tyre, në betejën e Petervaradinit në vitin 1128/1716, gjatë të cilës ai mori plagë fatale. Jeniçerët, pasi sulmuan trupat austriake dhe morën një pjesë të topave të tyre, u tërhoqën menjëherë në Beograd, pasi morën lajmin e martirizimit të Sadrazamit dhe shkatërrimin e krahut të djathtë të ushtrisë osmane.¹⁴ Austriakët nuk i ndoqën pas trupat osmane, por kapërcyen lumin e Danubit në jug, morën Timishoarën pas 3 muajsh rrethimi, dhe vazhduan avancimin e tyre drejt Beogradit, të cilin e rrethuan në vitin 1129/1717. **Sadrazami Halil Pasha** u përpoq ta shpëtonte qytetin, por nuk arriti, dhe përfundimisht Beogradi ra në duart e austriakëve në vitin 1129/1717.¹⁵

Në betejën e Petervaradinit, **Sadrazami** i ri **Nevshehirli Ibrahim Pasha** (1717-1730) ishte dëshmitar i paraqitjes së dobët të ushtarëve jeniçerë dhe u bind se ata ishin shumë të korrup-tuar për të luftuar kundër Austrisë. Për këtë arsye, ai propozoi nënshkrimin e menjëhershëm të traktatit të Pasarovicit (Porofës), në vitin 1130/1718, sipas të cilit osmanët i dorëzuan Timishoarën dhe Beogradin Austrisë, si dhe disa vende të tjera në Adriatik venedikasve.¹⁶ Megjithatë, Veziri i Madh Nevshehirli Ibrahim Pasha arriti t'i përmirësonte financat e Devletit, dhe

13 OT, IV, pjesa I, fq. 110-111.

14 Rashid, *vepër e cituar*, IV, fq. 263.

15 *Netajixh*, III, fq. 26.

16 Rashid, *Tarih*, Stamboll: 1282 H, V, fq. 20.

pati një sukses të veçantë në uljen e shpenzimeve vetëm brenda pak vitesh. Por, nisma e tij për organizimin e *Lale Devri* luksoz (periudha e festivaleve të tulipanëve) i nxiti njerëzit që të ngriheshin në revoltë kundër vezirit të madh, që përfundoi dhe me vdekjen e tij, në vitin 1143/1730.¹⁷

Lufta me Persinë

Në vitin 1135/1723, afganët ngritën krye kundër Safevitëve, morën Isfahanin dhe rrëzuan një herë e përgjithmonë sundimin e Safevitëve në Persi. Ky akt i nxiti Emirët Sunnitë të **Dagestanit** (në rajonin verior të Kaukazit) që të betoheshin për besnikëri ndaj Devletit Osman, që, nga ana e tij, caktoi njërin prej tyre, **Davudin**, si Han të **Shirvanit**. Ushtria osmane mori Tibilisin dhe emëroi Hanin **Shenevar** në drejtimin e tij, si dhe në drejtimin e Hemedanit, Revanit, Ganxhes dhe Tebrizit.¹⁸

Sadrazami Ibrahim Pasha emëroi shumë nga të afërmit e tij në pozicionet kyçe të Devletit. Ky nepotizëm e nxiti popullin të ngrihej në revoltë dhe ta rrëzonte Sulltan Ahmedin III në vitin 1143/1730. Mahmudi e trashëgoi fronin si Sulltani i ri osman.¹⁹

17 *Netajixh*, III, fq. 31.

18 *Netajixh*, III, fq. 29.

19 *Netajixh*, III, fq. 32.

KAPTULLI 13

PËRPPJEKJA PËR RINGRITJE

13.1 Sulltan Mahmudi 1730-1754

Ndërkohë *valiu* i Bagdadit Osman, **Ahmed Pasha**, mundi Shahun e Persisë, **Tahmasbin**, dhe e detyroi atë të kërkonte paqen. Por, **Nadir Aliu**, kryetari i fisit afshar, kundërshtoi çdo lloj kompromisi me osmanët, rrëzoi Tahmasbin nga posti i tij dhe e zëvendësoi atë me të birin, që në atë kohë ishte fëmijë, ndërkohë që u vetëmërua regjent, në mungesë të një personi të aftë apo të pjekur në moshë. Ai u nis për të rrethuar Bagdadin, por **Topall Osman Pasha**, *valiu* Osman i Erzurumit, e mundi ushtrinë perse në një betejë që u zhvillua në vitin 1146/1733. Persianët u shpërndanë dhe komandanti i tyre u plagos dhe u tërhoq. Më pas, Nadir Aliu përfitoi nga sëmundja e Osman Pashait për t'u rikthyer dhe për ta mundur ushtrinë osmane në Kirkuk. Ai mundi pranë Revanit **Koprylyzade Abdullah Pashanë** dhe në vitin 1148/1736, zuri vendin e Shahut të Persisë me kërkesë të disa dinjitarëve të vendit.²⁰

Lufta me Rusinë

Pasi rusët i kthyen Persisë kështjellën e Derbendit dhe disa vende të tjera, lidhën një traktat me të kundër osmanëve. Ky ishte një veprim i zgjuar nga ana e rusëve. Duke i dhënë Persisë disa avantazhe të vogla, Rusia arriti të siguronte kalimin e

20 *Netajixh*, III, fq. 33-34.

Persisë në anën e saj, në luftën kundër Devletit Musliman Osman. Por kjo ishte dhe një tradhti nga ana e Persisë, një tradhti që nuk mund të kapërcehej lehtë, për ata që e kishin kryer. Me anë të këtij traktati, Persia kreu një gabim të rëndë, që e vendosi atë në anën e një vendi jomusliman të fuqishëm kundër një Devleti musliman.

Ndërkohë, rusët shkelën traktatin e tyre të paqes me osmanët, duke sulmuar në vitin 1143/1730 kështjellën e Azakut dhe Ozit (Odesës) dhe u sulën kundër Krimesë. Për pasojë, **Sulltan Mahmudi** dërgoi Sadrazamin **Silahdar Mehmed Pashanë** për ta zgjidhur këtë situatë. Ushtria osmane mbërriti në Babadagë (Babadaği), por austriakët e vonuan avancimin e tyre, me pretekstin se ishin duke biseduar për paqen, ndërkohë që në të vërtetë e kishin sulmuar territorin osman, duke shkelur kështu në mënyrë flagrante traktatin e fundit të paqes me osmanët.

Mehmed Pasha nuk ishte një komandant me shumë përvojë dhe, për këtë arsye, çështjet e Devletit iu besuan **Osman Halis Efendiut**. Por ky i fundit, nuk pranoi të dërgonte pajimet dhe municionet e nevojshme në garnizonet e Ozit (Odesës), Benderit dhe Vidinit, me pretendimin se ky do të ishte një shpenzim i panevojshëm, ndërkohë që, sipas gjykimit të tij, arritja e një traktati paqeje ishte afër. Për pasojë, mosdërgimi i armatimeve çoi në dorëzimin e kështjellave strategjike të Azakut, Ozit dhe Këllburunit në duart e Ruisë. Kjo disfatë i kushtoi jetën Osman Halis Efendiut, ndërsa Silahdar Pasha u shkarkua nga posti i tij si Sadrazam, dhe në vendin e tij u emërua komandanti i kështjellës Bender, **Abdullah Pasha**. Në këtë rast, osmanët morën një mësim nga *hadithi sherifi*, sipas të cilit:

“Nëse çështjet (e rëndësishme) i besohen një personi të paaftë, atëherë duhet të pritet një fatkeqësi (dështim) prej tij.”

Ushtria ruse sulmoi Gadishullin e Krimesë, por populli i saj i transferoi orenditë e veta shtëpiake në vende të sigurta në

male, dogji grurin dhe, sa herë që kishte mundësi, e shqetësonte ushtrinë ruse. Megjithatë, ushtria pushtuese ruse e dogji dhe e shkatërroi gadishullin dhe u detyrua të tërhiqej përfundimisht, duke lënë pas më shumë se 20.000 ushtarë të vdekur apo të humbur.²¹

Lufta me Austrinë

Ndërkohë, austriakët sulmuan territorin e Nishit, Bosnjës dhe Vidinit. Ata e morën Nishin, por u mundën nga **Hekimogllu (Hekimoğlu) Ali Pasha** në Bosnjë, ku pësuan dhe humbje të rënda, pasi u vranë rreth 60.000 luftëtarë.²² **Ahmed Pasha**, djali i Kopyrylzade Shehid Mustafa Pashait, në vitin 1150/1737, rimori Nishin nga austriakët, ndërkohë që **Ivaz Mehmed Pasha** i shkaktoi disfatë ushtrisë austriake në Vidin. Më pas, ai kaloi lumin Danub në veri, i mundi ushtritë austriake në zonën e **Muhadijes** dhe **Harshovës**, dhe mori, në vitin 1151/1738, Adakalenë, në mes të lumit Danub.²³ Ai i shkaktoi një disfatë tjetër të rëndë ushtrisë austriake, që e detyroi atë të nënshkruante traktatin e paqes së Beogradit më 14 Xhumadel Ahire 1152/18 shtator 1739,²⁴ sipas të cilit Beogradi, Serbia dhe Harshova iu kthyen Devletit Osman.²⁵ Duke rimarrë territoret e humbura nëpërmjet Traktatit të Beogradit, Devleti Sublim Osman siguroi kufijtë e tij në Ballkan dhe kështjella e Beogradit shërbeu si parandalues për ardhjen e austriakëve në jug të Danubit.²⁶

Ndërkohë, rusët risulmuan gadishullin e Krimesë dhe Benderin, por u zbrapsën nga trupat osmane. **Numan Pasha**, komandanti i zonës së Benderit, i shkaktoi edhe një disfatë ushtrisë ruse, që u detyrua ta dorëzonte kështjellën e Ozit dhe Këllburunit, duke lidhur dhe një traktat paqeje me Devletin

21 Po aty, III, fq. 35.

22 OT, IV, pjesa I, fq. 26.

23 *Netajixh*, III, fq. 36.

24 Danişmend, *vepër e cituar*, IV, fq. 28.

25 *Netajixh*, III, fq. 39.

26 OT, IV, pjesa 1. fq. 326.

Osman në vitin 1739. Sipas këtij traktati, kështjella e Azakut duhej të shkatërrohej, në mënyrë që zona ku ajo ishte ndërtuar të qëndronte si një zonë asnjëse, ndërsa Devleti Osman u autorizua të ndërtonte një kështjellë në lumin Don dhe një kështjellë tjetër pranë Detit Azak. Nga ana tjetër, rusëve iu ndalua lundrimi i luftaniëve dhe anijeve tregtare në Detin Azak dhe në Detin e Zi, dhe tregtia e tyre në këto dete do të bëhej me anë të transportimit nga anijet osmane.²⁷

Përpjekje për rimëkëmbje nga rënia

Në periudhën e luftërave 1683-1699, administrata qendrore osmane rekrutoi në radhët e forcave jeniçere ushtarë të rinj, midis të cilëve u përfshinë dhe shitës, tregtarë perimesh dhe persona të tjerë të ngjashëm. Për të përfituar *ulufe* (paga si ushtarë jeniçerë), këta rekrutë duhet të merrnin pjesë në të paktën një *xhihad*, për të vërtetuar se ishin të stërvitur në mënyrë të përshtatshme ushtarake. Por kur blerja dhe shitja e *ulufëve* u lejua në vitin 1740, organizimi qendror ushtarak i Devletit Osman pësoi një goditje të rëndë. Pjesa më e madhe e tyre blihej nga shitësit dhe familjarët e fisnikëve, që e shikonin si një burim të ardhurash dhe si një lloj investimi.²⁸

Pas lidhjes së Traktatit të Beogradit dhe deri në fushatën e vitit 1768, në Devletin Osman mbizotëroi një periudhë paqeje, dhe, për këtë shkak, rekrutimi i ushtarëve të rinj nuk ishte i nevojshëm. *Ulufetë* e ushtarëve të vdekur, duhet të anuloheshin në parim, dhe duhet t'i riktheheshin thesarit, por kjo nuk ndodhte gjithnjë, pasi shpesh ato iu shiteshin fisnikëve nga kryekomandanti i jeniçerëve.²⁹ Për shkak të paefektshmërisë dhe korrupsionit, disa njerëz përfituan para nga Devleti, edhe pse në mënyrë të paligjshme, duke përshpejtuar kështu edhe rënien e tij.

27 OT, IV, pjesa 1. fq. 293.

28 *Netajixh*, III, fq. 85-86.

29 *Netajixh*, III, fq. 86.

Deri nga viti 1000/1592, Devlet-i Alijje (Devleti Sublim) kishte rreth 80.000-100.000 kalorës të shkathët dhe të armatosur mirë (*tëmarrllë sëpahi/spahinj të timarit*). Por, gjatë shekullit të 18-të, numri i tyre filloi të ulej gjithmonë e më shumë deri në $\frac{1}{4}$, që do të thoshte $\frac{1}{10}$ në aspektin e veprimtimit të suksesshëm.³⁰

Periodha midis 1740-1768, ishte e karakterizuar nga një periudhë veçanërisht e qetë duke iu referuar gjithë historisë osmane, fakt ky që solli shthurjen e disiplinës në radhët e ushtarëve. Vërtetë, Devleti dërgoi 300.000 ushtarë për të luftuar kundër Rusisë, por ata kishin pësuar disfatë dhe kishin humbur kështjellën e Hotinit. Ushtria osmane pësoi edhe një humbje tjetër, që i bindi administratorët për paaftësinë e tyre për të arritur një fitore, sidomos në një kohë kur, si morali ashtu dhe pajimet e tyre kishin arritur në nivelin më të ulët.³¹ Dukej se vetëkënaqësia kishte filluar.

Lufta me Persinë

Gjatë armëpushimit 4-vjeçar, **Nadir Shahu** arriti një sukses të rëndësishëm gjatë fushatave të tij në Indi. Në vitin 1156/1743, ai sulmoi territorin osman, ku u përfshi dhe Kirkuku dhe Bagdadi. Por, sulmi i tij në kështjellën Mevsil (Mosul) u zmbrops nga **Hysejin Pasha**, dhe iranianët pësuan humbje në radhët e ushtrisë së tyre, rreth 6.000 ushtarë të vdekur. Në vitin 1158/1745, Nadir Shahu, u zu në një pozicion të vështirë midis territorit të Karsit dhe Revanit, nga **Jegen (Yeğen) Mehmed Pasha** por shumë shpejt ai arriti ta kapërcente këtë vështirësi, për shkak të vdekjes së papritur të komandantit të ushtrisë osmane dhe përshtjellimit e rrëmujës që pasoi në radhët e ushtrisë së tyre. Megjithatë, me caktimin e **Hekimogllu Ali Pashait** si *serdar* (komandant i ushtrisë) në frontin lindor, Nadir Shahu kërkoi paqen, që u vendos nëpërmjet një traktati në vitin 1159/1746. Sipas traktatit, kufiri midis Devletit Sublim Osman

30 *Netajixh*, III, fq. 94.

31 *Po aty*, III, fq. 95-96.

dhe Persisë do të qëndronte aty ku kishte qenë që në kohën e Sulltan Muradit IV.

Sulltan Mahmudi I, i cili ndërroi jetë në Safer 1168/nëntor 1754, kishte synuar fuqizimin dhe rritjen e autoritetit të ushtrisë osmane.³² Gjatë sundimit të tij, i mirënjohuri **Klod Aleksandër Kont dë Boneval (Claude Alaxandre Comte de Bonneval)** (1675-1747), që u bë i famshëm pas konvertimit të tij në musliman dhe mori emrin Humbaraxhë Ahmed Pasha, hyri në shërbimin osman dhe i shërbeu Islamit në mënyrë të shkëlqyer. Devleti Sublim Osman kishte pasur një njësi ushtarake, të quajtur *humbaraxhë*, prej 300 ushtarësh, që shërbenin në kështjella. **Humbaraxhë Ahmed Pasha** krijoi një njësi tjetër *humbaraxhë* prej 300 vetash, të cilët i solli nga Bosnja nën urdhrin e sadrazamit, dhe mori përsipër stërvitjen dhe administrimin e tyre.³³

32 Po aty, III, fq. 41.

33 OT, IV, pjesa I, fq. 322-323.

KAPITULLI 14

KRIZË DHE PËRPPJEKJE

14.1 Sulltan Mustafai III 1757-1774

Lufta me Rusinë

Pas vdekjes së Sulltan Mahmudit, vendin ia zuri i vëllai, Osmani III (1754-1757), por, gjatë sundimit të tij të shkurtër, nuk pati asnjë ngjarje me vlerë të veçantë për t'u përmendur. Ai vdiq pas tre vjetësh dhe u pasua nga Mustafai, djali i Ahmedit III.

Sulltan Mustafai III përfitoi nga shërbimet e **Baronit de Tott**. Sulltani besonte se zgjerimi rus e kishte bërë luftën të paevitueshme, por Sadrazami i tij, **Ragib Pasha** (1756-1763), që ishte i ditur dhe i zgjuar, ia argumentoi se ushtria osmane ishte shumë e dobët për të luftuar kundër Rosisë. "Ai kishte të drejtë për vlerësimin e tij të situatës ushtarake: ushtritë evropiane kishin filluar të disiplinoheshin, ndërkohë që ushtria osmane, në të kundërt, ishte e shthurur. Dhe, ai duhet të kishte marrë masat e nevojshme për ta përmirësuar situatën, edhe pse nuk i mori. Kjo mund të ketë ndodhur, për shkak se nuk kishte më shpresë, apo për shkak se një rinovim i ushtrisë ishte shumë i rrezikshëm. Moshë e tij, gjithashtu, mund të ketë qenë një faktor ndikues: ai ishte mes të gjashtëdhjetave apo të shtatë-

dhjetave.”³⁴ **Për këtë arsye, mund të themi se, në gjysmën e dytë të shekullit të 18-të, Devleti Osman e kishte humbur në një masë të konsiderueshme dinamizmin e tij.**

Ndërkohë Mbretëresha Katerina, me origjinë gjermane, në vitin 1174/1761, kishte punuar në fshehtësi për vrasjen e bashkëshortit të saj, **Carit rus Petër III**, dhe më pas i zuri vendin. Në mënyrë që të fitonte mbështetjen e popullit rus, ajo ndërhynte në mënyrë aktive në çështjet e Polonisë, dhe bënte përpjekje për të zgjeruar territoret e saj drejt Turkestanit. Dinjitarët polakë (që në vend njiheshin me emërtimin *ban*) i kërkuan ndihmë Devletit Sublim Osman, me arsyetimin se pasi rusët të arrinin të merrnin Poloninë, ata do të hidheshin në sulm kundër osmanëve. Ata premtuan gjithashtu se do t’iu jepnin osmanëve Podoljen.

Çështja e luftës me Rusinë pati debate të nxehta në oborrin osman, ku disa këshilltarë të dobët dhe hipokritë mbështetën qëndrimin e sulltanit. Por, Veziri i Madh me përvojë Sadrazami **Mehmed Pasha**, djali i Muhsin Pashait, që ishte caktuar në drejtimin e Hotinit dhe Ozit (Odesës), diskutoi fuqishëm kundër zhvillimit të kësaj lufte, pasi duhej që më parë të ndërmerreshin përgatitjet e duhura, dhe të furnizoheshin kështjellat në pikat kufitare, ndaj dhe u zëvendësua nga **Hamza Pasha**. Në vitin 1769, ambasadori rus u thirr dhe u paralajmërua për evakuimin e menjëhershëm të trupave të vendit të tij nga Polonia. Ai kërkoi kohë për të marrë udhëzimet nga qeveria e tij, por osmanët e kuptuan se ai po kërkonte të fitonte më shumë kohë, dhe e burgosën. Me këtë veprim, duket se osmanët kishin dashur ta mbanin atë si peng, në këmbim të garancisë për sigurimin e tregtarëve muslimanë, që ndodheshin në Rusi.³⁵

Më pas, Hamza Pasha u shkarkua nga detyra për shkak të problemeve të tij psikiatrike dhe në vendin e tij u emërua

34 *Netajixh*, III, fq. 43.

35 *Netajixh*, III, fq. 43-49.

Mehmed Emin Pasha. Sadrazami i ri marshoi drejt Danubit, edhe pse trupat osmane nuk ishin të stërvitura për luftë. Ushtria ruse rrethoi kështjellën e Hotinit, por **Molldovanhë Ali Pasha** dhe Hani i Krimesë, **Devlet Gëraji** (sund.1769-70, 1775-77), e detyruan atë të tërhiqej dhe të largohej. Megjithatë, Sadrazami, që ishte dhe *Serdar-ë Ekrem* (kryekomandanti më i nderuar) e kuptoi se ushtria e tij ndodhej në kushte kritike dhe kërkoi të jepte dorëheqjen nga posti. Ai u zëvendësua nga Molldovanhë Ali Pasha në vitin 1183/1769,³⁶ që si kapërceu lumin Turla, bllokoi njësitë ushtarake moskovite. Këto zhvillime e vendosën **Mbretëreshën Katerina II** në një pozitë të vështirë, që do të ishin shoqëruar edhe me shpërthimin e kryengritjeve në Shën Petërburg, që në atë kohë ishte kryeqyteti i Rusisë, nëse rënia e papritur e shirave nuk do të kishin fryrë rrjedhën e lumit Turla, që prishi urën mbi të. Disa njësi ushtarake osmane u kthyen me varka, ndërsa njësi të tjera u shpërndanë dhe kështjella e Hotinit iu la rusëve pa luftë. Trupat ruse depërtuan në Vllahi e Moldavi, dhe sulmuan kështjellat e Benderit dhe Ozit (Odesës), por nuk arritën t'i merrnin. Ndërkohë, Ali Pasha ishte shkarkuar nga detyra dhe ishte zëvendësuar nga **Halil Pasha**, djali i Ivaz Pashait, që kaloi Danubin dhe së bashku me **Kapllan Gërajin**, e futën në grackë ushtrinë ruse të komanduar nga **Romanovi**. Edhe pse ushtria ruse u gjend në një pozitë dëshpëruese, të ngjashme me atë të betejës së Prutit të vitit 1711, ushtria osmane e harxhoi kohën duke fortifikuar pozicionet e saj, në vend që të ndërmernte një sulm të menjëhershëm, përpara se trupat ruse të arrinin të riorganizoheshin. Edhe pse më të pakët në numër, forcat më të stërvitura dhe më të disiplinuar ruse e mundën ushtrinë osmane në vitin 1184/1770.³⁷

36 *Netajixh*, III, fq. 46.

37 *Netajixh*, III; fq. 47.

Asgjësimi i flotës osmane

Në fillimin e luftës midis Devletit dhe Rusisë, Franca lajmëroi Devletin Osman se rusët do të dërgonin një flotë në Mesdhe. Dhe, ndërkohë që osmanët ishin duke diskutuar nëse diçka e tillë ishte e mundshme,³⁸ rusët dërguan disa luftanije nga Deti Balltik, me përforcime edhe nga Britania, Holanda dhe Venediku. Ata, po ashtu, kishin angazhuar edhe oficerë marine dhe detarë. Trupat ruse u shfaqën në gadishullin e Moresë dhe nxitën popullsinë të hidhej në revoltë kundër Devletit Osman. **Mehmed Pasha**, djali i Muhsin Pashait, u dërgua në More për t'i shtypur këto revolta. *Kaptan-ë Derja* osman, **Husameddin Pasha** u nis drejt Mesdheut dhe u përball me flotën ruse në dy beteja. **Xhezajirli Hasan Beu** do ta kishte marrë anijen kryesore të flotës ruse, nëse nuk do të kishte rënë zjarr, që i dogji dy anijet, dhe dy flotat u ndanë. Flota osmane ankoroi në portin e Çeshmes, pranë Izmirit, në vitin 1184/1770, ndërsa rusët me ndihmën e oficerëve detarë të Britanisë, Holandës dhe Venedikut, u hodhën në një sulm të befasishëm dhe dogjën anijet osmane.³⁹ Ndërkohë, si ushtarak i aftë, **Xhezajirli Hasani**, që u ngrit në rangun e pashait dhe më pas u emërua si vezir, avancoi drejt Dardaneleve. Flota ruse rrethoi kështjellën e ishullit të Lemnosit, por Hasan Pasha arriti t'i transportonte ushtarët e tij me anije të rastit në këtë ishull. Ai i sulmoi rusët dhe i mundi ata në betejë, pas së cilës ai u ngrit në rang, duke marrë titullin *gazi*.⁴⁰

38 "Pretendimi se osmanët nuk kishin dijeni për mundësinë e hyrjes në Mesdhe nëpërmjet detit Balltik, është një trillim i Hammerit. Faktikisht, mendimi i osmanëve ishte se Rusia kishte mundësi të mëdha për të pajisur një flotë të tillë, dhe për ta dërguar atë në Mesdhe, ku nuk kishin asnjë bazë të tyre." Cituar nga Kemal Beydilli, *Türk Bilim ve Matbaçılık Tarihinde Mühendishane, Mühendishane Matbaası ve Kütüphanesi (1776-1826)*, Stamboll 1995, fq. 365, poshtë-shënimi 1. "

39 *Netajixh*, III, fq. 48.

40 *Netajixh*, III, fq. 49.

Sulmi rus kundër Krimesë

Në vitin 1185/1771, një ushtri e madhe ruse sulmoi Krimenë, mundi Hanin e saj, **Selim Gërajn**, dhe burgosi *valiun* Osman të Kefes, Ibrahim Pashanë.⁴¹ Mareshali rus **Romanov** marshoi drejt Silistres në vitin 1187/1773, por, pasi pësoi humbje të mëdha, u tërhoq në pjesën veriore të Danubit. Populli i Krimesë kërkoi ndihmë dhe **Muhassili** i Xhanikut (mbledhësi i taksave të Samsunit) **el-Haxh Ali Beu**, grumbulloi 20.000 ushtarë me mbështetjen e trupave të Krimesë. Gadishulli do të ishte çliruar me forcë, nëse një traktat paqeje nuk do të ishte lidhur me Rusinë. **Sulltan Mustafai** vdiq në vitin 1188/1774 nga apopleksia (paralizë e trurit) dhe vëllai i tij, Abdylhamidi, u bë sulltan osman.⁴²

41 *Netajixh*, III, fq. 51.

42 *Netajixh*, III, fq. 54.

KAPITULLI 15

PËRDPJEKJA PËR RINGRITJE

15.1 Sulltan Abdulhamidi I 1774-1789

Sulltan Abdulhamidi I, djali i Sulltan Ahmedit III, erdhi në fron në një kohë kur luftërat me Rusinë ishin në zhvillim e sipër. Trupat ruse arritën në Shumna dhe rrethuan ushtrinë osmane, dhe Traktati i Kyçyk Kajnarxhas u lidh më 8 Xhumadel Ula 1187/17 korrik 1774. Ky traktat parashihte që Krimea të bëhej e pavarur, statusi i ambasadorëve rusë në Stamboll të barazohet me statusin e ambasadorëve gjermanë dhe holandezë, ndërsa rusëve iu dha e drejta të vizitonin Jerusalemin, të ndërtonin një kishë në Bejogllu (Beyoğlu) (Pera) në Stamboll dhe anijeve ruse iu garantua lundrimi në Detin e Zi dhe në detin Mesdhe. Nga ana tjetër, ky traktat i dha osmanëve gjithë territorin e Buxhakut, kështjellat e Akkermanit, Kilit dhe Ismailit, si dhe ishujt që ishin pushtuar nga rusët. Pasi morën kështjellën e Azakut, rusët pranuan gjithashtu të tërhiqnin trupat e tyre nga Vllahia dhe Moldavia, në këmbim të një shume prej 15.000 qese me akçe që osmanët do t'ua paguanin brenda 3 vitesh.⁴³

Rusia argumentoi se Krimea duhet të ishte e pavarur, pasi përfshirja e saj nën sundimin osman nxiste shpirtin e saj grabitqar kundër vendit të tyre. Por, kishte të ngjarë që pavarësia e Krimesë të lehtësonte çdo tentativë ruse në perspektivë për

43 *Netajixh*, III, fq. 56-70.

të pushtuar gadishullin dhe, për sa i përket pikëpamjes osmane, përfundimi ishte ekzistenca e praktikës joislame të dy Halifëve në të njëjtën kohë: Halifit Osman dhe Halifit të Krimesë. Por, osmanët u detyruan të hiqnin dorë nga gadishulli, edhe pse ata vazhduan t'i mbanin lidhjet fetare me Krimenë, kështu që *hutbeja* mbahej në emrin e Sulltanit osman, ndërsa Kazaskeri Osman ishte i autorizuar për të udhëzuar Kadiun kryesor të Kërëmit (Krimesë), për zbatimin e Sheriatit. Personi që përzgjidhej nga populli i Krimesë do të emërohej Han i Kërëmit nga Sulltani osman.⁴⁴

Sadrzami Halil Hamid Pasha

Devleti Osman priste që Rusia t'i shkelte kushtet e Traktatit të paqes së Kycyk Kajnarxhes. Për këtë arsye, osmanët fortifikuan kështjellat, që ndodheshin në pikat kufitare, ndërsa Sadrzami Halil Hamid Pasha (1782-1785), u përpoq të krijonte një flotë të fuqishme. Nevoja e domosdoshme dhe njëkohësisht shumë e vështirë, ishte të arrihej një politikë rrënjësore për të fuqizuar ushtrinë duke përmirësuar sistemin *timar*, që ishte trashëguar nga paraardhësit e tyre, ndërkohë që disa *timare* bliheshin nga të tjerë, si mënyrë për të siguruar jetesën.⁴⁵

Megjithatë, Halil Hamid Pasha, që ishte një prijës trim dhe i vendosur, rriti numrin e anëtarëve të shtabit, që u quajtën “pushkatarët e shpejtë”, nga 300 në 2.000 vetë, dhe grumbulloi në pika të rëndësishme strategjike ushqime dhe pajime për ushtrinë. Ai kontrolloi regjistrat e ushtarëve që ishin të pozicionuar në pikat kufitare dhe ndaloi zakonet e korruptuar të shitjes së pagave të ushtarakëve. Ai, gjithashtu, mori guximin të vendoste që ushtarët, pagat e të cilëve bliheshin nga shitësit e rëndomtë, të mos konsideroheshin si rekrutë të ushtrisë, dhe për pasojë të mos paguheshin. Por, këto vendime të guximshme

44 *Netajixh*, III, fq. 52-53.

45 Ahmed Asim, *Tarih*, Stamboll; botuar në *Jeride-yi Havadis*, I, fq. 34.

dhe heroike kundër korrupsionit në sistemin *timar*, do t'i kushtonin atij postin e tij dhe do ta çonin atë në martirizim në Xhumadel Ahire 1199/prill 1785.⁴⁶

Nga të dhënat e mësipërme, ne mund të dalim në përfundimin e logjikshëm se nga fundi i shekullit të 18-të, Devleti Osman i kishte ende forcat për t'u kthyer në superfuqi, edhe pse kjo ishte një detyrë e vështirë, që kishte nevojë për shtetarë trima, vizionarë dhe krijues, siç ishte dhe Halil Hamid Pasha. Dhe, persona të tillë nuk mund të mbijetonin për shkak të dinjitarëve, interesi i të cilëve pakësohej nga ata. Por, në këtë aspekt, Devleti Osman nuk ishte i vetëm në botën e shekullit të 18-të, siç thotë dhe Uilijam Hjuston (William Houston) në përshkrimin e tij të gjatë të mëposhtëm:

“Gjatë viteve 1780, Franca drejtohej nga një këshill aristokratësh me në krye mbretin. Për shumë aspekte, kjo periudhë u karakterizua nga një begati e konsiderueshme: rrugët ishin më të mirat në Evropë; administrata ishte në proces reformimi; industria ishte në lulëzim; pjesa më e madhe e fshatarëve ishin lënë të lirë dhe torturat nuk përdroreshin më si mënyrë për tregimin e të vërtetës.

Fatkeqësisht, vendi po ashtu kishte falimentuar ekonomikisht. Ajo kishte pasur shpenzime të tepërta për të ndihmuar kolonitë e Amerikës të fitonin Luftën e tyre të Pavarësisë, dhe administrata po përpiqej të rikuperohej nga humbjet. Fisnikët dhe kisha, megjithatë, nuk pranuan një rritje të taksimit. Në vend të tyre, kjo rritje do të binte në radhë të parë mbi klasën e mesme dhe mbi tregtarët, nëpërmjet pagesës së *piazhës* (*péage*), që ishin taksat të brendshme për kalimin e mallrave përgjatë rrugëve, lumenjve dhe kanaleve.

Kjo taksë do të binte edhe mbi fshatarësinë, me detyrimet ndaj çifligjeve, apo kështjellave. Por, më e keqja ishte rritja e çmimeve të ushqimeve, si rezultat i përkeqësimit të të korrave, dhe, nga viti 1789, gjendja u rëndua dhe më tepër, për shkak të

46 *Netajixh*, IV, fq. 5-6.

detyrimet për të paguar 80% e të ardhurave për bukën nga 2/3 në fillim të kësaj dekade. Këto probleme arritën kulmin pas sulmit të Bastijës, më 14 korrik, që u kthye në një shkak për përhapjen e kryengritjeve në të gjithë vendin. U formua Asambleja Kombëtare, ndërsa këshilli gjykues u shpërbë."⁴⁷

Kërëmi (Krimea)

Nëpërmjet intrigave dhe korrupsionit, rusët arritën të vendosnin personin e tyre, **Shahin Gërajin** (1777-1782), si Han të Krimesë së pavarur, edhe pse Devleti Osman, që ishte i dobët, ishte në favor të vendosjes së vëllait të tij, **Selim Gërajit**. Por, rusët u angazhuan në propagandë kundër Shahin Gërajit, që shkaktoi edhe vendosjen e tij në postin e Hanit. Populli i Krimesë nuk e pëlqente eurocentrikun Shahin Gëraj, i cili pinte verë në publik dhe hante vaktet e tij mbi tavolinë si evropianët. Në këtë mënyrë, ata u revoltuan kundër tij dhe në vitin 1782 e zëvendësuan atë me **Bahadër Gërajin**. Në atë kohë, situata politike në Evropë ishte në favor të Rosisë. Ndërkohë që, Britania ishte e angazhuar tërësisht për të shtypur Revolucionin amerikan, Franca ia zgjati dorën miqësore Rosisë. Për më tepër, **Franc Jozefi**, sovrani i Austrisë, që mendohet të mos ketë qenë shumë i mençur, besoi me naivitetet premtimin mashtrues të sovranes ruse, **Katerina II** (1782-1796), sipas të cilit do t'i jepte atij disa territore osmane, dhe, për pasojë, nënshkroi një traktat me rusët.⁴⁸ Por, në vitin 1797/1783, **Katerina II** dërgoi në Krime **Mareshalin Potemkin** në krye të një ushtrie të madhe dhe i grumbulloi të gjithë fisnikët e Krimesë në fushën Aksu, ku i detyroi ata të betoheshin për besnikëri ndaj Shahin Gërajit. Rezultati ishte sovraniteti *de facto* i Rosisë mbi Krimenë dhe Tamanin. I zemëruar nga kjo dredhi, Shahin Gëraj i strehua për pak muaj tek osmanët, të cilët e dërguan atë në ishullin e

47 William Houston, *Meltdown, the great 90s depression and how to come through it a winner*, Warner Futura: Londër 1994, fq. 69.

48 *Netajixh*, IV, fq. 9-11.

Rodosit për ta ekzekutuar për tradhtinë e tij. Megjithatë, Devleti Osman njohu nëpërmjet Traktatit të **Zishtovit** të vitit 1207/1792 sundimin rus mbi Krimenë dhe Tamanin.⁴⁹

Lufta me Austrinë dhe Rusinë 1201/1787

Sulltan Abdylhamidi nuk ishte në favor të luftës, pasi ai ishte tepër i shqetësuar nga vështirësitë dhe tragjeditë e përjetuara nga popullsia në zonat kufitare. Ai e kishte për zakon të lutej duke thënë: “Nëse shërbyesit e Allahut shkelen me këmbë, atëherë Allahu le ta marrë shpirtin tim.” Megjithatë, Devleti Osman ishte i detyruar t’i shpallte luftë Ruisë, për shkak të kërkesave poshtëruese të ambasadorit rus në Stamboll dhe sjelljes arrogante të Katerinës, që në vitin 1786 shkoi në Krime me ceremoni pompoze. Përveç të tjerash, Britania dhe Prusia i kishin nxitur osmanët të ndërmerrnin një veprim të tillë sepse iu shërbente edhe qëllimeve të tyre, ndërsa austriakët shpallën luftë kundër osmanëve kinse për shkak të lidhjes së traktatit të tyre me Rusinë.

Sulltan Abdylhamidi priti Sadrazamin **Koxha Jusuf Pasha** në *Hërka-i Sa’adet Dairesi* (vendin ku ruheshin reliktet e Shenjta në Sarajet e Topkapusë) dhe i dha atij **Sanxhak-ë Sherifin** (Flamurin e Profetit), duke u lutur për të dhe duke u shprehur se ai kishte autoritet absolut mbi djalin e tij, Shehzade Mustafain.⁵⁰

Ushtria osmane u nis dhe mbërriti në Edrene, edhe pse nuk ishte shumë e qartë se kundër kujt do të luftonte, kundër Ruisë apo Austrisë. Ndërkohë, serbët iu shkaktonin osmanëve shqetësime, një politikë kjo që ndiqej që prej një shekulli nga Serbia, sa herë që Devleti Osman dhe Austria ishin në luftë mes tyre. Kalimi i osmanëve nga Silistre, për të avancuar më pas drejt Ruisë, do ta ekspozonte Beogradin Osman ndaj një rrethimi të vërtetë të forcave austriake. Për këtë arsye, osmanët ndanë një

49 *Netajixh*, IV, fq. 12-13.

50 İsmail Hakkı Uzunçarşılı, *Osmanlı History*, vëll., V, pjesa I, fq. 525.

pjesë të forcave të tyre ushtarake nën drejtimin e **Shahin Ali Pashait**, që do të përballëshin me rusët në fushën e betejës; ndërsa Kapudan-ë Derja, **Gazi Hasan Pasha**, u caktua të mbulononte zonat bregdetare kundër forcave ruse; ndërkohë që trupa qendrore e *Ordu-ju Hymajunit* iu drejtua Vidinit.⁵¹

Ndërsa Sadrazami Jusuf Pasha (v.1800) mori fortesat e **Inlikut** duke iu shkaktuar humbje ushtrisë perandorake të Austrisë, komandanti i Beogradit Osman kaloi Danubin dhe mori fushën e **Banatit**. Austriakët pësuan humbje të rënda (80 topa) dhe osmanët kapën 50.000 të burgosur lufte. **Jusuf Pasha** dëshironte t'i ruante ato zona, por ushtarët i lanë ato për një plaçkë të madhe lufte dhe Sadrazami u detyrua të tërhiqej në tetor të vitit 1203/1788, në kampin dimëror të **Rusçukut**.⁵²

Pushtimi i Kështjellës së Ozit (Odesës)

Mareshali Pomtekin i Rosisë rrethoi kështjellën e Ozit (Odesës) me 80.000 ushtarë, por u përball me një rezistencë të guximshme. Ndërkohë, flota osmane, nën drejtimin e Kapudan-ë Derja, **Xhezajrili Hasan Pashait** (1774-1790), iu afrua Ozit. Edhe pse ishte e pamundur të afrohej për shkak të cektësisë së ujit në këtë vend, ai arriti ta mundte flotën ruse që erdhi nga Akjari (Sevastopoli). Por, shumë shpejt ai u kthye në Stamboll, në vitin 1203/1788, për arsye se një stuhi e papritur bllokoi rrugën e anijeve përforcuese. Për pasojë, **Potemkini** e mori kështjellën e Ozit pas një beteje të ashpër 3 ditore, ku humbi 20.000 ushtarë. Ai i lejoi ushtarët rusë që të plaçkitnin Ozin për tre ditë, gjatë të cilave ata vranë 25.000 muslimanë përfshirë dhe popullsinë civile. Sulltan Abdylhamidi ndjeu një keqardhje kaq të madhe për humbjen e Ozit dhe për masakrën ndaj popullit të tij, sa që ndërroi jetë nga pikëllimi në 1203/prill 1789.⁵³ Ashtu si babai i tij, Abdylhamidi nuk mundi ta duronte pamjen dëshpë-

51 *Netajixh*, IV, fq. 18.

52 *Netajixh*, IV, fq. 19.

53 *Netajixh*, IV, fq. 21.

ruese të fëmijëve që vuanin – një sjellje tipike kjo për një sulltan osman.

15.2 Sulltan Selimi III 1789-1807

Pas vdekjes së Abdylhamidit, Selimi III, nipi i Abdylhamidit dhe djali i Mustafait III, mori vendin e tij. Ai pranoi **bej'atin** përpara Akagallar (Akağalar) Kapësë, në Pallatin Topkapu.⁵⁴ Për shkak të një armiqësie personale, një nga zyrtarët e tij të lartë, Shemseddini, e këshilloi në mënyrë të gabuar sulltanin e ri që ta zëvendësonte në vitin 1789, Sadrazamin e aftë, Jusuf Pashanë, me Hasan Pashanë. Ky i fundit pësoi disfatë në **Boze**, në 1203/1789, nga një ushtri e bashkuar austriakësh dhe rusësh dhe Devleti Osman humbi kështjellën e Akkermanit dhe të Benderit, që i mori Rusia,⁵⁵ dhe Beogradin, që e mori Austria. Një ushtri e madhe ruse sulmoi qytetin Ismail, por u mund nga **Xhezajirli Gazi Hasan Pasha**.⁵⁶ Ky i fundit ekzekutoi **Tajfur Pashanë** për shkak të tërheqjes së tij nga kështjellat e Benderit, Akkermanit dhe Kilit, që ranë në duart e rusëve. Ndërkohë që përgatitej në mënyrë aktive për luftë, **Sadrazami** i moshuar (80 vjeçar), **Hasan Pasha**, vdiq nga malaria në Shumna, në vitin 1204/1790. Sadrazami i ri **Sherif Hasan Pasha** zmbropsi forcat e drejtuara nga **Princi Koburg**, që kishin rrethuar kështjellën e Jerkojit (Yerköy),⁵⁷ por ai nuk arriti të përballonte një sulm tjetër të forcave ruse nga toka dhe lumi ndaj kështjellës Ismail, që u mor nga forcat armike në 1205/dhjetor 1790, dhe që përfundoi me humbje të rënda, rreth 20.000 ushtarë të vrarë nga të dyja palët.⁵⁸ Në shkurt të vitit 1791, Sadrazami Sherif Hasan Pasha u ekzekutua në Shumna, për shkak të dështimit të tij. Ai kishte kaluar 50 ditë në fushën e Jerkojit, në vend që të sulmonte menjëherë forcat humbëse

54 Danişmend, IV, fq. 68.

55 *Netajixh*, IV, fq. 23-25.

56 *Netajixh*, IV, fq. 25.

57 *Netajixh*, IV, fq. 26.

58 *Netajixh*, IV, fq. 27.

austriake. Ai nuk arriti të ishte i suksesshëm në sulmin e tij kundër tyre, për arsye se lufta midis austriakëve dhe Prusisë në atë kohë kishte përfunduar, dhe Austria kishte arritur të mblidhte të gjitha forcat. Ky fakt tregon se Devleti Osman merrte masa të ashpra ndaj dështimeve katastrofike, pa bërë dallime për personin apo për pozitën që ai kishte.

Koxha Jusuf Pasha u emërua në postin e Sadrazamit për herë të dytë. I vetëdijshëm për pikat e dobëta të ushtrisë osmane, ai bëri përpjekje për t'iu lënë përshtypje rusëve me gatishmërinë e tij për një luftë të përgjakshme, nëse do të ishte e nevojshme, edhe pse, në të njëjtën kohë, ai bëri të ditur dëshirën për të vendosur paqen. Në 1206/gusht 1791, u përgatit një traktat paqeje me rusët, por **Sulltan Selimi III** vendosi të luftonte, pasi i kundërshtoi rreptësisht kushtet e këtij traktati, veçanërisht atë të dorëzimit të Odesës nga osmanët. Por, pashallarët e këshilluan sulltanin të mos ndërmerrte një aventurë të tillë, pasi ushtria nuk ishte gati për luftë. Përveç kësaj, Revolucioni Francez i vitit 1789 kishte pasur ndikime të fuqishme në të gjithë Evropën, dhe Prusia nuk i mbante angazhimet që kishte marrë për të mbështetur aleatin e saj osman kundër rusëve. Në këto rrethana, Devleti Osman ishte i detyruar të nënshkruante me Rusinë Traktatin e **Iashit** në Xhumade'l Ula 1206/shkurt 1792, sipas të cilit lumi Turla do të ishte kufiri ndarës midis dy vendeve. Rusia mori Odesën dhe Devleti Osman pranoi pa dëshirë aneksimin e Krimesë dhe Tamanit nga Rusia, ndërsa osmanët rimorën Benderin, Kilin dhe Akkermanin.⁵⁹ Nëse nuk do të kishte qenë i detyruar të luftonte kundër dy forcave armike në të njëjtën kohë (Rusisë dhe Austrisë), një përmirësim i dukshëm në fuqizimin e ushtrisë osmane mund të kishte lejuar përballjen e tyre me Rusinë në këtë luftë. Ushtarët osmanë ishin trima dhe luftëtarë të aftë, dhe, kur ishin të disiplinuar, ktheheshin në një sfidë të vërtetë edhe për ushtrinë shumë të fuqishme ruse. Në 1206/gusht 1791, Devleti Osman nënshkroi edhe

59 *Netajixh*, IV, fq. 33.

Traktatin e **Zishtovit** me Austrinë, sipas të cilit osmanët rimorën Beogradin, në këmbim të disa ndryshimeve në favor të Austrisë për disa pika kufitare.

Jusuf Pasha u caktua në postin e *valiut* të Trabzonit dhe të *Seraskerit* (Kryekomandantit) të Anapas, në maj të vitit 1792, ndërsa **Melek Mehmed Pasha** mori vendin e tij si Sadrazam. Kur miqtë e kritikuan tolerancën e tij në administratë, ai i përgjigjej më sarkazëm: “Në takimin tim të parë me Sulltan Selimin, unë i thashë atij se vëzhgimi im më tregonte se zyrtarët e lartë të Devletit ishin shumë besnikë ndaj tij si dhe shumë dinamikë. Një ditë më pas, shumë persona me influencë më dërguan dhurata të çmuara, dhe më falënderuan. Pra, në këtë mënyrë, kuptova se ata do të ishin në dijeni dhe do të konsultoheshin për gjithçka që mund t’i thuaja sulltanit. Për këtë arsye, preferova të mbaja marrëdhënie të mira me ta.”⁶⁰ Kjo tregon një atmosferë jo të shëndetshme të administratës osmane në atë kohë. Sadrazami, faktikisht, iu referohej atyre zyrave me influencë, për të gjitha çështjet e Devletit, duke përfshirë raportet zyrtare për përmirësimin e forcave tokësore dhe detare osmane. Melek Mehmed Pasha qëndroi në këtë detyrë për dy vite e gjysëm. Sulltani, që në atë kohë kishte për synim organizimin e një ushtrie të re, (*Nizam-ë Xheded* ose Urdhri i Ri) dhe një arsenal të ri, e zëvendësoi atë në tetor të vitit 1794 me një person shumë të aftë dhe të nderuar, **Izet Mehmed Pashanë**, guvernatori i Egjiptit.

Pushtimi francez i Egjiptit

Në vitin 1209/1794, Devleti Osman njohu regjimin republikan që ishte vendosur në Francë, pas Revolucionit të suksesshëm të vitit 1789. **Ali Efendiu** u emërua si ambasador, përfaqësues i Devletit, në Paris, ndërsa Franca dërgoi në Stamboll ambasadorin **Vertinak**.

60 *Netajixh*, IV, fq. 34.

Me kërkesë të ambasadorit francez, osmanët nënshkruan me Francën, në 1210/maj 1796, një traktat me 15 nene, që përcaktonte koordinimin e përgjithshëm midis Devletit Osman dhe Republikës së Francës në luftërat evropiane, dhe që deklaroi asnjansinë e Devletit Osman, në rast lufte, në të ardhmen, midis Francës dhe Britanisë. Ambasadori francez kishte deklaruar se me një traktat të tillë do të përfitonin të dyja palët, madje, ai përmendi edhe mundësinë e rimarrjes së Krimesë nga Devleti Osman. Disa nga shtetarët osmanë kishin mendimin që francezët e kishin për zakon ta ndërronin politikën e tyre vazhdimisht, dhe se nënshkrimi i një traktati të tillë midis Devletit Osman dhe Francës, do të bënte të mundur ngritjen e Rusisë dhe Austrisë kundër osmanëve dhe për këtë arsye do të ishte më me vend ta shtynin nënshkrimin e tij. Por sulltani ishte në favor të nënshkrimit të këtij traktati dhe për pasojë, Shejhulislami dhe Kadiaskerët e Rumelisë dhe Anadollit, si dhe dinjitarë të tjerë u mblodhën për të diskutuar këtë çështje, duke arritur në një përfundim që iu paraqit më pas sulltanit. Por, sulltani këmbënguli për ta lidhur këtë traktat menjëherë, dhe ai u nënshkrua, dhe u shkëmbye nga të dy palët më 17 Dhil Ka'de 1210/24 maj 1796.⁶¹

Shumë pak kohë më pas, Franca dhe Austria ndanë territorin e Venedikut mes tyre, ku Franca mori detin Adriatik me shtatë ishuj në këtë rajon dhe Prevezën, dhe në këtë mënyrë arriti të kishte kufij të përbashkët me Devletin Osman, që kishte kufij të përbashkët me Austrinë dhe Rusinë në Evropë. **Napoleon Bonaparti** (1769-1821) u autorizua nga qeveria republikane e Francës të nisej drejt Mesdheut në krye të një ushtrie prej 60.000 ushtarësh. Ai mbërriti fillimisht në Maltë, e bllokoj atë me 25 luftanije dhe me më shumë se 300 anije përforcuese, dhe e pushtoi atë. Ai asgjësoi piratët që u vetëquajtën "Kalorës të Shën Xhonit";⁶² ata ishin larguar nga Rodosi, kur ishulli u hap

61 *Netajixh*, IV, fq. 36.

62 *Netajixh*, IV, fq. 37.

ndaj Islamit në vitin 1522 nga **Sylejmani i Madhërishëm**. Kjo organizatë me emrin “Kalorësit e Shën Xhonit” ishte themeluar në vitin 1070, në Jeruzalem; ishte transferuar në vitin 1292 në Qipro; dhe ishte vendosur në ishullin e Rodosit, në vitin 1306. “Pas pushtimit të Tokave të Shenjta nga muslimanët, urdhri (kalorësit piratë) ishte vetëvendosur si një bastion i fortifikuar kundër Islamit dhe ishte kthyer në një bazë kryesore për piratët që sulmonin anijet otomane, që lundronin në Detin Egje dhe në detin e Mesdheut Lindor, dhe në një mbështetës të përpjekjeve të Kryqëzatave të ndryshme detare në ato zona.”⁶³

Më pas, **Napoleon Bonaparti** iu drejtua Aleksandrisë, portit të Egjiptit Osman dhe pa asnjë deklaratë lufte zyrtare, zbarkoi me ushtarët e tij në tokën e Egjiptit, në korrik të vitit 1798. Ai u përpoq ta justifikonte këtë akt të pazakontë dhe të pavend, duke pretenduar se kishte mbërritur në Egjipt për të parandaluar veprimtaritë imperialiste të Britanisë në mbështetje të Devletit Osman, dhe për t’i dhënë fund sjelljes së pacipë të memlukëve të Egjiptit, sikur Devleti Osman të kishte dashur me të vërtetë diçka të tillë prej tij. Valiu **Bekir Pasha**, Reisul Umera **Ibrahim Beu** dhe **Murad Beu** u përpoqën me gjithë forcat e tyre ta mbronin Egjiptin me 30.000 ushtarë, por ata pësuan disfatë nga ushtria franceze e stërvitur dhe e pajisur mirë me armatime moderne.⁶⁴

Xhezzar Ahmed Pasha

Pas pushtimit të Egjiptit, Napoleon Bonaparti synonte të pushtonte edhe Sirinë. Ai tha: “Vendosa të marshoja drejt Sirisë në kuadrin e kolonializmit. Siria dhe Egjipti duhet të jenë nën të njëjtën qeveri.”⁶⁵ **Napoleoni** u përpoq të mashtronte **Xhezzar**

63 Shaw, *vepër e cituar*, fq. 9.

64 *Netajixh*, IV, fq. 37.

65 Enver Zija Karal, *Osmanlı Tarihi*, Ankara 1994, botimi il 6-të, vëll. V, fq. 39.

Ahmed Pashanë (v.1804) e Akkasë Osmane, por pashai nuk iu përgjigj letrave të tij.

Britania nuk ishte dakord me pushtimin francez të Egjiptit. Kishte mjaft konkurrencë midis këtyre dy fuqive imperialiste. Francës iu desh të hiqte dorë nga kolonitë e saj në Kanada dhe Indi, që u kthyen në koloni të Britanisë me nënshkrimin e Traktatit të Parisit (1763), pas luftës 7-vjeçare (1756-1763), mes fuqive evropiane. Marrja e Egjiptit nga Franca, një vendi me rëndësi strategjike në Afrikë, që ndodhej në rrugën drejt Indisë, nuk ishte një situatë e pranueshme për Britaninë. Për këtë arsye, **Admirali britanik Nelson** shkatërroi dhe dogji anijet franceze.

Gjenerali Napoleon Bonaparti avancoi drejt Sirisë, mori kështjellën e Haifas në sajë të një marrëveshje dhe kështjellën Xhafa me luftë, ku ai masakroi 5.000 ushtarë shqiptarë dhe arabë. Pasi arriti në Akka, Napoleoni rrethoi qytetin për 50 ditë, gjatë të cilave ai humbi më shumë se 15.000 ushtarë dhe përfundimisht pësoi një disfatë të rëndë. **Kjo ishte disfata e parë e Napoleonit.** Ai groposi në këtë vend artilerinë e rëndë të ushtrisë franceze dhe me shpejtësi u tërhoq në Egjipt, pasi helmoi të gjithë ushtarët francezë të plagosur dhe të sëmurë. Nëse Napoleoni nuk do ta kishte sulmuar Akkanë, pushtimi francez i Egjiptit mund të kishte zgjatur më shumë. Rrethimi i Akkasë dhe disfata e turpshme e francezëve ishte me të vërtetë një pikë kthese për historinë e këtij rajoni.⁶⁶

Pushtimi francez i Egjiptit pati ndikime të rëndësishme për Historinë Botërore; për një periudhë tre vjeçare, qendra e politikës evropiane kaloi në Mesdhe. Ky ishte një dështim për Francën, pasi ajo nuk arriti të merrte Egjiptin për një kohë të gjatë dhe nuk mundi t'ia pengonte rrugën drejt Indisë, Britanisë dhe kështu, nuk arriti as të zotëronte Mesdheun Lindor. Por, ishin shkencëtarët dhe studiuesit që shoqëruan Bonapartin në Egjipt, ata që patën ndikim të madh mbi popullsinë e Egjiptit për të ardhmen e këtij vendi.

66 Netajixh, IV, fq. 38.

Aventura franceze në Egjipt i shërbeu mjaft mirë interesave të Britanisë; Britania u çlirua nga rreziku që i kanosej nga Bonaparti, i cili ishte një kërcënim për zotërimet e Britanisë në Lindje. Britania u vendos në Maltë gjatë kësaj fushate, duke marrë në këtë mënyrë një pikë tjetër strategjike që kontrollonte Mesdheun Perëndimor pas **Xhebelittarikut** (Gjibraltarit).⁶⁷

Rimarrja e Egjiptit nga osmanët

Me pushtimin francez të Egjiptit, Izet Mehmed Pasha u shkarkua nga posti i tij, dhe **Valiu** i Erzurumit, **Jusuf Zija Pasha**, mori vendin e tij si Sadrazam. Në vitin 1798, Devleti Osman nënshkroi një traktat me Britaninë dhe Rusinë, kundër Francës, dhe në vitin 1799, anijet ruse iu bashkuan atyre osmane në Stamboll, nën drejtimin e **Shermet Kapudanit**. Së bashku ata rimorën nga Franca Xhezajir-i Seb'a (Shtatë Ishujt). **Ali Pashë Tepelena** (v.1822) rimori Prevezën, Pargën dhe dy kështjella të tjera në brigjet e detit Adriatik. Siç ishte rasti në Dubrovnik, në ata shtatë ishuj, u themelua një republikë nën vartësinë e Devletit Osman, të cilit i paguante një tagër prej 70.000 dukatesh çdo tre vjet.⁶⁸

Napoleon Bonaparti, që ishte bllokuar në Egjipt për shkak të dështimit të flotës së tij, kontaktoi me **Sidni (Sidney) Smith**, admiralin e flotës britanike, dhe mori leje nga ai për të dërguar disa nga njerëzit e tij në Francë, duke e mashtruar në këtë mënyrë atë, pasi ai u largua vetë nga Egjipti me dy anije të vogla në Rebīul Ahir 1214/nëntor 1799 dhe mbërriti në Marsejë. Ai la në Egjipt, **Gjeneral Kleberin**, që kishte autorizimin për të nënshkruar një traktat me Britaninë, nëse asnjë përforsim nuk do të arrinte nga Franca brenda 6 muajve, sepse Napoleoni e dinte mjaft mirë se Franca mund të mos kishte mundësi të

67 Karal, *vepër e citur*, V, fq. 42.

68 *Netajixh*, IV, fq. 39.

ruante pozicionin që kishte arritur në Egjipt, pa ndihmën e një flote të fuqishme.⁶⁹

Jusuf Zija Pasha mbërriti në Damask në krye të ushtrisë osmane, që gjatë rrugës ishte përforcuar dhe nga rekrutë të rinj. Ai rihapi ndaj Islamit el-Arishin, dhe pas kësaj, francezët vendosën të tërhiqeshin nga Egjipti. Kleberi, përfaqësuesit britanikë dhe një përfaqësues i Zija Pashait nënshkruan një marrëveshje në vitin 1801, që përcaktoi kushtet për këtë tërheqje. Në shkurt të vitit 1801, francezët filluan të tërhiqeshin, por admirali britanik, në të njëjtën ditë që ata duhej të zbraznin kështjellën, mori një direktivë të papritur nga Londra sipas të cilës francezët duhet të dorëzonin edhe armët e tyre. Kjo e zemëroi gjeneralin francez dhe ushtarët e tij, dhe për këtë arsye ata u hodhën në një sulm të befasishëm kundër britanikëve. Por, përfundimisht, ata u mundën dhe u detyruan ta dorëzonin Egjiptin në 1801; dhe armët e tyre u ndanë midis osmanëve dhe britanikëve. **Veziri Hysrev Pasha** u caktua *Vali* i Egjiptit dhe Sadrazami Jusuf Zija Pasha u rikthye në Stamboll, duke lënë pas 10.000 ushtarë për të mbajtur nën kontroll çdo problem të mundshëm që mund të krijohet nga fisnikët memlukë. Pushtimi francez i Egjiptit, që zgjati vetëm për tre vjet, i kushtoi shtrenjtë Francës: 40.000-50.000 ushtarë dhe një flotë detare.⁷⁰ Por, nga ana tjetër, pati dhe një ndikim të tmerrshëm mbi vetë Egjiptin dhe botën muslimane. Me kalimin e kohës, Egjipti u bë më i fuqishëm se vetë Devleti Osman, pasi egjiptianët nën sundimin e **Muhammed Aliut** dhe dinastisë së tij përvetësuan idetë dhe armatimet perëndimore.

69 Gjeniu ushtarak **Javuz Sulltan Selimi** ishte në dijeni të këtij fakti që në vitin 1517, kur osmanët morën Egjiptin, pasi ai priti për mbërritjen e flotës osmane përpara se t'iu dërgonte vendeve të tjera një *fet'hname* (shpalljen se kishte marrë Egjiptin).

70 *Netajixh*, IV, fq. 40-41.

Fillesat e evropianizimit

Nizam-ë Xhedid

Gjatë periudhës së **Sulltan Mahmudit I** (1730-1754), osmanët kishin filluar të rinovonin dhe të përmirësonin ushtrinë e tyre. Të famshmit **Kont de Boneval**, i cili pranoi besimin islam dhe u bë i njohur me emrin **Humbaraxhë Ahmed Pasha**, iu besua zbatimi i kësaj politike. Ai stërviste ushtarët *humbaraxhë* dhe mendonte se “një gjeneral i aftë mund ta pushtonte gjithë botën me këta ushtarë.”⁷¹ Gjatë periudhës së sundimit të **Sulltan Mustafait III**, një fisnik hungarez, **Baroni de Tott**, u caktua për stërvitjen e ushtarëve osmanë. Sulltan Mustafai kishte bindjen e plotë se trupa e jeniçerëve nuk ishte më funksionale, për shkak të mungesës së disiplinës në radhët e tyre. Në vitin 1773, ai themeloi **Myhendis’hane-ji Bahri-ji Hymajun** (Kolegjin e Inxhinierisë së Marinës) për stërvitjen dhe trajnimin e oficerëve, ku mësues ishte Baroni de Tott.⁷²

Pas disfatës së flotës osmane në Çeshme, në vitin 1770, emri i **Gazi Hasan Pashait** u shfaq si një figurë e aftë. Ai u emërua Kapudan-ë Derja. “Ai kuptoi se ndërkohë që ishin të nevojshme anijet moderne, ato nuk do të ishin, gjithsesi, të mjaftueshme, nëse nuk do të drejtoheshin nga oficerë të aftë, dhe nga persona të trajnuar me teknikat e reja të flotave luftarake detare. Në këtë mënyrë, ai ndërmori reforma në dy fronte: Së pari, u ndërtuan kantiere të reja detare në Gjirin e Bririt të Artë, në Detin e Zi dhe në Detin Egje... Së dyti, Gazi Hasan Pasha punoi gjithashtu, për të krijuar një shërbim karriere për forcën detare. Marinarët nga fshatrat përgjatë brigjeve të Egjeut dhe Mesdheut filluan të regjistroheshin, por sistemi i mëparshëm, që i lejonte ata të jetonin të lirë dhe pa

71 Enver Zija Karal, *Osmanlı Tarihi*, Ankara: Türk Tarih Kürümü Basımevi, 1994, vëll. V, fq. 57.

72 Bekir Sıtkı Baykal, “Mustafa III”, *Millî Eğitim Bakanlığı İslam Ansiklopedisi*, Stamboll: 1993, vëll. VIII, fq. 701.

mbikëqyrje në lagjet Kasëmpasha dhe Gallata si beqarë, u zëvendësua me disa baraka në depot e arsenalit detar, në Sinop, në Detin e Zi, dhe në ishullin Midil-li, në Detin Egje, ku ata i nënshtroheshin një disipline dhe stërvitjeje të rreptë dhe të qëndrueshme. Në mënyrë që të kishte oficerë për flotën detare, ai e ktheu shkollën e matematikës së de Tottit në një Kolegj të Inxhinierisë Detare (*Myhendis'hane-i Bahri-i Hymajun*), të zhvilluar plotësisht me instruktimet e de Tottit, të Kembellit (Campbell) dhe të disa specialistëve të huaj dhe osmanë të gjeometrisë, lundrimit, e të ngjashme."⁷³

Pas ardhjes në fuqi, **Sulltan Selimi** filloi të zbatonte me ngulm idetë e babait të tij, dhe në vitin 1206/1792 urdhëroi zyrtarët e tij të lartë të prezantonin projekte për përmirësimin e situatës. Gjithashtu, ai urdhëroi stërvitje të veçantë për trupën jeniçere, dhe njëkohësisht krijimin e një force të re ushtarake. Ai përmirësoi institucionet ushtarake, themeloi *Myhendis'hane-i Berr-i Hymajun* (Shkollën e Inxhinierisë të Forcave Tokësore) në Haskoj (Hasköy), Stamboll, në vitin 1794. Ai ndërtoi 45 anije të reja, dhe krijoi një organizatë me emrin *irad-ë xhedid* (burimi i ri) për t'u marrë me çështjet financiare të *Nizam-ë Xhedidit* (Urdhrit të Ri ushtarak).⁷⁴

Ndërkohë, një ushtar i aftë dhe ambicioz me emrin **Muhammed Ali** fitoi famë në Egjipt. Ai kishte shërbyer si ushtar, në ekspeditën që Osmanët kishin dërguar nga Rumelia për në Egjipt, gjatë pushtimit të këtij vendi nga Napoleoni. Mënjëherë pas largimit të trupave franceze nga Egjipti, Muhammed Aliu thuri disa intriga kundër Hysrev Pashait, *Valiut* Osman të Egjiptit dhe iu shkaktoi pasardhësve të tij kaq shumë probleme, sa që ata e humbën kontrollin e situatës. Ai, gjithashtu, arriti të nënshtronte fisnikët memlukë dhe në fund mori postin e Vezirit Osman dhe *Valiut* të Egjiptit në vitin 1220/1805.

73 Shaw, *vepër e cituar*, I, fq. 252.

74 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 67.

Shfronësimi i Selimit III

Ndërkohë në mbarë Devletin Osman mbizotëronte shqetësimi dhe paqëndrueshmëria. Vehabitët u rebeluan në gadishullin arabik dhe kryengritjet u përhapën dhe në Greqi, në Gadishullin e Moresë, në Mesdhe dhe në Serbi. Devleti Osman nuk arriti ta kontrollonte këtë situatë të rrezikshme, dhe Këshilli i *Ulemave* fajësoi *Nizam-ë Xhedidin* për këtë dështim katastrofik. Megjithatë, duke qenë se kishte themeluar *Nizam-ë Xhedidin*, në Stamboll dhe Anadoll, Sulltan Selimi III vendosi ta dërgonte atë dhe në Rumeli, por Sadrazami, Ismail Pasha, e kundërshtoi fuqimisht atë dhe faktikisht, ai iu drejtua në mënyrë të fshehtë dhe dinjitarëve të Devletit që ta kundërshtonin atë. Dështimi i *Nizam-ë Xhedidit* në Rumeli nxiti edhe provincat e tjera për ta kundërshtuar në mënyrë aktive dhe për të vepruar fshehurazi kundër tij.

Duket se *Nizam-ë Xhedid* ishte një urdhër që ishte krijuar pa u menduar gjatë dhe nuk ishte shumë i përgatitur. Shumë persona me influencë nuk ishin të bindur për përshtatshmërinë e këtij urdhri, ndërsa të tjerë mendonin se për të zëvendësuar jeniçerët me një strukturë të re duhet të kishte një planifikim të mirë, në mënyrë të atillë që të mos u lihej hapësirë jeniçerëve për t'u revoltuar dhe për ta kërcënuar dhe vetë ekzistencën e Devletit.

Nën drejtimin e **Kabakçë Mustafait**, ushtarët në Bosfor u ngritën në revoltë, duke e detyruar Sulltan Selimin të abdikonte nga fronin në vitin 1807. Pak para abdikimit, disa nga këshilltarët e tij e këshilluan atë që të mblidhte ushtrinë osmane, që ishte dërguar në luftë në brigjet e Danubit kundër kryengritësve të atjeshëm, por ai i kundërshtoi duke thënë: "Jo! Në këtë rast, forcat ruse mund të vijnë në Çatallxa (pranë Stambollit)."⁷⁵ Kjo tregon se, për të, integriteti i Devletit Osman qëndronte mbi interesin e tij personal.

75 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 83.

Sulltan Selimi III ishte adhures i arteve të bukura, poezisë dhe këngës. Ai ishte një poet dhe një kompozitor i mirë muzike. Ai ishte krijuesi i melodisë *suz-i dilara* për muzikën klasike osmane. Por, ai dhe dinjitarët e Devletit pëlqenin jetën e shturur dhe luksoze. Ndoshta, kjo ishte dhe arsyeja kryesore që njerëzit nuk e pëlqyen *Nizam-ë Xhedid*, që ishte huazuar nga Evropa. Një gabim tjetër i Selimit ishte neglizhenca e tij ndaj pikëpamjeve të ulemasë dhe njerëzve të tjerë të ditur. Për shembull, ai e kundërshtoi pikëpamjen e tyre, sipas së cilës ishte e nevojshme të kishte diskutime me pjesëtarët e tjerë të elitës osmane, mbi çështjen e lidhjes së një traktati me Francën, por ai vendosi t'i vazhdonte i vetëm diskutimet dhe ta nënshkruante këtë traktat menjëherë. Pas pak kohe, francezët i shkelën kushtet e këtij traktati dhe pushtuan Egjiptin.

15.3 Sulltan Mustafai IV 1807-1808

Në vitin 1807, fronin e Selimit III e mori Mustafai, që nuk kishte një arsimim për t'u lakmuar dhe u detyrua të mbante marrëdhënie të mira me ata që e rrëzuan Selimin nga froni. Mbështetësit e *Nizam-ë Xhedidit*, nga ana tjetër, kishin mbështetur **Alemdar Mustafa Pashanë** e Rusçukut,⁷⁶ i cili kishte qenë ushtar jeniçer, por, që në vitin 1221/1806 ishte ngritur në rangun e vezirit, pas suksesit së tij në betejat kundër rusëve. Ndërkohë që *Ordu-ju Hymajun* ishte nisur nga Edreneja drejt Stambollit, Alemdari iu bashkua ushtrisë së Sadrazamit me 16.000 ushtarë. Përpara se të hynin në Stamboll, ushtria dërgoi **Haxhi Ali Again** për të ekzekutuar **Kabakçë Mustafain**, që në atë kohë kishte nën administrim Bosforin. Më pas, **Alemdar Mustafa Pasha**, në vitin 1223, mori kontrollin e Stambollit me 15.000 ushtarëve. Ai planifikoi të risillte në fron Selimin III, por, gjatë përpjekjeve për të siguruar pozitën e tij, Sulltan Mustafai urdhëroi ekzekutimin e menjëhershëm të Selimit dhe Shehzade Mahmudit, por kur Selimi u vra, Mahmudi arriti të arratisëj. Ky

76 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 85.

i fundit, në vitin 1808, mori fronin e Sulltanit osman dhe caktoi Alemdarin si Sadrazamin e tij.⁷⁷

15.4 Sulltan Mahmudi II 1808-1839

Mahmudi II, Sulltani i ardhshëm në moshë të re, i thirri *ajanët* (autoritete lokale me influencë) nga të gjithë provincat dhe zonat osmane, në një mbledhje në Stamboll, që u drejtua me guxim nga **Alemdar Mustafa Pasha**, i cili argumentoi se trupa e padisiplinuar e jeniçerëve ishte arsyeja kryesore për shpërbërjen e Devletit Osman, dhe se kjo mund të ndalohej vetëm nëpërmjet krijimit të një ushtrie të re të quajtur *Sekban-ë Xhedid*.⁷⁸ Ai shtoi, gjithashtu, se ky rinovim ishte një dëshirë e *Padishah-ë gyzin ve Halife-i Ruj-i Zemin* (Sulltanit të zgjedhur dhe Halifit të Botës).⁷⁹ Kjo ishte një përpjekje për të institucionizuar fuqinë dhe autoritetin e *ajanëve*, të cilët paraqitën një dokument të quajtur *sened-i ittifak* (dokumenti i marrëveshjes), ku radhiteshin disa parime për fuqizimin e autoritetit të Devletit Osman. Shejhulislami lëshoi një *fetva*, në të cilën deklarohet autenticiteti dhe përputhshmëria e këtij dokumenti me Sheriatin, ndërsa sulltani e miratoi atë me *Hatt-ë Hymajunin* (Dekretin Qiellor) e tij.⁸⁰

Por, kundërshtarët e këtyre risive, së bashku me disa jeniçerë, sulmuan në një mbrëmje nëntori të vitit 1808 shtëpinë e Alemdar Mustafait, gjatë të cilit ai mbeti i vvarë, dhe për pasojë organizata *Sekban-ë Xhedid* u shfuqizua.⁸¹ Kryengritësit kishin planifikuar të risillnin në fron Mustafain, por ai u ekzekutua.⁸²

Perandori francez dhe Cari i Rusisë përfituan nga kjo situatë dhe lidhën një marrëveshje kundër Devletit Osman. Në vitin

77 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 88-89.

78 Mehmed Tevfik, *Tarih-i Osmani*, Stamboll: 1305 H., fq. 293.

79 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 91.

80 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 93.

81 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 96.

82 *Netajixh*, IV, fq. 60.

1810, ushtria ruse sulmoi (për herë të parë) territorin osman nga ana e Anadollit. Rusët morën kështjellën e Ismailit dhe Ibrailit në pjesën evropiane të territorit osman, edhe pse ata pësuan disfatë në betejat që u zhvilluan në Shumna⁸³ dhe Silistre.⁸⁴ Rusët, gjithashtu, pushtuan edhe Vllahinë, dhe Moldavinë në Rumeli, ndërkohë që serbët u rebeluan kundër osmanëve nën drejtimin e **Karagjorgjit**. Megjithatë, **Napoleoni** drejtoi një sulm të befasishtë kundër Ruisë dhe forcat ruse u detyruan të lidhnin me osmanët traktatin e Bukureshtit në vitin 1812. Sipas këtij traktati, lumi **Prut** do të përcakonte vijën kufitare të territoreve midis dy fuqive: osmanët i dorëzuan Besarabinë Ruisë,⁸⁵ ndërkohë që **Hurshid Pasha** nënshtroi serbët dhe u kthye në Stamboll në vitin 1229/1814.⁸⁶

Pasi zgjidhën problemet me Rusinë dhe Serbinë, osmanët u përqendruan në rrezikun në rritje të vehabitëve në Gadishullin Arabik. **Muhammed Ali Pashait** së Egjiptit Osman iu kërkua të përballlej me vendosmëri me këtë kërcënim. Ai dërgoi djemtë e tij **Tosun Pashanë** dhe **Ibrahim Pashanë**, në Arabi, në krye të një ushtrie të fortë. Ata i mundën vehabitët në disa betejat dhe arritën të afirmonin autoritetin e Devletit në këtë gadishull të rëndësishëm.⁸⁷

Nacionalizmi dhe ndikimi mbi Devletin Osman

Në atë kohë në Evropë kishte filluar të hidhte hapat e parë çështja kombëtare që kishte filluar të përdorej për të nxitur popullsinë osmane jomuslimane,⁸⁸ kundër qeverisë së tyre.

83 Shanizade Mehmed Ataullah, *Tarih*, Stamboll: 1284, fq. 371.

84 *Netajixh*, IV, fq. 70.

85 M. Tevfik, *vepër e cituar*, fq. 295.

86 *Netajixh*, IV, fq. 70.

87 M. Tevfik, *vepër e cituar*, fq. 296.

88 Popullsia e qeverisur në administratën islame quhet **ra'aja/rajë** (shumësi: **ra'ijjet**), që do të thotë "ata për të cilët kujdesesh", dhe duke u bazuar në këtë fakt, është një gabim i madh t'iu referohesh atyre si të nënshtuar. Popujt e sunduar të Evropës në atë kohë meritojnë të emërtohen si "**të nënshtuar**", pasi ata dhe ishin të nënshtuar dhe trajtoheshin keq nga

Nacionalizmi është përshkruar si një “doktrinë e shpikur në Evropë, në fillim të shekullit të 19-të” që “konsideron se njerëzimi në mënyrë të natyrshme ndahet në kombe, dhe kombet dallohen nga disa karakteristika të përcaktuara, dhe se lloji i vetëm legjitim i qeverisë, është vetëqeverisje kombëtare.”⁸⁹ **Kjo doktrinë u përdor nga evropianët për të bashkuar Gjermaninë dhe Italinë, dhe për të shpërbërë Devletin Osman, që përfshinte një numër të madh komunitetesh. Megjithatë, nacionalizmi mbetej një doktrinë politike⁹⁰ dhe nuk kishte rëndësi nëse ishte një realitet objektiv apo jo. Benito Musolini ka thënë për këtë doktrinë: “Ne kemi krjuar mitin tonë. Miti është besim, është një pasion. Nuk është e nevojshme që të jetë një realitet. Është një realitet për faktin që është një e mirë, një shpresë, një besim që nxit. Miti ynë është Kombi, miti ynë është madhështia e Kombit! Dhe për këtë mit, për këtë madhështi, në të cilën ne dëshirojmë të ndryshojmë realitetin e plotë, *ne do t'i nënshtrojmë të gjithë të tjerët.*”⁹¹**

Deri në fund të shekullit të 18-të, motivi dominues në Evropë si dhe në territorin osman ishte **besimi**: bota e krishterë për të parin, dhe Islami për këtë të fundit. **Nacionalizmi** u shfaq për të krijuar e një teori të veçantë të legjitimitetit politik. “Edhe pse ishte një rrjedhojë e ideve të mëparshme, kjo teori u zhvillua më tepër gjatë periudhës së zhurmshme të luftërave revolucionare franceze, mes viteve 1789 dhe 1815, si një alternativë e re ndaj mënyrave mbizotëruese të mendimit, që e bazonin autoritetin e qeverisë në traditën, të drejtën hyjnore

drejtuesit e tyre, ndërkohë që populli osman *raja* gëzonte liri të plotë besimi dhe kulture. Edhe në shekullin e 21-të, shumë nga fuqitë perëndimore nuk kanë arritur ende në të njëjtin nivel tolerance dhe civilizimi.

89 E. Kedourie, *Nationalism*, Londër: 1960, fq. 9. Cituar në veprën e Richard Jay “*Nationalism in Political Ideologies* (nga bashkëautorët Robert Ecclashall, Vincent Geoghegen, Richard Jay dhe Rick Wilford, Londër: Unwin Hyman 1990, fq. 185. Theksimi është shtuar.

90 Shiko poshtë-shënimin 89.

91 Benito Mussolini, (1922) cituar nga *Mussolini's Italy* e R. Finer, Nju Jork: 1935, fq. 218; cituar po aty, fq. 185. Theksimi është shtuar.

apo në ligjin natyror."⁹² **Fuqitë evropiane e shfrytëzuan në mënyrë perfekte këtë doktrinë të re, për të shpërbërë Devletin Osman, duke nxitur fillimisht *rajën* e tij jomuslimane, dhe më pas, sidomos gjatë Luftës së Parë Botërore, edhe *rajën* e tij muslimane.**

Kryengritja greke

Rusët nxitën popullsinë greke dhe popuj të tjerë jomuslimanë në Evropë për të ngritur krye kundër sundimit osman. Kryengritjet dhe rebelimet filluan në Vllahi dhe më pas u përhapën në More në vitin 1236/1821. Kryengritjet në Vllahi u nënshtruan lehtësisht, por ato morën përmasa të rrezikshme në More, ku priftërinjtë luajtën një rol aktiv në nxitjen e dhunës. Popullsia greke në More kishte mbështetur **Tepedelenli Ali Pasha (Tepelena)**. Por, **Halet Efendiu**, *myhyrdari* i Sulltan Mahmudit II u inatos me Tepedelenli Ali Pashanë, pasi ai nuk i dërgonte më dhuratat që i dërgonte më parë. Përveç kësaj, **Halet Efendiu** kishte shërbyer për dinjitarët grekë në Stamboll dhe kishte qenë një *myrebbi* i fëmijëve të tyre.

Personi që nxiti, organizoi dhe drejtoi revoltat ishte **Aleksandër Ipsilanti**, asistent personal ushtarak i Carit të Rusisë. Një shoqëri e fshehtë e quajtur **Etniki Eterja**, nën drejtimin e Ipsilantit, kishte përgjegjësinë për nxitjen e kryengritjeve. Kjo shoqëri ishte themeluar në Odesë në vitin 1814, me pretekst përhapjen e arsimimit ndër të krishterët që jetonin brenda territorit osman. Objektivi i vërtetë i saj ishte të ringjallte Perandorinë nën drejtimin e Patriarkut Ortodoks të Stambollit.

Tepedelenli Ali Pasha mori informacione për përgatitjet e kryengritësve grekë në More dhe siguroi një letër që anëtarët e komitetit i dërgonin *Despotit* të Janjas. Ai thirri *despotin* dhe i dha atij këtë letër që i kishte rënë në dorë dhe i kërkoi atij ta lexonte. Despoti vdiq në çast nga tronditja dhe frika që pësoi.

Tepedelenli Ali Pasha njoftoi Stambollin për këtë situatë, por **Halet Efendi** dërgoi në More, për të hetuar mbi situatën, **Nikola Moruzin**, që ishte një përkthyes i *divanit*, si dhe një anëtar i shoqatës Etniki Eterja. Natyrisht, Nikola Moruzi raportoi se *raja* e Rumelisë ishte besnike ndaj Devletit. Për këtë arsye, u vendos që **Tepedelenli Ali Pasha** të ndëshkohej. Në këtë mënyrë Tepedelenli Ali Pasha u nxit deri në rebelim, nëpërmjet intrigave të Halet Efendiut dhe **Hurshid Pasha** u nis kundër tij.

Kryengritjet në Vllahi u shtypën lehtësisht dhe **Aleksandër Ipsilanti** u strehua në Austri. Cari rus e kritikoi lëvizjen e kryengritjeve.

Por, situata në More arriti në përmasa të rrezikshme për shkak të priftërinjve, të cilët kishin marrë një rol aktiv në nxitjen e dhunës. Patriarku Ortodoks Rum, në Stamboll, ishte një anëtar me ndikim i shoqatës Etniki Eterja, por pas kritikës së Carit të Rusisë ndaj kryengritjeve, ai u frikësua dhe publikoi një deklaratë që i fajësonte ata që këmbëngulnin për këtë kryengritje. Kjo deklaratë pati disa ndikime në Stamboll dhe Rumeli, por nuk pati asnjë ndikim në More. **Halet Efendi**, që vazhdimisht i udhëzonte keq sulltanin dhe sadrazamin, u dërgua në Konja ku dhe u ekzekutua.⁹³ “Sipas letrave të siguruara ishte e qartë se Patriarkati i Stambollit, dhe priftërinjtë në fshat, ishin të përfshirë në këto kryengritje dhe ata u ekzekutuan, gjithashtu edhe vezirët, zyrtarët e lartë u dërguan në ishujt dhe në zonat bregdetare.”⁹⁴ Kryepeshkopi Ortodoks rum (grek) **Grigorios** në Stamboll, **duke qenë anëtar i rajës osmane, u dënua për tradhti me ekzekutim, në vitin 1236/1821,**⁹⁵ një rast ky për të cilin edhe në ditët e sotme asnjë shtet nuk do të hezitonte për të vepruar në të njëjtën mënyrë.⁹⁶ **Edhe në ditët e sotme, rumët (grekët) e mbajnë të mbyllur fort derën ku ai u**


93 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 111-113.

94 *Netajixh*, IV, fq. 74.

95 M. Tevfik, *vepër e cituar*, fq. 297; Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 113.

96 Le të kujtojmë qëndrimin e mbajtur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndaj Teksasit kur ky i fundit kërkoi ndarjen.

var në Stamboll, për t'i kujtuar fëmijët e tyre për këtë incident, sa herë që ata shkojnë për të zbatuar detyrat e tyre fetare, si dhe për t'iu përcjellë atyre një ndjenjë urrejtje ndaj vendit, në të cilin ata jetojnë dhe gëzojnë të drejta të plota si qytetarë.



Porta e fundjavës. Porta e kyçur e Patriarkatit

Për shkak të faktit që filozofia greke është një nga tre elementet e kulturës evropiane, rumët (grekët të cilët “mendohet” se janë pasardhës të grekëve të lashtë, që në fakt është vetëm një mit) janë simpatizuar në Evropë, dhe për këtë arsye, **Koloneli Favje (Fabvier)** shërbeu në ushtrinë e Napoleonit, dhe **Lord Bajroni (Byron)** ishte një ndër kryengritësit në More.⁹⁷

Devleti Osman ishte i paaftë për të nënshtruar kryengritjen në More; forcat jeniçere nuk ishin të afta dhe përpjekja për të krijuar një ushtri të re rezultoi e pasuksesshme. Për këtë arsye u kërkua ndihma e valiut të Egjiptit, Muhammed Ali Pashait. Djali i tij, Ibrahim Pasha, u emërua vali i Moresë me autoritet të plotë, dhe vali i Vidinit, **Reshid Pasha**, u emërua, gjithashtu, si Bejlerbej i Rumelisë dhe **Serasker** (Kryekomandant) dhe iu dha

97 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 114.

përgjegjësi, dhe autoritet i plotë për të bashkëpunuar më Ibrahim Pashanë. Ibrahim Pasha përparoi nga jugu i Moresë, me forca të stërvitura mirë nga Egjipti, dhe rimori shumë vende të zaptuara nga kryengritësit. Reshid Pasha përparoi nga veriu dhe e rrethoi kështjellën e Mosologjit, që ishte një kështjellë shumë e fortë, dhe që merrte përforcime nga deti, dhe për pasojë ishte shumë e vështirë të merrej. Më pas, në bashkëpunim me Kapudan-ë Derja, **Hysrev Pashanë** dhe **Ibrahim Pashait** ky bastion i fundit i kryengritësve u nënshtrua në vitin 1241/1826.⁹⁸

Politika ruse, gjatë periudhës së Carit Nikolla I, ishte e përqendruar në shkatërrimin e Devletit Osman. Faktikisht, kjo politikë ishte një linjë vazhdimësie e zgjerimit rus. **Nacionalizmi**⁹⁹ filloi të përhapej në radhët e *rajës* së krishterë të Devletit Osman¹⁰⁰ dhe Cari Nikolla zuri vendin në boshtin e ngjarjeve që do të vijonin më pas, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo.

Vak'a-jë Hajrije 1241/1826

Disiplina në radhët e forcave jeniçere u përkeqësua edhe më tepër, gjatë shekullit të 18-të, dhe veçanërisht në çerekun e parë të shekullit të 19-të. Ky përkeqësim arriti në një nivel të atillë sa që shumë shitës dhe artizanë mbanin poste të paguara jeniçerësh, duke marrë *ulufe* (paga të jeniçerëve), por duke mos bërë asnjë punë dhe duke u kthyer në ngatërrestarë.

Sulltan Mahmudi II kishte nxjerrë mësim nga përpjekjet e mëparshme të dështuara për shpërbërjen e trupave jeniçere. Për

98 *Netajixh*, IV, fq. 75; Danişmend, IV, fq. 108-109.

99 Nacionalizmi u përhap në Evropë pas Revolucionit Francez më tepër si një nocion politiko-ideologjik, se sa si një nocion që ishte në varësi të realitetit dhe arsyes. Në ditët e sotme, këto të dyja qëndrojnë së bashku në "Bashkimin Evropian". Por nacionalizmi "përdoret" ende nga evropianët dhe përkrahësit e tyre në radhët e popullsisë të ndryshme nëpër botë.

100 Akdes Nimet Kurat, *Rusya Tarihi*, Atatürk Kültür, Dil ve Tarih Yüksek Kurumu, Ankara 1987, botimi i dytë, fq. 323.

këtë arsye, për zbatimin e planit të tij, ai caktoi njerëzit e duhur në postet e duhura. Më pas, më 17 Shevval 1241/25 maj 1826, ai mblodhi *Mexhlis-i Hassin* (një Këshill i posaçëm) për të marrë *fetva* mbi “domosdoshmërinë e stërvitjes ushtarake” dhe vendosën të krijonin një forcë “ushtarësh të stërvitur” nën emrin Eshkinxhi. Por, në të njëjtën kohë, 150 ushtarë u morën nga 51 njësi jeniçere dhe u caktuan të formonin këtë forcë të re ushtarake. Gjithashtu, u përgatit një dokument që u nënshkrua nga dinjitarët e jeniçerëve dhe përgjegjësit e administratës.

Eshkinxhinjtë filluan stërvitjen ushtarake, me uniformat e tyre të reja, më 5 Dhulka’de 1241/11 qershor 1826. Për arsye se mundësitë që jeniçerët t’i rezistonin edhe kësaj përpjekje ishin të mëdha, sulltani i bëri për vete drejtuesit e njësisve të artilerisë, humbaraxhinjve, llagëmxhinjve (lağımjı) dhe të kantierëve detare. Për më tepër, **Aga Hysejin Pasha** dhe **Izet Mehmed Pasha**, që ishin përgjegjës për brigjet e Bosforit, u përgatitën për të ndërhyrë në rast rebelimi të jeniçerëve.

Jeniçerët u mblodhën në Etmejdanë, duke ngritur lart në shenjë rebelimi kazanin e tyre, por me thirrjen që iu drejtua forcave të Bosforit dhe me valëvitjen e *Sanxhak-ë Sherifit* (Flamurit të Pejgamberit të Fundit), muslimanëve iu drejtua një ftesë për t’u mbledhur. Populli, që ishte mërziur me sjelljen e jeniçerëve, erdhi pas *imamëve* dhe kadinjve. Me ftesë të Shejhulislamit, rreth 3500 studentë të medreseve erdhën nën Sanxhak-ë Sherifin. Kazermat e jeniçerëve u shkatërruan dhe u dogjën. U lexua *Fermani* mbi shfuqizimin e trupave jeniçere në **Xhaminë Sulltanahmed** më 11 Dhulka’de 1241/17 qershor 1826. Kjo ngjarje u quajt **Vak’a-jë Hajrijje** (ngjarja e mirë). Pak kohë pas saj, edhe urdhri i *Bektashinjve* me të cilin jeniçerët deklarorin se kishin lidhje, u ndalua dhe u shfuqizua.¹⁰¹

Në një lloj mënyre, viti **1826** tregon se Devlet-i Alijje-i Osmanijes i kishte ardhur fundi, pasi e kishte humbur

101 Danişmend, *vepër e cituar*, IV, fq. 110-111; Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 150.

dinamikën e fillimit, dhe përpqej vetëm të mbijetonte në anën materiale. Nuk do të ishte e gabuar, që këto ngjarje, që ndodhën pas kësaj date, të vlerësoheshin si përpjekje për të penguar apo për të vonuar rënien e Devletit. Duhet të theksojmë në këtë rast, se rënia erdhi si fillim në mendjet e administratorëve dhe intelektualëve të tij; ata humbën shpresën në Islamin, forcën motivuese dhe gjallëruese, dhe energjinë e Devletit.

Asakir-i Measure-ji Muhammedijje

Një ushtri e re e bazuar në modelin evropian u formua dhe u quajt *Asakir-i Measure-ji Muhammedijje*. **Sulltan Mahmudi II**, që ishte i zemëruar nga armiqësia që kohët e fundit francezët kishin shfaqur ndaj Devletit Osman, përfshiu në radhët e ushtrisë së re oficerë nga Prusia dhe jo nga Franca. Përveç kësaj, ai dërgoi në Evropë studentë që të mësonin mbi artin e luftës.¹⁰²

Në vitin 1834, ai themeloi *Mekteb-i 'Ulum-ë Harbije* (Shkollën e Shkencave Ushtarake), ndërsa, në vitin 1827, ai kishte hapur një shkollë për trajnimin e doktorëve në këtë ushtri të re. Kjo shkollë u transferua në ndërtesën e saj të re në vitin 1838 dhe gjuha e mësimdhënies ishte frëngjisht.¹⁰³

Pavarësia e Greqisë

Pas shfuqizimit të trupave jeniçere, Devleti Osman kishte mbetur pothuajse pa forca ushtarake dhe Cari Nikolla I, që dëshironte të përfitonte nga kjo situatë për të shkatërruar osmanët, në mënyrë që të merrte në zotërim Ballkanin, Ngush-ticat dhe Anadollin, filloi përgatitjet për luftë. Ndërkohë, fuqitë evropiane vendosën që t'i jepnin fund sundimit osman në Greqi dhe ta shpallnin atë shtet. Flota franceze dhe ajo britanike u

102 Enver Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi*, V, Ankara 1994, botimi i gjashtë, fq. 151,.

103 Bernard Lewis, *The Emergence of Modern Turkey*, Oxford University Press, 1968, fq. 84-85.

dërguan në Mesdhe për të ushtruar presion ndaj Devletit Osman. Edhe cari rus, Nikolla I, dërgoi flotën e tij.¹⁰⁴

Guvernatori i Egjiptit Osman, **Muhammed Ali Pasha**, duke qenë se dëshironte të fitonte pavarësinë, kishte pozicionuar flotën e tij në brigjet e Moresë. Forcat kryengritëse greke u shtypën dhe kështjellat u rimorën nga duart e tyre, duke lënë vetëm disa grupe luftëtarësh në male. Në Dhulka'de 1242/5 qershor 1827, forcat muslimane morën Athinën, edhe pse grekët patën ndihmën e forcave evropiane.¹⁰⁵

Britanikëve nuk u pëlqente prania e Muhammed Ali Pashait në Mesdheun Lindor. Për ta ishte më e favorshme prania e një force të dobët osmane dhe e një Greqie të vogël në Mesdheun Lindor. Rusët dhe britanikët u takuan në Shën Petërburg, me pretekstin se do të diskutonin mënyrën për t'iu dhënë fund veprimeve të padrejta të Ibrahim Pashait në More, dhe nënshkruan, dhe një protokoll më 4 prill 1827, sipas të cilit Greqia duhet të ishte një shtet autonom që do t'i paguante tagër Devletit Osman, dhe se turqit duhet të largoheshin nga ky vend. Ky ishte hapi i parë drejt pavarësisë së Greqisë. Ky protokoll iu njoftua Austrisë, Prusisë dhe Francës. Austria e refuzoi, për arsye se nxiste nacionalizmin dhe duke qenë se Austria ishte perandori që kishte nën sundim disa grupe të popullsisë, nuk mund të ishte në favor të këtij protokollit. Nga ana tjetër, ishte i suksesshëm për Rusinë, ndërkohë që edhe Prusia e refuzoi.

Mirëpo, Franca njoftoi se ajo ishte në favor, duke pasur për qëllim prishjen dhe shkëputjen nga Lidhja e Shenjtë, që ishte themeluar në vitin 1815 kundër saj. Në këtë mënyrë, Britania, Rusia dhe Franca nënshkruan Traktatin e Londrës më 6 korrik 1827. Sipas këtij traktati, nëse osmanët do të pranonin Traktatin e Shën Petërburgut, do të kishte një armëpushim midis tyre dhe kryengritësve të Greqisë, dhe më pas, do të themelohej shteti

104 Akdes Nimet Kurat, *Rusya Tarihi*, fq. 324.

105 Danişmend, *vepër e cituar*, IV, fq. 112.

Grek. Në rastin e kundërt, këto tri fuqi do t'i ndihmonin kryengritësit e Greqisë dhe do të ushtronin presion ndaj osmanëve.

Devleti Osman nuk e pranoi Traktatin e Londrës, pasi e shikonte atë si një ndërhyrje në çështjet e brendshme të tij. Për pasojë, flotat e tre superfuqive bllokuan në Navarin flotën osmane dhe atë egjiptiane.¹⁰⁶ Këto tre fuqi i kërkuan Muhammed Ali Pashait të tërhiqej, por ai iu përgjigj se tërheqja e tij ishte në varësi të asgjësimit të flotës osmane, pasi vetëm në atë rast ai do të kishte një justifikim të tërhiqej, sepse forcat e tij do të gjendeshin në pozitë të vështirë, ngase do të ishte prerë rruga për kthimin e tyre.¹⁰⁷ Admiralët e flotës franceze, britanike dhe ruse i dhanë një ultimatum **Ibrahim Pashait**, duke i kërkuar tërheqjen e flotës Osmane dhe egjiptiane, si dhe tërheqjen e forcave muslimane nga Morea. Pas refuzimit të këtij ultimatum, forcat e bashkuara detare britanike-franceze-ruse hynë në Navarin, me pretekstin për të trembur Ibrahim Pashanë, por që në të vërtetë kishin për qëllim shkatërrimin e flotës muslimane. Ata i përmbytën anijet e flotës osmane dhe egjiptiane më 20 nëntor 1827.

Kjo ngjarje e ndryshoi krejtësisht situatën: forcat muslimane, që ishin në More, u gjendën në pozicionin e humbësve të betejës. Populli në Evropë e festoi ngjarjen në Navarin me gëzim të madh; aleanca që u organizua kundër prirjeve nacionaliste dhe projekti i Rusisë për një Lidhje të Shenjtë u shpërbë. Sipas Metternihut: “Me ngjarjet në Navarin filloi dhe një erë e re për historinë.” Populli musliman i Devletit Osman e shikonte këtë ngjarje si një luftë Kryqëzate.¹⁰⁸

Në vitin 1243/1828, forcat aleate shpallën pavarësinë e Greqisë.¹⁰⁹ Ashtu siç mund të pritej, Devleti Osman nuk pranoi

106 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 116-118.

107 *Netajixh*, IV, fq. 91.

108 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 118.

109 *Netajixh*, IV, fq. 299; M. Tevfik, fq. 299.

ta njihte këtë veprim, ndërsa rusët e morën këtë kundërshtim si një justifikim për t'u hedhur në sulm kundër tyre në vitin 1828. Duke qenë se këta të fundit nuk ishin të përgatitur për luftë, ushtria ruse avancoi shumë shpejt përmes Rumelisë. Nga ana tjetër, arriti të merrte në frontin lindor kështjellën e Ahëskas dhe të Karsit, ndërsa Edreneja, në pjesën evropiane, ra në duart e tyre në vitin 1245/1829. Në këtë mënyrë, Devleti Osman u detyrua të nënshkruante Traktatin e Edrenesë në vitin 1245/1829, sipas të cilit i dorëzoi Ruisisë, Ahëskën dhe Kirkasian dhe njohu pavarësinë e Greqisë,¹¹⁰ që në atë kohë përfshinte vetëm Gadishullin e Moresë.

Ndërkohë, **Muhammed Ali Pasha** i Egjiptit sulmoi Biladu'sh-Shamin (ajo që në ditët e sotme quhet Siri), duke kërcënuar autoritetin osman në këtë vend. Trupat osmane u dërguan në luftë kundër forcave egjiptiane, por ata pësuan disfatë në betejën e Akkasë dhe Konjas. Sulltan Mahmudi II dërgoi një ushtri tjetër nën drejtimin e Hafëz Pashait që u mund sërish nga ushtria e stërvitur mirë egjiptiane, në betejën e Nizipit, në vitin 1258/1839. Ndoshta ishte edhe një fat për Sulltan Mahmudin II, i cili ndërroi jetë në Stamboll, para se të merrte këto lajme të humbjeve nga fronti i luftës.¹¹¹

Pushtimi francez i Algjerisë 1246/1830

Xhezairi (Algeria) qeverisej në emër të Devletit Osman, nga disa ushtarë fisnikë muxhahidinë të quajtur *Dajë*.¹¹² Sapo mbërrinte në këtë vend, përfaqësuesi i sulltanit kujtohej se: "ai ndodhej në Divanin e Muxhahidinëve". Xhezajir Oxhagë

110 *Netajixh*, IV, fq. 80.

111 *Netajixh*, IV, fq. 93.

112 Në gjuhën Turke "*Dayi*" ka dy kuptime: dajë dhe guximtar, fisnik ose trim. Në Tunizi dhe Xhezair, prijësit *de facto*, të quajtur *Dajë*, u krijuan nga radhët e ushtarëve, dhe i drejtuan këto provinca në emër të Devletit Osman. Me kalimin e kohës, fuqia në Tunizi kaloi nga *Dajë* në *Bej*, por në Xhezair, *Dajët* e ruajtën autoritetin e tyre deri në vitin 1830 kur u pushtuan nga Franca.

(Jezayyir Ocağı) (Oxhaku i Algjerisë), siç quhej, kishte një flotë të fuqishme detare; aq të fuqishme, sa që anijet amerikane, kur hynin në rajonin e detit Mesdhe, në shekullin e 18-të, ishin të detyruara t'i paguanin tagër Oxhakut Algjerian. Edhe pse evropianët kishin drejtuar 17 sulme kundër Xhezairit, ata nuk kishin arritur ta kontrollonin atë. Për këtë arsye, vendosën të arrinin një armëpushim, periudhë gjatë të cilës u ofruan *Dajëve* dhurata, në mënyrë që të garantonin interesat e tyre tregtare në detin e Mesdheut.¹¹³

Por Franca industrialiste, që ishte kthyer në një superfuqi botërore, ishte e vendosur ta pushtonte këtë vend me rëndësi strategjike, që ta sfidonte autoritetin e Britanisë në rajonin e Mesdheut, të cilët kishin marrë Xhebelut Tarikun (shqiptimi i "shtrembëruar" i të cilit është: Gjibraltari) dhe Maltën. Për të arritur këtë synim, francezët gjetën si justifikim kërkesën e disa tregtarëve jomuslimanë në Xhezair për të marrë paratë e tyre nga francezët. Ndërsa ishin duke diskutuar për këtë çështje me Konsullin e Përgjithshëm francez, **Hysejin Dajë** (1765-1838, sundoi 1818-1830), i zemëruar, e goditi atë me një erashkë. Franca përfitoi nga ky incident dhe përdori armët e zjarrit të saj më të fuqishme për të pushtuar Xhezairin në vitin 1246/1830,¹¹⁴ edhe pse muslimanët atje organizuan një qëndresë të guximshme kundër pushtuesve.

Nën sundimin osman arsimimi në Xhezair pati një zhvillim të madh, veçanërisht në nivelin e shkollave fillore dhe të mesme.¹¹⁵ Kur prezantoi në janarin e vitit 1834 përfundimet e *Commission d'Afrique*, **Gjenerali Valze** theksoi se: "arabët (algjerianët) dinë të lexojnë dhe të shkruajnë. Në çdo fshat ka

113 *Netajixh*, IV, fq. 82.

114 Muhamad Farid Bej, *Tarihu'd Devleti'l 'Alijjet'i'l 'Uthmanijje*, Bejrut:1086, fq. 447.

115 Alf Andrew Heggoy, "Arab Education in Colonial Algeria", *Journal of African Studies*, VII, fq. 42, verë 1975, fq. 149, cituar në Dr. Fawzia Bariun, *Malik Bennabi, His Life and Theory of Civilization*, Kuala Lumpur: 1993, fq. 12.

nga dy shkolla.”¹¹⁶ Edhe pse Algjeria nuk ka pasur ndonjëherë shkolla fetare të përmendura, siç është *Zejtuna* në Tunizi, *Keravijjin* në Fez, apo *el-Ez’her* në Kajro, vendi pati shumë qendra edukimi, edhe pse të një rëndësie më të vogël. Për shembull, ishin 3.000 *kuttabe* (shkolla fillore) në pjesë të ndryshme të Algjerisë.¹¹⁷ Këto janë fakte që tregojnë se osmanët kujdeseshin për kulturën indigjene të algjerianëve dhe se ata nuk aplikonin pushtimin kulturor, që e çonte popullsinë lokale në një situatë të tillë që “të humbitnin vetveten”, ashtu siç silleshin fuqitë perëndimore kudo që kishin kolonizuar. Është e ditur se një banor lokal në Xhezair nën pushtimin francez, nëse nuk fliste gjuhën frënge dhe nëse nuk kishte ndonjë burim tjetër të ardhurash, ishte i detyruar të vdiste nga uria.

Traktati i Hynkar Iskelesi 1249/1833

Ibrahim Pasha, djali i Muhammed Ali Pashait, në vitin 1832, përparoi deri në Kytahja, në Anadoll, dhe për këtë arsye, Sulltan Mahmudi II i kërkoi ndihmë Carit të Rusisë, Nikolla I. Trupat e dërguara nga cari zbarkuan në brigjet e Bosforit, në pjesën e Anadollit. Nga shqetësimi se trupat ruse mund të pushtonin Stambollin, Britania dhe Franca ushtruan presion ndaj Muhammed Ali Pashait dhe e detyruan atë të binte në ujdi me Devletin Osman. Për pasojë, kryengritja e *Valiut* osman të Egjiptit u shmang nga fuqitë evropiane, të cilat parashikonin se vazhdimësia e një Devleti Osman, në gjendje të dobët, ishte më i favorshëm për ta, sesa një sundim egjiptian i fuqishëm dhe i modernizuar në Anadoll. Kjo nuk do të thoshte se çështja ishte

116 Nevill Barbour (red.), *A Survey of North West Afrika (the Maghrib)*, Oxford University Press, 1962, fq. 239, cituar në Dr. Fawzia Bariun, *vepër e cituar*, fq. 12.

117 Ahmed Tavfik el Medeni, *Hadhihi Hija el Xheza’ir*, Mektebet el Nahdeh, Kajro, fq. 139, cituar në Dr. Fawzia Bariun, *vepër e cituar*, fq. 12. Për dokumentet e francezëve mbi edukimin në Algjeri shiko Dr. Fawzia Bariun, *vepër e cituar*, fq. 13-22.

zgjidhur, për faktin se edhe flotat e fuqive të vendeve të huaja nuk ishin larguar nga Stambolli.

Para se të largoheshin nga Stambolli, rusët nënshkruan një traktat 8-vjeçar me Devletin Osman në Hynkar Iskelesi, në Bejkoz, që ishte dhe qendra e tyre zyrtare. Në këtë traktat kishte dhe një kusht që u mbajt i fshehtë, sipas të cilit Devleti Osman mori përsipër bllokimin e ngushticave për flotat e tjera në rast lufte. Pra, Rusia siguroi që asnjë flotë tjetër të mos hynte në Detin e Zi. Por me iniciativën e Britanisë, Austria, Franca dhe Prusia vepruan dhe u takuan me përfaqësuesit e Rusisë në Londër. Ata nënshkruan Marrëveshjen e Londrës në vitin 1840, që e vendosi Devletin Osman nën garancinë e pesë fuqive të lartpërmendura. Në këtë mënyrë, Rusia humbi avantazhet që kishte fituar nëpërmjet Traktatit të Hynkar Iskelesit.¹¹⁸

15.5 Sulltan Abdylmexhidi 1839-1861

Pas vdekjes së Sulltan Mahmudit II, në vitin 1839, vendin e tij e mori Abdylmexhidi, që ishte në moshën 18-vjeçare. **Mustafa Reshid Pasha** ishte në të njëjtën kohë Sadrazam, *Nazër* (Ministër) i Punëve të Jashtme dhe Ambasador në Londër. *Valiu* i Egjiptit Muhammed Ali Pasha kishte një pozitë të fuqishme, ndërkohë që Devleti Osman ishte në rrezik të ndahej në dy pjesë. Ishte shumë e nevojshme të fitohej mbështetje nga jashtë, për ta shmangur këtë problem.¹¹⁹ Por, riorganizimi i strukturës shtetërore të osmanëve kishte shumë elementë në favor të fuqive evropiane së bashku me ndryshimet e ndërmarra për të qenë në përputhje me kushtet botërore. “Më ardhjen në fron të sulltanit të ri, **Mustafa Reshid Pasha** erdhi në Stamboll dhe nëpërmjet takimeve të fshehta e bindi sulltanin për nevojën e domosdoshme për *Tanzimat*”.¹²⁰

118 Akdes Nimet Kurat, *vepër e cituar*, fq. 325-326.

119 Mahmud Xhelaleddin Pasha, *Mir'at-ı Hakikat*, Stamboll 1326, vëll., I, fq. 15.

120 Danişmend, *vepër e cituar*, IV, fq. 123.

Struktura e Devletit Osman, në atë kohë, ishte përkeqësuar në mënyrë domethënëse dhe të dukshme, dhe kishte nevojë për rregullime dhe ristrukturim të studiuar mirë. Por *Nizam-ë Xhedid*, apo *Tanzimati*, që ishin paraqitur rishtazi, nuk rezultuan të efektshme, veçse një katastrofë e vërtetë. Tanzimati ishte përpunuar vetëm nga Reshid Pasha dhe mund të ketë qenë madje një reformë e imponuar nga fuqitë e huaja. Sulltani ishte në moshë shumë të re dhe pa përvojë për të kuptuar dhe vlerësuar mangësitë serioze. **Në atë kohë – nga mesi i shekullit të 19-të – Devletit Osman i kishte ardhur praktikisht fundi, pasi ishte turpëruar dhe kishte pësuar disfata nga një mëkëmbës i mbretit, dhe një ushtri që duhet të kishin qenë nën kontrollin e tij të rreptë.** Nëse nuk do të ishte ndaluar nga “miqtë e tij evropianë”, me shumë mundësi, Ibrahim Pasha do të kishte hyrë në Stamboll dhe do ta kishte marrë Devletin. Kjo do të kishte sjellë rrëzimin e familjes sundimtare, por nuk do të kishte sjellë ndonjë ndryshim thelbësor për strukturën kryesore shoqëro-politike muslimane. Devleti Musliman mund të ishte ringritur edhe më i fuqishëm, nën drejtimin e një udhëheqësi të ri energjik dhe të angazhuar. Duket se fuqitë evropiane nuk e penguan Ibrahim Pashanë nga simpatia që kishin ndaj Devletit Osman, por vetëm për të parandaluar ardhjen e një administrate të aftë dhe dinamike që të merrte pushtetin në dorë, duke siguruar në këtë mënyrë interesat e tyre jetike në këtë hapësirë.

Sulltani i ri dhe pa përvojë autorizoi pa u menduar mirë Sadrazam **Mustafa Reshid Pashanë** të lexonte *Hatt-ë Hymajun* që shpallte *Tanzimatin* gjatë një ceremonie të madhe. Këto reforma administrative me tepër sipërfaqësore dhe naive, garantonin jetën dhe pronën e njerëzve në Devlet, pa dallim besimi fetar, apo sekti,¹²¹ dhe i dhanë thesarit të Devletit përgjegjësi të plotë mbi të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat. *Hatt-ë Hymajuni* u recitua nga Reshid Pasha në Sha’ban 1255/nëntor 1839 në Gylhane. Sulltani, vezirët dhe ulemaja u betuan në *Hërka-i*

121 M. Tevfik, *vepër e cituar*, fq. 304.

Se'adet Dairesi (Dhoma e caktuar për ruajtjen e pelerinës së Pejgamberit të Fundit dhe Relikteve të Shenjta) në Pallatin Topkapu që të pajtoheshin me rregullat e *Tanzimatit*. Faktikisht, Devleti Osman kishte nevojë për reformim. Sipas *Hatt-ë Hymajun* thuhej se Devleti Osman vepronte në përputhje me *ahkam-ë Xhelile-i Kur'anijje* dhe *kavanin-i Sher'ijje* nga fillimi deri në lulëzimin e tij, por këto rregulla të mira ishin neglizhuar për shkak të vështirësive dhe problemeve të vazhdueshme si dhe motivimeve të ndryshme gjatë 150 viteve të fundit. Në këtë reformë u përfshi edhe ndalimi i ryshfeteve, dhe rritja e pagave të zyrtarëve në një nivel të kënaqshëm.¹²² U pranua **barazia** midis muslimanëve dhe jomuslimanëve, jo si një lëshim ndaj fuqive evropiane, por me vetë imponimin e tyre. "Të gjitha rangjet dhe postet në strukturën shtetërore u bënë të disponueshme për jomuslimanët. Më parë, jomuslimanët nuk pranoheshin si dëshmitarë për muslimanët, por tashmë ata u kthyen në gjykatës të gjykatave që jepnin vendime për muslimanët."¹²³ Ndërkohë që, në të gjitha entitetet e mëdha politike ka një "kombësi dominuese": Në perandorinë austriake raca gjermane, në perandorinë moskovite raca ruse, në Britaninë e Madhe raca angleze, madje edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës elementi anglo-sakson është në pozicionin dominues dhe ekzistenca e këtyre shteteve është në varësi të këtyre dominancave kombëtare.¹²⁴ Përveç të tjerash, në Devletin Osman nuk ekzistonte një praktikë e tillë e "kombësisë dominuese". Nuk kishte një **komb dominues, por kishte një ummet dominuese** gjatë një periudhe 540-vjeçare, midis 1299/699, që teorikisht është pranuar si data e pavarësisë së Osman Gaziut, dhe 1839/1255."¹²⁵

122 Danişmend, *vepër e cituar*, IV, fq. 124-126.

123 Abdurrahman Şeref, *Tarih Soyleşleri (Musahabe-i Tarihiye)*, botuar nga Mübeccel Nami Duru, Stamboll, 1980, fq. 56.

124 Danişmend, IV, fq. 126-127.

125 Danişmend, IV, fq. 127. Theksimi është shtuar.

“Dikur në Gallata ndodhej një rajon policie. Disa të krishterë sollën në këtë rajon disa muslimanë me ankesën se këta të fundit i kishin quajtur ata “gavur” (gjaur) (versioni në gjuhën turke për *kafir*). Dhe komandanti i rajonit i qortonte të akuzuarit: “sa herë ju kemi thënë se është e ndaluar të quani më një *gavur* me nofkën “gavur”.¹²⁶

Jo vetëm muslimanët, por edhe disa të krishterë nuk ishin të kënaqur me disa nga rregullat e *Tanzimatit*. Patriarku ortodoks (rum) grek, që kishte marrë pjesë në ceremoninë e shpalljes së *Tanzimatit*, në Kopshtin Gylhane, tha: “Shpresoj të mos dalë sërish nga kjo kuletë”, pasi *Hatt-ë Hymajun* u vendos në një kuletë mëndafshi. Për arsye se ata ishin më të privilegjuar nga *raja* tjetër e krishterë, ata kishin qenë deri në një farë mase pjesëmarrës të administratës; ata kishin punuar si përkthyes në *Divan-ë Hymajun*, përkthyes të komisioneve ambasadoriale, bejlerët e Vllahisë dhe Moldavisë emëroheshin nga grekët e Fanarit, në Stamboll. Patriarku rum (grek) mbante përgjegjësi për të gjithë të krishterët, që jetonin brenda kufijve të Devletit Osman.¹²⁷

Raja Ortodokse iu drejtua Ruisë, Francës Katolike dhe protestantëve në Britani, dhe iu kërkoi atyre të siguronin që të drejtat e tyre të garantoheshin dhe të viheshin në jetë. Dhe shtetet evropiane i përdorën këto kërkesa për qëllimet e tyre politike.

Përpyekjet e mëparshme për përtëritje në fushën e arsimit dhe trajnimit ushtarak nuk prekën **thelbin** apo **strukturën** e Devletit. Por, *Tanzimati* ishte një goditje e rëndë për strukturën e tij dhe arriti të thyente linjën e drejtimit për historinë e Devletit Osman. Kjo ishte padyshim pika e parë e thyerjes që u thellua edhe më tepër në vitin 1856 me *Islahat Fermanë* (Dekretin Reformues), dhe vazhdoi deri në fund. Në të vërtetë, nga fundi i shekullit të 18-të, Devleti Osman e kishte humbur dinamikën

126 Karal, V, fq. 186.

127 Karal, V, fq. 187.

dhe shtysën e tij jetëdhënëse deri në nivelin e administratës dhe burokracisë. Për këtë arsye, mund të themi se çdo iniciativë e ndërmarrë që nga fillimi i shekullit të 19-të mund të shihet si “përpjekje për mbijetesë me çdo kusht”.

Mustafa Reshid Pasha caktoi dy nga ulematë më të respektuar, për të shpjeguar *Hatt-ë Hymajunin* e Gylhanes, në Rumeli dhe Anadoll. Këta të dy e zbatuan detyrën e tyre duke shkuar nga një qetet në tjetrin. Pika më e vështirë në *Tanzimat* ishte barazia e popullsisë, që nuk bënte dallime të përkatësive të ndryshme fetare.¹²⁸ Dhe, kjo ishte mjaft e natyrshme dhe e logjikshme, pasi muslimanët kishin luftuar brez pas brezi për të mbajtur Devletin, dhe kishin qenë “bërthama” dhe “elementi kryesor” për *Devlet-i Alije-i Islamijje*,¹²⁹ dhe tani popullsia *dhimmi* (jomuslimane) promovohet në nivelin e popullsisë muslimane. Shoqëria muslimane, që kishte jetuar në përputhje me parimin: “Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më mirë për ta.”¹³⁰

Një riorganizim i strukturës ishte mjaft i nevojshëm, por kjo duhet të ishte arritur nga vetë osmanët, duke mbajtur larg çdo lloj ndërhyrje nga jashtë. Por, për këtë veprim, do të ishte e nevojshme fuqia ushtarake dhe politike, që Devleti Osman nuk i kishte në atë kohë. Për këtë arsye, pati ndërhyrje madje edhe imponim nga fuqitë “e jashtme”. Faktikisht, qëllimi ishte të “zgjdheshin problemet me Egjiptin duke e lidhur atë me zbatimin e *Tanzimatit*, për të korrigjuar në këtë mënyrë opinionin publik evropian që kishte prirjen të fshihte ekzistencën e Devlet-i Alije.”¹³¹

128 Karal, V, fq. 171.

129 Mahmud Xhelaleddin Pasha, *Mir'at-i Hakikat*, Stamboll 1326, vëll., I, fq. 7.

130 *Ali Imran*: 110.

131 Mahmud Xhelaleddin Pasha, *Mir'at*, I, fq. 7.

“Kjo ndjesi e përgjithshme në Evropë, ishte se institucionet dhe struktura e lashtë e perandorisë,¹³² ishte barbare dhe pandreqmërisht e keqe, dhe se vetëm vendosja e një qeverie dhe e një **mënyre jetese** evropiane, sa më shpejt që të ishte e mundur, do ta pranonte Turqinë në nivelin dhe privilegjin e një shteti të civilizuar. **Ky qëndrim iu bë i ditur në mënyrë energjike tërë shtetarëve turq nga qeveritë dhe ambasadat e fuqive evropiane**, dhe për pasojë, u pranua, pa fjalë, nga pjesa gjithnjë e më e madhe e shtresës drejtuese turke, që ishte mjaft e ndërgjegjshme për fuqinë, pasurinë dhe zhvillimin e Evropës në krahasim me prapambetjen, varfërinë dhe dobësinë e tyre.”¹³³

Por, nga ana tjetër, një qytetar i Devletit Osman ishte për t’u pasur zili. “Ndoshta, komentet më mbresëlënëse janë ato të **Adolf Slejdit (Adolphus Slade)**, një oficer i flotës detare britanike, që e vizitoi Turqinë shumë herë pas vitit 1829 dhe që fitoi njohuri të detajuara për gjuhën, vendin dhe popullin. Kritikata e tij bazoheshin kryesisht në faktin që **reformatorët shkatërruan një rend të vjetër, që në vetvete nuk ishte i keq, dhe që, përkundrazi, kishte shumë elementë për t’u pasur zili**. Deri në atë kohë, osmanlliu kishte gëzuar sipas zakonisht disa nga privilegjet më të dashura nga njerëzit e lirë, për të cilat kombet e krishtera kishin luftuar një kohë të gjatë që t’i arrinin. Ai nuk i paguante asgjë qeverisë përveç një takse të moderuar për tokën, edhe pse ishte një taksë e detyrueshme, mund të klasifikohesh në nivelin e taksave të vlerësuar. Ai nuk paguante të dhjetën e taksave, duke qenë se vakëfet siguronin të ardhura të mjaftueshme për ministrat e islamizmit. Ai mund të udhëtonte sipas dëshirës pa nevojën e një pasaporte dhe asnjë oficer dogane nuk shikonte dhe nuk fuste duart e tij të pista në valixhet e tij; asnjë polic nuk mbante nën mbikëqyrje lëvizjet e tij apo nuk dëgjonte fjalët e tij. Shtëpia ishte e shenjtë. Djemtë e tij nuk kryenin shërbim ushtarak, përjashto këtu faktin kur thirreshin për luftë. Ambiciet e tij

132 Bernard Lewis vazhdon ta quajë “Perandori” **Devletin** Osman.

133 Bernard Lewis, *The Emergence of Modern Turkey*, botimi i dytë 1968, fq. 124, Thexsimit është shtuar.

nuk kufizoheshin nga lindjet e fëmijëve dhe pasuria. Nga niveli më i ulët, ai mund të aspironte për titullin pasha dhe nëse mund të lexonte, mund të aspironte për rangun e vezirit të madh. Ky ndërgjegjësimit që ishte prezantuar dhe mbështetur nga precedentë të panumërt, ia fisnikëronte mendjen dhe i jepte atij mundësinë të hynte pa paragjykime në shërbim si zyrtar i lartë. A nuk janë këto përparësitë që aq shumë çmohen nga kombet e lira? A nuk solli Revolucioni Francez përjashtimin e popullsisë nga postet e nderuara?"¹³⁴

Traktati i Londrës 1257/1841

Avancimi i suksesshëm i **Ibrahim Pashait**, djalit të Muhammed Ali Pashait, kundër Devletit Osman, u ndalua nga aleatët e tij evropianë: Britania, Austria dhe Prusia. Megjithëse, ata i dhanë guvernaturën e Egjiptit Muhammed Ali Pashait dhe pasardhësve të tij dhe kështjellën e Akkës, ky mëkëmbës ambicioz i kundërshtoi kushtet e tyre dhe rifilloi luftën e tij me Devletin Osman. Britania, Austria dhe Prusia pas një takimi ndërmjet tyre vendosën disa kushte për ngushticat, dhe Rusia ndjeu se duhet të bashkohej me ta. Për pasojë, Britania, Austria, Prusia dhe Rusia nënshkruan një traktat në Londër më 15 Korrik 1840.

Forcat egjiptiane pësuan disfatë dhe Muhammed Ali Pasha u detyrua të nënshkruante Traktatin e Londrës në 1841, sipas të cilit ai mori vetëm drejtimin trashëgimtar të Egjiptit, që ishte pjesë e Devletit Osman. Kalimi në Ngushticat e Bosforit dhe të Dardaneleve u mbyll për të gjitha luftanijet, duke e privuar në këtë mënyrë Rusinë nga privilegji i mëparshëm i lundrimit të lirë në këto zona.

134 A. Slade, *Record of Travels in Turkey, Greece etc... in the years 1829, 1830 and 1831*, botimi i dytë, 1854, fq. 145, cituar nga Lewis në *Emergence of Modern Turkey*, fq. 125.

Enxhyumen-i Danish

Falë përpjekjeve të një personi të diplomuar në medrese, **Ahmed Xhevdet Pashait** dhe të atyre që e njihnin rëndësinë e shkencës dhe arsimimit, u themelua, në vitin 1266/1850, *Enxhymen-i Danish* (Akademia). Detyra e saj ishte zhvillimi i gjuhës turke, ndjekja e prirjeve dhe rrymave intelektuale, përkthimi i librave shkencorë dhe botimi i librave të rinj. Në të përfshiheshin 40 anëtarë kryesorë dhe 40 korrespondentë, të cilët takoheshin një herë në muaj.¹³⁵

Ngushticat

Devleti Osman kishte mbajtur nën kontroll për shekuj me radhë dy ngushticat më të rëndësishme: Ngushticën e Dardaneleve dhe Ngushticën e Bosforit. Gjatë shekullit të 19-të, duke qenë se fuqitë e krishtera kishin bërë një revolucion industrial dhe ishin më të fuqishme, filluan të tregonin interes për këto ngushtica që kontrolloheshin prej Devletit Osman, që dukej i paaftë për t'i mbrojtur ato.

Rusia kishte ndjekur një politikë pushtimi, ku territori osman përbënte pjesën më të madhe. Qëllimi i saj ishte të merrte kontrollin e Detit të Zi dhe të arrinte deri në Detin Mesdhe nëpërmjet ngushticave, dhe të ndryshonte një herë e përgjithmonë pozicionin e saj, si një perandori e mbyllur kontinentale. Traktati i Kajnarxhas (1774) hapi rrugën për avancimin e Rusisë në këtë drejtim: Rusia pushtoi Krimenë në vitin 1783 dhe u kthye në një vend zotërues në Detin e Zi. Sulmi i Napoleon Bonapartit ndaj Egjiptit, i dha një mundësi tjetër Rusisë; Devleti Osman dhe Rusia nënshkruan një traktat kundër Francës në vitin 1799, sipas të cilit Rusia fitoi të drejtën të lundronte në këto ngushtica si një vend "mik" për 8 vjet. Tashmë, administrata e Rusisë kishte filluar të mendonte se ishte më e favorshme për ta, të merrnin nën mbrojtjen e tyre

135 Karal, VI, fq. 176-177.

Sulltanin osman, në vend që ta ndanin dhe të merrnin vetëm një pjesë në mesin e fuqive të tjera evropiane, apo të themelonin një qeveri greke në vendin e tij. Traktati u rinovua në vitin 1805, dhe në këtë rast u vendos që Deti i Zi të mbyllej për fuqitë e tjera; Rusia dhe Devleti Osman siguruan të drejtën ekskluzive të kishin anijet e tyre në Detin e Zi. Por ky traktat u anulua për shkak të luftës midis Ruisë dhe Devletit Osman, që filloi në vitin 1807, edhe pse në vitin 1829 rusët fituan sërish të drejtën e kalimit të anijeve të tyre tregtare nëpërmjet ngushticave me Traktatin e Edrenesë. Në vitin 1833, nëpërmjet Traktatit të Hynkar Iskelesi, Rusia arriti ndalimin e kalimit të anijeve të fuqive të tjera evropiane, por me Traktatin e Londrës të vitit 1841, rusët e humbën këtë pozitë të leverdishme.

Në gjysmën e dytë të shekullit të 18-të, Franca humbi kolonitë e saj në Kontinentin Amerikan që u kthyen në koloni të Britanisë dhe ndoqi politikën e kthimit të Mesdheut në një liqen francez, si dëshmëpërblim ndaj humbjeve së saj. Austria dhe Franca ndanë mes tyre tokat e Republikës së Venedikut pas Traktatit të **Kampoformios** (1797), dhe në vitin 1798, Napoleon Bonaparti pushtoi Egjiptin. Këta ishin hapa që u ndërморën për të realizuar ambigjen e Francës për Mesdheun. Por, kjo politikë ishte kundër ambicieve të Carit Aleksandër të Ruisë për ta kthyer Detin e Zi në një liqen rus, dhe për të marrë në kontroll ngushticat, e për të zotëruar Mesdheun Lindor. Atëherë, çdo përpjekje e Ruisë për të marrë dy ngushticat ndesh me kundërvënien e Francës, dhe çdo përpjekje e Francës për zgjerim drejt Mesdheut Lindor kundërshtoj nga Rusia.

Edhe Britania filloi të interesohej mjaft në çështjet e Mesdheut Lindor; kolonia e saj, India, kishte nevojë të mbrohej nga fuqitë e tjera. Për këtë arsye, Britania ndihmoi Devletin Osman në zbrapsjen e trupave franceze nga Egjipti. Rruga më e shkurtër midis Evropës dhe Indisë ishte nëpërmjet Detit Mesdhe; dhe Britania bëri të pamundurën për të marrë kontrollin e Mesdheut Lindor, duke dalë kundër Ruisë dhe Francës që dëshironin të zgjeroheshin drejt këtij rajoni, dhe gjatë shekullit

të 19-të, doli në mbështetje të integritetit të territoreve osmane, që ofronin dhe një rrugë tjetër drejt Indisë, nëpërmjet luginave të Tigrit dhe Eufratit, drejt Gjirit të Basras.¹³⁶

Lufta e Krimesë 1853-1856

Cari rus **Nikolla I** mendoi se Britania dhe Franca nuk do të hynin në luftën kundër Ruisë, në rast se kjo e fundit do të pushtonte disa pjesë të territorit osman. Ai mendonte se mund të binte në ujdi me Britaninë, që t'i ndanin mes tyre territoret e Devletit Osman. Ai i tha ambasadorit britanik, **Hamilton Sejmur (Saymour)**, më 9 Janar 1853 në Shën Petërburg, që ishte në atë kohë kryeqyteti i Ruisë, se "Osmanlliu ishte një njeri i sëmurë dhe se së shpejti do të vdiste, dhe se ishte e nevojshme që Rusia dhe Britania të bënin një marrëveshje për ndarjen e territoreve." Më pas, ai shtoi se nuk do të lejonte kurrë që Britania të vendosej në Stamboll dhe se Rusia do ta pushtonte Stambollin përkohësisht. Duke bërë të ditur qëllimin e tij, Cari Nikolla I gaboi në llogaritjet që kishte bërë. Britania dhe Franca kishin krijuar një bllok së bashku me Devletin Osman.¹³⁷

Shkaku i jashtëm i luftës ishte problemi i Vendeve të Shenjta në Jeruzalem. Vendet e Shenjta në Jeruzalem, ishin një burim i vazhdueshëm mosmarrëveshjesh mes katolikëve dhe ortodoksëve. Mbajtja e çelësave të këtyre vendeve dhe shërbi-meve në lidhje me këto vende, iu ishin dhënë katolikëve që nga periudha e Sylejmanit të Madhërisëm. Por, disa mosmarrëveshje të mëvonshme midis Devletit Osman dhe Francës, u shfrytëzuan nga Patriarku Ortodoks, dhe Kisha Ortodokse arriti t'i merrte këto privilegje në vitin 1634. Që nga ajo kohë, çështja e shërbimit në këto vende ishte kthyer në një temë mosmarrëveshjeje midis dy kishave.

136 Karal, *Osmanlı Tarihi*, V, fq. 205-208.

137 Akdes Nimet Kurat, *Rusya Tarihi, Başlangıçtan 1917'ye Kadar*, Atatürk Kültür, Dil ve Tarih Yüksek Kurumu, Türk Tarih Kurumu, botimi i dytë, Ankara: 1987, fq. 327.

Në vitin 1853, Rusia dërgoi **Princ Meçnikovin** në Stamboll. Ai u soll në mënyrë provokative; se ai u takua me Sadrazamin Osman, jo me uniformën e tij zyrtare, por me një veshje të përditshme. Ai nuk e vizitoi Nazirin e Punëve të Jashtme, Keçexhizade Fuad, i cili e priti atë për vizitë në zyrën e tij dhe dha dorëheqjen nga detyra e tij, pas kësaj sjelljeje të papranueshme. Pas shumë diskutimesh, një kompromis i pranueshëm për të gjitha palët do të ishte arritur, nëse princi nuk do të kishte këmbëngulur, që Cari i Ruisë të merrte në patronazh *rajën* Ortodokse prej 12 milionësh të Devletit Osman.¹³⁸ Mustafa Reshid Pasha krijoi një komitet të përbërë nga 46 anëtarë për të diskutuar këtë pretendim të Ruisë, por i njëjti u kundërshtua nga një shumicë prej 43 anëtarësh ndaj 3 anëtarëve, dhe Princi Meçnikov u kthye në Rusi.¹³⁹

Trupat ruse sulmuan Moldavinë dhe Vllahinë më Ramazan 1269/qershor 1853. Një kongres ndërkombëtar u mbledh në Vjenë, por nuk arriti ta zgjidhte krizën dhe flota ruse shkatërroi dhe dogji flotën osmane, që lundronte drejt Batumit dhe po transportonte ushqime dhe municione drejt bregdetit të Sinopit në Anadoll.¹⁴⁰ Ndërkohë, **Omer (Ömer) Pasha** mundi trupat ruse në Olltaniçe, ndërsa Britania dhe Franca hynë në luftë në vitin 1854 në anën e Devletit Osman. Forcat aleate mundën forcat ruse në Alma dhe hynë në Akjar (Sevastopol) në shtator të vitit 1855, ndërsa **Omer Pasha** iu shkaktoi një disfatë tjetër trupave ruse në (Gözleve) Evapatoria.¹⁴¹ Rezultati përfundimtar i gjithë këtyre ngjarjeve ishte nënshkrimi i Traktatit të Parisit, në vitin 1856, sipas të cilit Krimea iu la Ruisë, por e detyroi atë t'i dorëzonte Karsin, Devletit Osman. Deti i Zi u mbyll si për flotën ruse ashtu edhe për flotën osmane, ndërsa Vllahia dhe Moldavia fituan autonomi për çështjet e tyre të brendshme dhe u përsërit pavarësia e Serbisë.

138 Danişmend, IV, fq. 142.

139 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 230.

140 Karal, V, fq. 235.

141 Karal, V, fq. 240.

Krimea ishte mjaft e rëndësishme për Devletin Osman; humbja e saj nuk ishte e njëjtë me humbjet e provincave të tjera për ta. Territoret që osmanët kishin humbur më parë, kishin më pak popullsi muslimane sesa jomuslimane. Por, popullsia prej 2 milionë banorësh e Krimesë ishte muslimane dhe për pasojë, shpëtimi i Krimesë ishte një përparësi për Devletin Osman.¹⁴² Nga ana tjetër, sikur aleatët t'i kishin vendosur forcat e tyre kryesore në Kaukaz (në vend të Krimesë), ku **Shejh Shamili** udhëhiqte një kryengritje të fortë kundër Ruisë, Kaukazi mund të kishte shpëtuar nga pushtimi rus. Arsyeja kryesore e vendosjes së trupave kryesisht në Krime, ishte parandalimi i qëllimit të Ruisë, që ishte marrja e Stambollit. Faktikisht, për sa i përket Britanisë, problemi i saj ishte të përdorte Devletin Osman, që ishte quajtur nga **Nikolla I** "i sëmurë", si një pengesë ndaj zgjerimit rus. Problemi kryesor i Britanisë nuk ishte të shpëtonte Krimenë apo Kaukazin nga pushtimi rus, por ta detyronte atë të ndalonte. Në njërin nga fjalimet e tij, **Lordi Xh. Rasell (Lord J. Russel)** thotë: "Nëse nuk e ndalojmë Rusinë në Danub, do të na duhet ta ndalojmë më vonë, në brigjet e lumit Ind."¹⁴³

Pas Revolucionit të vitit 1848, në Francë u krijua **klasa punëtore** që u përpoq të përfitonte disa të drejta politike dhe **Lui Filipi (Luis Philippe)** u rrëzua nga froni dhe u shpall Republika. Qeveria e përkohshme republikane deklaroi se ishte në mbështetje të lëvizjeve kombëtare dhe disa organizata në vende të ndryshme evropiane, u rebeluan kundër sovranëve të tyre, në mënyrë që të fitonin të drejta politike dhe shoqërore. Për një kohë të shkurtër, kryengritjet dhe rebelimet e popullsisë u përhapën në Spanjë, Itali, Irlandë, Belgjikë, Holandë, Austri dhe Hungari. Hungarezët u rebeluan në vitin 1848 kundër Austrisë dhe fillimisht patën sukses, por përfundimisht ata u shtypën me mbështetjen e Ruisë, që dërgoi në Austri 200.000

142 *Netajixh*, IV, fq. 97. Theksimi është shtuar.

143 Karal, V, fq. 221.

ushtarë. Shumë nga hungarezët u strehuan në Devletin Osman. Qeveria austriake i kërkoi Devletit Osman t'i kthente mbrapsht ata, por osmanët nuk pranuan. Në këtë mënyrë u krijua problemi i refugjatëve hungarezë. Edhe polakët, që bashkëpunuan me hungarezët, gjetën strehim në Devletin Osman. Rusia kërkoi gjithashtu, kthimin e “vagabondëve” që ishin pjesë e popullsisë së saj, por osmanët refuzuan sërish. Ata nuk i quanin refugjatët “vagabondë” në kundërshtim nga Rusia dhe Austria. Devleti Osman publikoi në Evropë një raport, sipas të cilit deklaronte se mbronte refugjatët nga mëshira dhe nga ndjenjat njerëzore ndaj tyre. Nëse do të ishte e nevojshme, osmanët do të hiqnin dorë nga lufta për hir të refugjatëve; ishte e pandershme që një Devlet të nënshtrohte njerëzit që kishte strehuar. Publikimi i këtij raporti nga Devleti Osman, pati një ndikim të madh për opinionin publik në mbarë Evropën. Shumë demonstrata në përkrahje të Devletit Osman u organizuan në Britani dhe Francë dhe situata arriti në një fazë, sa kur të rinjtë e Britanisë u takuan në rrugë me ambasadorin osman, **Mosurus Pashanë**, ata ia zgjidhën kuajt nga karroca dhe e tërhoqën vetë karrocën e tij, deri te ndërtesa e Ambasadës Osmane.¹⁴⁴ Pra, mund të mendojmë se ky opinion publik në Britani dhe Francë pati gjithashtu ndikimet e tij për kalimin e këtyre shteteve në mbështetjen e osmanëve në Luftën e Krimesë.

Fermani i Islahatit 1272/1856

Ky *ferman* (dekret) u përgatit nga fundi i Luftës së Krimesë dhe u shpall 6 muaj para nënshkrimit të **Traktatit të Parisit**.¹⁴⁵ Pika më e rëndësishme e këtij dekreti ishte përmirësimi i statusit të popullsisë jomuslimane në Devletin Osman, duke iu dhënë atyre barazi në pagesën e taksave dhe në çdo aspekt tjetër të jetës. Tani, jomuslimanët nuk duhej të paguanin *xhizjen*. Të gjithë njerëzit që jetonin në Devletin Osman, pa dallim të

144 Karal, V, fq. 213-217. Theksimi është shtuar.

145 Karal, V, fq. 248.

besimit të tyre fetar apo sektar, kishin të drejtën të bëheshin nëpunës zyrtarë. Jomuslimanët mund të zgjidheshin gjithashtu edhe anëtarë të bordeve të *Vilajeteve* dhe *Sanxhaqeve*.¹⁴⁶

Popullsisë jomuslimane iu dha e drejta e regjistrimit në radhët e ushtrisë dhe në shkollat publike.¹⁴⁷ Kjo do të thoshte që një jomusliman, duke hyrë në shkollat ushtarake, mund të arrinte postin e një gjenerali të ushtrisë osmane; dhe, nëse do të ishte i talentuar, mund të drejtonte edhe ushtritë osmane. Një jomusliman mund të hynte në *Mylkije* (qeveri) dhe mund të bëhej *vali* (gubernator), inspektor, Ministër i Brendshëm dhe Kryeministër. Të gjitha këto mund të ndodhnin në një shtet që quhej *Devlet-i 'Alijje-i Osmanijje*,¹⁴⁸ ose *Devlet-i 'Alijje-i Islamijje*.¹⁴⁹

Nga ana tjetër, ishin disa pika në këtë ferman që nuk u pëlqyen nga jomuslimanët: shërbimi ushtarak nuk ishte i favorshëm për ta pasi më parë, ata ishin të përjashtuar nga shërbimi ushtarak dhe kishin qenë të detyruar që në vend të tij të paguanin xhizjen. Muslimanët, veçanërisht turqit, kishin luftuar për Devletin që në fillim, në një kohë kur jomuslimanët punonin dhe bënin tregti. Ndërsa, priftërinjtë e humbën pozitën e tyre të favorshme, që u kishte dhënë Sulltan Fatih Mehemedi. Ata mblidhnin të ardhura sipas dëshirës së tyre nga komuniteti, ndërkohë që, tashmë ata do të merrnin pagë nga Devleti dhe do të betoheshin për besnikëri ndaj tij. Për këtë arsye, kur fermani u lexua dhe u vendos në kuletën e mëndafshtë, peshkopi i Izmitit tha: “Le t’i lutemi Zotit që ky *ferman* të mos dalë nga kuleta e tij sërish.”¹⁵⁰

146 Danişmend, *vepër e cituar*, IV, fq. 175. Theksimi është shtuar.

147 Danişmend, IV, fq. 76.

148 Mustafa Na’ima, *Ravzatul Husejn fi Hulasati Ahbaril Hafikejn*, Stamboll: 1280, I, fq. 6.

149 Mahmud Xhelaledin Pasha, *Mir’at-ë Hakikat*, Stamboll 1326,.I, fq. 7.

150 Danişmend, IV, fq. 167.

Situata financiare

Për shkak të shpenzimeve të mëdha në Luftën e Krimesë, **për herë të parë, osmanët u detyruan të merrnin hua nga shtetet e tjera.** Me nënshkrimin e marrëveshjes, më 12 Shevval 1271/28 qershor 1855, osmanët morën hua nga Britania dhe Franca 5 milion sterlina, me një përqindje vjetore prej 4%, plus 1% për amortizim. Këstet e huas do të paguheshin dy herë në vit, çdo muaj qershor dhe dhjetor.¹⁵¹

Sipas **Traktatit të Parisit** të vitit 1856, paprekshmëria e territorit osman u vendos nën garancinë e Britanisë, Francës, Prusisë, Rusisë, Austrisë dhe Sardenjës.¹⁵² Por Britania, Franca dhe Austria, duke mos pasur besim në qëndrimin e Rusisë, ndaj Devletit Osman, nënshkruan një traktat tjetër në Paris më 15 prill 1856/9 Sha'ban 1272, sipas të cilit paprekshmëria e territorit osman u garantua nga të tre palët një nga një, dhe më pas nga të trija bashkërisht; çdo sulm ndaj territoreve osmane do të konsiderohej si shkak për luftë, dhe këto tre shtete do të përdornin ushtritë dhe flotën e tyre në marrëveshje me Devletin Osman, kundër çdo shkelësi.¹⁵³

Kur ushtritë e fuqive armike u larguan pas nënshkrimit të Traktatit të Parisit, “shthurja përfshiu strukturën e Devletit dhe vazhdimësia e saj shkaktoi dëme më të rënda se lufta”.¹⁵⁴ Duket se elita osmane, me thellimin e lidhjeve dhe komunikimit me evropianët gjatë tre viteve të fundit, pa se ata që arritën një revolucion industrial, dhe që shfrytëzuan pasuritë në mbarë botën, ishin bërë shumë të pasur, dhe edhe ajo filloi të kishte dëshirën e zjarrtë të jetonte si ata, duke vuajtur nga ky “shok kulturor” ... Personi që praktikoi mënyrën e civilizimit evropian në territorin osman dhe që bëri zgjimin e opinionit publik, ishte **Mustafa Reshid Pasha.** Duke qenë se nga natyra ishte një

151 Danişmend, IV, fq. 167.

152 Karal, *vepër e cituar*, V, fq. 243.

153 Danişmend, IV, fq. 182.

154 Mahmud Xhaleleddin Pasha, *Mir'at-ë Hakikat*, I, fq. 20.

person bujar, ai i ndihmoi ata që ishin në nevojë dhe bëri të mundur që Thesari i Devletit të paguante huat e tij, veprim ky që u ndoq edhe nga të tjerë duke pasur ndikime të mëdha në përkeqësimin e nivelit të të ardhurave dhe shpenzimeve.” “Në fillimet e epokës së Abylmexhidit, ishte e zakonshme që të tregoheshin niveli ekonomik, por shpenzimet e një dasme apo të një feste syneti, si dhe shpenzimet që ishin vënë nga Harem-i Hymajun e ngarkonin Thesarin e Devletit, dhe shthurjet e ndryshme, dhe dhuratat për Ministrat, i shkaktuan strukturës së Devletit tronditje rrënjësore ... huat nuk harxhoheshin për të plotësuar nevojat e Devletit, por për kënaqësi”.¹⁵⁵

Nga ana tjetër, Sulltan Abdylmexhidi ishte i ndërgjegjshëm për faktin që Egjipti ishte bërë më i fuqishëm se Devleti, falë reformave të kryera atje nga Mehmed Ali Pasha. Për këtë arsye, sulltani e priti disa herë Mehmed Ali Pashanë, kur ky i fundit kishte shkuar në Stamboll në vitin 1848, dhe ishte konsultuar me të për çështjet e administratës. Mehmed Ali Pasha kishte dhënë mendimin e tij si më poshtë:

“Së pari, edhe pse Ministrat kanë shfaqur nevojën për të marrë para hua nga jashtë, borxhi rritet dhe nuk pakësohet. Pasurimi i Thesarit, përmirësimi i ekonomisë së vendit, vjen nga tregtia dhe pasuria e njerëzve. Marrja e shtuar e huave është mjaft e dëmshme. Së dyti, shumë vende në shtet janë lënë të zbrazëta dhe shumë lumenj të rrjedhshëm nuk shfrytëzohen. Nëse tokat që i përkasin Devletit, i jepen popullit, dhe nëse lumenjtë vihen në përdorim shkencërisht, bujqësia do të përmirësohet. Dhe, nëse nomadët, që enden pa asnjë qëllim, vendosen në këto toka, luftërat mes fiseve për shkak të të ardhurave bien, dhe të ardhurat e shtetit rriten. Kërkesa ime e tretë është se evropianët kanë përparuar shumë në fushën e shkencës, arsimit dhe industrisë. Nuk është e mundur që ato të arrihen menjëherë, por ju duhet ta drejtoni popullin të ndërtojë shkolla, duke filluar nga fshatrat dhe qytezat. Ministrat tuaj duhet të pyeten

155 Shiko poshtë-shënimin 154.

çdo vit se çfarë kanë arritur në lidhje me këto tre çështje dhe puna e tyre duhet të ndiqet në mënyrë që të arrihet zhvillimi i dëshiruar.”¹⁵⁶

Reagimet ndaj ndryshimeve në strukturë

Themelimi i Devletit Osman i bazoi themelet e tij në Islam, dhe ndër shekuj përfaqësonte Islamin, por me reformat e viteve 1839 dhe 1856, jomuslimanët u barazuan me muslimanët, pra me themeluesit dhe mbështetësit e kësaj strukture shoqëroro-politike. Me fjalë të tjera, vitet 1839 dhe 1856, tregojnë këputjet e mëdha që ndodhën në linjën historike të sjelljes dhe ekzistencës së Devletit Osman. Kjo shkaktoi shqetësim dhe pikëllim të madh në mbarë botën Sunnite muslimane. “Nenet e pranuar në Traktatin e Parisit, në favor të popullsisë së krishterë, që jetonte në territorin e Devletit Osman, shkaktuan një zemërim të përgjithshëm kundër jomuslimanëve. Për disa, shkak kryesor për shpërthimin e kryengritjeve në Indi në atë kohë, ishin nenet në Traktatin e Parisit. Dhe, elementët e krishterë që mbështeteshin te fuqitë evropiane dhe që ishin nxitur fshehurazi prej tyre, ishin të pafytyrë.

Në këtë situatë të tensionuar, gjatë kohës së Haxhit, njerëzit sulmuan të krishterët, dhe konsujt e Britanisë e të Francës, u vranë gjatë ndërhyrjes për të mbrojtur subjektet e tyre. Për pasojë, një flotë e bashkuar britaniko-franceze iu drejtua Xhiddes dhe bombardoi qytetin për të marrë hak. Për më tepër, me dëshirën e komandantëve britanikë dhe francezë, 10 dinjitarë të qytetit të Xhiddes u ekzekutuan në gushtin e vitit 1856, me akuzën e nxitjes së atyre sulmeve. **Duhet të përmendim në këtë rast se ndërsa u kryen këto vrasje, Britania dhe Franca ishin në marrëdhënie paqeje me Devletin Osman, madje ishin dhe aleate të tij.**¹⁵⁷

156 Karal, *vepër e cituar*, VI, fq. 100-101.

157 Danişmend, IV, fq. 186. Theksimi është shtuar.

Nga ana tjetër, për Libanin, ku të huajt me intrigat e tyre kishin një ndikim të madh në vend, ngjarjet që u zhvilluan në Xhidde shkaktuan rrëmujë. Britanikët u angazhuan të nxisnin fisin Druz, ndërsa francezët fisin Maruni. Këta të fundit sulmuan të parët, dhe kjo u shoqërua me shumë viktima edhe në radhët e popullsisë së krishterë.

Gjithashtu, trazira pati edhe në Damask, ku ndër viktimat ishte dhe konsulli amerikan dhe ai holandez. Ministri i Punëve të Jashtme, **Fuad Pasha**, themeloi një gjykatë ushtarake dhe dha dënimin me varje për rreth 100 persona, ndër të cilët kishte dhe zyrtarë, në mënyrë që të parandalonte ndërhyrjen e shteteve evropiane.¹⁵⁸

Gjykata e Kulelisë

Muslimanët nuk ishin të kënaqur me efektshmërinë e Sulltan Abdylmexhidit dhe qeverisë së tij. Të gjitha përpjekjet e tyre për të përmirësuar situatën, ishin të padobishme. Zyrtarët e lartë jetonin në luks dhe korrupsion, ndërsa qeveria merrte hua shuma të mëdha parash nga fuqitë evropiane dhe inflacioni arriti në nivele të pashembullt, veçanërisht pas Luftës së Krimisë. Në këto rrethana, **Shejh Ahmedi** i Medresesë Bajezid, **Ferik Hysejin Pasha**, dhe disa intelektualë themeluan një shoqatë të fshehtë, që planifikonte të rrëzonte qeverinë dhe të rivendoste Sheriatin.¹⁵⁹ Duhet të theksojmë se kjo përpjekje për të krijuar një shoqatë të fshehtë dhe për të ardhur në fuqi, për të **rivendosur Devletin në orbitën e tij origjinale të themelimit, ishte e para dhe e vetme**. Iniciativa e tyre mund të interpretohej si një “organizatë joqeveritare” e rrethanave. Ata ishin të vetëdijshëm për faktin që **Tanzimati** dhe **Islahati** ishin ngjarje që binin ndesh me parimet themelore të Devletit.

Kur i kërkuan **Hasan Pashait** të anëtarësohej në këtë shoqatë, ai nxori sekretin e tyre dhe për këtë arsye 41 anëtarët e

158 Danişmend, IV, fq. 191-192.

159 Danişmend, IV, fq. 189. Theksimi është shtuar.

shoqatës u arrestuan në vitin 1859. Ata u gjykuan në barakat e Kulelisë dhe themeluesit e saj u dënuan me vdekje, ndërsa të tjerët u dënuan me burgim; por sulltani i ndryshoi dënimet me vdekje të themeluesve, në dënime me burgim. Kushtet depressive të Devletit dhe ngjarjet në Kuleli ndikuan në përkeqësimin e shëndetit të Sulltan Abdylmexhidit,¹⁶⁰ që vdiq në vitin 1861,¹⁶¹ dhe vëllai i tij u betua për besnikëri *bej'at* (nga arabishtja).

Abdylmexhidi kishte një natyrë shumë të ndjeshme dhe dukej se ai nuk ishte i lumtur me ngjarjet, që po ndodhnin në Devlet. *Ser-kurena* (Shambellani, administratori i pallatit të sulltanit), **Haxhi Ali Pasha**, e kishte parë një ditë Abdylmexhidin në **Dhomën** e **Hërka-i Sherifit**, duke u lutur: “Ja Rabbi! Më shpëto nga ky njeri!”, duke iu referuar Mustafa Reshid Pashait.¹⁶²

15.6 Sulltan Abdylazizi 1861-1876

Abdylazizi zuri vendin e sulltanit dhe Halifit në moshën 30-vjeçare. Ai ishte i shëndetshëm dhe kishte fizik të formuar, si sportist i mirë dhe mundës që ishte. Ai e ktheu teatrin, që ishte ndërtuar nga vëllai i tij në oborrin e pallatit, në një stallë,¹⁶³ që me gjasë ishte një reagim i rreptë dhe pafavorshëm i tij ndaj invadimit të kulturës perëndimore. Gjatë mandatit të parë të Fuad Pashait si Sadrazam, Devleti Osman kishte marrë hua nga Evropa. Kartëmonedha e quajtur “*kaime*” kishte dalë jashtë qarkullimit dhe disa hua të parregullta ishin shlyer. Abdylazizi ndaloi shpenzimet e tepërta dhe të panevojshme, ndaloi përdorimin në pallat të enëve prej ari dhe argjendi, dhe bëri përpjekje

160 Enver Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi*, Ankara, Türk Tarih Kurumu, 1983, vëll., VI, fq. 96.

161 M. Tevfik, *vepër e cituar*, fq. 308.

162 Karal, *vepër e cituar*, VI, fq. 107. Theksimi është shtuar.

163 Enver Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi*, Botimi i tretë, Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1983, vëll., VII, fq. 2.

për të parandaluar ryshfetet dhe mitmarrjen. Disa zyrtarë u dënuan me akuzën se kishin marrë ryshfete.¹⁶⁴

Por ishte mjaft e natyrshme që opinioni publik musliman, të mos ishte në favor të reformës që ishte praktikuar pa u menduar gjatë, dhe ishte ndërmarrë pa plan. Ndërsa populli osman musliman, i jepte mjaft rëndësi vlerave dhe etikës islame.

Si një shprehje e zhgënjimit ndaj shtytjes së shpejtë dhe të paplanifikuar të perëndimit, shoqëria osmane kishte aderuar gjithnjë e më shumë në vlerat dhe etikën islame. Turqit osmanë dhe muslimanët në përgjithësi, kishin shfaqur keqardhjen e tyre për gjendjen e vështirë në të cilën ndodheshin vëllezërit e tyre muslimanë turq të Turkestanit. “Në vitet 1860-ta, ndërgjegjësimit i turqve otomanë për muslimanët e tjerë dhe popullsinë turke, ishte rritur nga kryengritjet e zhvilluara në Azinë kontinentale. Pantaisët, muslimanët kinezë në provincën Junan, u rebeluan dhe themeluan një shtet të vetin. Jakub Beu arriti të merrte me sukses Turkestanin nga kontrolli i kinezëve dhe e drejtoi atë si një shtet musliman me qendër në Kashgar.”¹⁶⁵ Sulltan Abdylazizi u njoh nga populli i Turkestanit si Halif¹⁶⁶ dhe Jakub Beu dërgoi në Stamboll si përfaqësuesin e tij Sejjid Mahmud Jakubin. Britania e lehtësoi rrugën e saj nëpërmjet Indisë për shkak të luftës së saj me Rusinë për çështjen e Turkestanit. Sejjid Jakubi “u kthye në Kashgar së bashku me një grup turqish otomanë, ndër të cilët ishin edhe 4 oficerë ushtarakë, që do të vepronin si instruktorë në ushtri, si dhe disa oficerë të artillerisë së lehtë. Sejjid Mahmud Jakubi gjithashtu, u kthye nga Stambolli me titullin *emir* për Jakub Beun, dhe me një premtim për mbrojtje, sado i pavërtetë, nga Abdylazizi si kryezot. Jakubi vazhdoi të prodhonte monedhën me emrin e sulltanit me mbishkrimin “Mbrojti Kashgarin”, dhe emri i Abdylazizit përmendej edhe në lutje. Në vitin 1875, i dërguari i Jakub

164 Po aty, fq. 3.

165 Roderic H. Davison, *Reform in the Ottoman Empire 1856-1876*, Nju Jork: 1973, fq. 272.

166 Shiko poshtë-shënimin 165.

Beut vizitoi sërish Stambollin, u prit mirë nga Abdylazizi dhe u kthye me një ngarkesë prej 2.000 pushkësh të tipit Shnajder (Snider) me mbushje me fishekë dhe 6 pajime fushore ushtarake.¹⁶⁷

Nga ana tjetër, Rusia nuk ishte aspak e kënaqur me Traktatin e Parisit dhe kushtet e saj, por duke qenë e vetëdijshme se, nëse do t'i shpallte luftë të drejtpërdrejtë Devletit Osman, fuqitë evropiane do t'i vinin në ndihmë atij, ashtu siç kishte ndodhur edhe në Luftën e Krimesë, Rusia kërkoi mundësinë e ndërhyrjes dhe nxitjes së komuniteteve të krishtera në territorin osman, duke nxitur ndjenjat kombëtare tek ata.¹⁶⁸ Në fshehtësi, Rusia nxiti bullgarët dhe popullin e Malit të Zi, për pasojë, një kryengritje e madhe shpërtheu në Mal të Zi, në vitin 1280/1863, që arriti të nënshtrohej nga **Serdar-ë Ekrem Omer Pasha**.¹⁶⁹

Ngjarjet në Vllahi dhe Moldavi 1861-1866

Sipas Traktatit të Parisit, në 1278/6 dhjetor 1861 u lëshua një *ferman*, sipas të cilit qeveria e Vllahisë dhe Moldavisë i besohet **Princit Kuza**, nën drejtimin osman, që shënoi themelimin e Rumanisë së ditëve të sotme. Por, parlamenti i bashkuar i saj nuk e miratoi një projektligj të paraqitur nga princi dhe ai për të marrë hak e shfuqizoi, dhe shpërndau parlamentin. Në vitin 1281/28 qershor 1864, u vendos që shteti osman të vazhdonte sundimin në Rumani, edhe pse kësaj të fundit iu dha leje që të drejtonte vetë çështjet e saj të brendshme. Parlamenti zgjodhi Leopoldin, që ishte Konti i Flandersit dhe vëllai i Mbretit të Belgjikës, si princ të Rumanisë,¹⁷⁰ por ai nuk pranoi. Në këtë mënyrë, **Franca** thuri intriga për të siguruar zgjedhjen e **Sharlit** në këtë post. Aktualisht, ai erdhi në Stamboll në vitin 1866 për t'i shfaqur respektin e tij të veçantë sulltanit, i cili

167 R. H. Davison, *vepër e cituar*, fq. 273-274.

168 Mahmud Xhelaledin Pasha, *Mir'at-ı Hakikat*, vëll., I, fq. 21.

169 E.Z. Karal, *vepër e cituar*, VII, fq. 3-7.

170 Karal, VII, fq. 10.

pranoi ta njihte sundimin e tij trashëgimtar në Rumani, me kusht që të ishte nën sovranitetin osman, dhe që ushtria rumune të mos kalonte numrin prej 30.000 ushtarësh.¹⁷¹

Ngjarjet në Serbi

Qeveria serbe rriti numrin e xhandarmerisë së saj në vitin 1278/janar 1862 dhe gjatë muajve shkurt dhe mars vrau disa turq. Kjo ngjarje u shoqërua nga një periudhë trazire dhe kaosi, gjatë të cilës kështjella e Beogradit iu dorëzua, në vitin 1284/1867, pa luftë serbëve¹⁷². Qeveria osmane nuk ishte e aftë të bënte asgjë kundër Serbisë, sepse ata e dinin se fuqitë evropiane nuk do t'i lejonin turqit ta thyenin fuqinë e serbëve.

Kryengritja në Kretë

Në Kretë 15 për qind e popullsisë ishte muslimane, ndërsa pjesa tjetër ishte e krishterë. Disa nga këta muslimanë kishin ardhur nga Anadulli dhe të tjerët ishin të konvertuar në besimin islam. *Fermani* i *Islahatit* iu ofroi të krishterëve shumë privilegje dhe në vitin 1866, ata blenë sipërfaqe të gjera toke në Kretë. Megjithatë, ata u hodhën në kryengritje, ose ishin të detyruar të vepronin në këtë mënyrë, nën udhëheqjen e **Mihailit**, i cili kërcënoi se do t'iu digjte shtëpitë atyre që nuk do të merrnin pjesë në këto kryengritje, që kishin mbështetjen e Ruisë dhe Greqisë. Ndërkohë, fuqitë evropiane propozuan organizimin e një hulumtimi dhe plebishiti në Kretë, por Devleti Osman e kundërshtoi këtë ofertë. Ambasadori francez, Bure (Bourree), u prit në Stamboll nga vetë sulltani, që iu përgjigj këmbënguljes së tij për hulumtim: "...Në ishullin e Kretës gjendet një popullsi prej 300.000 rumësh (grekësh); ndërkohë që është e logjikshme të merret një monedhë floriri nga secili prej tyre si taksë vjetore dhe të ardhurat do të jenë 300.000 monedha floriri. Por, taksa është më pak se gjysëm lire dhe nuk ka një shtet të vetëm që

171 Karal, VII, fq. 11-13.

172 Karal, VII, fq. 14-17.

merr një sasi kaq të vogël si taksë, dhe vazhdimisht është diskutuar, dhe propozuar që të dërgohet një komision në këtë vend për shqyrtim.”

Megjithatë, Devleti Osman e mbajti nën kontroll këtë kryengritje në Kretë, duke bllokuar brigjet e Greqisë në vitin 1968, që të parandalonte çdo ndihmë të mundshme për kryengritësit, dhe në të njëjtën kohë shpalli një amnisti të përgjithshme. Në vitin 1869, u mbajt në Paris një konferencë që miratoi veprimtaritë dhe politikat e Devletit Osman në këtë kontekst.¹⁷³ Faktikisht, gjatë kësaj kohe, Britania praktikonte në Indi një politikë të tillë taksash që ia merre pronën atyre që nuk kishin mundësi të paguanin.

Qeveritë e Britanisë, Austrisë, Francës dhe Rusisë, në vitin 1867, shqyrtuan shtrirjen e realizimit të reformave të premtuara nga Devleti Osman dhe gjetën shumë gabime. Ata u ankuan se gjykatat e përziera ishin të pakta në numër dhe se metodat e tyre të zgjidhjes së çështjeve nuk ishin të kënaqshme. **Ahmed Xhevdet Pasha** ishte emëruar si kreu i *Divan-ë Ahkam-ë Adlije* (Gjykata e Shkallës së Lartë), që ishte e përbërë nga anëtarë muslimanë dhe jomuslimanë.¹⁷⁴

Sadrazami **Ali Pasha**, e këshilloi në vitin 1867 Sulltan Abdylazizin që ligji francez të përkthehej dhe të pranohej si kodi civil osman! Por **Ahmed Xhevdet Pasha** (1822-1895), i diplomuar në një medrese, ishte njohës i mirë i ligjeve islame, dhe për më tepër, e njihte mirë edhe Evropën. Ai ishte njohës i mirë i matematikës, historisë dhe i kodit civil francez. Me propozimin e tij, u vendos që të përpilohej një libër mbi ligjin me titullin *Mexhel-le-i Ahkam-ë Adlije* për marrëdhëniet individuale të njerëzve, duke përdorur libra të **fikhut** (jurisprudencës islame), dhe duke marrë në konsideratë nevojat e kohës. Një shoqatë u themelua nën kryesimin e Ahmed Xhevdet Pashait, që brenda një 10 vjeçari përgatiti Kodin Civil

173 Karal, VII, fq. 18-36.

174 Karal, VII, fq. 166.

Osman. **Mexhel-le** përbëhej nga një parathënie dhe 16 libra. 15 prej librave u përfunduan në vitin 1874 dhe libri i fundit i 16-ti përfundoi në vitin 1878.¹⁷⁵

Otomanët e rinj (Jeni Osmanllëllar)

Disa intelektualë osmanë, të ndikuar nga idetë e lirisë, dhe të liberalizmit, që frynin nga Evropa, themeluan një shoqëri të fshehtë të quajtur *Jeni Osmanllëllar* (Osmanët e rinj). Shoqëria e Otomanëve të Rinj u organizua në vitin 1865, dhe anëtarët e saj propagandonin idetë e tyre në gazetën *Tesvir-i Efkar*, dhe në gazeta të tjera. Ata filluan të propagandonin idetë e tyre në vitin 1866. Shoqëria e tyre e fshehtë ishte organizuar mbi bazën e **Karbonarëve**; ndër pjesëtarët e saj ishin: **Zijai**, (Namëk) **Kemali**, **Ali Suaviu**, gazetari **Agah Efendi** dhe **Shinasiu**. **Zhan (Jean) Pietri** i Korsikës luajti një rol kryesor dhe të rëndësishëm për prezantimin e anëtarëve të kësaj shoqërie me njëri-tjetrin. **Zhani** iu prezantoi Osmanëve të rinj një person të quajtur **Sukkakini**, që në të vërtetë ishte me origjinë italiane. **Sukkakini**, kishte menaxhuar çështjet tregtare dhe çështjet e fshehta politike të **Mustafa Fazil Pashait** së Egjiptit.¹⁷⁶ Mustafa Fazil Pasha, djali i Ibrahim Pashait, që ishte djali i Muhammed Ali Pashait, iu kundërvu administratorëve të Tanzimatit, për shkak të faktit që Hedivi (titull që sulltani i kishte dhënë pashait trashëgimtar të Egjiptit) i Egjiptit, **Ismail Pasha**, ndryshoi sistemin e tij të trashëgimisë nga “trashëgimtari është djali më i madh i familjes”, në “trashëgimtari është djali i Hedivit”, me çka iu privua pushteti djalit të madh, dhe ky ndryshim u arrit me pranimin e administratorëve të Tanzimatit në Stamboll. Ai ishte mjaft i pasur dhe mbështeste nga ana financiare “Otomanët e Rinj”: **Zija Pashanë**, **Namëk Kemalin**, **Ali Suavin**, **Agah Efendi**, që ishin në favor të Kushtetutës.¹⁷⁷

175 ` Karal, VII, fq. 172-173.

176 Ziya Nur Aksun, *Osmanlı Tarihi*, Stamboll, 1994, vëll., VI, fq. 6.

177 Danişmend, IV, fq. 212-213.

Qeveria osmane nuk ishte në favor të prezencës së këtyre intelektualëve në Stamboll dhe Namëk Kemalin e emëruan si asistent të Valiut të Erzurumit, ndërsa Zijain si *mutesarraf* (gubernator) të Qipros; por Sukkakini, në emër të shefit të tij i thirri ata në Evropë, dhe iu propozoi atyre që të punonin atje.¹⁷⁸

Edhe pse Osmanët e rinj u emëruan në poste të larta jashtë Stambollit, ata preferuan të shkonin në Evropë, duke vlerësuar si më tërheqëse mundësinë që iu dha për të fituar para dhe famë. Kemali dhe Zijai u larguan nga vendi në fshetësi, nga moli Tophane me ndihmën e ambasadorit francez. Suavi dhe Agahu, gjithashtu u dërguan në Evropë me ndihmën e Sukkakinit, dhe **Mustafa Fazil Pasha** i përshpejtoi veprimtaritë e tij në Evropë si mbrojtës i këtyre të "rinjve".¹⁷⁹ Ata vazhduan të shkruanin dhe t'i dërgonin shkrimet e tyre nëpërmjet zyrave të huaja postare, që ishin jashtë kontrollit të Devletit Osman. Disa gazeta franceze i përshkruanin ata si "shpëtimtarët e Turqisë dhe pararoja e përparimtarëve".¹⁸⁰ "Ndërkohë këta "të rinj të rritur" dëshironin një liri të tillë që do t'i shkaktonte Devletit një tronditje të fortë me gjithë kuptimin e fjalës në interes të të huajve, "territori osman është një nga vendet më të lira në botë; çdo gjë është e lirë në Turqi me përjashtim të kritikës kundër Islamit dhe Sulltanit", një fjali kjo e **Panait Istratiut**, një shkrimtari me famë nga Rumania, që ishte një shtet që i paguante tagër Devletit Osman."¹⁸¹

Në Dhilkade 1283/mars 1867, Osmanët e rinj filluan të propagandonin në Paris për idenë e një kushtetute të re për Turqinë. Në radhët e tyre kishte njerëz të sinqertë dhe të përkushtuar, por disa prej tyre punonin për të përmbushur interesat e tyre personale. Madje edhe Mustafa Fazil Pasha, që ishte në pozitën e kryetarit të shoqërisë, nuk ishte një njeri i

178 Ziya Nur Aksun, fq. 6.

179 Ziya Nur Aksun, fq. 6.

180 Aksun, fq. 8.

181 Aksun, IV, fq. 10.

besës;¹⁸² ai përpiquej t'i bënte presion sulltanit, që ai ta caktonte atë princ dhe trashëgimtar të Hedivit aktual të Egjiptit.¹⁸³ Duhet të përmendim në këtë rast se disa prej tyre, përfshi këtu edhe themeluesit paraardhës të tyre, **Shinasiun**, **Namëk Kemal** dhe **Zija Pashanë**, ishin anëtarë të organizatës masone; ky është një fakt mjaft i rëndësishëm për të cilin është e nevojshme të kryhen studime të mëtejshme.

Mustafa Fazil Pasha u kthye në Stamboll pak kohë më vonë dhe u anëtarësua në *Hej'et-i Vykela* (qeveri) dhe për pasojë burimi financiar i *Jeune Turks* (Xhonturqve) u kufizua, dhe ata u kthyen në Turqi pas vdekjes së **Ali Pashait**, që ishte armiku kryesor i tyre. Ata hynë në shërbimin civil të administratës që më parë e kishin kritikuar.¹⁸⁴

Ata vendosën lidhjet me **Murad Efendinë**, trashëgimtari i fronit dhe anëtar i organizatës së masonëve,¹⁸⁵ siç ishin edhe ata. Sulltan Abdylhamidi thotë në veprën *Muhtëra* të Dr. Atif Beut, të publikuar nga Ibnulemin, "Vëllai im (Muradi) ishte mik i (Namëk) Kemal Beut. Ata pinin alkool bashkë nga darka deri në mëngjes, si dhe shkruanin dhe lexonin. Një ditë, unë pashë Kemal Beun dhe i thashë: "Kemal Bej, duhet të jesh i vetëdijshëm se ti do të jesh shkaktari për vdekjen morale të vëllait tim, mos e nxit atë të pijë alkool deri në atë masë." ... Ata takoheshin në disa vende, por më tepër në Fermën Kurbagallëdere (Kurbagallidere). Puna e tyre ishte të kritikonin Sulltan Abdylazizin dhe të thurnin plane për ta kthyer opinionin publik lokal dhe atë të huaj kundër tij, si dhe për ta rrëzuar atë nga froni sa më shpejt të ishte e mundur, që në atë fron të ulej Muradi."¹⁸⁶

182 Danişmend, IV, fq. 212-213.

183 Stanford J. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, II, fq. 131.

184 Aksun, IV, fq. 12.

185 Karal, *Osmanlı Tarihi*, VII, fq. 352.

186 Aksun, IV, fq. 12-13.

Udhëtimi i Abdylazizit në Evropë

Perandori francez, **Napoleoni III**, ftoi **Sulltan Abdylazizin** në Paris, me rastin e Panairit Ndërkombëtar të Parisit, dhe i parashtrroi atij, nëpërmjet ambasadorit të tij në Stamboll, mundësinë e shfrytëzimit të kësaj rrethane të përshtatshme për fuqizimin e paqes së përgjithshme. Në atë kohë, problemi i Kretës iu ishte bashkuar problemeve të rajonit të Ballkanit, dhe, për këtë arsye, Sulltani osman vendosi të shkonte. Ai u nis në Safer 1284/qershor 1867 në rrugë detare, mbërriti në Tulon dhe shkoi në Paris. Ai u prit nga perandori në stacion, por kur **Napoleoni III** i tha atij se mënyra më e mirë për të zgjidhur problemin e Kretës, ishte t'ia linte atë Greqisë, **Abdylazizi** iu përgjigj se: “Devlet-i Alijje, pasi luftoi për 27 vjet dhe pasi kishte sakrifikuar kaq shumë shpirtra, arriti të aneksonte ishullin; unë nuk pranoj asnjë propozim për ta dorëzuar këtë ishull dhe jam i vendosur të luftoj deri në fund për hir të tij.” Pas kësaj deklarate të sulltanit, perandori hoqi dorë nga propozimi i tij. Dhe disa ia atribuuan këtë fjalim Fuad Pashait, që ishte i famshëm për shpejtësinë e përgjigjeve të tij; kur ai u pyet gjatë një bisede miqësore për çmimin e shitjes së Kretës, ai ia ktheu: “I njëjti çmim me të cilin e blemë!”¹⁸⁷

Sulltan Abdylazizi shkoi dhe në Londër, ku takoi **Mbretëreshën Viktoria**. Kryeministri britanik, **Palmerston (Palmerstone)**, që e kishte kthyer në parimin e tij dhënien e mbështetjes për Devletin Osman kundër Rusisë, kishte ndërruar jetë dy vite më parë. Sulltani vizitoi shtëpinë dhe familjen e tij; kjo sjellje besnikërie pati një ndikim mjaft të mirë për opinionin publik. Sulltan Abdylazizi u kthye nëpërmjet Brukselit, Vjenës dhe Varnës në Rebi'ulahir 1284/gusht 1867.¹⁸⁸

187 Danişmend, *vepër e cituar*, IV, fq. 219.

188 Danişmend, IV, fq. 222.

Konferenca e Londrës

Me disfatën në Gjermani, në vitin 1870, Franca humbi ndikimin e saj në Lindje. Britania qëndroi asnjëherë dhe nuk mbeti asnjë fuqi që t'i kundërvihej Rusisë në Lindje, përveç Gjermanisë. Ishte e mundur që të ekzistonte një marrëveshje e fshehtë, midis këtyre dy fuqive, mbi çështjen e Lindjes. Rusia nuk ishte e kënaqur me nenin e Traktatit të Parisit që ndalonte luftanijet e saj në Detin e Zi. Rusia njoftoi shtetet pjesëmarrëse në nënshkrimin e këtij traktati se ajo e shikonte këtë nen si të pavlefshëm. Pas ardhjes në fron të Sulltan Abdylazizit, Devleti Alije kishte më shumë se 20 luftanije të blinduara dhe rreth 100 anije luftarake druri që e shqetësonin Rusinë. Për këtë arsye, Rusia ngulte këmbë për amendimin e Traktatit të Parisit dhe një konferencë u mbajt në Londër në vitin 1871/1870. Në këtë konferencë, kushti i Rusisë për lejimin e anijeve të saj në Detin e Zi u pranua, por u vendos që në rast se Devleti Osman do të kërkonte që anijet e luftës së shteteve të tjera të hynin në Detin e Zi, ato do të futeshin aty, si dhe u konfirmua dhe një herë e drejta e Devletit Osman për t'i mbajtur të mbyllura ngushticat.¹⁸⁹ Pas kësaj konference, **Pansllavizmi** i mbështetur nga Rusia fitoi terren.

Drejt pavarësisë së Egjiptit 1863-1882

I orientuar drejt Evropës, **Ismail Pasha**, një djalë i ri në moshë, i zgjuar dhe aventurier, u caktua si drejtues i Egjiptit Osman në vitin 1863. Ai mbërriti në Stamboll për t'i paraqitur respektin e tij dhe për t'i dhuruar një anije avulllore Sulltan Abdylazizit, i cili nga ana e tij e vizitoi Egjiptin në vitin 1860/1863. Në vitin 1864-65, Ismaili e përforcoi ushtrinë osmane me 4.500 trupa, për të shtypur një kryengritje në Hixhaz, dhe në vitin 1866, ai dërgoi dhe 8.000 trupa të tjerë në mbështetje të Devletit në luftën e tij në Rumani. Gjithashtu, ai dërgoi edhe

189 Mahmud Xhelaeddin Pasha, *vepër e cituar*, I, fq. 31-32.

18.000 ushtarë në Kretë dhe iu dërgoi oficerëve të lartë osmanë dhurata të çmuara. Sulltani dhe Sadrazami Fuad Pasha, ishin shumë mirënjohës ndaj ndihmës së tij dhe e ngritën atë në rang, duke i dhënë edhe një sërë privilegjesh, ndër të cilat më i rëndësishmi ishte titulli i Hidivit (Hedivit), në vitin 1293/1876, që i dha atij fuqinë e drejtimit në mënyrë të pavarur të çështjeve të brendshme të Egjiptit.¹⁹⁰

Më lejen e qeverisë osmane, gërmimet e Kanalit të Suezit filluan në 18 mars 1866, dhe përfunduan brenda një kohe shumë të shkurtër në gusht të vitit 1869.¹⁹¹ **Por Ismaili mori hua shuma të mëdha parash nga jashtë dhe për këtë arsye, në vitin 1876, u detyrua të themelonte një organizatë për administrimin e këtyre huave.** Ndërkohë, britanikët blenë disa nga aksionet e kanalit duke u kthyer kështu në aksionarë të dytë pas Francës. Në qeverinë egjiptiane, që u krijua në vitin 1878, nën drejtimin e **Nobar Pashait** si kryeministër, u emëruan një britanik dhe një francez si Ministër për Financat dhe Çështjet Publike, përkatësisht.¹⁹² Megjithatë, Ismaili u shkarkua nga detyra në vitin 1879 dhe me kërkesë dhe iniciativë të Britanisë dhe Francës, djali i tij, **Tevfik**, u emërua si hediv. Nga viti 1299/1882, Britania e kishte forcuar shumë pozitën e saj në Egjipt.

Sadrazami Fuad Pasha ndërroi jetë në vitin 1286/1869, dhe pasardhësi i tij, Ali Pasha, vdiq në vitin 1288/1871. Pas tij, Mahmud Nedim Pasha u emërua si Sadrazam.¹⁹³

Trazirat në Bullgari 1848-1876

Bullgarët, që i përkisnin etnisë turke, u shtrinë drejt veriut të Detit të Zi dhe themeluan shtetin bullgar në vitin 61/680-81. Për pasojë, fiset sllave u zhvendosën në zonën e Ballkanit. Deri

190 Karal, *vepër e cituar*, VII, fq. 43.

191 Po aty, fq. 44-46.

192 Po aty, fq. 52.

193 Po aty, fq. 69.

në vitin 251/865, e gjithë popullsia në këtë vend pranoi krishterimin dhe turqit-bullgarë u krishterizuan gradualisht. Gjithashtu, gjuha e tyre u shndërrua në një gjuhë sllave dhe titujt e tyre turq ranë. Shteti i ri bullgar u kthye në një shtet vasal të Perandorisë Romake, por me kalimin e kohës, në shekullin e 8-të/14-të, turqit osmanë morën kontrollin e gjithë zonës.¹⁹⁴ Edhe pse bullgarët mbetën nën patriarkun grek gjatë sundimit osman, osmanët iu dhanë fund padrejtësive dhe rrëmujave në këtë vend, dhe fshatarët filluan të jetonin në kushte më të mira nga fshatarët e Evropës, dhe Ruisë. Gjatë luftës, në vitin 1245/1829, rusët vendosën lidhjet me bullgarët, të cilët i shihnin si ortodoksë, ndërkohë që grekët përpqeshin të fitonin besnikërinë e tyre nëpërmjet Kishës Greke.¹⁹⁵

Kryengritjet dhe revolucionet që tronditën mbarë Evropën në vitin 1848, patën ndikim negativ edhe te bullgarët. Ata u rebeluan në Vidin në vitin 1265/1849, por Devleti Osman arriti t'i shtypte këto revolta në vitin 1267/1851.¹⁹⁶ Në 1860, bullgarët iu drejtuan qeverisë osmane që të tërhiqeshin nga Kisha Greke, ndërsa elementët austriakë bënë përpjekje që t'i tërhiqnin në katolicizmin e tyre. Megjithatë, Kryepeshkopi grek nuk dëshironte që bullgarët të ktheheshin në katolikë, dhe deklaroi se **"Papa ishte një peshkop i refuzimit dhe risisë."** Megjithatë, shumë bullgarë u kthyen në katolikë, duke thënë se **Kryepeshkopi grek vetë ishte jobesimtar**, dhe ata që mbetën ortodoksë këmbëngulnin për themelimin e një kisha të tyre të pavarur.¹⁹⁷ Ndërkohë, Sulltani osman dekretoi *fermanin* e 1286/11 marsit 1870, që rivendosi zëvendësin e Patriarkut dhe shpallte se të gjitha çështjet e *mil-letit* bullgar do të ishin nën përgjegjësinë e tij.¹⁹⁸ **Në këtë mënyrë u themelua Kisha bullgare e pavarur dhe populli bullgar fitoi lirinë ndaj presionit religjioz grek.**

194 E. Z. Karal, *Osmanlı Tarihi*, Ankara 1983, VII, fq. 83.

195 Po aty, fq. 84.

196 Po aty, fq. 89.

197 Po aty, fq. 92.

198 Po aty, fq. 93.

Megjithatë, bullgarët u rebeluan edhe një herë në vitin 1293/1876 kundër sundimit osman. Edhe pse nga ana materiale ata ishin më mirë se rusët dhe fshatarët e tjerë, bullgarët duke-shin se ishin ngritur në revoltë për shkak të ndjenjave kombëtare dhe se mund të ishin ndikuar gjithashtu edhe nga njësitë guerrilase bullgare në Rumani. Revolucioni filloi në Sofje dhe Filibe (Plovdiv), por një forcë ushtarake osmane prej 18.000 ushtarësh nën udhëheqjen e Mit'hat Pashait, si dhe me ndihmën e turqve që jetonin në ato zona, arriti t'i shtypte.¹⁹⁹

Shura-jë Devlet (Këshilli i shtetit)

Një rregull i ri i quajtur *teshkil-i vilajet* (vilajetet formuese) u publikua në 7 Xhumadel Ahire 1281/7 nëntor 1864, dhe kishte për qëllim riorganizimin e *ejaleteve* në *sanxhaqe*, *kaza* dhe në *nahije*. Sipas këtij rregulli çdo *vilajet* drejtohej dhe qeverisej nga një *vali*, çdo *sanxhak* nga një *mutasarrif*, dhe çdo *kaza* nga një *kajmekam*, dhe secili prej tyre do të kryesonte në *mexhlis-i idare* (këshillin administrativ) të zonës së tyre administrative. Çdo *mexhlis-i idare* (këshilli administrativ) do të kishte anëtarë të tij muslimanë dhe jomuslimanë, që do të zgjidheshin nëpërmjet zgjedhjeve të organizuara çdo dy vjet, së bashku me nëpunësit qeveritarë. Çdo *vilajet* kishte një *mexhlis-i umumi* (këshill të përgjithshëm), që mblidhej një herë në vit; ky *mexhlis* (këshill) do të ishte i përbërë nga anëtarë të të gjitha *kazave* dhe do të diskutonte dhe do të merrte vendime mbi çështjet tregtare, bujqësore, industriale, arsimore dhe civile të *vilajetit*.

Kjo ishte një përjasje për *vahdet-i kuva* (bashkimi i fuqisë), por më 8 Dhilhixhxe 1284/1 prill 1868 u themelua **Shura-jë Devlet**, për t'iu afruar *tefrik-i kuva* (shpërndarjes së fuqisë). Anëtarë nga vilajete të ndryshme u mblodhën më 17 Muharrem 1285/10 maj 1868. Sulltan **Abdylazizi** mbajti një fjalim gjatë ceremonisë së inaugurimit të Shura-jë Devlet.²⁰⁰ Është e sigurt

199 Po aty, fq. 98.

200 Danişmend, IV, fq. 226-227.

se udhëtimi i sulltanit në Evropë dhe mbresat e tij nga vizita, kishin ndikuar në pranimin e propozimit të Ali Pashait për këtë riorganizim.

Shfronësimi i Sulltan Abdylazizit 1876

Trupat ruse pushtuan Tashkentin në Turkestan, në vitin 1865 dhe Samarkandën në vitin 1868, dhe Emiri i Buharasë u kthye në një *vali* të Carit rus. Trupat ruse pushtuan edhe Hiven në vitin 1873. Britania nuk ishte aspak e kënaqur për shtrirjen e Rusisë drejt Indisë, dhe u përpoq ta angazhonte atë në rajonin e Ballkanit dhe në Kaukaz. Rivaliteti midis Britanisë dhe Rusisë mbi Azinë vazhdoi për disa kohë edhe në Persi dhe në Afganistan. Ky rivalitet u zvogëluar deri në një farë mase pas vitit 1872; dhe Rusia filloi t'i nxiste njerëzit në Ballkan kundër Devletit Osman. Ndërkohë, Britania i anashkaloi këto veprime të Rusisë, për shkak të balancimit të problemeve në Evropë, madje edhe i nxiti ato, dhe i siguroi mbështetjen e saj **Mid'hatit** dhe miqve të tij nëpërmjet ambasadorit Eliot. Ky ambasador thotë se Mid'hati u zgjodh në vitin 1871 si kryetar i mbështetësve të lirisë dhe reformës, me fjalë të tjera, "ata" e emëruan atë. Ai, gjithashtu, shton se, Mid'hat Pasha jetonte në fermën e tij pranë mureve të qytetit, dhe ishte i zënë duke thurur plane.²⁰¹ Në anën tjetër, **Murad Efendiu** bashkëpunonte me komplotistët nëpërmjet mjekut të tij special, **Kapoljonit**, kambistit të tij **Hristaki** dhe **Zija Beut**.²⁰²

Periodha e trazirave në Evropën osmane dhe ndërhyrja e fuqive të huaja në çështjet e Devletit krijoi shqetësim dhe zhgënjim në territorin osman. Pjesa më e madhe e popullsisë fajësonte Sadrazamin **Mahmud Nedim Pashanë** për të gjitha këto përkeqësime dhe ky fakt mund t'i ketë nxitur studentët të demonstrojnë më 11 maj 1876, përpara Bab-ë Ali (zyrave qendrore të qeverisë osmane). Ata kërkuan shkarkimin e menjë-

201 Z.N. Aksun, IV, fq. 130.

202 Z.N. Aksun, IV, fq. 133.

hershëm të Sadrazamit dhe Shejhulislamit. Me një përpjekje të tij të pasuksesshme për të mbajtur postin, Sadrazami zëvendësoi Shejhulislam, Hasan Fehmi Efendiun, por në fund sulltani e shkarkoi edhe atë vetë nga detyra.

Për të qetësuar situatën, **Sulltan Abdylazizi** emëroi pa dëshirën e tij në postin e Sadrazamit myterxhim (përkthyes) **Mehmed Ruzhdi Pashanë**, dhe **Hysejin Hajrullah Efendiun** si Shejhulislam, ndërkohë që **Hysejin Avni Pasha** u emërua si Serasker (Shefi i Shtatmadhorisë dhe Ministër i Luftës). Edhe Mid'hat Pasha iu bashkua qeverisë.²⁰³ Me sa duket, sulltani nuk kishte besim tek ata dhe ishte vetëm një çështje kohe përpara se ai t'i shkarkonte nga detyra dhe të risillte Mahmud Nedim Pashanë në fuqi. Për këtë arsye, ata punuan fshehurazi që ta rrëzonin sulltanin nga fronin dhe kjo mund të ketë qenë një ide e Hysejin Avni Pashait, i cili e bindi dhe Mid'hat Pashanë që t'i bashkohej këtij komploti. Sadrazami Mehmed Ruzhdi Pasha në fillim hezitoi, por pas kërcënimeve u bind.²⁰⁴ Shejhulislami ishte bindur në shtëpinë e madhe të Mid'hat Pashait²⁰⁵ dhe Seraskeri Hysejin Avni Pasha bindi Sylejman Pashanë, komandantin e Kolegjit të Luftës, Ahmed Pashanë nga Kajseri, dhe Ministrin e Forcave Detare për t'u bashkuar në këtë komplot. Konspiratorët lëshuan një *fetva* që e shpallte Abdylazizin të çmendur dhe për këtë arsye Hilafeti i tij konsiderohej si i dëmshëm për Devletin, dhe për *mil-letin* (popullsinë). Ata rrethuan pallatin, u betuan për besnikëri ndaj Murad Efendiut, dhe më 30 maj 1876, pushkët u shkrepën, dhe shpallën rrëzimin e Abdylazizit, dhe ardhjen në fron të Sulltanit të ri, Muradit V.²⁰⁶

203 Mahmud Xhelaledin Pasha, *Mir'at-i Hakikat*, Stamboll, 1326, vëll. I, fq. 94.

204 Po aty, fq. 105. Është e qartë se "njerëzit e perëndimit e kishin harruar kuptimin e **Bej'es** (betimit për besnikëri)"; vlerat e Islamit ishin zhvlerësuar shumë në radhët e intelektualëve.

205 Po aty, fq. 106.

206 Karal, VII, fq. 109.

Ndërkohë që dy zyrtarët më të vjetër, **Ali Pashai** dhe **Fuad Pashai** merrnin hua shuma të mëdha parash nga Evropa, Sulltan Abdylazizi ishte përpjekur të bënte të pamundurën për të reduktuar shpenzimet. Megjithatë, vetëm atij iu ngarkua edhe përgjegjësia e kësaj situatë,²⁰⁷ dhe e rrëzuan nga fronti, edhe pse ai duket se kishte qenë akoma popullor për masat. Xhelaleddin Pasha thotë për këtë rast: “Nëse një oficer i guximshëm do ta kishte nxjerrë Sulltan Abdylazizin jashtë dverve të pallatit, dhe nëse sulltani do t’iu kishte shpjeguar ushtarëve situatën e vërtetë, pra komplotin, bajonetat e ushtarëve mund të ishin kthyer kundër komplotistëve, dhe ata, që kishin organizuar komplotin, do të ishin mundur dhe shkarkuar nga detyrat e tyre. Por, ata që e rrethonin atë, nuk ishin njerëz të tillë që të vepronin me trimëri. Në përgjithësi, ata ishin të dhënë pas përfitimeve dhe ryshfeteve.”²⁰⁸ Pak kohë pas rrëzimit të tij nga fronti, u njoftua se ish-sulltani kishte kryer vetëvrasje. Meqenëse kishte prerje në dy kyçet e tij.²⁰⁹ Abdylazizi ka shumë mundësi të ketë qenë viktimë e vrasjes politike.

15.7 Sulltan Muradi V 1876

Muradi V, djali i Abdylmexhid Hanit, u betua për besnikëri (**bej’e**).²¹⁰ Ai kishte marrë një edukim klasik islam dhe evropian, dhe ishte njohës i gjuhës arabe dhe frënge. Gjatë periudhës së Abdylazizit, ai kishte bërë një jetë relativisht të lirë dhe e kishte shoqëruar atë në udhëtimin e tij në Evropë. Si i familjarizuar me sjelljen evropiane, dhe si njohës i gjuhës frënge, ai kishte zënë një vend të shquar e të vlerësuar në pallatet franceze dhe britanike. Ai u miqësua me trashëgimtarin e fronit britanik, i cili ia prezantoi atë **organizatës masone**.²¹¹

207 Karal, *vepër e cituar*, VII, fq. 110-112.

208 Mahmud Xhelaleddin Pasha, *vepër e cituar*, I, fq. 112.

209 Po aty, I, fq. 120.

210 *Mir’at*, I, *vepër e cituar*, fq. 116.

211 Karal, *vepër e cituar*, VII, fq. 352. Theksimi është shtuar.

Më 30 mars të viti 1876, ai mori titullin Sulltan Osman dhe Halif, por zyrtarët që e zgjodhën atë nuk mund të pajtoheshin mes tyre me kushtet e **Meshrutijetit** (Kushtetutës), ndërsa **Evropa**, në anën tjetër, **kërkonte shpalljen e menjëhershme të saj**.²¹² Kjo ngjarje dhe ngjarje të tjera të mëvonshme janë një tregues i qartë i masës në të cilën Evropa kishte ndërhyrë në çështjet e brendshme të Devletit Osman, si dhe në mënyrën e “përcaktimit” të strukturës së Devletit.

Ish-Sulltani Abdylaziz vdiq në 1293/4 qershor 1876, por armiku i tij i betuar Hysejin Avni Pasha, të cilin e brente ndër-gjegjja, nuk lejoi ekspertizën e plotë për ekzaminimin e kufomës pas vdekjes, në mënyrë që të përcaktohej edhe shkaku i vdekjes, me pretekstin se një akt i tillë nuk duhej bërë për Sulltanin “e respektuar” Abdylaziz. Vdekja e tij shkaktoi shqetësim të madh në publik, që fajësoi për këtë krim Hysejin Avni Pashanë. Për këtë arsye, një oficer i zemëruar e vrau atë dhe plagosi Kajserili Ahmed Pashanë.²¹³

Aty nga fundi i periudhës së Abdylazizit, thuhej se ai kishte planifikuar të amendonte kushtet e marrjes së fronit osman. Kjo mund të kishte marginalizuar Muradin dhe të kishte vënë në rrezik kurorën e tij. Për pasojë, ai vendosi marrëdhënie të ngushta me Osmanët e Rinj, por në të njëjtën kohë ishte i vetëdijshëm, se nëse përpjekja e tij për të rrëzuar Sulltan Abdylazizin do të dështonte, ai mund të ekzekutohej. Kur rrëzimi nga fronti i Abdylazizit ndodhi një ditë më parë nga ç’ishte planifikuar, Muradi i ndjeshëm thuhet se kishte qenë mjaft i shqetësuar dhe konfuz, veçanërisht pasi kuptoi statusin dhe përgjegjësinë e tij, ndërsa fuqia kishte kaluar aktualisht në duart e

E.Z. Karal e lavdëron atë për faktin se ishte një mason dhe pretendon se ai fitoi famë midis sundimtarëve të Evropës, për shkak të faktit se ishte një mason. Halifi musliman bëhet mason dhe Prof. Enver Zija Karal e vlerëson dhe e lavdëron atë për këtë veprim. Pa dyshim, për shkak të faktit se edhe ky i fundit ishte një mason.

212 Karal, *vepër e cituar*, VII, fq. 352-353. Theksimi është shtuar.

213 Po aty, VII, fq. 357-360.

triumviratit të Pashallarëve Mid'hat, Ryshdi dhe Hysejin Avni. Ai nuk mund ta duronte këtë presion të tmerrshëm,²¹⁴ dhe u rrëzua nëpërmjet një *fetvaje* (vendimi ligjor), në vitin 1293/31 gusht 1876. Abdylhamidi pranoi **bej'atin** në të njëjtën datë.²¹⁵

214 Karal, VII, fq. 364.

215 Karal, VII, fq. 366.

KAPITULLI 16

RUAJTJA DHE PËRTËRITJA

16.1 Sulltan Abdylhamidi II 1876-1909

Sulltani i ri shkoi në tyrben e **Ejub Sulltanit** për ceremoninë e **Këllëç Allajë**; atje mori **Shpatën e Islamit** në prezencën shpirtërore të Sahabit të madh, dhe më pas, ai vizitoi dhe tyrbet e paraardhësve të tij.²¹⁶ **Mid'hat Pasha** mori postin e Sadr-azamit, por ai ishte shumë ambicioz dhe në disa raste mjaft i papërgjegjshëm. Për shembull, ai propozoi që të rinjtë jomuslimanë të pranoheshin në Kolegjin e Luftës, por sulltani e refuzoi rreptësisht këtë propozim.

Shpallja e Kushtetutës (Meshrutijet)

“Problemi i Orientit” hyri në një fazë kritike për shkak të trazirave në Bullgari, simpatisë që opinioni publik evropian krijoi për ta dhe grumbullimit të ushtrive të Rusisë në Besarabi dhe në kufi me Anadollin, për shkak të faktit që nuk mund ta pranonte nënshtrimin e kryengritjeve serbe. Nuk ishte në interesin e Britanisë së Madhe që Rusia të kthehej në aktorin kryesor të kësaj situatë, dhe për këtë arsye Britania mbledhi në një konferencë nënshkruesit e Traktatit të Parisit të vitit 1856 në Stamboll.

“Ndërkohë, administratorët osmanë vendosën të pranonin parimin e këshillimit, dhe u formua një komitet nën kryesimin e Mid’hat Pashait për të përgatitur një projekt të Kushtetutës... Por, ata nuk kishin gjykuar faktin se qëllimi i Evropës nuk ishte të arrinte reformat që garantonin sigurinë dhe mirëqenien e Devletit Osman, në të kundërt, në përputhje me marrëveshjen e triumviratit, qëllimi i tyre ishte të ndanin Devletin Osman në njësi të vogla, dhe t’i kthenin ato në vasalë të jashtëm të Devletit, që t’i kthenin në njësi që zgjidhnin në mënyrë të pavarura çështjet e tyre...”²¹⁷ “Konferenca u mbledh në Ministrinë e Forcave Detare në Haliç (Bririn e Artë) dhe në 23 dhjetor 1876 Mid’hat Pasha proklamoi me nxitim *Kanun-ë Esasi* (Kushtetutën) për t’iu bërë përshtypje pjesëmarrësve në këtë konferencë. Në këtë mënyrë, Sulltan Abdylhamidi përmbushi premtimin e tij për Kushtetutën, që e kishte dhënë përpara ardhjes së tij në fron. Ky ishte një ligj i ngutshëm, i pastudiuar mirë; në shkrimet e tij për Mid’hat Pashanë dhe për këtë kushtetutë, Sulltan Abdylhamidi thotë: “Në fakt, ai (Mid’hat Pasha) ishte në favor të Kushtetutës, por kjo ishte një mënyrë partizane vetëm për të arritur përmendjen e emrit të tij në libra. Kur Mid’hat Pasha dëshironte shpalljen e Kushtetutës me çdo kusht, ai nuk kishte studiuar *asnjë* kushtetutë të *asnjë* shteti dhe ai nuk kishte asnjë ide se çfarë ishte kjo. Udhëheqësi i tij, që ishte **Odjan Efendiu**, nuk ishte juristi më i dalluar. Për më tepër që ai nuk e njihnte situatën në vend.”²¹⁸

Hatt-ë Hymajun (Dekreti Qiellor) i Kanun-ë Esasi (Kushtetutës) u soll në Bab-ë Ali (zyrat qendrore të qeverisë) nga Said Pasha dhe u prit nga Mid’hat Pasha. Më pas u lexua dhe u proklamua nga **Mahmud Xhelaleddin Pasha** dhe u shoqërua me 101 shkrepte armësh në shenjë të shpalljes së Kushtetutës. Ministri i Jashtëm, **Safvet Pasha**, u tha delegatëve të konferencës që ishin pjesëmarrës në këtë takim se armët u shkrepën për

217 *Mir’at-ı Hakikat*, I, fq. 220.

218 Danişmend, IV, fq. 293. Theksimi është shtuar,

shpalljen e kushtetutës, dhe se të drejtat e gjithë nënshtetasve në territorin osman ishin të garantuara; për këtë arsye nuk ishte e nevojshme që kjo konferencë të vazhdonte. Por, përgjigjja që ai mori ishte se konferenca ishte mbledhur për pagën në **Ballkan**, për këtë arsye ata vazhduan punimet.”²¹⁹

“Shpallja e Kushtetutës në këtë mënyrë ishte një gabim psikologjik. Qeveria osmane u përpoq t’i befasonte fuqitë evropiane dhe të largohej nga konferenca, por kjo lëvizje e rëndësishme, duhet të ishte marrë pasi të ishte përgatitur edhe opinionin publik, dhe madje pasi të ishin ftuar dhe ambasadorët e shteteve evropiane dhe delegatët e tyre, në këtë ceremoni.”²²⁰

“Shtetet evropiane morën vendime mbi disa çështje në lidhje me Serbinë, Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinën dhe Bullgarinë, por qeveria osmane nuk i pranoi këto vendime.”²²¹

“Sulltan Abdylhamidi ishte i mendimit që shtetet evropiane, që i kishin tërhequr ambasadorët e tyre nga Stambolli, pas refuzimit nga qeveria osmane të vendimeve të tyre në lidhje me Ballkanin, duhet të kënaqeshin me disa lëshime. Por, ai ishte i vetëdijshëm për faktin që Sadrazami Mid’hat Pasha nuk dëshironte pajtimin. Nga ana tjetër, shtetet evropiane kishin bërë të ditur se ata e shikonin Mid’hat Pashanë si përgjegjës të kryesor për dështimin e konferencës.”²²²

Mid’hat Pasha ishte tepër ambicioz dhe sillej në mënyrë të papërgjegjshme herë pas here. Ai e kishte për zakon të fliste në mënyrë jo të matur për Republikën, gjatë pritjeve në të cilat konsumohej shumë alkool. Ai ëndërronte të ndryshonte Familjen Osmane, sipas modelit të Napoleonit III. Ai thoshte “deri tani u quajt Al-i Osman (Familja e Osmanit), dhe tani e tutje quhet “Al-i Mid’hat (Familja e Mid’hatit)!”²²³

219 Danişmend, IV, fq. 294.

220 Karal, *Osmanlı Tarihi*, Atatürk Kültür, Dil ve Tarih Yüksek Kurumu, Türk Tarih Kurumu, Ankara, 1995, botimi i 4-të, VIII, fq. 29.

221 Danişmend, IV, fq. 296; Karal, VIII, fq. 34.

222 Karal, *vepër e cituar*, VIII, fq. 36-37.

223 Danişmend, IV, fq. 297.

Mid'hat Pasha kishte zakon të mblidhte Kemal beun, Zija Beun dhe të rinj të tjerë që ishin quajtur "Osmanët e Rinj" çdo natë dhe t'iu tregonte atyre sekretet e çështjeve të shtetit. Zija dhe Kemal Beu themeluan një komitet në shtëpinë ushtarake të pritjes në Sheshin Bajezid, ku në krye ishte Mid'hat Pasha. Ata filluan të regjistronin djemtë e fisnikëve nën emrin *mil-let askeri* (ushtarët e kombit). Ata që u regjistruan në të, shkonin në shtëpinë e madhe të Mid'hat Pashait dhe paraqiteshin atje. Seraskerit (Kryekomandantit) Redif Pashait iu dha urdhri ta ndalonte këtë komitet dhe të bënte të ditur se ata që dëshironin të hynin në radhët e ushtrisë si vullnetarë, mund të regjistroheshin në zyrën e Seraskerit. Por, të rinjtë nuk pranuan duke thënë: "ne nuk pranojmë të jemi ushtarë të Seraskerit, ne do të jemi ushtarë të kombit", dhe duke shkuar në shtëpinë e madhe të Mid'hat Pashait u ankuan për qëndrimin e Seraskerit.

Mid'hat Pashait iu dha urdhri t'i largonte Zija dhe Kemal Beun, duke i emëruar ata në disa poste jashtë Stambollit. Mid'hat Pasha emëroi Zija Beun në postin e *valiut* të Sirisë në rangun e vezirit. Kemal Beu nuk dëshironte të largohej. Mid'hat Pasha u thirr në pallat ku iu mor dhe *myhr-i hymajüni* (vula), dhe u shkarkua nga detyra. Ai u largua me vaporin *Izzeddin* drejt Brindisit, ku dëshironte vetë të qëndronte.²²⁴ Është ironike që neni 113 ishte vendosur nga ai vetë dhe disa njerëz ishin larguar në zbatim të këtij neni, por tani, ky nen u përdor për të larguar vetë Mid'hat Pashanë.²²⁵ Shumë poezi u krijuan për largimin e tij. Njëra prej tyre është poezia e Kazim Pashait, një shkrimtari konservator:

*Emirul Mu'mini e dërgoi larg Mid'hatin nga territori i tij,
Në të njëjtën mënyrë që Krijuesi e largoi Satanin nga Parajsja,
Sepse ai bëri ç'ishte e mundur për të mashtruar Ademin,
Dhe ky punoi pa pushim për ta bërë njerëzimin të humbiste rrugën e drejtë.*

224 Z.N. Aksun, IV, fq. 264.

225 Z.N. Aksun, IV, fq. 251.

Por, Mid'hat Pasha ishte i bindur se në rast se ai do të shkarkohej nga detyra si Sadrazam, populli do të protestonte kundër këtij veprimi, dhe do ta kthenin atë. Madje, ai pyeti ndërsa vapori po kalonte në Ngushticën e Çanakkalesë (Dardaneleve) nëse kryengritjet në Stamboll kishin filluar.²²⁶ Por, në të vërtetë, një gjë e tillë nuk kishte ndodhur, pasi njerëzit ishin shumë të lumtur për largimin e tij.²²⁷ Kemal Beu u dërgua në ishullin Midil-li.²²⁸ Namëk Kemal Beu ndërroi jetë dhe u varros pas pak kohe, më 28 Rebi'ul Evvel 1306/2 dhjetor 1888, në ishullin Sakëz, ku ai shërbente si *mutasarrif*, por kur Sulltan Abdylhamidi mësoi se kishte dashur të varrosej në Bollajër, e transportoi trupin e tij pranë tyrbes së Sylejman Pashait, **duke i paguar shpenzimet nga Hazine-i Hassa (Thesari).**²²⁹

Parlamenti Osman (Mexhli-i Meb'usan)

Më 4 Rebi'ul Evvel 1294/19 mars 1877, me një ceremoni, u inaugurua Parlamentit Osman dhe **Ahmed Vefik Pashai** u zgjodh Kryetar i Parlamentit.²³⁰ Osmanët e Rinj bënë një gabim të rëndë në lidhje me përfaqësimin e tyre në Parlament. Në bazë të Kushtetutës, numri i pjesëmarrësve nga secili *vilajet*, duhet të ishte në përpjesëtim me numrin e popullsisë së tij, por Osmanët e Rinj nuk u pajtuan me këtë raport për pjesën evropiane të territorit osman. Ky fakt është përshkruar edhe nga Stenford Sho dhe Ezel Kural Sho në tekstin që vijon: “Ndërkohë që, Kushtetuta kërkonte një përpjesëtim të barabartë të përfaqësimit për të gjitha provincat e perandorisë,²³¹ në mënyrë që të ngazëllenin fuqitë e tjera me privilegjet që iu kishin dhënë të

226 Z.N. Aksun, IV, fq. 264.

227 Për Mid'hat Pashanë populli këndonte një këngë:
Mid'hat Pasha shet ushtarët,
zgjohu Sulltan Aziz zgjohu!

228 Mahmud Xhelaledin Pasha, *Mir'at-i Hakikat*, I, fq. 266-269.

229 Danişmend, IV, fq. 329. Theksimi është shtuar.

230 Danişmend, IV, fq. 298.

231 Struktura politike osmane nuk ishte perandori dhe osmanët nuk e quanin si të tillë.

krishterëve, provincat evropiane u mbipërfaqësuan në mënyrë të konsiderueshme, duke caktuar një deputet për çdo 82.882 meshkuj, ndërsa në provincat e Anadollit, një deputet për çdo 162.148 meshkuj, dhe në Afrikë një për 505.000.”²³² Megjithatë, Parlamenti i parë Osman u mblodh më 19 mars 1877, dhe elita osmane ishte optimiste se ky sistem parlamentar do të zgjidhte të gjitha problemet e Devletit.

Lufta me Rusinë

Pavarësisht faktit se vendimet e konferencës ishin kundërshtuar për shkak të ndikimit të Mid’hat Pashait, shpresa për paqe nuk kishte humbur ende, edhe pse Cari rus, Aleksandri II, ishte i shqetësuar nga Britania. Për këtë arsye, Ignatievi, ambasadori rus në Stamboll, zhvilloi një vizitë zyrtare në kryeqytetet evropiane, ku edhe diskutoi mbi situatën, dhe 6 fuqi të mëdha: Britania, Franca, Gjermania, Austria, Italia dhe Rusia nënshkruan Protokollin e Londrës më 31 mars 1877/16 Rebi’ul Evvel 1294. Ata ia dërguan me telegraf këtë Protokoll të shkurtër qeverisë osmane, duke i kërkuar asaj një pjesë toke për Malin e Zi, fillimin e reformave nga qeveria osmane në Bosnjë e Hercegovinë dhe Bullgari, dhe uljen e numrit të ushtrisë osmane. Rusia i dërgoi edhe një notë tjetër, ku i kërkonte qeverisë osmane të dërgonte një ambasador në Shën Petërburg, për të diskutuar reduktimin e numrit të ushtrisë ruse, pasi osmanët të kishin reduktuar numrin e tyre të ushtrisë. Qeveria osmane e kundërshtoi koncesionin e tokës për Karadagun (Malin e Zi) dhe kërkoi një reduktim të njëkohshëm të të dy ushtrive, osmane dhe ruse. Ata gjithashtu kërkuan që ndërkohë që ambasadori osman do të dërgohej në Rusi, duhet të dërgohej dhe ambasadori rus në Stamboll, më 10 prill 1877/26 Rebi’ul Evvel 1294.²³³

232 Stanford J. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, Kembrixh: 1992, II, fq. 181.

233 Danişmend, IV, fq. 299.

Duke hamendësuar se Devleti Osman do ta kundërshtonte Protokollin e Londrës, rusët nënshkruan një traktat të fshehtë me Rumaninë, sipas të cilit kjo e fundit do t'i lejonte ushtritë ruse të kalonin Danubin, dhe do t'i ndihmonin ata në sulmin kundër territorit osman.²³⁴

Duke qenë se në këtë mënyrë kishte përgatitur sfondin e nevojshëm politik dhe kishte përfunduar përgatitjet ushtarake, Rusia i shpalli luftë Devletit Osman më 24 prill 1877. Sulltan Abdylhamidi II iu kërkoi të gjitha palëve nënshkruese të Traktatit të Parisit, të zbatonin detyrimet e tyre dhe të vinin në ndihmë të tij.²³⁵ Por, shtetet evropiane nuk u përfshinë në këtë problem, për të cilin ata ishin zotuar nëpërmjet nënshkrimit të traktatit. Pasi kishte marrë në kontroll Detin e Zi, Cari i Rusisë planifikoi të pushtonte një pjesë të Anadollit, dhe të arrinte deri në Gjirin Iskenderun në Mesdhe. Ushtria ruse pushtoi Dobruxhën, Zishtovën dhe Tërnovën duke masakruar shumicën e popullsisë muslimane në këto vende, ndërsa Nikopoli ra pas një qëndrese mbresëlënëse. I zemëruar nga këto prapaska, Sulltan Abdylhamidi II ndryshoi komandantët e ushtrisë osmane dhe **Sylejman Pasha** arriti ta pengonte për një kohë të gjatë në Shipka, ushtrinë ruse, që ajo të mos kalonte në Bullgari.²³⁶ Njëra nga njësitë ushtarake ruse pushtoi Vidinin, por u ndalua në Plevne nga **Osman Pasha**²³⁷ dhe mbrojtja në Shipka dhe Plevne ndaloi sulmin e vrullshëm rus drejt Stambollit. Nga ana tjetër, **Ahmed Muhtar Pashai** kishte mbrojtur Karsin për një kohë të gjatë, në frontin lindor kundër sulmit rus. Në shenjë vlerësimi të përpjekjeve të tyre, **Sulltan Abdylhamidi** nderoi me titullin **gazi Osman Pashanë** dhe **Ahmed Muhtar Pashanë**.²³⁸ Por, në mbledhjen e Parlamentit të 7 Dhilhixhixhes 1294/13 dhjetorit

234 Mahmud Xhelaleddin Pasha, *Mir'at-ı Hakikat*, Dersaadet 1326, vëll., II, fq. 10.

235 Shaws, *vepër e cituar*, II, fq. 183.

236 M. Xhelaleddin Pasha, *Mir'at-ı Hakikat*, II, fq. 170-174.

237 Po aty, II, fq. 205-210.

238 Shaws, *vepër e cituar*, II, fq. 184.

1877, qeveria u kritikua dhe, në fakt, u gjend në një situatë jo të këndshme dhe të turpshme, për shkak të përparimeve të trupave ruse në Evropë dhe në Lindje. Megjithatë, Sulltan Abdylhamidi argumentoi se ai kishte respektuar fjalën e tij, se do të mblidhte Parlamentin, por ky i fundit ishte sjellë në një mënyrë të papërgjegjshme, dhe për këtë arsye kishte merituar vendimin e tij për ta shpërndarë në mënyrë të menjëhershme.

Traktati i Shën Stefanit

Me lejen e sulltanit, flota britanike hyri në Ngushticën e Dardaneleve dhe qëndroi në Stamboll. Ushtria ruse zbarkoi në Çatallxa, pranë Stambollit, por ato trupa ishin tepër të lodhura për të luftuar dhe për pasojë u nënshkrua Traktati i Shën Stefanit më 3 Rebiul Evvel 1295/3 mars 1878, që ishte një përsëritje e Traktatit të Edrenesë të nënshkruar një muaj më parë. Mali i Zi dhe Serbia shpallën pavarësinë, ndërsa Devleti Osman njohu pavarësinë e Rumanisë dhe pranoi t'i paguante dëmshpërblim. Rusia aneksoi Besarabinë jugore dhe Bullgarisë iu dha e drejta autonome për të drejtuar çështjet e saj të brendshme.²³⁹

Ngjarja e parë në Çiragan

Emigrantët e ardhur nga Bullgaria dyfishuan popullsinë e Stambollit. Një nga ish-Osmanët e Rinj, Pan-Turku **Ali Suavi**, punoi së bashku me një grup emigrantësh për rrëzimin e sulltanit duke protestuar pranimin nga ana e tij të Traktatit të Paqes. Ai sulmoi Pallatin Çiragan më 20 maj 1878, por ky sulm u shtyp dhe ai mbeti i vvarë. Kjo ngjarje e nxiti sulltanin të ndiqte politikën e tij të ushtrimit të pushtetit, në mënyrën që ai mendonte se ishte e përshtatshme.²⁴⁰ Dukej se Ali Suavi ishte një personalitet interesant. Ishte i njohur si një idealist, por ai si duket nuk kishte dijeni të parimit që lejonte vrasjen e të dytit në rastin e betimit të dy Halifëve. Për më tepër, Muradi, për të cilin ai dësh-

239 Mahmud Xhelaledin Pasha, *Mir'at-ı Hakikat*, vëll., III, fq. 89.

240 S. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, II, fq. 189.

ronte fronin e sundimtarit, nuk ishte mendërisht i shëndetshëm, dhe kjo kishte qenë dhe arsyeja e rrëzimit të tij nga fronti. Një nga bashkëkohësit e tij, **Mahmud Xhelaleddin Pasha** (1853-1903) thotë: “Kur Sulltan Abdylhamidi erdhi në pushtet, emëroi ata që kishin qenë partizanë të sulltanit të mëparshëm Murad, dhe elementë të rëndësishëm dhe të pacipë të quajtur Osmanët e Rinj, u emëruan në poste që nuk i meritonin aspak, dhe kjo ishte një mënyrë për t’i mbajtur ata nën kontroll, dhe për t’i parandaluar që të kalonin në anën tjetër. Por, ishte e pamundur të kontrolloheshin ata në atë mënyrë, pasi disa prej tyre si (Namëk) Kemal Beu, që kishte arritur të krijonte miqësi me *vekilët* (anëtarët e qeverisë osmane), ishin emëruar në disa poste qeveritare. Një njeri i shthurur i quajtur **Ali Suavi**, që kishte jetuar për një kohë të gjatë në Britani, ku ishte martuar dhe ku kishte gjetur një vend midis dinjitarëve të këtij vendi, falë bukurisë së bashkëshortes së tij, ishte i papunë.”²⁴¹ Një historian mason, Enver Zija Karal shkruan: “Ali Suavi lindi në Stamboll në vitin 1839 dhe u arsimua në Shkollën Ryshdijje, më pas, punoi si mësues dhe si nëpunës i shtetit. Pas shkarkimit të tij nga detyra, shkoi në Hixhaz, dhe u arratis nga ky vend në vitin 1867 drejt Evropës, me ndihmën e Fazil Mustafa Pashait së Egjiptit. Në Evropë ai punoi në Shoqatën Osmanët e Rinj me Namëk Kemalin dhe Zija Pashanë. Pas prishjes së marrëdhënieve me ta, ai shkoi në Lion të Francës, ku botoi një gazetë dhe një revistë, dhe shkroi libra. Kur Abdylhamidi erdhi në fron, ai u lejua të kthehej në vendlindjen e tij dhe iu prezantua sulltanit. Ai fitoi besimin e tij dhe punoi për një kohë të shkurtër si këshilltar i tij privat, dhe u emërua drejtor i të shquarës Shkollës së Mesme Gallatasaraj. Por, për shkak të disa arsyeve që mbeten të paqarta edhe në ditët e sotme, ai e humbi pozitën dhe postin e tij, dhe rifilloi sërish punën e tij si gazetar.

Ali Suavi ishte njeri i zgjuar, dinamik dhe tepër ambicioz. Ai mësoi arabisht, persisht, frëngjisht dhe anglisht. Në Evropë

241 Mahmud Xhelaleddin Pasha, *Mir’at-i Hakikat*, III, fq. 138.

ai propagandoi pro lirisë dhe kushtetutës, si dhe kritikoi për ca kohë qeverinë osmane dhe Hilafetin, dhe shikohej si një nga liderët e turqizmit, për shkak të artikujve që shkruante mbi gjuhën dhe historinë turke. Por, pas ardhjes në fron të Abdylhamidit, ai filloi të shkruante në favor të Dinastisë Osmane dhe kundër kushtetutës, dhe pasi u kthye në Stamboll, ndërmori një luftë të ashpër kundër Mid'hat Pashait."²⁴²

Ngjarja e dytë në Çiragan

Masonët kishin si synim rivendosjen në fron të Muradit, për vetë faktin se edhe ai ishte mason. Mjeshtri i **Llozhës** masonë **Prodos** në Stamboll, **Kelanti**, themeloi një komitet për Muradin V. Ky komitet vendoste mbi muret e qytetit manifeste që lavdëronin Muradin. Ata kishin planifikuar vrasjen e Sulltan Abdylhamidit, një plan ky që nuk arriti të zbatohet. Sipas një plani të ri të hartuar në shkurtin e vitit 1878, ata do të hynin fshehurazi në Pallatin Çiragan, përmes sistemit të ujësjellësit dhe do të lironin Muradin. Por, gjatë mbledhjes, komiteti u sulmua, Kelanti dhe Ali Shefkati arritën të shpëtonin duke u arratisur, ndërsa të tjerët u kapën dhe u dënuan. "Ali Suavi dhe Kelanti janë masonë. Sipas Sulltan Abdylhamidit, masonët janë persona me arsimim sipërfaqësor evropian."²⁴³

Traktati i Berlinit, 13 korrik 1878

Britania, Austria dhe Prusia kishin lakmi ndaj përfitimeve të mëdha territoriale të Rusisë dhe për këtë arsye, kërkuan mbledhjen e menjëhershme të një kongresi që do të mbahej në Berlin. Rusia pranoi pa dëshirë, pasi e dinte se nëse do të refuzonte pjesëmarrjen në këtë kongres, do të shkonte drejt një krize më të rëndë dhe ndoshta edhe drejt luftës.

242 Enver Zija Karal, *OT*, Ankara 1983, botimi i dytë, vëll., VIII, fq. 499.

243 Karal, *Osmanlı Tarihi*, VIII, fq. 501-504.

Britania i kërkoi Sulltanit osman ta lejonte atë të qeveriste Qipron, duke pretenduar se kjo ishte e nevojshme për të mbrojtur Anadollin Lindor kundër çdo sulmi rus, dhe e paralajmëroi se do të tërhiqej nga kongresi, nëse sulltani nuk do ta pranonte këtë kërkesë të saj. Në këtë mënyrë, sulltani u detyrua të jepte këtë koncesion në Traktatin e Qipros, që u nënshkrua më 4 qershor 1878. Megjithatë, Britania pranoi t'i paguante një shumë vjetore Thesarit Osman, nga çka mbetej nga të ardhurat që merrte ajo nga Qipro, dhe Devleti Osman vazhdoi të administronte institucionet juridike, fetare dhe arsimore të Qipros. Nga ana e saj, Britania premtoi se do t'i jepte Devletit të gjithë ndihmën e nevojshme për mbrojtjen e Anadollit lindor, në rast sulmi nga Rusia.²⁴⁴

Kongresi i Berlinit u mbledh në 12 Xhumadul' Ahire 1295/13 qershor 1878. Kryeministri gjerman, **Princ Bismarku**, u zgjodh president. Kryetari i delegacionit osman ishte **Aleksandër Kara Todor**; këtij të krishterit iu dha ky post për të impresionuar shtetet evropiane. Bismarku u tha delegatëve osmanë në takimin e tyre të parë: "Mos e gënjeni veten duke menduar se kongresi u mbledh për Devlet-i Alijje. Nëse Traktati i Shën Stefanit nuk do t'i kishte prekur fitimet e shteteve evropiane, do të kishte mbetur ashtu siç ishte."²⁴⁵

Faktikisht, sfera e ndikimit bullgar, në fakt e atij rus, që kishte arritur deri në brigjet e Egjeut, sipas Traktatit të Aja Stefanos (Shën Stefanit), u zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme në Kongresin e Berlinit. Devleti Osman rifitoi Dogu (Doğu) Bejazitin (Bejazitin Lindor) dhe Eleshkirtin, që i ishin dhënë Rusisë pas nënshkrimit të Traktatit të Shën Stefanit. Por, popullsia e Bosnjë e Hercegovinës nuk i pranoi nenet që u vendosën për ta në këtë Kongres. Për këtë arsye, Austria vendosi atje një regjim ushtarak. Pavarësisht nga fakti që Abdylhamidi ishte i ndjeshëm ndaj çështjeve të Islamit, më 21 prill 1879, ai u dety-

244 Shaws, *vepër e cituar*, II, fq. 190. Theksimi është shtuar.

245 Mahmud Xhelaleddin Pasha, *Mir'at-i Hakikat*, III, fq. 175-176.

rua të pranonte për një periudhë të pacaktuar njohjen e hegjemonisë austriake, sovranitetin austriak në atë territor. Megjithatë, muslimanët do të ishin të lirë të praktikonin besimin e tyre fetar dhe *hutbeja* do të mbahej në emër të *Halifit*. Popullsia e vendit do të kishte të drejtën të punësohej në administratë dhe ata muslimanë që do të dëshironin, do të lejoheshin të largoheheshin.²⁴⁶ Sulltan Abdylhamidi këmbënguli shumë për vendosjen e këtyre çështjeve dhe bëri të pamundurën për të mbrojtur popullsinë muslimane deri në skajin e kufizimit të tij.

Pushtimi francez i Tunizisë

Tunizia kishte qenë pjesë ligjore dhe zyrtare e Devletit Osman që nga viti 1574, por ishte drejtuar në emër të Devletit në fillim nga *bejlerbejtë*, dhe pas vitit 1591, nga *dajët dhe bejët*. *Dajët*, pas vitit 1591, dhe më pas *bejët*, u kthyen në sundimtarët *de facto* të kësaj province, dhe i drejtonin çështjet e tyre të brendshme në mënyrë të pavarur, edhe pse shenjat e sovranitetit (*hutbeja* dhe *sikke*: monedha) ishin në emër të Halifit-Sulltan Osman. Që nga periudha e **Ahmed Beut** (sundoi 1837-1855), e ëma e të cilit ishte një robinjë nga Gjenova, Tunizia kishte filluar t'i kthente shpinën autoritetit osman. Por veziri **Hajreddin Pasha**, një shtetar i spikatur dhe i aftë që kishte qenë një skllav nga Kaukazi, luftoi gjatë periudhës së **Sadik Beut** për ta mbajtur provincën nën sundimin osman. Besnikëria e tij ndaj Devletit Osman e bëri atë armikun e hidhur të gjithë konsujve të huaj në Tunizi, dhe si përfundim rivalët e tij politikë e detyruan të largohej nga provinca. **Sulltan Abdylhamidi** e emëroi atë në administratën qendrore osmane, por largimi i tij i dobësoi lidhjet e Devletit me Tunizinë. Ndërkohë, Tunizia ishte përfshirë në hua të mëdha parash dhe për administrimin e tyre u krijua një komitet në vitin 1869. Britania i hapi Francës dritën jeshile për pushtimin e Tunizisë në këmbim të njohjes prej saj të Traktatit të Qipros dhe Bismarku deklaroi qëndrimin e tij se

246 Shaws, *vepër e cituar*, II, fq. 192.

“Gjermania nuk do të kishte asnjë kundërshtim kundër Francës, nëse ajo do të pushtonte Tunizinë.” Me këtë gjest, Bismarku mund të ketë pasur dëshirën që të ulte krenarinë e Francës për humbjen e Alsak-Lorenës, që ta mbante atë jashtë Evropës, dhe ta shtynte atë që të hynte në një konflikt me Italinë në Afrikë.²⁴⁷

Duke pasur këtë nxitje dhe gatishmëri ndërkombëtare, Franca e sulmoi Tunizinë më 4 prill 1881, me pretekstin se do të vendoste ligjin dhe rregullin përgjatë kufijve të Algjerisë dhe Tunizisë, që kinse kishte qenë nën kërcënimin e sulmeve të fisit Kurumir në Algjeri. Franca detyroi **Sadik Beun** të nënshkruante traktatin e Bardosë në 12 maj 1881, që përcaktonte “**mbrojtjen**” franceze të Tunizisë, por që në mënyrë dashakeqe, nuk shprehte asgjë për shtetin “agresor” të supozuar.

Qeveria osmane protestoi kundër kësaj shkelje flagrante të Traktatit të Berlinit, por ishte e pafuqishme për t’u përballur me fuqitë arrogante imperialiste evropiane.

Gjykata e Drejtësisë e Jëlldëzit

Mahmud Xhelaleddin Pasha, që më pas mori postin e Nazirit të Financave dhe të Punëve Publike, i paraqiti Sulltan Abdylhamidit një peticion mbi shkaqet e vdekjes së Sulltan Abdylazizit. Sipas deklaramentit të **Pervin Felek Hanëmes**, që kishte dalë nga Pallati pas ngjarjes së Abdylazizit, dhe që ishte martuar me djalin e tij, **Mynir Beun** (më pas Pasha), Mahmud Xhelaleddin Pasha pohoi se Sulltan Abdylazizi nuk kishte kryer vetëvrasje, por e kishin vrasur.

Një gjykatë e jashtëzakonshme e drejtësisë u krijua nën kryesimin e **Sururi Efendisë**, kryetari i gjykatës së apelit, dhe anëtarët e saj ishin: **Hristoforidhi Efendi**, zv/Kryetari i kësaj gjykate, **Emîn Beu**, një *myhtedi* (i konvertuar) gjerman, që ishte i njohur për ndershmërinë e tij, **Tevfik Beu**, **Hysejin Beu** dhe **Tekavur Efendiu**. Ish-Sulltani Murad dhe e ëma nuk u thirrën

247 Karal, *vepër e cituar*, VIII, fq. 85.

në gjyq në mesin e 15 të akuzuarve, ndërsa Nijaz Kallfa u fal për arsye se ishte grua. Myterxhim Ryshdi Pasha, që ndodhej në Manisa ku vuante dënimin e tij, u mor në pyetje në Izmir për shkak se ishte i sëmurë. Më i famshmi ndër të pandehurit, Mid'hat Pasha, pasi u dërgua në mërgim, zhvilloi takime zyrtare me zyrtarë në Britani dhe në pjesën kontinentale të Evropës, edhe pse ai nuk kishte asnjë fuqi zyrtare. Duke qenë se ai arriti të falej me ndërhyrjen e Britanisë, u emërua *vali* i Izmirit në vitin 1880. Pasi mësoi arsyen e mbledhjes së gjykatës, ai u largua fshehurazi nga shtëpia e tij gjatë natës së 16/17 majit dhe u strehua në përfaqësinë e huaj më të afërt, në Konsullatën Franceze. Por, me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, ambasadori francez, **Ch. Tissot**, në Stamboll, i dërgoi një telegram Konsullit francez në Izmir dhe Mid'hat Pasha u largua nga Konsullata.

Pas tre ditë gjykimi, gjykata mori vendimin e dënimit të 10 të pandehurve, nga 15 persona që ishin nën akuzë, ku Mid'hat Pasha dhe Myterxhim Ryshdi Pasha morën dënimin me vdekje, dhe dy të tjerë u dënuan me burgim. Ky dënim u miratua nga Gjykata Supreme e Apelit dhe nga Zyra e Krye-Muftiut.

Por, Sulltan Abdylhamidi nuk ishte në favor të ekzekutimeve dhe i ndryshoi të gjitha dënimet me vdekje, në dënim me burgim.²⁴⁸ U vendos që këto dënime të zbatoheshin në Taif, vend drejt të cilit të dënuarit u transportuan në bordin e vaporit *Izzedin*.²⁴⁹

Dyjun-ë Umumijje (Huat Publike)

Ndërkohë, më 20 nëntor 1881, u themelua një institucion i ri i quajtur *dyjun-ë umumijje*, për menaxhimin dhe administrimin e huave publike që Devleti Osman kishte marrë nga

248 Duhet të theksojmë se kundërshtarët dhe armiqtë e tij, e quanin atë "Sulltani i Kuq", dhe ky emërtim i padrejtë pranohet nga disa, pa asnjë hetim të mëtejshëm.

249 Danişmend, IV, fq. 319-321.

shtetet evropiane. Ky institucion ishte si një shtet i pavarur brenda Devletit Osman. Funkionarët e tij kishin paga më të larta se kolegët e tjerë të Devletit. Kjo organizatë u ngarkua me detyrën për të mbledhur një pjesë të të ardhurave të Devletit Osman, në mënyrë që të shlyenin borxhet ndaj shteteve evropiane.²⁵⁰

Pushtimi britanik i Egjiptit 1882

Politika e papërgjegjshme financiare e Hedivit Ismail e çoi Egjiptin drejt një situatë tepër të vështirë. Ndërkohë që të gjitha të ardhurat e tij në vitin 1872 arritën në vlerën 9.5 milionë lira, borxhi i jashtëm i Egjiptit arrinte në vlerën 100 milionë lira, dhe interesi i tij vjetor ishte 7.5 milionë lira. Një komision përfaqësues i kreditorëve u krijua që të kontrollonte financat e vendit, dhe në vitin 1878, dy ministra britanikë dhe francezë u emëruan në kabinetin egjiptian.²⁵¹ I ballafaquar me protestën publike, Hedivi u përpoq të krijonte një qeveri tërësisht egjiptiane, por kjo alarmoi Britaninë dhe Francën dhe Hedivi u detyrua të abdikonte nga fronin më 26 korrik 1879, në favor të djalit të tij, Tevfik. Megjithatë, para se ai të abdikonte, Ismaili i kishte telegrafuar Sulltan Abdylhamidit për të kërkuar mbrojtjen e tij, por Sadrazami Osman i asaj kohe, Hajreddin Pasha i Tunizisë, kishte ngulur këmbë për abdikimin e tij dhe qëndrimi i Ismailit në post, do të kishte nxitur një kryengritje popullore, ose do të kishte nxitur ndërhyrjen nga jashtë në çështjet e Devletit.²⁵²

E revoltuar nga ndërhyrjet e huaja në çështjet e vendit të tyre, popullsia e Egjiptit, në vitin 1881, u hodh në kryengritje nën drejtimin e **Ahmed Urabi Pashait**. Ata morën qeverinë, duke i dhënë fund përkohësisht udhëheqjes evropiane. **Sulltan Abdylhamidi** mblodhi në Stamboll Konferencën e Ambasadorëve për të diskutuar situatën e krijuar në Egjipt. Sadrazami

250 Danişmend, IV, fq. 321-322.

251 Karal, *vepër e cituar*, VIII, fq. 88.

252 Po aty, VIII, fq. 89.

Said Pasha dhe anëtarë të tjerë të qeverisë osmane, ishin të mendimit që të merrnin pjesë në të, por sulltani nuk e pranoi pjesëmarrjen për arsye se një veprim i tillë do të ligjëronte ndërhyrjen e huaj në çështjet e Egjiptit. Ambasadorët vendosën që Devleti Osman duhet të përpiquej t'i zgjidhte vetë problemet e Egjiptit dhe mori vendimin që të mos kishte asnjë ndërhyrje të faktorit të huaj "me përjashtim të rrethanave të paparashikuara".²⁵³ Në këtë mënyrë, aftësitë politike të Sulltan Abdylhamidit kishin shpëtuar momentalisht Egjiptin nga ndërhyrja e shteteve të huaja. Ai thirri në Stamboll **Urabi Pashanë** dhe kolegët e tij për këshillim, dhe dërgoi **Dervish Pashanë** në Egjipt për të bërë një marrëveshje me Hedivin Ismail. Por, ndërkohë që këto bisedime po zhvilloheshin, anijet evropiane u shfaqën në brigjet e Aleksandrisë. Kjo solli shqetësim të madh dhe kryengritjen e popullsisë, ndërsa disa qytetarë të huaj, që u ndodhën në rrugët e qytetit, mbetën të vvarë gjatë revoltave. Për këtë arsye **Admirali Britanik Sejmur** bombardoi Aleksandrinë në 13 korrik 1882, edhe pse luftanijet franceze ishin larguar nga Gjiri i Aleksandrisë sipas një porosie të dhënë nga Dhoma e tyre e Deputetëve.²⁵⁴ E përballur më këtë përçarje në mesin e përpjekjeve të saj për paqe, qeveria osmane vendosi të dërgonte trupat e saj në Egjipt, por sulltani nuk pranoi. Ai mendonte se vendimi më i mirë që mund të merrnin osmanët për Egjiptin, ishte të zgjidhte problemet financiare dhe të emëronte nacionalistë egjiptianë në postet e larta, dhe ata do të ndërmerrnin veprimet e nevojshme.

Ndërkohë që përfaqësuesit e sulltanit ishin nisur për në Kajro, ndërhyrësit në Britani, të drejtuar nga Ministri i Tregtisë, **Xhozef Çemberlejn (Joseph Chamberlain)**, synonin të rrëzonin nacionalistët dhe të pushtonin Egjiptin, që të siguronin interesat e kreditorëve britanikë dhe në të njëjtën kohë të siguronin pambuk me çmim të ulët për industrinë tekstile të vendit të

253 S. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, II, fq. 194.

254 Po aty, II, fq. 194.

tyre, me qendër në Mançester. Nga ana tjetër, Franca e kundërshtonte një veprim të tillë ushtarak, pasi kjo do të bënte të mundur që Britania të vendosej në Mesdheun Lindor dhe do të rrezikonte seriozisht zotërimin ekonomik dhe kulturor francez në këtë zonë. Në atë kohë, Kryeministri liberal, Gledston (**Gladstone**), ishte gati të jepte dorëheqjen nga detyra, dhe për këtë arsye ndërhyrësit morën iniciativën në Londër. Trupat britanike zbarkuan në Aleksandri, shkatërruan egjiptianët në Tell el-Kebir, më 13 shtator 1882, dhe pushtuan Kajron 4 ditë më vonë. Devleti Osman protestoi kundër pushtimit britanik të Egjiptit, por pa dobi. Megjithatë, Britania deklaroi se pushtimi i Egjiptit ishte i përkohshëm dhe se do të tërhiqej pasi të zgjidhte problemet në këtë vend, që do të thoshte se do të ndiqte politikën e “shpëtimit dhe tërheqjes”. Sulltani nuk kishte asnjë alternativë tjetër, përveçse të pranonte këtë “premtim”. Më 24 tetor 1885, u nënshkrua një marrëveshje sipas të cilës sovraniteti Osman i Egjiptit u konfirmua në teori, dhe Egjipti pranoi t’i paguante një taksë vjetore Devletit Osman. Gjithashtu, si osmanët, ashtu dhe britanikët, do të dërgonin në Egjipt komisionarët e tyre të lartë, për të asistuar Hedivin në çështjet e brendshme.²⁵⁵ Ushtria egjiptiane u shpërbë dhe oficerët e saj u burgosën ose dolën në pension. Oficerët britanikë në Egjipt mbanin kapelën *fez* (ose *tarbush*) dhe morën titullin turk *Bej*. “Nëse ata do të kishin pasur mundësinë të ndryshonin edhe ngjyrën e fytyrës së tyre nga biond në zeshkan, ata do ta kishin bërë.”²⁵⁶

Sulltan Abdylhamidi mbante kontakte të ngushta me inteligjencën dhe prijësit e politikës egjiptiane nëpërmjet komisionarit të tij të lartë, **Ahmed Muhtar Pashait**, dhe familjes së Hedivit. Dinjitarët fisnikë të Egjiptit, nga ana e tyre, kishin dëshirë të madhe të mbanin lidhjet me qendrën, Stambollin. Ata i dërgonin fëmijët e tyre atje për t’u arsimuar, blenin shtëpi vërimi në brigjet e Bosforit dhe bënë lidhje martesore me familjet

255 Po aty, II, fq. 194.

256 Karal, *vepër e cituar*, VIII, fq. 98.

e fisnikëve osmanë, në atë nivel që osmanët “kishin më shumë ndikim në Egjipt nga ç’u dukej britanikëve, që mbetën kryesisht në sipërfaqe të jetës egjiptiane, përgjatë shumë viteve të kontrollit të tyre politik dhe ushtarak.”²⁵⁷



Ahmed Muhtar Pasha

Nuk ka asnjë dyshim që e gjithë kjo u bë e mundur për shkak të unitetit kulturor islam midis dy popujve; baza dhe prejardhja, përbënin sfondin e përshtatshëm për vazhdimësinë e kësaj lidhjeje. Zotërimi dhe pushtimi i huaj nuk arritën t’i ashpëronin këto marrëdhënie, dhe vetëm në një kohë më të vonë imperialistët evropianë do arrinin t’i dobësonin këto lidhje vëllazërore, nëpërmjet programeve të njëanshme të edukimit dhe historisë së falsifikuar në librat e shkruara nga historianët e tyre, pa u bazuar në burimet lokale apo në burimet osmane, por duke “përdorur” librat e “tyre” me modelin e “*nuqila ‘an Nicola*”.

Bullgaria

Me vendimin që u mor në Kongresin e Berlinit, Bullgaria u nda në një principatë nën sovranitetin osman dhe në një *vilajet*

257 S. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, II, fq. 195.

të quajtur “Rumelia Lindore”. Por, pas përpjekjeve të naciona- listëve bullgarë, këto dy pjesë u bashkuan më 18 shtator 1885. Pas diskutimeve të shumta, pikat strategjike Ruptkos dhe Kërxaali iu rikthyen Devletit Osman. Kjo mund të shihet si një ngjarje e suksesshme për osmanët nën rrethanat e asaj kohe.²⁵⁸

Lufta osmano-greke

Traktati i vitit 1830 përcaktoi kufijtë osmano-greke, por një shoqatë e fshehtë, *Ethniki Etaria*, organizoi një sulm të armato- sur, në vitin 1897, kundër postbllloqeve osmane në Thesali dhe në Maqedoni. Edhe pse ishte më e fuqishme se flota osmane, flota greke nuk arriti të pushtonte ishujt e Detit Egje. Trupat greke nën komandën e **Kostandinit**, vëllait të mbretit, luftuan kundër forcave osmane nën drejtimin e Myshir (Mareshal) **Ed’hem Pasha**, por ata pësuan disa herë humbje, dhe me fitoren e **Domekes (Dömeke)** më 17 maj 1897, rruga drejt Athinës mbeti e hapur për ushtrinë osmane. Në fakt, ajo do të hynte në Athinë, nëse Cari i Rusisë nuk do t’i kishte bërë një kërkesë per- sonale Sulltan Abdylhamidit, për të ndaluar operacionet ushta- rake. Edhe fuqitë e tjera evropiane kishin të njëjtën kërkesë për qeverinë osmane. Armëpushimi u shpall më 20 maj 1897 dhe u ndoq nga një traktat paqeje më 13 nëntor 1897. Devleti Osman aneksoi disa pika strategjike në kufirin me Thesalinë dhe grekët u detyruan të paguanin një shumë prej 100.000.000 frangash si dëmshpërblim luftime.²⁵⁹

Edhe pse të mundur në fushën e betejës, grekët vazhduan të pretendonin se Kreta i përkiste Greqisë, (faktikisht, Devleti Osman e kishte marrë Kretën nga venedikasit, jo nga grekët) dhe ata u përkrahën në këtë pretendim edhe nga fuqitë evropiane. Për shkak të disa problemeve në Kretë, administrata e saj e brendshme u la në dorën e disa drejtuesve lokalë, në vitin 1897. Princi Jorgji mbërriti në ishull në 21 dhjetor 1898 dhe mori

258 Danişmend, IV, fq. 328.

259 Karal, VIII, *vepër e cituar*, fq. 118.

pushtetin mbi të. Në teori, Kreta ishte nën sovranitetin osman, edhe pse nuk kishte asnjë dokument që e konfirmonte këtë sovranitet. Një parlament themelues u mbledh në vitin 1899 dhe një komitet i përbërë nga 5 anëtarë u caktua të ndihmonte princin. Pjesa më e madhe e popullsisë muslimane emigroi nga ishulli drejt Anadollit. Në këtë mënyrë, nëpërmjet një sërë kurthesh dhe intrigash, Kreta filloi gradualisht të krishterizohej.²⁶⁰

Marrëdhëniet osmano-gjermane

Sulltan Abdylhamidi ishte i kujdesshëm ndaj Britanisë, nënvlerësonte Francën dhe nuk i besonte asnjëherë Rusisë, pasi kjo e fundit, kishte treguar armiqësi ndaj turqve dhe kishte pushtuar territore të gjera muslimano-turke. “Qëndrimi i Sulltan Abdylhamidit në lidhje me politikën e jashtme ishte: sjellja me takt ndaj Rusisë, kujdesi që të mos krijohet asnjë problem me Britaninë, mbështetja tek Gjermania, të mos harronte që Austria e kishte një sy tek Maqedonia, të krijonte marrëdhënie sa më të mira me shtetet e tjera, të shkaktonte probleme në Ballkan në mënyrë që të krijohet armiqësi midis Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë.”²⁶¹ Në këtë mënyrë, ai vendosi që të punonte për të fituar mbështetjen dhe vullnetin e mirë të Gjermanisë. Pas një vizite në Greqi, **Kajzer Vilhelmi II** (Kaiser Wilhelm II) gjerman, vizitoi edhe Stambollin në vitin 1899, dhe më pas vizitoi edhe Damaskun, dhe Jerusalemin (Kudsin).

260 Karal, *vepër e cituar*, VIII, fq. 125.

261 Tahsin Paşa, *Abdülhamit ve Yıldız Hatıraları*, Stamboll 1931, fq. 62.



Shatërvani gjerman, Sheshi Sulltan Ahmed, Stamboll

Edhe pse Britania shprehu dëshirën për ndërtimin e linjës hekurudhore Stamboll-Bagdad-Basra, në vitin 1903, sulltani ia dha këtë koncesion të rëndësishëm Gjermanisë.²⁶² Përveç kësaj, u mbledhën para nga populli, për ndërtimin e hekurudhës së Hixhazit. Kjo linjë hekurudhore lidhte qendrën e Hilafetit, Stambollin me Medine el-Munevveren, me qytetin e Profetit Muhammed (a.s.), si dhe shërbente për pelegrinët muslimanë. Qëllimi ishte që kjo linjë të vazhdonte deri në qytetin e shenjtë Meke el-Mukerreme dhe më pas deri në Jemen. Osmanët ishin tepër të kujdesshëm për të ruajtur qetësinë e këtij qyteti të shenjtë dhe në këtë mënyrë linja e hekurudhës, dhe stacioni u

262 Karal, *vepër e cituar*, VIII, fq. 173-177.

vendosën në një pozicion të atillë që të mos binin ndesh me urdhrat e Profetit (a.s.). Britanikët nuk e pëlqenin krijimin e marrëdhënieve miqësore të sulltanit me Gjermaninë, pasi kjo kishte një ndikim negativ ndaj influencës së Britanisë në rajon. Linja hekurudhore do të kishte edhe një degë tjetër, atë të Bagdad-Basra-Kuvajt. Në këtë mënyrë, sulltani arriti të ngrinte nivelin e garës dhe të rivalitetit midis Gjermanisë dhe Britanisë.²⁶³

263 Tahsin Paşa, *vepër e cituar*, fq. 286.

KAPITULLI 17

SHOQËRIA ITTIHAD ve TERAKKI (BASHKIM DHE PËRARIM)

“Ndërkohë që shpërthimi arsimor, gjatë periudhës së sundimit të Abdylhamidit kishte prodhuar me qindra burokratë, doktorë, oficerë dhe shkrimtarë të arsimuar, që dëshironin të punonin brenda sistemit, ky zhvillim prezantoi dhe disa otomanë me mendimin liberal politik të Evropës perëndimore. ...kur sulltani bëri përpjekje për të balancuar buxhetin, duke reduktuar numrin e nëpunësve në stafin e ministrave, dhe numrin e oficerëve në radhët e ushtrisë, duke përjashtuar kështu një numër të madh kadrosh, që pasi ishin arsimuar, ata ndjenë se kishin të drejtën e tyre të punësimit në qeveri me paga të mira.”²⁶⁴

Studentët e Shkollës Ushtarake të Mjekësisë: Ibrahim Temo, Abdullah Xhevdet, Mehmed Reshid, Hysejnzade Ali dhe Is’hak Sukuti themeluan një shoqëri të fshehtë më 21 maj 1889 të quajtur *Ittihad ve Terakki* (Bashkim dhe Përparim), në të cilën u anëtarësuan studentë dhe oficerë të ushtrisë. Programi i tyre bazohej në parimet e kushtetutës, otomanizmit dhe lirisë. “Shoqëria Osmane Ittihad ve Terakki u themelua si një organizatë e fshehtë dhe u zgjerua me kalimin e kohës. Kjo shoqëri

264 S. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, fq. 255-256.

zbatonte shumë nga metodat dhe rregullat e praktikuara nga masonët.”²⁶⁵

Numri i pjesëtarëve të kësaj shoqërie u rrit me shpejtësi. **Ahmed Rizai** (1859-1930), njëri nga anëtarët e saj më të spikatur, shkoi në Paris ku u ndikua ndjeshëm nga **Pjer Lafit (Pierre Lafitte)**, dishepulli i **Ogyst Kontit (August Comte)**, dhe mësoi prej tij pozitivizmin, që formoi dhe pikëpamjet e tij mendore.²⁶⁶ Me kalimin e kohës, Ahmed Rizai u bë dhe prijësi i kësaj shoqërie.

Hedivi i Egjiptit e përkrahu këtë shoqëri, duke i dërguar herë pas here edhe para, por ai i ndaloi të gjitha këto pasi u njoftua se prijësi i saj, **Ahmed Rizai**, gjoja ishte një jobesimtar.²⁶⁷ Inteligjenca osmane e kohës supozonte me naivitet se vetëm një *meshrutijjet* (qeveri kushtetuese) e menjëhershme do të mund të zgjidhte të gjitha problemet e Devletit Osman.

Përpjekja për vrasje

Gjatë luftës ruso-osmane të vitit 1293/1877-78, në radhët e ushtrisë ruse të Kaukazit ishin të angazhuar një pjesë e madhe oficerësh dhe ushtarësh armenë. Armenët rusë u përpoqën të nxisnin dhe bindnin armenët osmanë, që kishin jetuar në kushte shumë të mira dhe ishin quajtur **“tebe’a-jë sadëka”** (besnikët). Armenët rusë u përpoqën që të angazhoheshin me veprimtari për Rusinë. Faktikisht, armenët nuk kishin jetuar asnjëherë nën një sovranitet tjetër, duke përfshirë këtu edhe atë romak, kaq të rehatshëm, sa ishte sundimi osman. Një shembull tregues ishte dhe emërimi i disa ministrave armenë, dhe punësimi i një pjese

265 Karal, *vepër e cituar*, botimi i 4-të, Ankara 1995, VIII, fq. 514. Është e logjikshme të besosh shprehjen e Enver Zija Karal që thotë se Shoqëria Ittihad ve Teraki ishte themeluar nga masonët, ose të paktën, që në fillimet e saj, ajo ishte nën ndikimin, madje dhe nën kontrollin e tyre, duke pasur gjithashtu parasysh edhe faktin që E.Z. Karal është vetë një mason.

266 Bernard Lewis, *The Emergence of Modern Turkey*, Oxford University Press, 1968, fq. 197-198. Theksimi është shtuar.

267 Karal, *vepër e cituar*, VIII, fq. 517.

të mirë nëpunësish të nivelit të lartë në administratën osmane. Britania, nga ana e saj, duke vënë re se ambiciet e Ruisë për të arritur drejt ujërave të ngrohta filluan të hynin në sferën e mundësisë, për shkak të kushteve të pranuar në Kongresin e Berlinit, vendosi të përdorte armenët për qëllimet e saj duke parandaluar kështu shtrirjen ruse drejt deteve më të ngrohta, gjë që do të vinte në rrezik interesat e Britanisë në lidhje me Egjiptin dhe Indinë. Në këtë mënyrë, armenët u kthyen në një grup të shfrytëzuar nga Fuqitë e Mëdha për interesat e tyre, që u shkaktonin atyre dëme.

Dhe, në këtë mënyrë, armenët osmanë të nxitur nga fuqitë e huaja vepruan. Ata u angazhuan në propagandë në Evropë duke deklaruar se armenët ishin të shtypur në territorin osman, dhe, nga ana tjetër, ata shkaktuan trazira dhe akte të mosbindjes në vend. Në këtë mënyrë, ata u përpoqën t'i hapnin rrugën ndërhyrjes së jashtme. Për ta vendosur Armeninë në Anadollin Lindor, ata morën vendimin të vrisnin Sulltanin osman Abdylhamidin, duke bombarduar karrocën e tij dhe duke shkatërruar *Bab-ë Alinë* (zyrat qendrore të qeverisë osmane); urën e Gallatës në Stamboll; Bankën Osmane si dhe Ambasadat në Stamboll. Duke shkaktuar këto trazira, ata kishin për qëllim të mundësonin ndërhyrjen e Evropës në çështjet e Devletit Osman. Ata ndërtuan një karrocë në Vjenë, në brendësi të së cilës vendosën 80 kg melinit dhe 20 kg mitrail (pjesë çeliku dhe hekuri), dhe e programuan kohën e shpërthimit të bombës për një minutë e 42 sekonda, që ishte dhe koha që i duhej sulltanit të dilte nga xhamia për faljen e së Xhumasë, dhe të shkonte në karrocën e tij, gjatë *Xhuma Selamllëgë (selamliḡı)* (përshëndetjes të së Xhumasë). Ndërkohë që, sulltani doli nga Xhamia Hamidije, më 18 Xhumade'l Ula 1323/21 korrik 1905, pas *salatul Xhuma*, ai qëndroi për të biseduar me Shejhulislamin, duke e vonuar kthimin e tij drejt karrocës, dhe bomba shpërtheu me aq zhurmë të madhe sa që u dëgjua në çdo cep të Stambollit.²⁶⁸ Sulltani

268 Danişmend, IV, fq. 349-350.

e kuptoi nga zhurma, tymi i madh dhe nga copat që fluturonin në ajër se kishte ndodhur një ngjarje e tmerrshme, por ai nuk tregoi asnjë shenjë frike apo alarmi, vetëm pyeti: çfarë ndodhi? Ai mori frerët dhe e ngau vetë njëerën nga karrocat, derisa mbërriti dhe hyri në Çit Kiosk. Dhe, më pas, priti ambasadorët, ashtu siç e kishte për zakon, dhe bisedoi me ta për 20 minuta. Ambasadorët i thanë pashait përkthyes se ata e gjetën sulltanin me pamjen e tij të natyrshme të fytyrës.”²⁶⁹ Në këtë ngjarje pati 26 viktima në njerëz, shumë të plagosur, karroca që u shkatërruan dhe shumë kuaj u vranë.

Sulltan Abdylhamidi dhe liria


Për sa i përket Sulltan Abdylhamidit, “liria” për të cilën luftonin Turqit e Rinj ishte një “armë shkatërrimtare për Devletin.” Për arsye se, sipas fjalëve të tij, “dhënia e lirisë ishte njësoj sikur t’i jepje një armë një njeriu që nuk dinte si ta përdorte atë. Ai njeri mund të vriste me atë armë babain, nënën, vëllezërit madje edhe veten. Pra, ishte e nevojshme që vendi të përgatitej për liri përpara se kjo t’iu jepej, dhe unë po përpiqem të arrij një gjë të tillë; mënyra më e mirë për të arritur këtë objektiv është përmirësimi i arsimit dhe unë po ndërtoj shkolla.”²⁷⁰ “Për Abdylhamidin, as “Osmanizmi” që ai kishte miratuar gjatë shpalljes së Kushtetutës, nuk kishte rëndësi. **Thelbi i çështjes për të ishte Islami, hallka e vetme e fortë që shërbente si lidhëse midis muslimanëve dhe Devletit Osman.**”²⁷¹ Citimi i mësipërm është marrë nga historiani turk, Enver Zija Karal, i cili, zakonisht, nuk ishte përkrahës i Abdylhamidit. Është me të vërtetë një fakt interesant të theksohet: se ngjarjet në vazhdim vërtetuan se Sulltan Abdylhamidi ishte mendjemprehtë dhe se kishte të drejtë; Devleti Osman shikohej si një “Fuqi e Madhe” (shikohej ndër *dyvel-i mu’azemme*/shtetet e mëdha), edhe pse

269 Tahsin Paşa, *Abdülhamit ve Yıldız Hatıraları*, Stamboll 1931, fq. 203.

270 Karal, *vepër e cituar*, VIII, fq. 537.

271 Karal, *vepër e cituar*, VIII, fq. 538.

kishte pika të dobëta dhe problemet e veta, por pas të ashtuquajturës “liri”, vetëm 10 vite ishin të mjaftueshme për shkatërrimin e tij.



Stacioni Hekurudhor osman në el-Medineh el-Munevvere (Medinën e Shkëlqyer)

Sulltan Abdylhamidi u përpoq nëpërmjet premtimeve që t'i ndërgjegjësonte anëtarët e shoqërisë Ittihad ve Terakki, që ndodheshin në disa qytete të Evropës dhe në Kajro. Disa prej tyre u kthyen dhe u punësuan në shërbimin e nëpunësit zyrtar. Por, ideja e “lirisë” u kthye në një “idhull” për inteligjencën osmane. Shtetet evropiane i mbështetën këta njerëz naivë, që besonin se vetëm nëpërmjet shpalljes së kushtetutës, evropianët do të hiqnin dorë nga projektet e tyre për ndarjen e territorit osman.²⁷²

Duke punuar sipas metodave masone dhe taktikave komplotuese, shoqëria Ittihad ve Terakki arriti të siguronte përkrashjen e oficerëve të ushtrisë së re në Rumeli, ku sulltani kishte dërguar më të mirët, për shkak të rëndësisë të kësaj zone. Mareshali **Shemsi Pasha** u dërgua në Manastir për të shtypur veprimet e bandave rebele që kryheshin nën drejtimin e

272 Danişmend, IV, fq. 360.

oficerëve të ushtrisë, ku ai u vra në 7 Xhumadel Ahire 1326/7 korrik 1908. Mareshal **Osman Fevzi Pasha** zuri vendin e tij, por ai u rrëmbye nga oficerët dhe u trajtua me shumë respekt prej tyre, pasi ai deklaroi fuqimisht se ishte në favor të shpalljes së kushtetutës.²⁷³ Ndërkohë telegrame të shumta i drejtoheshin sulltanit nga Rumelia, me shprehje jashtëzakonisht respektuese, por edhe të vendosura për shpalljen e kushtetutës. Ata deklaroi se jo vetëm ushtarakët, por edhe shitësit, dhe të gjithë njerëzit, ishin të vendosur ta shikonin kushtetutën e shpallur.²⁷⁴ Në atë kohë, Sulltan Abdylhamidi mbushte 66 vjeç dhe ishte në pushtet që prej 32 vitesh, një arsye kjo që tregonte se ishte tashmë i lodhur.²⁷⁵ Për këtë arsye, nën kërcënimin dhe shantazhin e Shoqërisë Ittihad ve Terakki, ai u detyrua të shpallte për të dytën herë Administrimin Kushtetutës, më 23 korrik 1908. "Kur më në fund u shpall Kushtetuta, Revolucioni i Turqve të Rinj ishte një nga ngjarjet më të çuditshme në histori. Ishte një ngjarje e paplanifikuar, të paktën për sa i përket mënyrës dhe kohës kur shpërtheu, nuk ndodhi me të vërtetë dhe nuk arriti ta rrëzonte Abdylhamidin nga froni. Por, ky revolucion e detyroi atë të thërriste Parlamentin dhe për arsye praktike të hiqte dorë nga një pjesë e madhe e kompetencave të tij."²⁷⁶

Më 3 prill 1909 u zhvillua një revoltë e dhunshme në Stamboll, kundër Shoqërisë Ittihad ve Terakki që kërkonte shkarkimin e Ahmed Rizait, nga kryesia e Asamblesë dhe vendosjen e një muslimani të vërtetë në këtë post. Kryengritësit sulmuan Asamblenë dhe ndërkohë që anëtarët ishin duke u arratisur, dy njerëz të pafajshëm mbetën të vvarë, pasi gabimisht u menduan se ishin Ahmed Rizai dhe Hysejin Xhahidi, ky i fundit një shkrimtar dhe gazetar i famshëm. Ittihad ve Terakki nuk ishte vendosur mirë në Stamboll dhe për këtë arsye anëtarët e saj u arratisën nga qyteti. Qeveria u tërhoq dhe fuqia mbeti në duart

273 Danişmend, IV, fq. 361.

274 Tahsin Paşa, *vepër e cituar*, fq. 263.

275 Danişmend, IV, fq. 362.

276 S. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, fq. 266.

e sulltanit. Ai emëroi Ismail Kemalin në kryesinë e Asamblesë. Oficerët e lartë të ushtrisë osmane maqedonase u mbledhën nën drejtimin e **Mahmud Shevket Pashait** dhe u betuan për të rivendosur ligjin, dhe rregullin. Ata u vetëquajtën "*Hareket Ordusu*" (Ushtria Operative) dhe u nisën drejt Stambollit me tren. Por kur parlamentarët u takuan me ta në stacionin Jeshilkoj (Yeşilköy), ndodhi një zhvillim tjetër: ata vendosën tashmë të rrëzonin vetë sulltanin. Nga ana tjetër, duket se të gjitha këto ngjarje ishin planifikuar dhe inskenuar nga disa grupe.

17.1 Shfronësimi i sulltanit

Kuvendi u mbledh më 27 prill 1909 dhe mori vendimin të shfronësonte sulltanin. Abdylhamidi u dërgua menjëherë në Selanik me tren.²⁷⁷ Midis katër përfaqësuesve që i sollën lajmin e keq Halifit-Sulltan, dy prej tyre ishin jomuslimanë: **Emanuel Karaso (Emmanuel Carasso)** (një hebre) dhe **Arami** (një armen). "Veprimi më i keq që kreu Komiteti Ittihad ve Terakki ishte ky mënjanim i Abdylhamidit, që ishte mjeshtër i diplomacisë evropiane, me një përvojë 32-vjeçare. Ambasadori britanik, **Nikolas o'Konor (Nicolas o'Connor)**, është cituar të ketë thënë se gjithë vendet evropiane ishin të gatshëm për t'u lutur për Abdylhamidin, në mënyrë që të shmangnin mundësinë e shpalljes së një lufte botërore. Ambasadori francez, **Moris Bompar (Maurice Bompard)**, deklaroi se nuk kishte asnjë diplomat tjetër të kalibrit të tij në asnjë shtet të Evropës."²⁷⁸

277 Po aty, fq. 282.

278 Danişmend, IV, fq. 379.



Sulltan Abdylhamidi II

Abdylhamidi u dënua me arrest shtëpie në vilën e madhe Alatini në Selanik, por u soll sërish në Stamboll në vitin 1912, gjatë Luftës Ballkanike, dhe qëndroi në Pallatin Bejlerbej, deri sa ndërroi jetë më 10 shkurt të vitit 1918. Ndërkohë që qëndroi në këtë vend, **Enver Pasha**, njëri prej tre udhëheqësve të Ittihad ve Terakki e vizitonte shpesh atë; ish-sulltani me përvojë kishte vërejtur se ai “do të bëhej një kolonel i mirë”.

Ndërkohë që prijësit e Ittihad ve Terakki ishin të angazhuar në fushatën zgjedhore, evropianët i shkaktuan goditje të rënda Devletit Osman tashmë të rrënuar dhe të pafuqishëm. Austria aneksoi Bosnjë e Hercegovinën më 5 tetor 1908. Bullgaria u shpall vend i pavarur dhe Greqia pushtoi Kretën, e cila u zbraz nga fuqitë evropiane më 27 korrik. Devleti Osman iu drejtua për ndihmë garantuesve dhe nënshkruesve të Traktatit të Berlinit, por pa dobi. Më pas, Devleti u përpoq t’i zgjidhte vetë problemet, duke nënshkruar një traktat me Austrinë,

nëpërmjet të cilit pranoi aneksimin austriak të Bosnjë e Hercegovinës, në këmbim të qytezës së Novi Pazarit. Austria, nga ana e saj, do t'i paguante Devletit dëmshpërblimet e luftës. Më 19 prill 1909, u nënshkrua edhe një traktat me Bullgarinë, sipas të cilit sulltani mori kontrollin e institucioneve muslimane në Bullgari dhe në Bosnjë e Hercegovinë, dhe në to emëroi drejtues fetarë (*kadinj* dhe *muftinj*). Austria dhe Bullgaria garantuan se do t'i përkrahnin financiarisht shkollat muslimane dhe xhamitë në vendet e tyre.

17.2 Sulltan Mehmed V Reshad 1909-1918

Mehmed Reshad, djali i Abdylmexhidit, zuri fronin e Halifit-Sulltan më 27 prill 1909. Në vitin 1910, shpërtheu një kryengritje në Shqipëri. Kjo kryengritje ishte drejtuar fillimisht nga katolikët, por më pas edhe muslimanët shqiptarë u bashkuan me ta. Sulltan Reshadi shkoi në Kosovë, në qershorin e vitit 1911, për të qetësuar situatën dhe shpalli një amnisti të përgjithshme. Kryengritja përfundoi më 4 shtator 1912.²⁷⁹



279 Stanford Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, fq. 288-293.

Meshhed-i Hydavendingar, në Kosovë

Lufta e Tripolit 1911

Britania dhe Franca pushtuan pjesën më të madhe të tokave muslimane në Afrikën e Veriut dhe atmosfera politike ishte e favorshme për një aventurë italiane në Tripolitania (Libi), ku kishte dhe shumë tregtarë italianë. Franca ishte e gatshme që në vitin 1900 të pranonte epërsinë e Italisë mbi Tripolitaninë, në këmbim të pranimit nga ana e Italisë të pushtimit francez të Marokut. Në vitin 1909, Italia i dha mbështetjen e saj kërkesës këmbëngulëse të Rusisë për liri lundrimi në Ngushticat e Stambollit dhe Çanakkalesë (Dardaneleve), me shpresën se kjo do ta bindte Rusinë të mbështeste pushtimin italian në Tripolitani.²⁸⁰

Qeveria italiane i shpalli luftë Tripolitanisë në 29 shtator 1911, me pretekstin se nënshtetasit e saj trajtoheshin keq atje. Trupat italiane pushtuan brigjet, por nuk arritën të futeshin më tej, pasi **Sulltan Abdylhamidi**, duke e ditur qëllimin e Italisë mbi Tripolin, kishte krijuar një njësi prej 5.000 ushtarësh të përbërë nga *kulloglije* (kuloğlu: të lindur nga martesë midis ushtarëve turq dhe grave të vendit) dhe vullnetarë të popullsisë lokale. Gjithashtu, edhe **Rexheb Pasha** kishte formuar një njësi kalorësiake prej 1.200 kalorësish të përbërë nga *kulloglije*, duke siguruar në këtë mënyrë mbrojtjen e vendit në rast të ndonjë sulmi të papritur italian, deri sa të mbërrinte ushtria osmane.²⁸¹ Disa oficerë të ushtrisë osmane shkuan atje dhe u bashkuan me lëvizjen për rezistencë të vendasve. **Kushçbashë Eshrefi**, një nga themeluesit e *Teshkilat-i Mahsusa* (organizatë forcash speciale) u vendos në Kajro në fshehtësi. Ai zotëronte gjuhën arabe dhe organizoi transferimin e oficerëve osmanë në Libi, ku shkoi dhe vetë. Në radhët e këtyre oficerëve vullnetarë ishin **Enveri**, **Mustafa Kemali**, **Fet'hiu** (Okjari), **Nuriu** (Xhonker), **Aliu** (Çetinkaja), **Omer Naxhiu** (hatib). Këta oficerë shiheshin si

280 Po aty, fq. 289.

281 Tahsin Paşa, *vepër e cituar*, fq. 278.

oficerë me leje, pasi Devleti Osman nuk ishte “zyrtarisht” në luftë me Italinë. Ata shkuan në Libi si vullnetarë dhe morën pjesë në rezistencë.²⁸²

Pasi nuk arriti të pushtonte Libinë, Italia e provoi fuqinë e saj në Dardanele dhe bombardoi Bejrutin. Italia pushtoi edhe Rodosin, dhe 12 ishuj të tjerë në Detin Egje, Dodekanezet. Këto humbje të rënda ushtarake e detyruan Devletin Osman të ulej në tryezën e bisedimeve dhe të nënshkruante një traktat me Italinë më 15 tetor 1912. Devleti Osman pranoi sovranitetin e Italisë në Libi, por *hutbeja* në xhamitë e Libisë vazhdoi të mbahet në emrin e Halifit, duke e mbajtur në këtë mënyrë një lidhje me Islamin. Një *naib* (zëvendës) do të qëndronte si përfaqësues i sulltanit në Libi dhe Italia pranoi t’i dorëzonte Rodosin dhe 12 ishujt e Dodekanezit Devletit Osman. Megjithatë, pak kohë pas kësaj, shpërtheu Lufta Ballkanike dhe Italia nuk i mbajti premtimet e saj.²⁸³ **Fazëll Beu**, një nga anëtarët e delegacionit osman, që ishin dërguar për nënshkrimin e Traktatit të Ushit me Italinë, e vizitoi Ministrin e Luftës, **Nazëm Pashanë**. Ndërkohë që po bisedonin për nënshkrimin e këtij traktati, Fazëll Beu i tha Nazëm Pashait: “Mes nesh ka tradhtarë, gjatë debatit, unë u përpoqa të arrija disa koncesione nga të deleguarit italianë dhe ata pranuan. Por gjatë seancës së dytë, pashë se kishin ndryshuar. Kur unë pyeta se cili ishte shkaku, ata u përgjigjën se ambasadori i tyre në Stamboll kishte biseduar me Ministrin e Punëve të Jashtme, **G. Norodongëjan**, i cili i kishte thënë ambasadorit se “ne jemi në një situatë të rëndë dhe jemi të detyruar të japim gjithçka që dëshironi, këmbëngulni në kërkesat tuaja dhe mos e humbim rastin, dhe se ambasadori italian në Stamboll ia përcolli këtë informacion delegacionit italian.”²⁸⁴

282 Karal, *Osmanlı Tarihi*, Ankara 1966, IX, fq. 276-277.

283 S. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, II, fq. 293.

284 Tahsin Ünal, *Türk Siyasi Tarihi*, Ankara 1978, fq. 403-404, cituar nga Nuri Ünlü, *İslam Tarihi*, Stamboll, 1944, vëllimi III, fq. 197.

Luftat Ballkanike 1912-1913

Sulltan Abdylhamidi II, një shtetar i mençur dhe i aftë, shfrytëzoi me zgjuarsi dallimet fetare midis grekëve dhe bullgarëve, ndërsa qeveria pa përvojë e Ittihad ve Terakki shpalli në korrik të vitit 1910, një dekret që iu dha një zgjidhje diferencimeve mes tyre. Ndërkohë që prej kohësh ekzistonin ndryshime historike të mëdha midis grekëve dhe bullgarëve për disa kisha dhe shkolla në Maqedoni, që nga ndarja e Kishës Bullgare nga Kisha Ortodokse Greke, në një masë të tillë që Patriarkati Grek e shkishëroi Kishën Bullgare.

Për shkak të shtypjes nga Ittihad ve Terakki, si dhe të nxitjes nga shtetet evropiane, në Shqipëri shpërthyen përsëri kryengritjet. Ittihad ve Terakki dërgoi në Shqipëri një forcë të armatosur ushtarake, por disa nga oficerët e kësaj force formuan një grup të quajtur *halaskaran* (shpëtimtarët) dhe u shpërngulën në pjesën kodrinore, ashtu sikurse kishin vepruar edhe Enveri dhe Nijaziu, nga Ittihad ve Terakki, në vitin 1326/1908. Anëtarët e këtij grupi në Stamboll, ushtruan shumë presion mbi qeverinë. Për këtë arsye, **Said Pasha** dha dorëheqjen në 1 Sha'ban 1330/16 korrik 1912, dhe për pasojë edhe Ittihad ve Terakki hoqi dorë nga pushteti.²⁸⁵

Qeveria osmane shkarkoi ushtarët e stërvitur mirë të Batalionit 120 në Rumeli, për shkak të garancisë së rreme që Rusia i kishte dhënë Ministrsit osman të Punëve të Jashtme, Norodongëjan Efendiut. Nga ana tjetër, Ittihad ve Terakki synonte disfatën e ushtrisë osmane në Rumeli, në mënyrë që të vinte sërish në pushtet.

Forcat e Greqisë, Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi, pasi kishin zgjidhur problemet falë dekretit të korrikut të vitit 1910, u bashkuan dhe sulmuan territorin osman në tetor të vitit 1912. Ata pushtuan territore të gjera në Evropën osmane; ish-Ministri i Brendshëm i Ittihad ve Terakki, **Talat Beu**, u kthye në një

285 Danişmend, IV, fq. 388.

ushtar vullnetar, shkoi në Edrene dhe u përpoq të propagandonte në radhët e ushtarëve të tjerë, për t'i bindur ata që të mos luftonin. Me pak fjalë, organizata Ittihad ve Terakki ishte e angazhuar për disfatizëm!

Shykri Pasha e mbrojti Edrenenë për 155 ditë, por më pas qyteti ra. Mbreti **Ferdinand** ia ktheu shpatën këtij heroi.²⁸⁶ **Lufta e Dytë Ballkanike** do të fillonte midis shteteve aleate, vetëm 52 ditë më pas, për shkak të dallimeve; Rumania, Greqia, Serbia dhe Mali i Zi luftuan kundër Bullgarisë. Edhe Devleti Osman hyri në luftë dhe rimori Edrenenë.²⁸⁷ Ushtria osmane rimori vetëm disa pjesë të territoreve që ishin pushtuar nga shtetet aleate ballkanike, por statusi i ardhshëm i këtij territori mbetej i paqartë.

Nga ana tjetër, anëtarët e Ittihad ve Terakki vendosën lidhjet me Ministrin e Luftës, **Nazëm Pashanë**, i cili njëkohësisht ishte dhe drejtuesi i *halaskaranëve* dhe i premtuan atij se nuk do të ndërhyjnë më në çështjet politike. Kështu, **Enveri** dhe **Xhemali** u emëruan në postet kyçe në Stamboll, duke marrë nën kontroll një pjesë të rëndësishme të ushtrisë në atë qytet.²⁸⁸ **Enver Beu** sulmoi *Bab-ë Ali* (ndërtesën qeveritare) më 14 Safer 1331/23 janar 1913, dhe e detyroi Sadrazamin **Kamil Pasha** të jepte dorëheqjen.²⁸⁹ Vendin e tij e zuri **Mahmud Shevket Pasha**, por edhe ai u vra. **Xhemal Pasha**, njëri nga tre udhëheqësit e Ittihad ve Terakki vendosi në Stamboll ligjin ushtarak. (Ittihad ve Terakki Komitesi) "Komiteti për Bashkim dhe Përparim caktoi njërin nga anëtarët e tij, Mehmed Sait Halim Pashanë, një princ egjiptian dhe stërnip i Muhammed Aliut, si Vezirin e Madh, si dhe 4 anëtarë të tjerë të këtij komiteti u emëruan në pozicionet kyçe të kabinetit qeveritar. Në këtë mënyrë filloi diktatura e Komitetit për Bashkim dhe Përparim ...(12 qershor

286 Danişmend, IV, fq. 391-392.

287 Danushmend, IV, fq. 406.

288 Ünlü, *vepër e cituar*, III, fq. 214.

289 S. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, II, fq. 295.

1913)²⁹⁰ duke e çuar përfundimisht Devletin Osman në një katastrofë.”

Një grup oficerësh filluan përpjekjet për të vendosur Enver Beun në postin e Ministrit të Luftës; atij iu njohën tre vite përvojë në pjesëmarrjen e tij në luftërat e Libisë dhe të Ballkanit, dhe për këtë arsye, ai u gradua menjëherë nga nënkolonel në rangun e pashait, dhe në të njëjtën ditë u emërua edhe Ministër i Luftës, më 3 janar 1914. Izet Pasha kishte dhënë ndërkohë dorëheqjen nga posti i Ministrit dhe zv/Kryekomandantit. Edhe Xhemal Beu pati të njëjtat favore, duke u ngritur në rangun e pashait. Këto dy figura, nxorën në pension të gjithë oficerët e lartë, që kishin më shumë përvojë se vetë ata me pretendimin se ishin duke rinovuar dhe rigjallëruar ushtrinë dhe flotën. Dhe, pas kësaj, administrata u përqendrua në duart e Enver Pashait, i cili ishte martuar me Naxhije Sulltanen, vajzën e Sylejman Efendiut, që ishte një nga djemtë e Abdylmexhidit, dhe që u bë dhëndër i Familjes Osmane.²⁹¹

Lufta e Parë Botërore 1914-1918

Me mbarimin e Revolucionit Industrial dhe me dështimin e fuqive evropiane për ndarjen e burimeve, dhe pasurive bazë botërore, ndryshimet, diskutimet dhe konfliktet mes tyre u thelluan. Kjo e përshpejtoi dhe e bëri të paevitueshme një luftë në shkallë të gjerë. Duke qenë se fuqitë evropiane garonin kryesisht për përvetësimin e territoreve osmane, rruga më e këshillueshme që mund të ndiqte Qeveria osmane, ishte të përpiqej në maksimum që të mbante një qëndrim asnjanes dhe të qëndronte jashtë konfliktit. Konflikti ishte krijuar midis fuqive industriale, për të ndarë dhe për të plaçkitur burimet botërore, Devleti Osman nuk ishte në pozitën për të pretenduar dhe nuk kishte as burimet e duhura financiare, ushtarake dhe politike për të arritur një pozicion të tillë.

290 Po aty, fq. 296.

291 Ünlü, *vepër e cituar*, III, fq. 221.

Britania, Franca dhe Rusia krijuan Antantën Trepalëshe ndërsa Gjermania, Austria dhe Italia krijuan në kundërpërgjigje një aleancë të quajtur Fuqitë Qendrore. Megjithatë, Italia deklaroi qëndrimin e saj asnjanes, duke u tërhequr nga fuqitë e tjera aleate, më 1 gusht 1914.²⁹² Shkaku kryesor i fillimit të Luftës së Parë Botërore ishte vrasja e princit të kurorës Austro-Hungareze, në Saraj-Bosna (Sarajevë), më 28 qershor 1914. Ittihad ve Terakki kishte tre liderë: Enverin, Talatin dhe Xhemalin. Ndërkohë që Enveri ishte në favor të Gjermanisë, prijësi i tretë, Xhemal Pasha, preferonte më shumë asnjansimin, ndoshta edhe mbështetjen e fuqive të Antantës, edhe pse kjo në atë kohë nuk ishte në interes të tyre. Megjithatë, Said Halim Pasha dhe Enver Pasha nënshkruan një traktat të fshehtë me Gjermaninë më 2 gusht 1914.²⁹³ Britania nuk kishte pranuar më parë të nënshkruante një traktat për t'i dorëzuar Devletit Osman dy anije: anijen *Sulltan Osman* dhe anijen *Reshadije*, edhe pse kishte paguar për to. Dy luftanije të tjera gjermane, *Göben* dhe *Breslau*, u ndoqën nga anijet luftarake britanike nga Mesdheu deri në Ngushticën e Dardaneleve, dhe Enver Pasha i pranoi ato në ujërat territoriale osmane, më 11 gusht 1914. Për të kamufluar këtë veprim, këto anije u deklaruan si anije të blera nga osmanët dhe emrat e tyre u ndryshuan në *Javuz* dhe *Midil-li*, ndërsa **Admirali gjerman Sushon (Souchon)** dhe ekuipazhi i tij veshën uniformën osmane. Gjermania synonte që Devleti Osman të hynte zyrtarisht në luftë në anën e saj, për t'i angazhuar në këtë mënyrë armiq të e saj, rusët në Odesa, dhe britanikët në Kanalin e Suezit. Nga ana tjetër, Britania dhe Rusia natyrisht synonin të siguronin asnjansimin e osmanëve, duke iu ofruar atyre garancinë e sigurimit të integritetit dhe pavarësinë e të gjitha territoreve të tyre. Më 14 shtator 1914, *Bahrije Naziri* (Ministri i Forcave Detare), Xhemal Pasha, i dha urdhrin Admiralit Sushon për t'u nisur drejt Detit të Zi dhe për të bombarduar çdo anije

292 Danişmend, *vepër e cituar*, IV, fq. 418.

293 Stanford Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, II, fq. 310.


ruse që mund të ndeshnin gjatë rrugës, por kjo u ndalua nga qeveria osmane. Më 11 tetor, ambasadori gjerman i propozoi qeverisë osmane 2 miliard *kurush*, nëse ata hynin në luftë në mbështetje të aleancës së Fuqive Qendrore, dhe faktikisht kjo shumë u pranua në 21 tetor. Enver Pasha dhe miqtë e tij anuluan kapitulacionet²⁹⁴ më 7 shtator, duke iu dhënë një goditje të rëndë interesave ekonomike të Fuqive të Antantës.

Pa u këshilluar me Ministrat e tjerë të kabinetit osman, Enver dhe Xhemal Pasha, i dhanë edhe një herë urdhrin Admiralit Sushon për të sulmuar rusët në Detin e Zi, urdhër që u zbatua më 29 tetor 1914, duke mbytur disa nga anijet ruse. Nga ana e saj, Rusia i shpalli luftë Devletit Osman më 2 nëntor 1914, dhe kjo u ndoq edhe nga Britania dhe Franca. Për më tepër, Britania kishte aneksuar Qipron, dhe njëkohësisht i kishte dhënë fund sundimit osman të Egjiptit, që ishte shpallur më 18 dhjetor 1914 protektorat i Britanisë. **Halifi-Sulltani** osman **Reshadi**, më 11 nëntor 1914, shpalli **xhihadin** (Luftën e Shenjtë) kundër Fuqive të Antantës, duke iu bërë thirrje të gjithë muslimanëve, veçanërisht atyre në Britani dhe Rusi, që të bashkoheshin në këtë fushatë kundër jobesimtarëve.²⁹⁵ Por, britanikët në Indi dhe Egjipt, dhe rusët në Azinë Qendrore arritën ta shtypnin thirrjen e sulltanit për një lëvizje Pan-islame. Megjithatë, thirrja e sulltanit për xhihad pati më shumë sukses nga ç'mund të pranohet, pasi kjo thirrje i detyroi fuqitë të vendosnin garnizone të mëdha në këto vende, në mënyrë që të parandalonin kryengritjet e *rajës* muslimane kundër fuqive të Antantës.²⁹⁶

294 Disa nga privilegjet që Sylejmani i Madhërisëm iu kishte dhënë tregtarëve francezë të quajtur *imtijazat* në shenjë të përkrahjes së tij ndaj Francës kundër Karlit V, Perandorit të Spanjës dhe Gjermanisë, dhe në këtë mënyrë të parandalonte bashkimin e evropianëve kundër Devletit Osman, për shkak të dobësisë së administratës osmane, ishin kthyer në "kapitulacione" me kalimin e kohës.

295 S. Shaw dhe Ezel Kural Shaw, vepër e cituar, II, fq. 312.

296 Po aty, II, fq. 319.



Suvenir i dy muslimanëve, që luftuan trupat ushtarake të Australisë dhe Zelandës së Re në Australi, në përgjigje të thirrjes së Halifit për Xhihad
Suvenirët janë të ekspozuara në muzeun e Australisë

Hyrja e Devletit Osman në Luftën e Parë Botërore shënoi fundin e Devletit. Pasi kishte filluar të humbiste dinamikën e tij, Devleti ishte përpjekur të mbijetonte që nga viti 1826, duke ndërmarrë një sërë reformash të pastudiuara mirë dhe duke i vënë fuqitë e mëdha ndërkombëtare në lojë me njëra-tjetrën. Sulltan Abdylhamidi pati mjaft sukses në zbatimin e politikës së tij të jashtme. Por, prijësit e Ittihad ve Terakki, të cilët, edhe pse ishin të vendosur në synimet e tyre, nuk kishin arritur të krijonin një baraspeshë midis aftësive dhe ambicieve të tyre, e tërhoqën Develtin drejt katastrofës.

Rusia sulmoi në nëntor të vitit 1914. Edhe pse osmanët arritën ta zmbropsnin këtë sulm, dhe u hodhën në kundërsulm ndaj Rusisë më 21 dhjetor, Rusia u hodh në një ofensivë në shkallë të gjerë në janarin e vitit 1915, që shkatërroi ushtrinë osmane dhe i hapi rrugën përparimit të ushtrisë ruse drejt Anadollit Lindor.

Flotat më të fuqishme detare të asaj kohe, britanike dhe franceze së bashku me luftanijet ruse u përpoqën të hynin në Ngushticën e **Çanakkalesë** (Dardaneleve), por ata pësuan një disfatë të madhe më **18 mars 1915**, gjatë të cilës pati dhe shumë

viktima. Lufta vazhdoi më tej në Galipoli ku zbarkuan, por përfundimisht u detyruan të tërhiqeshin. Nëse ata do të kishin arritur të merrnin Ngushticën e Dardaneleve, ata do të kishin pushtuar, më pas Stambollin, kryeqytetin osman, dhe përpjekjet e Gjermanisë për të avancuar drejt lindjes do të ishin paralizuar. Për më tepër, kjo do t'i kishte dhënë mundësinë Britanisë të shtrinte zotërimin e saj edhe në Mesopotami, dhe të konsolidonte posedimet e saj në Egjipt, ndërkohë që Aleatët mund të kishin dërguar municione dhe t'i kishin ardhur në ndihmë Rusisë nëpërmjet Detit të Zi. Luftërat në brigjet e Ngushticës së Dardaneleve iu kushtuan shtrenjtë osmanëve: 250.000 viktima nga të cilët 50.000 ishin oficerë.

Forcat britanike avancuan edhe drejt frontit të Irakut, me shpresën për t'iu bashkuar forcave ruse në Kaukaz. Edhe pse ushtria osmane iu shkaktoi atyre humbje në **Kutu'1 Amareh** në prill të vitit 1916, ata morën përforcime dhe pushtuan Bagdadin më 11 mars 1917.²⁹⁷

Edhe ushtria osmane avancoi drejt Kanalit të Suezit në vitin 1915. Trupat britanike u mundën dy herë në Gaza, por do-lën fitimtare në betejën e tretë, të vitit 1917. Ndërkohë, britanikët korrptuan në vitin 1916 **Sherif Hysejinin** e Mekës dhe e bindën atë që të tradhtonte Halifin Osman, dhe të ngrihej në revoltë kundër tij. T.E. Lorens (Lawrence), i diplomuar në Universitetin e Oksfordit, folës i rrjedhshëm i gjuhës arabe, dhe për të cilin ishin përhapur fjalë se ishte një fëmijë ilegjitim dhe spiun homoseksual, luajti një rol të rëndësishëm në këtë kryengritje, dhe ndoshta ishte ai truri i saj.²⁹⁸ Rusët pushtuan Anadollin Lindor, por Devleti Osman arriti t'i shpëtonte pushtimit të tyre,

297 Shiko posttë-shënimin 296.

298 Duhet theksuar në këtë rast se shetet evropiane e përdorën nacionalizmin arab kundër Devletit Osman. Por, kur ata hynë në Damask, komandanti i krishterë shkoi te varri i **Salahuddin Ejjubit**, që kishte shkatërruar ushtritë Kryqtare të shek. të 12-të, i dha një shkelm varrit të tij dhe tha: "Ngrehu O Saladin, ne erdhëm!" Themelimi i Shtetit **Religjuz** të Izraelit është një shpërblim tjetër (!) që britanikët i kanë dhuruar nacionalizmit arab.

për shkak të shpërthimit të Revolucionit Komunist të vitit 1917 në Rusi. Një çështje interesante është edhe fakti i përhapjes së fjalëve për ardhjen e **Leninit** në Rusi për këtë revolucion, pasi mendohej se ishte asistuar, madje edhe organizuar, nga *Teshkilat-ë Mahsusa* (organizata speciale) osmane, por kjo është një çështje për të cilën është e nevojshme të kryhen studime të veçanta.

17.1 Mehmedi VI Vahideddini

Më 28 qershor 1918, Sulltani Mehmed Reshadi ndërroi jetë dhe u pasua nga Mehmed Vahideddini, në periudhën e sundimit të të cilit, britanikët dhe francezët ndërmorën disa sulme kundër osmanëve në fronte të ndryshme. Trupat osmane luftuan me trimëri, por numri i ushtrive armike ia kalonte në numër ushtrisë osmane dhe armatimet e tyre ishin më të përparuara dhe superiore. Devleti Osman luftoi në shumë fronte gjatë Luftës së Parë Botërore: në Kaukaz, Ngushticën e Dardaneleve, Palestinë dhe Sina, Irak, Izmir dhe Antalja, Galici, Rumani dhe Dobruxha, dhe në Hixhaz, dhe në përfundim pati 3 milionë viktima, dhe arriti kolapsin duke iu nënshtruar **Armëpushimit** poshtërues **të Mondros**, që iu imponua **më 30 tetor 1918**. Dhe trupat osmane filluan të dorëzonin armët e tyre. Ndërkohë, Greqia iu bashkua forcave Aleate në momentin e fundit. Stambolli u pushtua nga fuqitë e Antantës.²⁹⁹ Devleti Osman pushoi së ekzistuari zyrtarisht³⁰⁰ më **4 nëntor 1922** me dorëheqjen e kabinetit të Tefvik Pashait.

299 Stanford Shaw dhe Ezel Kural Shaw, *vepër e cituar*, II, fq. 328.

300 Po aty, fq. 365.



Shatërvani i Abdylhamidit II

PËRFUNDIMI

Tashmë duhet të jetë e qartë që literatura perëndimore mbi Devletin Osman, sado akademike të duket në shkrimet e saj, përbën një monument të madh shtrebbërimi. Përderisa “... për një kohë shumë të gjatë historia e otomanëve është studiuar pa marrë nën shqyrtim *asnjë* nga burimet otomane, gjë që ka sjellë shtrebbërimet dhe gabime të rënda në historinë e tyre. Historia e Francës nuk do të konsiderohej e saktë dhe e balancuar nga pikëpamja metodologjike, nëse do të shkruhej mbi bazën e vëzhgimeve angleze apo italiane.”³⁰¹ Ky qëndrim metodologjikisht i GABUAR është mbajtur për historinë osmane.

Osmanët u ngritën si një fuqi e madhe islame në shekullin e 14-të dhe në shekullin e 16-të u kthyen në “superfuqinë” (numrin një) botërore dhe u përballën në mënyrë të suksesshme

301 Shaw, Stanford J. & Ezel Kural Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, Cambridge University Press: 1992, II, X. Tehksimi është shtuar.

me Evropën dhe Iranin. Që në fillimet e tyre, ata dëshironin t'i bashkonin të gjithë muslimanët nën Hilafetin e tyre. **Sulltan Muradi I** (1362-1389) ishte Halifi *de-fakto* dhe u njoh si i tillë edhe nga disa fuqi muslimane, ndërkohë që djali i tij, **Jëlldërëm Bajezidi**, iu shkaktoi humbje forcave të bashkuara evropiane dhe përfaqësoi "fuqinë supreme" të Islamit. **Fatih Mehemedi** (1451-1481) ishte Halif,³⁰² dhe stërnipi i tij, **Javuz Sulltan Selimi**, arriti të kombinonte Hilafetin "aktual" dhe "zyrtar". Deri në ditët e fundit të tij, Devleti Osman përfaqësoi Hilafetin Sunnit, dhe pas rënies së Devletit dhe Sulltanatit, Republika e Turqisë vazhdoi ta mbante edhe për pak kohë Hilafetin. **Megjithatë, Asambleja e Madhe Kombëtare e Turqisë e shfuqizoi Hilafetin më 3 mars 1924. Sipas Hajrullah Efendisë, "një nga arritjet më të mëdha të osmanëve ishte sukcesi i tyre në bashkimin e Sulltanatit me Hilafetin, që kishin qenë për një kohë të gjatë si institucione të ndara."**³⁰³

Deri në ditët e fundit të Devletit të tyre, osmanët u angazhuan në **xhihadin** e tyre në Evropë, por ata u ndeshën me kundërvënien e pothuajse të gjitha fuqive evropiane, që synonin t'i kthenin ata mbrapsht në Anadoll, ndoshta edhe jashtë tij.

Xhihadi përfaqësonte gurin themeltar të politikës së Devletit Osman, që u ndoq dhe u zbatua me entuziazëm përgjatë shekujve. Devleti Osman, për këtë arsye, nuk duhet të shihet si një shtet i izoluar nga paraardhësit e tij, nga Devleti Selçuk. Përkundrazi, Sulltani selçuk i dha Osman Gaziut "*beratin*" me të cilin u emërua si "*bej*". Ai e nxiti atë të zbatonte Islamin në çdo fushë të jetës dhe të kujdesej për "*ra'ijjetin*". **Në këtë mënyrë, Devleti Osman ishte një vazhdim i Devletit Selçuk, që ishte vazhdim i Hilafetit Abasid. Të gjitha institucionet e tij sociale, ekonomike, arsimore dhe juridike u përshtatën sipas**

302 Solakzade Mehmed Hemdemi, *Solakzade Tarihi*, Stamboll, 1298, fq. 266, rreshti 10, dhe fq. 270, rreshti 15; Stambollit i referohet edhe si "**Daru'l-Hilafet**".

303 *Tarih-i Devlet-i Alijje-i Osmanijje*, fq. 13-14, cituar nga David Kushner, *The Rise of the Turkish Nationalism 1876-1908*, Londër: 1977, fq. 37.

modelit Selçuk, që vetë ishte i bazuar mbi Islamin. Ashtu si selçukët e Anadollit nën drejtimin e Alaeddin Kejkubadit I, osmanët arritën nivelin më të lartë të civilizimit. **Suksesi apo dështimi i një civilizimi duhet të gjykohet nga mirëqenia e popullsisë së tij. Kur një njeri është i ri, ai mund të përballlet me vështirësitë, por kur ai arrin në një moshë të thyer, ai nuk ka mundësi të përballlet me to, dhe për këtë arsye duhet t'i sigurohet rehati.** Në të vërtetë, mirëqenia e qenieve njerëzore ishte një shqetësim prioritar për Devletin Osman, që vazhdoi të ishte i tillë edhe gjatë periudhës së rënies së tij. Popujt nën administrimin osman jetonin gjatë gjithë jetës së tyre në kushte mjaft të rehatshme. Gjyshi mbetej gjatë gjithë jetës së tij "autoriteti" i shtëpisë dhe asnjë nuk mund ta kundërshtonte, duke përfshirë këtu edhe djemtë e tij të martuar. Kjo situatë mbizotëronte në territoret osmane edhe gjysëm shekulli pas rënies zyrtare të Devletit Osman. Një sjellje e tillë kaq njerëzore ndaj të moshuarve, është e paimagjinueshme për kohët "moderne", kohë në të cilën ata zakonisht jetojnë një jetë të mërzitshme dhe të vetmuar, në institucione të izoluara larg familjeve të tyre.

Devleti Osman ishte thellësisht dhe ekskluzivisht islamik. Ushtria e tij quhej "Ushtria e Islamit" dhe të gjitha institucionet e tjera veçanërisht *medresetë* e tij ishin islame. Gjuha arabe vazhdoi për më shumë se 5 shekuj të mësohej si **gjuhë e arsimit dhe e Islamit.** Osmanët përdorën kalendarin musliman (Hixhri) dhe alfabetin arab të Kur'anit për gjuhën osmanoturke. Identiteti i tyre faktikisht i kishte rrënjët e tij në Islam në një masë të madhe, siç thotë dhe David Kushner, "Osmanët e kishin identifikuar veten e tyre me Islamin ndër shekuj dhe nuk treguan interes për prejardhjen e paraardhësve të tyre, deri në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të. **Për shembull, një libër i**

botuar në vitin 1877 për shkollat e ciklit të dytë nuk e përmend prejardhjen turke të osmanëve.”³⁰⁴

Nacionalizmi shihej me shqetësim të madh si një parim kontradiktor ndaj konceptit bazë islamik të Ummetit. Sulltan Abdylhamidi II kishte paralajmëruar në vitin 1907, se nacionalizmi cenonte seriozisht entitetin muslimano-osman. Karakteri Sunnit i Devletit ishte mjaft i rëndësishëm për t’u shpërfillur. Edhe në shpalljen e **Tanzimatit** të vitit 1839, që zyrtarisht shënoi fillimin e procesit të evropianizimit, përmendej se “**Devleti Osman zbatoi Kur’anin dhe Sheriatin që në fillimet e tij dhe arriti një standard mjaft të mirë jetese dhe popujt jetonin në mirëqenie, por 150 vitet e fundit u shoqëruan nga një periudhë lëshimesh dhe dobësish, duke arritur edhe në mosrespektimin e Sheriatit dhe të ligjeve, që rezultuan në dobësimin dhe rënien e Devletit.**”³⁰⁵ Në këtë rast duhet të theksojmë se nacionalizmi ishte një fenomen shumë i vonshëm që u shfaq në Devletin Osman, dhe në fakt ai erdhi me Partinë Ittihad ve Terakki që drejtoi Devletin vetëm për një dekadë (1909-1918). Walter L. Jr. ka shkruar për Devletin Osman, në ditët e tij të fundit, si më poshtë: “Duke u përballur me sulmin e forcave që ishin krejt të reja si për Devletin, ashtu edhe për të gjithë botën, forca të tilla si nacionalizmi dhe demokracia, avulli dhe elektriciteti, filloi të shkonte dëm pak e nga pak. Perandoria Otomane ishte e fundit ndër perandoritë e mëdha³⁰⁶ të Orientit të Afërm³⁰⁷ dhe ndoshta, edhe më e fuqishmja. Asnjëherë nuk i mungoi fuqia e mjaftueshme edhe në periudhat më të këqija të

304 David Kushner, *The Rise of Turkish Nationalism 1876-1908*, Londër: 1977, fq. 29. Theksimi është shtuar.

305 E.Z. Karal, *Osmanlı Tarihi*, Türk Tarih Kurumu, Ankara: 1983, VIII, fq. 255.

306 **Nuk është e nevojshme që të ritheksojmë sërish që nuk ishte një “perandori”.**

307 “Orienti i Afërm” sipas pikëpamjes perëndimore – një aspekt tjetër i centralizimit perëndimor të globit dhe ngjarjeve.

çoroditjes, për të garantuar qenien e saj në krahasim me garuesit e saj orientalë.”³⁰⁸

Si “ajo” Fuqi Muslimane, osmanët shpëtuan Afrikën e Veriut nga katolicizmi, mbrojtën el-Haramejn esh-Sherifejn (Mekën dhe Medinën) kundër sulmit portugez dhe më pas atij britanik, dhe kontrolluan ngushticën Babel Mendeb në Jemen. Prezenca osmane në Jemen nuk ishte për arsye të përfitimit nga burimet e naftës, që do të zbuloheshin dhe do të shfrytëzoheshin më vonë, në shekullin e 20-të, por për të mbrojtur tokat e shenjta të Islamit, el-Haramejn esh-Sherifejn. Duhet të theksojmë në këtë rast se muslimani i madh **Uvejs el-Karni** (në gjuhën turke: Veysel Karani), që jetoi në Jemen gjatë periudhës së **Pejgamberit të Fundit Muahammed** (Paqja qoftë me të), është i mirënjohur në Turqinë e sotme, edhe pse nuk njihet nga shumë njerëz në Jemen. Për të është thurur edhe një himn i famshëm dhe është ndërtuar një *mekam* (një vend ku ndodhet një tyrbe simbolike) në emrin e tij në Anadoll. Në mënyrë domethënëse, kur linja hekurudhore arriti territorin osman, Devletit Osman nuk iu desh shumë kohë për të lidhur qytetin e shenjtë të Pejgamberit të Fundit (Paqja qoftë me të), me qendrën e Hilafetit. **Linja hekurudhore e Hixhazit nuk u ndërtua me fondet publike, por nga kontributet personale të popullsisë muslimane.**

Krijimi i shiitëve në Iran, në shekullin e 16-të, kishte shërbyer si një pengesë për avancimin osman drejt Evropës dhe osmanët humbën më shumë se 30 vezirë në luftërat e tyre me Evropën e krishterë, dhe Iranin shiit.

Sulltan Abdylhamidi trashëgoi një Devlet të dobët që po shpërbëhej, por ai arriti ta mbante atë të bashkuar. Ai ushtroi pushtetin absolut, por ai e përdori këtë autoritet për të shlyer një pjesë të madhe të huave me jashtë, ndërkohë që paraardhësit e tij, nuk kishin arritur të paguanin as interesat e

308 Walter Livingstone Wright, Jr., *Ottoman Statecraft: The Book of Counsel for Vezirs and Governors of Sari Mehmed Pasha, the Defterdar*, Princeton: Princeton University Press, 1935, VIII.

tyre. Për më tepër, ai i kushtoi një rëndësi të madhe edukimit dhe hapi shumë shkolla. Inteligjencia osmane e kohës ishte e kapluar me reformën kushtetuese, por kjo ishte, siç u provua dhe nga eksperimentet e hidhura, e papërshtatshme dhe e papranueshme për mjedisin osman të asaj kohe. Ittihad ve Terakki (që më vonë u kthye në Parti), ishte e themeluar nga anëtarë të kombësive të ndryshme, por asnjëri prej tyre nuk ishte me origjinë turke. Ajo mbështeti dhe përshtati, edhe pse pa sukses, nacionalizmin turk si një mjet për të mbajtur të bashkuar Devletin Osman, që ishte në rrugën e rrënimit. Disa nga prijësit e saj ishin trima dhe patriotë, por ata duhet të mbajnë të gjithë përgjegjësi për shkatërrimin e Devletit Osman pas 10 vitesh. Trimëria dhe patriotizmi nuk ishin të mjaftueshme për të "shpëtuar" Devletin, por ishte e nevojshme të bëhej një bashkërendim i aftësive të shtetarit dhe udhëheqësit. Talat Pasha, për shembull, ishte një njeri shumë i ndershëm në jetën e tij private. Është e evidentuar se edhe ushqimi që ai konsumonte ishte i njëjtë me atë që konsumonin qytetarët e thjeshtë osmanë. Por, në fund të fundit, ai ishte nëpunës zyrtar dhe nuk i kishte aftësitë, dhe talentin e nevojshëm për të qenë Sadrazami (Kryeministri) i një prej fuqive më të mëdha (e dobët, por akoma e madhe) të kohës. Enver Pasha ishte një njeri i ndershëm dhe oficer trim, i cili u martirizua në vitin 1922, ndërsa luftonte kundër ushtrisë ruse në Taxhikistan. Por, mjeshtëria në shërbimin ushtarak nuk është e mjaftueshme për të qeverisur një shtet të madh të shoqëruar nga probleme të ndërlikuara si ato të osmanëve. Kur e takoi për herë të parë, shtetari me përvojë, ish-Sulltan Abdylhamidi II, tha në mënyrë profetizuese: "Ai do të kishte qenë një kolonel i mirë."³⁰⁹ Në të vërtetë, Enver Pasha mori postin e Ministrit të Luftës dhe të Kryekomandantit të gjithë ushtrive osmane (që ishin 9). Me pak fjalë, nëse vendos një rreshter në drejtimin e një brigade, atëherë duhet të jesh i

309 Muhammed Harb Abdul Hamid, (përkthimi dhe komentet nga) *Mudhakkiratu's Sulltan Abdil Hamid*, Egjipt 1978, fq. 128.

përgatitur për pasojat. Një situatë e ngjashme ndodhi edhe në dekadën e fundit të Devletit Osman.

Ndoshta, mënyra më e mirë për të kuptuar dhe për të vlerësuar ngjarjet sociale dhe historike, është ajo e krahasimit. Për këtë arsye është e nevojshme të bëjmë një krahasim midis Devletit Osman dhe disa entiteteve të tjera shoqëro-politike.

Perandoritë Greke dhe Romake kishin sjellë në shumë aspekte katastrofë për njerëzimin. Evropianët e kthyen gjithë Amerikën në shtete të krishtera folëse të gjuhëve angleze-spanjolle-portugeze dhe asgjësuan popullsinë indigjene. Britanikët lanë në të gjithë kontinentin e Australisë vetëm një numër të vogël të banorëve të saj vendas, dhe tashmë ajo është vetëm një zgjatim i hapësirës së influencës britanike: ku flitet anglisht, zbatohet kultura britanike dhe krishterimi, edhe pse krishterimi është duke humbur terren në Evropë, dhe ndërtesat e kishave janë vënë në shitje në Britani. Ky pushtim gjithëpërfshirës kulturor është i dallueshëm edhe në pjesë të tjera të botës, veçanërisht në kontinentin e Afrikës.

Në kontrast të dukshëm, Devleti Osman respektonte dhe ruante nëpërmjet **Sistemit** të tij të **Mil-leteve** identitetet kulturore të të gjitha popullsive të saj jomuslimane dhe joturke, dhe përmbahej nga shtypja, dhe shfrytëzimi i tyre kulturor. Pra, është një shtrembërim dhe **gabim trashanik të quhet "Perandori", sipas sensit perëndimor të fjalës.**

Devleti Osman qëndroi në vendin që në ditët e sotme quhet Greqi për 4 shekuj. Prezenca osmane në ish-Jugosllavi vazhdoi për 500 vjet. Në ditët e sotme, në këto vende ka popuj që kanë ruajtur identitetin dhe gjuhën e tyre, dhe gjithçka që u përket. Ndërsa popullsia indigjene në të gjitha pjesët e botës amerikane dhe në Australi janë një minoritet i vogël dhe nuk zënë asnjë vend në shoqërinë e vendit të tyre. Në ditët e sotme, stërnipërit e shtypësve, shfrytëzuesve dhe imperialistëve në Evropë dhe Amerikë shkruajnë vepra "akademike" për

Devletin Osman, duke e përshkruar atë si “shfrytëzues” dhe duke e quajtur “Perandori”.

Shkaqet e rënies së Devletit Osman mund të përmbliidhen si më poshtë vijon:

Dhjetë Sulltanët e Parë Osmanë, që do të thotë deri te Sulejmani i Madhërishtëm, ishin shtetarë mjaft energjikë dhe të aftë. Personaliteti dhe roli udhëheqës i tyre luajti një rol mjaft vendimtar për forcimin dhe zgjerimin e Devletit. Por, me përjashkrimin e disave prej tyre, si Muradi IV, Mustafai III dhe Abdylhamidi II, sulltanët që vijuan nuk i kishin këto aftësi. Për më tepër, gjatë periudhës midis 1595 dhe 1687, postet e larta administrative ku përfshihej dhe posti i bejlerbeut iu dhanë *ket'hydave* (nëpunës dhe përfaqësues) të vezirëve dhe *myltezimëve* (taksidarëve), të cilët, përmes këtyre pozicioneve, arritën të grumbullonin shuma të mëdha parash.³¹⁰ ...Kur një *timar* apo *zeamet* nuk ishte i zënë, *Mirlivasët* (rang i barabartë me gjeneralët e brigadave) ua jepnin atë atyre që u premtonin rryshfetin më të madh.³¹¹ Luftërat me Austrinë dhe Persinë, që u zhvilluan në 1592, rritën nevojën e rekrutimit vjetor të ushtarëve të rinj. Dhe mbi të gjitha, vrasja e Sulltan Osmanit II në vitin 1622 u pasua nga një periudhë 10-vjeçare ku mbizotëroi kaosi, ku *spahinjët* rekrutonin fëmijët e tyre dhe të afërmit, dhe iu jepnin titullin *veledesh* (djali i tij). Veziri i Madh dhe Kryekomandanti rekrutonin në radhët e ushtrisë të afërmit e tyre. Në këtë mënyrë, numri i ushtarëve me pagesë arriti në më shumë se 100.000 vetë. Muradi IV e reduktoi këtë numër në 50-55.000, por ky numër vazhdoi të qëndronte si një pengesë e madhe që ishte edhe faktori kryesor i rrënimit financiar të Devletit.³¹²

Së dyti, **xhihadi** ishte misioni dhe forca bazë motivuese për Devletin Osman. Por, që nga shekulli i 17-të, devotshmëria ndaj tij dhe ndaj vetë Islamit, filloi të reduktohej gradualisht në

310 *Netajixh*, II, fq. 90.

311 Po aty, II, fq. 91.

312 Po aty, II, fq. 93.

radhët e administratorëve dhe vezirëve. Ata ishin kryesisht me origjinë *devshirme*, në radhët e të cilëve mbizotëronte lakmia, dhe ishin më tepër të angazhuar me shpërndarjen e posteve për përkrahësit e tyre, sesa me fushatat e xhihadit. Një industrialist krahasohet me një person që nget një biçikletë; nëse nuk ecën përpara, ai bie. I njëjti rast është edhe për një entitet politik që humbet motivin nxitës të misionit të tij.

Së treti, **me përjashtim të periudhës 1740-1768** (vetëm 28 vjet), **të gjitha gjeneratat osmane u angazhuan në betejat kundër Evropës, duke përfshirë këtu edhe Rusinë.** Kjo, pa dyshim, i kushtoi shumë Devletit, si në aspektin e jetës, ashtu edhe në atë të pronës, dhe ishte për pasojë një faktor tjetër që luajti rol për rënien e tij.

Së katërti, zbulimi i rrugëve të reja detare dhe zbulimi i Amerikës në shekullin e 15-të, i pasuroi kundërshtarët dhe armiqtë e osmanëve, duke e vështirësuar më shumë për ta sfidën kundër fuqive imperialiste të krishtera. **Prurjet e argjendit të lirë amerikan nga Evropa drejt territorit osman ndihmoi në problemet financiare, veçanërisht për faktin se osmanët e përdorën argjendin si material për prodhimin e monedhës së tyre.**

Së pesti, **revolucioni industrial** e ktheu Evropën në një vend mjaft të fuqishëm nga ana financiare dhe teknologjike, në krahasim me Devletin Osman, i cili nuk mund të matej më me evropianët. Kjo ndodhi në mënyrë të veçantë në fushën e **armatimit.**


Ndërhyrja e **zonjave** të Pallatit, në çështjet e Devletit, ishte një shkak tjetër i rëndësishëm që ndikoi në përkeqësimin dhe rënien përfundimtare. Duke filluar me bashkëshorten e Sulejmanit të Madhërishtëm, Hyrrem Sulltan, ato luftonin kundër njëra-tjetrës për të siguruar fronin për djemtë e tyre, pa marrë në konsideratë përgatitjet dhe aftësitë drejtuese të djemve të tyre.

Edhe **luksi dhe jetesa e shfrenuar** luajtën një rol të rëndësishëm në dobësimin e Devletit Osman. Gjatë sundimit të Abaz Pashait së Egjiptit (1848-1854), shumë pashallarë dhe bejlerë të pasur u transferuan nga Egjipti në Stamboll me shuma të mëdha parash. **Gratë e Pallatit dhe bashkëshortet e vezirëve, pashallarëve dhe të personave të tjerë shumë të pasur** filluan të përshtatnin stilin luksoz dhe të korruptuar të jetesës evropiane. Për një kohë të shkurtër, **pallati nuk arrinte të paguante borxhet ndaj bankave, dhe Devleti ishte drejt falimentimit gjatë periudhës së Abdylmexhidit.**³¹³ Për mrekulli Abdylhamidi II arriti ta ndalonte situatën e përkeqësuar ekonomike dhe arriti në një shkallë të lartë të zgjidhjes së problemit. Gjatë kohës së udhëheqjes së tij, Devleti Osman ishte ende në rangun e Superfuqive (*Dyvel-i Muazzeme*). Por, për fat të keq, elita nuk arriti të kuptonte si duhet rolin e saj dhe të vlerësonte arritjet e tij, dhe për këtë arsye u përpoq fshehurazi ta rrëzonte atë nga fronin. Por, prijësve të Ittihad ve Terakki iu deshën vetëm 10 vjet për ta shkatërruar plotësisht Devletin Osman, duke e hequr atë edhe nga harta e botës.

313 Ahmed Cevdet Paşa, *Ma'ruzat*, (red. Yusuf Halaçoğlu, Stamboll, Çağrı Yayınları, 1980), fq. 7-17.

SOVRANËT OSMANË

1. Osman Gazi 1284 Uç Beji Bej 1289-1324
↓
2. Orhan Gazi 1324-1362
↓
3. Murad Hydavendigar 1362-1389
↓
4. Jëlldërëm Bajezid 1389-1402
↓
5. Çelebi Mehemmed 1413-1421
↓
6. Murad II 1421-1451
↓
7. Fatih Sulltan Mehemmed 1451-1481
↓
8. Bajezid II (Veli) 1481-1512
↓
9. Javuz Sulltan Selim 1512-1520
↓
10. Kanuni Sulltan Sylejman 1520-1566
↓
11. Selim II 1566-1574
↓
12. Murad III 1574-1595



SHTOJCË

1

ENTITETI SOCIO-POLITIK OSMAN: PERANDORI APO DEVLET?

Në këtë punim përpiqemi të gjejmë emërtimin e veçantë të preferuar nga osmanët, në mënyrë që të identifikojmë entitetin e tyre socio-politik. Kjo është një përpjekje që bazohet kryesisht në dokumentacionin që ruhet dhe rezervohet në Arkivat Osmane në Stamboll.

Nga një pikëpamje e përgjithshme, entiteti Socio-Politik Osman është përdorur nga historianët modernë si dhe nga studiues të tjerë me emërtimin “The Ottoman Empire” (Perandoria Otomane); pra, termi “Perandori” përkufizohet në aspektin e literaturës së përcaktuar për këtë temë, në mënyrë që të kuptojmë se cili është kuptimi i vërtetë i tij, si dhe nëse ky term mund të jetë i aplikueshëm, ose jo për osmanët. Megjithatë, duke marrë për bazë ngjyrimin dhe domethënien kuptimore të tij, është i qartë fakti që ky term i veçantë nuk është një term që mund të aplikohet për osmanët, për arsye se, në asnjë rast ata nuk përdorën termin “Perandori”. Në fakt, termi që ata kanë përdorur për të përshkruar veten në të gjitha dokumentet, raportet, *fermanet*, *demarshet* dhe korrespondencën zyrtare të tyre është termi *Devlet*. Kjo do të thotë, futje fshehurazi e një termi të

ngulitur në kontekstin modern politik, dhe për më tepër, që është një term i huaj për natyrën, cilësinë dhe strukturën e drejtimit dhe administrimit të tyre (të osmanëve). Kjo është bërë në mënyrë të qartë nga akademikët, studiuesit dhe autorët përrëndimorë, të cilët, kur flitet për të tjerët, i kushtojnë shumë pak vëmendje faktit që “Vendet dhe popujt janë unikë dhe nuk joshen aq lehtë nga identitetet e njëri-tjetrit, duke përjashtuar këtu disa raste të limituara dhe specifike.”³¹⁴

Të emërtosh një institucion apo entitet social ndryshe nga emërtimi i tij i përveçëm dhe origjinal, do të thotë se kemi të bëjmë me një vlerësim subjektiv madje dhe armiqësor ndaj tij. Për shembull, muslimanët Sunnitë, e quanin njërin prej sekteve *Mu'tezile* ndërsa ky sekt e quante veten *Ehlul Adl*, *Ehlut Tevhid* ose *Ehlul Hakk*. Nëse Sunnitët do të kishin pranuar emërtimin e preferuar nga vetë sekti, edhe ata do ta kishin quajtur atë *Ehlul Adl*, *Ehlut Tevhid* ose *Ehlul Hakk*. Por ata e quajtën këtë sekt përgjatë shekujve deri në ditët e sotme *Mu'tezile*, sipas dijetarit të madh Hasan el-Basri, i cili ka thënë për *Mu'tezilin* e parë, Uasil b. Ata: *I'tezele ana Uasil*. Nga ana tjetër, nëse dikush përmend Amr b. Hishamin, askush nuk do ta kuptojë se për cilin bëhet fjalë. Por, kur përmendim *Ebu Xhehl* (Simboli i injorancës), pothuajse të gjithë muslimanët e njohin atë për armiqësinë e tij të betuar kundër Islamit dhe Profetit (p.q.m.t.).

Pra, nëse ne i hedhim një shikim dokumentacionit dhe librave osmane të shkruar dhe të botuar gjatë Erës osmane, ne nuk e ndeshim frazën “Perandori Osmane” apo të barasvlershmen e tij në gjuhën turke *Osmanlı İmparatorluğu* (Osmanllë Imparatorllugu), apo *İmparatorijje-ji Osmanijje*. Në vend të kësaj, ata e quajnë entitetin e tyre shoqëror “*Devlet-i 'Alijje-i 'Osmanijje*” (Devleti Sublim Osman), apo *Devlet-i Senijje* (Devleti i Ndrithshëm). Ata nuk e quajtën asnjëherë sundimin apo pushtetin e administrimit të tyre *İmparatorijje-ji Osmanijje*, apo *Osmanlı*

314 Rupert Emerson, *From Empire to Nation*, Cambridge, Massachusetts, Harvard University Press, 1967, fq. vii.

İmparatorluğu (Perandori Osmane). Dhe, osmanët asnjëherë nuk e quajtën sovranin e tyre *İmparator* (Perandor).

Faktikisht, osmanët nuk e quajtën asnjëherë entitetin e tyre shoqëror dhe politik “një perandori”. Në përmbledhjen e gjerë të dokumenteve origjinale të Arkivit Osman (T.C. Başbakanlık Osmanlı Arşivi, Istanbul/Kryeministria e Republikës Turke Arkiva Osmane, Stamboll), që ndër të tjera, përfshin edhe korrespondencën zyrtare osmane, dhe në traktatet e kësaj strukture, i është referuar gjithnjë me emërtimin: *Devlet-i Alijje-i Osmanijje* (Devleti Sublim Osman), apo *Devleti Senijje* (Devleti i Ndrithshëm), etj. Kjo nomenklaturë është përdorur jo vetëm në dokumentet osmane, por edhe në shkrimet e historiografëve zyrtarë osmanë. Kaq rëndom ndeshet përdorimi i saj, sa që kur u themelua Banka Osmane e Turqisë, u vendos titulli kualitativ *Shahane* dhe jo “*Perandorake*”, duke qenë se emri aktual ishte *Bank-i Osmani-i Shahaneh*.

Megjithatë, kur lexojmë pothuajse çdo shkrim të akademi-këve dhe studiuesve për osmanët, shpesh mund të hasim frazën “Perandoria Osmane”. Tani, pyetja është: Pse *Devleti* Osman u quajt “Perandori Osmane?” Do të ishte mjaft interesante të kuptojmë se si ky emërtim i gabuar, filloi të qarkullonte duke iu referuar osmanëve në letërsinë perëndimore. Si dhe cili është motivi, nëse ka një të tillë, për të ngulitur termin “Perandori” në këto shkrime.

Por, si fillim, le të japim si shembull një numër dokumen-tesh, të përzgjedhura mbi parimin e rastësisë, për të vërtetuar pretendimin tonë se osmanët përdorën gjatë gjithë historisë së tyre termin Turk, *Devlet*.

“Në lidhje me linjën telegrafike që do të vendoset dhe do të kalojë midis territorit Tim të Devlet-i Alijje (Devletit Sublim) dhe territorit të Napolit, nëpërmjet rrugës (nën) detare ...” (1858)³¹⁵

315 Başbakanlık Osmanlı Arşivi (Arkivat Osmane) *Name-i Hümayun Defteri*, 12, 196; (shkurt BOA).

*Biz ki bilütfil Mevla Turkistan ve shamil olduđu memalik ve buldanın Padishahi es Sultan ibnus Sultan es Sultan el Gazi Abdülmejid Han ibnus Sultan el Gazi Mahmud Han ibnus Sultan el Gazi Abdülhamid Hanuz. Ishbu Tasdikname-i Hümayunumuzla beyan ve ilan ederiz ki Devlet-i Aliyyemizle hashmetlu Nederlanda ve Biba Kralı Hazretleri beyninde mevcut olan revabit-i dustiyi te'yid ile ...*³¹⁶

“Ne, me bekimin e Zotit, Padishahu i Turkestanit dhe territoreve që përmban ai, pasardhësi i sulltanit, Gazi (Luftëtar në Luftën e Shenjtë) Abdyl Mexhid Hani, pasardhësi i Sulltan Gazi Mahmud Hanit, pasardhës i Sulltan Gazi Abdylhamid Hanit, deklarojmë dhe shpallim nëpërmjet Ratifikimit tonë Qiellor se, duke nxitur marrëdhëniet ekzistuese miqësore midis Devletit Tonë Sublim dhe Madhërisë së Tij Mbretit të Holandës dhe Bibao ...”

Sulltani osman, *Abdyl Mexhid Han*, ratifikon një marrëveshje konsullore midis Devletit *Sublim* Osman dhe Madhërisë së tij Mbretit të Holandës në vitin 1857.

“Konsulli i Përgjithshëm i Budapestit i Sulltanatit të Ndrirshëm ...”³¹⁷

Osmanët përdorën fjalën *Senijje* (i ndritshëm, i përsosur dhe madhështor) si një mbiemër përkufizues për *devletin* e tyre dhe jo fjalën Perandorak. Kjo nuk do të thotë se osmanët nuk ishin në dijeni të përdorimit të zakonshëm të fjalës Perandor. Ata ishin në dijeni të përdorimit të këtij termi dhe e përdorën atë për ata persona, të cilët e quanin veten perandorë.

Për shembull:

*Hashmetlu Alamanya Imparatoru ...*³¹⁸

Madhëria e tij Perandori i Gjermanisë ... (në lidhje me dhënien e medaljes nga osmanët asistentit personal ushtarak të perandorit).

316 BOA, *Name-i Hümayun Defteri* 12, 159.

317 BOA, *AMD 257*, fq. 163.

318 BOA, *AMD 256*, fq. 14.

*Fransa Imparatoru Hazretleri ...*³¹⁹

Në lidhje me udhëtimin e Perandorit të Francës për në Algjeri, dhe mendimit të Ministrit Osman, se Pashait-Guvernator të Tunizisë Osmane nuk duhej t'i jepej urdhri për pritjen e Perandorit.

“Ministrit të Pallatit të Madhërisë së Tij, Perandorit të Japonisë.”³²⁰

“...Hashmetlu Avusturya Imparatoru ...”³²¹

“Madhëria e Tij, Perandori i Austrisë ...”

*Hashmetlu Japonya Imparatoriçesi ...*³²²

“Madhëria e Saj, Perandoresha e Japonisë ...”

“Perandori Romak, i ndjeri Karli VI ...”³²³

Dhe kur osmanët nënshkruanin një marrëveshje, me një entitet socio-politik forma e qeverisë e së cilës ishte një republikë, ata e quanin atë republikë (*xhumhuriyet*). Pakti që bazohej në ndryshimin e shtetësisë, që u lidh midis Devletit Sublim dhe Republikës së Amerikës ...”³²⁴

Në fakt, historianët zyrtarë të cilët shkruajtën historinë osmane, iu referuan atij si *devlet*. Për shembull, le të marrim në konsideratë shembujt e mëposhtëm:

el Kelam fi zuhurid Devletil Alijjetil Osmanijje.

“Bisedë (informacion) për Krijimin e Devletit Sublim Osman”³²⁵

Na'ima (1655-1716), historiani i parë zyrtar i osmanëve, përdor përcaktorin e zakonshëm dhe të përveçëm *devlet*, për t'iu referuar administratës dhe territorit osman. Nëse Sulltani osman apo nëpunësit e tjerë të lartë do të ishin të mendimit ta

319 BOA, AMD 216, fq. 37.

320 BOA, AMD 257, fq. 154.

321 BOA, *Irade-Hariciye* 6 1693 26 Shevval 1332.

322 BOA, AMD 257, fq. 169.

323 BOA, *Name-i Hümayun Defteri* 8, fq. 71.

324 BOA, AMD 218, fq. 139.

325 Na'ima, *Ravzatul Huseyn fi Hulasati Ahbaril Hafikejn*, I, fq. 6.

quanin “një perandori”, ai me siguri do të kishte përdorur termin “Perandori”. Për ta ilustruar sa më mirë këtë shërben paragrafi i rëndësishëm i Ahmed Vasëfit si më poshtë vijon:

“Botimi i historisë së re dhe i veprës së dobishme të quajtur *Mahasinul Eser ve Hakajikul Ahbar*, përpiluar nga historiani zyrtar i *Devletit Sublim Osman* ka përfunduar ...”³²⁶

Për osmanët, Devleti i tyre ishte “Sublim” dhe “I Ndrishëm” dhe ata shtuan dhe ndajshimin *osmanijje* (që i përket Osmanit). Kjo do të thotë se struktura socio-politike osmane është *Devlet*, dhe se ky *devlet* është sublim, dhe se, në vendin e dytë për nga rëndësia, iu përket osmanëve: Ithtarëve të Osman Gaziut. Faktikisht, është me të vërtetë e pamundur të gjendet një komb apo një popullsi tjetër, që të kishte një identitet kaq thellë të rrënjosur në botën e Islamit, si osmanët. Për osmanët, *Devleti* kishte të bënte me konceptin sipas të cilit njerëzit mund të jetonin brenda kornizës së tij si qenie njerëzore, një koncept ky që siguronte mbizotërimin e ligjit dhe rregullit, në të gjitha fushat e jetës, një koncept që mbartte në vetvete domethënien e gëzimit dhe të vetë lumturisë. Ky term përkufizonte një koncept më të gjerë se koncepti i “shtetit”. Ky fakt mund të shihet qartazi edhe në vargjet e poezisë së Sylejmanit të Madhërisëm:

“Halk içinde mu'teber bir nesne yok devlet gibi

Olmaya devlet cihanda bir nefes sihhat gibi.”

Nuk ka asgjë tjetër në këtë botë kaq të vlefshëm sa *devleti*.

Faktikisht, nuk mund të ketë asnjë *devlet* (lumturi) në këtë botë që të barazohet vetëm me një frymëmarrje të shëndetshme.

Dhe osmanët nuk do të hiqnin dorë nga kjo fjalë kuptimplotë, *devlet*.

Do të ishte e nevojshme t'i referoheshim dokumentit të ratifikimit të Sulltanit osman Abdulaziz të vitit 1870, në lidhje me amendamentet e bëra nga përfaqësuesit e osmanëve,

326 Ahmed Wasif, *Mahasinul Asar ve Hekajikul Ahbar*, II, fq. 257, Bulaq (Egjipt) 1243/1827.

Gjermanisë, Austrisë, Francës, Britanisë së Madhe, Italisë dhe Rusisë, në Londër për modifikimin e Traktatit të Parisit (1856). Ky dokument, në të cilin përmenden titujt zyrtarë të krerëve të shteteve që ishin të përfshirë në këtë Traktat të vitit 1870, vërteton tezën tonë. Në këtë dokument thuhet:

“Ne deklarojmë dhe shpallim me Ratifikimin tonë Qiellor, se ata të cilët u mblohdën në Londër për të amenduar Traktatin e Parisit përfaqësojnë:

Devletin Tonë Sublim: **Devlet-i ‘Alijjemiz** dhe:

1. Madhëria e Tij, **Perandori** i Gjermanisë dhe **Mbreti** i Prusisë.
2. Madhëria e Tij, **Perandori** i Austrisë dhe **Mbreti** i Bohemisë dhe Hungarisë.
3. **Presidenti** i Nderuar i Qeverisë Ekzekutive të Republikës së Francës.
4. Madhëria e Saj, **Mbretëresha** e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës.
5. Madhëria e Tij, **Mbreti** i Italisë, dhe
6. Madhëria e Tij, **Perandori** i Rusisë ...³²⁷

Nga ky dokument duket qartë, se sovranit osman, i referoheshin si **Padishah**, **Sulltan**, **Han** dhe jo si Perandor, ndërkohë që perandorët quheshin “Perandor”, mbretërit “Mbret” dhe Kreu i Republikës “President”.

Një dokument tjetër i Arkivit Osman, mbi ratifikimin e marrëveshjes midis Devletit Sublim Osman dhe Mbretit të Bavarisë në lidhje me vendosjen e konsullatave thotë:

“Ky është ratifikimi i marrëveshjes konsullore midis **Devlet-i ‘Alijje** (Devletit Sublim) dhe Madhërisë së Tij, Mbretit të Bavarisë.

Ne, me bekimin e Zotit, Padishah i Turkestanit dhe vendeve që përmban ai, *Sulltani*, biri i *Sulltanit*, *Sulltan* Abdulaziz

327 BOA, *Name-i Hümayun Defteri* 13, fq. 73.

Han, biri i *Sulltan Gazi Mahmud Hanit*, biri i *Sulltan Gazi Abdulhamid Hanit*,

Deklarojmë dhe shpallim se midis Devletit tonë Sublim dhe Madhërisë së Tij, Mbretit të Bavarisë ...”³²⁸

Pasi përcaktuam titujt zyrtarë në lidhje me korrespondencën me jashtë, dhe marrëveshjet, le të shikojmë disa nga dokumentet dhe korrespondencën në lidhje me çështjet e brendshme:

“Peticioni që iu dërgua *Divan-i Hymajunit*, u shqyrtua. Për sa i përket anijeve që do të mbajnë Flamurin e *Devletit Sublim Osman ...*”³²⁹

“Në lidhje me rritjen në gradë të Kolonelit Fejzi Bej, profesor në Shkollën e Mjekësisë *Shahane* për sëmundjet e brendshme, në rangun Brigadier ...”³³⁰

“... i punësuar në Brigadën e Dytë *Qiellore*”³³¹

(*Qiellore* dhe jo perandorake)

“Mësues vizatimi në Shkollën e Mesme *Shahane ...*”³³²

“... Për shkak të faktit që tregtarit të veshjeve, Z. Ohannes, një *raijjeti* (të kujdesuri) të *Devletit Sublim* i është dhënë Medalja *Mexhidi* i rendit të pestë ...”³³³

“Kompania e Shtatë Ushtarake *Qiellore*.”³³⁴

(Osmanët duke qenë se besonin se ishin përcjellës të Mesazhit Hyjnor – Islamit – e emërtuan Ushtrinë e tyre *Ordu-ju Humajun* – Ushtria *Qiellore*).

Huma, shpendi që besohet të ketë jetuar gjithnjë në lartësitë e qiellit, dhe që nuk zbriste asnjëherë në tokë për ta prekur atë.

328 BOA, *Name-i Hümayun Defteri* 13, fq. 71.

329 BOA, *Mukteza Defteri* 21, fq. 114.

330 BOA, *AMD* 257, fq. 72.

331 BOA, *AMD* 257, fq. 71.

332 BOA, *AMD* 256, fq. 29.

333 BOA, *AMD* 257, fq. 149.

334 BOA, *AMD* 256, fq. 149.

Osmanët e përshkruan ushtrinë e tyre si *Humayun* që i përket këtij shpendi, që do të thotë, Qiellor dhe jo perandorak.

Pa dyshim, këto dokumente shërbejnë për të vërtetuar se osmanët nuk i përdorën fjalët “Perandori”, ose “Perandorak”, për t’iu referuar strukturës së tyre socio-politike. Tani le të shikojmë disa aspekte të një Perandorie, në mënyrë që të kuptojmë nëse entiteti osman i kishte këto karakteristika.

a) Aspekti politik

Një perandori përfshin strukturën bazë të drejtimit të kombit ose racës sunduese, dhe kombe të tjera të mundura dhe të sunduara. Në të njëjtën mënyrë, ajo përfshin edhe zonën qendrore të perandorisë dhe territoret dhe zonat e tjera. Kjo pjesë qendrore është e banuar pothuajse vetëm nga kombi sundues, prej të cilit janë guvernatorët, administratorët dhe përfaqësuesit shtetërorë të të gjitha fushave, dhe e detyron popullsinë e qeverisur për gjithçka që e shikon si të përshtatshme për ta.

Në territorin osman, Vezirët e Mëdhenj dhe vezirët e tjerë ishin me origjinë nga vendet e pushtuara që nga shekulli i 15-të, të diplomuarit e *Enderunit* (Universitetit të Pallatit Osman) rekrutonin studentë nga mesi i *devshirme*. Madje, edhe Kryekomandanti i jeniçerëve, dhe vetë jeniçerët (bërthama e Ushtrisë Osmane) ishin nga radhët e *devshirme*. Vetë fjala jeniçer (nga turqishtja: *Jeni Çeri* – Ushtar i ri) është një tregues i origjinës së tyre. Në fillimet e tyre, jeniçerët ishin pa përjashtim nga *devshirme* (djemtë që merreshin nga të krishterët e Bosnjë e Hercegovinës, Shqipërisë etj.).

Megjithatë, më pas, në radhët e tyre u pranuan dhe turqit. Disa vezirë, pjesëtarë të *Divan-i Humajun* (institucionit suprem qeverisës të administratës osmane), ruajtën gjuhën e tyre, pavarësisht faktit se ishin konvertuar në fenë islame.

Le të shikojmë se çfarë thonë jomuslimanët e perëndimit për imperializmin:

“Imperializmi (nga lat. *imperium*, pushtet), marrja dhe administrimi i një perandorie, shpesh si një pjesë e një zgjerimi të përgjithshëm industrial dhe komercial. Nga shekulli i 15-të e në vazhdim, **Spanja, Portugalia, Holanda, Franca dhe Britania** filluan të ndërtonin perandoritë e tyre përtej detit.”³³⁵

“Sundimi i popujve të huaj dhe i tokave të reja nga evropianët ishte demonstrimi më mbresëlënës i hegjemonisë së tyre. Në vend që të përmendim këtu argumente të shumta mbi atë çka imperializmi ishte dhe është, duket më me vlerë ta kufizojmë nocionin për të, në një supremaci të tillë kaq të drejt-përdrejtë dhe formale, sado të paqartë mund të jenë kufijtë me lloje të tjera pushtetesh mbi botën joevropiane.... Në **shekullin e 19-të, imperializmi evropian u bart më tutje duke u bërë më efektiv se kurrë më parë**. Kjo ndodhi në dy faza të dalluara, dhe si fazë e parë mund të konsiderohet ajo që mori hov drejt vitit 1870. Gjatë kësaj faze, **disa nga fuqitë e vjetra perandorake të tilla si Rusia, Franca dhe Britania e Madhe vazhduan të zgjeronin perandoritë e tyre në mënyrë të habitshme**. Të tjerat qëndruan në të njëjtin vend dhe u zvogëluan: **në këtë grup u përfshinë Holanda, Spanja dhe Portugalia**.”³³⁶

Le të shikojmë se çfarë shkruan një studiues i famshëm perëndimor jomusliman për çështjen osmane:

“Deri në shekullin e 19-të, turqit e shikonin veten kryesisht si muslimanë; besnikëria dhe devotshmëria e tyre në nivele të ndryshme i përkiste Islamit dhe familjes osmane dhe shtetit. Gjuha që një person fliste; vendi ku ai jetonte; origjina nga e cila ai thoshte se vinte, mund të ishin të një rëndësie personale, sentimentale ose shoqërore. **Por nuk kishin asnjë rëndësi politike. Kaq rrënjësisht e kishin identifikuar turqit veten e tyre me Islamin, sa që vetë koncepti i kombësisë turke**

335 Chris Cook, *Dictionary of the Historical Terms*, Londër: Macmillan, 1983, fq. 152. (Theksimi është shtuar).

336 J.M. Roberts, *The Hutchinson History of the World*, Londër: Hutchinson, 1987, fq. 83. (Theksimi është shtuar).

kishte kaluar në një plan të dytë – dhe kjo pavarësisht mbi-jetesës së gjuhës turke dhe ekzistencës të asaj që në fakt ishte, edhe pse jo në teori, një shtet turk. Mes njerëzve të rëndomtë, fshatarëve dhe nomadëve, një sens i turqizmit mbijetoi, dhe gjeti shprehjen në një letërsi popullore të pasur por të shpërfillur. Megjithatë, grupet qeverisëse dhe të arsimuara nuk e kishin ruajtur në të njëjtën masë si arabët dhe persët, ndërgjegjshmërinë e identitetit të tyre brenda Islamit, si të ndarë nga grupet etnike dhe kulturore.”³³⁷

Vlen të përmendet se thellimi i identitetit të tyre në Islam, ndodhi në harmoni të plotë me ideologjinë islame, ndaj së cilës ata ishin përkrahës, dhe arsyeja e tyre e ekzistencës (*raison d’etre*), si një trup socio-politik i organizuar, ishte Islami:

Duke cituar sërish Bernard Luis:

“... njerëzit e shikonin veten vetëm dhe kryesisht si muslimanë. Të dy termat osman dhe turk, siç e kemi vënë re, janë terma me përdorim relativisht të kohëve të fundit, dhe turqit osmanë e identifikuan veten me Islamin – ata e zhytën identitetin e tyre në Islam – ndoshta në një nivel më të thellë nga popullsitë e tjera islame. Është interesante të theksojmë se ndërkohë që në Turqi, fjala turk pothuajse doli jashtë përdorimit, në perëndim, kjo fjalë u kthye në një sinonim të fjalës musliman, dhe për një perëndimor të konvertuar në fenë islame thuhej se ishte kthyer në turk, edhe në rastet kur konvertimi ndodhte në Fez apo Isfahan.”³³⁸

Pra, është me të vërtetë e pabazë të pretendohet se turqit osmanë e përdorën Islamin, vetëm, apo kryesisht për t’i treguar popullsisë së tyre arabe dhe popullsiive të tjera, se ata ishin muslimanë dhe duhet t’i qeverisnin ata.

Osmanët organizuan popujt e tjerë sipas besimit të tyre në sistemin “*mil-let*”. Çdo “*mil-let*” që do të thotë komunitet besim-

337 Bernard Lewis, *The Emergence of Modern Turkey*, Botimi i Dytë, Londër: Oxford University Press, 1968, fq. 2. (Theksimi është shtuar).

338 Po aty, fq. 13.

tarësh, apo ndjekësish të një besimi, kishin vendin e tyre në territorin osman, dhe kishin liri të plotë besimi, si dhe lirinë për të praktikuar ritualet e tyre ndër shekuj.

Le të shikojmë tani mendimin e një studiuesi tjetër perëndimor jomusliman për osmanët:

“Po të hedhim një shikim të gjatë, osmanët duhet të vlerësohen për ruajtjen e praktikave islame paralizuese në aspektin politik, por të çmuara në aspektin moral, të tilla si sistemi i “mil-letit”, taksat e ulëta dhe konceptin e *imtijazit* apo të kapitullacioneve, të cilat përfundimisht i parandaluan osmanët nga modernizmi i shpejtë, apo nga absorbimi i shpejtë i minoriteve fetare në qeverisjen osmane.”³³⁹

Nën një sundim perandorak, popujt e mundur, nuk janë fare të lumtur. Në mënyrë të natyrshme, ata përpiqen të çlirohen nga administrimi qendror, kurdoherë që të jetë e mundur. Nëse *Devleti* Osman do të kishte qenë perandorak, të gjitha territoret evropiane, të cilat ishin nën sundimin osman, deri në vitin 1402, do të ishin rebeluar kundër tij. Siç dihet, kur osmanët u mundën nga Tamerlani në Angora, në vitin 1402, në dukje, Devletit Osman i kishte ardhur fundi. Djemtë e Jëlldërëm Bajezidit të zënë rob, ishin të angazhuar në një luftë civile të vazhdueshme me njëri-tjetrin, që vazhdoi për një periudhë 11-vjeçare. Nuk kishte asnjë flotë osmane që meriton të përmendet. Pra, pjesa evropiane e territorit osman ishte e ndarë nga pjesa aziatike e saj dhe Kostandinopoja e krishterë ishte në qendër.

Duhet të theksojmë se asnjë rebelim apo kryengritje nuk u zhvillua në pjesën evropiane të Devletit Osman, që ishte e banuar kryesisht nga subjektet jomuslimanë. Atëherë, si mund të pretendojmë me të drejtë se sovraniteti osman ishte imperialist? Në të kundërt, të krishterët, serbët dhe kroatët luftuan kundër njëri-tjetrit pa mëshirë, gjatë fundit të shekullit

339 C.M.Kortepeter, Comment on Halil Inalcik's “*The Turkish Impact on the Development of Modern Europe*”, botimi i Kemal Karpaz, *The Ottoman State and Its Place in the World History*, Leiden: Brill, 1974, fq. 59.

të 20-të. Nën sundimin osman, edhe kur autoriteti qendror ra në vitin 1402, të krishterët në Ballkan dhe në tokat e reja të hapura ndaj Islamit në Evropë nuk luftuan ndërmjet tyre, dhe nuk u ngritën as në revoltë kundër osmanëve. Ky është një fakt që tregon dhe vërteton se drejtësia mbizotëronte në këto zona nën drejtimin islam të osmanëve, të cilët toleronin "Ithtarët e Librit", dhe i lejonin ata të jetonin sipas besimit të tyre, dhe të ushtronin lirinë e tyre të plotë fetare. Nga ana tjetër, ne mund të vëzhgojmë qëndrimin e racave të nënshtruara në një strukturë perandorake, me atë që po ndodh në ish Bashkimin Sovjetik, kur kontrolli mbi popullin u lirua pak.

Është tepër interesante të përmendet se në radhët e përfaqësuesve të osmanëve në vende të tjera, gjendeshin shumë zyrtarë të krishterë dhe joturq. Për shembull, përfaqësuesi i interesave të osmanëve si konsull zyrtar i Devletit Osman në Bavari, ishte **Aristarki Bej**, që ishte me origjinë greke dhe i krishterë. Osmanët përfaqësoheshin nga nënshtetasi i tyre i krishterë, Kostandin Pasha, në konferencën për paqe të vitit 1876, që u mbajt në Londër për amendimin e disa prej neneve të Traktatit të Parisit (1856).

Shembuj të tillë mund të jenë të shumtë. Është një fakt tregues që Devleti Osman, që ishte i bazuar në Islam, ishte tolerant ndaj nënshtetasve të tij jomuslimanë. Ne mund të shikojmë dhe ministra dhe *pashallarë* të krishterë armenë si pjesëtarë të Kabinetit Osman. Atëherë, a është kjo një karakteristikë e një fuqie perandorake? A mund të jetë ky një përshkrim i imperia-lizmit turk?

b) Aspekti kulturor

Një tipar karakteristik i gjithhershëm i një fuqie perandorake është imponimi i gjuhës së saj ndaj kombeve që ajo qeveris, pasi gjuha është aspekti më i rëndësishëm dhe baza e kulturës. Nuk ka asnjë dyshim se, kultura është tipari më ndikues mes elementeve në jetën e njeriut. Për pasojë, një qenie njerëzore i

përket popullit në kulturën e të cilit është rritur. Për këtë arsye, popujt e kolonizuar të Afrikës, gati sa nuk e humbën identitetin e tyre nën drejtimin e fuqive evropiane kolonizuese. Njerëzit e arsimuar dhe pjesa më e madhe e popullsisë fliste anglisht ose frëngjisht. **Britanikët përgatitën një pikëpamje të tillë mendore për popujt e kolonizuar në Afrikë, sa që një afrikan nën pushtimin britanik, kur pyetej nëse kishte qenë në Britani, do të përgjigjej: “Jo, nuk kam qenë kurrë në shtëpi”.** Nën pushtimin francez, një algjerian, apo tunizian ishte i dënuar të vdiste nga uria, nëse nuk do të mësonte të fliste frëngjisht. Në ish-Bashkimin Sovjetik pothuajse e gjithë popullsia jo-ruse fliste rusisht.

Në të kundërt, osmanët përdorën gjuhën arabe, jo turke, si gjuhën e arsimimit në shkollat dhe universitetet e tyre për të paktën 5 shekuj. Vetëm në shekullin e 19-të, ata filluan të përdornin gjuhën frënge si gjuhën e arsimit në disa nga fakultetet, ndërkohë që dhe gjuha arabe vazhdoi të mësohej dhe të përdorej në *medrese* deri në fund të Devletit Osman. **Dhe ata përdorën alfabetin arab për osmanishten turke.** Arsimimi dhe jeta kulturore në territorin osman përdori shkronjat e alfabetit arab, për të vetmen arsye se osmanët përfaqësonin Islamin, se Islami ishte arsyeja e vetme e ekzistencës (*raison d’être*) së tyre, dhe gjuha arabe është gjuha e Kur’anit.

Të paktën 60% e fjalëve të osmanishtes turke e kanë prejardhjen nga gjuha arabe. Edhe në ditët e sotme, në gjuhën turke, rreth 30% e fjalëve janë me origjinë arabe.

Nuk është e nevojshme të përmendim këtu se sa të rëndësishëm janë emrat për njerëzit. Emri i përveçëm quhet **alem** në gjuhën arabe, që do të thotë në të njëjtën kohë edhe flamur. Pra, **flamuri** përfaqëson një shtet, dhe një emër i përveçëm përfaqëson një person. Nëse iu hedhim një sy emrave të sovranëve osmanë do të gjejmë këto emra: Othman 1289, Ihtijarud Din Orhan 1326, Murad 1360, Bajezid 1389, Mehemmed 1402-1421, Sylejman 1403, Musa 1410, Murad 1421, Mehemmed Hapësi i

Kostandinopojës ndaj Islamit 1451, Bajezid 1481, Selim 1512, Sylejmani i Madhërishtëm 1520, Selim 1566, Murad 1574, Mehemed 1595, Ahmed 1603, Mustafa 1617, 1622, Othman 1618, Murad 1623, Ibrahim 1640, Mehemed 1648, Sylejman 1687, Ahmed 1692, Mustafa 1695, Ahmed 1703, Mahmud 1730, Othman 1754, Mustafa 1757, Abdyl Hamid 1773, Selim 1789, Mustafa 1807, Mahmud 1808, Abdyl Mexhid 1839, Abdyl Aziz 1861, Murad 1876, Abdyl Hamid 1876, Mehmed Reshad 1909 dhe Mehmed Vahided Din 1918-1922.

Pjesa më e madhe e Afrikës së Veriut ishte nën sundimin osman. Nëse ata nuk do të kishin arritur edhe në këtë vend, Algjeria, Tunizia dhe Libia do të ishin kthyer në vende katolike spanjishtfolëse, ashtu sikurse ndodhi në Spanjë (Andaluzi), dhe në pjesën më të madhe të Amerikës së Jugut. Egjipti u pushtua fillimisht nga Franca dhe më pas nga Britania. A mund të gjendet një sovran i vetëm mes mbretërve apo perandorëve britanikë dhe francezë me emër arab? Sigurisht që nuk gjendet asnjë. Do të ishte e paimagjinueshme. **Ky fakt tregon se sa të huaja ishin këto fuqi imperialiste për banorët vendas arabë.** Nga ana tjetër, edhe në ditët e sotme, emrat e përveçëm të popullsisë turke janë më tepër emra arabikë-islamë. Në kolonitë ish-perëndimore gjenden shumë vendas që kanë marrë emra të origjinës evropiane në ditët e sotme; **ky është një fakt që tregon se sa thellë ka qenë i rrënjosur imperializmi kulturor në këto territore.**

Si përmbledhje, a është e mundur të gjejmë një fuqi perandorake, një perandori, që iu mëson banorëve të vendit të saj gjuhën e kombit të sunduar, që përdor gjuhën e kombit të sunduar si gjuhën e arsimimit ndër shekuj, që vendoste si emra të sovranëve dhe popullsisë së saj dhe qytetarëve, emrat e të sunduarve? A është e mundur të gjejmë një perandori, që përdor alfabetin e të sunduarve, madje edhe për gjuhën e vet? **Edhe në ditët e sotme, kaligrafia më e bukur në alfabetin arab shkruhet nga kaligrafët turq, pasi arti *hatt* ka qenë për shekuj me radhë një traditë në Turqi. A është e mundur të imagji-**

nohet përdorimi i arabishtes në Francë dhe në Britani si gjuhë e arsimimit, dhe gjuha franceze dhe angleze të shkruhen me alfabetin arab zyrtarisht dhe ndër shekuj? Për sa i përket gjuhës turke, kjo ka ndodhur. Turqit osmanë e kishin zhytur identitetin e tyre në Islam dhe kishin shpërfillur gjuhën turke; ndërsa përpiluesi i parë i Gramatikës së gjuhës turke ishte një studiues francez, Zhan Deni. Për turqit që ishin shkolluar në *Medresetë*, gramatika (morfologjia dhe sintaksa) ishte shkenca që i përkiste vetëm gjuhës arabe. Kultura arabe dhe ajo islame ishin baza për jetën intelektuale osmane. Një nga poetët më të talentuar, Fuzuli, e shkroi poezinë e tij më të famshme *Su Kasidesi* (poezia e ujit) në emër të Profetit Muhammed (Paqja qoftë me të).

Pothuajse në shtëpi e në çdo të familje turke osmane, kishte një *Shemal-i Sherife* (një përshkrim në gjuhën arabe dhe me forma dhe kompozime shumë elegante) i personalitetit të Profetit (Paqja qoftë me të), dhe jo emrat, apo *Tuğrat* e Sulltanëve Osmanë.

Le të citojmë një jomusliman arab mbi gjuhën turke në administratën osmane: “Një shërbyes i Sulltanit osman që përdorte gjuhën turke nuk e kishte të domosdoshme ta shikonte veten si turk; një subjekt i sulltanit që nuk fliste gjuhën turke nuk do ta shikonte veten si i mënjanuar nga komuniteti politik, me përjashtim të viteve të fundit të perandorisë (autori përsërit këtë titull pa u menduar gjatë për të, M.M.).”³⁴⁰

Në përfundim, në aspektin e rëndësisë së mësimin të një gjuhe në një vend, ne duhet të kujtojmë atë që ndodhi kur **De Goli** i Francës dhe Abdunasiri i Egjiptit ishin gjallë. Për disa arsye Abdunasiri vendosi ta zëvendësonte gjuhën angleze në shkollat e Egjiptit me një gjuhë tjetër perëndimore. **Sharl de Gol** menjëherë vendosi të dërgonte 400 mësues të gjuhës

340 Albert Hourani, “*The Ottoman Background of the Modern Middle East in Karpat*”, fq. 67

franceze në Egjipt dhe të gjitha shpenzimet dhe pagat e tyre u mbuluan nga Franca.

c) Aspekti ekonomik

Një fuqi perandorake i përdor tregtarët e saj për të shfrytëzuar sa më shumë që të jetë e mundur burimet dhe pasuritë e zotërimeve të tyre, ndërsa përgjatë gjithë shekujve, nuk pati asnjë tregtar musliman turk që shfrytëzoi pasurinë e vendeve të pushtuara. Deri pas rënies së Devletit Osman, tregtia ishte në duart e popullsisë jomuslimane, sepse për të cituar në këtë rast Bernard Luis, "Muslimanët dinin vetëm 4 profesione – qeverisjen, luftën, besimin fetar dhe bujqësinë. Industria dhe tregtia u lanë në duart e subjekteve të pushtuara jomuslimane, që vazhduan të praktikonin zejet e tyre të trashëguara."³⁴¹

A është ky një aspekt karakteristik për një perandori? Nëse Devleti Osman do të kishte qenë një fuqi perandorake, popullsia kryesore, turqit, do të kishin qenë më të pasurit. Fuqitë perandorake kanë luftuar për hir të përfitimeve tregtare dhe tregut. Historia e Evropës së shekullit të 19-të, është e mbushur me lëvizjet evropiane drejt tregjeve të lira. Në të kundërt, Devleti Osman ishte për një tjetër parim: Islamit. Është interesante të rikujtojmë këtu se Hysejin Dajë i Algjerisë Osmane ofendoi përfaqësuesin francez për shkak të një *dhimmiu*, një subjekti osman, një tregtari hebre. Dhe ky veprim i kushtoi atij humbjen e Algjerisë që u mor nga Franca në vitin 1830.

341 Lewis, *vepër e cituar*, fq. 35.

2

NDJESË NË EMËR TË KRYQTARËVE

Ndjesë pas 9 shekujsh

Një grup përfaqësuesish të një kisha amerikane, të drejtuar nga **Rene Cardenas**, vizitoi Kryetarin për Çështjet Fetare të Republikës së Turqisë dhe i kërkoi ndjesë për Kryqëzatat që paraardhësit e tyre kishin kryer 9 shekuj më parë.



(Gazeta) Türkiye 04/06/1997

Përfaqësuesit e Kishës amerikane duke kërkuar ndjesë në emër të kryqtarëve

Në lidhje me diçiturën:

Një grup prej 45 personash erdhi në Goreme (Göreme), Nevshehir, dhe të gjithë kërkuan ndjesë në emër të paraardhësve të tyre, të cilët kryen krime ndaj muslimanëve dhe çifutëve gjatë Kryqëzatatave, 9 shekuj më parë. Ata ia lexuan tekstin e kërkesës së faljes popullit aty.



20 USHTARAKË OSMANË ISHIN TË BARABARTË ME NJË USHTRI

Ish-Kryeministri i Izraelit, **Barak**, i ka thënë Demirelit (ish-Presidentit të Turqisë), anëtar i Komisionit për Lindjen e Mesme: "Gjatë periudhës osmane, një tetar administronte këtë rajon i qetë me vetëm 20 ushtarë. Tani, ne jemi në vështirësi ta qeverisim me një ushtri të tërë."

INSTITUCIONET
OSMANE

HYRJE

Institucionet osmane* janë një mishërim i civilizimit osman që i ka **rrënjët e tij vetëm dhe vetëm nga Islami**. Islami është burim i vetëm dhe pjesë jetësore e strukturës shoqëro-politike osmane që është një vazhdimësi dhe pjesë përbërëse e civilizimit islam.

Duhet të rikujtojmë këtu se **civilizimi perëndimor** i ka fillimet e tij në tokat ku mbizotëronte krishterimi. Edhe pse ka në përmbajtjen e tij disa elemente të krishtera, në thelb, ai u krijua dhe zhvillua pavarësisht nga krishterimi pas luftërave të ashpra me këtë të fundit të përfaqësuar nga katolicizmi. Civilizimi perëndimor ka arritur një nivel ku vetë “qenia njerëzore” ka humbur, dhe “materia” ka zënë pjesën kryesore, ndërsa “qenia njerëzore” qëndron në periferi të saj. Një aspekt i saj është edhe humbja e interesit të qenieve njerëzore në krishterim; në Britani kishat filluan të viheshin në shitje. Një aspekt tjetër është shkatërrimi i marrëdhënieve ndërnjerëzore, dhuna, numri në rritje i fëmijëve të lindur jashtë martesave (numri i tyre është rritur në pak dekada dhe mund të jetë më i madh se numri i fëmijëve të ligjshëm, ndërkohë që brenda një kohe jo shumë të gjatë ligjshmëria mund të quhet “e dalë nga moda”, “e vjetëruar”, për disa vende perëndimore), dhe të pastrehëve, që i

* Emërtimi i përveçëm është: *Osmanllë* në gjuhën e tyre turke. Dhe nuk ka asnjë arsye apo justifikim të pranueshëm për ta shtrembëruar këtë emërtim me një tjetër: otoman, pasi emërtimet apo nomenklaturat, nuk duhet të përkthehen.

kalojnë netët në rrugët luksoze të mbështjellë me kartonë zhvendosës.

Secili prej civilizimeve krijon një lloj të tijin të qenieve njerëzore. Duke filluar nga **Mevlana Xhelaleddin Rumi, el-Haxh Bektash Veli, Junus Emre**, Anadolli ka qenë nën kontrollin shpirtëror të *shejhëve* të mëdhenj gjatë erës osmane. Mevlana Xhelaleddini dhe Horasan Erenleri (evlijatë e Horasanit) u vendosën në Anadoll gjatë dekadës së Devletit Selçuk. Themeluesi i Devletit Osman, vjehri i Osman Gaziut, **Edebaliu**, ishte një nga *shejhët Ahijjetul Fitjan*.¹ Gjatë kohës së Orhan Gaziut, djalit të Osman Gaziut, jetoi shejhu i madh sufi **Gejikli Baba. El-Haxh Bektash Veliu**, stolisi kohën e sundimit të tretë, Murad Hydavendigarit. Vajza e djalit të Hydavendigarit, Jëlldërëm Bajezidit, u martua me një *shejh* tjetër të madh, **Emir Sulltan Muhammed Buhariun. El-Haxh Bajram Veliu** e stolisi epokën e Muradit II dhe *Halifeja* e tij, **Ak Shemseddini**, ishte mjeshtri shpirtëror i Mehmed Fatihut, hapësit të Kostandinopojës ndaj Islamit në vitin 1453. Më pas, mund të shohim **Shemseddin Sivasin, Yftaden, Aziz Mahmud Hydain** dhe shumë *shejhë sufi* të mëdhenj deri në fund të Devletit Osman. "Sufizmi është më i fundit, më i hershmi, më i thjeshti, më i shpejti dhe më i suksesshmi i të gjitha sistemeve mistike në botë. Ai përkrah pjesëmarrjen e plotë në çështjet botërore, në ndryshim nga disiplinat e tjera mistike, të cilat karakterizohen nga tërheqja nga bota dhe asketizmi."² Shoqëria osmane ishte një shoqëri mjaft e shëndetshme nën mbikëqyrjen e mjeshtrëve shpirtërorë, të cilët gëzonin respektin e thellë të sulltanëve, vezirëve, pashallarëve, si dhe respektin e plotë të popullit. Shumë prej sulltanëve, në ceremonitë e ardhjes së tyre

1 Mehmed Neşri, *Kitab-ı Cihan-nüma*, Ankara, Türk Tarih Kurumu: 1949, I, fq. 80-84.

2 *Sufi Path*, (artikuj mbi sufizmin), botuar në Malajzi nga A.S. Noordeen: 1991, kapaku mbrapa.

në fron, iu jepej shpata e Islamit nga shejhët sufi, pasi vizitonin tyrben e sahabiut muxhahid **Ebu Ejjub el-Ensari**.³

Një nga studiuesit perëndimorë ka thënë për organizimin politik osman:

“Që nga themelimi deri në rënien e tij Perandoria Otomane⁴ ishte një shtet i përkushtuar ndaj përparimit apo mbrojtjes së pushtetit dhe besimit në Islam. Për 6 shekuj, otomanët ishin në luftë të vazhdueshme me perëndimin e krishterë, së pari në përpjekjen – kryesisht të suksesshme – për të vendosur ligjin islam në një pjesë të madhe të Evropës, dhe më pas, në rrugën e gjatë për të ndalur apo penguar kundërsulmet e pamëshirshme perëndimore. Kjo luftë e gjatë shekullore, që e kishte origjinën në vetë rrënjët e Islamit turk, nuk mund të mos ndikonte negativisht në të gjithë strukturën e shoqërisë dhe institucioneve turke. Për turkun otoman, perandoria e tyre, që përfshinte të gjitha qendrat e Islamit, ishte vetë Islami. Në kronikat otomane, territoret e perandorisë quhen toka të Islamit, sovrani i saj quhet “Padishah i Islamit”, ushtarët e saj “ushtarë të Islamit”, krerët e saj fetarë quhen “Shejhë të Islamit”; popullsia e saj e shikonte veten kryesisht dhe mbi të gjitha si muslimane. Termat otoman edhe turk janë, siç e kemi parë, terma që kanë përdorim relativisht të vonshëm, dhe turqit otomanë e kanë identifikuar veten e tyre me Islamin – duke e zhytur identitetin e tyre në Islam, në një nivel më të madh nga popujt e tjerë Islam. Është interesante të theksojmë se, ndërkohë që në Turqi fjala turk pothuajse u zhduk nga përdorimi, në perëndim kjo fjalë u kthye në sinonim të fjalës musliman, dhe për një perëndimor të konvertuar në Islam thuhej se “ishte kthyer në turk”, edhe në ato raste kur konvertimi ndodhte në Fez apo Isfahan.”⁵

3 Mustafa Nuri Pasha, *Netajixhu'l Vuku'at*, I, Stamboll: 1327, II, fq. 58.

4 **Devleti Osman nuk ishte një Perandori**. Shiko: Mehmet Maksudoğlu, “Osmanli Socio-Political Entity: Empire or Devlet?” *Hamdard Islamicus*, vëllimi XVIII (1995).

5 Bernard Lewis, *The Emergence of Modern Turkey*, botimi i dytë, Oxford University Press: 1986, fq. 13.

I – ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

1. Hilafeti

Hilafeti ishte institucioni qendror në Shtetin Islam. Me Islamin që ishte mesazhi i fundit,⁶ jo vetëm për njerëzimin në këtë tokë, por për gjithë universin,⁷ dhe qenia e parë njerëzore që ishte Ademi (Paqja qoftë me të), duke qenë dhe në të njëjtën kohë Halifi (mëkëmbësi)⁸ i Allahut mbi Tokë dhe Profeti i Parë, nocioni i Hilafetit (mëkëmbjes) zë pozicionin qendror në Islam. Që nga Ademi (Paqja qoftë me të), njerëzimi nuk ka qenë pri-vuar ndonjëherë nga Udhëzimi Qiellor; përgjatë gjithë ekzisten-cës së tij mbi tokë, njerëzimi është rimbushur nga ana shpir-tërore nëpërmjet mijëra profetëve, nga të cilët 25 përmenden në disa raste të caktuara në Kur'an, pasi nuk është një libër historie. *Ulu'l 'Azm*, Profetët (Më të Mëdhenj dhe më të rëndë-sishëm) janë: **Ademi/Adami**, **Nuhu/Noah**, **Musai/Mojsiu**, **Isai/Jezusi** (Paqja qoftë me ta), duke kulminuar me **Pejgambe-rin e Fundit Muhammed** (Paqja qoftë me të). Allahu i përkras-te të Dërguarit e Tij me mrekulli: kur Profeti Mojsi (Paqja qoftë me të) u dërgua, magjia ishte në zenitin e saj, dhe ishte një nga aspektet më të rëndësishme të njohurisë apo aftësive, dhe

6 Muhammedi (Paqja qoftë me të) është Pejgamberi i Fundit dhe Vula e Profetëve; Kur'an, *el-Ahzab*, 40.

7 Një praktikues musliman gjatë *salatit* (namazit) 5 herë në ditë, çdo herë lexon *suren el-Fatiha* (suren e parë të Kuranit Fisnik). Kjo sure fillon me fjalinë: “Falenderimi i takon Allahut, Zotit të Botëve.”

8 Kur'an, *el-Bekare*, 30.

Mojsiu (Paqja qoftë me të) mposhti magjistarët e Faraonit. Kur Profeti Jezus (Paqja qoftë me të) u dërgua, aftësitë mbizotëruese të asaj kohe ishin në fushën e mjekësisë, dhe ai, me lejen dhe përkrahjen e Allahut, e bëri të verbrin të shikonte dhe ringjalli të vdekurin. Kur Pejgamberi i Fundit Muhammed (Paqja qoftë me të) u dërgua, aftësitë mbizotëruese të asaj kohe i përkisnin fushës së letërsisë. Përpos mrekullive të tjera, mrekullia më e shquar e tij ishte Kur'ani, fjala e Allahut Madhështor. "Kur'ani është veçanërisht i dallueshëm për stilin e tij, krahasuar me çdo kompozim tjetër letrar njerëzor. Elokuenca njerëzore, me historinë e saj mbresëlënëse në fushën e thurjes së poezisë, nuk ka arritur të kompozojë asnjë rresht të vetëm të ngjashëm me rreshtat e Kur'anit. Kompozimi Kur'anik është një sfidë e gjallë për njerëzimin për imitimimin e stilit të tij mrekullues."⁹ Një qenie njerëzore nuk ka asnjë shans, asnjë mundësi të vëzhgojë, të jetojë mrekullitë e Mojsiut dhe Jezusit (Paqja qoftë me ta), por ka mundësinë dhe dobinë personale të përjetojë Mrekullinë e Fundit: Kur'anin.

Kjo situatë e qenies njerëzore si mëkëmbës i Krijuesit mbi tokë, e vendos njerëzimin në një pozicion mjaft realist dhe harmonik: gjithçka është vendosur nën shërbimin e tij, ai është caktuar të ketë në përdorim gjithçka mbi tokë,¹⁰ dhe në qiej.¹¹ Për këtë arsye kur një qenieje njerëzore i dhurohet *vahji* (shpallja, inspirimi) që manifestohet me Kur'anin, atëherë, ai nuk është më në mëdyshje të tilla si, për shembull, konsumimi i prodhimeve të kafshëve. Në një mënyrë është mjaft "njerëzore" të jesh vegetarian, duke menduar se asnjë nuk duhet të marrë jetën e një krijese tjetër për t'u ushqyer. Por, në realitet, kjo është në kontradiktë me jetën "aktuale" dhe ngjarjet që shohim në

9 Aly Bayoumy Aly Oteify, "Interrogative Utterances in Surah Al-Baqarah" *Intellectual Discourse* (The Journal of the Faculty (Kulliyah) of Islamic Revealed Knowledge of Human Sciences), International Islamic University Press, Malajzi: tetor 1993, I, numër 1, fq. 70.

10 Kur'an, *el-Haxhxh*, 65.

11 Kur'an, *Llukman*, 20; *el-Xhathije*, 13.

sjelljet e hindusëve vegjetarianë ndaj “qenieve njerëzore” të tjera në Kashmir dhe në vetë Indinë. Qenia njerëzore ka të drejtë të shfrytëzojë gjithçka që është e mirë¹² mbi tokë, dhe jeta e tij kthehet dhe mbetet kuptimplotë nëpërmjet përlules dhe bindjes ndaj Ligjeve të Allahut, d.m.th. ligjeve të natyrës.

Me krijimin e shoqërisë dhe shtetit musliman në Medinë e përndritur dhe rrëzëllitëse, ndodhi dhe revolucioni më i madh në historinë botërore: u krijua një koncept tërësisht i ri, i rëndësishëm “njerëzor” dhe bashkëkohor, *Ummeti*; një koncept që Evropa moderne ka arritur ta realizojë pjesërisht në dekadën e fundit të shekullit të 20-të, me krijimin e Bashkimit Evropian. *Ummeti* është koncept shumë më gjithëpërfshirës: ai përfshin të gjithë ata që besojnë në të njëjtat parime dhe që ndajnë të njëjtat pikëpamje dhe vlera, pa dallim nga vendi dhe pozita e tyre në gjeografinë botërore. Një individ mund të bëhet një anëtar i *Ummetit* me të drejta të plota, në momentin kur ai ose ajo kthehet në musliman, pa dallim race, ngjyre, gjuhe dhe pa dallim të vendbanimit të tij ose saj, nga çdo pjesë e botës. Si një anëtar i *Ummetit*, besimtari i islamit gëzon të gjitha të drejtat që gëzojnë bashkëbesimtarët e tjerë dhe ndan të gjitha detyrat, dhe detyrimet me të gjithë pjesëtarët e tjerë të *Ummetit*. Ky nuk është aspak socializëm, por është një mënyrë e krijimit të solidaritetit të thellë midis besimtarëve.

Është e detyrueshme që *Ummeti* të ketë një prijës. Udhëheqësi i parë i Ummetit ishte Pejgambëri i Fundit Muhammedi (Paqja qoftë me të). Ai u pasua nga Ebu Bekri radijallahu anhu (Allahu qoftë i kënaqur me të), (622-634) dhe ai u quajt **Halifetu Resulil-lah** (Mëkëmbësi i Pejgamberit të Allahut). Kur vendin e tij e zuri Omer b. el-Hattabi r.a. (634-644), do të kishte qenë tepër e rëndë që ai të quhej Halifetu Halifeti Resulil-lah (mëkëmbësi i mëkëmbësit të Pejgamberit të Allahut). Për këtë arsye ai u quajt **Emirul Mu'minin** (Princi i Besimtarëve). Më pas, pasardhësit dhe mëkëmbësit vazhduan si një hilafet në shtetin

12 Kur'an, *el-Bekare*, 172.

musliman. Udhëheqësia e Ummetit, Hilafeti u konvertua nga Emevitët (661-750) në dinasti trashëgimtare dhe vazhdoi me Abasidët (750-1258) në të njëjtën mënyrë, deri në pushtimin e Bagdadit nga mongolët në vitin 1258. Përveç bullgarëve turq, që e pranuan Islamin në masë në vitin 910 nën drejtimin e **Jalltavarogllu (Yaltavaroglu) Allmush Hanit**, që shtriheshin në territore të gjera në veri të Detit Kaspik, edhe turqit në atë kohë e kishin pranuar Islamin në Turkestan dhe Afganistan. Devleti muslimano-turk Karahanllë (840-1212) u konvertua në masë në fenë islame në vitin 944. Turqit muslimanë themeluan Devletin Gazne në Afganistan, në vitin 963, që zgjati deri në vitin 1186. Devleti Gazne zhvilloi 17 fushata xihadi në Indi si rezultat i të cilave u krijua dhe gjuha **Ordu** (në gjuhën turke: ushtri). Për arsye se **ordu** muslimane (*urdu* është forma e shtrembëruar, siç është Uzbek për Özbek) ishte e përbërë kryesisht nga turqit dhe popullsia vendase, gjuhët e tyre u përzien dhe kështu u krijua gjuha *ordu*.

Më pas turqit, nën udhëheqjen e **Selçukut**, u shfaqën në Xhend dhe Selçuku si musliman që ishte, nuk pranoi t'i bindej turkut jomusliman, Oguz Jabgu (sovrانيت), dhe themeloi devletin e tij në vitin 1038, që zgjati deri në vitin 1157. Nipi i Selçukut, **Muhammed Tugrull Beu**, si një kampion i Islamit sunnit, hyri në Bagdad në vitin 1055 dhe çliroi Halifin Abasid sunnit nga Bujitët shiitë. Kur Bagdadi u pushtua nga mongolët në vitin 1258, sulltanët selçukë vepronin si Halifë. Nga ana tjetër, ishin Sulltani memluk i Egjiptit dhe Biladu'sh-Shamit.¹³ Sulltani memluk i Egjiptit **Bajbarsi** vendosi një pjesëtar të familjes Abaside si Halif në el-Kahire në vitin 1261, por ky ishte një

13 Në atë kohë emri i këtij rajoni ishte dhe vazhdon të quhet kështu edhe në ditët e sotme nga popullsia e këtij rajoni: **Biladush Sham** dhe Damasku, është kryeqyteti i tij. Në kohën për të cilën bëhet fjalë, rajoni quhej Biladush Sham, madje edhe deri aty afër mesit të shekullit të 20-të.

Halif simbolik që mbante vetëm këtë “titull” dhe nuk kishte asnjë pushtet ushtarak, politik apo financiar.¹⁴

Pas Selçukëve të Mëdhenj (1038-1157), Devleti i Selçukëve të Anadollit (1075-1308) përfaqësoi Islamin, dhe sulltanët e tij ishin edhe Halifë. Duke qenë se Hilafeti është bashkimi i botës muslimane dhe përfaqësues i pushtetit të bashkuar musliman, ai është dhe një **makth** për ata që e kundërshtojnë Islamin. Për pasojë, në mënyrë që të zhvlerësojnë madje dhe të “çrrënjisin” konceptin e vërtetë të Hilafetit, ata gjithnjë përsërisin pretendimin e gabuar se Hilafeti ra në vitin 1258, **madje, ata përpiqen të hedhin dyshime mbi vetë institucionin e Hilafetit**. Në fakt, komuniteti musliman, *Ummeti*, kishte udhëheqje të veten gjatë gjithë ekzistencës së tij. Kjo udhëheqje u quajt Hilafet. **Për më tepër, është e pamundur që muslimanët të mos kenë një Halif**. Ka shumë *Ahadith Sherife* (thënie të Pejgamberit të Fundit s.a.v.s. që përbëjnë dhe burimin e dytë të Islamit)¹⁵ mbi **detyrimin** e muslimanëve për t’u betuar për besnikëri (bej’at) ndaj Halifit të tyre.

14 Bernard Lewis, *The Arabs in History*, New York: Harper Torchbook 1967, fq. 155. Kjo është e vërtetë; por, nga ana tjetër, ne duhet të kujtojmë se: në kritikën e hadithit të quajtur **el Xherh Ve’t ta’dil**, edhe një musliman, një besimtar i Islamit dhe i pejgamberisë së Muhamedit (s.a.v.s.), mund të refuzohet ndonjëherë, një *hadith sherif* i transmetuar nga ai mund të mos pranohet, nëse ai mund të ketë pasur disa defekte të vogla. Për shembull, *fartu’l gaffel* është një arsye e mjaftueshme për të refuzuar një *ravi* (sipas Muslimit). Në rastet kur ka mangësi ose neglizhencë në faljen e namazit, transmetimi i tij nuk konsiderohet serioz, dhe nuk pranohet. Po nëse i referohemi një jobesimtari në Islam, në pejgamberinë e Muhamedit (s.a.v.s.)? Është e drejtë nëse nuk i konsiderojmë dhe nëse i zhvlerësojmë pretendimet, qëndrimet dhe deklaratat e orientalistëve në lidhje me *ahadithi sherife*. Asnjë musliman **i ndërgjegjshëm** nuk mund t’i marrë seriozisht në konsideratë këto qëndrime. **Marrja me Kur’anin dhe Sunnetin është një detyrë e atyre që besojnë dhe jo e atyre që nuk besojnë.**

15 Ahmed b. Hanbel, *El Musned*, 3: 111; el Buhari, *es Sahih*, *el Enbija*, 50; Muslim, *es Sahih*, Imareh: 44; el Buhari, *es Sahih*, Shehadet: 33; Shiko gjithashtu: Abu Ja’la Muhammed b. Husajn el Ferra, *el Ahkamü’s Sultanijeh*, Surabaya, Indonezi: 1394/1974, fq. 20.

Në të vërtetë, sovranët e Mëdhenj Selçukë, si përfaqësues ushtarakë dhe politikë të pushtetit islam, ishin në një pozicion mjaft të justifikuar në sundimin e tyre si Halifë-Sulltanë. Pas tyre, sulltanët selçukë të Anadollit, trashëguan këtë detyrë. Pas vdekjes së Sulltanit të Fundit të Selçukëve të Anadollit, Mesudit II, në vitin 1308, ky Devlet pushoi së ekzistuari, duke ua lënë vendin disa principatave në Anadoll. Principatat (bejliket) më të mëdha dhe më të fuqishme ishin ato të Karamanit dhe Germjanit. Duke qenë se është e pamundur për muslimanët që të mos kenë një udhëheqës, një Halif, sovrani i Bejlikut më të madh dhe më të fuqishëm, atij të Karamanit, u pranua edhe si Halif.

I biri i Orhan Gaziut, **Muradi**, prijësi i tretë i Devletit Osman iu referua kryeqytetit të tij, Bursa, me emërtimin "**Daru'l-Hilafet**" (Selia e Hilafetit), në letrën e tij drejtuar sovranit të Bejlikut të Karamanit, që daton në 1 Rebiu-Thani 767/16 dhjetor 1365, nëpërmjet së cilës e njoftonte atë se luftëtarët muxhahidinë osmanë kishin hapur territore të reja në Evropë ndaj Islamit.¹⁶

Prijësi i katërt osman, **Jëlldërëm Bajezidi** vazhdoi të mban-te pozicionin e Halifit dhe atij iu drejtua si "Zil-lullahi fi'l Hafikejn" (Hija e Allahut mbi dy detet), "Rafi'u A'lami'sh Sheriat'i'sh Sherifeti's Sunnijeti" (Ngritësi i flamujve të Sheriatit [Ligjit të Islamit] të Nderuar Sunnit) dhe "Sulltanu Arzil-lah" (Sulltani i territorit të Allahut) nga Sovrani i Egjiptit Haxhixh b. Sha'ban, në një letër shkruar më 6 Shevval 793/6 shtator 1391.¹⁷

16 Feridun Ahmed Beğ, *Mexhmu'a-i Münshat-i Selatin*, Stamboll:1274, I, fq. 90.

17 *Münshat*, I, fq. 116.

"Institucioni" i Hilafetit është një **makth** për studiuesit jomuslimanë perëndimorë, disa prej të cilëve kanë marrëdhënie të ngushta me Ministrat e tyre të Jashtëm respektivë. Ata gjithnjë përsërisin dhe këmbëngulin për temën e rreme të rënies së Hilafetit. Ata janë të etur t'i bindin muslimanët se kur Halifi i Fundit Abasid u vra në vitin 1258 nga mongolët në Bagdad, institucioni i Hilafetit mori fund. Halifi Abasid, i cili ishte vendosur në Egjipt nga Sulltani memluk Bajbars në vitin 1261, ishte më tepër simbolik dhe nuk kishte asnjë pushtet. Kur sulltani osman, Javuz Selimi mori Egjiptin në vitin 1517, ai nuk zhvilloi asnjë ceremoni për

Është mjaft domethënëse që Halifi Abasid simbolik ishte në Egjipt, ndërsa kreu i këtij shteti iu drejtua sulltanit të katërt osman, Jëlldërëm Bajezidit, me titullin Halif; një fakt ky që tregon qartazi se prijësit osmanë pranoheshin si Halifë, nga sovranët e Devletit të Memlukëve, që në atë kohë ishte një fuqi e madhe islame. Fatih Mehemedi (1451-1481) u quajt “Sulltani i dy kontinenteve, Hakan i dy deteve, Emiru’l Mu’minin¹⁸ (Princi i Besimtarëve)”. Stambolli, kryeqyteti osman, ishte qendra e Hilafetit: “në pranverën e vitit 886/1481, ata e lanë Stambollin, që është Daru’l-Hilafeti (selia e Hilafetit) i tij dhe kaluan në Yskydar.”¹⁹

Djali i tij, Bajezidi II (1481-1512) për shembull, u njoh nga Hysejin Bajkara, Padishahu i Horasanit, me titullin “Halifetullahi fi’l enam”²⁰ (Mëkëmbësi i Allahut ndër njerëzit). Ajo që bëri Sulltani Javuz Selimi (1512-1520), pasi aneksoi Biladu’sh-Shamin dhe Egjiptin, në 1516 dhe 1517, duke dërguar Halifin e fundit simbolik Abasid në Stamboll, ishte në fakt, kombinimi i Hilafetit aktual dhe real me atë simbolik, duke e

marrjen e Hilafetit e për pasojë osmanët nuk e përfaqësuan Hilafetin në mënyrën në të cilin do të deklarohej më pas.

Faktet e thjeshta dhe të sigurta për këtë janë:

1. Edhe në Evropën post-krishtere, ata e shikojnë krishterimin si një “kulturë” dhe si një “pjesë e identitetit të tyre kulturor-historik”. **Të krishterët katolikë dhe ortodoksë kanë krerët e tyre.**

2. **Muslimanët nuk kanë një “krye”,** por ata janë të shpërndarë nëpër shtetet e tyre shekullore kombëtare. Hilafet do të thotë **bashkim** i muslimanëve, që bën një kontrast mjaft të madh krahasuar me interesat evropiane në tokat e muslimanëve. Për këtë arsye, **gjithçka** duhet të bëhet “për t’i dhënë fund” “konceptit” të Hilafetit.

3. Këta “studues” **nuk** marrin në konsideratë burimet origjinale, por ata marrin citime nga veprat e botuara të njëri-tjetrit, duke përsëritur kështu vlerësime të gabuara.

4. Kur sulltani selçuk, Muhammed Tuğrul Beğ hyri në Bagdad në vitin 1507, mori nga Halifi Abasid autoritetin për të qeverisur muslimanët në zonën e tij, sipas Sheriatit.

18 Tursun Beğ, *Tarih-i Ebu’l Feth*, përg. Mertol Tulum, Stamboll 1977, fq. 33; Ibn Kemal, *Tevarih- i Al-i Osman*, VII, fq. 194, 196.

19 Solakzade, *Tarih*, Stamboll: 1298 fq. 266.

20 *Münsheat*, I, fq. 360.

zëvendësuar këtë të fundit.²¹ Udhëheqësi i botës muslimane sunnite do të përfaqësohej nga osmanët gjatë shekujve në vazhdim. Sulltanët osmanë ishin “prijësit” e sunnitëve, që përbënin dhe shumicën e muslimanëve. Dhe ata ishin mjaft të ndërgjegjshëm për këtë pozicion. Kur Tirjaki Hasan Pasha mundi ushtritë e krishtera, që për nga numri ia kalonin ushtrisë së tij, që e rrethuan atë në kështjellën Kanixhe në vitin 1601, dhe i shkatërrroi plotësisht ata, ai mori nga sulltani një dekret që e ngrinte atë në rangun e Vezirit, ku shkruhej: “I Lavdëruar qoftë Allahu që na përzgjodhi në mes shumë shërbyesve të Tij besimtarë dhe na besoi çështjen e muslimanëve.”²² Sigurisht, “ai të cilit i besohen çështjet e muslimanëve” nuk është asnjë tjetër veç Halifit.

Kur Osmani II u rrëzua nga fronti dhe u strehua te jeniçerët në vitin 1622, ushtarët ishin të gjithë të mendimit se ata nuk do ta pranonin më atë si **Halif**, por nga ana tjetër, ata nuk do të pranonin as vrasjen e tij.²³ Sulltanët-Halifë Osmanë njiheshin nga sundimtarët e tjerë sunnitë si të tillë dhe nuk kishte asnjë sovran tjetër jomusliman kaq fuqiptotë në qendrat e Islamit përveç sulltanit osman. Ndërkohë që, prijësit osmanë i kushtonin më tepër vëmendje titujve “Sulltan”, “Padishah” etj., si tregues të pushtetit “aktual”, “politik”, “ushtarak”, “real”, ata përdorën edhe titullin “Halif” dhe u quajtën me këtë titull dhe sundimtarët e tjerë muslimanë.

Për të dhënë disa shembuj, mund të citojmë në këtë rast disa pasazhe të rëndësishme nga arkivat osmane:²⁴

21 Keşfi Mehmed Çelebi, *Keşfi'nin Selin-Namesi*, botuar nga Şefaattin Severcan, Kajseri 1995, fq. 189: mbajtja e **hutbesë së Hilafetit** në emër të Sulltanit Selim në Kajro në vitin 923/1517.

22 Na'ima, *vepër e cituar*, I, fq. 290.

23 Na'ima, *vepër e cituar*, II, fq. 229.

24 BOA, *Name-i Hümayun Defteri* (NMH) 9, fq. 101.

Stambolli quhet “**Daru'l-Hilafeti'l 'Alijje**” (Selia Hilafetit Sublim). Hysejin Bajkara, Padishahu i Horasanit, i drejtohej sovranit të katërt osman, Jëlldërëm Bajezidit, me titullin *zil-lullah* (hija e Allahut): *Münshat*, I, fq. 306.

Halifi/Sulltani osman, Sylejman II, ia njofton ardhjen e tij në fronin e osmanëve, që është Selia e Hilafetit,²⁵ Mbretit të Francës, Luis.

Dhe kur Sulltani osman i shkruan Hanit të Kërëmit (Krimisë), ku e fton atë të marrë pjesë në **xhihad**, përmend faktin që Hani kishte qenë shumë besnik ndaj **Halifit**, në vitin 1107/1696.²⁶

Hilafeti u mbajt dhe u përfaqësua deri në fund të Devletit Osman; kur **Halifi-Sulltan Reshadi** shpalli **xhihadin** kundër aleatëve, gjatë Luftës së Parë Botërore; përgjigja ndaj thirrjes së tij, erdhi edhe nga muslimanët që ndodheshin në Australinë e largët. Dy muslimanë që jetonin atje, filluan t'i luftonin britanikët dhe australianët kundër të cilëve Halifi kishte shpallur **xhihadin**. Këta dy muslimanë trima iu shkaktuan shumë probleme autoriteteve kristiane, të cilave iu desh disa kohë që t'i mbikëqyrnin. Në përfundim, ata ranë martirë të kësaj lufte dhe karroca me të cilin njëri prej tyre shiste akullore, është ekspozuar në ditët e sotme në muzeun e Australisë.

Institucioni i Hilafetit është shumë i rëndësishëm në Civilizimin Islam; të gjitha institucionet e tjera shoqërore, fetare, arsimore, shëndetësore, gjyqësore, ushtarake, ekonomike janë të lidhura me këtë institucion qendror.

2. Vizareti

Vizareti²⁷ sipas praktikës islame është dy llojesh: *Tefviz* dhe *Tenfiz*. Veziri i *tefovizit* (*Vezir Mufevvez*) ka autoritet dhe përgjegjësi të plotë. Posti i **vezirit** u themelua shumë herët në administratën osmane. Duke qenë një vazhdim i Devletit Selçuk të Anadollit, osmanët themeluan institucionin e tyre qendror dhe social, sipas modelit Selçuk.

25 BOA, NMH, 5, fq.18.

26 BOA, NMH, 5, fq.205.

27 el Maverdi, *el Ahkamu's Sultanijeh*, Kajro: 1380/1960, fq. 6.

Vetë fjala **Vezir** përmendet në Kur'an: "Dhe, cakto një vezir për mua nga familja ime, vëllain tim, Harunin",²⁸ i lutet Musai (a.s.) Allahu të Plotfuqishëm. Në konceptin islam, Musai (Paqja qoftë me të) është profet musliman, ngaqë Islami është feja e vetme dhe e njëjtë dhe Profeti i parë është Ademi (Paqja qoftë me të). Për këtë arsye, veziri i Musait (Paqja qoftë me të) ishte musliman, ndaj dhe institucioni i vizaretit është islamik. Koncepti i vezirit ka qenë gjithnjë prezent në mendjen islame. Në këtë mënyrë, ne e gjejmë këtë fjalë në thëniet e Pejgamberit të Fundit Muhammed (Paqja qoftë me të): "Nëse Allahu dëshiron të mirën për një emir (administrator), i cakton atij një vezir të besueshëm dhe të drejtë. Kur ai harron, ai e rikujton, kur ai kujton, ai e ndihmon."²⁹

"Veziri", përfaqëson një koncept tërësisht të ndryshëm nga koncepti perëndimor i "ministrit". Ky i fundit ushtron autoritet ndërsa i pari nënkupton llogaridhënie dhe përgjegjësi.³⁰ Fjala vezir vjen nga fjala në gjuhën arabe **v z r** që ka kuptimin "peshë", "ngarkesë", siç citohet edhe në Kur'an: "*La teziru vaziratun vizra uhra*"³¹ (Asnjë nuk do ta bartë barrën, përgjegjësinë e tjetrit). Pra, vezir do të thotë fjalë për fjalë: "një person i cili ngarkohet me një peshë apo përgjegjësi." Për arsye se devleti musliman është përgjegjës për mirëqenien e popullsisë së qeverisur, pa dallim race, ngjyre, besimi fetar, gjuhe, tradite etj., popullsia e qeverisur quhet në mënyrë domethënëse *ra'ijje* (për të cilën kujdesesh), në kontrast të dallueshëm me konceptin perëndimor të *subjektit*, që shiteshin së bashku me tokën si të ishin kafshë ferme.

Si të gjithë shtetet e tjera muslimane, osmanët kishin vezirë, duke qenë se kishin zbatuar modelin e administrimit nga paraardhësit e tyre, selçukët e Anadollit. Veziri i parë osman

28 Kur'an, *Ta Ha*, 29-30.

29 Nesai, *es Sunen, el Bej'at*, 33; Ebu Davud, *es Sunen, el Imaret*, 4.

30 el Maverdi, *el Ahkamu's Sultanijeh*, Kajro: 1327/1909, fq. 6.

31 *el En'am*, 164.

është **Alaeddin Pasha**,³² që jetoi gjatë kohës së Orhan Gaziut (1326-1362). Më pas, djali i Orhan Gaziut, Sylejman Pasha u caktua vezir në vitin 733/1332. Nga mesi i kohës së sundimit të Sulltan Muradit (1362-1389), **Xhendereli Halili** u emërua si vezir dhe më pas mori titullin **Hajreddin Pasha**. Pas vdekjes së tij në vitin 787/1385, i biri, **Ali Pasha** e zëvendësoi atë në këtë post. Më pas, **Timurtash Pasha** dhe disa komandantë të tjerë muxhahidinë u ngritën në rangun e vezirit. **Ali Pasha** u quajt **vezir-i a'zam** (Veziri i Madh).³³ Pas vdekjes së Ali Pashait, vendin e zuri i biri, **Ibrahim Pasha**. Pas vdekjes së Ibrahim Pashait, postin e *vezir-i a'zamt* e mori i biri, **Halil Pasha**, i cili qëndroi në këtë post për më shumë se 25 vjet.³⁴

Më pas **Mahmud Pasha Veliu** shërbeu si *vezir-i a'zam* dhe u ndoq nga **Gedik Ahmed Pasha**.³⁵

Gjatë Hilafetit të Sylejmanit të Madhërisëm (1520-1566), emërtimi i *vezirit a'zam* u ndryshua në emërtimin *sadr-ë a'zam* (ose *sadrazam*)³⁶ dhe ky emërtim u përdor deri në fundin e Devletit.

Vezirët osmanë kishin autoritet të plotë. Sadrazami mbante *muhr-i hymajunin* (Vulën Qiellore: Vulën e Halifit-Sulltan) dhe vepronte në emër të sulltanit; ai vuloste dokumentet zyrtare me këtë vulë. Për ca kohë edhe vezirët kishin të drejtën të shkruanin *fermane* (dekrete të sulltanit) dhe të vendosnin *tuğra* (emri i sulltanit i shkruar me një shkrim elegant) mbi to.³⁷ Me fjalë të tjera, *vizareti* (postin e vezirit) në administratën osmane ishte *vizaret tefoid* dhe veziri ishte *vezir mufevved* (vezir i autorizuar)³⁸ me përgjegjësi të plotë.

32 *Netajixh*, I, fq. 15.

33 *Netajixh*, I, fq. 16.

34 *Netajixh*, I, fq. 56.

35 *Netajixh*, I, fq. 57.

36 *Netajixh*, I, fq. 115.

37 *Netajixh*, I, fq. 91.

38 Stanford Shaw (*History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*), CUP, 1991, I, fq. 24, i referohet vezirit të parë osman si "kryeministër". Për arsye se nuk kishte asnjë vezir tjetër në atë kohë; përdorimi i termit

Duke qenë se Islami³⁹ është feja e njerëzimit, duke filluar që me qenien e parë njerëzore dhe njëkohësisht Profetin e Parë Ademin (Paqja qoftë me të), dhe duke vazhduar në periudhat gjatë shekujve me Profetë të tjerë si Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain (Paqja qoftë me ta). Edhe Sulejmani (Solomoni) (Paqja qoftë me të) ishte një nga profetët muslimanë. Veziri i tij i mençur **Asef b. Berhija** ishte pranuar nga osmanët si mjeshër dhe model për vezirët e tyre. **Posti i Sadrazamit** sipas përdorimit osman quhej "**Bab-ë Asefi**" (Porta e Asefit). Titulli i një libri të mirënjohur të Lutfi Pashait, që ishte Sadrazami i Sulejmanit të Madhërisëm, është **Asefname** (Libri i Asefit), vepër në të cilën autori tregon mbi përvojën e tij zyrtare dhe jep këshilla për pasardhësit. Shkurtimisht, *Sadrazami* osman shihet si i lidhur me Asefin, pasardhësin e Berhijasë. Dhe Asef si emër i përveçëm përdoret ende në Turqi, si traditë e trashëguar nga periudha osmane.

3. Divani

Duke qenë një vazhdim ligjor dhe natyral i Devletit Selçuk të Anadollit, Devleti Osman mori si model dhe zbatoi të gjitha institucionet e tyre islame. Që në periudhën e sundimit të sovranit të dytë, Orhan Gaziut, osmanët kishin Divanin e tyre, që ishte struktura qendrore juridike administrative.

"krye" është irrelevant. Për më tepër, "vezir" nuk duhet të përkthehet si "ministër"; këta dy terma nuk janë të njëjtë: *veziri* ishte në të njëjtën kohë edhe gjeneral ushtrie, bejlerbej (gubernator i përgjithshëm i Anadollit ose i Evropës osmane). Mahmud Pasha ishte Bejlerbeu i Rumelisë (Evropa osmane) dhe *vezir-i a'zam*: *Netajixh*, I, fq. 56; Llalla Shahin Pasha dhe më pas Timurtash Pasha ishin Bejlerbej të Rumelisë dhe të dy u ngritën në rangun e vezirit: I, fq. 15-16. Një gabim tjetër i rëndësishëm i autorit është se ai i konsideron ata si *vezir tenfidh* (vezirë ekzekutiv). "Ministër" mund të përdoret për "Nazër".

Duhet të kujtojmë në këtë rast se i ndjeri S. Shaw ishte një nga orientalistët më të "pranueshëm".

39 Islam do të thotë "nënshtrim" ndaj vullnetit të Krijuesit. Ligjet e fizikës (natyrës) në fenë islame quhen: *Sunnetullah*, që do të thotë mënyra në të cilën Allahu ka përcaktuar qeverisjen e universit.

3.1 Divan-ë Hymajun

Me kalimin e kohës, divani qendror osman u quajt Divan-i Hümajun (Divan-ë Hymajun). “Hyma” është një shpend, i cili besohej se jetonte vetëm në qiell dhe që nuk zbriste asnjëherë në tokë. “Hymajun” do të thotë që i përket Hymasë, pra, është “Qiellor”. Kjo për arsye se, osmanët, përfaqësuesit e Mesazhit të Fundit Qiellor, Islamit, i emërtonin institucionet dhe objektet e tyre të rëndësishme “Hymajun” (Qiellore). Pra, dekreti i Halifit-Sulltan Osman quhej **Hatt-ë Hymajun** (Dekreti Qiellor); vula e tij quhet **Myhr-i Hymajun** (Vula Qiellore); ushtria osmane **Ordu-ju Hymajun** (Ushtria Qiellore); flota detare **Donanma-jë Hymajun** (Flota Detare Qiellore), madje edhe porta e parë e Pallatit Topkapu quhet **Bab-ë Hymajun** (Porta Qiellore e Qendrës së Hilafetit). Pra, është e papranueshme që përdorimi i termit “Divan-ë Hymajun” të zëvendësohet në mënyrë të gabuar dhe të shtrembëruar me termin “Këshill Perandorak”.⁴⁰

Divan-ë Hymajun (Divani Qiellor), ishte i përbërë nga disa vezirë të tjerë që quheshin vezirë të dytë, të tretë etj. Gjithashtu në të kishte edhe dy **Kadiaskerë** (gjykatësit ushtarakë): Kadiaskeri i Rumelisë (i pjesës evropiane të territorit osman), dhe Kadiaskeri i Anadollit, dhe **Kadiu** (gjykatësi) i Stambollit. Kadiaskerët ishin përgjegjës për emërimin e kadinjve dhe përfaqësorin autoritetin më të lartë në zonat e tyre respektive. Autoriteti më i lartë gjyqësor ishte **Shejhulislami**, që ishte i barabartë nga ana protokollare me Sadrazamin. *Shejhulislami* ishte kreu i gjithë sistemit gjyqësor, si dhe kreu suprem i arsimit. Divan-ë

40 Stanford J. Shaw, *vepër e cituar*, fq. 25, 26, 101, 102, 108, 115, 117, 118, 120, 121, 122, 123, 131, 137, 163, 164, 258, 281, 282, 289. **Një shembull mjaft i mire, që tregon se si një term i huaj dhe i pasaktë është përdorur për t’iu referuar osmanëve. Emrat dhe nomenklaturat e përveçme NUK përkthehen.** Për më tepër, “Vendet dhe popujt janë unike dhe nuk mund të shkrihen kaq lehtësisht në identitetin e njëri-tjetrit, me përjashtim këtu të disa rasteve të veçanta dhe të kufizuara”, (Rupert Emerson, *From Empire to Nation*, Cambridge, Massachusetts, Harvard University Press, 1967, vii).

Hymajun (Divani Qiellor) kishte për detyrë të merrte *fetva* (mendim ligjor dhe lejen e dhënë në pajtim me Sheriatin) për çdo çështje të rëndësishme. Një **Nishanxhë** që vendoste **tuğrën** (firmë e shkruar në mënyrë artistike e Halifit-Sulltan) mbi dokumentet dhe ai kishte në ngarkim edhe korrespondencën zyrtare. Një pjesëtar tjetër i Divan-ë Hymajun ishte edhe **Defterdari**, i cili ishte përgjegjës për çështjet financiare. **Jeniçeri Agasë** (komandanti suprem i jeniçerëve) ishte një pjesëtar tjetër i Divanit. Pjesë përbërëse ishin edhe **Bolyk Agallarë (Bölük Ağaları)** (komandantët e njësisve të ushtrisë qendrore) dhe **Haxhegan-ë Divan-ë Hymajun** (shkruesit e Divan-ë Hymajun).⁴¹

Deri në periudhën e Fatih Mehemmedit, Halifi-Sulltani Osman kryesonte mbledhjet e **Divan-ë Hymajunit**. Një ditë, kur ishte mbledhur Divan-ë Hymajun, një fshatar turk pyeti: “Cili nga ju është sulltani? Dua t’i ankojem atij për një problem.” Sulltani kishte mbetur i pakënaqur nga kjo ndërhyrje dhe pas kësaj ndodhie filloi të praktikohej dëgjimi i seancave të Divanit Hyjnor nga sulltani pas një dritareje të mbuluar me perde, dhe që ndodhej pranë vendit.⁴² Pas kësaj, edhe vula e sulltanit iu dha vezirëve që mbanin postin e Sadrazamit, dhe ata u ngarkuan me përgjegjësinë e administrimit të çështjeve të Devletit.⁴³

Divan-ë Hymajun mbledhej pas Namazit të Sabahut çdo ditë me përjashtim të ditëve të pushimit. Pasi dëgjonin **mehterin**, ata diskutonin çështjet. Divan-ë Hymajun vendoste për çështje të rëndësishme dhe ky institucion vepronte edhe si Gjykatë Sublime. Duke qenë se njerëzit mund t’i paraqisnin ankesat e tyre para Divan-ë Hymajunit nuk ishte e nevojshme që administrata osmane të kishte një *Divan-ë Mezalim* për ankesat.

41 *Netajixh*, I, fq. 58.

42 Solakzade, *Tarih*, Stamboll 1298, fq. 268.

43 Po aty, fq. 268-269.

3.2 Divani i Vezir-i A'zamid

Përveç Divan-ë Hymajun kishte dhe një divan tjetër që quhej **Divan-ë Asefi**, që ishte Divani i Sadrazamit. Në këtë divan diskutoheshin dhe merreshin vendime për ato çështje dhe raste, të cilat nuk përfshiheshin në Divan-ë Hymajun, dhe që ishin të një rëndësie dytësore dhe që nuk ishte e nevojshme të paraqiteshin te Halifi-Sulltan.

Ky Divan quhej Divan-ë Asefi (Divani i Asefit); si bartës i Mesazhit Hyjnor të Islamit, osmanët e shikonin Asef b. Berhijan, vezirin e urtë të Profetit Sulejman (Paqja qoftë me të), si vezir musliman. Pra, modeli i Sadrazamit osman ishte ky vezir i urtë.

Divan-ë Asefi mblidhej në rezidencën e Sadrazamit disa ditë në javë, pas **namazit të ikindisë** (namazi i mesit të pasdites). Për këtë arsye u quajt dhe **ikindi divan-ë** (divani i ikindisë).⁴⁴

4. Kalemijje

Një nga pjesëtarët e Divan-ë Hymajun ishte **Nishanxhë**. Posti i tij kishte në ngarkim zbatimin e vendimeve të marra, dhe urdhrave të dhëna nga Divan-ë Hymajun. Ai duhet të vendoste **tuğrën** (shumë elegante, pothuajse një kryevepër: firma e Halifit-Sulltan) mbi dokumente. Ai shkruante gjithashtu dekretet e emërimeve në postet ushtarake, dekretet e dhënies së **timareve** për personat që e meritonin. Ai mbikëqyrte planet e kadastrës për tokat e reja të hapura ndaj Islamit. Ai kishte në ngarkim korrespondencën me jashtë. **Reisu'l Kuttab**, që më pas pati një influencë më të madhe, ishte nën juridiksionin e tij. **Haxhegan-ë Divan-ë Hymajun** (Shkruesit e Divan-ë Hymajun) ishin të ngarkuar të mbanin llogarinë e ushtrisë dhe korrespondencën e brendshme.⁴⁵

44 M. Zeki Pakalin, *Osmanlı Tarih Terimleri ve Deyimleri Sözlüğü*, Stamboll, 1983, II, fq. 47-48.

45 Netajixh, I, fq. 58.

5. Komunikimi

Nuk është e nevojshme të theksojmë këtu rëndësinë e komunikimit, si një pjesë jetësore për çdo trup shoqëroro-politik për ruajtjen e qëndrueshmërisë së ekzistencës së tij dhe arritjen e zhvillimit. Organizimi i komunikimit në devletet muslimane quhej *berid*. *Berid* do të thotë një largësi prej 12 milje. Njësia matëse e distancës *ferseh* është e barabartë me 3 milje, pra, një *berid* është i barabartë me 4 *ferseh*.

Organizata *Berid* e administratës muslimane e themeluar për herë të parë nga Mu'avija b. Ebi Sufjan, dhe pas tij ishte Abdulmalik b. Mervan, ai që e zhvilloi këtë organizatë. Duke qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm për strukturën shoqëroro-politike, *beridi* u zbatua edhe nga devletet e tjera muslimane. Devleti Osman përzgjedhi zbatimin e tij, mbi të tjerat, nga Devleti Selçuk i Anadollit.

Devleti Osman krijoi një rrjet të përsosur komunikimi që arrinte në çdo pjesë të territorit të tij të gjerë. Selia apo qendra e Hilafetit, Stambolli, ishte qendra e rrjetit rrugor të komunikimit. Nga Stambolli fillonin tre rrugë kryesore drejt Evropës me tre rrugë të tjera anësore drejt Azisë. Drejtimet e rrugëve për në Evropë ishin:

- a) **sağ koll** (krahu i djathtë): Stamboll – Kırklareli – Aydos – Prevadi – Babadağ – İsakçı – Akkerman – Özü.
- b) **orta koll** (drejtimi i mesëm): Stamboll – Silivri – Çorlu – Edirne – Filibe – Sofje – Beograd.
- c) **soll koll** (krahu i majtë): Stamboll – Silivri – Tekirdağ – Gelibolu – Keskan – Gümüljine – Selanik – Yenişehir.

Në pjesën aziatike të territorit osman, tre rrugët kryesore ishin:

- a) **sağ koll** (krahu i djathtë): Üsküdar – Eskişehir – Akşehir – Konya – Adana – Antakya – Haleb.
- b) **orta koll** (drejtimi i mesëm): Üsküdar – Gebze – İznik – Sapanca – Geyve – Hendek – Düzje – Bollu – Hajhamza –

Merzifon – Amasya – Turhal – Tokat – Sivas – Malatya – Diyarbekr.

- c) **soll koll** (krahu i majtë): Üsküdar – Gebze – İzniç- Sapanca – Geyve – Hendek – Düzje – Bolu – Hajihamza – Merzifon – Karahisar-ë Sharki – Bayburd – Terjan – Erzurum – Kars.

Si plotësues i rrugëve kryesore, ishte krijuar edhe një rrjet tjetër rrugësh dytësore, të cilat lidhnin qendrën me pjesët e tjera të territorit osman. Qeveria qendrore ndërtoi rrugët kryesore, ndërsa rrugët dytësore u ndërtuan nga drejtuesit e *timareve* dhe *ze'ameteve* (ata njerëz të aftë, të cilët kishin përgjegjësinë të mbliidhnin taksën (oshr) në emër të Devletit, dhe që kishin detyrimin e mbajtjes së një numri të caktuar ushtarësh të armatosur, dhe të gatshëm për xhihad).

Përgjatë këtyre rrugëve, Devleti Osman themeloi institucione të quajtura *menzilhane*. Urdhurat, që vinin nga qendra dhe pjesa tjetër e korrespondencës, shkante në vende të largëta nëpërmjet këtyre rrugëve, dhe oficerët i ndërronin kuajt e tyre në *menzilhanet*. Fshatrat, që ndodheshin pranë një *menzilhaneje* kishin përgjegjësinë që të mbanin një numër të caktuar kuajsh për oficerët, në mënyrë që ata të kishin mundësinë të shkonin nga një *menzilhane* në tjetrën, të siguronin ushqim për ta dhe të merrnin masa të tjera për nevojat e tyre.

Organizimi në *menzilhane* u përdor edhe për qëllime ushtarake: përpara fushatave të xhihadit, Halifi-Sulltan i dërgonte urdhrat e tij në drejtime të ndryshme dhe në *menzilhane* mbahej ushqim i mjaftueshëm etj., për çdo nevojë që mund të kishte ushtria gjatë rrugës. Dhe njerëzit vinin në këto qendra edhe për të shitur mallrat e tyre, dhe këto qendra u shndërruan në qendra të vërteta tregtie.

Menzilhane administrohej nga drejtuesi **Menzilhane Emîni**, që emërohej çdo vit. Nën drejtimin e tij, kishte dhe punonjës të tjerë, si dhe një grup njerëzish që banonin në qytezat ose fshatrat pranë *menzilhanes*, që u quajtën *menzilkesht*. *Menzil Emîni* kishte në ngarkim administrimin e *menzilit* (stacionit, ndalesës),

sigurimin e strehimit dhe ushqimit të trupave ushtarake që ndalonin në *menzil* gjatë rrugës së tyre. Në këmbim, ata që shërbenin në *menzil*, ishin të përjashtuar nga taksat. Organizimi i *menzilit* kontrollohej nga *kadinjtë*, *naibët* e tyre (zëvendësit) apo *muhtesibët* (mbikëqyrësit e tregtisë).

Pas krijimit të këtij posti në vitin 1834, institucionet e *menzilhanes* u përhapën.⁴⁶

Menzili ishte një mënyrë organizimi e komunikimit dykahesh: urdhrat, letrat nga qendra në periferi, informacionet për armikun dhe çështjet lokale nga periferia në qendër, përcilleshin nëpërmjet këtyre pikave. Korrespondenca konfidenciale përcillej nga një *ulak* (lajmës i shpejtë), i cili, si ndërronte kalin e tij në *menzil*, më pas vazhdonte rrugën me shpejtësi. Kali që i përkiste një *menzili* kthehej mbrapsht nga vendi ku ndodhej për në *menzilin* nga ishte nisur nga një funksionar që quhej *syryxhy* (drejtues).

Nga ana tjetër, ishte edhe një organizim i komunikimit njëkahësh: disa Bejlerë Akënxhë njihnin më shumë se gjysmë duzine gjuhësh lokale në zonën e tyre të veprimit, hynin në territorin e armikut dhe dërgonin nga këto territore pëllumba drejt Stambollit, duke lidhur në këmbën e shpendit informacione të ndryshme. Pra, Divan-ë Hymajun Osman ishte në dijeni të pothuajse çdo takimi politik që mbahej në botën e krishterë në shekullin e 16-të.

46 Jusuf Halacoğlu, "Osmanlı İmparatorluğunda Menzil Teşkilatı Hakkında Bazı Mülâhazalar", *Osmanlı Araştırmaları*, Stamboll: 1981, II, fq. 123-132.

II – INSTITUCIONET EKONOMIKE

6. Administrimi i Tokës

Në administratën osmane kishte dy mënyra përfitimi nga toka:

a) *hakk-ë zira'et* (e drejta e kultivimit): Ata persona, të cilët kishin të drejtën të përdornin tokën, kishin **tapunë** (tapinë) e saj, duke pasur në këtë mënyrë edhe të drejtën e punimit dhe kultivimit të tokës. Ata jetonin me prodhimet bujqësore të tokës së tyre.

b) *oshr-ë sher'i* (e drejta juridike e 1/10, në përputhje me ligjin e Sheriatit): Kjo ishte e drejta e Devletit. Devleti ua dha këtë të drejtë ushtarakëve, që kishin vërtetuar trimërinë e tyre në fushatat e xihadit, që u quajt **timar**; apo fisnikëve, ose oficerëve të lartë, që u quajt **ze'amet**; ose mbahej për Halifin-Sulltan, apo vezirët e tij që u quajt **hass**. *Timari*, *ze'ameti* dhe *hassi* janë të gjitha **ikta** (sipërfaqe toke) në madhësi të ndryshme. Ata, të cilëve u jepej e drejta të zotëronin ato **iktaate**, kishin të drejtën të mblidhnin 1/10 (oshrin) e Devletit për drithërat e prodhuar; kjo taksë përbënte edhe të ardhurat e tyre, në vend të një page. Në shumë raste, taksa **oshr** e tokës iu dhurohej fondacioneve fetare (*evkaf*: shumësi i *vakëf*). Për shembull, toka në fshat u ishte dhënë, me anë të *tapisë*, 80-100 personave për ta kultivuar dhe e drejta e Devletit (*oshr*: 1/10 e drithërave të prodhuar) i jepej një **sipahiu** si **timar**, ose një **za'imi** si **ze'amet**, apo një fisniku ose një komandanti të lartë si **hass**, ose kjo e ardhur

mund të dhurohej për vakëfet.⁴⁷ Muslimanët nën administrimin osman themeluan vakëfe për çdo nevojë të ndryshme njerëzore: për të ushqyer njerëzit e varfër; për përkujdesjen e fëmijëve jetimë; për të siguruar shpenzimet e martesave dhe mobileve për vajzat jetime; për mirëmbajtjen e xhamive; *zavijeve* (strehëve të sufive); për mirëmbajtjen e *kervansarajeve* (ndërtesave të fortifikuara përgjatë rrugëve të karvanëve me ushqime etj., dhe me ushqim për kafshët), madje edhe të kujdeseshin për shpendët shtegtarë, të cilët nuk mund të vazhdonin fluturimin e tyre dhe duhet të ndaleshin, dhe për ujqërit e uritur që iu afroreshin fshatrave në dimër. Ata siguronin ushqim për ta nga vakëfet të cilat ishin themeluar për këto qëllime dhe nevoja.

Njerëzit në grupin e dytë, ata të cilët kishin të drejtën të mblihdnin taksën oshr në emër të Devletit, u quajtën **sahib-i arz**. Secili nga fshatarët që dëshironte të shiste tokën e tij, duhet të jepte një *takrir* (kërkesë) në praninë e **sahib-i arz**, nga i cili ishte e detyrueshme të merrje leje për të kryer këtë transaksion.⁴⁸

7. Tregtia

Devleti Osman kishte krijuar lehtësira për veprimtarinë tregtare në territorin e tij. Siguria në rrugë ishte mjaft e rëndësishme. Për këtë arsye, duke ndjekur modelin e selçukëve të Anadollit, osmanët ndërtuan përgjatë rrugëve kryesore, *kervansaraje*. *Kervansaraji* ishte një ndërtesë prej guri, një ndërtesë e fortifikuar në brendësi të së cilës gjendeshin të gjitha lehtësitë për udhëtarët, kafshët e tyre dhe mallrat. Një karvan do të nisej nga njëra nga këto ndërtesa menjëherë pas *salat el-fexhr* (namazit të sabahut) dhe do të mbërrinte në një ndërtesë tjetër aty nga mesi i pasdites, në çdo rast përpara perëndimit të diellit. Udhëtarët dhe kafshët e tyre do ta kalonin natën në këto

47 Netajixh, I, fq. 119.

48 Netajixh, I, fq. 120.

ndërtesa ku pushonin dhe vazhdonin rrugën e tyre gjatë ditës së nesërme.

Fisnikët dhe muslimanët e pasur i ndërtuan *kervansarajet* si një institucion i vakëfit. Të ardhurat që merreshin nga dyqanet, tokat, frutoret etj., shkonin për mirëmbajtjen e kervansarajeve. Udhëtarët, tregtarët dhe kafshët e tyre kishin të drejtë të qëndronin në kervansaraje me ushqim dhe shërbime falas deri në tre ditë. Brenda ndërtesës së kervansarajit zakonisht kishte një mesxhid, një imam, një muezin, shefa kuzhine, shërbyes dhe një grup i vogël kalorësish për të mbrojtur zonën.⁴⁹

7.1 Ahijje-Fitjan

Artizanët dhe zejtarët ishin organizatorë në institucionet shoqëroro-profesionale të quajtura Ahijje-Fitjan. Në çdo qytet apo qytezë kishte *Ahinj*. Kjo organizatë kujdesej për trajnimin e fillestarëve që ata të bëheshin muslimanë të mirë, për cilësinë e prodhimit, duke mbrojtur në këtë mënyrë jo vetëm njerëzit që ushtronin këtë profesion, por edhe të drejtat e konsumatorit.⁵⁰ Shejhu drejtues i një tregu (lonxhe) ishte njëkohësisht dhe drejtuesi shpirtëror i profesionit të tij.

Ahinjtë kishin një **sandëk** (sënduk) që përdorej si përkrahje financiare për artizanët dhe zejtarët, të cilët si mbaronin trajnimin, fitonin të drejtën për të hapur biznesin e tyre. Përkrahja ishte në formën e një dhurate nga kolegët, dhe në të nuk përfshihej asnjë borxh apo interes.

49 *Netajixh*, II, fq. 105-106. Të gjitha këto veprime ishin të frymëzuara nga **hadith-i sherif** të Pejgamberit të Fundit. Këto u krijuan nën konceptin e **sadaka xharije**. Qëndrimi deri në tre ditë për strehimin dhe mikpritjen në kervansaraj ishte caktuar gjithashtu nga Pejgamberi i Fundit Muhammed (paqja qoftë me të).

50 Një musliman nuk duhet të mashtrë; sipas një **hadithi sherifi** "ai që mashtron, NUK është i yni." Pra, organizimi Lonxha ishte i përkushtuar ndaj arritjes së cilësisë së prodhimit, si dhe në sigurimin e të drejtave të konsumatorit. Mjeshtri i Lonxhas, duke qenë se ishte një Shejh sufi përbënte në vete një garanci për ndershmerinë dhe besueshmerinë.

8. Financa

Si një fakt i natyrshëm, sistemi financiar osman ishte në varësi të konceptit islam të administrimit, dhe në përputhje me traditën islame të trashëguar nga selçukët e Anadollit.

8.1 Bejtu'l Mal

Bejtu'l Mal (Thesari Publik) u quajt në praktikën osmane **Hazine-i Amire**. Zyrtari i lartë që mbante përgjegjësinë e financave të Devletit ishte **Defterdari**. Ai ishte një anëtar i **Divan-ë Hymajunit**. Administrata Qendrore Osmane i mbante regjistrat me aq kujdes dhe me aq detaje, sa që ata ishin në dijeni të faktit se sa njerëz jetonin në çdo fshat dhe se çfarë kishin në zotërimin e tyre si kafshët, ashtu edhe zotërime të tjera.

Me kalimin e kohës, kur territori i Devletit Osman u zgjerua dhe çështjet fiskale u shtuan, ata caktuan dy defterdarë: një për Rumelinë (pjesën evropiane të territorit osman) dhe një për Anadollin (pjesën aziatike të territorit osman), sipas emërtimeve përkatëse: **Rumeli Defterdarë** dhe **Anadollu Defterdarë**, dhe më pas defterdarët e tjerë u quajtën Defterdari i Dytë dhe Defterdari i Tretë, dhe Defterdari Kryesor quhej **Bash Defterdarë**.⁵¹ Ky institucion u shfuqizua pas vitit 1826.

8.2 Zekati

Në zbatim të Sheriatit, Ligjit të Shenjtë të Islamit, Devleti Osman i zgjidhte çështjet ekonomike sipas Kur'anit dhe Sunnetit (Praktikë e Pejgamberit të Fundit s.a.v.s.). Politika ekonomike e Islamit është e shpjeguar në Kur'an: "... Që ajo (pasuria) të mos ndahet ndërmjet pasanikëve tuaj."⁵² Islami toleron grupin e të pasurve, por iu imponon atyre detyrime më të rënda: ata duhet të paguajnë taksë për interes të të varfërve

51 *Netajixh*, I, fq. 115.

52 *el Hashr*, 7.

dhe nuk lejohen të praktikojnë asnjë mënyrë imorale për shfrytëzimin, dhe grumbullimin e pasurisë.⁵³

Si një Shtet Islam, Devleti Osman mblidhte *zekatin* nga muslimanët dhe *xhizjen* nga jomuslimanët në territorin e tij. Duke qenë se Islami përfshin të gjitha aspektet dhe veprimtaritë e jetës njerëzore, siguron për to mirëqenien në këtë botë, dhe në botën e përtejme, *zekati*, si mjet kryesor i solidaritetit financiar dhe i harmonisë, dhe sigurisë shoqërore, përmendet në mënyrë domethënëse në Kur'an në shumë vende bashkë me **salatin** (namazin):

“Faleni salatin (namazin) dhe jepni zekatin ...”⁵⁴ *Zekati* mblidhet nga Devleti dhe shpenzimet shkonin për vende të veçanta, ashtu siç përmendet dhe në Kur'an.

Zekati ka dy kuptime kryesore:

- a) Pastërti, dëlirësi.
- b) Rritje.⁵⁵

Kur një musliman paguan zekatin për pasurinë e tij, ai e pastron atë nga e drejta e Krijuesit dhe e muslimanëve të tjerë; dhe pasuria e tij rritet në të njëjtën mënyrë, sikurse rritet një bimë e mbjellë. Pa dyshim, mënyra më e mirë për të kuptuar dhe vlerësuar çdo institucion social është ballafaqimi; për këtë rast të veçantë, duhet të vëzhgojmë shoqëritë e tjera, të cilat nuk kanë një institucion të tillë si *zekati*. Të paktën tre shekujt e fundit të historisë botërore kanë qenë të dominuar nga fuqitë perëndimore. Duke qenë se sfondi i tyre është një krishterim i shtrembëruar, këto shoqëri kanë mungesë të institucioneve

53 M. Hamidullah, fq. 122.

54 *el Bekare*, 43; *el Bekare*, 83; *el Bekare*, 110; *en Nisa*, 77 dhe 162; *el Maide*: 12 dhe 55; *el A'raf*, 156; *et Tevbe*, 5, 11, 18, 71; *el Kehf*, 81; *Merjem*, 13, 31, 55; *el Enbija*, 73; *el Haxhxh*, 41, 78; *el Mu'minin*, 4; *en Nur*, 37, 56; *en Neml*, 3; *er Rum*, 39; *Llukman*, 4; *el Ahzab*, 33; *Fussilet*, 7; *el Muxhadile*, 13; *el Muzzemmil*, 20; *el Bejjine*, 5.

55 Ebu Bakr Muhammed b. Aziz es Sixhistani, *Garibu'l Kur'an (el Musemma bi Nuz'hati'l Kulub)*, Bejrut; Daru'l Fikri'l Arabi, botimi i tretë, 1402/1982, fq. 102.

shoqëroro-ekonomike. Përderisa, ato nuk kishin **Sheriat**, ata prodhuan dhe iu dorëzuan sistemit ekonomik liberalo-kapitalist apo sistemit ekonomik totalitaro-socialist. Ky i fundit u provua, pas eksperimenteve të hidhura në kurriz të një pjese të madhe të njerëzimit, se ishte i pamjaftueshëm, dhe vendet kryesore socialiste janë tashmë në procesin e ndryshimit të këtij sistemi. Sistemi i parë është ende mbizotërues, por është ende tepër e vështirë të themi se sistemi liberalo-kapitalist ka sjellë satisfaksion dhe lumturi për pjesën më të madhe të njerëzimit; **ai është i detyruar të rrëzohet** në një periudhë afatgjatë, për arsye se varet nga shfrytëzimi, një fakt ky nga i cili lindi socializmi si reagim ndaj tij.

8.3 Oshr

Oshr do të thotë 1/10 (në shumës: a'shar). Devleti Osman e mblidhte këtë taksë nga muslimanët në territorin e tij. Sasia që mblidhej përbënte 1/10 e sasisë së drithërave të prodhuara. Kjo përqindje vlente në rastin e drithit të prodhuar vetëm nga shirat, apo shkrirjes së akujve në pranverë. Nëse përfshihej edhe përpjekja njerëzore, dhe ujitja, në këtë rast raporti përbënte 1/20.

8.4. Xhizja

Popullsia jomuslimane ishte e përjashtuar nga shërbimi ushtarak dhe paguante *xhizjen*. Ajo merrej nga ata jomuslimanë që ishin të aftë fizikisht; personat e varfër, gratë, fëmijët, priftërinjtë, murgjit, eremitët dhe të moshuarit ishin të përjashtuar. *Xhizja* ishte praktikuar edhe më parë nga shtete të tjera muslimane përpara Devletit Osman, që e kishte modeluar strukturën e tij nga Devleti Selçuk i Anadollit, i cili, nga ana tjetër, kishte ndjekur shembullin e shteteve të mëparshme islame.

Khizja përmendet edhe në Kur'anin Fisnik:⁵⁶ “Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar (haram) atë që e ndaloi Allahu dhe i Dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë, prej atyre të cilëve u është dhënë libri, derisa të japin **xhizjen** në dorë e duke qenë të mposhtur.” Dhe Pejgamberi i Fundit Muhammed (s.a.v.s.), mori xhizjen nga Peshkopi i Akabes (Ejles) gjatë fushatës së xhihadit në Tebuk në vitin 9/630.⁵⁷

Në praktikën osmane, të varfrit, femrat, fëmijët, të moshuarit, zyrtarët fetarë, klerikët, familjet e punësuarat si funksionarë në Devlet dhe popujt e disa ishujve, dhe vendeve të rëndësishme, ishin të përjashtuara nga xhizja.

Khizja kishte tre nivele: *a'la* (për të pasurit), *evsat* (për shtresën e mesme) dhe *edna* (për të varfrit). Dokumentacioni i xhizjes dërgohej në qytet. Këto dokumente shpërndaheshin për njerëzit e caktuar në muajin **Muharrem** (Muaji i Parë Hënor Islam i vitit). Kjo taksë nuk mbliidhej në muajt e tjerë të vitit.⁵⁸ Jomuslimanët në territorin osman gëzonin të drejta të plota si *ra'ijjet*⁵⁹ me pagesën e xhizjes. Kur një jomusliman mashkull

56 *et Tevbe*, 29.

57 Ibn Hisham, *es Siretu'n Nebevjetu*, Kajro: 1375/1955, II, fq. 525.

Është e pamundur të numërohen të gjitha gabimet në “veprat akademike” të botuara nga studiuesit perëndimorë dhe nga nxënësit e tyre në të ashtuquajturën prej tyre botë muslimane, për sa i përket strukturës financiare të politikës së muslimanëve. Ata thjesht e bëjnë një sy të verbër ndaj Kur'anit dhe vazhdojnë të citojnë gabimet nga veprat, dhe vlerësimet e njëri-tjetrit. Pra, me kalimin e kohës, pjesa më e madhe e lexuesve të pandërgjegjshëm i pranon këto opinione të “pabaza” si të vërteta dhe si fakte.

58 *Netajixh*, III, fq. 100.

59 Koncepti dhe statusi i *ra'ijjetit* është **tërësisht i ndryshëm** nga koncepti i *subjekteve*. Në Evropë, njerëzit e qeverisur ishin subjekte të nënshtruara në nivelin e kafshëve; ata shiteshin bashkë me tokat, si të ishin kafshë ferme dhe ishte e natyrshme që një vajzë *subjekt* e sapo martuar të kalonte natën e parë të martesës me pronarin e tokës dhe jo me bashkëshortin e saj (praktika **Primae Noctae**).

Nga ana tjetër, në praktikën islame **ra'ijjet** janë ata për të cilët **kujdeset**. Devleti Osman kishte si synim të mbronte të drejtat e *dhimhive* brenda territorit të saj. Për shembull, le të shikojmë një **hukm** (vendim të Divan-ë

konvertohej në fenë islame, ai përjashtohej automatikisht nga taksa *xhizje*, ndërkohë që femrat ishin tashmë të përjashtuara.

Xhizje ishte një lloj takse, që paguhej nga meshkujt jomuslimanë që ishin të aftë fizikisht. Pa dyshim që kjo taksë ishte një nxitje e drejtpërdrejtë për të pranuar me dëshirë Islamin. Jeta, nderi dhe prona e një **dhimmiu** (jomuslimani) ishin të mbrojtur nga Devleti Islam; dhimmiu gëzonte liri të plotë besimi, ai nuk ishte i shtypur, por me siguri ai mund të ketë ndërë një sens vartësie. Nuk kishte asnjë rregull pengues për këdo që dëshironte të kthehej në musliman; duke iu nënshtruar Vullnetit të Krijuesit, duke qenë në këtë mënyrë në harmoni me universin dhe me veten, si dhe për të përfituar poste më të rëndësishme në Devletin Osman.

8.5 Taksa Haraxh

Jomuslimanët paguanin **haraxh** (haraç) ndaj Devletit Osman, ashtu sikurse muslimanët paguanin **oshr**. Toka që pranohej si tokë e **haraxhit** duhej të paguante më shumë se toka që pranohej si tokë e **oshr**it. *Haraxhi* ishte një nga të ardhurat kryesore të Devletit Osman.

Jomuslimanët ishin të lumtur nën administrimin islam osman, për arsye se osmanët i trajtonin ata mirë, nuk ndërhynin në praktikatat e tyre fetare, gjë që ishte në një kontrast të thellë me praktikën evropiane të krishterë ndaj jo të krishterëve. Gjithashtu, osmanët i lehtësonin kushtet e jetesës së jomuslimanëve. Mund të marrim si shembull kontrasti në këtë rast, rregullat e

Hymajunit) datuar më 24 Xhumade'l Ula 975/26 nëntor 1567, dërguar **Beut të Allaxhahisarit**; është shkruar se 4 *spahinj* kishin vlarë 3 *dhimminj* në mal, kishte prova se ata e kishin kryer këtë faj, dhe ata duheshin ekzekutuar (BOA – Arkiva Osmane e Kryeministrisë), *MD*, 7, fq.185, cituar nga Zija Kazıcı, *İslam Müesseseleri Tarihi*, Stamboll 1991, fq. 306.

Pra, është e dukshme që ky është një nga gabimet më të mëdha të orientalistëve që shtrembërojnë termin *ra'ijjet* duke përdorur në vend të tij termin *subjekt*.

Stefan Dushanit, Mbretit të Serbisë, që iu imponuan fshatarëve të krishterë për të punuar për pronarin e tyre dy ditë në javë, që do të thotë 104 ditë në vit, pa pagesë. Të njëjtët fshatarë punonin 3 ditë në vit për autoritetin e tyre lokal, Spahiun Osman. Ky ishte një parim themelor osman që parandalonte shfrytëzimin e fshatarëve nga pronarët lokalë.⁶⁰

8.6 Gana'im, Fej

Gana'im përbënte një pjesë themelore për të ardhurat e *Bejtu'l Malit* (Thesarit Publik) osman së bashku me tagrat që merreshin nga shtetet jo besimtare evropiane si: Perandoria Romake (Lindore), Nemsia (Austria), Venediku, Raguza, Eflaku, Polonia dhe Rusia. Megjithatë, dy shtetet e fundit i paguanin kryesisht tagër Hanatit të Kërëmit (Krimesë) që ishte pjesë e Hilafetit Osman.

Duke përfaqësuar fazën finale të Mesazhit Hyjnor të Islamit, shoqëria osmane ishte në pozitë të zbatonte Urdhëresat Qiellore, *Sheriatin*, dhe në linjë me Deklaratën Hyjnore: "... me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë."⁶¹ Në të vërtetë, **Devleti Osman e shikonte veten si përgjegjës për vendosjen e rregullit të botës (*Nizam-ë Alem*)**, dhe nuk hezituoi të pranonte mbrojtjen e Republikës së Raguzës (Dubrovnikut), në shekullin e 15-të, ku ata kërkuan mbrojtjen osmane kundër fqinjëve të tyre të krishterë, Republikës së Venedikut, që ishte një nga shtetet më të fuqishme të botës në atë kohë. Republika e Raguzës i dha me dëshirën e saj Devletit Osman një pjesë toke, që kishte madhësinë e një hapësire me gjatësi që përshkohej për 30 minuta dhe me gjerësinë që përshkohej për një orë, në kufi me Republikën e Venedikut, duke e futur territorin osman midis vetes dhe Venedikut, dhe duke siguruar territorin madje dhe vetë ekzistencën e saj. Njëra nga linjat

60 Halil İnalcık, *The Ottoman Empire*, përkthyer nga Norman Itzkowitz dhe Colin Imber, Londër: 1973, fq. 13.

61 *el Enbija* 105.

fillonte në portin e Klekut dhe linja tjetër nga porti i Storinas, dhe të dyja bashkoheshin në Kroaci, duke formuar kështu një territor që iu përkiste osmanëve midis Republikave të Raguzës dhe Venedikut. Në këtë mënyrë, ata jetuan të sigurt dhe të qetë nën mbrojtjen osmane për më shumë se 400 vjet. Republika e Raguzës (Dubrovnikut) i paguante Devletit Osman 75.000 gurush çdo tre vjet si tagër. Në vitin 1215/1800 nuk ishin osmanët, por ishte Napoleon Bonaparti, ai që e pushtoi këtë republikë.⁶²

Osmanët nuk mbështeteshin vetëm në fuqinë ushtarake. Gjatë shekullit të 14-të, 15-të dhe të 16-të, ata ishin përkrahës të mbrojtjes së drejtësisë dhe rregullit. Mënyra e krahasimit është mënyra më e mirë për të çmuar dhe vlerësuar ngjarjet. Në shekullin e 15-të, popullsisë së krishterë të Republikës së Raguzës iu ofrua mbrojtja e muslimanëve osmanë, duke iu dhënë atyre territore me dëshirë, dhe duke iu paguar atyre një tagër vjetore. Në shekullin e 20-të, në të njëjtin rajon, popullsisë muslimane të Bosnjës iu shkaktuan tragjedi, që zgjatën për vite me radhë, për shkak të lojërave të pista dhe të shpifura të fuqive evropiane, si dhe të lojërave të asaj që quhet OKB, nën drejtimin e një kopti.

Për sa i përket shpenzimit nga të ardhurat e përfutuara nga *gana'imi*, Devleti Osman u bazua në Kur'anin Fisnik, ku përmendet "Ju (besimtarë) ta dini se një e pesta e asaj që e fituat, nga ndonjë send, i takon (përkujtuesve të) Allahut, të dërguarit të Tij, të afërmve të tij (të të dërguarit), jetimëve, nevojtarëve dhe atyre në mërgim."⁶³ **Për këtë arsye, rregulli është që 1/5 veçohet për liderin e Devletit Musliman.** Kjo 1/5 shpenzohej për nevojat e Devletit si një mjet për të zbatuar Urdhëresat Hyjnore. Pjesa tjetër (4/5) ishte e drejta e luftëtarëve muxhahidinë, të cilët merrnin pjesë në fushatat e xhihadit.

62 *Netajixh*, I, fq. 69-70.

63 Kur'an, *el Enfal*, 41.

III – SISTEMI LIGJOR

Përpara se të shqyrtojmë sistemin ligjor, është e nevojshme të kuptojmë botëkuptimin e Islamit. Vetë fjala “Islam” do të thotë “nënshtrim”, “bindje”. Një musliman, për këtë arsye, e nënshtron veten, i bindet urdhrave të Krijuesit të universit. Në këtë kuptim, dielli, hëna, të gjitha trupat qiellore, uji, toka janë të gjitha muslimane, që do të thotë se ato iu binden ligjeve të natyrës, të cilat janë paracaktuar nga Krijuesi në mënyrë që të zbatohen prej tyre. Ato që në shkencën e fizikës quhen “ligje të fizikës”, në fenë islame quhen “Sunnetullah” (mënyra e drejtimit të universit nga Allahu). Është mjaft domethënëse që qenia njerëzore urdhërohet në Kur’an që të jetë “e drejtë” në “matje”, menjëherë pasi përmendet se dielli dhe hëna, janë ndjekës të një rruge të llogaritur, qielli që qëndron lart dhe Krijuesi është ai që vendos balancën: “Dielli dhe hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë... Edhe yjet edhe bimët i bëjnë përuilje (dëshirës së Rrahmanit). Ai e ngriti dhe qiellin, dhe Ai vuri drejtësinë. Që të mos kaloni kufirin në drejtësi. Edhe ju mbani me drejtësi peshojën, e mos lini mangët në peshojë.”⁶⁴

Emrat më të bukur i përkasin Allahut, Krijuesit. Një nga emrat e Tij është **Hakk**, që ka disa kuptime si “i drejtë”, “i duhur”, “i saktë”, “hise” ...⁶⁵ Në gjuhët perëndimore nuk ekzis-

64 *er Rahman*, 5-9.

65 Për kuptimet e ndryshme të *Hakk* shiko: Dr. Uehbeh el Zuhajli, *el Fikhu'l Islami ve adilletuhu*, Dimeshq, Daru'l Fikr, botimi i dytë 1409/1989, fq. 8.

ton asnjë fjalë e vetme që korrespondon me këtë fjalë dhe koncept. Koncepti i fjalës *Hakk*, është një temë qendrore në mendimin dhe praktikën islame. Për këtë arsye, i gjithë sistemi ligjor në civilizimin islam, është sajuar të jetë një linjë dhe në përputhje me çështjen e hakkut, dhe ta zbatojë atë. Në Islam, jeta e njeriut është e menduar si një tërësi: jeta në këtë botë quhet *el hajatu'd dunja* (jeta e afërt), dhe jeta e përtejme quhet *el hajatu'l ahire* (jeta e mëvonshme, e përjetshme). Me fjalë të tjera, jeta njerëzore nuk përfundon me vdekjen, jeta e përbotshme është një fazë testimi, dhe një përgatitje për jetën e përtejme. Për pasojë, nëse dikush bën diçka të gabuar kundër dikujt dhe drejtësia nuk zbatohet në mënyrën e duhur, për shkak të disa rrethanave, ai që ka pësuar gabimin do ta marrë të drejtën e tij nga gabuesi në jetën e përtejme, nëse ky i pari nuk e fal këtë të fundit. Dhe që drejtësia të vendoset në mënyrën e duhur, ekzistojnë disa kushte për t'u kualifikuar si dëshmitar, si për shembull: moskonsumimi i pijeve alkoolike, falja e namazeve ditore, sjellja në përputhje me vlerat morale, etj. Nuk është një ngjarje e jashtëzakonshme që Kadiu (gjykatës musliman, që vepron sipas Sheriatit) i Bursës, Mulla Fenari, kundërshtoi sovranin e katërt osman, Jëlldërëm Bajezidin, si dëshmitar në gjykatë për arsye se fitimtari i Nikopolis (1396) kishte neglizhuar disa herë, jo faljen e namazit (pasi një musliman mund të falet individualisht, edhe pse pjesëmarrja në grup është mjaft e rekomanduar), por pjesëmarrjen në *xhema'at* (kongregacioni në xhami). Më pas, sulltani ndërtoi një xhami pranë pallatit të tij, në mënyrë që të kishte mundësi të merrte pjesë për t'u falur në *xhemat*.⁶⁶

Në administratën osmane, i gjithë sistemi ligjor ishte krijuar për të siguruar mirëqenien e popullit. Popullsia e qeverisur, pa dallim race, besimi fetar, ngjyre dhe gjuhe quhej *ra'aja* (njëjës: ra'ijjet). Ra'ijjet fjalë për fjalë do të thotë ata për të cilët

66 Taşköprizade Ahmed Isameddin, *esh Sheka'iku'n Nu'manijetut fi Ulemai'd Devleti'l Aljjeti'l Uthmanijjeti*, Bejrut, 1975, fq. 19.

kujdesesh. Që nga fillimet e saj, administrata osmane ishte mjaft e kujdesshme për *hakkun* e *ra'ijjetit* (rajës) dhe të drejtën si *emaneh ilahijje* (përgjegjësi hyjnore, fetare)⁶⁷ (*ri'ajet-i hukuk-ë ra'aja*).

9. Kada (Drejtësia)

Administrata osmane ishte mjaft e ndjeshme ndaj vendosjes së drejtësisë në territorin osman. Që në fillimet e saj, ata emëruan dijetarë të mirinformuar, të besueshëm dhe të arsimuar për kadinj.

Kadiu i parë osman është Tursun Fekih, njëri prej dhëndurëve të Shejhut Edeballi. Kadiu ishte përgjegjës jo vetëm për vendosjen e drejtësisë, duke ushtruar postin e prokurorit publik, por kishte edhe përgjegjësinë e sigurimit të institucioneve arsimore, që ndodheshin në zonën e tij të mbulimit, si dhe administrimin e vakëfeve. Atij i ishte dhënë një autoritet kaq i madh, sa që “Kadiu musliman i mesjetës bënte një figurë mjaft të mjerë përpara kolegut të tij otoman. I emëruar nga një përgjegjës i autoriteteve qendrore, ai ishte i detyruar t’iu jepte atyre fusha të rëndësishme juridiksioni, dhe ishte tërësisht në varësi të bashkëpunimit të tyre mjaft të paqartë, për ekzekutimin dhe zbatimin e gjykimeve të tij. Nga ana tjetër, kadiu otoman ishte autoriteti qendror në zonën e tij të juridiksionit, e cila në sistemin otoman të administrimit provincial, njihet si *kaza* – zona e administruar nga një kadi; pasi *vilajeti* qeverisej nga një Vali. Për më tepër, ai i përkiste hierarkisë krenare dhe të fuqishme të autoriteteve gjyqësore dhe teologjike, të gatshëm për ta mbështetur atë në çdo përballje me institucionet ushtarake, ose politike dhe i kryesuar nga *Shejh-ul-Islami* (ose Kryemuftiu) dhe dy Kaziaskerëve (gjykatësve ushtarakë) në kryeqytet, kaq të madhërisëm dhe të respektuar sa që sulltani vetë u ngrit në këmbë për t’i pritur, kur ata erdhën për ta uruar për

67 Feridun Beğ, *Münsheat-ı Selatin*, I, fq. 69.

festën e Bajramit.”⁶⁸ Për ta mbajtur institucionin e kadiut në një pozicion mbi shoqërinë dhe për të mbrojtur qëndrimin e tij kishte rregulla shumë të përpikta: një kadiu i ndalohej të merrte pjesë në aktivitete tregtare; të merrte hua, apo të jepte hua para; të merrte dhurata të mëdha ose të vogla; të hante në ngjarjet në të cilat ishte i ftuar etj. Një kadi e ushtronte detyrën e tij për një periudhë jo më të gjatë se 20 muaj. Në rastin kur në këtë post ishin të emëruar zyrtarë të lartë, kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës ishte e kufizuar deri në një vit. Kjo masë zbatohet për të parandaluar krijimin e miqësisë së ngushtë me njerëzit, gjë që mund të ndikonte negativisht në gjykimin e tyre në ndonjë rast kur këta njerëz mund të ishin të përfshirë. Nga ana tjetër, duke ndjekur praktikën islame, një kadi do të shihej si i hequr nga detyra e tij pas kësaj periudhe të caktuar dhe do të qëndronte në pritje për t’u caktuar në një vend tjetër, duke shkuar në Stamboll. Gjatë kësaj periudhe pritjeje, ai do të rifreskonte njohuritë e tij.

Halifi ishte ai që miratonte gjykimin e kadiut. Duke pasur një shoqëri të vendosur dhe të qëndrueshme, administrata osmane emëronte kadinj që ishin diplomuar në medresetë (universitetet) më të mira. Meqenëse *medhhebi* i përgjithshëm ishte *hanefi*, kadinjtë gjykonin sipas medhhebit hanefi. Zonat e populluara me pjesëtarë të medhhebit *shafi’i*, kishin kadinjtë shafi’i dhe ata gjykonin sipas atij *medhhebi*. Në Afrikën e Veriut kishte **kadinj** të shkollës *hanefi* dhe *maliki*.

Në territorin osman ishte e mundur që një individ me disa aftësi të caktuara, të bëhej *Sadrazam*, edhe nëse ai nuk kishte një arsimim të duhur. Por, ishte e pamundur për këdo që të bëhej kadi, madje edhe i një qyteze të vogël, nëse nuk do të ishte kualifikuar nëpërmjet arsimimit të medreseve.

68 Bernard Lewis, *The Emergence of Modern Turkey*, botimi i dytë, Oxford University Press, 1968, fq. 14.

Nekibu'l Eshraf

Pasardhësit e Pejgamberit të Fundit Muhammed (Paqja qoftë me të) pasuan nga vajza e tij, Fatime (r.a) dhe djemtë e saj: Hasani dhe Hysejini (r. anhumana). Ata, që ishin pasardhës të Hasanit (r.a.), u quajtën *shurefa*, ose **eshraf** (shumësi i *sherif*); dhe ata, që ishin pasardhës të Hysejinit (r.a.), u quajtën *sadat* (shumësi i *sejjid*). Këta tituj u përdorën nga Abasidët, duke filluar nga shekulli 4/10, dhe vazhduan të përdreshin edhe nga strukturat e tjera politike muslimane. Ata mbanin një turban dhe një *xhubbe* të gjelbër gjatë viteve të qeverisjes së Harun Rashidit. Sulltani turk Memluk i Egjiptit, Eshraf Shaban, e rigjallëroi këtë zakon në vitin 773/1371, duke i urdhëruar *sejjidët* dhe *sherifët* të vishnin turbanin e gjelbër. Zonjat e këtij grupi mbanin gjithashtu një shami të gjelbër mbi kokat e tyre.

Kur Devleti Osman mori drejtimin e muslimanëve, edhe *sejjidët* dhe *sherifët* hynë nën drejtimin e tyre. Sulltanët osmanë i respektonin shumë ata. Jëlldërëm Bajezidi (1389-1402) emëroi **Sejjid Ali Natta b. Muhammedin** si kryetarin e tyre në Ramazan 802/maj 1400. Gjatë viteve të drejtimin të Sulltan Bajezidit II (1481-1512), **Sejjid Muhammedi** u caktua si kryetari i këtij grupi të nderuar, në vitin 900/1494, me titullin **Nekibu'l Eshraf**. Ky post i Nekibu'l Eshrafit vazhdoi të ekzistonte deri në fund të Devletit Osman.

Sejjidët dhe *sherifët* ishin të përjashtuar nga taksat në Devletin Osman. Nekibu'l Eshrafi paguhej nga Bejtu'l Mali. Kur vendosej Sulltani/Halifi i ri, Nekibu'l Eshrafi duhej të bënte *bejatin* (betimin e besnikërisë), dhe më pas ndiqej edhe nga dinjitarët e tjerë. Ai ishte i pari që uronte sulltanin me rastin e Bajramit. Kur Nekibu'l Eshraf shkante në një fushatë xihadi së bashku me sulltanin, ai do të qëndronte nën **Sanxhak-ë Sherifin** (flamuri i nderuar i Pejgamberit të Fundit Muhammed p.q.m.t.). *Sejjidët* dhe *sherifët* zakonisht thërrisnin *tekbir* dhe *salavat* kur Sanxhak-ë Sherifi nxirrej nga dhoma e vet në

Pallatin Topkapu, ndërsa ata thërrisnin tekbire dhe salavat nën Sanxhak-ë Sherifin gjatë xhihadit.

Nëse dikush bënte një gabim, nuk do të dërgohej përpara kadiut, por do të shkonte tek Nekibu'l Eshrafi në Stamboll, ose te *kajmekami* i tij (përfaqësues, që ishte po ashtu *sejjid*) në provincat, dhe do të gjykohej dhe burgosej nga ky përfaqësues.⁶⁹

9.1 Shejhulislami

Titulli “Shejhulislam” filloi të përdorej gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 4-të H/10-të e.s., dhe iu jepej atyre dijetarëve, të cilët ishin të aftë të diskutonin mbi çështjet gjyqësore që shqyrtoheshin nga *fukahatë* (ekspertë të ligjit të Islamit). Duke qenë se ishte *superfuqia* muslimane, Devleti Osman e institucionalizoi postin e Shejhulislamit. Dhe ky post fitoi një rëndësi kaq të madhe, që asnjë entitet tjetër politik musliman nuk e kishte arritur më parë.⁷⁰

Për shkak të faktit se Halifi/Sulltan (meshru/imami ligjor) është mëkëmbësi i Allahut në Tokë, mban përgjegjësi vetëm ndaj Tij, dhe ka për detyrë të veprojë në përputhje me Kur’anin dhe Sunnetin, në rast të pakujdesisë së tij, për këtë rrjedhë veprimesh, ai humbet të drejtën e tij të bindjes dhe përruljes. Autoriteti i tij kufizohet nga Sheriati ⁷¹ dhe për këtë arsye ishte një nevojë themelore që ai të emëronte një studiues, dijetar, për ta këshilluar për çështjet e Devletit, që duhet të zgjidheshin në përputhje me Sheriatin.

Në administratën osmane, Shejhulislami ishte i barabartë me Sadrazamin. Në çdo çështje të rëndësishme ishte e detyrueshme që Devleti të merrte “fetva” nga Shejhulislami. Me fjalë të tjera, Shejhulislami ishte zyrtari më i lartë që jepte

69 İ.H. Uzunçarşılı, *Osmanlı Devletinin İlmiye Teşkilatı*, Ankara: 1984, fq. 161-170.

70 J.H. Kramers, “Şeyhülislam” *İslam Ansiklopedisi XXI*, Stamboll: 1979, fq. 468.

71 Ahmed Akgündüz, *Osmanlı Kanunnamelerinin Hukuki Tahlileri*, Stamboll: 1990, I, fq. 47. Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, fq. 179. Po aty, fq. 181.

mendime ligjore për çështje të rëndësishme të Devletit Osman. Edhe rrëzimi i një sulltani osman mund të bëhej i mundur vetëm nëpërmjet fetvas së tij.

Shejhulislami ishte kreu i sistemit gjyqësor dhe i arsimit, dhe i vakëfeve (fondacioneve fetare) në të gjithë territorin osman. Shejhulislam Ebussuud Efendiu filloi të emëronte, në vitin 962/1574, *muderrisë* (profesorë në medrese), kadinj dhe muftinj në qyteza dhe qytete, imamë dhe muezinë në xhami.⁷² Me kalimin e kohës, Shejhulislami filloi të emëronte edhe kaz-askerë, pasi këshillohej edhe me Sadrazamin për këtë çështje.⁷³

Sadrazami, në vitin 992/1584, vizitoi Shejhulislamin, dhe ky veprim u kthye në një rregull më pas. Shejhulislami e vizitonte Sadrazamin vetëm kur ky i fundit emërohej në këtë post. Sadrazami shkonte për *iftar* (darkë në fund të ditës së agjërimit), që jepej nga Shejhulislami me ftesë të këtij të fundit.⁷⁴

Shejhulislami shkonte në xhihad së bashku me Sulltanin/Halif, duke filluar nga fundi i shekullit të XVI dhe gjatë shekullit XVII. Gjatë fushatës së xhihadit, ishte zakon që të vendoseshin tre *tuga* (flamuj të ngritur me bisht kali në maje) përpara tendës së Shejhulislamit dhe një numër i njëjtë *tugash* vendosej përpara tendës së vezirit.⁷⁵

Shejhulislami dhe Sadrazami drejtonin namazin e *zuhrit* (drekës) më 15 Ramazan në **Xhaminë Aja Sofja**, dhe më pas ata vizitonin Halifin/Sulltan, i cili hapte kutinë e veshjeve (bohça) të **Hërka-i Sherif** (manteli i Nderuar i Pejgamberit të fundit p.q.m.t.) në Pallatin Topkapu, me një ceremoni të madhe, ku merrnin pjesë zyrtarët e lartë të Hilafetit Osman.⁷⁶

Muhammed Sehmseddin Fenari (751-834/1350-1431) është pranuar si muftiu i parë (Shejhulislam). Ai u emërua në vitin

72 Uzunçarshılı, fq. 179.

73 Po aty, fq. 181.

74 Po aty, fq. 187-188.

75 Po aty, fq. 206.

76 Po aty, fq. 207.

1424⁷⁷ dhe u pasua në këtë post nga **Mulla Jegani** dhe **Fahreddin Axhemiu**.⁷⁸ Shejhulislamët më të famshëm osmanë janë: **Mulla Husrevi**, **Mulla Gyranu**, **Ali Xhemali Efendiu** (1503-1525), **Kemal Pashazade** (1525-1533) dhe **Ebussuud Efendiu** (1545-1574).

Pas përpjekjeve të Perëndimit, posti i Shejhulislamit filloi të humbiste rëndësinë që kishte fituar. Në vitin 1839, një organizatë e quajtur *Shura-jë Devlet* (këshilli konsultativ) u themelua, duke zvogëluar në këtë mënyrë rëndësinë e këtij posti. Kur *Adlije Nezareti* (Ministria e Drejtësisë) u krijua në vitin 1879, ajo ndërmoi një lëvizje tjetër për të frenuar juridiksionin e Shejhulislamit.⁷⁹ Shejhulislami vazhdoi të ishte anëtar i kabinetit të qeverisë osmane deri në fund të këtij entiteti shoqëroro-politik në vitin 1922.

Pozicioni i Shejhulislamit mund të kuptohet më mirë nëse paraqitet në tabelën e mëposhtme:

77 Mustakimzade Sulejman Sa'deddin, *Devhatu'l Meshajih*, Stamboll: 1978, fq. 3-4; Michael M. Pixley, "The Development and Role of Seyhulislam in the Early Ottoman History", *Journal of the American Oriental Society*, vëll. 96, nr. 1, janar-mars 1976, fq. 92.

78 R.C. Repp, *The Mufti of Istanbul: a study in the development of the Ottoman learned hierarchy*, Oxford University Computing Service: 1986, fq. 98-105.

79 J.H. Kramers, fq. 488. Sovranët osmanë ishin aktualisht dhe Halifë që nga Muradi I (1362-1389). Djali i tij, Bajezidi (1389-1402), ishte udhëheqësi i territorit musliman dhe iu shkaktoi humbje ushtrive të bashkuara të Kryqëzatave, në Nikopolis, në vitin 1396. Fatih Mehemedi (1451-1481) ishte Halif, siç përmendet edhe nga Kemal Pashazade (në *Tevarih-i Al-i Osman VII*, fq. 194, 296) që do të thotë në një periudhë përpara se Sulltan Javuz Selimi (1512-1520) të merrte Hilafetin simbolik të Abasidëve me fitoren që arriti ndaj memlukëve. Por, osmanët theksojnë titujt "Sulltan", "Padishah", "Hakan" që tregojnë pushtetin "aktual" dhe të "vërtetë".

HALIFI/SULLTANI⁸⁰

<i>Sadrzami</i>	<i>Shejhulislami (Mufti i Stambollit)</i>
administrim i përbotshëm	Fe, ligj
sekretar ushtarak	arsimim, evkaf
<i>Kahja Beğ</i>	<i>nekibu'l eshraf</i>
Ministër i Luftës dhe i Brendshëm	Inspektorë
Reisul Kuttab (Ministër i Punëve të Jashtme)	Kudat (Gjykatësit)
Çavush Bashë (Ministër i Policisë) ⁸¹	Nuvvab

9.2 Kadiaskeri (Kazaskeri)

Kadilkudat (Kryekadiu) sipas praktikës osmane quhej **Kadiasker** (gjykatës ushtarak), por ai nuk ishte vetëm i tillë. Ai mund të emëronte kadinj dhe mbante përgjegjësi për të gjitha institucionet gjyqësore, dhe arsimore, që ishin nën juridiksionin e tij.

Kur osmanët ndjenë nevojën e këtij posti për të administruar një numër çështjesh gjyqësore, për ushtarët dhe popullsinë muslimane, që banonte në territore të mëdha, ata krijuan postin e Kadiaskerit rreth vitit 1360. **Xhendereli Kara Halili**, kadiu i Bursës, u emërua si kadiasker.⁸²

Me kalimin e kohës, Devleti Osman krijoi dy poste për kadiaskerin: një për Rumelinë (pjesën evropiane të territorit osman) dhe një për Anadollin (pjesën aziatike të territorit osman). Kadiaskerët ishin anëtarë të *Divan-ë Hymajunit*. Detyra e tyre ishte të emëronin kadinjtë dhe muderrisët në rajonin e tyre.

80 Sovranët osmanë ishin edhe Halifë.

81 Përmbledhje me disa modifikime nga: Stanley Lane-Poole, *Turkey*, Londër: 1986, fq. 324.

82 Uzunçarşılı, *Osmanlı Tarihi*, I, fq. 166.

Ata vepronin njëkohësisht edhe si gjykatës të gjykatës së lartë. Vetëm nëse kishte ndonjë autorizim ose urdhër tjetër, kadiaskeri i Rumelisë vepronte si gjykatës. Për arsye se shtrirja e Devletit Osman ishte drejt *daru'l-harbit*, Evropës, Kadiaskerët dhe Bejlerbejtë e Rumelisë, kishin përparësi në administratë dhe ceremonitë ndaj homologëve të tyre që ishin përgjegjës për pjesën aziatike.

Kur pjesa Lindore dhe pjesa Juglindore e Anadollit u aneksuan nga Javuz Selimi (1512-1520) në vitin 922/1516, në Dijarbakër u vendos një kadiasker i tretë, për pjesën arabe dhe *axheme* (perse). Kur Biladu'sh-Shami (që në ditët e sotme quhet "Siria") dhe Egjipti u aneksuan, zona e juridiksionit të kadiaskerit të tretë u zgjerua dhe selia e tij kaloi në kryeqytet. Më pas, ky post u shfuqizua dhe zona e tij e juridiksionit u shkri me atë të kadiaskerit të Anadollit. Posti i kadiaskerit vazhdoi të funksiononte deri në fundin e qenies së Devletit Osman.⁸³

Kadiaskeri emërohej nga kadinjtë me përvojë që mbanin poste të larta. Mandati i tij në këtë post ishte njëvjeçar.⁸⁴ Kadiaskerët ishin edhe anëtarë të Divanit të Sadrazamit. Vezirët pjesëmarrës në këtë divan, qëndronin në krahun e djathtë të Sadrazamit, ndërsa kadiaskerët qëndronin në krahun e majtë të tij.⁸⁵

Vetë kadiaskerët mbanin Divan çdo ditë, me përjashtim të ditës së martë dhe të mërkurë, si dhe jepnin vendime gjyqësore brenda territorit të juridiksionit të tyre.⁸⁶

Kadiaskeri ishte kryetari i një organizate mjaft të madhe dhe në shërbimin e tij kishte shumë ndihmës dhe funksionarë. Më i rëndësishmi prej tyre ishte *kassami* ushatarek, i cili e

83 Uzunçarşılı, *Osmanlı Devletinin İlmiye Teşkilatı*, Ankara: 1984, fq. 152.

84 Po aty, fq. 152.

85 Po aty, fq. 153.

86 Po aty, fq. 154.

përfaqësonte atë me autoritet të plotë në provinca. Të tjerë ishin: *tezkirexhi, berat katibi, ahkam katibi, muhzir, muhasebexhi*.⁸⁷

9.3 Ihtisab Agasë (Ağası)

Ihtisab do të thotë “devotshmëri”, “një veprim që kryhet për të kënaqur Krijuesin, por pa pritur asnjë shpërblim nga i krijuari”. Ky është një institucion i veçantë islam, duke i pasur rrënjët e tij në parimet islame të *el-Emr bi'l Ma'ruf ve'n Nahj 'ani'l Munker* (të urdhërosh atë që është e mirë, dhe të ndalosh atë që është e ligë). Ndryshe nga individualiteti, ose socializmi, që i kushton më tepër rëndësi individit dhe shoqërisë respektivisht, Islami krijon një baraspeshë të këndshme midis rolit të individit dhe shoqërisë. Nga njëra anë, çdo person përgjigjet për veten e tij, nga ana tjetër, ekziston një përgjegjësi shoqërore e deklaruar në fenë islame: “Ruajuni nga e keqja (nga dënimi) që nuk i godet vetëm ata që bënë mizori prej jush...”.⁸⁸ Për këtë arsye, vendosja dhe ruajtja e drejtësisë në çdo fushë të jetës, ishte një pikë kryesore për administratën osmane.

Çdo civilizim krijon llojin ose tipin e tij të qenies njerëzore, dhe në këmbim, kjo lloj qenie njerëzore kontribuon ndaj shoqërisë së saj dhe civilizimit. Islami i kushton rëndësi atij tipi individi besimtar, që është i përgjegjshëm, i kujdesshëm, i ndër-gjegjshëm ndaj vetëvlerësimit, ashtu sikurse thotë edhe Pejgamberi i Fundit (Paqja qoftë me të): “Secili prej jush që shikon një të keqe, duhet ta ndryshojë (parandalojë) atë të keqe me dorën e tij, nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij (duke këshilluar keqbërësin), nëse nuk është e mundur, atëherë të jetë i zemëruar në zemrën e tij; dhe kjo është kategoria më e dobët e besimit.”⁸⁹ Çdo musliman supozohet të ndjekë këtë drejtim të natyrshëm të ndërgjegjes.

87 Mehmet İpşirli, *XVII. Yüzyil Başlanna Kadar Osmanlı İmparatorluğunda Kadiaskerlik Müessesesi* (Disertacion i publikuar pas doktoraturës: Universiteti i Stambollit, Fakulteti i Letërsisë), fq. 186-187.

88 *el Enfal*: 25.

89 Muslim, *es Sahih, Kitabu'l Imareh*, 20.

Si një shoqëri e organizuar, aspekti i përgjegjesisë ishte i mishëruar në institucionin e *ihhtisabit*. Ai që e zbatonte këtë detyrë në shoqërinë osmane quhej *Ihtisab Agasë* (Mjeshtër i *Ihtisabit*). Si një zyrtar i rëndësishëm, Ihtisab Agasë duhet të kishte kualifikime të caktuara: së pari, ai duhet t'i përkiste fesë islame. Duke qenë se ai duhej të përmbushte detyra që vinin nga Kur'ani, do të kishte qenë një kontradiktë e thellë, që këto detyra t'i ngarkoheshin dikujt që nuk pranon Mesazhin e Përrjetshëm, Islamin. Personi në ngarkim duhet të ishte një mashkull në moshë madhore dhe shqetësimi i tij kryesor duhet të ishte të kërkonte kënaqësinë e Allahut (subhanehu ve te'ala). Devotshmëria, sjellja e mirë, të qenit i drejtpërdrejtë, të pasurit të një karakteri të fortë, njohuri të mira të Sheriatit, si dhe kulturë të përgjithshme dhe fuqi për të përmbushur, dhe zbatuar verdiktin e Tij, ishin kushtet e tjera për t'u emëruar si Muhtesib (Ihtisab Agasë).⁹⁰ Ai emërohej në parim për një vit, por shpesh, mandati i tij arrinte deri në tre ose katër vjet.⁹¹

Ihtisab Agasë kishte disa ndihmës, të cilët e ndihmonin atë në zbatimin e gjykimeve të tij. Ata ishin gjithashtu mbartës të cilësive të mira. Nëse njëri prej tyre kryente një gabim, ai do të shkarkohej nga detyra menjëherë. Ihtisab Agasë (Muhtesibi) lëvizte në të gjithë qytezën, duke e patrulluar atë dhe parandalonte gjithçka të keqe që ai ndeshte. Autoriteti dhe përgjegjësia e tij përfshinte: të kontrollonte nëse imamët recitonin Kur'anin në mënyrën e saktë, duke mos shtrembëruar asnjë shqiptim të *ajeteve* për hir të harmonisë muzikore; të kontrollonte njësitë matëse dhe peshoret në treg; të kontrollonte cilësinë e mallrave dhe çmimet; të parandalonte njerëzit që të mos pengonin kalimtarët në trotuare duke vendosur ngarkesa në to; të parandalonte ndërtesat të mos ngushtonin rrugën duke kapërcyer kufijtë e paracaktuara; të parandalonte njerëzit të mos mbingarkonin kafshët e tyre; të kontrollonte banjat publike; të siguronte

90 el Maverdi, *el Ahkamu's Sultanijetu*, Egjipt: 1973, fq. 241.

91 Ziya Kazıcı, *Osmanlılarda Ihtisab Müessesesi*, Stamboll: 1987, fq. 54-61.

ushqime të mjaftueshme për qytezën; të jepte leje për hapjen e dyqaneve etj. **Ihtisab Agasë** siguronte që Falja e së Xhumasë të kryhej kudo ku mblidheshin 40 muslimanë meshkuj, pasi ky numër është kushti sipas qëndrimit Hanefit për mbajtjen e namazit të së Xhumasë. Ai kishte autoritetin për të ndërhyrë ndaj çdo veprimi, që nuk ishte në linjë me vlerat islame. Ai e merrte autoritetin e tij nga kadinjtë.

Njëra nga detyrat e Muhtesibit, ishte të mblidhte taksat nga tregjet. Ky detyrim filloi që në periudhën e Osman Gaziut.⁹² Siç jemi në dijeni, Fatih Mehemmedi (1451-1481) caktoi detyrat dhe përgjegjësitë e Muhtesibit.

Gjatë periudhës së Sulltan Mahmudit II (1808-1839), ky institucion u shndërrua, në vitin 1242/1826, në një ministri (Ihtisab Nezareti) dhe Muhtesibi u quajt "**Ihtisab Nazërë** (Ministri i Ihtisabit). Me themelimin e organizatës policore në vitin 1261/1845 dhe **Zaptije Myshirijjeti** në 1261/1846, disa nga detyrat e Ihtisab Nazërë i kaluan kësaj strukture, dhe Ihtisab Nazërë vazhdoi të mbante përgjegjësinë për aktivitete tregtare dhe fiksimin e çmimeve (*nerh*). Në vitin 1271/1854, ky institucion u shfuqizua me themelimin e **Shehremanetit** (Bashkisë) së Stambollit.⁹³

92 Mehmed Neşri, *Kitab-ı Cihan-Nüma*, botuar nga F.R. Unat dhe M.A. Köymen, Ankara, Türk Tarih Kurumu: 1949, I, fq. 110.

93 Z. Kazıcı, *vepër e cituar*, fq. 33.

IV – ORGANIZIMI USHTARAK

10. Ushtria

I themeluar mbi bazën e konceptit dhe devotshmërisë ndaj parimeve të *“I’la-ji Kelimeti’l-lah”* (zbatimi i urdhrave të Allahut), Devleti Osman kishte nevojë për një ushtri të fortë. Ata i kushtuan një kujdes të veçantë faktit që të kishin një ushtri gjithmonë të gatshme; që në fillimet e Devletit të tyre, ata krijuan dhe zhvilluan një sistem të përsosur për të pasur një ushtri të fuqishme dhe të organizuar mjaft mirë, pa pasur nevojën e investimeve të mëdha financiare nga Bejtu’l Mali. Ata kishin një ushtri qendrore dhe një ushtri edhe më të madhe provinciale; të dyja këto ushtri së bashku përbënin *Ordu-ju Hymajun* (Ushtri-në Qiellore).

Me kalimin e kohës *Ordu-ju Hymajun*,⁹⁴ siç u quajt nga osmanët, ishte e përbërë nga njësitë e mëposhtme:

94 Hyma është një shpend, që është konsideruar se ka jetuar gjithnjë lart në qiej, *hymajun* do të thotë që i përket *hyma*-s; qiellor. Si bartës të Mesazhit të Fundit Qiellor të Islamit, osmanët emërtonin çdo institucion dhe objekt të rëndësishëm me emrin *hymajun*: *Divan-ë Hymajun* (Divani Qiellor), *Donanma-jë Hymanjun* (Flota Detare Qiellore); *Hatt-ë Hymajun* (Dorëshkrimi i Sulltanit/Halif); *Myhr-i Hymajun* (Vula e Sulltanit), *Otag-ë Hymajun* (Tenda e Halifit/Sulltan, që ngrihej gjatë xhihadit); *Bab-ë Hymajun* (Porta e parë e rezidencës së Haifit/Sulltan: Pallatit Topkapusu; porta e dytë është *Babu’s Selam*, porta e tretë është: *Babu’s Sa’adet*). Nuk është e nevojshme të themi se nomenklaturat NUK duhet të përkthehen dhe nëse do t’i referohemi *Divan-ë Hymajunit* si **“Këshilli Perandorak”** pa dyshim ky do të ishte një **shtrembërim i madh**. Devleti

ORDU-JU HYMAJUN

Kapukullu Askerleri		Ejalet Askerleri	
<u>Ushtria qendrore</u>		<u>Ushtria provinciale</u>	
Këmbësoria	<i>Kalorësia</i>	<u>Jerli Kullu</u>	<u>Serhad Kullu</u>
Kapëkullu		Jaja	Tëmarlë Suvariler
Piyadesi			
1. Jeniçeri	Sipahi	1. Azeb	1. Akënxhë
2. Xhebexhi	Silahdar	2. Sekban	2. Deli
3. Topçu	Sag Ulufexhi	3. Ixhareli	3. Gonyl-ly
4. Humbaraxhë	Soll Ulufexhi	4. Llagëmxhë	4. Beshli
5. Llagëmxhë	Saç Garibler Soll Garibler	5. Muselem	

10.1 Ushtria qendrore

Në fillimet e tyre, trupat osmane ishin kryesisht trupa kalorësish. Çdo mashkull i aftë supozohej se ishte një *gazi* (luftëtar në xhihad). Pas betejave gaziinjë ktheheshin në fshatrat e tyre, për t'u kujdesur për bagëtinë dhe për të punuar, dhe kultivuar tokën e tyre. Ata ishin nën administrimin e sistemit *ikta*.⁹⁵

Orhan Gaziu (1326-1362) ishte i pari, që krijoi ushtrinë osmane të rregullt, të përbërë nga djem turq të moshave të reja: trupa e këmbësorisë, që quhej "*jaja*"⁹⁶ dhe që ishte e përbërë prej 1000 muxhahidinësh; dhe njësitë kalorësiake të quajtur "*muselem*" (që do të thotë të përjashtuar nga taksat). *Jaja* kishin një komandant për çdo 10 ushtarë, dhe një "*jyzbashë*" për 100 ushtarë. 30 *muselmë* konsideroheshin si një "*oxhak*" (njësi). Trupat e ushtarakëve *jaja* dhe *muselem* shërbyen me devot-

Osman nuk ishte një fuqi imperialiste, por ishte themeluar mbi bazën e parimeve të **xhihadit: përhapja e fesë islame, zbatimi i Urdhrave Hyjnore të Krijuesit**. Për fuqitë perandorake lexuesit mund t'i referohen: **J.M. Roberts, *The Hutchinson History of the World*, Londër: Hutchinson 1987, fq. 835.**

95 Uzunçarşılı, *Osmanlı Devleti Teşkilatından Kapıkulu Ocakları*, Atatürk Kültür, Dil ve Tarih Yüksek Kurumu, Ankara: 1984, I, fq. 1.

96 Neşri, *vepër e cituar*, I, fq. 154.

shmëri të madhe deri nga mesi i shekullit të 15-të. *Jajatë* e Devletit Osman mbanin **borkun** (börk) e bardhë (kapele prej shajaku), që të dalloheshin nga ushtarët e Emirateve të tjera turke në Anadoll.

Nga ana tjetër, kufijtë e Devletit Osman filluan të zgjeroheshin gjatë periudhës së Orhan Gaziut, dhe në atë të djalit të tij Murad Hanit. Hapësirat e gjera të tokës që u hapën ndaj Islamit ishin kryesisht të banuara nga të krishterë. Për këtë arsye, ishte mjaft e nevojshme që numri i popullsisë muslimane të rritej në këto toka të reja të përvetësuara. Me këshillën e një dietari, Kara Rystemit, ata filluan të merrnin një rob lufte në pesë të tillë si plaçkë lufte e Devletit, duke u bazuar në Ligjin e Sheriatit (Kur'ani, *el-Enfal*, *ajeti* 41) në vitin 763/1361.⁹⁷ Robërit e rinj në moshë u jepeshin fshatarëve për t'i ndihmuar ata në punët e tyre dhe ishin të mësuar me vështirësitë, dhe iu përshtatën mënyrës së jetesës islame duke mësuar edhe gjuhën turke. Kjo praktikë u quajt *Tyrke vermek* (t'i japësh turqëve). Disa vite më vonë, ata u rekrutuan në ushtri dhe morën emrin *jeniçeri* (ushtar i ri). Në fillimet e tyre, robërit e Devletit punësoheshin në anijet që transportonin kalorësit së bashku me kuajt e tyre, nga Anadollit për në Evropë. Por disa prej tyre arratiseshin. Për pasojë, Devleti Osman zhvilloi një sistem të quajtur *devshirme* (mbledhje). Ata mblodhën fëmijë, pasi ishin konvertuar në fenë islame dhe kishin mësuar gjuhën turke, dhe vendoseshin në *Axhemi Oxhagë* (*Ocağı*), dhe pasi trajnoheshin atje, ata ktheheshin në ushtarë *jeniçerë*. Të rinjtë që iu përkisnin moshave midis 10 dhe 20 vjeçare trajnoheshin në *Axhemi Oxhagë*.⁹⁸ Më pas, ata rekrutoheshin si jeniçerë dhe spahinj. Ata ishin skllavër personal të sulltanit, siç tregon edhe vetë fjala *kapëkullu*: skllav i Portës. Ata paguheshin çdo tre muaj dhe merrnin një pagë që quhej *ulufe*.

97 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, I, fq. 6-7.

98 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, I, fq. 11-13.

10.1.1 Jeniçerët

Organizata e jeniçerëve u themelua në vitin 1362 dhe mori formën e saj të re gjatë periudhës së Muradit I (1362-1389). Njësitë e tyre ushtarake quheshin **orta** dhe komandanti i tyre ishte **çorbaxhiu**. Komandanti i përgjithshëm quhej **Jeniçer Agasë**.⁹⁹ Sulltani osman ishte numri një i jeniçerëve. Borku (kapela prej shajaku) ishte e njëjtë me atë që kishin mbajtur *Ahinjtë*.

Jeniçerët pozicionoheshin në qendër së bashku me sulltanin gjatë fushatave të xihadit. Ata ishin ushtarë të stërvitur mirë, të shkëlqyer dhe kryenin shërbime të mëdha gjatë shekullit të 16-të dhe të 17-të. Disa njësi apo divizione ushtarake jeniçere ishin të pozicionuara madje edhe nëpër kështjella.

10.1.2 Xhebexhi

Detyra e tyre ishte të siguronin dhe të mbanin pajimet e luftës së jeniçerëve të tilla si: harku, shigjeta, pushka, shpata, baruti, plumbat, koraca, heshtat. Ata i mbanin këto pajime gjatë fushatave të xihadit në front dhe ua shpërndanin ato jeniçerëve. Pas betejave ata i mblidhnin të gjitha pajimet dhe riparonin ato që kishin nevojë të riparoheshin.

Në Stamboll ata kishin një depo të quajtur *xhebehane*, si dhe kishin nga një magazinë në kështjellat dhe vendet që gjendeshin afër kufirit.¹⁰⁰

10.1.3 Topçu

Detyra e tyre ishte transportimi i topave dhe përdorimi i artilerisë në fushën e betejës. Osmanët e përdorën artilerinë për herë të parë gjatë betejës së Kosovës, në vitin 1389. Më pas, ata përdorën këtë armë të re të kohës në Betejën e Nikopolisit të vitit 1396.

99 *Netajixh*, I, fq. 142; *Kapıkulu Ocakları*, I, fq. 145-146.

100 *Kapıkulu Ocakları*, II, fq. 3-5.

Osmanët e kishin vendosur artilerinë edhe nëpër kështjella. Duhet të theksojmë në këtë rast se ata përdorën mortajën gjatë kohës së Fatihut (1451-1481).¹⁰¹

Topat e vegjël mbaheshin nga devetë, kuajt etj. Por, kur ata transportonin topa të kalibrit të madh, ata i transportonin ato me karroca.

10.1.4 Humbaraxhë

Ky grup ushtarësh ishte pjesë e administrimit të Xhebe-xhinjve dhe Topçuve. Ata bënë eksplozive të quajtur *humbara*.

Disa prej njësive të tyre nuk ishin me rrogë, por ata kishin **timar** dhe shërbenin në kështjella. Timaret e tyre ishin në afërsi të kështjellave në të cilat shërbenin.

Një fisnik francez, Konti Bonneval, u strehua në territorin osman në vitin 1142/1729, dhe u konvertua në fenë islame duke marrë emrin Ahmed. Ai më pas u bë i njohur me emrin Humbaraxhë Ahmed Pasha, i cili reformoi dhe zhvilloi njësitë e humbaraxhinjve në vitin 1144/1731.¹⁰²

Humbara ishte një bombë e vogël e mbushur me eksploziv, që hidhej nga mortaja. Ekzistonte edhe një lloj tjetër eksplozivi, që hidhej me dorë. *Humbara* hidhej nëpërmjet mortajës drejt caqeve pa qenë e nevojshme t'i shikojë ato. Për këtë arsye ky grup ushtarësh kryente shumë shërbime gjatë rrethimit të kështjellave, si dhe hapje të tyre ndaj Islamit.

10.1.5 Llagëmxhë (Lağımçı)

Ky grup ishte një njësi me shkathësi të larta teknike. Një pjesë e tij ishte nën juridiksionin e komandantit të xhybexhinjëve dhe pjesa tjetër nën juridiksionin e pronarëve të timareve.

Detyra e llagëmxhinjve ishte të hapnin tunele nën dhe drejt kështjellave, që rrethoheshin nga Ordu-ju Hymajun. Ata

101 Po aty, II, fq. 35-36.

102 Po aty, II, fq. 117-119.

gërmonin tunele nën dhe në afërsi të mureve të kështjellave të rrethuara dhe vendosnin aty një sasi të mjaftueshme baruti, në mënyrë që të shpërthenin, dhe të shkatërronin muret dhe kullat. Detyra e tyre kishte nevojë për njohuri të mira në gjeometri dhe inxhinieri.

Nëse personeli i llagëmxhinjve nuk ishte i mjaftueshëm, administrata do të urdhëronte personelin shtesë të llagëmxhinjve nga provincat. Për shembull, Sylejmani i Madhërisëm (1520-1566) urdhëroi ardhjen e llagëmxhinjve nga disa qyteza për t'iu bashkuar Ordu-ju Hymajunit, ndërsa ishte nisur drejt një fushate xhihadi në Sigetvar në vitin 1566.

Njësitë ushtarake të llagëmxhinjve luajtën një rol të rëndësishëm në vitin 1078/1667 gjatë hapjes së kështjellës Kandije në Kretë, që ishte mjaft mirë e fortifikuar.¹⁰³

Llagëmxhinjtë riparonin urat ku do të kalonte Ordu-ju Hymajuni dhe nëse ishte e nevojshme ndërtonin dhe ura të reja.

10.1.6 Kapukullu Syvarisi

Kapukullu Syvarisi (kalorësia) ishin të përbërë nga 6 *bolyke* (bölük = njësi). Dy *bolyket* e para u quajtën *sipah* dhe *silahdar* dhe u krijuan gjatë kohës së Sulltan Muradit (1362-1389). Më pas, atyre iu shtuan edhe 4 njësitë e tjera.

Kapukullu Syvarisi (kalorësia) ishte gjithashtu e përbërë nga sklevër dhe ndihmës personal të sulltanit. Ata ishin kalorës dhe paguheshin më mirë se jeniçerët. *Syvarët* përzgjidheshin nga Jeniçeri Agasë nga radhët e ushtarëve jeniçerë të vjetër, që shërbenin mirë. Disa të rinj të devshirmesë arsimoheshin në Shkollën e Pallatit të quajtur *Enderun*. Ata bëheshin zyrtarë të lartë, komandantë, vezirë dhe sadrazamë. Nga personeli i Enderunit, disa rekrutoheshin edhe si Kapukullu Syvarisi. Ata ishin të edukuar mirë dhe ishin jashtëzakonisht të shkathët për të luftuar mbi shpinën e kuajve.¹⁰⁴

103 Po aty, II, fq. 131-132.

104 Po aty, II, fq. 137-139.

Të gjithë ushtarët kapukullu, njësitë e këmbëtorisë dhe të kalorësisë u shpërbënë në vitin 1826.

10.2 Ejalet Askerleri (Ushtria provinciale)

Ata ishin ushtarë të ejaleteve dhe sanxhaqeve, dhe përbënin pjesën më të madhe të Ordu-ju Hymajun Osmane, dhe ishin ushtarë që mbaheshin nga pronarët e *timareve* dhe *ze'ametit*.

10.2.1 Jerli Kullu

Jerli kullu ishin një personel i rregullt ushtarak dhe kishin një rrogë bazë. Ata ishin ushtarakë të Pashallarëve të Ejaleteve dhe Sanxhkabejve.

10.2.1.1 Azebët

Origjina e kësaj fjale vjen nga gjuha arabe *a'zeb* (beqar, i pamartuar). Azebët ishin me origjinë turke nga Anadolli dhe ishin pararojë. Ata ecnin përpara Ordu-ju Hymajun. Ata ishin të rinj të pamartuar, të rekrutuar mbi bazën e marrjes së një djali të ri nga çdo 20-35 shtëpi në qytezat sipas nevojës. Azebët u shpërbënë gjatë viteve të sundimit të Sylejmanit të Madhërisëm.

Nga ana tjetër, azebë kishte edhe nëpër kështjella; ky grup u krijua nga Fatihu dhe u shfuqizua në vitin 1826.

10.2.1.2 Sekban dhe Tyfenkxhi

Sekbanët ishin ushtarë vullnetarë, që mblidheshin nga fshatrat kur ishte e nevojshme. Ata përdornin shpatën dhe pushkën. Me kalimin e kohës, ky grup u zëvendësua nga një grup tjetër që u quajt *tyfenkxhi*, dhe që ishin po ashtu vullnetarë.

10.2.1.3 Ixhareli

Ky grup ishte personel i artillerisë. Ata jetonin në kështjella dhe në qytezat kufitare. Për arsye se atyre u paguhej *uxhret* (në

gjuhën arabe: uxhrat: (taksë) ata u quajtën ixhareli. Komandanti i tyre u quajt Topçu Agasë.

10.2.1.4 Llagëmxhë

Ata jetonin në kështjellat kufitare. Detyra e tyre ishte të kundërvepronin kundër jobesimtarëve, që ngarkoheshin për të gërmuar dhe hapur tunele. Komandanti i tyre emërohej nga Stambolli dhe quhej Llagëmxhëbashë. Kur llagëmxhinjtë ndesheshin me armiqtë në tunelet e nëndheshme, zhvilloheshin luftime shumë të ashpra.

10.2.1.5 Muselem

Ata nuk ishin ushtarë luftëtarë. Detyra e tyre ishte të shtrojnë rrugët dhe të ndërtonin urat ku do të kalonte Ordu-ju Hymajuni, etj. Ata ishin të përjashtuar nga pagesa e taksave dhe për këtë arsye u quajtën Muselem. Në pjesën evropiane të territorit osman, popullsia e krishterë ishte e punësuar si *muselem*.

10.2.2 Serhad Kullu

Pjesa më me rëndësi e këtyre luftëtarëve muxhahidinë ishte akënxhë oxhagë.

10.2.2.1 Akënxhë (Sulmues)

Këta luftëtarë muxhahedinë iu përkisnin njësisë së kalorësisë së lehtë komando të përbërë nga turq. Prijësi i tyre quhej Akënxhë Beji, që ishte në rang të barabartë me atë të Gjeneral-Majorit. Akënxhë Beji i përgjigjej drejtpërdrejtë Qendrës; Pashai i Ejaletit¹⁰⁵ nuk kishte juridiksion mbi të. Ai kishte liri të plotë për të përzgjedhur ushtarakët e tij vullnetarë; asnjë nuk mund të ndërhynte në rekrutimin e ushtarëve të tij. Akënxhinjtë emër-

105 *Ejalet* ishte një territor i gjerë në administratën osmane. Numri i *Ejaleteve* ndryshoi me kalimin e kohës nga 32 në 36. Egjipti ishte një *Ejalet*. Libia, Budini (pjesa evropiane e Hungarisë) ishin disa *ejalet* të tjera.

toheshin sipas Beut të tyre. Bejlerët më të famshëm ishin Evrenos Bej Ogullarë (Bijtë e Evrenos Beut), Mihalogullarë (Bijtë e Mihal Gazit) dhe Malkoçogullarë (Bijtë e Malkoç Beut). **Komandanti Akënxhë Bej fliste rrjedhshëm deri në 10 gjuhë lokale, në zonën në të cilën vepronte.** Akënxhinjtë ishin muxhahidinë komando të fortë, jashtëzakonisht të guximshëm dhe të stërvitur shumë mirë. Disa prej tyre ishin *tëmarllë* (kishin të drejtën të mblidhnin *oshrin* për zona të caktuara) dhe disa prej tyre ishin të përjashtuar nga taksat. Një Akënxhë Beji komandonte 30.000-50.000 akënxhinj. Mihalogllu Mehmed Beu kishte nën drejtimin e tij më shumë se 50.000 akënxhinj gjatë fushatave të xhihadit në Gjermani, në vitet 1530 dhe 1532.

Akënxhinjtë i paraprinin Ordu-ju Hymajunit me disa ditë. Kur ata hynin në territorin e jobesimtarëve në Evropë, ata ndaheshin në grupe të vogla dhe më pas edhe një herë në disa grupe më të vogla, duke i përngjasuar në këtë mënyrë shembëllimit të degëve të një peme. Për pasojë, 20-30 akënxhinj hynin në secilin prej fshatrave të armikut dhe një numër më i madh hynte në qytezat kufitare, madje edhe më thellë. Rezultati ishte demoralizimi i plotë i kundërshtarit. Akënxhinjtë, për shembull, depërtuan dhe sulmuan “deri në fushën e largët të Mottingut (1408), në veri-perëndimin e skajshëm”.¹⁰⁶ Në shekullin e 16-të, asnjë prej fshatrave në Evropë nuk ishte i sigurt nëse në mëngjes nuk do të sulmohej nga akënxhinjtë. Në Poloni, ende ruhet një kullë, nga e cila roja kishte rënë i goditur nga shigjeta e një akënxhiu.

Akënxhinjtë pësuan një disfatë të madhe në vitin 1595, kur Sinan Pasha urdhëroi mbledhjen e taksës nga ganimeti, gjatë rrugës mbi një urë, duke e ndarë në këtë mënyrë të gjithë ushtrinë në dy pjesë. Kur Vojvoda Mihail i Eflakut (Rumani Jugore në ditët e sotme) sulmoi, pjesa më e madhe e akënxhinjve ruanin prapavijën dhe ata ranë martirë gjatë këtij sulmi. Megjith-

106 Donald Edgar Pitcher, *An Historical Geography of the Ottoman Empire*, Leiden: E.J. Brill, 1972, fq. 5.

atë, ata vazhduan të ishin të rëndësishëm deri në një farë mase, deri në gjysmën e parë të shekullit të 17-të. Më pas, vendin e tyre e zunë kalorësit e Kërëmit (Krimesë).

10.2.2.2 Deli

Origjina e kësaj fjale nga gjuha arabe është *delil* (udhërrëfyes). Ishin tepër të guximshëm, ndaj u quajtën edhe *deli* (të çmendur). Ata ishin pjesë e kalorësisë së lehtë, dhe besohej se ishin ndjekës të linjës së Hazreti Omer b. el-Hattabit.

Ata operonin në pjesën evropiane të territorit osman, dhe njësitë e tyre ishin të përbëra nga turq dhe muslimanë serbë kroatë dhe boshnjakë. Ata mbanin një kokore prej gëzofit të hienës dhe të puplave të shqiponjës; pantallonat e tyre (shallvare) ishin prej gëzofit të ariut, apo të ujkut, një paraqitje kjo që i frikësonte së tepërmi kundërshtarët, që në fillim.

Këta luftëtarë ishin shumë aktivë gjatë shekullit të 16-të, por u shpërbënë në vitin 1826.

10.2.2.3 Gonyl-ly (Gönüllü) (Vullnetar)

Ata ishin njësi të kalorësisë së lehtë, dhe ishin të përbërë nga popullsia, që jetonte në kufirin e pjesës evropiane të territorit osman. Detyra e tyre ishte të mbronin qytezat dhe qytetet në zonat kufitare, dhe merrnin rrogë për këtë. Këta luftëtarë përdornin pushkët dhe ishin mjaft aktivë, deri në fillimet e shekullit të 19-të.

10.2.2.4 Beshli

Besh në gjuhën turke do të thotë: pesë; *beshli*: i përbërë nga pesë, për shkak të faktit që rekrutoheshin mbi bazën e rregullit të një luftëtari nga çdo pesë shtëpi, nga ku morën dhe emrin e tyre beshlinj.

Ishin pjesë e kalorësisë së lehtë dhe merrnin pjesë në *akën* (sulm), sa herë që ishte e nevojshme. Ishin ushtarë me rrogë.

10.2.3 Tëmarllë Syvari

Administrata osmane pranoi që në fillimet e saj **iktanë** islame, duke e marrë atë nga selçukët e Anadollit. Një komandanti, një ushtaraku, që kryente një shërbim të mirë gjatë një fushte të caktuar të **xhihadit**, i jepej një pjesë toke me një numër të caktuar fshatrash, madje edhe qytezash. Ai nuk ishte në zotërim të kësaj pjese toke, por kishte të drejtën të mbliidhte taksën islame **oshr** në emër të Devletit. Në këmbim të kësaj të ardhure, ai duhet të përgatiste, stërviste dhe të mbante një numër të caktuar luftëtarësh muxhahidinë të armatosur, dhe të ishte i gatshëm të merrte pjesë në xhihad, kurdoherë që ishte e nevojshme (praktikisht çdo verë). Forcat që ai përgatiste quheshin "**xhebelu**".

Për arsye se pjesa më e madhe e territorit osman jepej dhe administrohej sipas kësaj praktike, ushtarët muxhahidinë përbënin thelbin e ushtrisë osmane. Ata ishin kalorës shumë të shkathët, dhe përbënin pjesën më të rëndësishme të **Ordu-ju Hymajunit**, deri në fund të shekullit të 16-të të e.s.

Ky sistem timar ishte një institucion shumë i efektshëm; kur zotëruesi i timarit (në gjuhën turke tëmar do të thotë: të kujdesesh për kalin, ta ruash atë) vdiste ose martirizohej në luftë, djali i tij trashëgonte timarin. Kur disa nga luftëtarët muxhahidinë binin dëshmorë, shumë të tjerë prisnin të rekrutoheshin. Pra, Devleti Osman kishte një ushtri të madhe luftëtarësh muxhahidinë në dispozicion, pa pasur nevojën e shpenzimeve të asnjë shume nga **Hazine-i Amire** (Thesari Publik: Bejtul Mal). Dhe, pavarësisht se sa të gjata ishin luftërat, kjo nuk ndikonte mbi Devletin Osman, në lidhje me personelin; një numër i madh rekrutësh të rinj ishin në dispozicion dhe gatishmëri të stërviteshin dhe të viheshin nën shërbimin e zotëruesve të timareve.

11. Flota detare

11.1 Flota qendrore

Flota detare osmane u quajt *Donanma-jë Hymajun* (Flota Detare Qiellore) dhe kryeadmirali ishte *Kapudan-ë Derja*. Ata përdornin anije me rrema dhe anije lundrimi. Anijet ndërtoheshin në disa *tersane*. Fjala *tersane* (depo armësh) u mor nga osmanët nga shtetet perëndimore si: Spanja, Portugalia dhe Venecia, të cilat përdorën formën “darsena” të kësaj fjale që osmanët e transformuan në *tersane*. Vetë fjala *darsena* vjen nga fjala arabe *Daru's-Sina'eh*.¹⁰⁷ Duket se evropianët kanë marrë fjalën *daru's-sina'a* dhe e shqiptuan atë si *darsena*; në të njëjtën mënyrë si për: Xhebelut Tarik për Gjibraltarin, el-Vadil Kebir për Guvadalkebir, el-Kuhul për alkoolin etj.

Tersaneja qendrore osman ishte në Stamboll dhe quhej *Tersane-i Amire*. Përveç Stambollit, osmanët kishin *tersane* për ndërtimin e anijeve në: Gelibollu, Sinop, Iznikmid (Izmit), Suvejsh, Birexhik, Basra, Rusxhuk, Samsun dhe Kefken.¹⁰⁸

Flota detare osmane u fuqizua gjatë kohës së Sulltan Muradit II (1421-1451). Flota detare në atë kohë ushtronte presion mbi Perandorinë e Pontusit të Trabzonit dhe mblidhte taksa prej saj.¹⁰⁹ Para hapjes së Stambollit ndaj Islamit në vitin 1453, flota detare osmane kishte rreth 350 anije,¹¹⁰ por periudha e artë e *Donanma-jë Hymajunit* i përket shekullit të 16-të, kur tre të katërtat e Mesdheut u kthyen në një liqen musliman nën sundimin osman. **Superioriteti në rajonin e Mesdheut kaloi nga bota e krishterë tek Islami më 28 shtator 1538 me zhvillimin e betejës së rëndësishme të Prevezës. Donanma-jë Hymajun, nën drejtimin e Kapudan-ë Derja, Hëzër Hajreddin**

107 Idris Bostan, *Osmanlı Bahriye Teşkilatı XVII. Yüzyılda Tersane-i Amire*, Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1992, fq. 1.

108 Po aty, fq. 14-24.

109 I.H. Uzunçarşılı, *Osmanlı Devletinin Merkez ve Bahriye Tşkilatı*, Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1984, fq. 391.

110 Po aty, fq. 391-392.

Pashait, i shkaktoi disfatë flotës detare të krishterë të Bashkuar, nën drejtimin e admiralit të famshëm Andrea Doria, i cili arriti të shpëtonte lëkurën, duke fikur dritat e anijes së tij kryesore, dhe duke u zhdukur më pas në errësirën e Mesdheut; një veprim ky që u dënua si tepër degradues dhe i pandershëm edhe për një kapiten, e lëre më për një admiral të madh.¹¹¹

Superioriteti osman në Mesdhe e mbajti pozitën e tij deri në vdekjen e **Këllëç Ali Pashait** në vitin 995/1587, i cili ishte stërvitur nga Hëzër Hajreddin Pasha.¹¹² Superioriteti musliman në Mesdhe u rigjallërua nga **Mezomorta**¹¹³ **Hysejin Pasha**, në fillimet e shekullit të 18-të.

Përveç flotës detare kryesore, osmanët kishin anije lumenjsh, në Tuna (Danub) dhe Fërat (Eufrat) të quajtura *inxhe donanma*. Anijet dhe varkat, që përdoreshin mbi ujërat e lumit Tuna dhe lumenjve të tjerë garantonin sigurinë e rajoneve përreth. Anijet kalonin dimrin në tersanen të Rusçukut mbi lumin Danub.¹¹⁴

Luftëtarët muxhahidinë në anijet qendrore quheshin *ezep* (nga *azeb* në gjuhën arabe: beqar). Ata kishin *reisin* (komandantin) e tyre. Komandanti suprem i flotës detare ishte Kapudan-ë Derja (Kaptan Pasha). Rangu i Kaptan Pashait ishte i barabartë

111 Është mjaft interesante të theksojmë se kjo betejë e rëndësishme detare ose nënvlerësohet, ose nuk përmendet asnjëherë në librat më "serioze" "akademike" të autorëve perëndimorë, ndërkohë që ata e përshkruajnë me detaje betejën e Lepantos (Inebahtit, 1571) kur bota e krishterë shkatërroi flotën detare osmane.

112 Uzunçarşılı, *Osmanlı Devletinin Merkez ve Bahriye Teşkilatı*, fq. 392.

113 Ky luftëtar muxhahid u plagos rëndë gjatë një xhihadi detar. Ai mbeti gjysëm i vdekur për një kohë të gjatë dhe për këtë arsye mori dhe nofkën: mezomorta. Osmanët muslimanë nuk kishin shumë dëshirë të përdorin fjalë të gjuhës turke. Ata nuk e kishin problem të merrnin hua fjalë që kishin të bënin me detin, me aktivitetet detare etj., nga kundërshtarët e tyre evropianë. Ky është një fakt tregues edhe për përdorimin e fjalës *mezomorta*. Muxhahidinët detarë zotëronin gjuhët kryesore evropiane të tilla si spanjisht, portugalisht etj.

114 Uzunçarşılı, *vepër e cituar*, fq. 403-404.

me atë të Bejlerbeut, duke filluar me Hëzër Hajreddin Pashanë. Më pas, rangi i Kaptan Pashait u barazua me atë të Vezirit.¹¹⁵ Nën drejtimin e Kaptan Pashait ishin Sanxhakbejlerët, të cilët quheshin Derja Beji. Secili nga Derja Bejët merrte pjesë në fushatat e xhihadit detar me një, dy ose tre anije së bashku me zotëruesit e timareve të rajoneve të tyre.¹¹⁶

Bajezidi II (1481-1512) nisi në vitin 1502 dhe kjo më pas u kthye në një traditë për Donanma-jë Hymajun, nisjen drejt Mesdheut çdo vit në pranverë, traditë kjo që vazhdoi deri në mesin e shekullit të 19-të. Qëllimi ishte mbrojtja e brigjeve të territorit musliman kundër sulmeve të armikut dhe piratëve. Më pas, ata dërgonin anijet e tyre për të patrulluar Detin e Zi, kur Rusia filloi të veçohej si një fuqi tjetër kërcënuese.¹¹⁷

Devleti Osman kishte flotën e tij edhe në Oqeanin Indian. **Piri Reisi** (1465-1554) ishte një nga kapitenët osmanë, që operonte në Oqeanin Indian, në luftë kundër portugezëve, që në atë kohë ishin fuqia detare kryesore e krishterë. Harta e parë e njohur e Amerikës na vjen nga Piri Reisi, që e hartoi në vitin 1513, në Gelibollu.¹¹⁸

Në këtë hartë ai i referohet Amerikës me emërtimin "*Vilajet-i Antilia*". Piri Reisi përpiloi edhe një libër mbi lundrimin në Egje dhe në Mesdhe me titullin *Kitabë-ë Bahrije*.

11.2 Muxhahidinët vullnetarë detarë

Një pjesë mjaft e rëndësishme e fuqisë detare osmane ishin edhe luftëtarët muxhahidinë vullnetarë detarë. Vullnetari i parë i mirënjohur muxhahid detar, i cili komandonte disa nga anijet gjatë fushatës së xhihadit kundër jobesimtarëve të Evropës, është **Kemal Reisi**. Më pas, ai u ngrit nga Bajezidi II (1481-1512)

115 Po aty, fq. 414.

116 Po aty, fq. 421.

117 Po aty, fq. 437.

118 Afetinan, *Piri Reisin Hayatı ve Eserleri*, Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1992, fq. 27.

si Kapudan-ë Derja dhe kreu shumë shërbime për Devletin Osman. Me mandat nga Bajezidi II, ai sulmoi brigjet e Spanjës dhe transferoi mijëra muslimanë nga Andaluzia drejt Daru'l-Islamit.¹¹⁹ Nipi i tij, Piri Reisi, mori pjesë nën drejtimin e tij në fushatat e xhihadit dhe më pas hyri në shërbimin e Devletit Osman. Gazinjtë më të famshëm vullnetarë detarë të shekullit të 16-të janë: **Oruç Reisi** dhe **Hëzër Reisi**. Ata ishin djemtë e Jakup Sipahiut dhe kishin edhe dy vëllezër të tjerë: Is'hakun dhe Iljasin. Të lindur në ishullin e Midil-lit, ata ishin adhurues të detit dhe u angazhuan në aktivitetet tregtare. Kur anija e tyre u sulmua nga korsarët e Maltës, të cilët e quanin veten Kalorës të Shën Xhonit, njëri nga vëllezërit, Iljasi, ra martir gjatë këtij sulmi.¹²⁰ Ky veprim armiqësor i nxiti ata të ktheheshin në gazinj detarë. Për pasojë, ata filluan të luftonin në det të hapur kundër jobesimtarëve evropianë. Oruç Reisi dhe Hëzër Reisi shkuan në Afrikën e Veriut, dëbuan spanjollët nga Xhezairi dhe Tunizia, dhe Oruç Reisi ra martir në vitin 1518 pranë Tlemsenit në Xhezair. Hëzër Reisi dhe gazinj të tjerë detarë shpëtuan Xhezairin dhe Tunizinë, nga konvertimi i tyre në vende katolike spanjishtfolëse, siç ndodhi me Amerikën e Jugut. Hëzër Reisi u nderua nga Halifi-Sulltan osman **Javuz Selim** (1512-1520), që ia dha të drejtën e rekrutimit të vullnetarëve nga Anadulli. Hëzër

119 Një nga "grackat" që orientalistët i vendosin për Devletin Muslimano-Osman është "pse osmanët nuk e shpëtuan Andaluzinë?" Përgjigja është mjaft e qartë dhe e thjeshtë: ishte e pamundur që çilado palë (muslimane apo jobesimtare evropiane) të dominonte të gjithë Mesdheun. Mesdheu është një rajon shumë i gjerë për t'u dominuar vetëm nga njëra palë luftuese. Përveç kësaj, osmanët i ndihmuan muslimanët e Andaluzisë, duke transferuar me mijëra prej tyre drejt Daru'l-Islamit. Për më tepër, superfuqia detare nuk ishte në anën e osmanëve në vitin 1492, kur pjesa e fundit muslimane e Anadaluzisë ra në duart e jobesimtarëve: Superioriteti kaloi te muslimanët osmanë vetëm në 28 shtatorin e vitit 1538, kur ata shkatërruan Forcat e bashkuara të flotës detare të krishterë në Prevezë. Nga ana tjetër, ishte e pamundur që ata të kalonin të gjithë Evropën në rrugë tokësore dhe të aneksonin Spanjën dhe Portugalinë, të cilat nuk ishin fuqi të vogla, në dekadën e fundit të shekullit të 15-të.

120 Katib Çelebi, *Tuhfetu'l Kibar fi Esfari'l Bihar*, Stamboll: 1329, fq. 25.

Reisi u bë Sulltan i Xhezairit, por duke e kuptuar se ishte e pamundur për të ta mbronte këtë pjesë të botës muslimane kundër perandorisë tepër të fuqishme spanjolle-gjermane, ai, me dëshirën e tij, ia ktheu këtë pjesë Devletit Osman gjatë kohës së Sylejmanit të Madhërishëm (1520-1566), i cili e emëroi atë Kapudan-ë Derja të Devletit Osman. Hëzër Hajreddin Pasha është admirali musliman, i cili mundi Andrea Dorian në Prevezë, më 28 Shtator 1538; një datë kjo të cilën evropianët kanë preferuar ta harrojnë dhe të bëjnë ç'është e mundur që edhe të tjerët ta harrojnë gjithashtu.

Turgut Pasha, të cilin evropianët e quajtën për shkak të frikës që kishin prej tij, Dragut (shtrembërim i Dragua), është një luftëtar tjetër muxhahid detar i shekullit të 16-të. Djali i një fshatari me emrin Veli nga provinca e Menteshesë në Anadoll, ai iu bashkua muxhahidinëve detarë në moshë shumë të re. Ai mori titullin *reis* dhe u kthye në makthin e marinarëve evropianë dhe popullsisë që jetonte në brigjet e Mesdheut. Ai shpëtoi Trablusgarbin nga korsarët e Maltës.¹²¹ Duke u vënë nën shërbimin e Devletit Osman, ai mori titullin Bejlerbej i Trablusgarbit (Libisë) në rangun e Pashait. Gjatë rrethimit të Maltës në vitin 1565, ai ra martir dhe trupi i tij u transportua në Trablusgarb, ku edhe u varros pranë xhamisë së tij. Ai konsiderohej një *veli* (njëjësi i *evlija*) dhe u kthye në një traditë, për popullsinë e Libisë, që të përmendej jo me titullin e përbotshëm Pasha, por më titullin e tij fetar: **Sidi Turgut** (Sejjidi: titulli i shejhut sufi në Afrikën e Veriut).

Kurduogllu Muslihiddin Reis, Salih Reis, Mezomorta Hysejin Reis janë disa nga prijësit gazinj vullnetarë detarë më të

121 Këta korsarë (siç i quante Sulltani Javuz Selim) ishin të stërvitur mirë. Ata vinin nga çdo pjesë e Evropës për të luftuar kundër "jobesimtarëve turq", siç besonin se ishin, për arsye se muslimanët osmanë nuk e pranonin Profetin Isa (Jezus: Paqja qoftë me të) si Zot, sikurse evropianët e kishin pranuar. **Për të pasur një konceptim të tijin, lexuesi mund t'i referohet asaj që ka shkruar një autor evropian: Stanley-Lane Poole, *Turkey*, Londër: 1886, fq. 142-151.**

famshëm. (Prijësi i fundit me emrin Mezmorta u quajt kështu, për arsye se mbeti gjysmë i vdekur për një kohë të gjatë, për shkak të plagëve të rënda që kishte marrë gjatë një xihadi detar).

Herë pas here ata rekrutonin dhe stërvitnin vullnetarë nga Anadulli. Ata ishin gjithashtu të angazhuar vazhdimisht në fushata xihadi kundër evropianëve.

Çdo Reis kishte flamurin e tij. Hëzër Reis Pasha kishte një flamur të gjelbër me vizatimin e *Zulfiqarit* (shpatën e Aliut Kerremallahu Vexhheh) dhe *Myhr-i Sulejman* (vulën e Sulejmanit Alejhis Selam: trekëndësh i dyfishtë) mbi të. Hilali (gjysëm-hënëza) njihej si simbol i zakonshëm i Islamit.

Me kalimin e kohës, Trablusgarbi, Tunizia dhe Xhezairi, të cilat quheshin *Garb Oxhakllarë*, u kthyen në provinca gjysmë të pavarura *de facto*. Gazinjtë vullnetarë ishin në administrimin e tyre dhe guvernatorët e tyre miratoheshin nga autoriteti qendror. Këto provinca merrnin pjesë në mënyrë aktive në veprimtaritë e xihadit të Devletit Osman, duke dërguar disa luftanije nën shërbimin e tij gjatë betejave detare. Deri në luftën e Krimesë (1853-1856), Tunizia i dërgoi Devletit Osman disa luftanije për të luftuar kundër Rusisë.

Është interesante të theksojmë dhe të përmendim si një shembull i fuqisë së tyre, se kur marinarët amerikanë hynë në Mesdhe, në shekullin e 18-të, ata u detyruan t'u paguanin tagër gazinjve në Xhezair.

V – INSTITUCIONET SOCIALE

Shoqëria osmane ishte mjaft mirë e organizuar. Midis popullit kishte një solidaritet të pamasë; ata kujdeseshin për këdo nëpërmjet institucioneve sociale të themeluara shumë mirë.

12. Vakëfi

Institucioni i vakëfit është mishërim i solidaritetit islam social të bamirësisë. Është veprimi më i lartë financiar që një person mund të arrijë në jetën e tij. Ky institucion përbën kristalizimin e frymës së Ummetit: një besimtar cakton shumën e të ardhurave nga pronat si: ndërtesat, dyqanet, kopshtet etj., për përfitimin e besimtarëve të tjerë. Ai ose ajo, i dërgon të ardhurat në vakëf, të ardhurat e të cilave shpenzohen sipas kushteve të përcaktuara nga ai ose ajo, për qëllime të veçanta. Ai që dhuron pronën e tij, quhet **vakif**, prona e caktuar për dhurim është **vakëf**, dokumenti mbi të cilin përmenden kushtet quhet **vakëfije**, administratori i caktuar për të administruar vakëfin quhet **muteveli**.

Vakëfi i ka rrënjët e tij nga Kur'ani: “Kurrë nuk do të arrini *birr* (mirësinë/sinqeritetin e plotë me besim) derisa të jepni më të dashurën e pasurisë suaj. Çkado që të jepni, Allahu atë e di.”¹²²

Fjala *birr* që ndeshet në këtë *ajet* shpjegohet në detaje në *Suretu'l Bekare* (ajeti 177): “Nuk është tërë mirësia t'i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit,

pejgamberëve dhe pasurinë që e do ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirimin e robërve, dhe ai që fal namazin, e jep *zekatin*, dhe ata që kur premtojnë zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillë janë ata të sinqertit dhe të tillë janë ata të devotshmit”.

Gjithashtu, janë edhe thëniet e Pejgamberit të Fundit që nxit muslimanët të themelojnë vakëfe. Për shembull: “Kur njëri nga djemtë e Ademit vdes, mbarojnë dhe veprimet bamirëse, dhe mirësitë e tij, përveç tre prej tyre: dituria nga e cila përfitojnë njerëzit, pasardhësit e mirë dhe *sadaka xharije* (bamirësi që vazhdon)”.

Muslimanët themeluan vakëfe duke filluar që në periudhën e Pejgamberit të Fundit (Paqja qoftë me të) dhe vazhduan përgjatë shekujve. Kjo praktikë u kthye në një traditë të qëndrueshme dhe vazhdoi deri tek osmanët. Osmani i parë, i cili themeloi një vakëf, ishte sundimtari i dytë, Orhan Beu (1326-1362). Ai ndërtoi një medrese në Iznik dhe caktoi disa pasuri të patundshme për mirëmbajtjen dhe pagesën e *muderrisit* (profesorit), si dhe për nevojat e studentëve. Muderrisi i parë i kësaj medreseje ishte **Davud-ë Kajseriu**, që ishte arsimuar në qytezën e tij të lindjes, në Kajseri, e pastaj në Egjipt. Pas tij, **Taxhuddin Gerediu** dhe më vonë **Alauddin Esvedi** u bënë *muderrisë* në këtë medrese, nga e cila u diplomuan dijetarë dhe administratorë të aftë.¹²³

Përveç këtij institucioni arsimor, Orhan Gaziu ndërtoi edhe një xhami, dhe një medrese në Adapazarë, një xhami dhe një *zavije* (strehë), një *imaret* dhe një shtëpi pritjeje, dhe një xhami tjetër në Kandëra. Ai caktoi pasuri të patundshme për mirëmbajtjen dhe nevojat e të gjitha këtyre institucioneve, dhe për

123 Ali Himmet Berki, “Vakıf Kuran ilk Osmanlı Padişahı” *Vakıflar Dergisi*, Ankara: 1962, V, fq. 127.

njerëzit që shërbenin në to si *muderrisë, imamë, hatibë, kuzhinierë, shërbyes, portierë, etj.*¹²⁴

Vakëfija e zavijes në Bursa daton që në vitin 761/1359. Në këtë *vakëfije* thuhet se: *oshri* që mblidhej nga disa fshatra, të ardhurat nga hanet, hamamet, dyqanet, fabrikat, kopshtet frutore, caktoheshin për mirëmbajtjen e ndërtesës, për pagesën e personelit në të, për akomodimin e njerëzve, duke siguruar për ta ushqim falas për tre ditë me lejen e administratorit *muteveli*. Nëse mbetej një shumë pasi të shpenzohej për nevojat e lartpërmendura, kjo shumë do të shpenzohej për nevojat e muslimanëve të varfër. Muteveliu i parë i këtij vakëfi ishte Sinan Pasha. Ishte paracaktuar se pas vdekjes së tij, vendin si *muteveli* do ta merrte Kadiu i Bursës.

Për të dalluar “Historinë” nga “Tregimi”, mënyra e krahasimit është mënyra më e mirë për ta bërë këtë dallim. Pra, ne duhet t’i hedhim një sy Evropës së kohës kur muslimanët kishin institucione të tilla si hamamet (banjat publike), ne e shohim Evropën në pozitën që përshkruhet si më poshtë vijon nga vetë evropianët: “Murgjit vetëorturues krenoheshin në papastërtinë e tyre.” Në librin e tij *History of Inquisition* (Historia e Inkuzicionit), **Lorente** përmend shumë shembuj të të konvertuarve nga Muhamedanizmi që “fshikulloheshin për vdekje dhe më pas hidheshin në burgje të ndyra, për arsye se ata vazhdonin të merrnin abdesin e tyre të përditshëm, sipas besimit të tyre të mëparshëm.” I njëjti shkrimtar perëndimor thotë se: “Rrugët dhe banesat ishin të ndyra nga jashtëqitjet e njerëzve dhe kafshëve. Të krishterë të papastër, të ndyrë, duke filluar nga mbretërit deri te njerëzit e rëndomtë, ishin të mbushur me plagë dhe të bërë shoshë nga sëmundjet.”¹²⁵

Osmanët themelonin vakëfe për të lehtësuar problemet, me të cilat përballej popullsia, duke përfshirë pothuajse gjithçka që

124 Po aty, V, fq. 128-129.

125 Robert J. Scruton, *Nature's Way to Nutrition and Vibrant Health*, Melvin Powes: Hollywood, Kaliforni, 1977, fq. 16-17.

mund të ishte e imagjinueshme: ata caktonin vakëfe për sendet shtëpiake dhe për nevojat e ndryshme të vajzave jetime (kjo nuk duhet të ngatërrohet me pajën e jomuslimaneve), për t'u përkujdesur për shpendët shtegtarë, të cilët nuk ishin të aftë të vazhdonin shtegtimin e tyre, madje edhe për të ushqyer ujçërit e uritur, që iu afroreshin fshatrave të banuara në dimër.

Përveç institucionit të vakëfit, osmanët përdornin edhe shtylla guri të quajtura *sadaka tashë* (guri i bamirësisë), në të cilat vendosnin para, në disa vende të caktuara të qytezave; njerëzit në nevojë shkonin te njëra nga këto shtylla që ishin rreth një metër e gjysmë të larta, pas namazit të *jacisë* (natën), kur njerëzit ishin në gjumë, dhe merrnin pa u vënë në siklet një sasi parash nga maja e shtyllës, pa e ditur se kush e kishte vënë këtë shumë në atë vend.¹²⁶ Njëra nga këto shtylla prej guri, që ka mbijetuar edhe në ditët e sotme, ndodhet në Doganxhëllar (Doğancılar), Yskydar, në Stamboll. Disa të tjera ndodhen në Iznik (tani në muze), që u hap ndaj Islamit nga osmanët në vitin 1331. Kjo është një provë, që tregon se muslimanët kanë ndihmuar njerëzit në nevojë, në gjysmën e parë të shekullit të 14-të, duke mos iu shkaktuar asnjë ndjenjë sikleti apo turpërimi atyre.

Administrimi i ndërtesave dhe mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe sanitare, urave etj., nga përfaqësuesit publikë arriti të përmirësonte dukshëm Thesarin e Devletit Osman.

13. Zavije-Tarikatet

Edebaliu, që ishte vjehri i Osman Gaziut, ishte një shejh sufi me njohuri të mëdha, mjaft i arsimuar dhe kishte në zotë-


126 Është një kënaqësi e madhe për mua të përsëris falenderimet dhe mirënjohjen time të thellë ndaj Universitetit Ndërkombëtar Islam, Malajzi, që më lejoi të mblidhja materialin e nevojshëm në Turqi, në kryeqytetet respektive të Devletit Osman, gjatë të cilat pata rastin të bëja fotografi dhe të disa *sadaka tashë* në Iznik (Nike), që datonin që nga gjysma e parë e shekullit të 14-të, si dhe një *sadaka tashë* në Stamboll (Üsküdar, Doğancılar, përballë dyqanit të berberit).

rimin e tij një *zavije*. Kur Osman Gaziu kishte parë një ëndërr, në të cilën ai shihte një hënë që dilte nga kërthiza e Edebaliut dhe hynte në kraharorin e tij, dhe menjëherë pas kësaj, një pemë mbinte nga kërthiza e Osmanit duke u degëzuar në një zonë të gjerë, dhe nën hijen e kësaj peme, kishte male dhe lumenj të rrjedhshëm, pasi ia tregoi ditën tjetër këtë ëndërr Shejhut Edebali, ky i fundit i shpjegoi atij se Allahu i Plotfuqishëm iu kishte caktuar Osmanit dhe pasardhësve të tij, sovranitetin e gjithë botës, dhe vajza e tij u bë *hallall* për Osmanin, dhe iu dha atij për nuse.

Kishte edhe shejhë të tjerë sufi si **Turgud Shejhu**, një murid (dishepull) i të cilit ishte i pranishëm kur Shejhu Edebaliu i shpjegonte domethënien e kësaj ëndrre Osman Gaziut, dhe kur ai kërkoi diçka në shenjë dhurate për këtë lajm të mrekullueshëm, Osman Gaziu i dha atij një fshat.¹²⁷

Gjatë viteve të pasardhësit të Osman Gaziut, Orhan Gaziut, mbi të tjerët, ishte edhe një shejh i mirënjohur sufi, me emrin **Gejikli Baba**. I biri i Orhan Gaziut, Sulltan Muradi II ishte vetë një Shejh Ahi. Stërnipi i tij, Muradi II (1421-1451), ishte në një nivel kaq të lartë shpirtëror, sa që ai pa në ëndërr tre engjëj, që qëndronin lart në qiell, mbi kopshtin e xhamisë së njohur me emrin *Yç Sherefli xhami* në Edrene dhe ai ngriti një shtyllë mermeri në secilin vend për të penguar njerëzit të shkelnin mbi to. Tre shtyllat prej mermeri të gjelbër, janë ende në oborrin e xhamisë, që në atë kohë quhej "*Yç Sherefli xhami*" (xhamia, pronare e tre të nderuarve; që iu referohet tre engjëjve). Me kalimin e kohës, kjo xhami filloi të quhej *Yç sherefeli* (që i përket tre sherefeve: vendeve për thirrjen e ezanit); por në fakt, sherefet e saj nuk janë tre në numër.

127 Neşri, I, fq. 82.



Tre shtyllat prej mermeri, që u ngritën nga Sulltan Muradi II në vendet ku tre engjëjt qëndronin sipas ëndrrës së tij, që u ndërtuan për të mos lejuar njerëzit të shkelnin mbi to

Shejhët sufi kryen shumë shërbime të vyera përgjatë gjithë historisë osmane; ata arsimonin njerëzit në *zavijet* e tyre, i mësonin ata të jetonin në përputhje me ligjet e Krijuesit. Duhet të theksojmë në këtë rast se, shejhët sufi shkonin në Ballkan, vendoseshin atje, dhe përhapnin Islamit edhe më përpara se këto vende të hapeshin ndaj Islamit nga ushtria osmane.

Zavija ishte një ndërtesë në të cilën një Shejh sufi jetonte së bashku me familjen e tij. Ai i arsimonte njerëzit sipas linjës islame, me personalitetin e tij të përqendruar dhe të devotshëm, më tepër nëpërmjet *halit* (gjendjes, natyrës së tij), sesa nëpërmjet *kavlit* (të shprehurit me fjalë). Me fjalë të tjera, ai ishte një figurë kaq e ditur, e mençur, e këndshme, e devotshme, e pastër dhe me njohuri të gjera, sa që ndikimi i tij te vizitorët dhe dishepujt përcillte personalitetin e tij të pastër, të dëlirë dhe rrezatues.

Disa *zavije* (tekke – teqe) kishin dhoma për *muridët* (dishepujt), që të jetonin dhe të praktikonin trajnimin *halvet* (tërheqje në vetmi): duke agjëruar disa ditë dhe duke praktikuar *dhikr*. Sipas praktikës osmane të Islamit, t'i përkisje një *tarikati* (urdhri) sufi ishte një përkushtim dhe angazhim mjaft i lartë. Për pasojë, urdhrat e sufive ishin të përhapura në të gjithë territorin osman dhe ata kishin ambiente apo *zavije* me vakëfe mjaft të pasura për to nga administrata, dhe nga publiku. Si një kampion sunnit islam, Devleti Osman toleronte dhe nxiste tarikatat sunnite.

14. Imaret

Tradita e *imaretit* i përket shtetit osman që nga periudha e themeluesit të saj, periudhës së Osman Gaziut. Osman Gaziu ishte një musliman shumë i mirë dhe i devotshëm. “Ai e kishte për zakon të mblidhte njerëzit e varfër dhe besimtarë çdo tre ditë dhe t’u shtronte darka, si dhe t’i vishte njerëzit në nevojë dhe t’i përkrahte gratë e veja.”¹²⁸

Imareti ishte një ndërtesë ku të varfrit mund të ushqeheshin çdo ditë. Ishte e ndërtuar nga individë të ndryshëm dhe jo nga fondet publike, dhe merrte të ardhura të mjaftueshme nga dyqanet, arat e mbjella, kopshtet frutore etj., që ishin kthyer në vakëfe për këtë institucion. Personi që ndërtonte një *imaret*, do të radhiste në vakëfijën e tij të gjitha llojet e ushqimeve që shërbeheshin çdo ditë dhe do të përcaktonte dhe sasinë e këtij ushqimi. Në vakëfije përmendej edhe struktura administrative e imaretit. Imareti ishte nën ngarkimin e një personi të aftë dhe shërbyesit duhet të kishin disa cilësi të caktuara. Për shembull, Orhan Gaziu (1326-1362) ndërtoi një *imaret* në Iznik, pas hapjes së këtij qyteti historik ndaj Islamit në vitin 1331, dhe emëroi *el-Haxh Hasanin*, që ishte një murid i Shejhut Edebali, si Shejh të këtij imareti.¹²⁹ **Pra, imareti ishte një institucion jo vetëm për të ushqyer njerëzit falas, por edhe për të pastruar shpirtrat e tyre**

128 Po aty, fq. 72.

129 Po aty, fq. 162.

nën drejtimin e mjeshtëreve kompetentë sufi. Kjo do të thotë se që në fillimet e gjysmës së parë të shekullit të 14-të, Devleti Islam i osmanëve nuk e nënvlerësonte rëndësinë e individit; për të përkujdeseshin mjaft mirë dhe nevojat e tij shpirtërore plotësoheshin dhe ai përsosej shpirtërisht.

Imarete kishte në të gjithë territorin osman. Edhe pas një periudhe më shumë se gjysmë shekullore, pas rënies së Devletit Osman, kjo traditë humane e mrekullueshme vazhdoi të ekzistonte: persona të ndryshëm ndërtonin godina të tilla pothuajse në çdo fshat të Anadollit me të njëjtin material me të cilin ndërtonin shtëpitë e tyre. Ata e ndërtonin këtë ndërtesë për miqtë, njerëzit të cilët vinin nga vendet e tjera aty dhe dërgonin në to për tre ditë ushqim falas nga shtëpitë e tyre. Ndonjëherë, fshatarët ndërtonin një dhomë për miqtë dhe dërgonin ushqime atje nga shtëpitë e ndryshme të fshatit. Siç dihet, periudha prej tre netësh për miqtë është caktuar nga Pejgamberi i Fundit (Paqja qoftë me të).

15. Kervansaraj

Devleti Osman dëshironte të sigurote mirëqenien e *ra'ijetit* (popullsia për të cilën kujdesej). Siguria e brendshme përbënte një përparësi thelbësore për administratën osmane. Përveç masave të sigurisë në qytetet, qytezat dhe fshatrat e territorit osman, osmanët i kushtonin vëmendje edhe sigurisë së rrugëve të fshatit. Njerëzit e asaj kohe udhëtonin me karvanë, në grupe, me kuaj apo deve. Tregtia bëhej nëpërmjet deveve. Përgjatë rrugëve kryesore ishin ndërtuar godina të quajtura *kervansaraje* (vende pushimi për karvanët).

Në kervansaraj kishte dhoma për udhëtarët, vend për kafshët dhe mallrat e tyre, një mesxhid, një hamam (ndërtesë banjoje) dhe gjithçka tjetër që mund t'i duhej një udhëtarit. Kervansarajet ishin të ndërtuara përgjatë rrugëve kryesore në një largësi nga njëra-tjetra që një karvan të largohej prej aty pas namazit të sabahut (fexhr), në agim, dhe të arrinte në

kervansarajin tjetër pasdreke ('asr), dhe të kalonte natën atje. Kervansaraji ishte më shumë se një han i zakonshëm për udhëtarët; ishte një vend i fortifikuar dhe udhëtarëve nuk iu duhej të paguanin për qëndrimin e tyre deri në tre net.

Kervansaraji nuk ndërtohej nga fondet publike; muslimanët e pasur e ndërtonin atë me shpenzimet e tyre dhe caktonin një pjesë të të ardhurave për mirëmbajtjen, administrimin e tij etj., sipas konceptit islam, për të kënaqur Krijuesin: ideali kryesor i çdo muslimani. Nga **Sejjid Mustafa Nuri Pasha**, që ishte Defter-i Hakani Nazërë (Ministri i Financave) gjatë periudhës së Sulltan Abdylhamidit II, mund të citojmë një shembull të mirë që ilustron mënyrën se si një kervansaraj u krijua dhe u mirëmbajt: "Sipas vakëfijes së Enishte Hasan Pashait, që u bë Sadrazam, gjatë kohës së Sulltan Ahmedit III, ishte një vend që quhej **Karamurt** në rajonin e Shejhu'l Hadid, që i përkiste njësisë administrative të Uzejrit. Karamurti shtrihej në rrugën drejt Gadishullit Arabik dhe el-Haramejn esh-Sherifejn. Me kalimin e kohës, fshatrat e këtij rajoni u braktisën nga banorët dhe shtëpitë u rrënuan, dhe u kthyen në strehë për grabitësit. Defter-i Hakani Nazërë (Ministri i Financave) i asaj kohe e vlerësoi këtë vend për një shumë prej 5.000 gurush, por Sadrazami e bleu këtë vend për 7.500 gurush, duke e marrë në pronësinë e tij, dhe duke e kthyer më pas në një vakëf. Ai ndërtoi atje një kështjellë dhe brenda kështjellës ndërtoi një xhami, dy hamame (një për burrat dhe një për gratë), një han me 90 oxhaqe (një oxhak për çdo dhomë), një medrese, një imaret, 30 dyqane, dhe shtëpi për rojet e kështjellës: për muteveliun e vakëfit, për katibin (shkruesin), për vaizin (predikuesin), për myezinët dhe kajimin (që e pastron dhe mirëmban xhaminë). Ai caktoi një shumë të ardhurash për:

26 kalorës (ku secili prej tyre merrte 15 akçe në ditë).

1 komandant të tyre (syvari agasë) (i cili merrte 30 akçe në ditë).

1 ket'hyda (ndihmësi dhe zv/komandanti) (i cili merrte 20 akçe në ditë).

1 alemdar (bartës i flamurit) (i cili merrte 17 akçe në ditë).

1 çavush për mbrojtjen e kalimtarëve (i cili merrte 16 akçe në ditë).

Ai, gjithashtu, caktoi një shumë për personelin e kështjellës:

15 ushtarë (secili prej tyre merrte 10 akçe në ditë).

1 dizdar (komandanti i tyre) (i cili merrte 15 në akçe ditë).

4 bevvabë (portierë) (të cilët merrnin nga 12 në akçe ditë).

Për më tepër, ai caktoi dhe disa paga për shërbyesit e imaretit dhe një sasi parash për ushqimin që do të gatuhej dhe do të shërbehej falas në imaret. Të gjithë ushtarët, komandantët e tyre dhe të punësuarit e tjerë të vakëfit kishin mundësinë të ushqeheshin falas në imaret. Ai shpërndau dhe për secilën nga motrat e tij një shumë prej 50 akçesh në ditë nga vakëfi.

Pra, krijimi i këtij vakëfi shërbente për tre arsye: zhvillimin rural, sigurinë e rrugëve dhe përhapjen e diturisë.¹³⁰

16. Hamami

Duke qenë se Islami i kushton një rëndësi të veçantë pastërtisë, muslimanët, në të gjitha periudhat, kanë pasur hamamet e tyre. Kur ata hapnin një qytet ndaj Islamit ose kur ata ndërtonin një qytet të ri, në qendrën e këtij qyteti ata ndërtonin xhaminë ku bëhej falja e së Xhumasë dhe pranë saj ndërtohej dhe një hamam, dhe ndërtesa të tjera qeveritare.

Kjo traditë ishte përcjellë nga selçukët e Anadollit. Si përfaqësues të Islamit, ata ishin shumë të dhënë ndaj pastërtisë, në një nivel të atillë që edhe gjatë fushatave të xhihadit ata nuk e linin larjen. Kishte një organizatë të veçantë të quajtur

130 Sejjid Mustafa Nuri Pasha, *Netajixhu'l Vuku'at*, Stamboll: 1324, II, fq. 105-106.

hamamxhë esnafë, që siguronte ujë të ngrohtë dhe banjë lëvizëse për një ushtri të madhe.

Hamami ishte një ndër ndërtesat e para që ndërtohej në një qytet apo qytezë të hapur ndaj Islamit në periudhën osmane. Për shembull, në Iznik (Nike) gjendet një hamam që është ende në përdorim dhe që daton nga fillimi i shekullit të 14-të. Përveç hamameve publike, shtëpitë kishin sallat e banjave të tyre private, të quajtura *gusl-hane* (dhomë për larjen e madhe).

Ndoshta edhe Kul-lija (kompleksi i ndërtesave) e Xhamisë Selimije në Edrene është një shembull mjaft i mirë për të ilustruar këtë praktikë të osmanëve. Përpara se të niste ndërtimi i kësaj xhamie, që është një kryevepër e arkitektit më të madh osman, Sinanit, ata ndërtuan fillimisht hamamin, në mënyrë që punëtorët e xhamisë të kishin mundësi të mbanin pastërtinë e tyre gjatë punimeve. Pas kësaj, u ndërtua xhamia dhe kompleksi i ndërtesave të tjera.

Ata ishin, gjithashtu, shumë të dhënë për mbajtjen e pastërtisë së rrugëve. Disa njerëz caktonin vakëfe për këtë qëllim. Punonjësi i atij vakëfi, duke mbajtur mbi supe apo shpinë, një thes me hi, përshkonte gjithë qytezën dhe kur ai shikonte një person që pështynte në rrugë, merrte një sasi nga hiri i thesit (që quhet *hejbe*) dhe e mbulonte atë papastërti me hi.

Sërish duhet të theksojmë se nëpërmjet mënyrës së krahasimit mund të kuptojmë dhe të vlerësojmë më së miri nivelin e civilizimit të shoqërive. Pra, nëse i hedhim një shikim Evropës së asaj periudhe, që në atë kohë Perëndimi ishte me të vërtetë në periudhën e tij të errët (ishin kohë të arta për botën muslimane), ne kemi një peizazh të tillë: "Në të gjitha brigjet mesdhetare, banjat e lira publike u shkatërruan. Besimi se papastërtia ishte më pranë hyjnorese u përhap në të gjithë Evropën ... Kjo formë çmendurie e krishterimit mbizotëroi deri në mesin e shekullit të 18-të."¹³¹

131 Robert J. Scrutton, *vepër e cituar*, fq. 16.

Nga ana tjetër, siç kemi cituar edhe në disa pjesë të tjera të kësaj vepre, ndërtimi i hamameve, madje edhe në kervansarajet përgjatë rrugëve kryesore, ishte një praktikë e zakonshme e Devletit Osman. Përpos banjave të zakonshme publike, njerëzit shkonin në *kapllëxha* dhe *içmexhe* për të mirëmbajtur shëndetin, një praktikë kjo që vazhdon edhe në ditët e sotme në Turqi, pas shpërbërjes së Devletit Osman, pas më shumë se 9 dekadash. Kapllëxha (Ilixha) ka ujëra të pasura me minerale për kurimin e reumatizms dhe disa sëmundjeve të tjera ku njerëzit lahen rregullisht. Içmexhe është një vend që ofron për njerëzit pirjen e ujit, që përmban një varietet elementesh minerale që pastrojnë organizmin; një praktikë që këshillohet nga mjekësia moderne, ndërkohë që popullsia e territorit osman e ka praktikuar për shekuj me radhë.

Me këtë praktikim të pastërtisë, njerëzit ishin të shëndetshëm në masë. Mundja ishte një sport i zakonshëm. Në çdo ngjarje apo festë, zhvilloheshin gara mundjeje. Në festat e ndryshme, për Bajram, për ceremonitë martesore dhe të synetit etj., edhe nëpër fshatra, zhvilloheshin gara në mundje.

Duhet të theksojmë këtu se sëmundjet veneriane erdhën në territorin osman nga Evropa, nga Fregistani, siç e quanin osmanët. Në gjuhën osmane turke sëmundjet veneriane quhen *frengi* (që i përket, që ka të bëjë me Frenkun).

17. Spitali

Osmanët e trashëguan traditën e spitaleve nga selçukët e Anadollit. Selçukët kishin spitale, që quheshin *daru'sh-shifa*, në qytetet kryesore të Anadollit. Daru'sh-shifa ndërtohej dhe i caktohej një vakëf dhe administratori, doktorët, shërbyesit, i merrnin pagat e tyre nga ky vakëf. Pacientët kuroheshin falas pa dallim race dhe origjine. Përveç daru'sh-shifa, selçukët kishin edhe *bimaristanin* për të kuruar sëmundjet mendore dhe ata me të meta mendore. Një ndërtesë e daru'sh-shifa, nga

periudha e selçukëve, mund të gjendet edhe në ditët e sotme në qytetin e Amasjas, në Anadoll.

Osmanët e vazhduan këtë traditë të selçukëve për spitallet.¹³² Sulltan Jëlldërëm Bajezidi ndërtoi një *daru't-tibb* në Bursa dhe caktoi **Hoxha Husniun** (1389-1412) si tebib (doktor) atje.¹³³ Ata kishin *daru' sh-shifa* në qytetet kryesore si pjesë të kul-rijeve. Një kul-rije kishte një xhami, një hamam, disa medrese, bibliotekë, imaret etj.

Osmanët kishin edhe institucionin *bimaristan*. Bimarhane kishte në Manisa, në fillimin e shekullit të 16-të. Kishte një bimarhane në Kul-lijen e Haseki Hyrrem Sulltanës, të ndërtuar në vitin 946/1540, së bashku me një xhami, imaret, *sibyan mektebi* (shkollë për fëmijët) dhe një medrese.¹³⁴ Spitali Bimarhaneja e Sylejmanijes u ndërtua në vitin 957/1550 nga Sylejmani i Madhërisëm në Kul-lijen e tij të Sylejmanijes. Bimarhaneja e Valide-i Atik, nënës së Sulltan Muradit III, u ndërtua në vitin 991/1583, në Kul-lijen e saj, në Toptashë, Yskydar. Edhe në Kul-lijen e Sulltan Ahmedit (ndërtuar në vitin 1086/1617) kishte një bimaristan.

Në bimaristan kuroheshin të sëmurët me të meta mendore. Doktorët përdornin ujë dhe muzikë për të kuruar këta pacientë. Gjendej një vend në formë tavoline të pjerrët nga njëra anë e së cilës rridhte në atë pjerrësi ujë i ngadalshëm dhe pacientët dëgjonin zhurmën që krijonin pikat e ujit. Gjithashtu, edhe muzika ishte një mjet tjetër që përdorej për kurimin e tyre.

Doktorët kishin vënë re se ishte e nevojshme të përdroreshin lloje të ndryshme muzike në varësi të çehreve të ndryshme të pacientëve. Në këtë mënyrë, ata caktuan *mekame* të ndryshme muzike për sëmundje të ndryshme. Për shembull:

Rast : konsiderohej si e dobishme për paralizën.

132 Osman Şevki Uludağ (bot. İlter Uzel), *Beş Buçuk Asırlık Türk Tababeti Tarihi*, Ankara: 1991, fq. 25.

133 Po aty, fq. 161.

134 Aptullah Kuran, *Mimar Sinan*, Stamboll: 1985, fq. 38-39.

- Irak* : për njerëzit gjaknxehtë.
Isfahan : për të përmirësuar inteligjencën.
Rehavi : për dhimbjen e kokës.¹³⁵

Vaksinimi i lisë së dhenve u përçua nga territori osman drejt Evropës, në shekullin e 17-të. Evropianët ishin mjaft të shqetësuar për këtë në fillim. **Volteri** (1696-1778) bëri ç' ishte e mundur për të përhapur këtë shqetësim.¹³⁶

Doktorët osmanë ishin njëkohësisht edhe ulema (dijetarë) të Sheriatit. Ata ishin të interesuar në *Tibb-ë Nebevi* të Ebu Naimit. Libri i parë i botuar në territorin osman është *Havassu'l Edvoije* nga Is'hak b. Murad, në vitin 792/1390.¹³⁷ Më pas, Ahmed Da'i shkroi *Kitab-ë Tibb* dhe Ahmediu përpiloi *Muntehab-ë Shifa*, në vitin 800/1397. Sipas Ahmediut, qytetet duhet të kishin hapësira të gjera rreth tyre, dhe *kibla* e tyre nuk duhet të pengohet dhe të rrethohet nga malet, siç ndodhte për qytetin e Bursës.¹³⁸ Mumin b. Mukbil shkroi *Zahire-i Muradije* në vitin 841/1437, në emër të Sulltan Muradit (1421-1451). Ai, gjithashtu, shkroi në mjekësi *Miftahu'n Nur ve Hazainu's Surur* dhe *Kitab-ë Tibb*.¹³⁹ Mjeshtri shpirtëror i Fatih Mehemmedit (1451-1481), Shejhu Akshemseddin, ishte edhe një doktor i aftë. Ai nxori në pah, **që në fillimin e shekullit të 15-të ndikimin e trashëgimisë** për disa lloje sëmundjesh,¹⁴⁰ dhe ai kundërshtoi, që në atë kohë, bindjen se yjet ndikonin në kurimin e sëmundjes së malaries,¹⁴¹ që ishte një sëmundje e re për kohën. Bashkëkohësi i tij, Altunxhuzade, dha një kontribut të madh në fushën

135 Osman Şevki Uludağ, *vepër e cituar*, fq. 140-141.

136 Po aty, fq. 143-151. *Shkrimet Filozofike (Philosophical Writings)* të Volterit (letra e 11-të i referohet vaksinimit kundër lisë së dhenve: posttëshërimi 19 nga O.U.).

137 Po aty, fq. 24.

138 Po aty, fq. 32-33.

139 Po aty, fq. 33-34.

140 Po aty, fq. 48.

141 Po aty, fq. 47.

e urologjisë.¹⁴² Haxhi Pasha (shek. i 15-të) ishte një gjeni i mjekësisë; studioi për mjekësi në Egjipt, ku studimi i kësaj shkence ishte në nivele të larta, punoi në këtë vend në *Maristan* (spital), dhe pasi u kthye në Turqi, shkroi *Teshil-i Shifa* dhe *Shifau'l Eskam ve Devau'l Alam*.¹⁴³ Duhet të kujtojmë se libri i Ibn Sinasë *el-Kanun fit Tibb* u studiuua në universitetet evropiane, deri në shekullin e 17-të. Më pas, superioriteti në fushën e mjekësisë kaloi në Evropë; ata nuk e patën problem të bënin autopsinë e trupit të njeriut për kërkime dhe studime të mëtejshme, dhe në këtë mënyrë përparuan.

Vakëfija e çdo spitali përpilohej me kujdesin më të madh: caktimi i shumës që do të paguheshin: doktorët, nëpunësit, funksionarët, caktimi i llojit të ushqimit që do të shërbehej në varësi të stinëve të vitit etj.; të gjitha ishin të shprehura qartë dhe në detaje.

Nga ana tjetër, është me të vërtetë rrëqethëse, nëse kujtojmë praktikën ekzistuese në Evropën e së njëjtës periudhë në lidhje me njerëzit me sëmundje mendore: fshatarët e varfër digjeshin të gjallë “në mënyrë që t’i shpëtonin ata nga shpirtrat e ligj, që kishin pushtuar trupat e tyre”.

Në vitin 1312/1896, Halifi-Sulltan Osman, Abdylhamidi II, themeloi institucionin *daru'l-axheze* (shtëpi për personat me aftësi të kufizuara). Ky institucion (që vazhdon të ekzistojë me disa modifikime) ishte një strehë për përkujdesjen e personave të moshuar dhe të varfër, madje edhe për fëmijët, pa dallim race dhe besimi fetar, që ishin me aftësi të kufizuara. Fragmenti i mëposhtëm i marrë nga gazeta zyrtare e osmanëve, *Takvim-i Vakaji*, që daton nga janari i vitit 1906, është një shembull i mirë që tregon personat e regjistruar që qëndronin në këtë institucion:

142 Fuat Kamil Beksan, “Beş Asır Evvel Turkiyede Uroloji”, *Uroloji Kliniği Dergisi* 1935 (2) 2, fq. 73-89, cituar Po aty, fq. 49.

143 Osman Şevki Uludağ, *vepër e cituar*, fq. 50-51.

muslimanë	grekë	armenë	katolikë	çifutë	Bullgarë
meshkuj	270	92	51	4	35
femra	197	27	11	14	
fëmijë	296	2	1		

18. Arsimimi

Për osmanët arsimit dhe njerëzit e ditur kishin një vend të rëndësishëm dhe ishin në nivele të larta. Dy shembuj duhet të përmenden për mënyrën se si osmanët i respektonin njerëzit e ditur:

Qëllimi i studiuesit dhe enciklopedistit të famshëm osman, **Katib Çelebi** (v. 1067/1657), ishte të bëhej një ushtarak *sipahi* (kalorës) në radhët e ushtrisë osmane. Por, kur ai pa respektin e thellë që i kushtohej një *alimi* (dijetari), që vizitoi qytezën e tij të lindjes, ai ndryshoi mendim dhe u bë një dijetar i madh.

Shembulli i dytë ka të bëjë me një historian të mirënjohur, **Kemal Pashazade** Ahmed Shemsuddin (1468-1534). Edhe qëllimi i tij ishte të bëhej një oficer në ushtrinë numër një të botës, pasi ky ishte vendi që ushtria osmane zinte në atë kohë. Por, kur ai pa se një alim i ri, **Mulla Lutfi-i Tokadi**, gëzonte një respekt më të madh nga çdo komandant i lartë, ai ndryshoi mendim dhe u bë alim, kadiasker dhe Shejhulislam.

Sistemi i arsimimit osman ishte i përbërë nga institucionet që vijojnë: xhami, teqe, sibjan mektebi (kuttab: shkollë për fëmijë), medrese dhe enderun.

18.1 Xhamia

Muslimanët i merrnin udhëzimet e tyre fetare në mesxhidet e tyre nga predikuesit. Mesxhidi ishte i vendosur në qendrën e çdo lagjeje banimi. Në të mbaheshin *vaze* (predikim) që drejtoheshin nga predikues të kualifikuar.

Përpos predikuesve edhe imamët e xhamive kishin një funksion edukues. *Imami* ishte një lloj kryetari i lagjes së tij. Ai kishte detyrën e lidhjes në martesë të çiftëve sipas mënyrës islame. Ai kujdesej për njerëzit e varfër dhe të ve në lagje dhe gjente personat e duhur që mund t'i ndihmonin dhe të për-kujdeseshin për njerëzit në nevojë.

Përveç institucionit të xhamisë, ishte edhe teqeja (zavije), ku shkonin njerëz të çdo shtrese, për të dëgjuar Shejhun sufi, për të marrë pjesë në *dhikr*, për të mësuar për përgjegjësitë personale dhe për të pastruar shpirtrat e tyre.

18.2 Sibjan mektebi

Një fëmijë musliman turk merrte mësimin e tij të parë që kur lindte: Ezani thirrej në veshët e tij duke e mbajtur fëmijën në drejtimin e Ka'bes, gjatë ceremonisë së vënies së emrit. Nëse fëmija ishte djalë, nëna do t'i thoshte atij ndërkohë që e ushqente për herë të parë me gj: "*Ja shehid ol ja gazi*" (qofsh ose dëshmor, ose luftëtar i mbijetuar nga xihadi). Kur fëmija mbushte 4 vjeç, 4 muaj e 10 ditë dërgohej me ceremoni të madhe në sibjan mektebi, ku mësonte të lexonte Kur'anin Fisnik dhe të shkruante. Kur fëmija kishte përfunduar leximin e Kur'anit nga fillimi deri në fund, zhvillohej një ceremoni e madhe festive e quajtur *hatim xhemijeti* (mbledhje për të festuar *Hatmen* – leximin e plotë të Kur'anit).

Shkolla për fëmijët ishte e ngjashme me një *kuttab* nga kohët e hershme të Islamit. Në çdo njësi banimi dhe në çdo rreth qyteti të madh, kishte një sibjan mektebi. Fëmijët e moshave 5-6 vjeç dërgoheshin në këto shkolla fillore. Sipas vakëfijeve, këto shkolla kishin disa emërtime si *daru't-ta'lim*, ose *mual-limhane* ose *mekteb*, *mektebhane*. Ata mësonin atje elifbanë (alfabetin), të shkruanin, të lexonin, të recitonin Kur'anin Fisnik dhe aritmetikë. Mësuesi quhej *mual-lim*, asistenti i tij ishte *kallfa*. Në dokumentin *vakëfije* të shkollës ishte e caktuar edhe sasia e parave që do të merrej si pagë ditore.

Sibjan mektebi ishte shumë e zakonshme dhe gjendej nga një shkollë e tillë në çdo njësi banimi të qytetit, madje edhe në fshatra. Evlija Çelebiu thotë se kishte 1993 sibjan mektebi në Stamboll, në shekullin e 17-të.¹⁴⁴ Jo vetëm në kryeqytet apo në qytetet e mëdha të territorit osman, por edhe në periferi gjendeshin shumë institucione arsimimi: për shembull, në Xhezair (Algjeri) kishte 2 shkolla në çdo fshat, kur Franca pushtoi këtë rajon, në vitin 1830.¹⁴⁵ Përpara vitit 1830, arsimi i ciklit fillor dhe dytësor ishte në lulëzimin e tij në Xhezair (Algjeri).¹⁴⁶ Nuk është e nevojshme të theksojmë edhe një herë se kjo situatë e arsimit ishte e ngjashme edhe në provincat e tjera.

18.3 Medreseja

Medreseja ishte një zhvillim relativisht më i vonshëm në arsimin islam. Faza më e hershme ishte në formën e shkollave në xhami, të cilat filluan të krijoheshin gjatë kohës së Pejgamberit të Fundit Muhammed (Paqja qoftë me të) dhe Halifëve të tij të devotshëm. Kur'ani Fisnik, Hadithi (Thëniet e Pejgamberit s.a.v.s) gjuha arabe dhe shkencat në lidhje me Islamin, mësoheshin në xhami.

Faza tjetër ishte krijimi i shkollave private të hapura kryesisht në shtëpitë e intelektualëve dhe dijetarëve. Këto shkolla ishin një formë embrionale e akademive për studime më të përparuara.

Faza e tretë ishte themelimi i *daru'l-hikmet*. Por, gjatë periudhës së sundimit të Fatimidëve, ky zhvillim u shfrytëzua veçanërisht për qëllime të propagandës shiite, duke injoruar në këtë mënyrë qëllimin e tij kryesor (përfitimim e njohurive, ndër-gjegjësimin dhe më pas shërbimin ndaj njerëzimit).

144 C. Baltacı, *XV-XVI Asırlarda Osmanlı Medreseleri*, Stamboll: 1976, fq. 19.

145 Nevill (bot.) *A Survey of North West Africa (The Maghrib)*, Oxford University Press: 1962, fq. 239, cituar në Dr. Fawzia Bariun, *Malik Bennabi, His Life and Theory of Civilization*, Kuala Lumpur, 1993, fq. 12.

146 Fawzia Bariun, *Malik Bennabi, His Life and Theory of Civilization*, Kuala Lumpur, 1993, fq. 12.

Pra, arsyeja për të cilën sunnitët muslimanë krijuan medresenë, ishte kryesisht një mënyrë për të luftuar kundër ideve të gabuara dhe të shtrembëruara në fe. Një nga institucionet më mbresëlënëse arsimore në atë kohë, ishte Medreseja Nizamijje, në Bagdad. Kjo medrese u themelua nga Nizamul Mulk, që ishte veziri i madh i sulltanit selçuk, Alp Arslan, dhe pasardhësit të tij, Melik Shah. Kjo medrese shërbeu për dy qëllime: përhapjen e diturisë dhe purifikimin e mendimit islam.¹⁴⁷

Devleti Osman zbatoi sistemin e medreseve, duke e marrë atë nga selçukët e Anadollit. Ishte e nevojshme të merrej një diplomë e quajtur *ixhazet*, që të emëroheshe si mësues në një medrese. Muderrisi ishte një dijetar i kualifikuar, me njohuri të thella të gjuhës arabe dhe me dijeni të gjera të *tefsirit*, *hadithit*, *sires* (jetës dhe biografisë së Pejgamberit të Fundit p.q.m.t.), fikhut, përveç fushës së tij të specializimit.¹⁴⁸

Medreseja e parë osmane u ndërtua në **Iznik** nga Orhan Gaziu. Muderrisi (profesori) i parë në këtë medrese ishte **Davud Kajseri** (v. 751/1351), që ishte arsimuar, pas qytetës së tij të lindjes Kajseri, në Kahire, ku ai kishte studiuar tesfirin, hadithin, usulin (metodologji), bedi' dhe shkenca të tjera. Orhan Gaziu ndërtoi edhe një medrese tjetër në Bursa në vitin 736/1335. Djali i tij, Sulltan Muradi, ndërtoi një medrese në Çekirge, në Bursa, në vitin 767/1365-66. Jëlldërëm Bajezidi ndërtoi një medrese tjetër në Bursa.¹⁴⁹ Çelebi Sulltan Mehemedi (1412-1421) themeloi një medrese të re në Bursa, që më pas mori emrin Medreseja Sulltanijje, ku muderrisi i parë ishte studiuesi i shkëlqyer dhe njëri prej djemve të dijetarit të shquar, Shemsuddin Fenarit, Muhammed Shahu, që në atë kohë ishte vetëm 18 vjeç.¹⁵⁰

147 Mustafa Bilge, *Ilk Osmanlı Medreseleri*, I.Ü. Edebiyat Fakültesi Basımevi, Stamboll: 1984, fq. XI-XII.

148 Po aty, fq. XII.

149 C. Baltacı, *vepër e cituar*, fq. 15.

150 M. Bilge, *vepër e cituar*, fq. XIII.

Sulltan Muradi II (1421-1451) themeloi *Daru'l-Hadithin* në vitin 838/1435 dhe *Yç Sherefli Medresenë* në 851/1447-48, në Edrene, që në atë kohë ishte kryeqendra e Hilafetit Osman. Ai ndërtoi një medrese tjetër që u quajt *Muradije* në Bursa.¹⁵¹ Sulltan Fatih Mehemedi (1451-1481) ndërtoi rreth xhamisë së tij në Stamboll tetë medresetë e tij, që u quajtën sipas këtij numri *el Medarisu's Semanijje*. Sylejmani i Madhërisëm (1520-1566) ndërtoi medresenë e tij në kompleksin e *Kul-lije-i Sylejmanijje* në Stamboll. Pasardhësi i tij, Selimi II (1566-1574), ndërtoi medresenë e tij në *Selimijje Kul-lije*, në Edrene.

Gjuha e mësimdhënies dhe gjuha e librave që studioheshin në medresetë osmane ishe **arabishtja**. "Studentët si fillim merrnin mësim të gjuhës arabe. Pasi arrinin të përfitonin një nivel të mjaftueshëm të njohurive të kësaj gjuhe, studentët fillonin të studionin komentet mbi Kur'anin Fisnik, traditat dhe literaturën përkatëse dhe jurisprudencën muslimane, si dhe sociologji dhe drejtësi. Komenti bazë mbi Kur'anin Fisnik ishte ai i el-Bejdaviut (*Envar et-Tenzil*), koment i quajtur "*Tefsir-i Kadi*."¹⁵² Sovranët dhe dinjitarët e lartë kishin respekt të thellë ndaj dijetarëve. Pjesa më e madhe e shehzadeve (bijve të sulltanëve) dhe pjesëtarë të tjerë të aristokracisë, punonin shumë për të marrë sa më shumë njohuri nën drejtimin e tutorëve të tyre privatë, të cilët përzgjidheshin mes dijetarëve, ose akademikëve të dalluar të kohës.¹⁵³

Studentët, ashtu si dhe muderrisi i tyre, merrnin hua nga vakëfi i medresesë. Muteveliu i vakëfit emëronte muderrisin.

Kishte dy lloje medresesh: medresetë e zakonshme dhe medresetë për specializim. Medresetë e zakonshme ndërtoheshin në çdo njësi banimi në qytet, madje edhe në fshatrat e territorit osman. Në këto medrese studioheshin shkencat islame dhe disiplina të tjera në nivele të ndryshme. Ata, që studionin

151 C. Baltacı, *XV-XVI Asirlarda Osmanlı Medreseleri*, Stamboll: 1976, fq. 19.

152 M. Bilge, fq. XIV.

153 Po aty, fq. XIII.

disa shkenca të caktuara islame dhe shkenca të tjera në nivel të lartë në këto medrese, emëroheshin si kadi, mufti apo muderris.

Medresetë për specializim ishin: *daru'l-hadith* (ku studiohej tradita fetare Islame), *daru't-tibb* (ku studimet ishin të specializuara mbi mjekësinë) dhe *daru'l-kurra*.

Daru'l-Hadith ishte një medrese, që specializonte studentët mbi bisedat dhe thëniet, veprimet dhe *takriret* (aprovimet) e Pejgamberit të Fundit. Studentët studionin në këto medrese: rivajet, dirajet, isnad, teraxhimu'l ehval (biografitë e ravijëve). Ata lexonin kryeveprat e shkencës së haditheve si Sahihun e Buharit dhe Sahihun e Muslimit dhe sherhët e tyre. Kërkesa për t'u pranuar në këtë medrese ishte diplomimi nga një medrese e zakonshme ose njohuri të një niveli të pranueshëm.

Daru't-Tibb. Tibb (mjekësia) studiohej nëpër Daru'sh-Shifa (spitale) gjatë periudhës së selçukëve dhe gjatë sundimit osman, deri në periudhën e Sylejmanit të Madhërishëm. Kur ai ndërtoi një medrese për mjekësinë, në kompleksin e ndërtesave të Kullijes Sylejmanije, studimi i mjekësisë kaloi te medresetë, ndërkohë që daru'sh-shifa mbetën vende trajnimi dhe praktike. Studentët në medresetë e mjekësisë (tibb) studionin libra të doktorëve të mëparshëm, si dhe libra të shkruara nga doktorë osmanë.¹⁵⁴

Daru'l-Kurra. Një nxënës që kishte përfunduar arsimimin e tij në sibjan mektebi apo që kishte marrë leksione private, hynte fillimisht në një daru'l-kurra të nivelit të ulët, ku ai memorizonte gjithë Kur'anin Fisnik. Më pas, ai hynte në një nivel më të lartë të daru'l-kurra, ku studionte *ilm-i kiraet* dhe *meharixhu'l huruf*. Ata studentë, që diplomoheshin në këto medrese punësoheshin në xhami.¹⁵⁵ Muaji i Ramazanit ishte periudhë pushimi për medresetë. Ishte e zakonshme që studentët t'i kalonin pushimet e tyre në fshatra ku mbanin vaz (predikonin) dhe

154 C. Baltacı, fq. 21-22.

155 Po aty, fq. 23.

imamet të faljes së teravive atje, duke vënë në këtë mënyrë në praktikë atë që kishin mësuar në medrese.

18.4 Enderun

Enderun mektebi ishte një institucion arsimor i vetëm dhe origjinal i themeluar nga Devleti Osman; nuk ka pasur asnjë institucion të ngjashëm me të, as në administrimin e selçukëve dhe as në Perëndim. Është e vërtetë se pjesëtarët e familjes sundimtare merrnin një lloj të veçantë arsimimi si në praktikën selçuke, ashtu edhe në atë evropiane, por Enderun ishte tërësisht ndryshe: ishte një shkollë e madhe me qindra studentë të përzgjedhur, e krijuar në Topkapusu Sarajë (Pallati Topkapi) për t'i dhënë mësim *elitës*, dhe për të stërvitur një numër të madh studentësh të shkëlqyer si të merrnin përgjegjësinë si sadrazam, vezir, pasha, bejlerbej, kaptan pasha etj. Ishte një akademi e specializuar për shkencat ushtarake, administrative dhe politike.

Shkolla Enderun rekrutonte studentë nga radhët e Axhemi Olanlar (Oğlanlar) (të rinjve të konvertuar në muslimanë). Fillimisht, ata stërviteshin në njërin nga këto pallate:

Edirne Sarajë.

Gallata Sarajë.

Ibrahim Pasha Sarajë.

Iskender Çelebi Sarajë.

Sulltan Muradi (1362-1389) ndërtoi një numër dhomash për këta të rinj në **Edirne Sarajë**. Për të ndjekur këtë shkollë, përzgjidheshin të rinjtë e konvertuar në muslimanë, që ishin të zgjuar dhe të aftë fizikisht. Ata mësonin lexim, shkrim dhe stërviteshin nga ana ushtarake.

Gallata Sarajë u themelua nga Sulltan Bajezidi II (1481-1512) në vitin 1481, me këshillën e Shejhut sufi, **Gyl Baba**. Në të u ndërtuan një xhami, tre konvikte me kapacitet për 200 studentë secili, tre hamame, ndërtesa për administratën dhe

kuzhina. Studentët mësoheshin nga Gyl Baba dhe dijetarë të tjerë. Ata ishin të angazhuar në veprimtari sportive të tilla si: hedhje shtize, gjuajtje me shigjetë mbi kalë etj.

Ibrahim Pasha Sarajë dhe **Iskender Çelebi Sarajë** u ndërtuan në shekullin e 16-të. Iskender Çelebiu mbante 6.000 sklevër. Gjashtë nga këta sklevër u bënë vezirë. Mes tyre ishte dhe sadrazami i mirënjohur Sokollu Mehmed Pasha.¹⁵⁶

Studentët, që trajnoheshin në këto shkolla dërgoheshin në njësitë ushtarake të kapukullu syvari dhe ata më të mirët dërgoheshin në shkollën Enderun për trajnim të mëtejshëm. Shkolla Enderun kishte 6 njësi; njësia më e lartë ishte **has oda**, ku kishte rreth 40 studentë dhe nga radhët e tyre dilnin zyrtarët e lartë.¹⁵⁷

156 B. Miller, *The Palace School of Muhammad the Conqueror*, Cambridge: 1941, fq. 78, cituar nga Ülker Akkutay, *Enderun Mektebi*, Ankara: 1984, fq. 86.

157 Ky kapitull është një përmbledhje e shkurtër e *Enderun Mektebi* (fq. 1-105) të Ülker Akkutay, Ankara: 1984.

PËRFUNDIMI

Institucionet osmane i kanë rrënjët e tyre në Islam. Si kampionë të Islamit sunnit, osmanët ishin shumë të etur të zbatonin “urdhëresat e Krijuesit” në çdo aspekt të jetës. Për këtë arsye, institucionet e tyre themeloheshin dhe drejtoheshin mbi bazën e mënyrës islame të jetesës. Me fjalë të tjera, të gjitha institucionet osmane krijoheshin, menaxhoheshin dhe mirëmbaheshin në mënyrë të atillë që të lehtësonin mënyrën e jetesës së krijesave, në përputhje me urdhrat e Krijuesit.

Institucionet osmane ishin pjesë jetësore e civilizimit osman. Çdo civilizim mund të vlerësohet nga lloji i qenies njerëzore që krijon, si dhe nga sa të lumtur janë qeniet njerëzore në atë mjedis. Civilizimi osman ishte perfekt: ai formonte nga njëra anë ushtarakë të guximshëm dhe fisnikë për fushën e betejës dhe nga ana tjetër, një *Osmanllë Efendisi*, një njeri fisnik të pastër. Ra’ijjeti (popullsia e qeverisur) jetonte e lumtur pa dallim race apo besimi fetar. Të moshuarve iu kushtohej respekt i veçantë. Një i moshuar osman ishte “autoriteti” dhe “shtylla” e shtëpisë së tij, derisa të rronte. Ai kishte autoritet të plotë, madje edhe mbi djemtë e tij të martuar që kishin fëmijë dhe nipër. Edhe pas rënies së Devletit Osman, gjysmë shekulli më vonë, vrasja vazhdonte të ishte një ngjarje e rrallë në kryeqytetin e tyre, Stambollin, dhe njerëzit do të flisnin rreth një ngjarjeje të tillë për javë të tëra të habitur dhe me përçmim.

“Lulëzimi dhe rënia e një civilizimi janë në varësi të një mase të barabartë të cilësisë së mësimdhënies bazë. Nëse i fton ithtarët e tij të heqin dorë nga bota, me siguri nga ana shpirtërore do të kishte një progres të madh, megjithatë, pjesët e tjera përbërëse të qenies njerëzore, trupi, aftësitë intelektuale, etj, nuk do të lejoheshin të kryenin detyrat e tyre të natyrshme dhe

do të vdisnin përpara moshës së tyre të lulëzimit. Por, nëse nga ana tjetër, një civilizim i kushton vëmendje vetëm aspektit material të jetës, qenia njerëzore do të ketë një progres të madh në këtë aspekt në kurriz të të tjerëve; dhe një civilizim i tillë mund të kthehet edhe në një lloj bumerangu (kundërgoditje), duke shkaktuar vetë vdekjen e tij. Sepse materializmi shpesh sjell egoizmin dhe mungesën e respektit ndaj të drejtave të të tjerëve, duke krijuar armiq, të cilët qëndrojnë në pritje të një mundësie për kundërpërgjigje. Rezultati është vrasje e ndërsjellë.”¹⁵⁸

Duke qenë se civilizimi osman varej nga Islami, ai parashikonte sigurimin e lumturisë në këtë botë dhe në botën e përtejme: “mirësi në këtë botë dhe mirësi në botën e përtejme”.¹⁵⁹ “Islami me siguri nuk do t’i kënaqë ekstremistët e asnjërës shkollë, ultra-spiritualistët (të cilët duan të heqin dorë nga gjërat e përbotshme dhe të vetësakrifikohen si detyrim) dhe ultra-materialistëve (të cilët nuk besojnë në të drejtat e qenieve të tjera njerëzore), e megjithatë, mund të praktikohet nga pjesa mbizotëruese e njerëzimit, që ndjek një rrugë të mesme, dhe kërkon të zhvillojë në të njëjtën kohë trupin dhe shpirtin, duke krijuar një baraspeshë harmonike për gjithë qenien njerëzore. Islami ka këmbëngulur mbi rëndësinë e të dyja këtyre pjesëve përbërëse të njeriut, si dhe mbi pandashmërinë e tyre, në mënyrë të tillë që njëra pjesë nuk duhet të sakrifikohet për të mirën apo përfitimin e tjetrës.”¹⁶⁰ Pra, kur osmanët ndërjuan, për shembull, imaretet, kishte një Shejh sufi, një mjeshtër shpirtëror përgjegjës për t’i pastruar shpirtrat e njerëzve, në plotësim të ushqimit të trupit të tyre material.

Ndoshta civilizimi modern asimetric, i pabalancuar, tepër materialist mund të ketë shumë për të mësuar dhe për t’iu ngjasuar osmanëve, të cilët përfaqësuan linjën e fundit më të gjatë të civilizimit islam “të balancuar”.

158 M. Hamidullah, *Introduction to Islam*, botimi i 5-të, Lahore: 1979, fq. 38-39.

159 Kur’an, *el-Bekare*, 201.

160 M. Hamidullah, *vepër e cituar*, botimi i 5-të, Lahore: 1979, fq. 39.

BIBLIOGRAFIA

A. Dokumentacioni zyrtar

Başbakanlık Osmanlı Arşivi (BOA) (Arkiva Osmane e Kryeministrisë turke), *Mühimme Defteri* 5.

BOA, *Mühimme Defteri* 7.

BOA, *Name-i Hümayun Defteri (NHD)* 5.

BOA, *Name-i Hümayun Defteri (NHD)* 7.

BOA, *Name-i Hümayun Defteri (NHD)* 8.

BOA, *NHD* 9.

BOA, *NHD* 12.

BOA, *NHD* 13.

BOA, *AMD* 216.

BOA, *AMD* 218.

BOA, *AMD* 256.

BOA, *AMD* 257.

BOA, *Irade – Hariciye* 6 1693 Şevval 1332.

BOA, *Mukteza Defteri* 21 pg.114.

Topkapı Sarayı Müzesi Kitaplığı (TSMK) E/645

(Përkthimi i letrës së dërguar sulltanit osman në vitin 925/1519 nga *hatibët, fukuhatë, imamët, tregtarët dhe fisnikët e Xhezairit (Algjerisë) në lidhje me veprimtaritë e xhihadit të Oruç Reisit*).

B. Libra dhe Artiku

1. Në turqisht:

Abdullah Battal Taymas, *Qazan Türkleri* (Stamboll, 1341/1925).

Afetinan, *Piri Reisin Hayatı ve Eserleri* (Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1992).

Ahmed Asim, *Tarih* (Stamboll, Jeride-i Havâdis p.d.)

Ahmed Cevdet Paşa, *Maruzat*, red. nga Yusuf Halaçoğlu (Stamboll, Çağrı Yayınları 1980).

Akgündüz, Ahmed, *Osmanlı Kanunnamelerinin Hukuki Tahlilleri I* (Stamboll, 1990).

Akkutay, Ülker, *Enderun Mektebi* (Ankara, 1984).

Aknerli Grigor, *Mongol Tarihi*, trans. by Hrand D. Andreasyan, (İstanbul Üniversitesi Edebiyat Fakültesi, Stamboll, 1954).

Aly Bayoumy Aly Oteify, "Interrogative Utterances in Surah Al-Baqarah" *Intellectual Discourse* (The journal of the Faculty (Kulliyah) of Islamic Revealed Knowledge and Human Sciences) (International Islamic University Press, Malaysia, October 1993) I, Nr.1, fq.70.

Aşıkpaşaoğlu Tarihi, ed. Nihal Atsız (Ankara, 1985).

Baltacı, Cahit, *XV-XVI, Asırlarda Osmanlı Medreseleri* (Stamboll, 1976).

Baykal, Bekir Sıtkı, "Mustafa III", *M.E.B. İslâm Ansiklopedisi* vëll. VIII (Stamboll, 1993) fq.701.

Berki, Ali Himmet, "Vakıf Kuran ilk Osmanlı Padişahı" *Vakıflar Dergisi* vëll. V. (Ankara, 1962).

Beydilli, Kemal, *Türk Bilim ve Matbacılık Tarihinde Mühendishâne, Mühendishâne Matbası ve Kütüphanesi (1776 – 1826)* (Stamboll, 1995).

Bilge, Mustafa, *İlk Osmanlı Medreseleri* (İstanbul Üniversitesi Fakültesi Basımevi, 1984).

Bostan, İdris, *Osmanlı Bahriye Teşkilatı XVII, Yüzyılda Tersane-i Amire* (Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1992).

Çıfci, Fâzıl, *Candaroğlu İsmail Bey, Şahsiyeti ve Eserleri*, (Kastamonu, 1996).

Danişmend, İsmail Hami, *İzahlı Osmanlı Tarih Kronolojisi*, 4 vëllime. (Stamboll, 1971).

Defterdar Sarı Mehmed Paşa, *Zübde-i Vakayı'at* (Stamboll: Tercümen Yayınları 1977).

- Eneveri, Düstürname, bot. nga M. Halil Yinanç (Stamboll, 1928).
- Faiq, Reshad, *Tarih-i Edebiyat-ı Osmaniyye* (Stamboll, p.d.).
- Feridun Beğ, *Münshat-i Selatin* (Stamboll, 1274).
- Fındıqlılı Mehmed Ağa, *Tarih* (Stamboll, 1928).
- Halacoğlu, Yusuf, "Osmanlı İmparatorluğunda Menzil Teşkilatı Hakkında Bazı Mülahazalar" *Osmanlı Araştırmaları* II (Stamboll, 1981).
- Hamidullah, Muhammad, *Introduction to Islam*, botimi i 5-të (Lahore, 1979).
- İbn Kemal (1468-1534) shkroi *Tevarih-i Al-i Osman* me urdhër të Bajezidit II (1481-1512).
- _____, bot. nga Şerafettin Turan, *Tevarih-i Al-i Osman, VII Defter* (Atatürk Kültür, Dil ve Tarih Yüksek Kurumu, Ankara, 1991).
- İnalçık, Halil – Mevlüt Oğuz, *Gazavat-ı Sultan Murad b. Mehmed Han* (Ankara, 1978).
- İpşirli, Mehmet, *Yüzyıl Başlarına Kadar Osmanlı İmparatorluğunda Kadiaskerlik Müessesesi* (disertacion pas doktoraturës që nuk është publikuar, İstanbul Üniversitesi, Edebiyat Fakültesi).
- Jelalzade Qoja Nishanji Mustapha, *Kitab-ı Measir-i Selim Khani*, (dorëshkrim) (TSMK H. 1415).
- Karal, Enver Ziya, *Osmanlı Tarihi* (Ankara: Türk Tarih Kurumu 1983-1996).
- Katib, Chelebi, *Tuhfetü'l Kibar fi Esfari'l Bihar* (Stamboll, 1329).
- Kazıcı Ziya, *Osmanlılarda İhtisab Müessesesi* (Stamboll, 1987).
- Keşfi Mehmed Çelebi, ed. by Şefaettin Severcan, *Keşfi'nin Selim-Namesi* (Kayseri, 1995).
- Khoja Sa' deddin, *Tacu't Tevarih* (Stamboll, 1329).
- Köprülü, F. Orhan – Mustafa Uzun, "Akşemseddin" *Türkiye Diyanet Vakfı Ansiklopedisi*, v. II, fq. 299-301.
- Kramers, J. H., "Şeyhülislam" *İslam Ansiklopedisi XXI* (Stamboll, 1979).
- Kuran, Aptullah, *Mimar Sinan* (Stamboll, 1985).
- Levend, Agah Sırrı, *Gazavatnameler ve Mihaloğlu Ali Beyin Gazavatnamesi* (Stamboll, 1956).
- Lutfi Pasha, *Tevarih-i Al-i Osman* (Stamboll, 1341).
- Mahmud Jeleleddin Pasha, *Mirat-ı Haqiqat* (Stamboll, 1326).

Maksudoğlu, Mehmet, "Tunusta Dayıların Ortaya Çıkışı" *Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, vol. XIV (Ankara, 1967), fq. 189-202.

_____, "Tunusta Hakimyetin Dayılardan Beylere Geçışı" *Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, vëll. XV (Ankara, 1968), fq. 173-186.

Mehmed Rashid Efenedi, *Tarih* (Stamboll, 1867).

Mehmed Süreyya, *Sijill-i Osmani* (Stamboll, 1308).

Mehmed Tefviq, *Tarih-i Osmani* (Stamboll, 1305).

Mustapha Nuri, *Netayiu'l Vuqu'at* 4 vëllime (Stamboll, 1327).

Müneccimbaşı Ahmed b. Lütfullah, bot. nga Ahmet Ağırkça, *Camiü'd Düvel, Osmanlı Tarihi, (1299-1481)* (Stamboll, 1995).

Müstakimzade Süleyman Sa'deddin, *Devhatu'l Meşahih* (Stamboll, 1978).

Na'ima, *Ravzatul Huseyn fi Khulasati Ahbaril Khafiqayn*, botimi i 2-të (Stamboll, 1978)

Neşri (Mehmed) ed. by F.R. Unat and M.A. Köymen, *Kitab-ı Cihan-nüma*, 2 vëllime (Ankara, Türk Tarih Kurumu, 1949).

Oruç Beğ Tarihi (Stamboll, Tercüman Yayınları, 1972).

Otmanbölük, Günvar, "Fatihin Annesi Özbeöz Türktür" (E ema e Fatihut eşhtë me origjinë turke) (gazeta) *Türkiye*, 13 janar 1992, fq. 8. (Bursa Sher'iyye Sijilleri, Nr.31 (fq.35), 201 (fq.64) dhe 375 (fq.40).

Öztuna, Yılmaz, *Osmanlı Tarihi* 4 vëllime, (Faisal Finans Kurumu, Stamboll, 1986).

Pakalın, M. Zeki, *Osmanlı Tarihi Terimleri ve Deyimleri Sözlüğü* 2 vëllime, (Stamboll, 1983).

Parmaksızoğlu, İsmet, "Kemal Reis" *İslam Ansiklopedisi* vëll. VI, (Enciklopedia e Islamit në turqisht, botuar nga Minsitria e Arsimit), fq. 566-569.

Pechuyi, İbrahim, *Tarih-i Pechuyi* (Stamboll, Enderun Kitabevi 1980).

Piri Reis, *Kitab-ı Bahriye* (Stamboll, 1935).

Qarachelebizade (Shejhulislam) Abdulaziz, *Ravzatul Ebrar* (Bulak, 1248)

Rashid, *Tarih II* vëllime (Stamboll, 1281).

Şahin, Kamil, "Edebalı" *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*, vëll. X, 393-394.

Shanizade Mehmed 'Ataullah, *Tarih* (Stamboll, 1284).

Selaniki Mustafa Efendi, bot. nga Mehmet İpşirli, *Tarih-i Selanki*, 2 vëllime, (Stamboll, 1989).

Silahdar Fındıklılı Mehmed Ağa, *Silahdar Tarihi* (Stamboll, 1928).

Solaqzade Mehmed Hemdemi, *Solaqzade Tarihi*, (Stamboll, 1298).

Togan, Zeki Velidi, "İbn Faldan", *İslam Ansiklopedisi*, vëll. V, pjesa II (Stamboll, 1993), fq. 730-731.

Turan, Osman, *Türk Cihan Hakimteti Mekfuresi Tarihi*, 2 vëllime (Stamboll: Nakışlar Yayınevi, 1979).

Tursun Beğ, *Tarih-i Ebu'l Feth*, (Stamboll: Fetis Cemiyeti, 1977).

Uludağ, Osman Şevki, bot. nga İlder Uzel, *Beş Bçuk Asırlık Türk Tababeti Tarihi* (Ankara, 1991).

Uzunçarşılı, İsmail Hakkı, *Osmanlı Tarihi*, 4 vëllime (Ankara, Türk Tarih Kurumu, 1947-1959).

_____, *Osmanlı Devleti Teşkilatından Kapıkulu Ocakları*, I, (Ankara, 1984).

_____, *Osmanlı Devletinin İlimiye Teşkilatı* (Ankara, 1984).

_____, "Gazi Orhan Bey Vakfiyesi" *Belleten* vol. V, 19, (Ankara TTK, 1941), fq. 280-283.

Yazıcızade, *Selchuqname*, TSMK, Revan 1391.

Yüce, Nuri, "Bulgar (Batı Hun Devleti içindeki Türk kavimlerinden biri)" *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*, vëll. VI (Stamboll, 1992), fq. 390.

2. Në arabisht:

el Kur'anu'l Kerim

Ebu Bekr Muhammed b. Aziz es Sixhistani, *Garibu'l Kur'an (el Musemma bi Nuz'hati'l Kulub)*, Bejrut; Daru'l Fikri'l Arabi, (Bejrut: Daru'l Fikri'l Arabi, 1402/1982) botimi i 3-të.

Ebu Davud, es *Sunen*.

Abu Ya'la Muhammed b. Husejn al Ferra, *el Ahkamu's Sultaniijeh* (Surubaya, Indonezi: 1394/1974).

Ahmed Ibn Hanbel, *el-Musned*.

el Buhari, *el Xhami'u's Sahih*.

Hallak, Hasan, *Tarihun Nukud ve'd Dawawin* (Bejrut, 1986).

Hrejdi, Muhammed Abdullatif, *el Hurub'l 'Uthmanijje-el-Farisijeh wa atharuha fi inhisari'l meddi'l Islami 'an Urubba* (Luftërat osmano-perse dhe ndikimi i tyre në kufizimin e valës Islame nga Evropa) (Kajro, 1408/1987).

Harb, Muhammed, "Abdul Hamid", (përkthimi dhe komentet nga) *Mudhakkiratu's Sulltan Abdil Hamid*, (Egjipt, 1978).

Ibn Battuta, *Rihletu'bni Battuta* (Tuhfetu'n Nuzzar) (Bejrut, 1384/1964).

Ibn Hisham, *es Siretu'n Nebevjetu* (Kajro, 1375/1955).

Ibn Ijas, bot. nga Muhammed Mustafa, *Bedai'u'z Zuhur fi Weka'i'id Duhur* (Kajro, 1960).

Maksudoğlu, Mehmet, "Zuhuru'd Dayat bi'l Kutri't Tunisijji", *Ankara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi* vëll. XIV (Ankara, 1967), fq. 202-210.

Malik b.Enes, *el Muvatta*.

El-Maverdi, *el Ahkamu's Sultaniijeh* (Kajro, 1983).

Muhammad Ferid Bej, *Tarih'd 'Aliijeti'l 'Uthmanijjeti* (Bejrut, 1986).

Nesai, *es Sunen, el Bej'at*

Öztuna, Yılmaz, *Tarihu'd Devleti'l 'Uthmanijjeti I* (përkthyer nga Adnan Mahmud Salman, redaktuar nga Dr. Mahmud el-Ensari), (Stamboll: Faisal Finance Institution Inc. 1408/1988).

esh-Shazuli, Mahmud Thabit, *el Mes'eketush Sharkijeh: diraseh vethaikijeh 'ani'l Hilafeti'l 'Uthmanijeh* (Kajro: Maktabat Wahbah, n.d.)

esh-Shinavi, Abdulaziz Muhammed, *ed Devleh el-'Uthmanijeh, Devleh Islamijeh Muftaran 'Alejha*, 3 vëllime (Kajro, 1980).

Taşköprüzade İsameddin b. Ahmed b. Mustafa, *esh Shekaiku'n Nu'manijjatu fi Ulemai'd Devleti'l Aliijeti Uthmanijjeti* (Bejrut, 1975).

3. Në anglisht:

Ibn Battuta (përkthyer nga H.A.R. Gibb), *Travels in Asia and Africa 1325-1354* (Londër, 1983).

Bariun, Fawzia, *Mālik Bennabi, His Life and the Theory of Civilization* (Kuala Lumpur: ABIM, 1993).

- Bryer, Anthony, *Peoples and Settlement in Anatolia and Caucasus 800-1900*, (Londër: Variorum Reprints, 1988).
- Davison, Roderic H., *Reform in the Ottoman Empire 1856-1876* (New York, 1973).
- Dunn, Ross E., *The Adventures of Ibn Battuta: A Muslim Traveler of 14th Century* (Londër, 1973).
- Emerson, Rupert, *From Empire to Nation* (Cambridge, Massachussets: Harvard University Press, 1967).
- Ferriman, Z, Duckett, *Turkey and the Turks* (Londër: Mills and Boon Ltd., 1911).
- Figgie, Jr. Harry E. and Gerald J. Swanson, *Bankruptcy 1995 The Coming Collapse of America And How to Stop it* (Boston, New York: Back Bay Books, 1992).
- Gibb, H.A.R., *A History of Ottoman Poetry* (Londër, 1900, ribotuar 1958).
- Gibbson, H.A., *The Foundation of the Ottoman Empire, A History of the Osmanlı up to the death of Bayezid I 1300 – 1403* (Frank Vass & Co. Ltd., 1988).
- Goldsmith, Jr., Arthur, *A Concise History of the Middle East* (Colorado: Boulder, 1988).
- Hamdani, ‘Abbās, “Ottoman Response to the Discovery of America and the New Route to India” *Journal of American Oriental Society*, vol. 101 (1981), fq.323 – 330.
- Houston, William, *Meltdown, The great ‘90s Depression and how to come through it a winner* (Londër, 1994).
- Inalcık, Halil (përkthyer nga Norman Itzkowitz and Colin Imber), *The Ottoman Empire* (Londër, 1973).
- _____, “The Heyday and Decline of the Ottoman Empire” *The Cambridge History of Islam, IA*, (Cambridge University Press, 1988), fq.324 – 353.
- Jay, Richard, “Nationalism” *Political Ideologies* (Londër: Unwin Hyman, 1990).
- Jenkins, R.J.H. (ed. By J.M. Hussey), “Social Life in the Byzantine Empire” *The Cambridge Medieval History*, vëll. IV, pjesa II (Cambridge University Press, 1967, ribot. 1978).
- Keller, Werner (përkthyer nga William Neil), *The Bible as History* (Britani e Madhe, 1967).

- Köprülü, M. Fuad (përkthyer dhe botuar nga Gary Leiser), *The Origins of the Ottoman Empire* (New York, 1992).
- Kushner, David, *The Rise of Turkish Nationalism 1876-1908* (Londër, 1977).
- Lane-Poole, Stanley, *Turkey* (ribotuar, Londër, 1986).
- Lapidus, Ira M., *A History of the Islamic Societies*, (Cambridge University Press, 1988).
- Lewis, Bernard, *The Emergence of Modern Turkey* (botimi i dytë, Londër 1968).
- _____, *The Arabs in History* (New York: Harper Torchbook, 1967).
- Lings, Martin, *Muhammad (s.a.w) His Life based on the earliest sources*, (Londër: George Allen & Unwin, 1983).
- Lord Kirnoss, *The Ottoman Centuries, the Rise and Fall of the Turkish Empire* (New York: Morrow Quill Paperbacks, 1977).
- Maksudoğlu, Mehmet, "Empire or Devlet? The Ottoman Polity Revisited" *International Islamic University Malaysia, Research and Information Bulletin*, janar dhe shkurt 1994.
- _____, "Osmanlı Socio-Political Entity: Empire or Devlet?" *Hamdard Islamicus*, vëll. XVIII (1995).
- Muller, Herbert J., *The Uses of the Past : Profiles of the Past Societies* (New York: New American Library, 1954).
- Pitcher, Donald Edgar, *An Historical Geography of the Ottoman Empire* (Leiden: E.J. Brill, 1972).
- Pixley, Michael M., "The Development and the Role of Shaykhulislam in the Early Ottoman History" *Journal of the American Oriental Society*, vëll. 96, Nr.1 janar – mars 1976.
- Reid, Anthony, *The Contest for North Sumatra, Atjeh; the Netherlands and Britain 1858 – 1898* (Oxford University Press – University of Malaya Press, 1969).
- Repp, R.C., *The Middle of Stamboll: a study in the development of the Ottoman learned hierarchy* (Oxford University Computing Service, 1986).
- Savory, R.M., "Safavid Persia" *The Cambridge History of Islam I A* (Cambridge, CUP).
- Scrutton, Robert, *Nature's Way to Nutrition and Vibrant Health* (California: Willshire Book Company, 1977).

Shaw, Stanford J., *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey I*, (ribotuar, Cambridge, 1988).

Shaw, Stanford J. – Ezel Kural Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey*, vëll. II, (Cambridge, 1977).

Spuler, Bertold (përkthyer nga F.R.C. Bogley), *The Muslim World, Part I The Age of the Caliphs* (Leiden: E.J. Brill, 1960).

Stripling, George William Frederic, *The Ottoman Turks and the Arabs 1511 – 1574* (Philadelphia: Porcupine Press, 1977).

Sufi Path (artikuj në lidhje me Sufizmin), (Malaysia: A.S. Noordeen, 1991), kapaku mbrapa.

Taylor, A.J.P., *The Course of German History* (Londër: Routledge paperback, 1988).

Uğur, Ahmet, *The Reign of Sultan Selim I in the light of the Selim-Nāme Literature* (Berlin: Klaus Schwarz Verlag, 1985).

Vaughan, Dorothy, *Europe and the Turk, A Pattern of Alliances 1350 – 1700* (Liverpool, 1954).

Wright, Jr., Walter Livingstone, *Ottoman Statcraft, The Book of Counsel for Vezirs and Governors of Sarı Mehmed Pasha, the Defterdar*, (Princeton: Princeton University Press, 1935).

4. Në frëngjisht

Cahen, Claude, *La Turquie Pre-Ottomane* (Stamboll-Paris, 1988).

TREGUESI

Simbolet

1289 IV, XXXV, XLIII, 1, 22, 32,
33, 478, 494
1299 XXXV, XLIII, 33, 34, 36,
393, 419, 596

A

abasidët XXVII, XXXVI,
XXXVIII, 6, 9, 11, 12, 13,
25, 27, 158, 206, 510, 539
Abbas Hamdani 164, 195, 196,
218, 219, 247, 264, 280,
281, 296
Abbas Mirza 296
Abdalan-ë Rum 29
Abdulkadir Gejlani 263, 314
Abdullah Mihal 38
Abdullah Xhevdet 449
Abdulmeliku 294
Abdurrahman Gaziu 41
Abdyhhamidi II VII, XXXVII,
427, 433, 456, 460, 475,
477, 579

Abisini 281
Açeh 282, 283, 292
Adami 507
Ademi 244, 507, 516, 518
Aden 279, 280
Adlije Nezareti 542
Admirali Moceniko 320
Admirali Nelson 370
Admirali Sejmur (Seymour)
442
Admirali Sushon (Souchon),
463
Adolf Slejdi (Adolphus Slade)
396
Adrianapoja 56, 65
Afrika Latine XLI, 269, 293
Aga Hysejin Pasha 384
Agah Efendi 414, 415
ahi XI, 28, 55, 569
Ahi Hasan 28
Ahi Shemseddin 28
Ahijan-ë Rum 29
Ahijje (futuvveh) 29
Ahijje-Fitjan VIII, XI, 527
Ahijjeh 27

- ahinjtë* XXXVIII, 55
 Ahmed Asim XXXIV, 360, 594
 Ahmed b. Hanbeli, XXVI, 150, 598
 Ahmed Beu (Beğ), XIX, 95, 181, 182, 188, 438, 512
 Ahmed ibn Mexhid 219
 Ahmed Muhtar Pashai 433, 443
 Ahmed Pashai 179, 186, 253, 266, 347, 349
 Ahmed Riza, 450, 454
 Ahmed Urabi Pasha, 441
 Ahmed Vasëf XXXIV, 486
 Ahmed Vefik Pasha 431
 Ahmed Xhevdet Pashai 398, 414
 Ahmed i Xhelajirit 97
 Aishe 297, 315
 A.J.P. Taylor 162
 Aj 7
 Ajadimitri, Kisha 125
 Aja Sofja 42, 151, 157, 159, 165, 181
 Aja Sofja (Hagia Sophia/Shën Sofja), 42
 Aja Sofja, Xhamia 329, 541
 Ajashilunje 49
 Ajdën (Aydın) 69, 77, 84, 101, 110, 116, 148
 Ajdënlë Mehmed Agai 344
 Ajdënoğlu (Aydinoğlu) 84, 100, 116, 122
 Ajdos 41, 68
 Ajdos (Ajtes) 68
 Ak Shemseddin 504
 Ak Temur 31
 Akaba XVI, XXX, 531
 Akçaj 95
 Akçakoxha 40, 41, 47
 akënxhë, XI, XLI, 131, 175, 211, 524, 549, 555, 556
 akënxhinj 38, 73, 93, 94, 117, 176, 211, 255, 297, 298, 326, 555, 556
 Akënxhë Sinan 126
 Akkerman 208, 211, 359, 365, 522
 Akkirman 187
 Akkojunllu 171, 174, 181, 182, 183, 239
 Aksaraj 89, 95, 166
 Akshehir 71, 100, 109, 10, 148, 181
 Akshemseddin 4, 156, 158, 159, 160, 578
 Alaeddin Ali 94
 Alaeddin Beu 40, 41, 75
 Alaeddin Kejkubad 17, 34, 470
 Alaije 148
 Alajundlu 8
 Alauddevle 228
 Albert 129, 130, 211, 496
 Aleks Komneni, 15
 Aleksandër Ipsilanti 380, 381
 Aleksandër Kara Todori 437
 Aleksandri 108, 233, 309, 432, 443
 Aleksandropoja 56

- Alemdar Mustafa Pasha 376,
 377
 Alepo (Haleb) 222, 229, 239,
 240, 250
 Alfonsi V 175
 Alfonso de Pavia 164
 Algjeria XLI, 210, 268, 272,
 295, 388, 389, 390, 439,
 485, 497, 582, 593
 Ali Beu 122, 128, 129, 131, 228,
 234, 249
 Ali Beu, djali i Shehsuvarit 228
 Ali (Çetinkaja) 458
 Ali Efendi 232, 367
 Ali Kushçu 192
 Ali Pasha, 74, 78, 81, 89, 100,
 107, 215, 290, 293, 305,
 333, 344, 345, 349, 351,
 355, 364, 378, 380, 382,
 386, 387, 388, 390, 391,
 397, 406, 413, 414, 416,
 419, 422, 424, 517, 560
 Ali Suavi 414, 434, 435, 436
 Ali Xhemali Efendi 542
 Alkaevli 7
 alp, alperen XI
 Allashehir (Filadelfia) 85
 Allaxhahisari 127
 Amadeus II 67
 Amasja 89, 95, 100, 108, 113,
 104, 115, 171, 201, 215,
 227, 266, 577
 Amasra 171, 172
 Amerika 162, 202, 218, 264,
 280, 293, 361, 381, 393,
 476, 485, 495, 561
 Amorium 7, 13
 Amurijjeh 13
 Amxhazade Hysejin Pasha 334
 Anadolli XI, XIV, XXVII,
 XXVIII, XXXII, XXXIII,
 XXXVI, XXXVIII, XL, 3,
 5, 13, 14, 16, 19, 23, 27,
 30, 37, 48, 49, 50, 54, 55,
 60, 61, 65, 66, 67, 75, 77,
 81, 82, 84, 88, 95, 98, 99,
 100, 120, 121, 127, 131,
 173, 190, 212, 213, 215,
 217, 221, 224, 232, 255,
 266, 277, 306, 310, 320,
 321, 375, 390, 395, 401,
 469, 472, 504, 512, 550,
 563, 577
 Andaluzi V, XL, XLI, 209, 268,
 269, 272, 273, 495, 562
 Andrea Doria, 267, 273, 274,
 275, 277, 278, 560, 563
 Andronikosi 124, 125
 Andronikos II Paleologos 64
 Ankara XXXII, 54, 55, 56, 81,
 94, 96, 99, 104, 113, 120,
 121, 124, 141
 Anri Matjë (Henry Mathieu)
 147
 Anthony Bryer 118, 206
 Apafi Mihal 321
 arabe, (gjuha); arabisht XII-
 XVII, XXV, XXIX, XLIII,

- 8, 11, 16, 79, 164, 409,
424, 435, 458, 466, 470,
494, 496, 516, 554, 555,
557, 560, 582, 584
- Aram 455
- Argos 180
- Arkiduka Ferdinand XL, 301,
302
- Arkiduka Maksimiljani 299
- Armëpushimi i Mondros 467
- Armutllu 46
- Asakir-i Measure-ji
Muhammedije 385
- Asefname 518
- Ashëkpashazade XXXIII
- Astrahan 184, 244, 288
- atijeh XXVI
- Atilla 8
- Avasim 7
- avni 145
- Avshar 7
- Axhlan Beu 46
- Azak V, XLII, 184, 334, 335,
341, 343, 348, 350, 359
- azeb* 225, 560
- Azeb 549
- Azerbajxhan 99, 182, 221, 264,
266, 296, 305
- Aziz Mahmud Hydai 311, 504
- B**
- Bab-ë Asefi 518
- Babuz Zuvejleh 234
- Bafi 289
- Bagdad XXXVI, 9, 23, 264, 313,
314, 447, 510, 512, 513,
583
- Bahadër Gëraj 362
- Bahadur Shah 279
- Bahrejni 264
- Bajat 7
- Bajbars 510, 512
- Bajëndër 8
- Bajezidi II XXXII, XXXIII,
XXXVII, XL, 189, 207,
209, 210, 211, 215, 238,
239, 513, 539, 561, 586,
595
- Bajsungur Mirza, XXXVII, 239
- Bajxhu Nojin 18
- Bakër Kyresi 112
- Baleare, ishujt 210
- Bali Beu 211, 255
- Ballaban Beu 176
- Ballëkesir 47
- Balltaogllu (Baltaoğlu)
Sylejman Beu 154
- Balltaxhë Mehmed Pasha 341,
342
- Banati 364
- Banda, Açeş 283
- Barbaro 291
- Barbarosa, 267, 269, 270
- Baroni de Tott 353, 373
- Bartholomeu Diaz 164
- bastion 273
- Battal Gaziu 5, 6
- Batu Hani 9, 244
- Baxhijan-ë Rum 29

- bedesten 191
- Bedkersburg 111
- Bedreddin Bagdadi 132
- Bedreddin et Tunisi 132
- beğlerbeği XI
- Bejlerbej XI, 38, 81, 260, 272,
278, 301, 382, 456, 518,
563
- Bejliku i Germijanit 109, 110
- Bejshehri (Beğşehri) 71, 75, 76,
109, 110, 126, 148, 181
- Bejtul Mal XI, 31, 558
- Bekir Pasha 369
- Bekir Subashë 313
- Benito Musolini 379
- Beogradi 87, 250, 287, 297, 301,
327, 333, 334, 345, 522
- berat* XI, XXXVI, XXXVII, 45,
58, 236, 260, 270, 469,
545
- Berat 168, 175
- Bergama 47
- Bernard Luis (Bernard Lewis)
XIX, XXV, 183, 385, 396,
450, 491, 506, 511, 538
- Besarabia 187, 378, 427, 434
- Beshiktashi 276, 277
- Beshli 549, 557
- Beteja e Arasit 182
- Beteja e Çëlldërit 296
- beytülmal XI
- Biga 61, 64, 65
- Big-dili 7
- Biladu'sh-Sham (Siria) 98, 230,
240, 246, 249, 251, 388,
510, 513, 544
- Biler 9
- Bilexhik 27, 33, 36, 61
- Bitola (Manastiri) 58, 73
- Bixhaje (Bougie), 268
- Bizanti 73, 188
- Blum 64
- Bodrum (Halikarnasos) 109
- Bogazkesen (Boğazkesen) 149,
153
- Bogdani V, 135, 137, 183, 185,
186, 187, 207, 208, 210,
211, 254, 297, 303, 309
- Bogomil 67, 179
- Bollajër 50, 54, 431
- Boris Han 9
- bork (börk), XI, 41, 63, 550
- Borkyjaruk (Börküyaruk), 16
- boruk (böruk) XI, 63
- Borxhia 169
- Bosfori 3, 41, 87, 90, 149, 384,
390, 397, 398, 443
- Bosnja 14, 179, 180, 255, 349,
429, 432, 437, 456, 489
- bota e krishterë, XLI, 25, 84,
87, 162, 165, 168, 204,
209, 250, 254, 256, 272,
379, 524, 559
- Brazili 280, 294, 295
- Breslau 463
- Budapesti 257, 258, 260, 261,
297, 301, 484
- Budin 297, 301

- | | |
|--|---|
| Buhara 8 | Çalldëran 223, 224, 225, 227,
228, 229, 239 |
| Buhari XXVI, 78, 511, 585, 598 | |
| bullgar 8, 9, 66, 68, 74, 90, 419,
420, 437 | Çanak Han 8
Çanakkale 48, 431, 458, 465 |
| bullgarët, 8, 9, 10, 61, 68, 74,
88, 90, 102, 411, 420, 421,
445 | Çankëre 112, 121
Çatallburgaz 68
Çatallxha 69, 375, 434 |
| Bullgarët e Vollgës 9, 10 | Çavundur 8 |
| Bullgaria 50, 56, 60, 66, 68, 74,
75, 81, 84, 86, 87, 108,
419, 427, 429, 432, 433,
434, 444, 446, 456, 457,
460, 461 | Çebni 8
Çelebi Mehammedi XXXVII
Çelebi Mehemmedi IV, XV,
107, 108, 109, 111, 112,
113, 114, 115, 116, 121,
181 |
| Bursa, XXXIII, XL, 39, 46, 47,
50, 52, 54, 56, 58, 62, 69,
72, 80, 83, 92, 93, 95, 100,
107, 114, 118, 123, 124,
127, 130, 133, 140, 142,
143, 146, 147, 206, 238,
512, 567, 577, 583, 584,
596 | Çetinkaja 458
Ch. Tissot 440
çifutët 67, 498, 580
Çiragan 434, 436
Çirmen 68
Çorlu 56, 522
Çubuk 99
Çukurova 212 |
| Bykdyz 8 | |
| C | D |
| Cari Ivan Shishman 68 | Dag (Dağ) 7, 8 |
| Cari rus XLIV | Dagestani 296 |
| Cezar XLIV, 65, 307 | Damask 158, 227, 233, 240,
372, 408, 466 |
| <i>Cihan-numa</i> XIX, XXXII | Dani 111, 120 |
| Ç | Danubi 8, 91, 96, 137, 168, 187,
208, 250, 322, 332, 333,
349, 402, 560 |
| Çagrë (Çağrı) Bej 14 | |
| Çajërzhëk (Çayırçık) 146, 148 | Darab Beu 184 |

- Dardanelet 255, 319, 321, 356,
431, 458, 459, 465
- Darende 89, 96
- Darëxha 41, 114
- Daru'l-hadith 141
- Daru'l-harb 57, 544
- Daru'l-hikmet 582
- Daru'l-hilafet 58, 59, 237, 469
- Daru'l-Islam 57, 178, 206, 562
- Daru't-Tibb 577, 585
- Daru'l-xihad 251
- David Komneni 174
- Davudi (a.s.) 244, 346
- Davud Kajseri 42, 583
- Davut Pasha, 311
- D.E. Piçer (Donald Edgar
Pitcher) XXX, XLI, 40,
105, 106, 205, 210, 227,
288, 556
- Defterdar 82, 254, 520
- Deli 549, 557
- Demirhan Beu 47
- Deniz 7, 8
- dervish XII
- Dervish Pasha 442
- Despina Maria 146
- Despoti i Epirit Karlotoxhi 125
- Deti i Zi XI, XXXVII, 18, 40, 41,
91, 101, 116, 171, 178,
184, 186, 208, 209, 288,
309, 341, 350, 359, 373,
391, 398, 399, 418, 419,
433, 464, 466, 561
- Deti Egje, 3, 15, 16, 59, 109,
110, 134, 156, 182, 213,
- 319, 369, 373, 374, 437,
445, 459
- Devlet Hatun 71, 72, 123
- Devleti XV, XVI, XXX, XXXI,
XXXVI, XXXVII, XXXIX,
XLIII, XLIV, 3, 11, 30,
32, 34, 35, 38, 39, 46, 50,
54, 62, 70, 82, 89, 97, 116,
118, 133, 149, 159, 171,
173, 174, 180, 182, 186,
188, 193, 202, 205, 209,
213, 220, 226, 228, 231,
237, 238, 253, 254, 285,
307, 319, 321, 323, 329,
330, 339, 340, 346, 348,
350, 351, 367, 375, 376,
378, 381, 385, 392, 394,
395, 404-409, 415, 422,
423, 425, 428, 432, 437,
438, 441, 452, 456, 457,
465, 469, 471, 473-477,
486, 510, 517, 520, 523,
525, 526, 528, 529, 540,
550, 558
- Devlet-i Alijje-i Osmanijje XV,
21, 34, 76, 351, 384, 404,
417, 418, 437, 482, 483,
487
- Devlet Gëraji 289, 343, 355
- Devleti Osman, XI, XIII, XIV,
XV, XXV, XXX, XXXII,
XXXV, XXXVIII, XLIII,
XLIV, 25, 32, 35, 46, 51,
55, 59, 63, 64, 67, 71, 76,
86, 87, 89, 94, 95, 96, 110,

- 111, 116, 120, 123, 148,
155, 159, 166, 175, 176,
177, 189, 190, 196, 207,
209, 210, 211, 213, 223,
231, 235, 236, 237, 240,
243, 248, 252, 255, 259,
264, 267, 278, 279, 280,
290, 292, 293, 295, 304,
307, 321, 324, 325, 329,
335, 350, 354, 360, 361,
362, 363, 365, 366, 367,
368, 369, 371, 372, 375,
382, 385, 387, 390, 391,
393, 394, 395, 398, 403,
409, 412, 413, 418, 420,
433, 434, 437, 440, 442,
443, 445, 452, 456, 458,
459, 461, 462, 463, 466,
467, 469, 470, 471, 474,
477, 483, 492, 493, 497,
505, 518, 522, 523, 526,
528, 529, 530, 531, 533,
534, 539, 540, 543, 548,
549, 550, 558, 561, 571,
572, 583, 586
- Devleti Selçuk 75, 96, 97, 469,
504, 515, 518, 522, 530
- Devlet-i Senijje, XXV, 482
- devshirme XII, 64, 251, 476,
489, 550
- Diaz 164, 218
- Dilaver Pasha 310, 311
- Dimetoka (Dydimothikhon)
56
- Dimitrijos Laskarius 116
- Dimitrios 166
- dirlik 172
- Diu 231, 279
- divani* XXVI, XXXVI, 45, 381,
519, 521
- Divani VIII, XXVII, XXVIII,
187, 228, 261, 281, 321,
518, 519, 521, 548
- Divan-ë Hymajun (*Divan-ı
Hümayun*) VIII, XXVII,
38, 187, 228, 281, 321,
324, 394, 519, 520, 521,
524, 528, 532, 543, 548
- Divriği (Divriği) 89ö 96
- dizdar* XII, 51, 149, 574
- Dobruksa 9, 88, 433, 467
- Dodurga 7
- Doger (Döğer) 7
- Dom Zhao 164, 218
- Dom Zhao II 164
- Domaniç 21, 22
- Domeke (Dömeke) 445
- Domur 22
- Don Huan 290, 293
- Donanma-jë Hymajun 187,
251, 273, 274, 276, 278,
287, 292, 341, 344, 519,
559, 561
- Doxhi i Venedikut 60, 272
- Dragut 563
- Drama 68
- Drini 88
- Dubrovniku (Raguza), 65, 166,
180, 533
- Duka XXXIX, 65, 67, 151, 276

- Duka i Madh Notaras 151
 Duka i Savojes 67, 276
 Dulkadiri 139, 228
 Dulkadiroglu (Dulkadiroglu)
 212
Dysturname (Düsturname) e
 Enveriu XXXIII
- DH**
- dhimmi XII, 395, 497, 532
 dhimmitë 74, 105, 531
- E**
- Ebu Abdil-lah Muhammed
 268, 272
 Ebu Davud 26, 28, 516
 Ebu Ejjub XXXIX, 3, 160, 505
 Ebu Ejjub el-Ensari 160, 505
 Ebu Hanife Nu'man b. Thabit
 263
 Ebu Ja'la el-Ferra 59
 Ebu'l Berekat 235, 236
 Ebu Sa'id 182
 Ebussuud Efendiu 541, 542
 Ebu Zekerijja Jahja 212
 Edebali 26, 27, 28, 33, 35, 45,
 159, 504, 537, 568, 569,
 571, 597
 Edinxhik 49
 Edirne 238, 522, 586
 Edremi 47
- Edrene XXXIII, 50, 56, 59, 61,
 65, 73, 84, 114, 115, 117,
 121, 126, 127, 129, 131,
 132, 133, 141, 149, 152,
 167, 174, 208, 209, 250,
 260, 292, 309, 323, 326,
 329, 332, 339, 363, 461,
 569, 575, 584
- Egjipt VIII, XXXVII, XL, 26, 76,
 87, 95, 98, 104, 158, 162,
 201, 220, 225, 229, 231,
 233, 235, 236, 238, 240,
 241, 242, 249, 251, 253,
 279, 289, 292, 308, 310,
 317, 367, 369, 370, 371,
 372, 374, 378, 382, 386,
 388, 390, 391, 397, 398,
 414, 416, 418, 419, 435,
 441, 443, 444, 450, 464,
 466, 473, 477, 486, 496,
 497, 510, 512, 513, 539,
 546, 566, 579, 598
- Egri (Eğri) XLIII, 299, 331
 Egriboz (Eğriboz) 111, 182, 183
 Ehli Bejti 214
 Ehl-i Kitab 67
ejalet 234, 421, 554, 555
 Ejjub 160
 Ejmyr 8
 Ejup Sulltan XXXIX, 5, 254
 Elbasan 176
 Elena 170, 171
el-Haramejn esh-Sherifejn XL,
 202, 231, 235, 254, 279,
 472, 573

- El-Haxh Ali Beu 357 108, 109, 121, 185, 244,
 248
- El-Haxh Bajram Veli 504
- El-Haxh Bektash Veli 504 Emiratat e Germijanit 71, 184
- El-Haxh Hasan 42, 571 Emirul Mu'minin XXXVII,
 XXXVIII, 58, 158, 509
- Elkas Mirza 265
- El-Maverdi XXVI, 515, 516, Emmanuel Carasso 455
 546, 598 enderun XII, 580
- El-Me'mun, 6, 13 *Enderun* XII, 250, 553, 586, 587,
 594, 596
- el-Medine XXV, XXVI, XXVII, En-Nasir li Dinil-lah 28
 XL, 3, 33, 141, 146, 202, 229, 235, 236, 254, 301,
 447, 453, 472, 509
- El-Mu'tesim 7
- el-Xhezair 268, 269
- el-Xhezira 99
- Emanat-ë Mukaddese* (Reliktet e shenjta) 237, 242
- Emanat-ë Mukaddeseh* 237
- emanat-i ilahi 13
- Emanuel Karaso, 455
- Emet 71
- Emevit, Hilafeti XXXVIII, 3
- emevitët XXVII, 12, 25, 205, 206, 214, 510
- Emin Beu 439
- emir* XXVIII, 410, 516
- Emir Çaka 16
- Emir Rashid 260
- Emir Sulltan, 123, 124, 141, 504
- Emir Sulltan Muhammed Buhari 504
- Emir Sylejman, 105, 113, 114
- Emir Timur 10, 94, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 104, 108, 109, 121, 185, 244,
 248
- Emiratet e Germijanit 71, 184
- Emirul Mu'minin XXXVII,
 XXXVIII, 58, 158, 509
- Emmanuel Carasso 455
- enderun XII, 580
- Enderun* XII, 250, 553, 586, 587,
 594, 596
- En-Nasir li Dinil-lah 28
- Enver Beu (Beğ) 461, 462
- Enver Pasha 35, 456, 462, 463,
 473
- Enver Zija (Ziya) Karal XIX,
 XXXV, 369, 373, 385,
 409, 425, 435, 436, 450,
 452
- Enveri 178, 458, 460, 461, 463
- Enxhymen-i Danish 398
- Erdel 260, 299, 303, 320, 333,
 334
- Eregli (Ereğli) 6, 12
- eren* VII
- e r e n 51
- Ertugrull (Ertuğrul) Gaziu 21,
 23
- Erzinxhan 89, 96
- Erzurum 14, 17, 18, 183, 296,
 347, 371, 415, 523
- Eseks 304
- Eskishehir (Eskişehir) 28, 31ö
 32, 34, 522
- Esperih 9
- Estergon XLIII, 298, 303, 305,
 307, 327

etat 21

Etiopia 164, 195, 219, 281

evkaf 525, 543

Evrenos Beu (Beğ), XXXVII,
XXXVIII, 54, 56, 59, 68,
73, 77, 120, 124, 128, 131,
168, 175, 180, 188, 556

Evropa IV, XI, XXXIX, XLII,
12, 23, 38, 42, 43, 44, 46,
52, 54, 56, 68, 72, 73, 74,
77, 81, 84, 86, 87, 88, 92,
94, 96, 97, 101, 102, 104,
105, 112, 122, 131, 132,
135, 148, 150, 152, 160,
164, 168, 172, 173, 184,
187, 188, 189, 190, 206,
208, 212, 217, 218, 224,
226, 230, 231, 233, 237,
242, 251, 253, 254, 256,
261, 265, 305, 329, 331,
340, 361, 362, 366, 368,
376, 378, 379, 380, 382,
383, 385, 387, 396, 403,
409, 413, 414, 415, 417,
420, 422, 424, 425, 434,
435, 451, 460, 469, 472,
474, 476, 493, 509, 512,
513, 518, 522, 531, 550,
556, 562, 567, 575, 576,
579, 598

Exhe Beu (Beğ) 49

Exhe Halil 48

Ezani XII, 6, 178, 226, 271, 317,
569, 581

F

Fahreddin Axhemi 542

farz 'ajñ muakkad 33

Fasi (Magrib) 294

Fatih V, XXIX, XXXII, XXXIII,
XXXVI, XXXVII, XLII, 4,
32, 127, 145, 146, 147,
153, 155, 157, 158, 160,
163, 167, 168, 169, 170,
173, 174, 176, 177, 178,
179, 181, 184, 185, 186,
188, 189, 190, 191, 194,
201, 238, 243, 254, 404,
469, 478, 504, 513, 520,
542, 547, 552, 578, 584,
596

Fazëll Ahmed Pasha 322, 323,
324

Fazëll Beu 459

Fej 533

fej XXVI

Ferdinandi XL, 188, 257, 258,
259, 260, 261, 263, 301,
302, 461

Ferexh 104

Ferhad Pasha 250, 296

Ferhadi 298

Feridun Beğ (Beu) XIX, XXXII,
XXXV, 22, 46, 58, 87, 595

Ferik Hysejin Pasha 408

ferman XII, XIV, 190, 403, 404,
411

ferman-ë ali 190

Fermani VII, 384, 403, 412

- feta* XII, 29
fet'h XXIX, 11, 59, 64, 131, 151,
 153, 323
 Fet'hi (Okyar) 458
fetva XII, 131, 235, 310, 377,
 384, 423, 519, 540
 feudalizëm XXX, XXXI, 70
 Fikh XXX
 Filadelfia 231
 Filibe 59, 60, 73, 172, 250, 421,
 522
 Filipi II 295
 Firuz Agai 149
fitjan 29, 54, 55
 fitre 12
 Flamuri Otoman 121, 243, 283,
 310
 Flota e Papatit 134
 flota romake 3, 90
 Foça 16, 109
 Franc Jozef 362
 Franca XXIV, 35, 64, 65, 92,
 101, 145, 176, 204, 206,
 212, 213, 242, 254, 258,
 261, 264, 265, 270, 275,
 276, 295, 304, 305, 323,
 324, 328, 345, 356, 361,
 362, 367, 368, 370-372,
 376, 385, 386, 388-391,
 394, 398-407, 411, 413,
 418, 419, 432, 435, 438-
 441, 443, 446, 458, 463,
 464, 468, 485, 487, 490,
 495-497, 515, 582
 Françesko Morozini 318
 Frangistani 233
 Fransua (François) I 258, 304
 Fransua 258, 274
 Frederiku 207
 Fuad Pasha 408, 409, 417, 419,
 424
 Futuvveh 27, 55
 futuvveh 28, 29
 Fuzuliu 264, 496
- G**
- G. Norodongëjan, 459
 Galipoli 66, 67, 134, 466
 Gallata 86, 146, 374, 394, 435,
 586
ganimet XXXIX, 209, 238, 302,
 556
gaza XII, 57
 Gazali 249, 250, 253
gazavat 52, 256
gazi XII, XXXIX, 79, 97, 106,
 132, 174, 213, 268, 269,
 270, 277, 356, 433, 549,
 581
 Gazi Evrenos Beu 68
 Gazi Fazëll 48, 49
 Gazi Gëraj 297
 Gazi Hasan Pasha, 364, 365,
 373
 Gazi Is'hak Beu (Beğ) 129
 Gazi Sylejman Pasha 50
 Gazijan-ë Rum 29
 Gebze 114, 189, 522, 523

- Gedik Ahmed Pasha 186, 188, 189, 202, 517
- Gejikli Baba 504, 569
- Gelibollu 50, 66, 85, 91, 110, 111, 116, 123, 149, 182, 272, 559, 561
- gelin hamamë 146
- Gemlik 46
- Genadios 151, 166
- Genadios Skolarios 166
- George 118, 207, 231, 600, 601
- Germijan 19, 71, 77, 84, 101, 109, 118, 123, 148, 512
- Germijanogllu (Germiyanoğlu) 107
- Gijaseddin Kejhusrev 16, 21
- Gijasuddin Kejhusrev II 18
- Gijasuddin Mesud 19
- Girne 289
- Gladstone, 443
- Göben 463
- Gok (Gök), 7, 8
- Gonyl-ly (Gönüllü) 549, 557
- greke VIII, 63, 162, 185, 194, 290, 380, 382, 386, 399, 445, 493
- grekët 59, 73, 157, 166, 380-382, 386, 394, 412, 420, 445, 460, 580
- Grenada 209, 210
- Greçia 110, 185, 375, 385-388, 412, 413, 417, 445, 446, 456, 460, 461, 467, 474
- Greçia e Lashtë 145
- Grigorios 381
- gusl XII, 31, 575
- Guxharat 279, 282
- Gymylxhine 58, 59, 68
- Gymyshly Kymbet 38
- Gyn 7
- Gyzelxhe, 87, 149, 275
- Gyzelxhe Hisar, 87, 149
- Gj**
- Gjeneral Kleberi 371
- Gjenerali Napoleon Bonaparti 370
- Gjenerali kroat Ruzunxhuk 284
- Gjenerali Valze 389
- Gjenova 73, 84, 178, 184, 438
- gjenovezët XLII, 94, 171
- gjenovasit 172, 243
- Gjeorgjia 171, 266
- Gjergj 121
- Gjergj Kastrioti 175-177
- Gjon Kastrioti 120
- Gjon Andronikus Paleologos 73
- Gjorgje Brankoviç 127, 129, 167, 170
- Gjykata e Kuleli 408
- H**
- H.A. Gibbons XXIII
- Habsburgët 257, 258, 264, 271, 326, 328
- Haçova, XXXIV, 299, 302

- hadith* 74, 78, 583, 585
 Hadithi 582
hadith sherif XIII, XXVI, 79, 150,
 237, 348, 511, 527
 Hadixhe Turhan 319
 Hafëz Pasha 313, 388
 hafiz/hafëz XII, 140, 226
 hafsi 212, 268, 272
 Hagia Sophia 191
 Hajdar Pasha 293
 Hajrabollu 68
 Hajreddin Pasha XLI, 68, 73,
 81, 273, 275, 276, 438, 441,
 517
 Hajri Beu (Beğ) 240, 249, 253
Hakk 39, 123, 128
 hakk-ë zira'et 525
 halaskaran 460, 461
 Haleb 522
 Halet Efendi 380, 381
 Halife-Sulltan XXVII, 23, 24,
 284, 287, 438, 455, 457, 464,
 512, 514, 515, 517, 519-523,
 525, 530, 540
 Halifi XXVI, XXVII, XXXVI,
 XXXVII, 6, 9, 11-14, 17, 22,
 24, 28, 46, 50, 58, 59, 76, 87,
 160, 229, 237-239, 283, 299,
 303, 311, 360, 409, 410, 425,
 438, 459, 469, 507, 510-515,
 538
 Halifi Ebu Bekr XXVI
 Halil Hamid Pasha, 360, 361
 Halil Pasha 89, 133, 156, 308,
 325, 345, 355, 517
 Halilur Rahman (Hebron) 141
 hamam XII, 61, 146, 572, 574,
 575, 577
 hamamxhë esnafë XIII, 575
 Hamidi 77, 84, 101, 116
 Hamideli 71, 118
 Hamilton Sejmur (Saymour),
 400
 Hamza Beu (Beğ) 108, 122,
 154, 177
 Hamza Pasha 354
 Han Allmësh 9
 Hanati i Kazanit 10, 244, 304
 Hani i Turkestanit 182
 hass XIII, 525
 Hatixhe Hyma 146
 Hatt-ë Hymajun (Hatt-ı
 Hümayun) XXVII, 187, 303,
 377, 392-395, 428, 519, 548
 haraç XIII, XLIII
haraxh XIII, XXIX, 12, 231, 236,
 532
 Harran 12
 Harshova 349
 Haruni (a.s.) XXVIII
 Harun er-Rashidi 12
 Hasan Pasha, XL, 275, 297,
 301, 303, 356, 364, 365,
 373, 408, 514, 573
 Hasan Khan XXXIV, 226, 246
 Hassan Ali Hallak XXVI
 Hatixhe Hatun 127
 Hatman Dorosenko 324, 325
 Hatunije Kynbedi 147
 Hatvan 299

- haxh XIII, XV, XLII, 77, 129,
201, 293, 407
- Haxh b. Sha'ban XXXVII 560
- Haxh Isa Dede, 141
- haxhet namaz XII 270
- Haxhi Ali Aga 376
- Haxhi Ali Pasha 409
- Haxhi Bajram 158
- Haxhi Bajram Veli 120, 158
- Haxhi Hysejin 270
- Haxhi Ilbeji (İlbeği), 48, 54, 56,
61
- Haxhi Ivaz Pasha 115, 117
- Hazar (Kaspiku) 288
- Hazret Ali 261, 263
- Hekimogllu (Hekimoğlu) Ali
Pasha 349, 351
- Hemedan 14, 346
- Hendeku 522, 523
- Henri (Henry) 164, 295
- Henri Bakëll (Henry Buckle)
44
- Henri IV 101
- Hercegovina 135, 179, 429,
432, 437, 456, 457, 489
- Hereke 114
- Hermanshtad 131
- Hernando Kortezi 275
- Hersegzade Ahmed Pasha 179
- Hërka-i Sherif 541
- Hëzër 123, 136, 267
- Hëzër Beu (Beğ) 166
- Hëzër Hajreddin 269, 274ö 272
- Hëzër Hajreddin Beu 210
- Hëzër Hajreddin Pasha 61, 63,
267, 271, 274, 275, 276, 559,
560
- Hëzër Hajreddin Reis XL, 268,
270
- Hëzër Reis 268, 270, 562, 564
- Hilafeti IV, V, VIII, XXXVI, 3,
14, 23, 26, 45, 58, 158,
189, 190, 192, 232, 237,
238, 239, 271, 293, 294,
301, 423, 447, 469, 472,
507, 510-515, 517, 519,
522, 533, 541, 584, 598
- Hilafeti Abasid XXXVI, 23, 469
- hil'et-i fahireh 58
- Historia e Inkuizionit 43
- Hixhaz XV, 37, 77, 201, 202,
212, 230, 235, 239, 278, 279,
289, 418, 435, 447, 467, 472
- Hixhreti 3, 33, 165, 284
- Horasan Erenleri 504
- Hordhia 10, 59, 185, 237, 244,
246
- Hordhia e Artë 10, 59, 185,
237, 244
- Hoxha Firuz Beu (Beğ) 84
- Hoxha Sa'deddin XXXIV, 233,
235
- Hristaki 422
- Hristoforidhi Efendi 439
- Hudabende 296
- huffaz XII, 53
- Humbaraxhë Ahmed Pasha
352, 373, 552
- humsul ganaim 31

- Hunët 8
 hungarez/e XL, 61, 78, 86, 87,
 111, 126, 156, 255, 257, 260,
 325, 373, 463
 hungarezët 91, 102, 131, 136,
 167, 176, 181, 187, 254, 299,
 301, 402, 403
 Hungaria XL, 50, 60, 66, 67, 80,
 85, 87, 89-93, 111, 126, 127-
 131, 134-136, 156, 167-169,
 177, 181, 183, 188, 190, 204,
 207, 210-212, 250, 254-261,
 322, 325, 333, 402, 487, 555
 Hurshid Pasha 378, 381
 Husameddin Çoban 17
 Husameddin Pasha 356
 hutbe XXXV, 33, 34, 84, 112,
 158, 201, 226, 228, 231, 234,
 238, 239, 249, 253, 271, 360,
 438, 459, 514
 Hvarezm 288
 Hyma (Huma) XXVII, 228,
 519, 548
 Hyma Hatun 146
 Hymajun XXVII, 228, 282, 519,
 548
 Hysejn Avni Pasha 423, 425,
 426
 Hysejn Beu (Beğ) 71, 439
 Hysejn Dajë 389, 497
 Hysejn Hajrullah Efendi 423
 Hysejn Pasha 310, 351
 Hysejn-zade Ali 449
 Hysrev Pasha 372, 374, 383
- I**
 Ibn Battuta XXXII, 27, 28, 29,
 40, 55, 598, 599
 Ibn Haxher el Askalani 131
 Ibn-i Kemal 22, 154
 Ibn Ijas XXXIII, 598
 Ibn Kemal XXXIII, XXXIV, 31-
 34, 157, 172, 174, 184, 234,
 238, 241, 513
 Ibrahim (a.s.) 7
 Ibrahim Beu (Beğ) 122, 126,
 127, 131, 132, 134, 136, 146,
 148, 181, 369
 Ibrahim ibn Adham 133
 Ibrahim Pasha 253, 254, 301,
 263, 325-327, 345, 346, 357,
 378, 382, 383, 386, 387, 390,
 392, 397, 414, 517
 Ibrahim Temo 449
 Idil 9
 Igdër 8
 Ihtisab Agasë 545-547
 İ.H. Uzunçarşılı XXIV, 21, 34
 Ihtiman 68
 Ijaz b. Ganm 12
 ikta XIII, XVI, XXX, 40, 51, 70,
 525, 549, 558
 Ilhanllı 37
 Ilhanllinjte 98
 Iljas 118, 121, 123, 267, 562
 Iljas Beu (Beğ) 121
 Imami Azam Ebu Hanife 314
 Imam Mutahher 282

- imaret XIII, 42, 61, 114, 140-142, 208, 209, 240, 552, 566, 571, 577, 590
- India XXXVII, XLII, 11, 195, 218, 219, 224, 227, 230, 231, 247, 248, 256, 278, 279, 281, 282, 295, 351, 370, 399, 400, 407, 410, 413, 422, 451, 464, 509
- Indonezia 283
- Inebahtë (Lepanto) 180, 210, 213, 290, 560
- Inegol (İnegöl) 36, 172
- Inxhegiz 68, 69
- Inlik 364
- Inkuizicioni XL, 44
- Ipsala 56
- Irak 18, 99, 182, 195, 227, 264, 466, 467
- Irak-ë Arab 267
- Irena 119
- Isa Beu (Beğ) 120, 121
- Isa Çelebi 104, 105, 107, 108, 121
- Isfendijar Beu (Beğ) 107, 109, 111, 121, 127, 146, 238
- Is'hak 181, 267, 562
- Is'hak Beu (Beğ) 127, 129
- Is'hak Sukuti 449
- Iskender Beğ (Skënder Beu) 121, 168, 175-177, 181
- Iskender Pasha 309
- Islahat 408
- Ismail Beu (Beğ) 172, 173, 184
- İsmail Hakkı Uzunçarşılı XX, XXXIV, 21 ... (poshtshënimet)
- Ismaili II 296
- Ismail Pasha 375, 414, 418
- Ismet Parmaksëzoullu XLI
- Isparta 71
- israf 92
- Ishtvan 260
- Italia 64, 65, 67, 125, 169, 185, 188, 189, 207, 265, 272, 279, 402, 432, 439, 458, 459, 463, 487
- İtil 9, 288
- İtil (Vollga) 288
- İttihad dhe Terakki Partia XLIV
- İttihad ve Terakki 449, 453-456, 460, 461, 463, 465, 471, 473, 477
- Ivani III 185
- Ivan III Vasiljeviç 185
- Ivaz Mehmed Pasha 349
- Ixhareli 549, 554, 555
- ixhazet XIII, 34, 76, 583
- Izmir (Smirna) 100
- Izmit 37, 40, 46, 47, 113, 404, 559
- Iznik (Nikea) XLII, 15, 37, 41, 42, 44, 46, 100, 118, 256, 566, 568, 571, 575, 583
- Izzet Mehmed Pasha 367, 371, 384
- Izzet Pasha 462

- J**
- Jabërlle 7
- Ja'feth 7
- Jahshi Beu (Beğ)
jaja 52, 53, 64, 549, 550
- Jakub Beu (Beğ) 107, 109, 123,
176, 410
- Jakub Exhe 50
- Jakup Sipahi 562
- Jakub Shah 238
- Jaltavar 9
- Jaltavarogllu (Yaltavarogllu)
Allmush Han 510
- Jalvaç 110
- Jan Albert 211
- Janbollu 68
- Janëkkale 297
- Janosh Hunjadi 131, 135-137,
148, 156, 167, 169
- Janosh Zapolja 257-261
- Janja 124, 380
- Jarhisar 36, 172
- Ja Sin 246
- Java XLIII
- Javuz 220, 221, 231, 232, 235,
248, 294, 463
- Javuz Selim XXXVII, XXXVIII,
XLII, 158, 186, 220, 222-226,
232-235, 239-243, 246, 254,
270, 271, 315, 513, 544, 562,
563, 542
- Jazëxhëogllu (Yazıcıoğlu)
Mehemmed 143
- Jazëxhëzade (Yazıcızade)
XXXII
- Jazër 7
- Jean sans Peur (Gjoni i
Patrembur) 92
- Jegen (Yeğen) Mehmed Pasha
351
- Jemen XXV, XLII, 212, 235,
253, 264, 279, 280, 282, 447,
472
- jeniçeri XII, XIII, XVI, XXV,
XXXIX, 63, 64, 77, 135, 136,
169, 218, 222-224, 227, 239,
250-253, 273, 298-300, 310,
311, 330, 345, 350, 373-377,
382-385, 489, 514, 520, 549-
553
- Jenishahir 36, 61, 88, 172, 201
- Jerli Kullu 549, 554
- Jerusalem 16, 195, 202, 203,
219, 229, 242, 246, 295, 395
- Jezusi 101, 138, 244, 245, 507,
508, 563
- Jezu Krishti 146, 164, 165, 179,
194, 305
- Jëlldërëm Bajezid 71, 83-107,
110, 112, 113, 123, 124, 143,
158, 160, 211, 238, 469, 478,
492, 504, 512-514, 536, 539,
577, 583
- Jëlldöz 7, 439
- Jëva 8
- Joani 63
- Joanis 63, 66, 116, 118
- Joanis V 66, 69, 85

- Joanis V Paleologos 85, 134
 Junus Emre 504
 Junus Pasha 232
 jus primae noctis XXXI, 23, 46,
 70
 Jusuf 98, 298
 Jusufi (a.s.) 244
 Jusuf Mirza 182
 Jusuf Pasha 313, 364, 365, 367
 Jusuf Zija Pasha
- K**
- Kabakçë Mustafa 375, 376
 kadi XIII, 62, 82, 86, 89, 96,
 166, 303, 360, 519, 536-538,
 543, 567, 585
 Kadiasker XXXIV, 62, 241, 304,
 519, 543, 544
 kadiasker 234, 543, 544, 580
 kadiasker (gjykatës ushtarak)
 82
 Kadiasker Kara Halil 63
 Kadi Burhaneddin 84, 89, 95
 kadë XIII
 Kafir 75, 79, 97, 127, 128, 138,
 271, 300, 309, 394
 Kajë 7, 21, 22
 Kajëtbej 201, 249
 Kajro XXVI, 33, 67, 76, 202,
 212, 221, 226, 229, 232,
 233, 236, 238, 241, 251,
 257, 264, 280, 390, 442,
 453, 458, 514, 515, 516,
 531, 598
- Kajseri 5, 89, 95, 423, 566, 583
 Kajzer Vilhelmi II (Kaiser
 Wilhelm II) 446
 Kalexhik 112, 121
 Kalikut (Kalkuta) 219
 Kalorësit e Sh. Xhonit 90, 100,
 101, 108, 183, 203, 231, 244,
 246, 251, 252, 277, 278, 287,
 291, 323, 368, 369, 562
 Kalorësit e Zvicrës 90
 Kamil Pasha 461
 Kandëra 41, 566
 Kandije 252, 323, 553
 Kanixhe XL, 301-303, 322, 339,
 514
 Kanun-ë Esasi 428
 Kansu Gavri XXXVIII, 228-
 231, 249
 Kanuni Sulltan Sylejman 249-
 251, 478
 Kapëdagë (Kapıdağı) 12
 Kapëdagë, Istmi 3
 Kapllan Gëraj 355
 Kapoljon 422
 Kaptan-ë derja XIV, XL, 290,
 291, 293, 356
 Kapudan-ë Derja 154, 274, 364,
 373, 383, 559, 560, 562, 563
 Kapukullu 549, 553, 554, 587
 Karaagaç (Karaağaç) 71
 Kara Ahmed Pasha 261
 Karabaë (Karabağ) 99, 226, 266
 Karaevli 7
 Kara Halil 28, 41, 62, 63, 68, 81,
 82, 543

- Karaxha Beu (Beğ) 135, 169
 Karaxhahisar 31, 33, 34
 Karaxha Pasha 125, 126, 148, 169
 Karaman 19, 54, 58, 75, 76, 84, 88, 94, 95, 103, 108, 109, 118, 122, 126-128, 134, 148, 166, 182, 188, 201-203, 237, 512
 Karaman, Bejliku 59, 75, 76, 88, 95, 109, 110, 112, 124, 126, 131, 132, 149, 172, 181, 211, 212, 512
 Karamursel 47
 Karamursel Gazi 41
 Karakash Mehmed Pasha 309
 Kara Timurtash Pasha 85
 Kara Jusuf 98, 99
 Karbonarët 414
kardesh 28
 Kardinali Besarion 185
 Kardinali Cezarini 134
 Kardinali Gregorius 151
 Kardinali Izidor 165
 Kardinali Kondolmieri 134
 Karesi 47, 49, 50, 69
 Karesi, Bejliku 46, 48
 Karinabad 68
 Karëk 7
 Karlieli 277
 Karkën 7
 Kars 351, 388, 401, 433, 523
 Kasim Beu (Beğ) 109, 111, 112
 Kastamonu 77, 89, 107, 112, 146, 148, 173, 190, 238
 Katif 264, 281
 Kavala 68
 Kaza 82, 421, 537
 Kazan 10, 244, 288, 304
 Kazasker XIII
 Karli V 257, 258, 259, 261, 263, 265, 269, 272, 273, 274, 275, 277, 290, 293, 304, 464, 485
 Karli XII 341
 Kasimir Jagellon IV 210
 Kastija 210
 Katalanët 64, 65
 Katerina I 342, 355, 362
 Katerina II 362
 Katib Çelebi XXXIV, XXXIX, 271, 272, 580
 Kaukazi 8, 14, 30, 186, 288, 346, 402, 422, 438, 450, 466, 467
 Kefe 184, 186, 217, 243, 288, 321, 357
 Kelanti 436
 kelenderi 31
 Kemah 99, 227
 Kemal Pashazade XXXIII, 542, 580
 Kemal Reis XL, 209, 210, 268, 561
 Kemankesh Kara Mustafa Pasha 317
 Kepi i Shpresës së Mirë 164, 218, 231, 278
 Kerbela 214
 kervansaraj 526, 527, 572, 573, 576

- Keshan 50
 Këllëç Ali Pasha 291, 293, 560
 Këllëç Allajë 4, 318, 427
 Këllëç Arslan 16
 Kënëk 8, 11
 Kërëm 186, 244, 310, 320, 321,
 324, 326, 335, 341, 360, 362,
 515, 533, 557
 Kërklareli 68
 Këzëllagaç (Kızılağaç) 68
 Kështjella Çimbeni 49
 Kiklad, Ishujt 110, 111
 Kili 208, 209, 359, 365, 366
 Kina 99, 101, 104
 Kirkasian 388
 Klod Aleksandër Kont dë
 Boneval (Claude
 Alexandre Comte de
 Bonneval 352
 Knjazi i Moskës 185
 Koloneli Favje (Fabvier) 382
 Komneni i Madh Andronikos
 III 118, 207
 Konotop 322
 Kont de Boneval 373
 Kontinenti i Amerikës 280, 399
 Konur Alp 40
 Konja XXXV, 6, 12, 15, 19, 31,
 75, 88, 89, 95, 109, 110, 122,
 182, 201, 202, 289, 381, 388
 Kopyryzade (Köprülüzade)
 Abdullah Pasha 347
 Kopyryly (Köprülü) Mehmed
 Pasha 319-322, 329
 Kopyryzade (Köprülüzade)
 Abdullah Pasha 347
 Kopyryzade (Köprülüzade)
 Numan Pasha 344
 Korinti 121
 Korkut 213, 215, 218, 219
 Korona 180, 210, 213
 Korsika 277, 414
 Kosedagë (Kösedağ) 18, 19,
 100
 Kose (Köse) Mihal 36, 38
 Kosem (Köse) Sultaneshah
 315
 Kosova XXXIX, 14, 76, 77, 79,
 80, 83, 103, 137, 139, 151,
 457, 551
 Kostendil (Köstendil) 68
 Kostandin 46, 166, 185, 493
 Kostandin Paleologos 166, 185
 Kostandini i Madh 192
 Kostandini VI 119
 Kostandinopoja XXXVI, XLII,
 XLIII, 3, 4, 5, 12, 16, 19,
 37, 56, 57, 60, 65, 67, 73,
 85, 90, 91, 94, 98, 114,
 118, 149-160, 163-168,
 174, 189, 196, 238, 256,
 314, 492, 495, 504
 Kostantinijje XLII, 256
 Koxhaeli 47
 Koxha Jusuf Pasha 363, 366
 Koxha Nishanxhë XXXIII
 Kreta XLIV, 252, 317, 339, 412,
 413, 419, 445, 456, 553

- Krimea (Kërëmi) V, VII, XLII, VII, XLII, 17, 73, 185, 186, 208, 217, 243, 244, 288, 289, 297, 303, 304, 308, 309, 310, 341, 343, 348, 349, 355, 357, 359, 360, 362, 363, 366, 368, 398, 400-405, 408, 411, 515, 533, 557, 564
- Krishterimi 52, 145, 166, 167, 188, 194, 195, 202, 237, 245, 256, 259, 324, 420, 474, 503, 513, 575
- krishterët 16, 43, 44, 50, 53, 64, 67, 72, 180, 184, 189, 194, 209, 212, 219, 251, 270, 272, 273, 275, 301, 317, 380, 394, 407, 489, 492
- Kruja 175-177, 187
- Kryqëzatat 16, 84, 246, 369, 498, 542
- Kryqtarët 61, 91, 246
- Kujuxhu Murad Pasha 306
- Kula 71
- Kula Shahin Pasha 131
- kumanët 9
- Kur'ani Fisnik XII, XVI, XVII, XXIX, 22, 24, 31, 50, 53, 74, 136, 163, 222, 232, 242, 244, 245, 282, 300, 470, 471, 494, 508, 528, 531, 534, 540, 546, 550, 565, 581, 582, 584, 585
- Kurdogllu (Kurdoğlu) Hëzër Reis 282
- Kurdogllu (Kurdoğlu) Muslihuiddin Reis 253, 268
- Kurum Han 9
- Kutallmësh 15
- Kutejbeh b. Muslim 8
- Kuvrat Han 9
- Kytahja 22, 40, 71, 123, 284, 390
- L**
- lada sexhupak 283
- Ladislavi 131
- Llagëmxhinj (Lağimji) 384, 549, 552, 553, 555
- Lajosh 61, 66, 254, 255, 256
- Lakanas 118
- Lale Devri 346
- Larende 95, 182
- Larisa 88
- latine 14, 70, 155
- Lazar 72, 76, 77, 80, 83, 170
- Lefkosha 289
- Lehistan (Polonia) 210, 211, 309
- Lepanto 180, 210, 213, 290, 291, 293, 275, 560
- Lezha (Lesh Alesio) 177
- Libia XLI, 201, 277, 294, 317, 318, 458, 459, 462, 495, 555, 563
- Lorente 43, 567
- Lord Bajron (Lord Byron) 382
- Lord J. Russel 402
- Lorendano 111

- Ludoviku 171
 Lui Filip (Louis Philippe) 402
 Lyleburgaz 56
 Lytfi Pasha XXXIV
- LL**
- Llalla Mustafa Pasha 289, 296
 Llalla Shahin 61
 Llalla Shahin Pasha 54, 56, 59,
 68, 81, 518
- M**
- ma'ash* XXVI
 i Madhërishmi 259
 Magnisa (Manisa) 133
 Magoza 289
 Magribi 281, 294, 295
 Mahmud Pasha 170, 173, 178,
 181, 182
 Mahmud Xhelaledin Pasha
 428, 435, 439
 Mahmud Nedim Pasha 419,
 422, 423
 Mahmud Shah 279
 Mahmud Shevket Pasha 455,
 461
 Malaka 282
 Malatja 7, 229
 Malazgirt 15
 Malhun Hatun 26
 Mali i Zi 344, 411, 429, 432,
 434, 461
 Malik b. Enes XXVI
 Mallkara 50, 56, 55, 218
 Malta 205, 252, 274, 275, 278,
 293, 368, 371, 389, 562, 563
 Mani 260
 Mankup 184, 186
 Manuel II 85
 Manuelli 86, 90, 112, 114, 116,
 118, 124
 Manuelli II 85, 86
 Manuel Paleologos II 85
 Manzikert 14, 15
 Maqedonia 68, 69, 233, 445,
 446, 460
 Mara 37, 170
 Marakesh 268
 Mareshali Potemkin 362, 364
 Maria 61, 127, 145, 146
 Marica 57, 59
 Marko Ganis 118
 Marko Grimani 274
 Marko Polo 196
 Marta Rabe 342
 Mbretëresha Katerina II 355,
 362
 Mbretëresha e Anglisë 305
 Mbretëresha Viktoria 417
 Mbreti i Austrisë XLIV
 Mbreti Fransua (François) I
 258
 Mbreti Jan Sobijeski 326, 327
 Mbreti Ladislav 131, 134, 136,
 211
 Mbreti Lazlo 136, 156
 Mbreti Lajosh 61, 66, 254, 255,
 257

- Mbreti Sebastjan 295
- Mbreti Shishman 66, 68, 74, 75, 90
- medrese XIV, XXX, 17, 30, 42, 43, 61, 62, 97, 103, 114, 130, 191, 192, 208, 209, 250, 278, 384, 398, 408, 413, 470, 494, 496, 538, 541, 566, 573, 577, 580-586, 594
- Medina XV, XXV, XXVI, XXXVII, XL, 3, 141, 146, 202, 229, 235, 236, 254, 453, 472, 509
- medhheb* 131, 214, 538
- Megaduka 65
- Mehdije 277
- Mehemmed 112, 133, 137, 139, 141, 143, 150
- Mehemmed Çelebi XV, XXVIII, 100, 104, 105, 107—116, 121
- Mehemmed Fatih XXXIII, XXXVI, 145
- Mehemmedi II 4, 32, 134, 135, 145, 149, 155, 166, 168
- Mehemmedi III 299-301, 305
- Mehemmed Pasha 188, 308
- mehles* 145
- Mehmed Emin Pasha 355
- Mehmed Gëraj 321
- Mehmed Pasha XXXII, XLIII, 224, 285, 305
- Mehmed Rashid XXXV, 322
- Mehmed Ruzhdi Pasha 423
- Mehmet Reshid 449
- mehter* XIV, XV, XXXVI, 32, 520
- Meka XV, XXV, XXXVII, 136, 141, 146, 163, 195, 202, 219, 229, 235, 236, 241, 254, 264, 279, 292, 466, 472
- Meksikë 275
- Mekteb-i Ulum-ë Harbijje 385
- Melek Hatun 75
- Melik Eshref 249
- Melik Muejjet 234
- memlukët XXIV, 84, 95, 96, 98, 164, 190, 195, 211, 212, 214, 221, 222, 224-242, 249, 251, 253, 369, 372, 374, 510, 539
- Mengli Gëraj 186, 208, 209, 243
- Menon 125, 126
- mensur* 79
- menshur XIV, XXXVI, 22, 25
- Menteshe 77, 84, 85, 108, 116, 121, 148, 277, 563
- Menteshe, Bejliku 101, 110, 121, 122
- menzilhane* 523, 254
- Menzilhane Emimi 523
- menzilkesh 523
- Meriç 57, 59, 61
- Merzifonllu Kara Mustafa 324, 325
- Merxh Dabik 230, 231
- Meslemeh b. Abd il-Melik 5
- Mesazhi Hyjnor XXVII, 521, 488, 533

- Mesazhi i Fundit XXVII, 13,
79, 128, 187, 228, 245, 246,
255, 519, 548
- Mesdheu 16, 66, 110, 175, 178,
209, 221, 248, 253, 275, 276,
287, 289, 292, 323, 333, 335,
344, 356, 368, 370, 373, 375,
386, 389, 399, 433, 463, 559,
560-564
- Mesjeta 30, 42, 139, 140, 142,
161, 164, 191, 537
- Meshrutijet (Kushtetuta) 425,
427, 450
- Mevlaj Muhammed 293
- Mevlana Kara Rystem 62
- Mevlana Xhelaluddin Rumi
31, 504
- mevlid/mevlud* 94, 143
- Mexhel-le-i Ahkam-ë Adlije
413
- Mezid Beu (Beğ) 131, 178
- Mezomorta 560, 563, 564
- M. Fuad Kopryly (Köprülü 29,
30)
- Mid'hat Pasha 422, 423, 426-
432
- Midil-li 109, 125, 166, 178, 213,
219, 267, 374, 431, 463, 562
- Mihal 113, 321
- Mihaliç 92
- Mihalogllu (Mihaloğlu)
Mehmed 117 556
- Mihail 65, 207, 298, 303, 412,
556
- Mikael 118, 119, 207
- Mikail 11, 14
- Milosh Obiliç 79, 80
- Mimar Kasëm Aga 319
- Mimar Muslihuddin 153
- Mirçe 111
- Mirimiran 45, 270
- Mir Muhammed 260
- Mirza XXXVII, 239, 265
- Mjeshtri i Madh 203, 204
- Mohaç 254, 255, 257, 260
- Mojsiu 244, 507, 508
- Molldovanhë Ali Pasha 355
- Moceniko 320
- Molla Husrev 542
- Molla Jegan 542
- Mongol XXXVI, XXXVIII, 17,
18, 24, 30, 34, 63, 244
- mongolët 9, 18, 19, 29, 37, 63,
100-102, 165, 195, 233, 247,
510, 512
- Moreja 94, 95, 110, 121, 125,
166, 181, 185, 210, 212, 213,
323, 333, 335, 344, 345, 356,
375, 380-383, 386-388
- Moreja (Peloponezi) 137, 165,
170, 180
- Moris Bompar (Maurice
Bompard) 455
- Moton 210, 213
- Motting 556
- Mu'avija 214, 522
- mudexhxhel-lët (muslimanët e
Andaluzisë) 272
- Mudanja 40

- muderris XIV, XXXIV, 42, 541,
 543, 566, 567, 583-585
 Muhadije 349
 Muhammed XXVI, XXVIII,
 XXXIX, XL, 3, 8, 13, 29, 33,
 40, 58, 67, 70, 74, 94, 141,
 150, 162, 163, 165, 189, 245,
 300, 303, 319, 320, 417, 496,
 507-509, 511, 513, 516, 527,
 531, 539, 582
 Muhammed Ali 372, 374, 461
 Muhammed Ali Pasha 378,
 382, 386-388, 397, 381, 390
 Muhammed Alp Arslan 14
 Muhammedije 385
 Muhammed Shemsuddin
 Fenari 541
 Muhassil 357
 muhaxhirin XXXIX, 58
 Muhibbi 284
 Muhjiddin Arabi 232
 Muhjiddin ibnul Arabi 240
 Muhjiddin Reis 268
 mukashefe XIV, 160
 Mulla Gyranı 542
 Mulla Fenari 536
 Mukattam, Mali 233
 Murad Beu (Beğ) 46, 54, 369
 Murad Efendi 416, 422, 423
 Murad Gazi 36, 50, 54, 79, 80
 Murad Hydavendigar 64-66,
 69, 237, 238, 478, 504
 Muradi I XXXVI, XXXVIII, 82,
 106, 469, 542
 Muradi II 104, 116, 146, 478,
 569, 570, 584
 Muradi III 294, 298, 478
 Muradije 130, 140, 147, 584
 Murad Han 54-56, 61, 76, 140,
 158, 550
 Murad Pasha 306
 Murad Reis 275, 281
 Musa (a.s.) XXVIII, 244, 507,
 516, 518
 Musa el-Kazim 214, 263
 Musa Çelebi 105, 107, 108, 111,
 114
 Muskat 280, 281
 musel-lem XIV, 53, 64, 549,
 555
 Mustafa Xhenabi XLI
 Mustafa Fazil Pasha 414-416
 Mustafa Kemal 458
 Mustafa Nuri Pasha XX,
 XXXIV, 96, 101, 573
 Mustafa Reshid Pasha 391,
 392, 395, 401, 405, 409
 Mutahharten Beu (Beğ) 96
 Mu'tesim 13
 muxhahid XI, XII, XIV, 6, 63,
 505
 muxhahidinët 25, 49, 58, 75,
 91, 97, 156, 163, 268, 273,
 274, 290, 302, 318, 388, 512,
 517, 534, 549, 555, 556, 558,
 561, 563
 muteveli XIV, 84, 565, 567,
 573, 584
 myderris XIV

- Myhendis'hane-i Berri-i
Hymajun 374
- Myhendis'hane-i Bahri-ji
Hymajun 373, 374
- myhr-i hymajun XXVIII, 187,
430, 519, 548
- mykashefe XIV
- Mynexhxhimbashë Ahmed
Lytfullah 31
- Mynir Beu (Beğ) 439
- Mynsheat-i Selatin XXXII,
XXXV
- mysel-lem XIV
- mytevel-li XIV
- muzaffer 79
- myxhahid XIV
- Myezzinzade Ali Pasha 290
- N**
- nacionalizmi 272, 378, 379,
383, 386, 466, 471
- Nadir Ali 347
- Nadir Shah 351
- Nahçevan 266
- Naima XIX, XXXIV, 239, 309,
485, 596
- Nakibu'l Eshraf 539, 540, 543
- Namazi i Bajramit 34
- Namazi i së Xhumasë XXXV,
33, 34, 84, 158, 201, 228, 234,
240, 320, 442, 451, 547, 574
- Name-i Hymajun 58, 315, 514
- Namëk Kemal 415, 416, 431
- Napoli 56, 64, 168, 175, 176,
183, 188, 206, 207, 212, 276,
483
- Napoleon Bonaparti 180, 270,
368-371, 374, 378, 382, 398,
399, 534
- Napoleoni III 417, 429
- Nasirud Din Farak 95
- Nasreddin Hoxha 166
- Nasuh Pasha 306
- Naxhije Sulltan 462
- Nazëm Pasha 459, 461
- nedim XIV, XXXIV
- Nesai 598
- Ngushtica e Dardaneleve 49,
135, 318, 320
- Neshri (Neşri) XIX, XXXII,
XXXIII, XXXIX, 139
- Nestorianizmi 195
- Nica 204, 276
- Nigbollu (Niğbolu) 74, 75, 88,
89, 91, 94, 98, 108, 238
- Nigde (Niğde) 89, 95, 112
- Nikea XLII, 15, 16, 19, 37, 41,
100, 245, 256, 568, 575
- Nikolas o'Koner (Nicolas
o'Conner) 455
- Nikopoli 66, 75, 89, 90, 93, 95,
101, 108, 238, 433, 536, 542,
551
- Nilyfer Hatun 36, 42, 45
- Nish 72, 73, 177, 331, 349
- Nizam-ë Xhedid 367, 373-376,
392, 533
- Noe 165, 244

- Nubia 240 81, 143, 158, 478, 505, 512,
 Nuhu (a.s.) 7, 244, 507, 518 517, 518, 549, 550, 566, 569,
 Nuri (Xhonker) 458 571, 583
 Nuri Jyxhe 8 Ortodoks 69, 87, 90, 105, 151,
 160, 162, 165-167, 170, 171,
O 186, 194, 290, 324, 325, 344,
 380, 381, 394, 400, 401, 420,
 460, 513
 Odjan Efendi 428
 Okjari 458 Oruç XXXIII, 267, 268, 269
 Omer b. el-Hattabi XXVI, 509, Oruç Reis XLI, 268-270, 562
 557 Osman
 Oguz (Oğuz) 8, 11, 21, 37 Osman Beu (Beğ) 24, 31-38,
 129, 177
 Oguz Han (Oğuz Khan) 7
 Ogyst Konti (August Comte, Osman Fevzi Pasha 454
 450 Osman Gazi XXX, XXXII,
 Olivera Despina 83 XXXV, XXXVI, 22, 24, 25,
 26, 28, 31, 33, 34, 36, 39, 40,
 Oltaniçe 401 42, 52, 63, 393, 469, 478, 486,
 504, 547, 568, 569, 571
 Omer b. El-Hattab XXVI, XXXVII, 12, 158, 509, 557
 504, 547, 568, 569, 571
 Omer (Ömer) Beu 187 Osman Halis Efendi 348
 Omer (Ömer) Efendi 310, 311 Oshal 9
 Omer (Ömer) Pasha 401, 411 Oshr XIV, 12, 71, 523, 525, 526,
 530, 532, 533, 556, 558, 567
 Omurtag Han 9 Oshr-ë sher'i 525
 Ordu 11, 510 Oshyr (öshür) XIV
 Ordu-ju Hymajun XXVII, 187, Osman Turan XLI, 122, 256
 202, 207, 230, 241, 255, 258, Ostroviça 167
 259, 261, 266, 287, 299, 300, Otluk hisarë 109
 309, 314, 325, 332-334, 341, Otlukbeli 182, 183
 364, 376, 519, 548, 549, 552- Otranto 188, 189
 558
 Orhan Beu (Beğ) 35, 38, 40, 41, Othman b. Affan 12
 47, 53, 54, 566 Ozdemiroglu (Özdemiroğlu)
 Orhan Gazi XII, XIV, XXVIII, Osman Pasha 296
 XXX, XXXII, XXXVI, XLIII, Ozi (Özi), kështjella 309
 39, 41, 42, 45-48-54, 64, 66,

- P**
- Palmerstone 417
- Panait Istrati 415
- Papa 66, 87, 90, 104, 135, 154, 176, 178, 180, 185, 189, 202, 206, 207, 212, 261, 280, 420
- Papa Bonifacios IX 90
- Papa Kaliksus III 169
- Papa Leon X 242
- Papa Nikolasi V 151
- Papa Pali II 185
- Papa Pali III 274
- Papa Piu II 171, 176, 178, 196
- Papa Urbani V 60
- Parlamenti 411, 431-434, 454
- Pars Han 9
- Pasha XL, 81, 210, 224, 397, 563
- Pataren 179
- Patriark 151, 160, 166, 194, 380-382, 394, 400, 420
- Peçenek 8, 18
- Peçuji 147, 301
- Peçuji Ibrahim XXX, 300
- Pejgamberi i Fundit XIII, XV, XVI, XXX, 29, 33, 40, 67, 150, 245, 507, 508, 527, 531, 545, 572
- Pejgamberi i Fundit Muhammed XIII, XV, XXVI, XXVIII, XXXIX, 29, 33, 40, 49, 67, 70, 94, 141, 150, 162, 244, 472, 507, 508, 516, 527, 531, 539, 582
- Pelekanon 41
- Pendik 114
- Penon 269, 271
- Perandori i Gjermanisë 126, 129, 261
- Perandori Joanis 60, 66, 69, 104
- Perandori Manuel 86, 118
- Perandori romak Joanis Paleologos 134
- Perandori romak Nikifori 6, 12
- Perandorit romak Theofilos 7
- Perandori Romak 485
- Perandoria Romake XXX, XXXVI, XLIII, 3, 12, 16, 19, 37, 54-60, 65-68, 75, 85-90, 97, 104, 114-119, 125, 145, 156, 163, 185, 188, 193, 196, 238, 420, 474, 533
- Perandoria Austriake 264
- Perandoria Bizantine XXX, 43, 45, 46, 136
- Perandoria Pontus 16, 166, 171, 173, 174, 559
- Perandoria Romake e Lindjes 37
- Pero de Kovilja (Covilha) 164
- Persia Sasanide 3
- Pervin Felek Hanum 439
- Petervaradin 180, 345
- Petër XLIV, 341, 342, 354
- Petronion, kështjella 109
- Petru Aron 186
- për herë të parë XXXIX, 8, 29, 58, 64, 76, 154, 158, 282,

- 307, 378, 405, 473, 522,
551, 581
- Pianosa 210
- Pietro Zeno 110, 111
- Pijale Pasha 278, 287, 289
- Pir Ahmed Beu (Beğ) 181, 182
- Piri Mehemed Pasha 168
- Piri Mehmed Çelebi 225
- Piri Mehmed Pasha 225
- Piri Reis XXXIV, XLI, 280, 281,
561, 562
- Pisaro 212
- Pjer (Pierre) L'Hermit 16
- Pjer Lafit (Pierre Lafitte) 450
- Podesta i Peras 73
- polakët 102, 187, 254, 255, 299,
303, 309, 310, 320, 324, 334,
335, 403
- Polen de Lagard 276
- Polonia 88, 131, 137, 138, 183,
190, 210-212, 303, 305, 309,
310, 320, 324, 326, 333, 343,
354, 533, 556
- Ponza 277
- Portugalia 35, 202, 164, 194,
218, 219, 260, 264, 274, 294,
295, 326, 490, 559, 562
- portugez XLII, XLIII, 164, 195,
219, 230, 231, 235, 236, 247,
264, 278-283, 292, 295, 472,
474, 561
- Potur 179
- Potur oğullari (Potur oğulari)
179
- Pravadi 74
- Prester Xhon 195, 295
- Preveza 209, 267, 274, 275, 277,
368, 371, 559, 562, 563
- princ i kurorës 217
- Princesha Sofia 185
- Princi Bismark 437-439
- Princi Henri 164, 295
- Princi Koburg 365
- Princi Meçnikov 401
- Princi Trubeçkoj 321
- Princi Viogorski 321
- Prodos Lozha 436
- Profeti XXX, 13, 138, 161, 163,
164, 214, 215, 241, 244, 255,
300, 319, 328, 332, 363, 447,
448, 482, 496, 507, 516, 518
- Pruti XLIV, 341, 343, 355, 378
- Pulat Timur 10
- Pustin Push Baba 61
- Q**
- qiellor XXVII, 46, 207, 287, 303,
321, 377, 428, 484, 487, 488,
489, 507, 517, 519
- qiellore, detyrë 46
- Qipro VI, 92, 110, 236, 242,
289, 290, 291, 369, 415,
437, 438
- R**
- Raab 297, 307
- ra'aja XIV, 140, 378, 536, 537
- racizëm XXV

- ra'ijjet XXXI, 70, 140, 240, 378,
 469, 531, 532, 536, 537, 589
 Radul 177
 Ragib Pasha 353
 Raguza V, 179, 533, 534
 raison d'etre 223, 491, 494
 raijjet XIV, 488
 Rakoçi 320
 Ramazanogllu (Ramazanoğlu)
 212
 Ramazan Pasha 295
 Ranuna, lugina 33
 Redif Pasha 430
 reich 21, 34, 35
 Reisul Kuttab Mustafa 326
 Rejdaniijeh 233
 Rekonkuista 195
 rekonkuista 268
 Republika e Venedikut 56, 88,
 92, 110, 125, 148, 175, 178,
 181-183, 188, 207, 213, 236,
 242, 261, 274, 305, 399, 533
 Reshadije 463
 Reshid Pasha 382, 383, 392,
 395, 401, 405, 409
 Revan XXXII, 296, 305, 308,
 314, 346, 347, 351
 Revan (Erevan) 266, 305
 Rexheb Han 282
 Rexheb Pasha 458
ribat 51
 rinia sufite 29
 Rodos 90, 125, 202-205, 251,
 253, 275, 368, 459
 Rodos, ishulli 108, 182, 183,
 246, 251, 363, 369
 Robert Xh. Skratn (Robert J.
 Scrutton) 43
 Roma 188
 romakët 14, 16, 19, 31, 41, 43,
 50, 63, 69, 119, 125, 133, 154,
 155, 157, 158, 165, 174, 191,
 206, 232
 Romanov 355, 357
 Romanus Diogenus 14
 Rozhe de Flor (Roger de Flor)
 64, 65
 Rudolfi II 297
 Rum(ët) 14, 16, 29, 76, 381,
 382, 394, 412
 Rumeli Hisarë 149, 150
 Rumelia (Evropa Osmane) XI,
 XIV, XXXVII, 51, 58, 68, 69,
 75, 81, 84, 87, 94, 108, 113,
 116, 120, 126, 127, 131, 148,
 149, 169, 217, 224, 225, 261,
 368, 374, 375, 378, 381, 382,
 388, 395, 453, 454, 460, 519,
 528, 543, 544
 Rusçuk 364, 376, 560
 Rusia XXXVIII, 35, 185, 186,
 227, 243, 244, 270, 288, 289,
 304, 321-325, 342, 347, 348,
 351, 353-371, 377-381, 386-
 391, 394, 397-405, 410-413,
 417-422, 427, 432-437, 445,
 446, 450, 451, 458, 460, 463-
 467, 476, 487, 490, 533, 561,
 564

- Rustem Pasha 285
- S**
- Sa'adet Gëraj 243
- Sa'd b. Ebi Vekkas XXXIX, 77, 78
- Sa'deddin Ali Solakzade XXXII
- Sa'deddin Efendi 300
- Sadik Beu (Beğ) 438, 439
- sadrazam XII, XV, XXXIII, XXIX, 179, 224, 253, 285
- Sadrazam XV, XXXII, XLIV, 288, 291
- Sadrazam Ali Pasha 344, 345
- Sadrazam Bozokllu Mustafa Pasha 332
- Sadrazam Elmaz Mehmed Pasha 334
- Sadrazam Halil Pasha 308, 345
- Sadrazam Hysejin Pasha 310
- Sadrazam Kemankesh (shigetari) Mustafa Pasha 317, 330
- Sadrazam Nevshehirli Ibrahim Pasha 345, 346
- Sadrazam Javuz Ali Pasha 305
- sadr-ë azam 517
- Safi ed-Din Is'hak 213, 214
- Safranbollu 190
- Safvan 29
- Sahabi XXXIX, XL, 3, 4, 12, 160, 427, 505
- sahib-i arz 526
- Saideli 109
- Said Pasha 428, 442, 460
- Sakëz 109, 125, 156, 166, 287, 333, 431
- salat XV, XXIX, 507, 529
- salat el-haxheh XII, 78
- salavat 141, 539, 540
- Salih Reis 274, 275, 563
- salijane, urdhri 253
- Salur 8
- Salltanat-ë Senijje 21
- Samakov 68
- Samarkand XXXVII, 97, 192, 422
- Samsun 89, 357, 559
- sandëk 527
- sanxhak 58, 82, 113, 137, 157, 215, 219, 250, 260, 421
- sanxhakbej (sanxhakbegi) 82, 95, 172, 184, 217, 236, 307, 314, 319, 332
- Sanxhak-ë Sherif (Flamuri i Profetit) 255, 300, 319, 332, 363, 384, 539, 540
- Sanxhaku i Beut 46
- Sakalibeh 8
- Sardenja 210, 405
- Sare Hatun 173
- Sarë Mehmed Pasha XXVII, 327
- Sarë Timurtash Pasha 94
- Sarkofagu i El-Me'munit 7
- Saruhan 69, 84, 85, 108, 110, 116, 148, 219
- Saruxha Pasha 153

- Sav Tigin 14
 Savakin 240
 Seerrai 58
 Sekban 549, 554
 Selanik 56, 88, 112, 113, 124,
 125, 455, 456, 522
 Selaniki XXXIV
 Selanik (Thesaloniki) 60, 112
 Selçuk 11, 14, 510
 selçukët XXVII, XXVIII, XXIX,
 XXXVI, XXXVIII, 15-19, 23,
 25, 26, 30, 100, 108, 470, 516,
 528, 568, 574, 576, 583
 selçukët e Anadolliit XXVII,
 XXVIII, XXXVI, 16, 17,
 22 23, 30, 33, 98, 470,
 516, 526, 528, 558, 574,
 576, 583
 Selçukname XXXII
 Selimi 215, 217-219, 225, 227,
 231, 232, 239, 284, 285, 289,
 367, 376
 Selim Gëraj 357, 362
 Selimi II 285, 287, 294, 584
 Selman el-Farisi 13
 Selman Reis 242, 253
 Semendire 129, 170, 217, 331
 Senati i Venedikut 104
 Şerafettin Turan XXXIV, 31,
 154
 Serbia 50, 81, 170, 56, 57, 60,
 72, 80, 83, 87, 90, 113, 128,
 166, 170, 176, 178, 349, 363,
 375, 378, 401, 421, 429, 434,
 446, 460, 461, 533
 Mbreti Serb 68, 170
 serbët 56, 61, 68, 74, 80, 83, 99,
 103, 105, 169, 170, 171, 256,
 296, 363, 378, 412, 492, 557
 Serez 56, 68
 skllavëri 46, 52
 Serhad Kullu 549, 555
 Sejdi Ahmed Pasha 320
 Sejdi Ali Reis 274, 281, 282
 Sejdishehri 71, 110, 148
 Sejitgazi 6
 Sejjid Ali Natta b. Muhammed
 539
 Sejjid Battall Gazi 5
 Sejjid Mahmud Jakub 410
 Sejjid Mustafa Nuri Pasha 573
 Sërpsëndëgë (Sırpsındığı) 60,
 61, 68
 Sidni (Sidney) Smith 371
 Sigetvar 284, 287, 298, 553
 sikke XXXV, 34, 84, 112, 249,
 253, 271, 438
 Silahdar Fëndëklëllë Mehmed
 Aga XXXIV
 Silahdar Mehmed Pasha 348
 Silistre 217, 357, 363, 378
 Rruqa e Mëndafshit 19
 Simav 71
 Sinaj 233
 Sinan Pasha 126, 127, 225, 228,
 229, 273, 293, 297, 298, 305,
 556, 567
 Sinop 17, 112, 121, 172, 374,
 401, 559

- sipahi XV, XXX, 70, 525, 549,
 580
 spahinjë XXXI, 70, 311, 330,
 351, 475, 532, 550
 Sër Antuan Shirli (Sir Antoine
 Shirley) 305
 Sisam 16
 Sitti Mykrime Hatun 139
 Sivas 18, 89, 95, 98, 504, 523
 Skuerkiafiko (Squerciafico)
 186
 Skutari 3, 12, 46
 Sokia 16
 Sofja 72
 Sofu Bajezid 104
 Sogyt (Söğüt) XXXII, XXXVI,
 19, 21, 22, 218
 Sokollu Mehmed Pasha
 XXXII, XLIII, 285, 288, 289,
 291, 341, 587
 Solakzade XXXII, XXXIX,
 XLII, 133
 Sozopol 68
 Spanja XL, 65, 194, 212, 218,
 242, 258, 259, 268, 270, 271,
 274, 290, 294, 295, 324, 326,
 340, 402, 490, 495, 559, 562
 spanjoll XLI
 staat (shtet) 20, 34, 35
 state (shtet) 20, 34, 35
 Stefan Dushan 57, 533
 Stella 145, 147
 Stefan 211
 Stefan Cel Mare 187, 209
 Suakin 281
subh 156
 subjektiv XXV, 66, 482
 subjektë XIV, 407, 492, 497,
 516, 531, 532
 Sudak 17
 Suez 248, 279-282, 292
 Suez, Kanali 419, 463, 466
 sufi XV, XVI, 4, 26, 51, 132,
 315, 504, 563, 568-572, 581,
 586, 590
 Sufi 4, 120, 123, 133, 240
 Sufjan b. Avf 3, 12
sexhde 78
 Sukkakini 414, 415
 Sulltani Alau'd Din 282
 Sulltanati 106, 116, 205, 218,
 294, 315, 469
 Sulltanati i Rumit 16
 Sulltani Bajezidi XXXVII, 90,
 92, 94, 99, 202, 203, 206, 208,
 217, 218
 Sulltan Bajezidi II 189, 207,
 209, 539, 586
 Sulltan Fatihu 160, 162, 163,
 166, 168, 171, 173, 174, 176-
 194, 226, 404, 584
 Sulltan Hasani 273
 Sulltan Mahmudi 347, 348,
 352, 353, 373, 377, 380, 383,
 385, 388, 390, 391, 547
 Sulltan Mehemedi II 32, 112,
 135, 149, 150, 153, 155, 160,
 173, 186, 238, 243
 Sulltan Mehemedi III 299-
 301

- Sulltan Muradi XV, XXXVIII, XLIII, 54, 56, 58-61, 64-83, 90, 103, 117, 118, 120-143, 146-148, 158, 175, 314, 315, 517, 553, 578, 583, 586
- Sulltan Muradi I 106, 211
- Sulltan Mustafa III 353, 357, 373
- Sulltan Mustafa IV 376
- Sulltan Selimi 219-222, 227, 228-233, 241-243, 246, 247, 251, 268, 374, 375, 469, 513
- Sulltan Sylejmani 225, 249-251, 255, 257, 259, 261, 263, 266, 272, 282, 284, 285, 287, 304, 310, 331, 332, 478
- Sulltani Memluk XXXVIII, 37, 87, 95, 104, 201
- Sumatra 282
- Sunnet XV, 67, 70, 215, 228, 511, 528
- Surat 282
- Sururi Efendi 439
- Suvar 9
- Suvejsh 292, 559
- el-Suvejsh (Suez) 248, 279, 292
- surreh XV, 202
- Sylejman Aga 310, 311
- Sylejman Çelebi 93, 100, 101, 104, 107, 108, 143
- Sylejman Pasha XXXVI, 36, 41-54, 81, 260, 279, 423, 431, 433, 157
- Sylejman Shah 16, 71
- synnet XV
- sünnet düğünü XL
- Syrmeli Ali Pasha 333
- syrre XVI, 235
- Sylejmani i Madhërishëm XXVIII, XXXII, XXXIII, XXXIV, XLI, 239, 249, 251, 253-267, 272, 284, 285, 291, 298, 304, 310, 369, 400, 475, 476, 486, 517, 553, 554, 577, 584, 585
- SH**
- Sh. Stefani 254, 434, 437
- Shami 95, 246, 249, 251, 510, 544
- Sharli VIII 204, 206
- Sharli VI 101, 204
- Shah 215, 222, 223, 296, 313, 314, 326
- Shah Abbas 304-306, 308
- shahi* 152
- Shahin Ali Pasha 364
- Shahin Gëraj 362
- Shah Ismail 214, 215, 217, 218, 221, 222-227, 230, 235, 239, 249, 250, 259, 263
- Shah Ismail Safevi 213
- Shahkullu 215
- Shah Tahmasb 265, 266, 296, 347
- Shanizade XXXIV
- Shebinkarahisar 184
- shehid (martir) 79, 349, 581
- Shehremaneti 547

- Shehsuvar Beu (Beğ) 228, 234
 Shehsuvarogllu
 (Şehsuvaroğlu) Ali Beu
 (Beğ) 249
 shehzade XV, 100, 107, 108,
 112, 117
 Shehzade Ahmed 215, 218
 Shehzade Mustafa 104, 182,
 363
 Shehzade Orhan 149
 shehzadet 82, 104, 117, 217,
 220, 584
 shejh 31, 35, 51, 158
 shejhulislam XV, 519, 540-542
 Shejhulislam Esad Efendi 310
 Shejh Ahmed 408
 Shejh Akshemseddin 4, 156,
 158-160, 578
 Shejh Aziz Mahmud Hudai
 311, 504
 Shejh Bedreddin 111
 Shejh Ebu Vefa 254
 Shejh Edebali 26-28, 33, 35, 42,
 45, 159, 504, 537, 568, 569,
 571
 Shejh Emir Sulltan 123, 124,
 141, 501
 Shejh Kutbeddin 104, 106
 Shejh Ramazan 104
 Shemseddin Fenari 536, 541,
 583
 Shemseddin Sivasi 504
 Shemsi Pasha 453
 Sherif Hasan Pasha 365
 Shermet Kapudan 371
 shariat XXIX, 25, 34, 39, 62, 67,
 82
 Sheriat XIII, 76, 96, 97, 223,
 234, 360, 377, 408, 471, 512,
 520, 525, 528, 530, 533, 536,
 540, 546, 550, 578
 Sherif Ebu Numej 236
 Sherif Numej 279
 Shën Xhoni (Saint-John) 90,
 100, 101, 108, 183, 203, 231,
 244, 246, 251, 252, 277, 278,
 287, 291, 323, 368, 369, 562
 Shën Severini 111
 Shën Stefani 254, 434, 437
 Shejh Shamil 402
 Shibabu'd Din el Hemevi 27
 Shiit-Bujit 11
 shiit 213-215, 221, 224-229, 239,
 246, 296, 472, 510, 582
 shiizmi XXXVIII, 213-215, 218,
 221, 228, 230
 Shiltberger (Schiltberger) 91
 Shinasi 414, 146
 Shirvan 265, 296, 306, 346
 Shishman 66, 68, 74, 75, 90
 Shkodra 88, 187, 188
 Shkup 127, 170
 Sho (Shaw) XXIII, XXIV,
 XXVII, XXVIII, XXX, 328,
 431
 Shqipëria V, 88, 110, 120, 168,
 175, 176, 181, 188, 265,
 457, 460, 489
 shqiptarët 56, 370, 457
 Shtipi 72

- Shumnu 74
 Shura-jë Devlet 421, 542
 Shykri Pasha 461
- T**
- tablhane XV, 32
 Tablhane (Mehter) 32
 Tahmasb 263, 266, 296, 347
 Tahmasb Han 259
 Tajfur Pasha 365
 takrir 526, 585
 Tamerlan 97, 492
 tapu 525
 Tarhunxhu Ahmed 310, 331
 Tarih-i Ebu'l Fet'h XXXIII
 tarikat XV, XVI, 213, 568, 571
 Tarsus 6, 7
 Tasheli 110, 127, 132, 148, 182
 tatarët 18, 19, 26, 100, 101, 102,
 244, 343
 Tavshanllë 71
 Taxhikistan 473
 Taxhu't Tevarih XXXIV, 226,
 233, 299
 Tebriz 98, 225, 226, 250, 263,
 265, 267, 296, 305, 306, 308,
 346
 tefviz XXVIII, XXIX, 515
 Tekavur Efendi 439
 Teke 77, 84
 tekfur XVI, 19, 31, 36, 37
 tekke/teqe XVI, 30, 61, 141,
 143, 571, 580, 581
 Teofilos 13
- Tepedelenli Ali Pasha
 (Tepelena) 380, 381
 Tetish 9
Tevarih-i Al-i Osman XXXIII
 Tevfik Beu (Beğ) 439
 tëmar XIII, XVI, XXX, 70, 351,
 549, 556, 558
 Tërnovo 74, 88
 Tiflis 296
 timar XIII, XVI, XXX, XXXI,
 39, 40, 51, 70, 254, 265, 330,
 344, 351, 360, 361, 475, 521,
 523, 525, 552, 554, 558, 561
 Timishoara 261, 345
 Timurtash 136
 Timurtash Pasha 68-72, 81, 85,
 94, 129, 517, 518
 Tirjaki Hasan Pasha XL, 301,
 302, 514
 Tlemcen 269
 Toka e Shenjtë 90, 292
 Tokaj, Kuvendi në 257
 Toktamësh 10, 244
 Tomas 166, 185
 Tokat 89, 95, 122, 182, 523
 Topall Osman Pasha 347
 Tosja 112, 121
 Trablusgarb 278, 294, 317, 318,
 563, 564
 Trabzon 127, 173, 174, 177,
 183, 217, 367, 559
 Trakia 56, 57, 59, 60, 67
 Traktati i Berlinit, 436
 Traktati i Hynkar Iskelesi 390,
 391, 399

- Traktati i Londrës 386, 387, 397, 399
 Traktati i Parisit 370, 401, 403, 405, 407, 411, 418, 427, 433, 487, 493
 Traktati i Rashtadit 345
 Traktati i Vestfalias (Westphalia) XXVI, 35
 Traktati i Zivatorokut XLIII, 307
 Transilvania 129, 131, 256, 257, 260, 320, 333, 334
 Trebizond 16, 118, 166, 171, 174, 207
 Tripoli 277, 278, 458
 tug (tuğ) XVI, 31, 58, 260, 541
 Tugra (Tuğra) 66, 496, 517, 520, 521
 Tugrull Beg (Tuğrul Beğ) 11, 14, 510
 Tuhfetu'n Nuzzar XXXII
 Tulon 276, 417
 Tumanbej 231, 233, 234
 Tunizia XLI, 212, 268, 271, 272, 273, 293, 294, 317, 318, 388, 390, 438, 439, 441, 485, 494, 495, 562, 564
 Tunxha 57
 Turahan Beg 124, 127
 Turgut Alp 36
 Turgut Pasha 278, 563
 Turgut Reis 274-277
 Turhan Beg 187
 Turkestan XXXVIII, 8, 11, 30, 41, 63, 79, 97, 99, 101, 102, 182, 214, 256, 354, 410, 422, 484, 487, 510
 Tur Sina 279
 Tursun Beu (Beğ) XXXIII, 47
 Tyrke vermek 63, 550
 Tyrk-i Iman 8
 Tyrkiman 8
 Tyrkmen 8
 Tyfenkxhi 554
- TH**
 Theodor 69
 Thesaloniki 60, 112
- U**
 Ubejd Han XXXVII, 239
 uç beji (beği) 21, 478
 ulema 9, 39, 97, 140, 186, 243, 246, 268, 270, 311
 ulufe XVI, 51, 350, 383, 549, 550
 Ullubad 37, 117
 Ulluxhami 92, 93
 Ulluç Ali Pasha 290, 291
 Ullu Xhami 143, 238
 Ulu'l Azm 507
 ullu vezir XXVIII
 Ummet 237, 239, 303, 393, 471, 509-511, 565
 Urban 153
 Urla 16
 Urosh 60
 Ustazhllu Mehmet Han 222

- ushr, XIV, XXIX
 Ushtria Kryqtare 61
 ushtria osmane 63, 91, 95, 100,
 103, 109, 121, 135, 139, 153,
 155, 165, 169, 170, 172, 181,
 183
 Uzbekistan (Özbekistan) 97,
 102
 Uzun Hasan 171, 174, 178,
 180-185
- V**
- Vadi's Sejl 294, 295
vahj XXVI, 508
 vakëf XIII, XIV, XXI< XL, 82,
 84, 85, 114, 141, 143, 146,
 191, 240, 253, 301, 308, 396,
 525, 526, 527, 537, 541, 565-
 568, 571, 573-576, 579, 581,
 584
 Vak'a-jë Hajrijje 383, 384
 vali 231, 234, 240, 309, 318-320,
 344, 347, 357, 367, 371, 372,
 374, 382, 390, 404, 421, 422,
 430, 440
 Vardar, lumi 72
 Vardar Jenixhesi (Jenixheja e
 Vardarit) 125, 267
 Varna 104, 135, 136, 149
 Vasko de Gama 219, 278
 Vazag 131
 veli XII, XIV, XVI, 79, 132, 133,
 158, 160, 563
 veliahd XXXV, 217
 venedikasit 88, 90, 94, 125, 171,
 176, 177, 180, 181, 210, 212,
 243, 318
 Venediku 50, 56, 84, 88, 104,
 110, 125, 135, 137, 148, 156,
 175-177, 180, 181, 187, 188,
 190, 212, 213, 272, 274, 290,
 291, 293, 303, 318-324, 335,
 344, 345, 356, 368, 533, 534
 Veroja (Karaferje) 68
 Vertinak 367
 Vesiletun Nexhat 94
 vezir XII, XVI, XXVII, XXVIII,
 81, 116, 117, 179, 224, 229,
 302, 356, 376, 397, 430, 515-
 517, 521, 586
 Vezir Ahmed Pasha 253
 Vezir Hysrev Pasha 372
 Vezir-i Azam 74, 107, 156, 170,
 228, 254, 285, 517, 521
vezir i tefvizit XXIX, XXVIII,
 515
 Vezir Uzun Ibrahim Pasha 325
 Vidin 84, 86, 126, 177, 348, 349,
 364, 382, 420, 433
 Vilajet-i Antilia 561
 Vinsent Kapelo (Vincent
 Capello) 274
 Vjena XLIV, 57, 257, 258, 297,
 301, 325-331, 401, 417, 451
 Vlad 177, 178
 Vlad Drakul 120, 129
 Vladislav 211
 Vlad Tepesh 177

- Vllahia 60, 84, 93, 111, 116,
120, 128, 129, 135, 137, 177,
207-209, 254, 355, 359, 378,
380, 381, 394, 401, 411
vllahët 74, 87, 102
Vojvoda i Bogdanit 183, 185-
187, 209, 211, 309
Vojvoda i Vllahisë 111, 128,
177, 208, 209
Vojvodë 111
Vulakogllu (Vulakoğlu) 126
Walter Livingstone XXVII,
XXX, 472
Wright, Jr. XXVII, 472
- XH**
- Xhafer b. Abdullah 9
Xhamia Aja Sofja 329, 541
Xhamia e Gjelbër, 114
Xhanberdi Gazali 249, 250, 253
Xhanëbek 59, 237
Xhanëbek Gëraj 310
Xhandar 109, 112
Xhandarogllu (Jandarogllu),
Bejliku 89, 111, 112, 121,
124, 127, 172
Xhanik 109, 357
Xhanik, Bejliku 89
Xhelalu'd Din Dinar 282
Xhem 174, 189, 201-207, 210,
212
Xhemal Bej 462
Xhemal Pasha 461, 463, 464
Xhendereli Halil 73, 89, 517
Xhendereli Kara Halil 28, 41,
62, 81, 82, 543
Xherba 67, 268, 278
xhevanmerd 28
Xhevri 147
Xhezair 268-276, 293, 294, 317,
38, 388-390, 562, 564, 582
Xhezajirli Gazi Hasan Pasha
365
Xhezajirli Hasan 356
Xhezajirli Hasan Pasha 364
Xhezzar Ahmed Pasha 369
Xhidde 231, 236, 279, 407, 408
xhihad XI, XII, XVI, 4, 11, 12,
14, 32, 39, 40, 45, 46, 48, 51,
56, 57, 59, 70, 75-78, 82, 85,
88, 97, 99, 105, 148, 160, 162,
167, 168, 171, 210, 223, 237,
256, 267, 284, 298, 331, 335,
350, 464, 469, 475, 476, 510,
515, 523, 525, 531, 539, 540,
541, 549, 551, 558, 561, 562,
574, 581
Xhixhel 269
xhizjeh XVI, XXIX, 6, 13, 67, 68,
71, 250, 403, 404, 529-532
Xhingiz Hani 18, 101, 232
Xhovani di Kapistrano
(Giovani di Capistrano),
169
Xhozef Çemberlen (Joseph
Chamberlain) 442
Xhynejd Beu (Beğ) 108, 116,
117, 122

- Y**
- Zigismund 86-89, 91, 111, 126,
127, 129
- Yftade 504
- Zihne (Alistati) 68
- Yregir (Üreğir) 8
- Zija 414, 415, 430
- Z**
- Zija Beu (Beğ) 422, 430
- Zija Pasha 372, 414, 416, 435
- zil-lullah XXXVI, 59, 87, 158,
238, 514
- Zaganos Pasha 156
- Zishtovi 363, 367
- Zagra 59
- Zitvatorok XLIII, 307
- Zapolja 257, 258, 261
- Zaptje Myshirijeti 547
- Zoe (Sofia) 185
- Z. Duckett Ferriman XXIII
- Zulkarnejn 7
- Zejudi 282
- ZH**
- zeamet* 330, 475
- zekat* XVII, XXVI, XXIX, XXX,
45, 53, 68, 71, 142, 528, 529,
566
- Zhan (Jean) de la Foret 264

Prof. Dr.
Mehmet
MAKSUDOĞLU

HISTORIA
OSMANE DHE
INSTITUCIONE



ISBN 978-975-17-4201-8

